

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

DOKUMENTA KRYESORE  
TË PARTISË  
SË PUNËS TË SHQIPËRISË

BIBLIOTEKA  
E  
SHKOLLËS SË PARTISË

TIRANË, 1971





## PARATHËNJE

Me vendim të KQ të PPSH, ka filluar që në vitin 1960 botimi i «Dokumentave kryesore të PPSH».

Në «Dokumenta kryesore të PPSH» përfshihen dokumentat më të rëndësishme të Partisë sonë, rezolucione dhe vendime të kongreseve dhe të konferencave të Partisë, të plenumeve të KQ si dhe dokumenta të tjera të Partisë si direktiva, qarkore, letra e thirrje të KQ.

Meqenëse vëllimi I dhe vëllimi II nuk gjenden nëpër libraritë, edhe nëpër bibliotekat janë në sasi shumë të kufizuara, u ndërnuar botimi i dytë i dy vëllimeve të para.

Në vëllimin I të «Dokumentave kryesore të PPSH» përfshihen dokumenta që nga krijimi i PKSH e deri në fund të vitit 1948.

Në botimin e dytë të këtij vëllimi janë futur edhe disa materiale të reja të kësaj periudhe, të cilat në treguesin e lëndës janë shënuar me një yll para numrit rendor.

Në dokumentat që përmban ky vëllim mishërohet vija e Partisë për periudhën e Luftës nacional-çlirimtare dhe për vitet e para pas çlirimit.

Vëllimi I, «Dokumenta kryesore të PPSH», përmban dokumenta që kanë vlerë të madhe teorike dhe praktike. Në to bëhet përgjithësimi i përvojës së pasur të të gjithë luftës e veprimtarisë revolucionare të Partisë sonë dhe zbatimit krijues të marksizëm-leninizmit në kushtet e vendit tonë.

Në to argumentohen thellësisht mbi baza marksiste-leniniste dhe të praktikës sonë revolucionare strategjia, taktika, qëllimet dhe detyrat e mëdha që duhej të zbatonte Partia në këto periudha që janë nga më të lavdishmet në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar.

Në to janë përpunuar mbi baza shkencore problemet themelore të çlirimit kombëtar dhe të fitores së revolucionit në Shqipëri siç janë: bashkimi i popullit në një Front të vetëm Nacional-Çlirimtar, organizimi dhe fitorja e kryengritjes së armatosur, krijimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, ngritja dhe konsolidimi i pushtetit popullor, qëndrimi parimor ndaj «Ballit Kombëtar», «Le-

galitetit», aleatëve të jashtëm, koalicionit anglo-sovjeto-amerikan, popujve fqinjë e të tjerë.

Në këto dokumenta njihemi me luftën heroike të komunistëve dhe masave popullore kundër armiqve të jashtëm, pushtuesve fashistë italianë e gjermanë, imperialistëve anglo-amerikanë, revizionistëve jugosllavë, si dhe me luftën kundër armiqve të brendshëm, tradhëtarëve të vendit që bënë kauzë të përbashkët me pushtuesit.

Në to jepet qartë dhe në mënyrë bindëse drejtësia e politikës konsekuente marksiste-leniniste e Partisë për ruajtjen e unitetit të radhëve të saja dhe pastërtinë ideologjike të marksizëm-leninizmit. Lufta kundër fashizmit, oportunitizmit, sektarizmit dhe revizionizmit zënë një vend të rëndësishëm në materialet e kësaj periudhe.

Me principialitet të lartë dhe guxim revolucionar KQ i PKSH ka luftuar dhe përballuar shumë vështirësi e rreziqe të shkaktuara nga ndërhyrja dhe orvatjet antimarksiste dhe antishqiptare të udhëheqjes jugosllave dhe të Partisë Komuniste Jugosllave ndaj Partisë e vendit tonë. Për këto bëjnë fjalë shumë nga dokumentat e KQ të PKSH që botohen në këtë vëllim.

Në këto materiale duket qartë fryma e internacionalizmit proletar dhe e solidaritetit socialist të Partisë dhe të popullit shqiptar ndaj luftës së popujve të Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, ndaj popujve të botës, sidomos ndaj popujve fqinjë që luftonin kundër fashizmit, ndaj partive komuniste e punëtore motra.

Mjaft dokumenta flasin për kujdesin e madh që ka treguar KQ i PKSH për ngritjen dhe kalitjen ideologjike të komunistëve, për forcimin organizativ të Partisë në terren e ushtri, për zbatimin me rreptësi të normave leniniste në Parti, për krijimin e forcimin e levave të Partisë, për funksionimin dhe përsosjen e organeve të shtetit të ri, të diktaturës së proletariatit.

Dokumentat që përmban ky vëllim janë botuar tërësisht me fare pak përjashtime. Janë ndrequr gabimet e shtypit dhe janë zëvendësuar disa fjalë që nuk jepnin kuptimin e duhur. Dokumentave që u ka munguar data, kjo është përcaktuar në bazë të përmbajtjes dhe është vënë në kllapa katrore; gjithashtu fjalët që i janë shtuar dokumentit, kur ka qenë nevoja për ta bërë më të qartë kuptimin, janë vënë në kllapa katrore. Pjesët e hequra janë zëvendësuar me pika. Po ashtu është bërë njësimi i drejtshkrimit dhe i trajtave morfologjike sipas normave të sotme letrare.

Të gjitha dokumentat që ribotohen dhe ato që botohen për herë të parë janë verifikuar me origjinalin që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë. Ndërsa dokumentat që janë marrë nga veprat e shokut Enver Hoxha botohen sipas veprave të tija pa asnjë ndryshim. Disa dokumenta që në botimin e parë të vitit 1960

ishin botuar me ndonjë shkurtim, në botimin e dytë botohen më të plota sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.

Artikujt e hyrjes mbi mbledhjet e Partisë dhe plenumet e KQ, të përgatitura nga grupi i punës, janë po ata të botimit të parë me ndonjë saktësim ose shkurtim të vogël që janë konsideruar të nevojshëm. Këta janë vënë me shkronja të vogla.

Shënimet përkatëse për çështje të veçanta dhe shpjegimet për ndonjë fjalë të huaj që hasen brenda dokumentit janë bërë dhe vihen në fund të faqes me qëllim për të lehtësuar lexuesin.

Në krahasim me botimin e parë të këtij vëllimi, në shënimet janë bërë disa shkurtime, disa shënime janë hequr fare duke u nisur nga fakti se tani lexuesit kanë në duar tekstin e Historisë së PPSH dhe Veprat e shokut Enver Hoxha.

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

## **MBLEDHJA E GRUPEVE KRYESORE KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR KRIJIMIN E PKSH**

**Nëntor 1941**

Mbledhja e grupeve komuniste për themelimin e Partisë u mbajt më 8-14 nëntor 1941 në Tiranë, sipas marrëveshjes së arritur midis udhëheqjeve të këtyre grupeve. Në mbledhje merrnin pjesë 15 vetë, përfaqësues të grupit komunist të Korçës, grupit komunist të Shkodrës dhe grupit të «Të Rinjve».

Detyra kryesore për të cilën ishte organizuar mbledhja u zgjidh në parim qysh në fillim. Më 8 Nëntor u muar vendimi historik për shkrirjen e grupeve dhe për themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH).

Në mbledhje u dëgjuan raportet mbi veprimtarinë e secilit grup, u vunë në dukje sukseset dhe të metat e lëvizjes komuniste në Shqipëri dhe u rrahën problemet jetësore që i dilnin Partisë.

Në diskutimin e problemeve ideologjike, taktike dhe organizative të Partisë u shfaqën divergjenca të theksuara midis përfaqësuesve të grupeve dhe veçanërisht midis grupit të Korçës, që mbronin parimet marksiste-leniniste dhe grupit të «Të Rinjve», i kryesuar nga Anastas Lula e Sadik Premte, të cilët mbronin pikëpamjet antimarksiste.

Anastas Lula e Sadik Premte u munduan të pengonin formimin e një partie të vetme marksiste-leniniste, me një unitet të shëndoshë organizativ dhe ideologjik dhe me një politikë luftarake.

Kundër tezave antimarksiste e likuidatore të krerëve të grupit të «Të Rinjve» zhvilloi një luftë parimore shoku Enver Hoxha, përfaqësues i grupit të Korçës dhe shokë të tjerë pjesëmarrës të mbledhjes që qëndronin në pozita marksiste-leniniste. Anastas Lula dhe Sadik Premte, kur e panë veten të mundur, pranuan sa për sy e faqe vendimet e mbledhjes dhe prematuan se do t'i zbatonin ato.

Mbledhja e grupeve komuniste përfundoi me triumfin e parimeve marksiste-leniniste mbi trockizmin dhe oportunizmin në lëvizjen punëtore dhe komuniste në Shqipëri.

Për udhëheqjen e Partisë u zgjodh Komiteti Qendror i Përkohshëm prej 7 vetësh. Për drejtimin e tij u ngarkua shoku Enver Hoxha.

Mbledhja e grupeve kryesore komuniste aprovoi rezolucionin që botohet në këtë vëllim. Në rezolucion i bëhet një analizë dhe një vlerësim i

drejtë marksist-leninist gjendjes ndërkombëtare dhe të brendshme, lëvizjes punëtore dhe komuniste në Shqipëri dhe përcaktohen bazat ideologjike dhe organizative mbi të cilat u themelua PKSH. Aty jepen vijat themelore të programit minimum dhe të taktikës revolucionare të saj.

Për rëndësinë e saj të jashtzakonshme, mbledhja e grupeve kryesore komuniste për krijimin e Partisë zë vendin e një kongresi kushtetues.

## REZOLUCIONI I MBLEDHJES SË GRUPEVE KRYESORE KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR KRIJIMIN E PARTISË

[Nëntor 1941]

### REZOLUCION

Në mbledhjen e parë të grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë, është përfunduar në këtë rezolucion:

#### I. Situata politike

Kemi hyrë në vitin e tretë të luftës imperialiste, e cila është shndërruar në luftë të përbotshme dhe ka përfshirë të gjitha kontinentet dhe të gjitha vendet kryesore të botës. Qysh prej shumë kohësh komunistët kanë sinjalizuar dhe kanë treguar rrezikun që kërcënon njerëzimin prej kësaj lufte të tmerrshme dhe të përgjakshme që në fakt është vazhdimi i kasaphanës së parë të përbotshme. Gjithashtu në fillim të kësajlufte shoku Mollotov ka thënë që ka filluar vargu i luftërave imperialiste të përbotshme, të cilat do të shndërrohen në një varg revolucionesh.

Me hyrjen e Gjermanisë në luftë kundër URSS-it<sup>1</sup> situata politike e përbotshme është shndërruar që nga themelet. Janë ndryshuar rrënjësisht pozita e masave punëtore si dhe konditat e luftës së popujve të robëruar edhe të shtypur prej fashizmit. Ka ndryshuar edhe vetë karakteri i luftës.

Hordhitë e tërbuara të Hitlerit shtazërisht kanë sulmuar tokën sovjetike duke kujtuar se dhe atje do të gjenin një shtet të kalbur nga kolona e pestë<sup>2</sup>. Ato hordhi shkatërruese, plaçkitën dhe

1 BRSS.

2 Kolona e pestë — grup kundërrevolucionar i përbërë prej spiunësh, diversantësh, trockistësh dhe armiqsh të tjerë që vepronin në prapavijën e Spanjës republikane në periudhën e rebelimit fashist 1936—1939. Fashistët, të cilët sulmonin më 1936 mbi Madrid në 4 kolona, e quajtën këtë grup tra-

vranë njerëz të cilët për njëzet vjet kanë ndërtuar socializmin, punëtorë dhe kolkozianë që kanë jetuar në begati dhe lumturi, pa shfrytëzim të njeriut prej njeriut. Ato hordhi e kanë trazuar kullën e këshqjellës së paqes, tufani i tërbuar i luftës përshkoi fushat pjellore sovjetike. Të gjithë popujt e Bashkimit Sovjetik të udhëhequr prej Partisë Komuniste Bolshevike janë ngritur në këmbë, si një njeri për mbrojtjen e tokës së vet socialiste. Ushtria e Kuqe lavdiplote u ka dhënë dhe po u jep grushte për vdekje hordhive të fashizmit gjerman. Më tepër se katër milion të elitës së gjakpiresve të Hitlerit u hodhën jashtë përdorimit. Ajo ushtri e armatosur me të gjitha mjetet që shtiu në dorë tokat e robëruara prej saj në Evropë, po dërmohet në ndeshjet me ledhet e fuqishme të botës së socializmit. Këtë siguri në fitore URSS-i na e ka thënë me mitingje, me manifestime më 22 qershor, ditën kur hordhitë e Hitlerit i ranë papritmas tokës sovjetike. Këtë siguri në fitore URSS-i na e ka treguar me luftën heroike që tash gjashtë muaj po vazhdon pa pushim për shkatërrimin e fashizmit. Këto ngjarje shoku Stalin ja bëri të ditura gjithë botës duke thënë: «armiku është i fortë dhe na duhet të mobilizojmë të gjitha fuqitë tona për ta dërmuar. Lufta do të jetë e gjatë dhe e përgjakshme, prandaj duhet ta kuptojmë gjendjen. Përderisa i dolëm në krye ndërhyrjes kundërrevolucionare të 1918-s, aq më tepër do t'ja dalim sot kur fashizmi ka filluar të shkatërrohet nën goditjet tona e ne po i japim grushte për vdekje deri në shkatërrimin e plotë të tij». Këto fjalë të shokut të madh Stalin po vërtetohen prej ngjarjeve të fundit në ballin e luftës, ngjarje të cilat paralajmërojnë ofensivën e madhe e cila nuk do të pushojë derisa të mos jetë shfarosur fashizmi nga fajja e botës.

Më fort se kurrë influenca e Bashkimit Sovjetik është rritur si ndër sytë e popujve të robëruar, ashtu dhe përpara popujve të Anglisë dhe Amerikës të cilët dëshirojnë t'i japin fund kësaj lufte të imponuar si dhe fashizmit. Kjo influencë e fortë i detyrohet faktit që URSS-i po lufton për mbrojtjen e atdheut socialist dhe për çlirimin e popujve të robëruar, për vendosjen e paqes së drejtë pa aneksime e kontribute e pa robërim popujsh të huaj. Kjo influencë e URSS-it i detyrohet faktit që atdheu i socializmit lufton për të drejtat e popujve, që të vendosin mbi fatin e vet.

Popujt e robëruar të Evropës, të vendosur për t'i dhënë fund skllavërisë së padurueshme nën të cilën i mban të ngujuar fashi-

dhëtarësh kolona e pestë. Shprehja «kolona e pestë» mori kuptimin e agjenturës së imperialistëve në vendet demokratike dhe në gjirin e lëvizjes revolucionare.

Në vendin tonë me këtë emër thirreshin armiqtë e maskuar të Luftës nacional-çlirimtare, të cilët përpqeshin të mbillnin çoroditje, panik dhe përçarje në radhët e masave popullore.

zmi, po i japin armikut grushte të rënda me sabotime, me greva dhe me veprime të armatosura. Evropa është transformuar në një vullkan të gjallë të luftës nacional-çlirimtare në krye të së cilës gjenden partitë komuniste. Gjithashtu luftë të fuqishme po bëjnë popujt e Italisë dhe Gjermanisë për çlirimin e vet nga skllavëria e Hitlerit dhe e Musolinit.

Tashmë, në të gjitha vendet, është krijuar një front prej të gjitha demokracive përparimdashëse në luftë kundër errësisë, përdhunisë e robërisë, kundër armikut të betuar të njerëzimit, kundër fashizmit.

Kjo gjendje ka shkaktuar formimin e dy fronteve të kundërta e armiq për vdekje: nga një anë fronti i luftës së padrejtë, i luftës grabitëse, i errësisë, i skllavërisë, fronti i fashizmit, nga ana tjetër fronti i luftës së drejtë, i luftës çlirimtare për përparimin, kulturën dhe qytetërimin, front i përbërë rreth Bashkimit të madh Sovjetik, prej vendeve demokratike<sup>1</sup>, Anglisë, Amerikës e Kinës e prej të gjithë popujve të robëruar e popujve liridashës të të gjithë botës.

Me hyrjen e Japonisë dhe Amerikës kjo luftë ka marrë karakterin e një lufte botërore. Këto dy fuqi janë ndeshur për interesat e Oqeanit Pacifik e të Lindjes së Largët, interesa të kundërt të cilët kanë qenë aq të ashpërsuar saqë kanë përfunduar në luftë.

Fashizmi italian që prej më se dy vjetësh na e ka shkelur vendin, ka punuar të gjitha të zezat mbi kurrizin tonë. Me ndihmën e disa shqiptarëve, vegla të tija, si qena në zinxhirë e tradhëtarë të Shqipërisë na ka grabitur lirinë kombëtare, është munduar të na shkombëtarizojë, të korruptojë rininë, t'i italianizojë shkollat. Prej më se dy vjetësh armiku e ka përdorur vendin tonë si bazë për përhapjen e tij në Ballkan dhe e ka kthyer këtë vend në fushë lufte kundër lirisë kombëtare të popujve vëllezër grek dhe jugosllavë, na ka bombarduar fshatrat e qytetet duke shkatërruar vatrat e pasurinë e katundarit e të qytetarit...

I pangopur nga këto, fashizmi italian na i ka zaptuar tokat, na ka kthyer në feudalizëm, kërkon të na përçajë me anë të fesë, e siç ka bërë kudo ku ka shkelur, ja ka marrë popullit bukën. Pusullet lajmërojnë kosën e tmerrshme të urisë që është e varur mbi kokën e turmave të varfëra të qyteteve e të fshatrave. Armiku po e detyron katundarin të dorëzojë gjënë e gjallë e bereqetin, ka zhdukur nga tregu vajin, gazin dhe sendet më të para të jetesës duke i dhënë mundësinë një grushti të vogël kapitalistësh të spe-

1 Vende demokratike ose demokraci të mëdha quheshin atëhere vendet kapitaliste — Anglia, SHBA-ja etj. që luftonin kundër shteteve fashiste, për të bërë dallimin e rendit të tyre të demokracisë borgjeze nga rendi politik fashist në Gjermani, Itali, Japoni, Spanjë e gjetkë.



kullojë në kurriz të popullit fukara. Populli nuk mund të paguajë as sendet më të para të jetesës, mbasi e gjithë tregëtia është monopolizuar në duar të disa njerëzve të lidhur me Mëkëmbësinë<sup>1</sup>.

Por të gjitha këto dhunime e spekulime në kurriz të popullit shqiptar e demaskuan keqas fashizmin. Urrejtja në popull që shkon duke u fryrë përherë më tepër shpërtheu në udhët e qyteteve të Shqipërisë. Qeveria e parë e humbi kredinë dhe nuk vlente më për ta bërë popullin shqiptar lopë të butë që ta mjelë fashizmi në qetësi, për ta përdorur për të shtypur lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve fqinjë, për ta pasur vendin tonë si bazë në Ballkan për luftën kundër Bashkimit Sovjetik, pararojës së lavdishme në luftën çlirimtare kundër fashizmit.

Duke i dhënë popullit shqiptar iluzionin e një «vetëqeverimi», fashizmi kërkon ta shmangë popullin shqiptar nga udha e vërtetë e çlirimit që është kryengritja kundër fashizmit.

Prej shtypjes barbare që po e ngujon tash më se dy vjet, lëvizja nacional-çlirimtare e popullit shqiptar është duke fituar fuqi të reja e nuk është larg dita në të cilën këto forca të bashkuara do të shndërrohen në një lumë të fuqishëm që do të përmbysë nën rrymën e tij të gjithë armiqtë e lirisë kombëtare të popullit shqiptar.

Prandaj ne duhet të punojmë pa pushim për të mobilizuar masat e popullit shqiptar në lëvizjen nacional-çlirimtare, të bashkohemi me të gjithë nacionalistët<sup>2</sup> që duan me të vërtetë Shqipërinë e lirë, me të gjithë shqiptarët e ndershëm që duan të luftojnë kundër fashizmit.

Ne duhet t'i mobilizojmë turmat e popullit shqiptar të qyteteve dhe të fshatrave në luftën kundër agjentëve të kolonës së pestë, kundër spiunëve, kundër spekulatorëve. Komunistët kanë

1 Mëkëmbësia ose Luogotenencia quhej në kohën e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste aparati administrativ italian i krijuar nga pushtuesit në Tiranë, i cili ushtronte në fakt gjithë pushtetin në vendin tonë. Në krye të mëkëmbësisë ishte mëkëmbësi fuqiplotë i mbretit të Italisë, Viktor Emanueli III, dhe Duçes së fashizmit. Që prej fillimit të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste mëkëmbës u emërua F. Jakomoni, fashist i regjur, ish-ministër fuqiplotë i Italisë në Shqipëri gjatë kohës së regjimit të Zogut. Në mars të vitit 1943 F. Jakomoni u zëvendësua me gjeneral Parianin.

2 Nacionalistë — thirrreshin zakonisht patriotët që e donin atdheun dhe kërkonin çlirimin e tij nga pushtuesit e huaj, por nuk ushqenin qëllime të largëta revolucionare. Por nacionalistë e quanin veten edhe pseudopatriotët nga radhët e çifligarëve, të bajraktarëve dhe të borgjezisë reaksionare. Për këtë arsye patriotët e vërtetë, për të mos i ngatërruar me elementët reaksionarë e tradhëtarë, quheshin dhe «nacionalistë të ndershëm», «nacionalistë patriotë».

detyrë të gjenden në krye të luftës për një Shqipëri të lirë demokratike dhe popullore duke luftuar krah për krah me lëvizjen nacional-revolucionare të popujve të tjerë dhe të Bashkimit Sovjetik.

## II. Lëvizja komuniste në Shqipëri

Revolucioni proletar në Rusi bëri përshtypjen më të thellë në rininë dhe në të gjithë popullin shqiptar të robëruar nën sistemin feudal dhe të eksploatuar prej fuqive imperialiste. Më 1922—1924 shoqëria «Bashkimi» u bë eksponentja e lëvizjes së masave shqiptare antifeudale e antiimperialiste, shtyu parlamentin shqiptar të nderojë kujtimin e shokut Lenin dhe qeverinë të njohë de jure Bashkimin Sovjetik, ngjarje këto pa precedencë në jetën e shteteve borgjeze. Më 1925—1926 nga emigracioni anëtarët e majtë të shoq[ërisë] «Bashkimi» pranohen në Bashkimin Sovjetik dhe atje formohet një grup komunistësh shqiptarë. Formohet dhe «Konare-ja» (Komiteti Nacional Revolucionar) prej elementëve nacional-revolucionarë të partisë së Fan Nolit<sup>1</sup>, që ishin në emigracion dhe më 1928 riorganizohet kjo me përjashtim të atyre që bënin kompromis me shtetet imperialiste, merr emrin «Çlirimi Nacional» dhe vazhdon të botojë «Lirinë Kombëtare». «Çlirimi Nacional» kishte lidhje me Komitetin Ballkanik<sup>2</sup> dhe më vonë (1929), shokët komunistë shqiptarë e përfaqësonin këtë në komitet e përmes komitetit në Komintern. Më 1930 shokët e parë komunistë shqiptarë vijnë nga Bashkimi Sovjetik në Shqipëri dhe lidhen këtu me lëvizjen e masave që sapo kishte filluar të dilte në dukje në Korçë dhe mbajnë lidhjen me Kominternin.

Në 1932 komunistët në Korçë bënë lidhjet e para me masat punëtore e popullore dhe shokut Ali Kelmendi i detyrohet për kujtimin për udhëheqjen përgjithësisht të drejtë që i dha kësaj lë-

1 Partia e Fan Nolit — përkrahësit e qeverisë demokratike të krijuar pas fitores së Revolucionit demokratik të qershorit 1924, kryetari i së cilës ishte Fan Noli. Në të vërtetë Fan Noli nuk kishte ndonjë parti më vete. Shumica e përkrahësve të tij bënin pjesë në shoqërinë «Bashkimi»; Komiteti Nacional Revolucionar (Konare-ja) u krijua prej elementëve të mërguar të kësaj shoqërie, pas rrëzimit të qeverisë demokratike të 1924-s dhe ardhjes në fuqi të Ahmet Zogut. Edhe kryetari i Konare-së në fillim ka qenë Fan Noli.

2 Komiteti Ballkanik — Komiteti i Federatës Komuniste Ballkanike, seksioni i Internacionales së tretë Komuniste që bashkonte dhe koordinonte veprimtarinë e partive komuniste të vendeve ballkanike. Sekretar i Federatës Komuniste Ballkanike ka qenë Gj. Dimitrovi.

Grupi i komunistëve shqiptarë në Bashkimin Sovjetik në të cilin bënte pjesë edhe Ali Kelmendi si dhe «Çlirimi Nacional» kanë pasur lidhje të rrullta me Komitetin e Federatës Komuniste Ballkanike.

vizije bashkë me shokët e tjerë të Korçës që më 1933 e deri më 1936, lëvizje kjo që hodhi themelet e formimit të Partisë Komuniste.

Më 1934 përjashtohet nga «Puna e Korçës»<sup>1</sup> X[oxi] N[iko], për luftën e paprinciptë kundër vijës së ndjekur prej shokut Ali. X[oxi] N[iko] bashkohet me ideologjinë e intelektualëve arqiomarksistë<sup>2</sup> të ardhur që nga Greqia në Shqipëri, krijon fraksionin e tij dhe lufton pjesëmarrjen e komunistëve në lëvizjen e masave duke shpikur teorinë e «kuadrove». Më vonë X[oxi] N[iko] luan rolin e grevëthyesit pastaj të provokatorit e më në fund (në gjuqin e komunistëve në janar 1939) tradhëton haptazi.

Më 1936 fillon të rritet grupi i Shkodrës, i cili më vonë hyn në kontakt me «Punën e Korçës» e me fraksionin e X[oxi] N[ikos] bashkohet me këtë të fundit, përvetëson teorinë e «kuadrove» dhe kështu mbetet me lidhje fare të dobëta me masat. Njëkohësisht merr formë edhe grupi i trockistëve në Tiranë<sup>3</sup>, me të cilin kishin pasur kontakte të gjitha grupet e lartpërmendura.

Më 1937 arrijnë në Shqipëri udhëzimet e reja (vija e re) të Kominternit<sup>4</sup> për shpërndarjen provizore të celulave dhe për rior-

1 «Puna e Korçës» quhej grupi komunist i Korçës. («Puna e Korçës» nuk duhet ngatërruar me shoqërinë profesionale «Puna» të punëtorëve të ndërtimit të krijuar në Korçë më 1933).

2 Arqiomarksistë quheshin pjesëtarët e një organizate antimarksiste në Greqi. Më 1930 ajo u bashkua me Internacionalen e katërt të Trockit, si seksion i Greqisë. Gjatë Luftës së dytë botërore arqiomarksistët vepruan si shërbëtorë të hapët të fashistëve italianë e gjermanë.

Emrin arqiomarksistë e kanë marrë nga organi i tyre i quajtur «Arqio Marksizmu» (arkivi i marksizmit).

3 Grupi i trockistëve të Tiranës ishte një grup i vogël i përbërë prej elementësh trockistë, armiq të komunizmit, i krijuar në Tiranë nga viti 1936. Ky grup kryesohej prej tradhëtarit Aristidh Qendro, dezertor nga grupi komunist i Korçës. Grupi u shkatërrua menjëherë pas krijimit të P.K.S.H. Aristidh Qendro u vu në shërbim të reaksionit të brendshëm dhe të pushtuesve fashistë. Pas çlirimit u gjykua dhe u dënua me vdekje për veprimtari tradhëtare.

4 Është fjala për direktivat e Kominternit, sipas vendimeve të Kongresit të shtatë të Internacionales Komuniste, i cili u mbajt prej 25 korrikut deri më 25 gusht 1935 në Moskë. Kongresi dëgjoi dhe diskutoi: Raportin e G.J. Dimitrovit «Mbi sulmin e fashizmit dhe detyrat e komunistëve për bashkimin e klasës punëtore në luftë kundër fashizmit», raportin e P. Toliatit «Mbi detyrat e Internacionales Komuniste në lidhje me përgatitjen e luftës së re botërore nga ana e imperialistëve», dhe raportin «Mbi konkluzionet e ndërtimit të socializmit në BRSS».

Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar pas vendosjes së diktaturës fashiste në Gjermani, Kongresi i shtatë përcaktoi një orientim taktik të ri

ganizimin e tyre në bazën e partisë, pasi të kishin hedhur themelet të shëndosha në masat, për shfrytëzimin e rasteve legale, për mbrojtjen e të drejtave demokratike dhe nacionale, për mbrojtjen e paqes kundër përgatitjeve për luftën imperialiste.

Këto direktiva që patën një rëndësi të madhe historike në lëvizjen komuniste, u pranuan dhe u zbatuan pjesërisht vetëm prej «Punës së Korçës». Në mungesën e partive të formuara, fronti popullor u realizua gjer në një masë jo vetëm nga poshtë, por edhe nga lart duke përfutur nga antagonizmat e borgjezisë. Në këtë punë në frontin antiimperialist mund të përmbledhej edhe Zogu në goftë se ky e luftonte me armë hyrjen e fashizmit në Shqipëri.

Grupet e bashkuara të Shkodrës e të X[oxi] N[ikos] jo vetëm që s'i pranuan direktivat, por edhe e luftuan mundësinë e një fronti popullor antiimperialist në Shqipëri gjersa të formohej, gjoja, Partia Komuniste Shqiptare (shih «Buletin jeshil»<sup>1</sup>, Nr. 1 dhe 2).

Mbas invazionit fashist në Shqipëri filloi rezistenca pasive e popullit kundër fashizmit. Në shtator-tetor 1939, u bë kompromisi socialdemokrat midis «Punës së Korçës» e grupit të Shkodrës, kompromis ky për hir të paqes së brendshme pa pastrimin e elementëve të dëmshëm dhe të teorive të huaja për partinë e proletariatit, teori që ishin krijuar veçanërisht prej intelektualëve. Ky kompromis liberal-oportunist, i bazuar në një paqe të kalbur brenda organizatës e zgjeroi hendekun midis dy grupeve, dezorientoi anëtarët, frenoi lëvizjen e masave dhe e liroi fushën për formimin e grupeve të reja si dhe për forcimin e aktivitetit të trockistëve. Ky kompromis i cili siç mund të pritej i çoi komunistët në bisht të situatës dhe të masave, mori fund në maj-qershor 1940.

Në shkurt 1940 në çështjen e grevës së gjimnazit të Tiranës u dukën shenjat e qenies së një grupi të tretë të quajtur më vonë

për partitë komuniste dhe lëvizjen punëtore botërore në përgjithësi. Ky orientim i ri ishte bashkimi dhe mobilizimi i të gjitha forcave të klasës punëtore dhe masave të gjera popullore në luftën kundër fashizmit dhe përgatitja e luftës së re. Në lidhje me këtë orientim kongresi vuri për detyrë krijimin e një fronti të vetëm popullor, antifashist dhe antiimperialist, ku të merrnin pjesë përveç partive komuniste, bashkimet profesionale dhe gjithë organizatat e punonjësve e antifashiste dhe kështu me veprime të përbashkëta të luftohej kundër fashizmit e për mbrojtjen e paqes. Detyrat që vuri Kongresi i shtatë i Kominternit, në formë direktivash, ju dërguan më 1937 edhe lëvizjes komuniste në Shqipëri.

1 «Buletini jeshil» — organ i grupit komunist të Shkodrës, që drejtohej nga vetë ish-kryetari i grupit, trockisti Zef Mala. Dolën gjithsejt vetëm dy numra: Nr. 1 i dhjetorit 1938 dhe Nr. 2 i janarit 1939. Në «Buletin jeshil» përmbahen një tok pikëpamjesh antimarksiste dhe gabime të rënda politike. Buletini quhej «jeshil» nga kapakët e tij të gjelbër.



grupi i «Të Rinjve» si dhe qenia e grupeve të tjera si p.sh. grupi i Z[jarrit]. Në maj 1940 krerët e këtij grupi u zbuluan dhe pas ndarjes në mes të grupit të Korçës dhe grupit të Shkodrës, krerët e grupit të «Të Rinjve» u bashkuan me ata të grupit të Shkodrës. Grupi «Zjarri» mbeti i veçuar dhe është akoma i tillë.

U hap një luftë principi midis grupeve të teorisë «së kuadrove» dhe grupit të Korçës i cili insistonte për punën në masat. Kjo u kthye në një luftë të paprincipitë, e cila frenoi më tepër se kurrë lëvizjen e masave.

Nën influencën e disa intelektualëve të cilët futën një intelektualizëm të kalbur, të huaj për lëvizjen punëtore, kanë mbirë edhe grupe të tjera, të cilat e kanë ndezur dhe më fort luftën e grupeve. Por kjo nuk do të thotë që duhet të luftojmë kundër intelektualëve besnikë të lëvizjes punëtore, kundër intelektualëve të dhënë për Partinë.

Pas sulmit fashist kundër Bashkimit Sovjetik, u ndie më tepër se kurrë, sidomos nga poshtë, dëmi i madh që i vinte lëvizjes komuniste nga lufta e shterpët midis grupeve dhe nevoja urdhëuese për t'i dhënë fund kësaj lufte dhe për të realizuar konditat e nevojshme për njësinë e lëvizjes në Shqipëri. Kjo u kthye në realitet me mbledhjen e parë të grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë, mbledhje gjatë së cilës u bë një shikim i përgjithshëm i punës komuniste të zhvilluar deri në ditët e tashme në Shqipëri, i shkaqeve të lindjes dhe të luftës së grupeve, i studimit të formimit të Partisë Komuniste Shqiptare. Kjo mbledhje dha si frut krijimin e një Komiteti Qendror të Përkohshëm të Partisë, të cilit ju ngarkua barra e rëndë e zbatimit të detyrave që u imponon komunistëve shqiptarë momenti historik: të bisedohet me të gjitha grupet e tjera komuniste të Shqipërisë, t'u jepet mundësia për të hyrë në radhët e Partisë, në rast se janë të vendosur të punojnë për komunizmin dhe t'i nënshtrohen disiplinës së Partisë. K[omitetit] Qendror të Përkohshëm i ngarkohet barra e rëndë të seleksionojë elementët, të organizojë dhe të forcojë Partinë në shembullin e Partisë Bolshevike të Leninit e të Stalinit.

### III. Sukseset

Lëvizja komuniste në Shqipëri ka pasur disa suksese.

Është mbajtur një qëndrim politik në çdo moment me rëndësi, qëndrim i inspiruar gjithmonë nga interesat e popullit shqiptar, të proletariatit dhe të Bashkimit Sovjetik, por që nuk ka hyrë thellë në popull.

Deri në një masë janë shfrytëzuar rastet legale:

a) me anën e ndërhyrjes ndër organizatat e regjimit ku për-

qëndroheshin turma («Jashtëshkollorët» në Korçë, «Besa shqip-tare» në Shkodër, «Fryma e re» në Tiranë);

b) me anë të disa botimeve legale e gjysmëlegale («Nëna» e Gorkit, «Bota e re»), janë krijuar organizata zejtarësh e punëtorësh (shoq[ëritë] profesionale e Shoq[ëria] «Puna» në Korçë, shoq[ëritë] e tipografëve e të marangozëve në Tiranë), të cilat kanë zhvilluar aksione ekonomike e politike me anë grevash e demonstratash, të cilat kanë pasur dhe deri-diku ja kanë arritur qëllimit të mobilizimit të një pjese të turmës punëtore zejtare e shkollore për përmirësimin e kushteve të jetesës e kundër shfrytëzimit;

c) me anë të aksioneve politike, për mbrojtjen e të drejtave demokratike (pjesërisht zgjedhjet parlamentare, bashkiake, në dhomën e tregëtisë, pleqësitë);

d) janë bërë demonstrata për mbrojtjen e lirisë kombëtare dhe kundër zaptuesit fashist, të cilat kanë pasur një farë suksesi në zhvillimin e ndjenjës kombëtare dhe antifashiste ndër turmat (demonstratat e prillit 1939, 28 nëntorit 1939, 1940 dhe tash më në fund demonstratat e 28 tetorit dhe nëntorit 1941 në Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër. Në krye të vendit ajo e Korçës<sup>1</sup> e cila dha sinjalin e përgjakshëm të luftës kundër fashizmit).

Janë hedhur herë pas here trakte me përmbajtje dhe parulla revolucionare të cilat kanë pasur si qëllim t'i shpjegojnë popullit gjendjen dhe kanë pasur si efekt lartësimin e prestigjit të komunizmit, të partisë së proletariatit dhe të URSS-it. Është përkthyer dhe shpërndarë në një farë mase në të gjithë Shqipërinë literaturë komuniste (kjo literaturë veç është e pakontrolluar dhe KQ i përket ta kontrollojë).

### IV. Gabimet

*Gabimet organizative* — Gabimi organizativ dhe politik më i madh ka qenë mospranimi dhe moszbatimi i direktivës së Ndërkombëtares Komuniste, e cila ishte e një rëndësie historike pasi i hapte perspektiva të gjera lëvizjes komuniste: të shpërndaheshin celulata komuniste të deriatëhershme, të cilat ishin oportuniste, trockiste, me shpirt tarafi, fraksionare, të palidhura me masat, të infektuara prej luftës së grupeve, sektare; të hidheshin këto në turmat në mënyrë që prej turmës të lindte baza e organizatës së shëndoshë. Grupi që e pranoi direktivën edhe ai nuk e zbatoi veçse pjesërisht dhe pasi shpërndau celulata i krijoi prapë në mënyrën e vjetër.

<sup>1</sup> Demonstrata e Korçës u bë më 8 nëntor 1941. Ajo përfundoi në përleshje me fashistët, të cilët përdorën kundër masës së demonstruesve bombat e dorës dhe armët e tjera të zjarrit. Veç të plagosurve të shumtë në demonstratë mbeti i vrarë anëtari i vjetër i grupit të Korçës, Koci Bako (Hero i Popullit).

Mospranimi i direktivës së Kominternit ka shtyrë grupet, të cilat nuk e pranuan dhe nuk e zbatuan direktivën e Nd[ërkombëtares] K[omuniste], të kërkonin lidhje prej partie në parti.

- Në drejtuesit e «Punës së Korçës» ka mbizotëruar lokalizmi, mungesa e shpirtit të sakrificës, monopolizimi ndër disa duar i punës me përgjegjësi. Ka mbizotëruar, veç këtyre, kënaqja me rezultatet e aksioneve, gjë që çonte në mospërfitim organizativ dhe në lënien në mëshirën e vet të elementëve dhe lëvizjeve të reja që lindnin jashtë Korçës. Ka mbizotëruar edhe liberalizmi i organizatës kundrejt shokëve dhe ka arritur gjer në oportunizëm kundrejt elementëve të tjerë, bile dhe karshi armiqve të deklaruar të klasës si Z[ai] F[undo]<sup>1</sup> dhe A[ristidh] Q[endro] gabim ky i fundit në të cilin kanë rënë edhe shokët e grupeve të tjera.

- Grupet e tjera janë karakterizuar nga ashpërsi e ngushtë karshi shokëve, gjë që çonte në kontrollin e imtësive më të holla të jetës private, në ndarjen nga familja, në krijimin e kolektivave artificiale, në rrojtjen keq, të cilat i ngjajnë çdo gjëje tjetër veç kolektivave komuniste, gjë që u jepte iluzionin shokëve se jepnin gjithshka për organizatën. Këto nuk janë tjetër veçse sektarizëm që e përqëndron vëmendjen në gjërat e vogla dhe e largon nga veprimet e gjera. Veç këtyre ekzistonte ambicia e disave, që e bënë të theksuar shpirtin e tarafit.

- Nuk është bërë asnjë tentativë serioze për organizimin e punës në baza të Partisë duke eliminuar tarafilëkun dhe duke spastruar lëvizjen nga elementët e dëmshëm, por përkundrazi është shkuar në kompromis socialdemokrat, që nuk ka të bëjë aspak me partinë e proletarietit, që ka thëlluar më fort hendekun në mes të grupeve të reja e u ka dhënë lehtësi elementëve trockistë dhe të tjerë.

- Organizimi i celulave dhe puna e tyre nuk kanë qenë të drejta. Treshet<sup>2</sup> ishin të kufizuara në vetëvete dhe të palidhura me masat. Lufta e tarafeve ka çuar në rekrutimin e elementëve të pakontrolluar dhe në konkurrencën për anëtarë. Kjo luftë e ndyrë grupesh e ka penguar punën e drejtë organizative komuniste në Shqipëri dhe e ka çuar në rrugë [të shtrembër], duke shkëlur aq fort konspiracionin sa që punët e brendshme të komunistëve ishin bërë tema

1 Zai Fundo — armik i klasës punëtore dhe i socializmit, dezertor, ka zhvilluar një punë të poshtër armiqësore kundër përhapjes së ideve komuniste në Shqipëri, kundër Bashkimit Sovjetik dhe Internacionales Komuniste. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare u vu në shërbim të reaksionit të brendshëm dhe të pushtesve fashistë gjermanë. Për veprimtarinë e tij tradhëtare kundër Partisë dhe popullit u gjykua dhe u dënua me vdekje qysh gjatë luftës, më 1944.

2 Treshet — quheshin celulat e grupeve komuniste të përbëra prej tri vetësh.

bisede në pazar. Por në realitet është bërë fare pak punë konstruktive.

- Janë bërë gabime të rënda në punën me rininë. Janë krijuar celula të rinjsh pa marrë parasysh problemet e veçanta të moshës së re dhe duke e ngarkuar me përgjegjësi më të madhe se mundësitë e moshës.

- *Gabimet politike dhe shmangiet teorike* — Duke u nisur nga pikëpamja e gabuar dhe e huaj për partinë e proletarietit, që në Shqipëri nuk ka klasa, ka rrjedhur mohimi i luftës së klasës, i mundësisë së një lëvizjeje komuniste turmash, pra dhe i revolucionit, teori që e largon klasën punëtore nga lufta e vërtetë dhe të çon në oportunizmin më të rrezikshëm. Këtë ka rrjedhur teoria që të pregatiten kuadrot pastaj të hyhet ndër masa. Kjo teori bashkë me atë të mosrrezikimit të kuadrove është disfatiste, oportuniste dhe çon në likuidimin e Partisë. Ajo i largon komunistët nga turmat dhe i kthen në një sekt. Prej veprimtarisë në masat kuadrot forcohen bile edhe madhohen. Prej këtyre pikëpamjeve të gabuara kanë rrjedhur mohimi i mundësisë së formimit të një fronti popullor dhe antiimperialist në Shqipëri, përmbledhja në vetëvete, izolimi nga jeta e përditshme dhe gabime në analizimin e situatave, si dhe heqja dorë nga ana e komunistëve prej rolit drejtues në hovin e masave.

- Puna ndër masa që është bërë ndër disa qendra të Shqipërisë nuk ka pasur një karakter vazhdimësie revolucionare.

- Gjatë ditëve 1-7 prill 1939 agjitacioni antifashist ka ndejtur tepër në vija legale. Është pasur në këtë rast «kujdesi» të ruhet legaliteti. Kjo ka çuar në mosmarrjen e armëve, duke u lënë e gjithë puna e mbrojtjes së lirisë kombëtare në duart e Zogut, gjë që ishte në kundërshtim me gjendjen objektive kur shumica dërmuese e popullit shqiptar donte të luftonte, por i mungonte udhëheqja. Po të kishim marrë armët kundër invazionit fashist, ne komunistët do të kishim fituar besimin e turmave, do të kishim krijuar lidhje të ngushta me fshatarësinë. I tillë është qëndrimi i komunistëve gjatë okupacionit grek: në vend që të përfitohej nga situata e krijuar për të marrë fuqinë në dorë, për të treguar se si punojnë komunistët duke zaptuar depot e armëve dhe duke ja shpërndarë këto popullit, ata bënë punën e rojtarit të depove dhe ranë në pikëpamjen e gabuar se ushtria e Metaksait ishte ushtri çlirimtare<sup>1</sup>.

1 Është fjala për grupin komunist të Korçës me rastin e pushtimit të qytetit të Korçës dhe të një pjese të Shqipërisë së Jugut nga ushtria greke në fund të vitit 1941, pas thyerjes dhe largimit të ushtrisë fashiste italiane. Grupi komunist i Korçës, ashtu si gjithë populli shqiptar në këtë rast mbajti qëndrim të drejtë, duke sabotuar me çdo mënyrë luftën e ushtrisë agresive italiane dhe duke ndihmuar luftën e popullit grek kundër fashistëve. Elementë dhe simpatizantë të grupit të Korçës që u ndodhën në atë kohë

Gjatë fazës së parë të luftës imperialiste nuk është bërë një agjitacion i gjerë kundër luftës e për mbrojtjen e paqes e bile aty-këtu janë dukur teori që predikonin se lufta në fjalë është midis dy palë imperialistësh, se neve nuk na intereson të ndërhyjmë dhe se në fund të fundit zgjerimi i Shqipërisë<sup>1</sup> do ta shtojë elementin komunist e proletar i cili do të na ndihmojë për të formuar partinë. Kjo është një pikëpamje e një shovinizmi më të zi, i cili në realitet i shërben imperializmit.

→ Është mbrojtur «teoria e vogël» se në polici mund të kallëzosh pak për të mbrojtur një pjesë të gjerë të punës, ose për të provuar nëse filani është spiun ose jo, ka lidhje me filan qeveritar ose jo, si edhe gjoja për t'i forcuar shokët. Kjo mënyrë qëndrimi para armikut të klasës është tradhëti.

→ Në çështjen e moralit është konstatuar një vendosje e keqe e problemit. Janë bërë në këtë fushë gabime të rënda e të papërshtatshme me moralin proletar.

→ Janë mbrojtur disa pikëpamje të huaja për komunizmin dhe që e komprometojnë rëndë emrin e partisë së proletariatit.

Shumë nga gabimet e rreshtuara më lart duke u përsëritur janë lartësuar në teori, në shmangie (deviacione) që nuk kanë të bëjnë aspak me partinë e proletariatit dhe që në shumë raste janë trockiste. Këto i kanë rrënjët në influencën e teorive anarkiste, trockiste e të tjera, të cilat janë të huaja për partinë e proletariatit.

## V. Detyrat organizative

Organizatet e kaluara ngushtësisht sektare, me frymë grupi dhe fraksioni, të themeluara në baza krejt të vogla dhe shpesh gati krejtësisht të izoluar nga masat, celula komuniste të tilla të deritashme duhen likuiduar dhe të riorganizohen sa më shpejt,

→ ushtarë dezertuan nga fronti. Por grupi komunist i Korçës ra në gabim duke menduar se ushtria dhe qeveria reaksionare greke e Metaksait, diktatorit fashist të Greqisë, do të sillëshin si çlirimtarë ndaj Shqipërisë. Si rrjedhim, me rastin e largimit të ushtrisë italiane nga Korça dhe rrethet, Korça ndejti më tepër se dy ditë e lirë pa asnjë pushtues; komunistët në vend që të merrnin inisiativë dhe të krijonin një administratë shqiptare dhe armët e lëna nëpër depot nga italianët t'ja ndanin popullit, ata u bënë rojtarë të depove dhe ja dorëzuan ushtrisë greke. Vetëm pak ditë pas pushimit, qeveria greke shpalli aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës mbretërisë së Greqisë.

1 Zgjerimi i Shqipërisë ishte një parullë e pushtuesve fashistë dhe e tradhëtarëve të vendit për të ngjallur ndjenja shoviniste, për të armiqësuar popullin tonë me popujt fqinjë jugosllavë e grek dhe për ta larguar atë nga Lufta nacional-çlirimtare.

→ pse një punë e tillë ka qenë krejtësisht e gabuar. Gjithashtu e gabuar është edhe mënyra e punimit me rininë, me të cilën është punuar në baza të ngushta, duke krijuar celula, të cilat në shumë raste kanë qenë të përmbledhura në vetëvete, dhe s'kanë pasur lidhje të gjera me masat e rinisë punëtore, fshatare e intelektuale. Këto janë dy të metat më kryesore të organizimit, të cilat është e domosdoshme të zhduken sa më shpejt.

→ Një nga ligjet themelore të zhvillimit të partisë së tipit të ri, të Partisë Bolshevike, është lufta në dy fronte, kundër gabimeve të vetëvetes dhe veçanërisht kundër tentativës së krijimit të grupeve dhe lufta pa pajtim kundër armikut të klasës. Prandaj partia nuk do të bëhet parti e tipit të vjetër, parti e ngjashme me ato të Ndërkombëtares së dytë socialdemokrate, në të cilën mbretëronte brejtja, mospunimi, tarafilëku, fraksionazhi dhe tradhëtia e interesave të klasës punëtore. Duam një parti të disiplinuar, në të cilën shokët do t'u nënshtrohen forumeve (komiteteve) më të larta, parti e cila do të jetë e zonja të udhëheqë klasën punëtore në luftë deri në fitim, e cila do të jetë ngushtësisht e lidhur me të gjitha turmat punonjëse të qytetit dhe të fshatit. «Po të mos ndahen nga populli, nga nëna e cila i ka lindur, komunistët do të jenë të pathyeshëm<sup>1</sup>», kështu na ka mësuar mësuesi ynë i madh Stalin. Të tillë parti duam.

→ Ne duhet patjetër të vazhdojmë punën, më me energji për të larguar të gjitha shenjat e teoritë negative dhe të sëmura.

→ Për të ruajtur Partinë nga goditjet e armikut të klasës, prej tendencave të ndryshme të tarafeve, prej veprimeve shkatërruese të ndonjërit, është e nevojshme që sa më shpejt dhe sa më energjikisht të vazhdojmë pastrimin e radhëve të Partisë duke mbajtur atë që është e mirë dhe duke e shpërndarë nga influenca e huaj. Është e nevojshme të likuidohet kufizimi në punë, politikanllëku, liberalizmi dhe shfaqjet oportuniste. Prandaj është e nevojshme të kemi sytë të hapur mirë politikisht dhe organizativisht kurdoherë dhe është i domosdoshëm bashkëpunimi në mes të anëtarëve dhe udhëheqësve Në këtë drejtim është e nevojshme të njihet aftësia e të gjitha forumeve dhe e të gjithë anëtarëve të Partisë dhe të vihen të gjithë në vendin e përshtatshëm.

→ Për ruajtjen e njësisë së Partisë është e nevojshme të zhduken nga Partia të gjithë fraksionarët e tarafxhinjtë e pandreqshëm. Në këtë mënyrë Partia, nëpërmjet spastrimit të radhëve të saja, përforcohet edhe më fort. Duhet t'u kushtojmë një vëmendje të veçantë shokëve të cilët kanë neveritur tarafilëkun dhe janë bërë luftëtarë të dhënë për Partinë.

Tarafllëku, fraksionizmi, padisiplina janë shkaqet kryesore

1 Shih: J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 136.



të ligshisë të organizatave komuniste të Shqipërisë. Për këtë arësyje organizata e Partisë ka këto detyra përpara saj:

1) Të seleksionojë dhe të organizojë anëtarët në celula, të krijojë celula të reja. Sistemi i celulave duhet të bëhet, patjetër, në një kohë sa më të shkurtër, baza organizative e Partisë.

2) Duhet që menjëherë të përforcohen radhët e Partisë me fuqi të reja, me luftëtarë të shëndoshë, punëtorë e fshatarë të rekrutuar prej të varfërve të qytetit e të fshatit. Duhet të likuidojmë një herë e mirë frikën dhe sektarizmin e futjes në Parti të elementëve të shëndoshë punëtorë e katundarë. Celulat duhet të lindin prej lëvizjes punëtoje, prej nga lindin drejtuesit e vërtetë të Partisë.

3) Duhet të ngulim këmbë energjikisht për lartësimin ideologjik teorikisht e politikisht të kuadrove, duke mësuar teorinë marksiste-leniniste, duke studjuar kursin e Historisë së PK (b) të URSS-it që është shtylla kryesore për formimin e një partie të fortë komuniste ilegale e ky kurs do të vlejë që të përgatiten shokët për të luftuar kundër të gjitha frazeologjizmave dhe intelektualizmit të sëmurë.

4) Në celula dhe në komitete duhet të ndahet puna e të gjithë anëtarëve në përshtatje me aftësitë e secilit.

5) Anëtar i Partisë mund të jetë vetëm ai që pranon programin, që bën pjesë aktive në një organizatë të Partisë (celulë) e që paguan kuotizacionin.

6) Duhet të krijohen lidhje të forta në mes të celulave dhe të komiteteve qarkore si edhe në mes të komiteteve më të ulta dhe atyre më të larta.

7) Komitetet duhet të bëjnë vazhdimisht kontrollin mbi punën e celulave dhe të çdo anëtari. Veçanërisht duhet të ruhem të mos depërtojë si kontrabandë ndonjë punë e tarafilëkut të vjetër.

8) Për të shëndoshur gjendjen në Parti, është e nevojshme inisiativë sa më e madhe e celulave e shokët udhëheqës duhet ta ndihmojnë me çdo mënyrë këtë inisiativë. Duhet që shokët të shkrijnë të gjithë vullnetin dhe zjarrin e mundshëm të tyre në punën e përditshme të Partisë. Duhet të zhvillojnë dashurinë për Partinë, dhe ta ruajnë emrin tonë dhe të Partisë sonë si sytë e veta.

9) Padiplina, përcmimi e përbuzja e punës dhe e vendimeve të Partisë është një nga dukjet më të rënda dhe më të dëmshme në organizatë. Është e domosdoshme që t'u jepet fund këtyre dukjeve, është e domosdoshme disiplina e çelniqtë dhe nënshtrimi patjetër ndaj të gjitha vendimeve të Partisë. Prandaj Partia do të largojë sa më energjikisht nga radhët e veta çdo të

padiplinuar, çdo element me tendencë anarkiste, oportuniste, likuidatore dhe çdo të sëmurë nga ambicia.

10) Në çështjen e konspiracionit dhe të ruajtjes së sekreteve të Partisë para armikut të klasës, disa elementë likuidatorë, oportunistë dhe tradhëtarë thonë se nuk mund t'u qëndrojnë torturave, por duhet kallëzuar, tradhëtuar; këto janë pikëpamje të huaja për partinë e proletariatit dhe duhen zhdukur pa mëshirë. Konspiracioni i deritashëm ka qenë i kalbvr. Ne kemi konspiracion për ta ruajtë organizatën kundër armikut të klasës, dhe jo për t'u fshehur prapa perdes e për t'u mbyllur në vetëvete.

11) Të shtrihemi organizativisht në të gjitha vendet ku deritani kjo punë nuk është bërë ose është bërë fare pak.

12) Të zhvillojmë agjitacionin dhe propagandën në turmat e gjera të popullit, të organizohen dhe të bëhen veprime.

13) Të krijojmë dhe të organizojmë realisht lëvizjen guerrile të masës si skelet të ushtrisë së ardhshme si edhe bazat reale materiale e politike për njësitë guerrile, bashkë me partitë e tjera politike dhe me lëvizjen nacional-çlirimtare.

14) Është e nevojshme të bëhet një kthesë në punën me gratë. Veçanërisht situata e sotme na detyron një punë serioze ndër gra; të futim në Parti gra punonjëse, t'i ndihmojmë në punën e tyre për mobilizimin e masës femërore për luftën çlirimtare.

15) Organizatat e Partisë dhe forumet e larta detyrohen t'i japin ndihmën e tyre rinisë komuniste shqiptare në zhvillimin e saj dhe në mobilizimin e të gjithë rinisë së ndershme shqiptare.

16) Duhet që organizata e Partisë të mbledhë ndihma për Partinë në mënyrë që Partia të mund të zhvillojë një punë të gjerë partie, për luftën çlirimtare, për viktimat e tmerrit të bardhë. Këto duhet të forcohen dhe të zgjerohen në të gjithë vendin tonë.

Në çdo organizatë duhet të ekzistojë një llojë disipline, por në P[artinë] tonë K[omuniste] është e domosdoshme një disiplinë e veçantë e cila buron nga vetëdija (koshienca) e lartë e anëtarëve të Partisë, bijtë më të vetëdijshëm të klasës punëtoje dhe të popullit. Konditat e rënda të punës ilegale na imponojnë një disiplinë edhe më të fortë e veçanërisht ndër ne në Shqipëri. Çdo anëtar i Partisë do t'i nënshtrohet patjetër disiplinës së Partisë. Pa një disiplinë çeliku dhe njësinë e Partisë, Partia jonë, e cila ka një numër të madh armiqsh, nuk do të mund ta udhëhiqte me sukses luftën. Padiplinën e bien në Parti elementë të huaj të cilët depërtojnë në të me qëllim që ta shkatërrojnë nga brenda. Depërtojnë kështu elementë të ndryshëm nga shtresat borgjeze të vogla, të cilat nuk kanë shkrirë shpirtin borgjez të vogël, d.m.th. njerëz të cilët nuk janë të pjekur për të qenë anëtarë të Partisë, ose karrieristë të ndryshëm, të cilët sjellin ngatërresa dhe krijojnë shesh për punë antiparti dhe trockiste.

Të gjithë këta njerëz nuk është vështirë t'i njohim në qoftë se i kemi sytë e hapur.

Konferenca<sup>1</sup> dhe forumet<sup>2</sup> e reja shprehin që organizata e Partisë në Shqipëri do të vërë të gjitha fuqitë për likuidimin e gjendjes së sëmurë që ka sunduar në të gjitha organizatat komuniste të Shqipërisë dhe do të vërë të gjitha forcat organizative të Partisë që të qëndrojnë në radhët e para të luftës për bolshevizimin e Partisë sonë, e cila duhet t'u përgjigjet detyrave të mëdha që sot paraqiten përpara saj.

## VI. Detyrat politike

Partia duhet të zgjerojë punën ndër masat e gjera punonjëse të Shqipërisë dhe të zgjerojë e të forcojë edhe më fort punën e saj me lëvizjen nacional-çlirimtare nga poshtë dhe nga lart.//Të mbjellim idenë për një kryengritje të përgjithshme çlirimtare të popullit nëpërmjet aksioneve të përbashkëta. ||

Duhet:

1) Të krijohet dhe të zgjerohet njësi luftarake në mes të masave punonjëse të qytetit e të fshatit.

2) Të luftohet për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar dhe për qeverinë popullore demokratike, në një Shqipëri të lirë prej fashizmit.

3) Duhet të zhvillohet dashuria për Bashkimin Sovjetik, duke popullarizuar realizimet e popujve sovjetikë dhe rolin e pararojës të URSS-it në luftën çlirimtare kundër fashizmit.

4) Nëpër aksione (sabotazhe), greva, demonstrata etj. të pregatitimit politikisht e ushtarakisht popullin drejt kryengritjes së përgjithshme me armë, duke përmbledhur në luftë të gjitha fuqitë patriotike dhe antifashiste. E me gjithë këto nuk duhet të harrojmë rrezikun e influencës së nazizmit. Të demaskojmë qeverinë e tradhëtarit Kruja<sup>3</sup>, manevrat e saja për të përçarë frontin nacional-çlirimtar të popullit shqiptar, duke paraqitur si rrezik për Shqipërinë luftën çlirimtare të popujve fqinjë, jugosllavë dhe

1 Mbledhja e grupeve komuniste.

2 Komiteti Qendror i Përkohshëm i PKSH dhe Komiteti Qendror i Rinisë Komuniste Shqiptare.

3 Në Rezolucionin e mbledhjes së grupeve kryesore komuniste dhe në thirrjen e parë të KQ drejtuar popullit shqiptar pas krijimit të Partisë, bëhet fjalë për ndonjë ngjarje që i përket muajit dhjetor, siç është ardhja në fuqi e qeverisë kuislinge të Mustafa Krujës. Për këtë arsye këto dy dokumenta, që aprovoi mbledhja e grupeve komuniste, u vunë në qarkullim në dhjetor, pasi u bë redaktimi përfundimtar i tyre dhe pasi u krijuan mundësitë teknike për botim.

grek, me qëllim që të dobësohet lufta kundër fashizmit. Të luftojmë orvatjet e fashizmit për të përçarë popullin shqiptar me anë të fesë, të zhdukim antagonizmat fetare.

5) Të zhvillojmë dashurinë dhe bashkëpunimin luftarak me të gjithë popujt e Ballkanit, sidomos me popujt serb, grek, maqedonaz, që luftojnë heroikisht për çlirimin e vet nacional.

6) Luftë për të drejtat e jetës së popullit punëtor shqiptar — punëtorë, fshatarë, intelektualë si dhe për brezin tonë të ri luftarak.

7) Vetëm duke i përmbushur këto detyra, Partia jonë mundet të sigurojë influencën e vet në masat popullore dhe të vërë armiq të në pamundësi për të shmangur luftën popullore prej udhës së drejtë, prej udhës së luftës kundër fashizmit.

Çdo anëtar i Partisë duhet të jetë koshient dhe ta kuptojë këtë situatë serioze dhe fatprurëse, të punojë pa pushim për të arritur në këtë rezultat.

Kështu dhe vetëm kështu do të mund të luajmë rolin e pararojës në luftën për liri të popullit të robëruar dhe të mjeruar për çlirimin kombëtar.

## KOMITETI CENTRAL I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## THIRRJA E PARË E KQ TË PKSH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR PAS KRIJIMIT TË PARTISË

[Nëntor 1941]

### POPULL SHQIPTAR!

Fashizmi gjerman bashkë me hyzmeqarët e tij të vendeve të tjera, Musolini, Manerheimi, Antonesku<sup>1</sup> e të tjerë fashistë tradhëtarë të popullit të vet, i pangopur me gjakderdhjet që ka shkaktuar në kurriz të popujve të shtypur e të robëruar me qëllim që të majmet me djersën e tyre dhe me pasuritë e vendeve të zaptuara, po vazhdon me shpirt ndër dhëmbë luftën kundër Bashkimit Sovjetik, vatrës së popujve të lirë sovjetikë.

Gjakatari i çmëndur Hitler kujtonte se do të mund ta skllavëronte me një luftë të shpejtë tokën e lirë sovjetike, siç mundi të bënte në vendet e tjera të zaptuara prej tij. Ai kujtonte se do të gjente përpara vetes një shtet të shkatërruar dhe të kalbur prej punës së kolonës së pestë. Por ishte gabuar keqas. Në Unionin Sovjetik gjeti një shtet të fortë, të organizuar më së miri, dhe një popull të lirë, të begatshëm, të bashkuar si një bllok të çelniqtë. Popujt e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, të vendit ku të gjitha kombësitë kanë gjetur shprehjen më të lirë të zhvillimit të tyre të plotë kombëtar, kultural dhe material, paraqesin një vullnet të vetëm: të luftojnë gjer në fitoren mbi fashizmin, që ka sulmuar tokën e tyre të lumtur, tokën në të cilën për njëzet vjet ata kanë ndërtnuar socializmin.

Ushtria e Kuqe heroike, ushtria e punëtorëve, katundarëve dhe intelektualëve sovjetikë, e udhëhequr prej Partisë Komuniste

<sup>1</sup> Manerheim K. G. — udhëheqës reaksionar i shtetit finlandez, armik i BRSS. Më 1939—1940 dhe 1941—1942 kryekomandant i ushtrisë finlandeze.

Antonesku J. — diktator ushtarak fashist i Rumanisë në vjetët 1940—1944. Më 1941 e futi Rumaninë në luftë kundër BRSS. Pas çlirimit të Rumanisë nga Ushtria Sovjetike u arrestua dhe u pushkatua si kriminel lufte.

Bolshevike të URSS-it dhe prej mësuesit dhe shokut të madh Stalin po u jep grushte vdekjeje ushtrive të kusarëve fashistë që hidhen si bisha për të shkatërruar çdo vepër qytetërimi e për të kthyer në botë errësirën mesjetare. Një pjesë e madhe e fuqive më të mira të fashizmit janë shkatërruar në ndeshjet me forcat sovjetike të tokës, të detit e të ajrit. Para Moskës fatose, qytetit të revolucionit dhe Leningradit, qytetit të Leninit, forcat e imperializmit po dërmohen në ndeshjet që valë pas vale hasin në muret heroike të përbëra nga gjokse të të gjithë popujve sovjetikë.

Por popujt sovjetikë nuk luftojnë vetëm për mbrojtjen e atdheut socialist. Popujt e URSS-it me humbjet e rënda që po i japin vazhdimisht bishës fashiste, luftojnë dhe për çlirimin e gjithë popujve të robëruar dhe të kërcënuar nga fashizmi, luftojnë dhe për çlirimin kombëtar të Shqipërisë. Shoku Stalin ka deklaruar botërisht: «Lufta jonë është luftë çlirimtare, ne po luftojmë për mbrojtjen e atdheut tonë dhe për çlirimin e të gjithë popujve të robëruar, të cilët pas shkatërrimit të fashizmit do të jenë të lirë të vendosin mbi formën e vetëqeverimit të tyre<sup>1</sup>».

Të gjithë popujt e botës gjenden të bashkuar në këtë luftë çlirimtare kundër fashizmit.

Hitleri u përpoq të tërhiqte edhe demokracitë angleze e amerikane në një kryqëzatë kundër sovjetëve. Por edhe ky plan i dështoi. Popujt anglez dhe amerikan po e ndihmojnë me çdo mjet aleatin e tyre Bashkimin Sovjetik.

Të gjithë popujt e skllavëruar të Evropës si edhe popujt e Ballkanit po bëjnë një luftë heroike për çlirimin e tyre. Malazeztë, sërëbët, kroatët, maqedonasit, grekët, vendet e të cilëve janë të skllavëruar nga fashizmi gjerman dhe italian, po bëjnë një luftë të gjerë për çlirimin kombëtar. Me luftën e papushuar të çetave partizane, me veprimet e sabotazhit nuk po e lënë fashizmin t'i mjelë e t'i shtypë në qetësi, po i shkatërrojnë qendrat jetësore, nuk po e lënë t'u marrë bereqet, armë, municione dhe njerëz për t'i përdorur në luftën kundër popujve të tjerë. Me veprime sabotazhi, me greva dhe gjatë demonstratash, popujt e tjerë të Evropës, francezët, norvegjezët, belgjianët, polonezët, gjermanët si edhe populli i Italisë (të cilin tradhëtari Duçe ja ka shitur Gestapos së Hitlerit) po tregojnë çdo ditë urrejtjen e tyre kundrejt shtypësit që i ka copëtuar dhe i ka plaçkitur në luftërat e grabitjes të ndezura nga klika Hitler-Musolin. Lëvizja e këtyre vendeve po bëhet më e fuqishme dhe nuk është larg dita në të cilën do të fillojë ndër to kryengritja e përgjithshme antifashiste.

<sup>1</sup> Shih: J. V. Stalin «Mbi luftën e madhe patriotike të BS», botim i MMP. Tiranë, 1952, f. 9, 26, 27.



PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË, USHTARË, XHANDARË,  
NËNOFICERË DHE OFICERË SHQIPTARË!

Fashizmi italian që prej më se dy vjetësh na ka shkelur vendin, ka punuar të gjitha të zezat mbi kurrizin tonë. Me ndihmën e disa shqiptarëve, vegla të tija e tradhëtarë të Shqipërisë, na ka grabitur lirinë kombëtare, është munduar të na shkombëtarizojë, të korruptojë rininë, t'i italianizojë shkollat. Prej më se dy vjetësh armiku e ka përdorur vendin tonë si bazë për përhapjen e tij në Ballkan dhe e ka kthyer këtë vend në fushë lufte kundër lirisë kombëtare të popujve vëllezër, grek dhe jugosllavë, na ka bombarduar fshatrat e qytetet duke shkatërruar vatrat e pasurinë e fshatarit e të qytetarit, ... I pangopur nga këto, fashizmi italian na i ka zaptuar vatrat, na ka kthyer rishtaz në feudalizëm dhe kërkon të sjellë në fuqi njerëz edhe më reaksionarë se qeveritarët e tanishëm, kërkon të na përçajë me anë të fesë e, siç ka bërë kudo ku ka shkelur, ja ka marrë popullit bukën; pusullet lajmërojnë kosën e tmerrshme të urisë që është varur mbi kokën e turmave të varfëra të qyteteve e të katundeve. Po e detyron katundarin të dorëzojë gjënë e gjallë e bereqetin, ka zhdukur nga tregu vajin, gazin dhe sendet më të para të jetesës duke i dhënë mundësi një grushti të vogël kapitalistësh të spekullojnë mbi kurriz të popullit fukara. Populli nuk mund të paguajë as sendet më të para të jetesës, pasi e gjithë tregëtia është monopolizuar në duar të disa njerëzve të lidhur me Luogotenencën. Të gjitha këto spekulime në kurriz të popullit shqiptar fashizmi i bën për të pasuruar një grusht gjakpirësish fashistë që përbëjnë klikën hajdute që është në fuqi.

Por populli shqiptar i bashkuar si një njeri për t'u mbrojtur nga intrigat dhe shtypjet fashiste, i ka treguar haptazi armikut fashist në Korçë, Tiranë, Durrës e Vlorë, se intrigat e tija në kurriz të bashkimit tonë kombëtar, janë gur i hedhur në ujë, se të gjithë shqiptarët pa dallim feje, krahine e parimesh janë të një mendje e të një zemre në vendosjen për të luftuar kundër zaptuesit të vendit, fashizmit. Në gjakun e shenjtë të dëshmorëve që ranë në udhët e Korçës shqiptarët janë betuar të hakmerren, të luftojnë gjer në shkatërrimin e zaptuesit, gjer në çlirimin tonë kombëtar nga skllavëria fashiste.

PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË, USHTARË, XHANDARË,  
NËNOFICERË DHE OFICERË SHQIPTARË!

Lufta e sotme grabitëse të cilën popujt e Gjermanisë dhe të Italisë nuk e kanë dashur aspak dhe që nuk bën tjetër veçse i shton vuajtjet e tyre e tonat dhe ato të popujve të tjerë, po jep

provën më të qartë se fashizmit i kanë ardhur ditët e fundit. Zaptuesi fashist duke e parashikuar vdekjen e tij të sigurtë, po e dyfishon shtypjen me anë burgimesh, rrahjesh, vrasjesh e internimesh. I ligshuar nga humbjet kolosale që shkon duke pësuar çdo orë në frontin sovjetik, i pazoti t'i bëjë ballë rrymës së madhe kryengritëse që e kërcënon në vendin e tij dhe ndër ne, fashizmi mundohet të rekrutojë milicë dhe xhandarë shqiptarë për ta vënë shqiptarin të shtypë shqiptarin, për të na pasur xhelatë të mirë kundër popujve vëllezër që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar. Në anën tjetër shenjë e dobësisë së fashizmit është shpërndarja e lajmeve të gënjeshtërtë dhe e premtimeve për të ashtuquajtura reforma.

Para kësaj gjendjeje ne nuk duhet të rrimë me duar kryq. Prandaj ne u drejtohemi të gjithë shqiptarëve të ndershëm që e duan me të vërtetë Shqipërinë, të bashkojmë të gjitha forcat tona për t'i vënë në shërbim të luftës sonë për çlirimin kombëtar. Lufta e hapur është e vetmi qëndrim kundrejt zaptuesit. Çdo bir i këtij vendi të jetë ushtar i Luftës nacional-çlirimtare. Për ta mposhtur armikun lufta jonë duhet të jetë e organizuar, e bashkuar dhe e fuqishme. Të gjithë burrat shqiptarë duhet të rrokin armët dhe të bashkohen me çetat që do të luftojnë për vatrat tona. Lufta e çetave do të jetë shprehja më besnike e vullnetit të popullit shqiptar për t'u çliruar nga skllavëria fashiste dhe për të rrojtur i lirë.

Por që lufta jonë të jetë vendimtare, ne duhet të luftojmë nga çdo anë armikun. Asnjë taksë, asnjë kokërr gruri, asnjë pikë vaji, asnjë gotë uji, armikut fashist. Nëpunësit, xhandarët, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët shqiptarë, detyrat dhe armët që fashizmi u ka dhënë, në vend që t'i përdorin për të shtypur popullin shqiptar dhe popujt lridashës vëllezër të Ballkanit, t'i përdorin kundër zaptuesit fashist.

POPULL SHQIPTAR!

Lufta jonë nacional-çlirimtare ka filluar. Është në duart tona ta bëjmë përherë më të ashpër, përherë më vdekjeprurëse për zaptuesit fashistë.

Me ne janë të gjithë popujt lridashës të botës. Luftën tonë nacional-çlirimtare duhet ta lidhim ngushtë me luftën heroike të popujve të Unionit Sovjetik, që gjenden në ballë të luftës çlirimtare kundër fashizmit. Ta kuptojmë dhe ta forcojmë sa më tepër këtë lidhje si edhe atë me luftën nacional-çlirimtare që popujt e robëruar nga fashizmi po bëjnë pa pushim kundër zaptuesit.



Lufta nacional-çlirimtare e popullit shqiptar ju vë detyra të rënda revolucionare, që do ta vënë në provën e zjarrit besnikërinë tuaj ndaj popullit, vendosjen tuaj revolucionare, aftësinë tuaj organizative. Shtrengoni në mënyrë përherë më të fuqishme radhët tuaja rreth Partisë. Mbahuni kurdoherë në ballë të Luftës nacional-çlirimtare bashkë me popullin shqiptar. Organizoni luftën çlirimtare kundër zaptuesit fashist. Lidhuni përherë më tepër me turmat e katundeve e të qyteteve të vendit tonë. Kryeni detyrën që kenë kundrejt popullit shqiptar. Eksperienca revolucionare e deritanishme le të jetë mësim për luftën e sotme. Që të jeni të denjë për besimin që populli shqiptar ka vënë në ju, vazhdoni traditën e bolshevikëve të Leninit e të Stalinit, duke dhënë shembullin e vendosjes revolucionare të sakrificës, të inisiativës dhe të organizimit. Jepni jetën tuaj për çlirimin kombëtar. Të jeni përherë në vendet më të para të luftës, atje ku më i madh të jetë rreziku.

Lufta për çlirimin kombëtar nga zgjedha e fashizmit italian kërkon prej të gjithë shqiptarëve të ndershëm kontributin e tyre. Asnjë shqiptar nuk duhet të rrijë jashtë kësaj lufte.

Të gjithë, pra, në luftë të bashkuar.

**PËR ÇLIRIMIN KOMBËTAR KUNDËR ZAPTUESIT FASHIST!**

Rroftë bashkimi i popullit shqiptar në Luftën nacional-çlirimtare!

Rroftë bashkimi i popujve ballkanikë në luftën kundër fashizmit!

Rroftë kujtimi i dëshmorëve të popullit shqiptar të rënë në Luftën nacional-çlirimtare!

Rroftë Unioni Sovjetik, pararojë e luftës kundër fashizmit!

Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

**KOMITETI QENDROR  
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE**

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR  
TË RINISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË NË PËRGJEGJE  
TË PËRSHËNDETJES ME RASTIN E KRIJIMIT TË  
ORGANIZATËS SË RINISË KOMUNISTE SHQIPTARE  
MË 23 NËNTOR 1941**

[Nëntor 1941]

**KOMITETI QENDROR I PËRKOHSHËM I PARTISË  
KOMUNISTE TË SHQIPËRISË**

**SHOQËRISHT**

**KOMITETIT QENDROR TË PËRKOHSHËM TË RINISË  
KOMUNISTE SHQIPTARE**

E dashur dhe inkurajuese i arrin KQP të Partisë Komuniste të Shqipërisë përshëndetja e zjarrtë shoqërore e KQP të Rinisë Komuniste Shqiptare në këtë kohë të vështirë të organizimit të Partisë sonë, të rinisë komuniste dhe të luftës çlirimtare kundër zgjedhës fashiste.

Partia ushqen shpresat më të mëdha se Rinia Komuniste Shqiptare do të jetë e denjë për besimin që ka vënë mbi të Partia jonë e re dhe se do të dijë ta kryejë revolucionarisht detyrën e lartë që i është ngarkuar, duke u frymëzuar nga shembulli heroik i Rinisë Komuniste Sovjetike në njësi të çelniktë vullnetesh dhe zemrash me Partinë, të organizojë dhe të udhëheqë revolucionarisht rininë shqiptare të skllavëruar, drejt së ardhshmes së ndritur, drejt çlirimit nga zinxhirët mesjetarë të skllavërisë fashiste dhe drejt jetës së re të përparimit, të kulturës dhe të gëzimit. Rroftë Rinia Komuniste Shqiptare!

**KOMITETI QENDROR I PËRKOHSHËM I  
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË**

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**QARKORE PËR ORGANIZIMIN E  
«JAVËS SË PARTISË»**

[Janar 1942]

**KOMITETEVE QARKORE TË PKSH**

Të dashur shokë,

Duhet të keni parasysh se Partia, për të kryer veprimet e saja në fushën revolucionare, ka nevojë që çështjes financiare dhe materiale t'i jepet një rëndësi e veçantë.

Ju kujtojmë me insistim se duhet të marrë fund rregullimi i kuotizacioneve dhe të komunikohet sasia mujore e çdo qarku, duke theksuar të ardhurat e rregullta me ndihmat e anëtarëve të Partisë në formë të hollash ose plaçkash.

Të vihen në lëvizje të gjithë anëtarët e Partisë për të mbledhur ndihmën për Partinë, ndihmën popullore, në të holla dhe në plaçka, si dhe ndihmën për çlirimin nacional.

Veç këtyre detyrave që shënuam më lart, detyra të përditshme për çdo militant komunist, porositeni që të hapet një fushatë e posaçme: «Java e Partisë» që prej datës 19 deri 26 kallnor 1942. Gjatë kësaj jave në çdo celulë, në çdo simpatizant, mik të Partisë, në popull, në antifashistë, në nacionalistë, të popullarizohet Partia jonë, udhëheqësja e vërtetë e popullit shqiptar në Luftën nacional-çlirimtare, të popullarizohet lufta çlirimtare e popullit shqiptar, të popullarizohet lufta çlirimtare e popujve të robëruar, të popullarizohet lufta e Bashkimit Sovjetik, pararojë e lavdishme për çlirimin e popujve të robëruar nga fashizmi. Njëkohësisht të theksohet nevoja dhe të mblidhet ndihma në të holla dhe në sende.

Pra në këtë javë duhen koncentruar të gjitha forcat e Partisë për një sukses politik e ekonomik të plotë.

Të fala shoqërore  
nga Komiteti Qendror i PKSH  
*Selami*<sup>1</sup>

PS — Ju vëmë në dijeni se më 21 kallnor është dita e vdekjes së Leninit. Duhet të mbani konferenca mbi rëndësinë e ditës dhe mbi jetën e Leninit, punën dhe rolin e tij. Një shok që di mirë jetën e Leninit dhe literaturën marksiste të bëjë një referat, i cili do të mbahet në qytete e në fshatra, në të rinj e në të vjetër.

*Botohet sipas kopjes së  
daktilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

<sup>1</sup> Selami — një nga pseudonimet e shokut Enver Hoxha gjatë Luftës nacional-çlirimtare.

## THIRRJE E KQ TË PKSH DREJTUAR USHTARËVE, NËNOFICERËVE DHE OFICERËVE SHQIPTARË

[Shkurt 1942]

USHTARË, NËNOFICERË, OFICERË TË SHQIPËRISË!

Të gjithë ju punëtorë, fshatarë, qytetarë, intelektualë të ndershëm që gjendeni nën uniformë dhe që ju pregatisin për uniformën ushtarake!

Tetë muaj kanë kaluar që prej ditës kur bisha e egër e gjakpirëse, fashizmi gjerman, bashkë me hyzmeqarët e tij, ka sulmuar Bashkimin Sovjetik, vendin e begatshëm, atdheun e punëtorëve e të fshatarëve sovjetikë, në të cilin është zhdukur një herë e përgjithmonë shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Hordhitë fashiste hitleriane kanë dashur të kthenin përsëri skllavërinë mesjetare, errësirën dhe reaksionin në tokën e lirë sovjetike dhe të robëronin popujt e lumtur të URSS-it. Që të mund të realizonin planet e tyre të errëta, ato u lëshuan në fushat pjellore të URSS-it, në fshatrat e qytetet, ku kanë lënë miliona njerëz të vrarë e të plagosur dhe ku kanë bërë egërsi të padëgjua. Duke mos bërë asnjë dallim në popullsinë luftuese, ato kanë vrarë fëmijë, gra e pleq. Ato përlyen me gjak çdo pëllëmbë toke të URSS-it që kanë marrë, duke mos kursyer asnjë krijesë njerëzore dhe asnjë material. Të gjithë popujt e Bashkimit Sovjetik me Ushtrinë e Kuqe të tyre të pamundshme, të udhëhequr prej Partisë Bolshevike, me shokun e madh Stalin në krye. . . po u japin goditje pas goditjesh, duke u shkaktuar thyerje të tmerrshme bandave fashiste dhe duke varguar fitime pas fitimesh. Po çlirohen fshatra e qytete prej thundrës së zaptuesit gjakpirës dhe keqbërës. Nën goditjet e rënda të Ushtrisë së Kuqe dhe të partizanëve sovjetikë është zhvilluar demoralizimi dhe çorganizimi në radhët e ushtrisë hitleriane. Ajo ushtri, e cila lehtë dhe pa qëndresë ka robëruar një pjesë të madhe të Evropës, sot nën shtypjen e fortë dhe të fuqishme të ofensivës së madhe sovjetike, po pëson thyerje pas thyerjesh, po tërhiqet dhe detyrohet të lëshojë fshatrat, qytetet dhe fushat

e URSS-it, të cilat i kishte zaptuar me gjak. Hitleri po ndërron shtatmadhorinë dhe ka marrë komandën në duart e veta vetëm e vetëm që të mbrojë moralin e trupave të tij, moral i cili është fort i tronditur dhe duket haptazi në dorëzimin e ushtarëve gjermanë te Ushtria e Kuqe dhe në dezertimin e ushtarëve prej frontit.

Hitleri po matet që të fillojë ofensivën e pranverës, por që të mund ta bëjë këtë, ai detyrohet të kërkojë mish të ri për topat. Ai detyrohet t'i plotësojë radhët e ushtrisë së tij të zbrazëta nga humbjet e shkaktuara prej Ushtrisë së Kuqe, prej urisë dhe nga të ngrirët prej të ftohtit. Ai i ka mobilizuar të gjithë shërbëtorët e vet, e në radhë të parë Musolinin dhe qeveritë kukulla e tradhëtare të vendeve të shtypura të Evropës, që t'i mbledhin dhe t'i grumbullojnë forca dhe rezerva për ofensivën e re. Shërbëtorët besnikë të fashizmit i janë përveshur punës. Nuk i mjaftoi zaptuesit fashist që ta robëronte vendin dhe ekonomikisht ta plaçkiste dhe ta varfëronte, po tashti kërkon gjak e mish për planet e tij të errëta e të çmendura. Qeveria e poshtër dhe e shitur, në krye të së cilës është Mustafa Kruja, hyzmeqar besnik i fashizmit, mobilizon dhe përpiqet të mobilizojë brezat më të zgjedhur, fuqitë dhe shpresat e popullit tonë, njerëzit tanë të rinj, të cilët do t'i çojë në kasaphanë për hesapin e interesave të Hitler-Musolinit.

USHTARË, NËNOFICERË, OFICERË TË SHQIPËRISË!

Sigurisht që ju e dini tmerrin e kësaj lufte imperialiste, në të cilën ju keni marrë pjesë pa vullnetin tuaj. Ju kanë shtyrë në këtë luftë imperialiste të padrejtë dhe robëruese hyzmeqarët e Hitlerit dhe të Musolinit, klika e tyre fashiste. Ju po derdhni gjakun për interesat e zaptuesve gjakpirës fashistë të cilët po ju çojnë që të luftoni kundër vendeve fqinje, jugosllav dhe grek, që të shtypni kryengritjen nacional-revolucionare dhe që të luftoni kundër partizanëve. Armiku i vendit tonë dhe i vendeve kundër të cilëve ju çon të luftoni, i ka bërë të gjitha me plan e me kujdes. Armiku do të na ngatërrojë në mes nesh që të mund të na skllavërojë më lehtë dhe të na hedhë në robërinë koloniale. Armiku ka gjetur edhe një politikë tjetër, ai don të na ngatërrojë ndërmjet nesh. Ai don të na hedhë në luftën vëllavrasëse dhe don që ne vetë të mbytemi me duart tona. Një të ardhshme të tmerrshme po na ndërton fashizmi dhe eksponenti i tij Mustafa Kruja, i cili ato që ka shpenzuar në Romë e Torino detyrohet t'i shpaguajë patjetër dhe vetëm me gjakun tuaj, pse zaptuesi kërkon njerëz dhe shesh të ri, me të cilët kërkon të plotësojë radhët e zbrazëta të ushtrisë. Mustafa Kruja dhe qeveria e tij duan t'ju

përdorin që të shtypni kryengritjet nacional-revolucionare dhe njëkohësisht lëvizjen tuaj për lirinë e popullit.

Ju e dini se populli ynë ka luftuar gjithmonë për pavarësinë dhe për lirinë e vet. Për këtë ndiqni rrugën e shenjtë që kanë ndjekur të parët tanë. Ta dëbojmë armikun nga vendi ynë, se vetëm në këtë mënyrë do të kemi liri, bukë e nder për popullin tonë. Ju bijtë e popullit shqiptar, stërnipat e të parëve tanë heroikë dhe trima, nuk duhet në asnjë mënyrë t'u shërbeni interesave e qëllimeve të fëlliqura të fashizmit dhe të hyzmeqarëve të tij, nuk duhet të shkoni të luftoni kundër popujve që luftojnë për lirinë e tyre. Armiku gënjeshtar, me anë të hyzmeqarëve të tij, hap fjalë se grekët e jugosllavët do ta copëtojnë Shqipërinë. Këto janë gënjeshtër të pakuptimshme të armikut të popullit tonë dhe të popujve fqinjë. Garanci se vendi ynë nuk do të copëtohet prej askujt është lufta e partizanëve të vendeve fqinje, dhe në radhë të parë lufta jonë për çlirimin nacional. Nuk duhet të shkoni në luftë kundër popujve të huaj dhe popullit shqiptar se do të jeni përgjegjës përpara historisë, përpara popullit shqiptar dhe të gjithë popujve të tjerë. Kundërshtoni me armë çdo kërkesë të tradhëtarit Mustafa Kruja për t'ju çuar në ushtri të zaptuesit dhe në ushtrinë vëllavrasëse. Bashkohuni me çetat luftarake revolucionare të partizanëve, të cilat e kanë treguar se nuk kanë kurrëgjë as kundër jush, ushtarë, as kundër popullit shqiptar. Përkundrazi ata janë sjellë vëllazërisht dhe miqësisht me ju. Prandaj vëllazërohuni dhe kaloni me gjithë armë në çetat partizane, bashkohuni me to dhe krah për krah me to luftoni kundër zaptuesit të ndyrë. Edhe në vendin tonë vëllezërit tuaj po pregatisin luftën në atë mënyrë si kanë filluar popujt fqinjë. Ata ju bëjnë thirrje që të bashkoheni në luftë për lirinë e popullit tuaj, që t'u drejtoheni komandave revolucionare dhe të formoni çetat partizane. Prandaj ju... mos e derdhni gjakun pa ditur për çka dhe për interesat e fashizmit, po gjakun tuaj të vlefshëm derdhni për çlirimin e popullit shqiptar kundër armikut të përbashkët dhe skllavërues. Ne nuk duhet dhe nuk duam të luftojmë për fitoren e fashizmit, por për zhdukjen e tij, për fitoren e fuqive atdhetare popullore.

Në luftën për lirinë dhe fatlumsinë e Shqipërisë ne nuk jemi të vetëm. Luftën tonë do ta ndihmojnë në radhë të parë Bashkimi Sovjetik dhe popujt e Anglisë dhe të Amerikës si edhe të gjithë popujt e robëruar e në radhë të parë popujt fqinjë. Me ne është Ushtria e Kuqe, e cila po i jep goditje të rënda fashizmit hitlerian. Ne luftojmë për çlirimin kombëtar, ne luftojmë për një çështje të drejtë. Ne do të fitojmë. Edhe ushtarët e vet po e neverisin Hitlerin. E ju jeni dëshmitarë edhe përse kanë bërë shokët tuaj, ushtarët italianë, gjë që kanë bërë edhe përpara dhe do të bëjnë gjithmonë posa që t'u jepet rasti. Ata e kanë neve-

ritur luftën, Musolinin dhe fashizmin. Shpesh dhe gjithnjë ata dëshirojnë që kësaj lufte t'i jepet fund, sepse e dinë që prej saj nuk kanë kurrfarë dobie as ata as popujt e tyre të robëruar, por vetëm Musolini e Hitleri si dhe qentë në zinxhirë, hyzmeqarët besnikë të fashizmit, Mustafa Krujat e ndryshëm.

#### USHTARË TË SHQIPËRISË!

Formoni këshillat për luftën kundër zaptuesit, kundër luftës, kundër dërgimit jashtë vendit tuaj. Kaloni me armë në dorë në radhë të partizanëve dhe luftoni bashkë me ta kundër zaptuesit. Asgjësoni çdo gjë që të mundeni dhe që i shërben zaptuesit për luftën e tij dhe për të mbajtur në skllavëri popujt e robëruar.

#### REKRUTË!

Mos ju përgjigjini dëshirave të shërbëtorëve të urryer të fashizmit. Mos ju përgjigjini zaptuesit për të plotësuar radhët e tija të boshatisura, për t'i shërbyer si rezervë dhe për të luftuar kundër popujve të vegjël. Përgjigjuni zërit të popullit që ju thërret për të luftuar për çlirimin e vendit tonë. Ne nuk duhet ta pranojmë zaptuesin dhe ushtrinë e tij, se përndryshe do ta përlyejmë emrin tonë dhe do të na quajnë si pjesëmarrës dhe tradhëtarë, por të bëjmë luftën e shenjtë për çlirimin e vendit tonë.

NË LUFTË PËR SHQIPËRINË E LIRË DHE FATLUME!  
POSHTË KLIKA FASHISTE MUSOLIN-HITLER!  
POSHTË HYZMEQARI I SHITUR DHE ARMIKU I BETUAR I  
POPULLIT MUSTAFA KRUIJA ME QEVERINË E TIJ!  
RROFTË LUFTA NACIONAL-ÇLIRIMTARE!  
RROFTË BASHKIMI SOVJETIK DHE USHTRIA E KUQE E  
PATHYESHME!  
RROFTË BASHKIMI I POPUJVE BALLKANIKË!  
RROFTË PARTIA KOMUNISTE SHQIPTARE!  
JASHTË ZAPTUESIT!  
VDEKJE FASHIZMIT! LIRI POPULLIT!

KOMITETI QENDROR  
I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*



## LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETEVE QARKORE NË LIDHJE ME DITËN E USHTRISË SOVJETIKE

[Shkurt 1942]

Të dashur shokë,

23 shkurti është dita e themelimit të Ushtrisë së Kuqe, Ushtrisë Sovjetike. Kjo ditë festohet në gjithë botën si një ditë e madhe e mobilizimit të masave. Aq më tepër, kjo ditë festohet sot që Ushtria e Kuqe ka dalë në skenë dhe po u jep grushte të forta fashistëve luftëdashës, e sidomos tani që ka filluar ofensivën të cilën nuk ka për ta ndaluar asnjë ushtri. Megjithëqë gjendemi në kondita të vështira nën robërimin fashist, duhet ta festojmë këtë ditë ashtu siç u ka hije komunistëve. Në këto ditë duhet të mobilizojmë gjithë masat, të grumbullojmë rreth nesh çdo gjë që është e ndershme dhe të hedhim themelet e ushtrisë sonë, të radhëve dhe të njëjësive tona partizane. Këto ditë duhet të bëjmë agjitacion nëpërmjet konferencash, mbledhjesh, kudo që komunistët bien në kontakt me njerëz të ndershëm. Aty të flitet, në radhë të parë, për rëndësinë dhe për rolin e Ushtrisë së Kuqe (të popullarizohet Ushtria e Kuqe), mbi situatën politike dhe mbi zhvillimin e saj (situata politike e jashtme dhe e brendshme), e njëkohësisht të flitet mbi nevojën e krijimit të ushtrisë sonë, të njëjësive, çetave e komandave prej njerëzve që duan të luftojnë (dhe tani për tani, të mësojmë se si duhet të luftojmë) kundër fashizmit, kundër zaptuesit të ndyrë, i cili po e shtyp vendin tonë. Këtë ditë duhet të bëhet gara socialiste prej komunistëve në grumbullimin e masës dhe në depërtimin në masë (për të grumbulluar sa më shumë masë, për t'u shpjeguar sa më mirë dhe për t'i bindur sa më tepër) e veçanërisht ndër fshatra.

Këtë ditë shokët duhet të flasin kryesisht përsa vijon:

- a) Ushtria e Kuqe si fuqi, e cila ka lindur nga gjiri i popullit, nga masat, e cila ka bërë luftëra të mëdha dhe ka korrur fitime të shkëlqyeshme, e cila ka çliruar popujt sovjetikë prej zgjedhës së carit e të kapitalistëve, e cila gjatë luftës ka ndeshur në pengesa të mëdha e të çdo lloji duke i thyer e duke i mposhtur.
- b) Mbi rolin e saj të madh: E para si luftëtare për çlirimin, si luftëtare për ruajtjen dhe forcimin e Revolucionit të madh socialist sovjetik. E dyta si luftëtare për çlirimin e gjithë popujve nga robëria, e sot, në radhë të parë, për çlirimin e gjithë popujve nga robëria fashiste.
- c) Duhet të flasim për rolin çlirimtar të Ushtrisë së Kuqe, pikërisht në këto ditë që ka filluar ofensiva e saj e madhe.

### Pak fjalë për historikun e Ushtrisë së Kuqe

Themelet e para të Ushtrisë së Kuqe u hodhën gjatë ditëve të fillimit të revolucionit, u vunë për herë të parë prej njëjësive të punëtorëve revolucionarë dhe prej Rojeve të Kuqe të udhëhequra prej komunistëve, ndën një shtab («Këshilli Ushtarak Revolucionar»), i cili lindi në ditët e para të revolucionit, e që më vonë u bë «Shtabi Legal i Kryengritjes». Më 16 Tetor u bë një mbledhje e zgjeruar e Komitetit Qendror të Partisë, ku u zgjodh Qendra [e

Partisë], me shokun Stalin në krye, e cila mori në dorë drejtimin e kryengritjes. Partia dërgoi komisarë të Këshillit Ushtarak Revolucionar në gjithë njësitë revolucionare të ushtrisë, me detyra të caktuara.

Më 24 Tetor u botua «Rruga e Punëtorëve» (me gjithë përpjekjet e qeverisë provizore për ta ndaluar) me programin dhe një thirrje, së cilës ju përgjegjën punëtorët, ushtarët, Rojet e Kuqe, si dhe marinaret e luftanijeve «Aurora» dhe «Zarja Svobodi». Kryqëzori «Aurora» me buçitjen e topave të tij, të drejtuar kundër Pallatit të Dimrit, më 25 tetor shpalli një epokë të re, epokën e Revolucionit të madh socialist.

Më 10 nëntor, Kerenski dhe Krasnovi arritën në Petrograd, ku eserët kishin nxitur kryengritjen e kadetëve. Ashtu si në kohën e kryengritjes të tetorit Lenini mori pjesë personalisht në shtypjen e lëvizjes antisovjetike.

Prej tetorit e deri në janar-shkurt të 1918-s, pothuajse në të gjitha krahinat zotëronte një rrymë revolucionare. Gjithë ndërhyrjet dhe gjithë planet e kapitalistëve nuk mundën të thyenin Ushtrinë e Kuqe të fuqishme, e cila ishte formuar, u forcua dhe u bë si çelik në luftë e që ishte e aftë për të mbrojtur vendin prej gjithë sulmeve të armiqve.

Në këtë kohë rreziku më i madh për Sovjetët ishin ushtritë e Gjermanisë imperialiste. Më 10 shkurt 1918, u ndërpre në bisedimet për paqe, në saje të divergjencës së «Komunistëve të majtë» (Trocki, Buharini, Radeku, Pjatakovi etj.). Trocki tradhëtoi duke u thënë gjermanëve se Republika Sovjetike nuk e donte luftën dhe do të çmobilizonte ushtrinë. Ushtria gjermane u hodh në ofensivë dhe rrezikoi Petrogradin. Thirrjes «Atdheu Socialist është në rrezik», masat e punëtorëve dhe të fshatarëve ju përgjegjën duke vrapuar që të forconin radhët e Ushtrisë së Kuqe. Në Narvë dhe Pskov, imperialistët gjermanë u ndaluan përfundimisht. Dita e 23 shkurtit, dita e zbrapjes së forcave të imperializmit gjerman u bë ditëlindja e Ushtrisë së Kuqe të re. Në rrethana të tilla Ushtria e Kuqe e re e Bashkimit Sovjetik pranoi paqen e caktuar prej komandës gjermane.

Kongresi VII i partisë, në rezolutën e tij vuri një nen mbi shërbimin ushtarak të detyrueshëm për të gjithë banorët e Bashkimit Sovjetik, në Ushtrinë e Kuqe Sovjetike.

Nga njëra anë intervencioni i 18 shteteve me Ingliterën, Amerikën, Francën dhe Japoninë në krye, me një fjalë Antanta imperialiste dhe nga ana tjetër kundërrevolucionarët e Ruisë, formuan dy bloqet e mëdha që luftonin kundër Bashkimit Sovjetik për të zhdukur fitimet e revolucionit. Intervenistët, bashkë me gjeneralët e rojeve të bardha e sulmuan nga Lindja, nga Jugu

dhe Veriu Bashkimin Sovjetik. Revolucioni kërcënohej nga një rrezik i madh. Në saje të zotësisë së bolshevikëve për t'ju përshatur gjendjes së re dhe të dëshirës së popullit për të luftuar për një çështje të drejtë, për paqe, për tokë, për liri e për socializëm, Ushtria Sovjetike tregoi një vetëmohim dhe heroizëm të pashoq. Shtypi me sukses njëri pas tjetrit, intervenistët dhe rojet e bardha të udhëhequra prej gjeneralëve Denikin e Kollçak dhe në verën e 1919-s shtypi Judenčin. Kështu u shpartallua hovi i parë i intervenistëve dhe i rojeve të bardha. Sulmi i fisnikëve (panëve) polonezë, të udhëhequr prej mareshalit Pilsudski të shtytur prej intervenistëve pësoi të njëjtin fat. Dhe po të mos kishte qenë tradhëtia e Trockit, bolshevikët do t'i fitonin me siguri betejat e humbura të Varshavës dhe të Lvovit<sup>1</sup>. Në këtë rast Trocki, pra, i ndihmoi imperialistët, por Komiteti Qendror ja hoqi atij të drejtën e udhëheqjes ushtarake. Shoku Stalin mori komandën në front. Më 20 tetor 1920, u nënshkrua Paqja e Rigës midis Sovjetëve dhe polakëve, duke mbetur Rusia e Bardhë dhe Galicia në duart e polakëve. Menjëherë mbas Paqes së Rigës, Stalini u këthye kundër gjeneral Vrangelit, i cili ishte pajisur me armët më moderne të marrura prej Anglisë dhe Francës dhe po marshonte drejt Basenit të Donit [Donbasit].

Megjithëqë Ushtria e Kuqe nuk ishte e pajisur si duhet, këtij armiku kaq të fortë i dha grushtet e duhura duke e ndjekur deri në Krime. Dhe kështu, në nëntor të 1920-s, intervenimi mbaroi ndën goditjet e Ushtrisë së Kuqe.

### **Pse dhe si fitoi ushtria e kuqe kundër intervenistëve dhe rojeve të bardha?**

Ushtria e Kuqe fitoi, pse politika e qeverisë sovjetike, për të cilën luftonte, ishte një politikë e drejtë, që u përgjigjej interesave të popullit, pse ishte besnike dhe absolutisht loyale kundër drejt popullit.

1 Trocki dhe Tukaçevski i shtynë trupat e kuqe në frontin e Perëndimit të përparonin drejt Varshavës në një mënyrë krejt të paorganizuar, e pa u dhënë rast të konsolidonin pozitat e fituara, kështu pararoja, duke u larguar prej grumbullit të ushtrisë, mbeti pa ushqime e pa ndihma dhe u thye nën goditjet e para kundër armikut.

Përsa i takon Lvovit, i poshtri Trocki i dha urdhër kavalerisë që të mos e pushtonte qytetin. Ky largim nga Lvovi dobësoi frontin e jugut e si rrjedhim krejt frontin perëndimor.

Tradhëtia tjetër e Trockit është detyrimi që i bënte ushtrisë të kalonte nëpër stepat e nëpër rajonet kozake, ku banorët nuk ushqenin simpati për Sovjetët e veç kësaj mungonin furnizimet, lëndët e para, komunikacionet etj. (Shënimi është i vetë dokumentit).

«Ushtria e Kuqe është pjellë e popullit, dhe në qoftë se ajo i qëndron besnike popullit të vet, si një bir besnik nënës së vet, ajo do të gëzojë përkrahjen e popullit, ajo do të fitojë... sepse bërthama udhëheqëse e... Ushtrisë së Kuqe që Partia Bolshevikë» dhe «vetëm për këtë arsye që e mundur të bëhej mrekullia që u bë. Vetëm për këtë arsye, me gjithë fushatat e njëpasnjëshme të imperialistëve të Antantës dhe të imperialistëve të mbarë botës, ne qemë në gjendje të fitojmë»<sup>1</sup>.

Ushtria e Kuqe fitoi pse ishte edukuar politikisht prej njerëzve të tillë si Lenini, Stalini, Molotovi, Kalinini, Sverdlovi etj.; pse kishte në radhët e saja heronj të lindur si Kotovski, Çapajevi, Lazo, Shçorsi etj.; pse kishte në radhët e saja organizatorë dhe agjitorë, komandantë ushtarakë si Frunze, Voroshilov, Budjoni etj.; kishte komisarët politikë për të cilët Lenini thotë:

«Pa komisarët ushtarakë të luftës ne nuk do të kishim Ushtri të Kuqe»<sup>2</sup>.

Ushtria e Kuqe fitoi pse Republika Sovjetike u ndihmua prej proletariatit të vendeve të tjera imperialiste e interveniste.

Fillon koha e zhvillimit paqësor. Partia e çelniktë dhe Ushtria e Kuqe e forcuar në luftë diti si të punojë dhe mbajti mend fare mirë fjalët e Leninit se derisa të ketë kapitalistë, do të ketë gjithmonë luftë. Kontradiktat themeltare midis socializmit dhe kapitalizmit dhe midis kapitalistëve me njëri-tjetrin, kontradikta që sjellin rishtas luftën, e shtrëngojnë BRSS të mbajë në këmbë Armatën e Kuqe, armatën më të madhe e më të fortë në botë e të një tipi të ri që bota nuk e ka parë deri më sot. Ashtu siç janë bërë mrekulli dhe heroizma pune në ndërtimin e socializmit, po ashtu janë treguar heroikë ushtarët e kuq dhe kuadrot në këtë sistem të ri ushtarak. Koha e shkurtër e Ushtrisë së Kuqe është plot heroizma e vetëmohime, si p.sh. përpjekjet kundër japonezëve në kodrat Zornaja Zora etj. Ndërsa mrekullitë e tanishme të Armatës së Kuqe kanë çuditur dhe po çuditin gjithë botën. Kjo është ushtria që ka marrë përsipër barrën e çlirimit të mbarë njerëzimit nga zgjedha fashiste dhe nga robëria. Ushtria e Kuqe po i jep grushte të forta armikut barbar. Do ta shuajë sigurisht një herë e përgjithmonë nga sipërfaqja e dheut. Ndihej luftën e popujve të tjerë për çlirimin nga robëria dhe ky çlirim nis në datën 6 dhjetor 1941<sup>3</sup>, datë kur Bashkimi Sovjetik filloi ofensivën kundër hordhivë fashiste.

1 Historia e PK (b) të BS — Kursi i shkurtër, botim shqip, viti 1953, faqe 253—254.

2 Cituar sipas Historisë së PK (b) të BS — Kursi i shkurtër, botim shqip, viti 1953, faqe 255.

3 Është fjala për fillimin e kundërmësymjes së Ushtrisë Sovjetike në frontin përpara Moskës.

Në konferencë duhet të flitet për situatën politike të jashtme e të brendshme, të demaskohet politika e Mustafa Krujës dhe të popullarizohet rëndësia e roli i partizanëve.

Njësitë partizane luftojnë për çlirimin e vendit të tyre prej okupatorit fashist. Ndër to marrin pjesë ata njerëz që duan të luftojnë në këtë etapë lufte, në etapën e revolucionit antifashist. Janë formacione lufte, mish dhe gjak i popullit tonë, të përbëra prej elementëve më të pastër. Të gjithë ata që duan lirinë e popullit dhe vdekjen e fashizmit duhet të rekrutohen dhe të marrin pjesë në radhët e partizanëve popullorë, të cilët me luftën e tyre kundër armikut dhe hyzmeqarëve të tij, spiunëve dhe kolonës së pestë, do të çlirojnë popullin. Popujt fqinjë po luftojnë heroikisht në njësitë e tyre partizane kundër armikut. Tani ne na mbetet radha të fillojmë luftën partizane. Para nesh qëndron detyra e madhe historike. Duhet të grumbullojmë rreth vetes masat luftëdashëse<sup>1</sup> të popullit, të vihem në krye të tyre në këto kohë të vështira, por të favorshme për ne, sepse fashizmi është tronditur nga themelet.

Detyra e njerëzve të rritur e të aftë është lufta, krijimi i çetave, formimi i guerrileve, për t'i dhënë grushte armikut deri në fitoren e plotë kundër tij. Gratë dhe rinia kanë për detyrë të sigurojnë lidhjet, të kujdesen për të plagosurit, t'u japin ndihmat e para; kur çetave u mungojnë ushqimet, kanë për detyrë t'ua sigurojnë, bashkë me partizanët që mbeten prapavijave kanë për detyrë të formojnë këshillat nacional-çlirimtare të popullit (të cilat njëkohësisht do të jenë fillestaret e qeverisë sonë të ardhshme dhe të cilat do të kenë pushtetin gjyqësor, sigurimin publik të prapavijave dhe përkujdesjen për të varfërit). Një pjesë duhet të kujdeset për grumbullimin e gjërave ushqimore dhe për shpërndarjen e tyre ose për dërgimin e tyre nëpër çeta. Krahas me këtë duhet të bëhen kurset e grave për ndihmat e para.

Me këto vihen themelet për krijimin e pushtetit tonë, krijimin e njërive partizane. Duhet të sigurohet në gjithë qytetet dhe fshatrat, kudo që është e mundur mbajtja e çetave dhe duhet filluar sa më parë me aksione, agjitacion dhe propagandë politike. Nuk duhet të harrojmë se çetat tona janë agjitorët dhe propagandistët më të mëdha.

Pastaj, duhet të bëjmë agjitacion dhe propagandë që njerë-

1 Është fjala për masat që ishin për luftën kundër fashizmit.



zit të mos shkojnë ushtarë, të cilët i mobilizon armiku. E në qoftë se ata shkojnë duhet të bëjmë agjitacion për arratisje ndër çeta, dhe për të mos u larguar jashtë kufive. Në rast se shkojnë në front të mos luftojnë, por të dorëzohen e të vëllazërohen në fronte etj.

Nënat, gratë, motrat të mobilizohen që të mos i lënë djemtë, burrat dhe vëllezërit e tyre të shkojnë ushtarë, të mos luftojnë për interesat imperialiste, por përkundrazi t'i shtyjnë për në Luftën nacional-çlirimtare.

#### TË FALA SHOQËRORE KQ I PKSH

P SH

Porositen shokët e komiteteve qarkore që ta punojnë këtë letër herën e parë në qarkor e pastaj në aktiv. Përgjegjësit e celulave do ta punojnë ndër celula përpara datës 23 fror që kështu shokët në këtë datë të fillojnë konferencat në popull.

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

#### DIREKTIVA TË KQ TË PKSH NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN E AKSIONEVE DHE TË LUFTËS SË ARMATOSUR KUNDËR PUSHTUESIT FASHIST DHE TRADHËTARËVE

Mars 1942

TË GJITHA KOMITETEVE QARKORE DHE PËRGJEGJËSVE TË  
CELULAVE, TË GJITHA FORUMEVE TË RINISË KOMUNISTE  
SHQIPTARE

Të dashur shokë,

Para disa ditësh ju kemi dërguar një letër<sup>1</sup> mbi festimin e njëzetekatërvjetorit të themelimit të Ushtrisë së Kuqe. Atje është dhënë direktiva si duhet të punoni për formimin e çetave dhe se si duhet të informoni dhe të mobilizoni popullin për luftën tonë. Ajo direktivë duhet zbatuar.

Duhet shënuar disa çështje organizative:

1) Vihet re një farë dobësie në organizatë e veçanërisht në zbatimin e disa direktivave dhe detyrave të caktuara. Prandaj, shokë, edhe një herë, po ju përmendim se të gjitha direktivat e dhëna dhe detyrat e caktuara duhen zbatuar pikë për pikë, veçanërisht përsa u përket aksioneve, sepse në këtë mënyrë ne dhe populli përgatitemi për luftë. Prej aksioneve të imta dhe të vogla drejt aksioneve të mëdha me armë.

2) Vihet re një ligshiti e madhe nga pikëpamja e konspiracionit. Harrohet që ne gjendemi në një kohë mjaft të vështirë dhe të rrethuar nga të gjitha anët prej armikut dhe se detyrohemi të punojmë në kushte mjaft të vështira, në kushtet e skllavërisë së diktaturës fashiste. Prandaj, shokë, të forcojmë më tepër konspiracionin në mënyrë që armiku të mos mund të na dëmtojë dhe të na japë grushte të rënda. Veçanërisht duhet të kemi mendjen në të gjitha veprimet teknike<sup>2</sup>. Ne do të mbrohemi mirë veçanë-

1 Shih në këtë vëllim, f. 40.

2 Është fjala për lëvizjet në lidhje me bazat e teknikës së shtypit.

risht në qoftë se depërtojmë gjerësisht në turmë dhe lidhemi ngushtë me të. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që duhet të biem në konspiracionin e vjetër të kalbur. Porositen shokët e komiteve qarkore që në celulat të flasin mbi rëndësinë e konspiracionit të drejtë dhe të shëndoshë. Shpesh ngjet që bëhen zbulime nëpërmjet lidhjeve, prandaj duhet të mbrohen mirë teknika, materiali, lidhjet dhe shtëpitë përkatëse. Është vënë re ndër shumë shokë që materiali ilegal mbahet pa nevojë nëpër xheda dhe lihet pa kujdes nëpër shtëpi, si në tryeza dhe nëpër shtretër. Duhet të mos humbasë dhe të ruhet me kujdes materiali i Partisë (libra, broshura, proklamata etj.) Komitetet qarkore duhet të kenë të paktën nga një kopje prej çdo proklamate, letre dhe dokumenti të vet dhe të forumeve të larta.

3) Nuk duhet të bëhen veprime për veprime, por vetëm veprime që lejon komiteti qarkor. Të gjitha veprimet që bëhen jashtë këtij rrethi kanë karakter antiparti (përjashtohen veprimet e dobishme të cilat vijnë nga vetë inisiativa e mosbërja e të cilave, do të shkaktonte vonimin ose moskryerjen e tyre).

Nuk duhet të shkohet në të majtë, për të bërë aksione në mënyrën e vjetër, si p.sh. pasi bën një aksion vendi M, të bëjë me-demos dhe vendi N. Gjithashtu duhet të kemi mendjen që të mos biem në pozitën e vjetër të «ruajtjes së kuadrove» — sëmundje e djathtë. Shmangie nga e majta po duken përherë e më tepër e veçanërisht në rininë. Vetëm aksionet e organizuara, demonstratat mund të kenë karakter të drejtë. Prandaj porositen organizatat të bëhen veprime për bukë, kundër luftës, kundër shkuarjes në ushtrinë fashiste, kundër fashizmit, zaptuesit (këtu mund të dalin një ose më shumë oratorë për një ose dy minuta, për t'i dhënë karakter politik asaj lëvizjeje). Në asnjë rast të mos lejohet që demonstruesit të ndalohen në një vend, por duhet të jenë në lëvizje të vazhdueshme. S'duhet të insistohet e të bëhet një përpjekje e fortë e këmbëngulëse, por me gjithë ashpërsinë e tyre duhet të kenë elasticitetin e nevojshëm për të ruajtur kuadrot.

Duhet të ruajmë me çdo mënyrë kuadrot. Nuk duhet të veprojmë në mënyrë që të na dhjetojë armiku. Në qoftë se lidhemi me turmën dhe dalim bashkë me të, atëhere i ruajmë kuadrot. Përsëritet që mos të bihet në pozitë e vjetra («për t'i ruajtur kuadrot, të mos bëjmë aksione» ose «aksione patjetër»).

4) Të bëjmë aksione sabotazhi të çdo lloji e vetëm prej asosh që e dëmtojmë zaptuesin: djegie magazinash, deponsh benzine e municionesh, shkatërrim armësh, me një fjalë të shkatërrojmë çdo gjë që i shërben armikut për të na mbajtur në skllavëri dhe për luftën e tij. Të bëjmë luftën kundër kolonës së pestë dhe kundër spiunëve.

5) Të përforcojmë punën në rininë dhe në gratë. Këtë për

arësye se duhet të përforcojmë punën e agjitacionit dhe të propagandës sonë dhe të sigurojmë kuadrot, të cilët do të zëvendësojnë dhe do të plotësojnë kuadrot udhëheqës të sotëm. Të vazhdojmë dhe të zgjerojmë agjitacionin dhe propagandën tek të varfërit e fshatit e të qytetit, të depërtojmë në fshat. Të dërgohen në fshat agjitorë të përgatitur dhe me influencë për të përgatitur baza për çetat e ardhshme. T'u kushtojmë vëmendje të veçantë shokëve dhe miqve që nuk kanë pranuar të shkojnë në ushtri dhe të organizohen në luftë kundër zaptuesit. Nuk duhet të lëmë asnjë rast të na shpëtojë pa u lidhur ngushtë me turmën popullore.

Pasi ndër disa shokë sundon mejtimi që e gjithë organizata e Partisë duhet të shkojë në çeta posa të formohen dhe të hidhemi në luftë të hapët, këshillohen shokët udhëheqës që qysh tani të mos bien në gabime:

a) Çetat janë të përbëra prej njerëzve që duan të luftojnë kundër fashizmit (d.m.th. duhet ta shtrojmë çështjen në mënyrë të gjerë). Njerëzit që marrin pjesë në çetat duhet të kenë një të kaluar të papërlyer dhe jo të errët.

b) Ato organizohen më së miri prej njerëzve që janë grumbulluar ndër grupet edukative, pasi ndër këto grupe ata janë mësuar me një farë disipline dhe sepse në radhët tona duhet dhe do të ekzistojë një disiplinë, por jo një disiplinë ushtarake dhe e ngurtë (në kuptimin borgjez), tek ne është e nevojshme një disiplinë që ekziston tek njerëz që luftojnë për një çështje të drejtë.

Në grupet edukative parashtrahet çështja se cilët njerëz duhet të luftojnë në radhët partizane. Gjithashtu në po atë mënyrë edhe nëpër konferencat ata njerëz që duan të luftojnë në radhët partizane marrin këshilla në të njëjtin drejtim; ata stërviten në artin ushtarak dhe mësojnë përdorimin e armëve të ndryshme prej komanduesit të çetës. Shoku komisar politik u shpjegon mbi situatën politike të brendshme dhe të jashtme, dhe u mëson çdo gjë që është e dobishme dhe që ngjet tek ne, në çetat dhe në botën e jashtme. Kujdesohet për jetën kulturele dhe politike të çetës në gjendje paqësore, në veprimet e çetave, që këto të marrin karakterin politik.

Në përgjithësi çetën e përbëjnë elementë jashtë Partisë. Ata janë njerëz të dhënë. Nuk duhet të merren njerëz shpirtvegjël, të cilët mund të sjellin demoralizim në radhët e çetës, d.m.th. kryesisht duhen marrë në çetë njerëz prej turmave të gjera që janë jashtë Partisë, e në të tilla çeta duhet të dërgohen shokë të aftë të cilët do të punojnë atje. Një pjesë e madhe e anëtarëve të Partisë duhet të qëndrojnë në vend dhe një pjesë e vogël duhet të shkojnë në celulat e çetave, pasi lufta guerrile e partizane është vetëm një pjesë aktuale e luftës sonë dhe nuk duhet që organizata e mbarë vendit të hidhet në një sektor të punës. Një prej dety-

rave tona kryesore sot është të formojmë njësite dhe çeta, por kjo nuk do të thotë që të formohen kryekëput prej fuqive tona të Partisë.

c) Njësia themelore është çeta, e cila është e përbërë prej detashmenteve<sup>1</sup>. Kur futet në aksion, çeta duhet të ketë në radhët e saja 50-60 njerëz. Mund të ketë edhe më pak, mundet të ketë edhe deri në 100 vetë edhe më tepër. Njerëzit prej të njëjtit vend ose fshat përbëjnë një çetë të përbashkët.

Njësia më e madhe se çeta është batalioni. Më i madh se batalioni është regjimenti<sup>2</sup>.

Komanda kryesore e partizanëve të të gjithë vendit është komanda e lartë e njësive partizane çlirimtare popullore.

### Cila është përbërja e komandës

Në ballë të çetës është komandanti ushtarak dhe zëvendësi i tij, është komisar politik dhe zëvendësi i tij. Përbërjen e komandës së çetës e cakton shtabi i batalionit (d.m.th. komiteti qarkor i vendit në territorin e të cilit formohet çeta). Shtabi i batalionit (komandanti dhe zëvendësi, komisar politik dhe zëvendësi) caktohet prej shtabit të aradhës<sup>3</sup> d.m.th. prej komitetit qarkor ose Komitetit Qendror. Shtabi i aradhës caktohet prej shtabit madhor d.m.th. prej Komitetit Qendror<sup>4</sup>. Çdo detashment, çdo çetë, çdo batalion, regjiment e shtab madhor, ka intendentin e vet (komisarin e nozullimeve), i cili ka lidhje me bazat ushqimore për çetën e me këshillat për çlirimin nacional. Komisar politik dhe zëvendësi i tij duhet të jenë anëtarë partie. Komanduesi ushtarak nuk është e domosdoshme të jetë anëtar partie, bile është e dëshirueshme të jetë një person jo anëtar partie, por që të jetë i ndershëm dhe me aftësi ushtarake, ndërsa zëvendësi i tij mund të jetë anëtar partie.

ç) Komisar politik nuk mund të jetë njëkohësisht edhe përgjegjës i celulës që gjendet në çetë...

d) Këshillohen në mënyrë të rreptë shokët që gjenden në celulë të çetës të mos ndahen dhe të mos bëjnë mbledhje haptazi.

1 Detashment këtu ka kuptimin e njësive më të vogël se çeta.

2 Regjimente nuk u krijuan në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, u gjend më e përshtatshme, për kushtet e vendit tonë, krijimi i grupeve dhe i brigadave si reparte më të mëdha se batalioni.

3 Aradhë — repart partizan më i madh se batalioni.

4 Deri në krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH më 10 korrik 1943, mbi bazën e platformës së Konferencës së Pezës, KQ i PKSHP dhe komitetet qarkore jo vetëm udhëhiqnin, por edhe drejtonin drejtpërdrejt organizimin dhe veprimet ushtarake të njësive partizane.

Këto duhet të bëhen me kujdes dhe konspirative, në mënyrë që mos të vijë ndonjë mosmarrëveshje në çetë për shkak të ndarjes së shokëve për mbledhje, «pse po ndahen komunistët». Këto duhen bërë në këtë mënyrë: Të shkohet në drejtime dhe me pretekste të ndryshme pa rënë në sy dhe duke ju përshtatur vendit dhe rrethanave. Në shpjegimet e ndryshme para çetës sidomos në çështjet politike, shokët duhet të mos bien në kundërshtim, duhet të diskutojnë përpara në celulë, të marrin vendim të përbashkët dhe qëndrim të njëjtë për çështjet e ndryshme.

e) Pasi në çetë ka njerëz të mirë të cilët shumë shpejt do të mund të bëheshin anëtarë partie shumë të mirë, duhet të kujdesemi shumë për ta duke i përgatitur për anëtarë partie. Duhet të kujdesemi që e gjithë çeta të jetë e konsideruar si një grup edukativ. Për këtë duhet të kujdeset komisar politik, përgjegjës i celulës dhe anëtarët e Partisë. Gjithashtu edhe për punën kulturore në çetë duhen krijuar kurset për analfabetë, konferencat, shfaqjet etj.

f) Morali i çetës duhet të jetë kurdoherë në lartësi të denjë për luftëtarët e çlirimit nacional dhe të revolucionit çlirimtar antifashist.

### Në ç'mënyrë do të bëhen lidhjet

a) Në çdo çetë duhet të caktohet një shok, i cili do të ketë lidhjet me komitetin qarkor (lidhjet ushtarake mbahen nëpërmjet shtabeve ushtarake). Ai duhet të raportojë gjerësisht për punën, gjendjen dhe nevojat e çetës dhe merr prej komitetit qarkor librat, broshurat, proklamatat dhe materialin e Partisë. Kjo lidhje nuk është e qëndrueshme.

b) Në çdo celulë duhet të caktohet shoku për vijën ushtarake, i cili do të kujdeset për mbledhjen dhe dërgimin e vullnetarëve, të ushqimit, të armëve dhe të materialit sanitar etj., i cili do të jetë i lidhur me shokët e komisionit ushtarak që përbëhet prej një ose dy anëtarësh të komitetit qarkor dhe prej shokësh të tjerë, të cilët kanë me u kujdesë për çdo material dhe për çdo gjë që është e nevojshme të dërgohet në çetë. Komisioni nuk duhet të kuptohet në mënyrë të fortë si një forum i veçantë, por si shokë të cilët janë të caktuar prej komitetit qarkor dhe gjenden në lidhje të vazhdueshme me të dhe të cilët do të raportojnë vazhdimisht mbi gjendjen.

c) Në prapavijat, në vendet e çliruara nga partizanët, vendoset pushteti prej popullit ashtu si don populli. Në fshat kryepalokun dhe këshillin e zgjedhin fshatarët në konferencat e tyre gjersa mos të jetë formuar aty këshilli ynë për çlirimin nacional. Ndërron kryetarët e komuneve dhe të bashkive dhe zëvendësohen



me ata që vetë populli i ka zgjedhur, por me kusht që të jenë të ndershëm. Garancia për të mos u zgjedhur elementë të pandershëm është propaganda dhe agjitacioni ynë. Të mblidhet ndihma nëpërmjet këshillave nacional-çlirimtare në çdo gjë, misër, grurë, vaj, gjalpë, (tëlynë) lesh, çorape, para, bagëti etj. etj.

ç) Në mënyrë politike kërkohet dhe bindet populli politikisht që të japë pa dhimbje sa më shumë që të jetë e mundur për ne që jemi ushtria e popullit dhe si të tillë populli të na mbajë.

d) Kur ka mundësi për të marrë ndonjë magazinë ushqimi ose rrobesh t'ja ndajmë popullit dhe guerrileve, të cilat na kanë ndihmuar me çdo mënyrë dhe një pjesë ta mbajmë për vete. Gjithashtu bëhet dhe me paratë. Sjellja me popullin duhet të jetë e mirë dhe e mbështetur në baza të shëndosha. Çdo shmangie në këtë kuptim, si p.sh. vjedhja, hyrja ndër shtëpi pa leje, shnderimi i grave, vrasja e njerëzve pa arsye e çdo hakmarrje tjetër personale e çdo lloji, dënohen në vend. Komunistët duhet të jenë shembull dhe gjykues të drejtë, pasqyrë e sakrificës, e vetëmohimit dhe e thjeshtësisë. Në mënyrë të denjë dhe njerëzore duhet të sillemi me armikun që zëmë rob dhe të bisedojmë me të. Nuk lejohet të rrihen as ushtarët robër as oficerët. Me të gjithë ata që s'meritojnë vdekjen duhet të sillemi në mënyrën njerëzore. Nuk do t'i përdhunojmë, as t'i përuhim e t'i poshtërojmë, por përkundrazi ne duhet të fillojmë menjëherë punën politike. Ndalohet rreptësisht marrja e pasurisë personale si para, sahatë etj. përveç dokumentave, armëve, (në rast të jashtëzakonshëm mund të ndërrohet veshmbathja, gjë që i duhet thënë vetëm çdo anëtar të celulës që punon në çetë).

Këto direktiva duhet të zbatohen në jetë. Çdo moszbatim ose zbatim i dobët i tyre, do të ketë pasoja të rënda. Duke mos lënë pas dore punët e tjera të Partisë, ne duhet t'i përvishemi sa më shpejt punës për formimin e çetave partizane. Duhet t'i zbatojmë këto direktiva pikërisht dhe ashtu si u ka hije anëtarëve të Partisë Komuniste, të vendosur dhe të disiplinuar.

#### SKEMË

Emri X. Y. (pseudonimi)	Ka kryer ushtrinë	Ç'armë përdor	A është i shëndoshë	Gjendja shoq. e origjina	I besuar I vendosur
	po	pushkë të gjatë	po	punëtor fshatar	po

T'i dorëzohen menjëherë nga ana e organizatës numri dhe emrat e njerëzve, të cilët janë në dispozicion të Partisë, shokut

që është i ngarkuar për vijën ushtarake dhe të vihet në dijeni menjëherë mbi numrin e njerëzve dhe të armëve që janë në dispozicion. Me anë të lidhjes së zakonshme të komiteteve qarkore, t'i dërgohet forumit më të lartë numri i luftëtarëve dhe i materialit luftarak.

Me përshëndetje shoqërore

VDEKJE FASHIZMIT— LIRI POPULLIT  
KQ i PKSH

**P S KËTO DIREKTIVA DUHET T'I MBANI SHUMË MIRË DHE NË ASNJË MËNYRË NUK DUHET TË BIEN NË DORË TË ARMIKUT.**

Qarkoret porositen t'i punojnë herën e parë vetë, pastaj në aktiv dhe pastaj në celula.

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## KONSULTA E PARË E AKTIVIT TË PKSH

8-10 prill 1942

Konsulta e parë e Aktivit të PKSH u mbajt në prill të vitit 1942 në Tiranë. Ajo filloi më 8 prill dhe vazhdoi tri ditë me disa ndërprerje, për shkak të gjurmimeve të armikut.

Në konsultë muarën pjesë anëtarët e Komitetit Qendror, sekretarët politikë dhe organizativë të komiteteve qarkore dhe një numër komunistësh të tjerë.

Në Konsultën e Aktivit të PKSH u analizua situata ndërkombëtare dhe situata politike e brendshme, puna e Partisë që prej krijimit të saj, gjendja në lidhje me ekzistencën dhe punën e grupazheve në Parti, gjendja organizative e Partisë, puna e Partisë në lidhje me përgatitjen e luftës së armatosur, puna me rininë si dhe çështjet financiare teknike të Partisë.

Shoku Enver Hoxha mbajti referatin kryesor. Konsulta aprovoi veprimtarinë e KQ të Përkohshëm të PKSH. Ajo doli me një rezolucion, që botohet në këtë vëllim në të cilin vihen detyra konkrete për forcimin e mëtejshëm të Partisë, për krijimin dhe forcimin e lidhjeve të saja me masat, për rritjen dhe forcimin e Luftës nacional-çlirimtare kundër pushtuesve fashistë dhe tradhëtarëve, për forcimin e lidhjeve të luftës sonë me atë të Bashkimit Sovjetik dhe të gjithë popujve që luftonin kundër fashizmit.

Konsulta këshilloi Anastas Lulën e Sadik Premten të shkëputnin të gjitha lidhjet e vjetra, të hiqnin dorë nga rruga e shtrembër dhe i paralajmëroi se do të merrnin masat më të ashpra në qoftë se do të bënin të kundërtën. Ajo i porositi komunistët që të mos harronin luftën kundër renegatëve jashtë Partisë, sidomos kundër grupit trockist të «Zjarrit».

Në konsultë u vendos, gjithashtu, që Komiteti Qendror i Përkohshëm të merrte masat për të thirrur Konferencën e parë të Vendit të PKSH.

Konsulta pati një rëndësi të madhe për forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe të punës së saj.

## NGA REZOLUCIONI I KONSULTËS SË PARË TË AKTIVIT TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

8 prill 1942<sup>1</sup>

### REZOLUCION

Në Konsultën e parë të Aktivit të Partisë të P[artisë] Komuniste Shqiptare janë mbledhur delegatë nga të gjitha organizatat krahinore të Shqipërisë.

Në fillim të mbledhjes u përkujtuan shokët Asim Vokshi, Xhemal Kada, Teni Konomi, Ramiz Varvara, Musa Fratari, Koci Bako, Vaso Kadia, Hamid Shijaku e të gjithë luftëtarët e njohur e të panjohur, të rënë si heronj në luftën kundër fashizmit, u përkujtuan edhe shokët Halim Xhelo, Ali Kelmendi dhe Thanas Ziko, viktimat të tmerrit të bardhë; ju drejtua mirënjohja dhe nderimet shokëve ndër burgje, të cilët kanë qëndruar dhe qëndrojnë si u ka hije komunistëve para veglave gjakpirëse të zaptuesit fashist. U dënuan pa mëshirë gjithë tradhëtarët e klasës punëtore e të Partisë Komuniste, që poshtërsisht tradhëtuan përpara policisë, gjyqeve e reaksionit.

Në konsultë është përfunduar në këtë rezolucion:

Për të dytën herë antagonizmat e zhvilluara në gji të sistemit kapitalist e hodhën botën mbarë në kasaphanë e përgjakshme të luftës imperialiste botërore. Traktati i Versajës nga një anë dhe ai i Uashingtonit nga ana tjetër e ndanë botën në dy palë imperialiste kundërshtarë: nga një anë Anglia, Franca, Amerika (Shtetet e Bashkuara), të cilat siguruan zotërimin e tregjeve, të lëndëve të para, të zonave të influencës dhe të udhëve detare, nga ana tjetër Gjermania, Italia e Japonia; Gjermania që e humbi luftën dhe Italia, Japonia që nuk muarën thelën që u ishte premtuar, si shpërblim për pjesëmarrjen e tyre në Luftën e parë imperialiste. Prej Luftës së parë imperialiste botërore lindi një faktor i ri me një rëndësi të jashtzakonshme për zhvillimin e njerëzimit:

<sup>1</sup> Është vënë data e fillimit të konsultës.

Bashkini Sovjetik, socializmi në një të gjashtën e botës. I lindur nga lufta për paqen, bukën dhe tokën e popujve sovjetikë, B[ashkimi] S[ovjetik] u bë kështjella e paqes, së cilës i ndeji besnik dhe i shërbeu me të gjitha fuqitë e tija.

Të krijuara për të shtypur lëvizjen revolucionare të klasës punëtore, për të genë kështjellë reaksioni kundër URSS-it dhe për të bërë rindarjen e botës, lindën fashizmi dhe nazizmi, diktaturat më të tërbuara të pjesës më reaksionare të kapitalit financiar. Pasi shkeli shumë popuj, pasi robëroi popullin polonez dhe francez, i pazoti të bënte invadimin e Anglisë fashizmi italo-gjerman bashkë me hyzmeqarët e tij të vendeve të tjera, u drejtua me tërbim kundër URSS-it atdheut të lumtur e paqedashës të punëtorëve dhe të fshatarëve. Gjakësori me këmishë të murme, Hitleri, pandehte se do të gjente një shteg të dobët, të kalbur nga grindjet e brendshme dhe nga veprimtaria e kolonës së pestë me trockistët në krye, armiq të partisë dhe të popullit sovjetik, plehra të ndyra, të cilat ishin spastruar me kohë nga atdheu i socializmit. Ai pandehte se industria dhe ekonomia sovjetike ishin ëndrra dhe jo realitet, ai pandehte se forca vigane e Ushtrisë së Kuqe ishte një legjendë. Po gjakësori Hitler u gabua rëndë. Hordhitë e tija gjakatare, të pajisura me material luftarak të shumtë e të përfeksionuar, të rrëmbyer në të gjitha vendet e robëruara të Evropës, ndeshën në qëndresën heroike të Ushtrisë së Kuqe, ushtri e lindur në ditët e mëdha të Revolucionit, e rritur dhe e edukuar prej dorës së hekurit të Partisë Bolshevike dhe të shokut Stalin. Në radhët e kësaj ushtrie ndodhen bijtë më trimë e më të zgjedhur të popujve të URSS-it, të frymëzuar nga një ndjenjë e gjallë patriotike dhe nga një ideal i lartë çlirimtar. Sulmuesi fashist gjeti para tij blokun e fortë të popujve sovjetikë, të vendosur në njësi luftarake me shtetin sovjetik, për të mbrojtur gjer në pikën e fundit të gjakut atdheun socialist dhe për të çliruar popujt e robëruar dhe të gjithë njerëzimin nga skllavëria dhe kërcënimi fashist. Duke përfutur nga befasia e sulmit të tij tradhëtar, nga industria luftarake dhe ekonomia e të gjithë Evropës së robëruar, nga mobilizimi i përgjithshëm i forcave të tija, armiku fashist shkeli një pjesë të tokës sovjetike të begatuar nga djersa dhe të vaditur nga gjaku i punëtorëve dhe i fshatarëve sovjetikë. Mbrojtja e fortë aktive e Ushtrisë së Kuqe dhe e popujve sovjetikë që një grusht i tmerrshëm për hordhitë hitleriane. Njëkohësisht URSS-i i mobilizoi të gjitha forcat e tija, e ndaloi armikun dhe nisi ofensivën e madhe që prej Detit të Ngrirë e gjer në Detin e Zi, po i shkakton humbje të mëdha fashizmit dhe nuk do të ndalet deri në zhdukjen e plotë të tij. Kjo ofensivë e detyroi Hitlerin të hedhë në zjarrin e luftës pjesën më të mirë të rezervave të tija. Fashizmi hitlerian është plagosur për vdekje. Radhët e ushtrisë së tij janë boshatisur, prodhimi i materialit po keqësohet

çdo ditë, pasi armiku është i detyruar të dërgojë në front punëtorët e specializuar të industrive të tija. Kurse burimet e Ushtrisë së Kuqe po shtohen përditë e më tepër, nga prodhimi i materialit dhe nga forca të reja njerëzish që përgatiten dita në ditë. Pranvera do të tregojë haptazi hovin e forcën e vërtetë të Ushtrisë së Kuqe, do të tregojë edhe ndihmën reale të aleatëve të URSS-it. Gjithashtu lufta e popujve të robëruar do të marrë sigurisht karakter të hapur kryengritjeje ku do të vërtetohen fjalët e shokut Stalin se Evropa është një vullkan i gjallë i cili do të shpërthejë në flakë revolucionin.

Me luftën e drejtë që po bën URSS-i janë bashkuar demokracitë e mëdha, Amerika e Anglia, me ekonomitë dhe industritë e tyre të fuqishme. Në këtë luftë URSS-i ka përkrah tij popullin heroik kinez dhe popujt e robëruar dhe përparimdashësit e të gjithë botës.

I tërbuar nga humbjet e rënda që pëson në frontin sovjetik, duke i parë në mbarim rezervat e tija në njerëz dhe në material, Hitleri mundohet të përgatisë ofensivën e pranverës. Prandaj ai ka vënë në lëvizje të gjitha veglat e tija të vendeve të robëruara të Evropës, për t'i gjetur e për t'i mbledhur mish të ri për top.

Me përleshjen në mes të militarizmit japonez dhe Amerikës, përleshje e shkaktuar nga kundërshtimet për zonat e influencës dhe udhët detare në Pacifik, lufta mori karakter botëror. Por lufta e demokracive në Lindjen e Largët, e ndihmon luftën e drejtë të popullit heroik kinez duke humbur kështu karakterin thjesht imperialist, ... sepse në të marrin pjesë edhe popujt e tjerë të robëruar nën zgjedhën imperialiste, të cilët luftojnë njëkohësisht dhe për independencën dhe çlirimin e tyre.

E nisur thjesht imperialiste, duke përfshirë të gjithë botën, me hyrjen e Bashkimit Sovjetik, kjo luftë ka marrë karakter çlirimtar. Jemi në fazën e revolucionit antifashist, që bashkon të gjithë përparimdashësit me URSS-in në krye dhe që do ta çlirojë njerëzimin nga murtaja fashiste.

Fatin e gjithë popujve të vegjël e pësoi edhe vendi ynë. Vjete me radhë Italia fashiste bëri ç'ishte e mundur që të shtinte në dorë ekonominë tonë dhe të krijonte një influencë politike. Me anë të agjentëve të saj dhe të kolonës së pestë Italia fashiste bleu dhe shtiu në dorë një pjesë të ish-qeveritarëve dhe të krerëve të emigracionit. Zaptimi ushtarak i vendit tonë i duhej fashizmit italian për të pasur një bazë për përhapjen e tij në Ballkan dhe për të përgatitur në këtë sektor sheshin e luftës së tij imperialiste të cilën të gjithë imperialistët përipiqeshin t'ja ofronin URSS-it dhe ta drejtonin kundër tij. Populli shqiptar, bir i denjë i gjyshëve, që gjatë shekujsh luftuan për liri, e priti me pushkë armikun. Në të katër anët e vendit populli dhe rinia treguan vendosjen e tyre për të mbrojtur me gjak lirinë e atdheut. I armatosur



gjer në dhëmbë, me një ushtri të motorizuar dhe të shumtë, fashizmi italian e shkeli me gjak vendin tonë. Ai erdhi gjoja si çlirues i popullit dhe si përhapës i qytetërimit. Por në të vërtetë ai na skllavëroi, na mori lirinë, independencën kombëtare, na gjakosi me fqinjët tanë, solli në fuqi reaksionin më të poshtër dhe sot agjentët më të urryer të kolonës së pestë Mustafa Krujën me klikën e tij tradhëtare.

Tradhëtari Mustafa Kruja, armik i betuar i popullit shqiptar, xhandar besnik i fashizmit italian, po përpiqet nën maskën e nacionalizmit t'i bëjë varrin popullit shqiptar, ta hedhë në vëllavrasje përbrenda dhe në gjak me fqinjët. Nën maskën e partisë nacional-fashiste shqiptare ai përpiqet të futë nacionalistët në kurth të fashizmit. Në këtë mënyrë kërkon ta përçajë Frontin Nacional-Çlirimtar të popullit shqiptar, organizon luftën kundër të gjithë elementëve patriotë, përparimdashës dhe komunistëve të cilët janë luftëtarët më të vendosur të Luftës nacional-çlirimtare. Për këtë qëllim mblodhi ushtarë dhe rekruton milicë mercenarë që të vërë në zbatim planin e fashizmit italian, të shtypë lëvizjen nacional-çlirimtare në vendin tonë si dhe në vendet fqinje. Mustafa Kruja me një të shtënë kërkon të vrasë dy zogj: të shtypë popullin shqiptar dhe t'i japë fashizmit, aleatit të nazizmit, fuqi të reja për ofensivën e pranverës, të trumbetuar me aq bujë prej fashizmit gjerman. Por me gjithë përpjekjet e qeverisë tradhëtare, e cila mundohet ta hedhë popullin shqiptar në pozitat e fashizmit, pakënaqësia e popullit shtohet dita-ditës, vullneti për çlirimin shprehet në Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë, luftë e cila po fiton fuqi përherë më të mëdha. Urrejtja e popullit shqiptar kundër zaptuesit bëhet edhe më e fuqishme për shkak të ndjekjeve, të mbledhjes së ushtarëve, të milicëve, të vrasjeve, të burgosjeve. Influenca e Partisë sonë në maset punëtoare, fshatare e qytetare po shtohet përherë më tepër. Del përherë më i theksuar roli i Partisë, si organizuese e masave në Luftën nacional-çlirimtare. Zhvillimi i gjendjes së jashtme ushtron një influencë lartësuese në popullin shqiptar e në jetën politike të vendit. Njerëz që përpara rrinin krejt të veçuar nga jeta politike, tashti interesohen gjallërisht për të. Po formohet dhe po forcohet ideja për kryengritjen e përgjithshme dhe populli fillon të kuptojë se vetëm me forcat e veta duhet dhe mund ta fitojë çlirimin duke e lidhur luftën e vet me atë të Bashkimit Sovjetik, të Amerikës, Anglisë dhe Kinës si dhe me atë të viseve të robëruara, ku qëndron garancia e vërtetë e çlirimit tonë. Por megjithkëtë nuk duhet ta nënvleftësojmë armikun. Në disa drejtime dhe në disa krahina ai është duke pasur suksese. Metodrat që ai përdor janë të ndryshme. Për të krijuar p.sh. urrëjtjen kundër URSS-it, ai e akuzon luftën e B[ashkimit] S[ovjetik] si luftë për pansllavizëm. Prandaj ne duhet t'i hapim sytë mirë. Çdo moskujdesi politike nga

ana jonë mund ta paguajmë shtrenjtë. Ne duhet ta shikojmë gjendjen realisht. Duhet t'u tregojmë masave të popullit se kush është mik e kush është armik, kush lufton kundër jush dhe kush lufton me ju për të drejtat e popullit. Vetëm një drejtim i fortë nga ana jonë mund ta udhëzojë popullin në udhën e drejtë që çon në çlirimin nga zgjedha e fashizmit.

\*  
\*  
\*

Konsulta konstaton ndryshimin e madh që është bërë edhe në organizatën tonë në krahasim me të kaluarën. Komiteti Qendror i Përkohshëm ka organizuar punën e vjetër të grupeve, ka ndërtuar celulatat komuniste duke i grumbulluar rreth forumeve lokale, ka bashkuar organizatat e qarqeve të ndryshme dhe i ka lidhur me Komitetin Qendror. Shokët e Komitetit Qendror kanë paraqitur vijën politike dhe organizative në organizatat lokale, u kanë ndihmuar këtyre organizatave me këshilla dhe me direktiva. Ata kanë vënë themelet e Partisë duke luftuar po në një kohë sektarizmin, lokalizmin e të gjitha sëmundjet e së shkuarës, kanë filluar luftën kundër shmangieve dhe elementëve të sëmurë. Me anë të luftës dhe të aksionit KQ ka hedhur themelet e njësisë së Partisë. Ai ka marrë qëndrime për të gjitha çështjet dhe me proklamatat e tija ka dhënë vijën politike të punës, i ka dhënë jetë organizatës. Për ta forcuar Partinë KQ ka marrë vendime të bëhen aksione, demonstrata etj., të cilat janë i vetmi mjet i forcimit të Partisë dhe i lidhjes së saj me masën. Organizatat lokale kanë kryer veprime (greva, demonstrata, sabotazhe), të cilat në praktikë kanë kontribuar për zhdukjen e pikëpamjeve të gabuara të shokëve, e kanë forcuar Partinë dhe e kanë ngritur lart emrin e saj. Janë bërë hapat e parë të hyrjes organizativisht në punëtorët e fshatarët e përgjithësisht janë formuar lidhje me masën e gjerë të qytetit e pjesërisht të fshatit. Është shtuar influenza e komunistëve në popull dhe është zmadhuar numri i miqve të Partisë.

Janë bërë hapat e parë të punës në masën e grave, janë organizuar celula grash, të cilat kanë organizuar konferenca femërore ku është paraqitur vija jonë e luftës për çlirimin e gruas krah për krah me burrin.

Në ushtri janë shpërndarë proklamata dhe është bërë agjitacion për dezertim nga radhët e ushtrisë fashiste.

Komiteti Qendror dhe shumica e organizatave lokale i kanë dhënë ndihmën me të çmueshme rinisë në luftën e saj për organizimin dhe të drejtat e jetës. Brezi ynë i ri e luftëtar i përgjigjet me entuziazëm djaloshtar kujdesit të Partisë duke zënë një vend të denjë në Luftën nacional-çlirimtare të popullit shqiptar.



Komiteti Qendror ka bërë një luftë të papushueshme për të zhdukur nga radhët e Partisë mbeturinat e frymës së grupeve, lëkundjet, liberalizmin, oportunizmin, ambicien, tarafilëkun, influencat e borgjezisë së vogël, mungesën e besimit në klasën punëtore dhe në popullin shqiptar. Duhet t'i shfarosim e t'i demaskojmë një herë e mirë grupashët e sëmurë dhe të gjithë ata që hedhin gurë në rrotat e Partisë. Nuk mund të kemi me të vërtetë një parti komuniste të fortë pa luftuar me këmbëngulje gjithë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të Partisë. Partia jonë ka bërë ç'është e mundur që të vërë në udhë të mbarë elementët e sëmurë të grupeve të ndryshme. Megjithkëtë janë disa elementë që nuk po shképuten nga gjendja e parë, por vazhdojnë shmangien nga vija e drejtë e Partisë. Këta elementë megjithëse e kanë pranuar një herë gabimin e tyre vazhdojnë akoma rrugën e shtrembër. Përveç këtyre janë edhe dy elementë<sup>1</sup> që përpiqen të mbajnë me çdo mënyrë lidhjet e vjetra dhe të grumbullojnë rreth vetes miq të rinj ose shokët e tyre të vjetër. Disa prej këtyre ka mundësi të ndreqen dhe do të bëhet ç'është e mundur që të vihen në udhë të mbarë.

Duhet ta demaskojmë e ta luftojmë grupin e «Zjarrit» që e quan veten parti, i cili ka rënë në baltën e oportunizmit likuidator. Njerëzit e këtij grupi thonë se janë «komunistë legalë», lejojnë bashkëpunimin me qeverinë e Mustafa Krutës, nuk pranojnë asnjë agjitacion, propagandë dhe aksion, thonë se nuk ka ardhur koha, thonë se URSS-i po tërhiqet, prandaj edhe ne duhet të tërhiqemi në pozitë tona, të rrimë pasivë dhe të shkrihem në nacionalistët, se dhe Bashkimi Sovjetik vetë po bën koncesione. Këta thonë se vetëm katër ditë para dëbimit të Italisë (jo të fashizmit) mund të bëjmë aksione dhe kur të kemi qeverinë dhe ushtrinë e kuqe atëherë do ta bëjmë revolucionin. Këta falsifikojnë direktivat e Kominternit («Nuk duhet të bëjmë aksione, demonstrata, greva etj. e vetëm 4 ditë përpara shkatërrimit të Italisë, ne të hidhemi në aksion») dhe ne na kërcënojnë me «gjqin e popullit». Partia duhet të luftojë pa mëshirë mbeturinat e trockizmit, A[ristidh] Q[endron] dhe Z[ai] F[undon], që kërkojnë vazhdimisht të korruptojnë radhët tona, të bashkohen me elementët e nxjerrë jashtë Partisë si N[iko] X[oxi], i qitur jashtë prej lëvizjes punëtore që prej 1935-s dhe i dënuar si armik e tradhëtar i Partisë Komuniste që prej gjyqit të 1939-s<sup>2</sup> dhe të hyjnë në shportën e plehrave, në grupin e «Zjarrit».

1 Është fjala për Anastas Lulën dhe Sadik Premten.

2 Gjyqi i komunistëve, që u zhvillua në janar-shkurt 1939 në Tiranë nga qeveria e A. Zogut, dënoi 50 komunistë me internim dhe burgim. Në gjyq Zef Mala, kryetar i grupit të Shkodrës dhe Niko Xoxi, që ishte bashkuar me këtë grup, tradhëtuan haptas duke i treguar shokët e tyre përpara policisë.

Partia do të kishte shkuar me të vërtetë përpara po të mos ishte shkelur disiplina dhe po të mos ishin hapur teori të gabuara nga elementët e sëmurë si p.sh.: «puna me fshatarët, është e pamundur se ata (fshatarët) janë prapanikë»; «puna me rininë nuk duhet të jetë kështu» etj. etj.

Fuqia e Partisë matet nga gjendja e kuadrove dhe nga lidhjet e tyre me masat e popullit. Ne nuk mund të kemi një parti të fortë në qoftë se kuadrot tanë qëndrojnë larg masës dhe nuk janë të shkrirë në të. Deri sot cilësia e shokëve dhe gjendja e tyre është e ulët. Ka akoma frymë sektare në organizatë, «të pakënaqur» pse nuk janë zgjedhur në ndonjë forum, ose «pse nuk është filani në forum», «pse është filani në Parti», «nuk ishim të kënaqur pse ne s'kishim shokë në forum të k[omitetit] qarkor», «pse ishte filani në forum, i cili s'ish i mirë dhe koha e tregoi që s'ish i mirë se u përjashtua edhe nga Partia». Mundohen të demonstrojnë se «partia ka bërë gabim» e që «ata kanë pasur të drejtë». Por Partia ka të drejtë si për ata që përjashtoi si për ata që pretendojnë të tilla gjëra që s'janë aspak komuniste gjë që i dobëson edhe më tepër kuadrot. Ne duhet të përpiqemi sa të jetë e mundur më shpejt t'i japim fund rrymës kundër vijës së Partisë që ekziston në gjë të Partisë dhe ta ngremë nivelin politik të shokëve. Por kështu kuadrot tanë nuk mund të vazhdojnë për shumë kohë. Partia jonë nuk mund të ketë jetë të gjatë në qoftë se nuk i ushqejmë kuadrot me elementë të rinj të dalë nga gjiri i popullit, të regjru nga agjitacioni, propaganda dhe aksioni në masë. Nuk mund të kemi një parti të fortë në qoftë se elementët që lëkunden, që janë lidhur dobët me Partinë tonë nuk pastrohen prej radhëve të Partisë ose nuk vijnë në rrugën e drejtë. Ne duhet t'i japim gjak të ri Partisë, duhet ta zhvillojmë dhe ta përtërijmë vazhdimisht atë. Është vënë re se shumë elementë të vendosur, të papërlyer, të çelniktë dhe besnikë ndaj Partisë sonë qëndrojnë jashtë kuadrove të Partisë sonë. Këta janë kryesisht punëtorë e fshatarë. Thuhet për këta se nuk janë në lartësinë e duhur politike dhe teorike. Ku do të zhvillohen më mirë se në radhët tona këta elementë të vendosur? Por ne nuk kemi bërë asgjë për ta jashtë kuadrove të Partisë, dhe akoma presim që të zhvillohen! Ne po e përsërisim, nuk mund të kemi një parti jetëgjatë po qe se mbetemi në këtë gjendje. Kuadrot tanë lindin në luftë, plogështia dhe inaktiviteti janë armë për armikun dhe vdekje për ne. Masa është e vetmja shoshë që nxjerr një parti të fortë. Ne pas çdo veprimi bëjmë komente, por nuk përfitojmë organizativisht dhe të shtojmë eksperiencën revolucionare. Masën që është grumbulluar nga veprimet e deritanishme nuk kemi ditur ta lidhim ngushtë sa duhet me Partinë tonë. Gati në të gjitha organizatat, grupet edukative dhe konferencat nuk janë organizuar ose dhe në janë organizuar nuk u është dhënë rëndësia e duhur. Nga ana tjetër fo-

rumet drejtuese dhe shokët e përgatitur nuk kanë treguar interesin e duhur për lartësimin e kuadrove dhe pastrimin e tyre. Në shumë organizata mbledhjet nuk janë bërë në rregull dhe nuk është biseduar çka duhet të bisedohet në këtë gjendje në të cilën ndodhemi. Shpeshherë organizatat janë bërë qendra bisedash akademike. Vija e Partisë që duhet të jetë mishi e gjaku i organizatës nuk është kuptuar sa duhet prej shokëve.

Si do t'i lidhim masat me Partinë kur vetë shokët nuk janë lidhur mirë me të. Fryma e grupeve dhe gjendja e kaluar na ka ndaluar mjaft në këtë pikë, por nuk janë vetëm këto shkaqe. Për shembull në shumë celula rezolucioni i parë<sup>1</sup> vetëm sa është kënduar; proklamatat që janë programi i Partisë sonë nuk janë rrahur, nuk është bërë të thuash asnjë referat për ndonjë subjekt me rëndësi, nga shumë celula. Si do të zbatohet vija e Partisë kur anëtarët e shumë forumeve nuk e kryejnë si duhet detyrën që u është ngarkuar, po tregojnë një plogështi dhe pazotësi duke u ruajtur nga përgjegjësitë? Shumë herë ndarja e punës nuk bëhet si duhet, shokëve nuk u ngarkohen detyrat që mund t'i kryejnë më mirë. Nuk është vetëm gjendja e kuadrove që e dobëson Partinë; gati në të gjithë sektorët ku Partia duhet të zhvillojë aktivitetin e saj puna është lënë pas dore dhe nuk është bërë sa duhet.

a) Punëtorët jo vetëm që nuk janë organizuar, por edhe nuk janë grumbulluar akoma sa duhet rreth Partisë sonë. Shokët justifikohen shpeshherë për këtë punë duke thënë se punëtorët janë të shpërndarë këtu në Shqipëri dhe s'mund të grumbullohen kollaj. Po si mund të jetë e fortë Partia jonë pa punëtorë kurse baza e saj duhet të jetë në punëtorë? Nëse ka njerëz që mund të grumbullohen dhe të organizohen më lehtë janë punëtorët, ata e ndjejnë peshën e përditshme të shfrytëzimit e të zgjedhës. Shumë shokë kur paraqiten në celulë thonë se kanë gjetur një punëtor simpatizant, por harrojnë të flasin për grumbullimet e masës punëtore.

b) Fshatarësia ishte lënë në fatin e saj gjer dje. Por edhe sot shumica e shokëve nuk e kanë çmuar akoma vlefën e saj. Disa thonë se fshatari ynë është prapanik, disa të tjerë thonë se duhet të punojmë me fshatarin, por e kanë zët t'i lyejnë këpucët me baltë fshati ose të ftohen, e presin fshatarin t'u vijë në qytet pas-taj ta kapin. Gati të gjithë shokët nuk e njohin mirë ose e njohin shumë keq fshatin. Pamja e shumicës së shokëve nuk i kapërcen muret e qytetit dhe kështu kur flasin për fshatin flasin sikur të jetë një vend i huaj. Natyrisht nga kjo rrjedh një mospërfillje për fshatarin dhe mungesa e aftësisë për të prekur problemet e

<sup>1</sup> Rezolucioni i mbledhjes së grupeve kryesore komuniste për krijimin e Partisë.

jetës dhe plagët e fshatarit. Ja sepse në manifestimet tona fshatari qëndron si i huaj dhe shikon si në kinema turmën që manifeston (manifestimi i Korçës 8 nëntor). Kur kemi ditur t'i prekim plagët fshatarit, ai nuk mungon të vijë me ne e të dëgjojë fjalët e udhëzimet tona (aksioni i bukës në Vlorë).

c) Rinia, e ardhshmja e popullit dhe e Partisë sonë ende nuk është organizuar dhe grumbulluar sa duhet. Ne duhet të grumbullojmë masat sa më të gjera të rinisë të dy seksleve, në qytet e në fshat. Këtë nuk e kemi bërë sa duhet, rinia nuk di mirë se ç'është fashizmi dhe e ardhshmja e saj nën të. Një pjesë e rinisë megjithëse e vogël tërhiqet akoma nga ideat fallso të fashizmit. Një pjesë tjetër në qytet e në fshat është përlurur nën peshën e rëndë të punës e të zgjedhës fashiste dhe ne nuk i kemi dhënë dorën ta ngremë. Në përgjithësi i njohim fare pak aspiratat e rinisë, kemi akoma mejtimit e së kaluarës për rininë dhe për punën me rininë dhe më e keqja është se në disa organizata të rinisë ekziston akoma fryma e grupeve.

ç) Problemi i gruas sapo është prekur, kurse gruaja është gjysma e shoqërisë dhe pjesa më e shtypur. Kemi mejtimit të gabuara për të dhe hallet e saj i njohim fare pak në qytet dhe aq më keq në fshat. Shumë shokë thonë se s'na vijnë gratë në organizatë ose në rrethet simpatizuese të organizatës. Edhe ato shoqe e ata shokë që punojnë me qejf, punojnë më tepër në rrethet familjare dhe harrojnë të hidhen në fabrikë, në mëhallë ose në fshat ku është masa e grave. Njohim fare pak ose aspak hallet e gruas si problemi i martesës, i foshnjës, i mizerjes në përgjithësi etj. Gratë dhe rinia janë ato që do t'i vënë shpatullat organizatës në ditët më të vështira të luftës.

d) Nuk janë formuar njësitë ushtarake, ushtria popullore ose edhe në rast se është bërë diçka në disa vende, nuk janë njësi me kuptimin e vërtetë të fjalës. Themi se do ta luftojmë armikun, por për një punë me kaq rëndësi ne kemi qenë të plogët dhe nuk kemi punuar sa duhet. Çështja e organizimit të ushtrisë popullore është një çështje themelore dhe urgjente për ne. Ushtarëve të mobilizuar nuk u kemi dhënë kujdesin e duhur, kurse ata na kërkojnë dhe janë gati të vijnë me ne.

dh) Pa aksione s'ka parti komuniste. Aksionet që janë bërë deri sot si sabotazhe, demonstrata, nuk janë bërë në shkallë të gjerë. Por ajo që e rrit dhe e forcon Partinë tonë është aksioni dhe lufta. Nuk mund të lidhemi me popullin po nuk i provuam atij se jemi të zot ta udhëheqim. Në shumë raste nuk kemi bërë aksione kur situata e ka dashur të bëheshin, kështu që ne do të kishim fituar mjaft. Problemit të bukës dhe të mizerjes së përditshme të popullit nuk i kemi dhënë rëndësinë e duhur.

Mjaft e dobët është disiplina në disa organizata. Shpeshherë direktivat nuk zbatohen si duhet dhe nganjëherë nuk zbatohen



fare. Vazhdojnë shpeshherë lidhjet e vjetra e nuk ekziston një lidhje e ngushtë e forumeve të Partisë me organizatën. Nganjëherë disa persona kanë marrë vendime jashtë organizatës duke ju shmangur vendimeve të marrura prej forumeve përgjegjëse. Prej konspiracionit të kalbur kemi arritur në dekonspiracionin më të madh. Shokët dhe organizatat nuk i kanë ruajtur vendet e teknikës e të materialit aq sa duhej. Mbajtja e lidhjeve të vjetra ka shkaktuar dekonspirimin e forumeve dhe të lidhjeve të Partisë, gjë për të cilën kanë faj edhe disa anëtarë të forumeve. Qëndrimi i shokëve që kanë rënë në dorë të armikut ka qenë në lartësinë e duhur. Shënohet veç një tendencë për ekzagjerim dhe përhapje paniku, gjë që e ndihmon punën e armikut fashist, i cili me çdo mënyrë kërkon të futë frikë dhe demoralizim në radhët tona. Këto dukje janë shumë të rrezikshme për radhët e organizatës. Duhet luftuar pa mëshirë të gjithë alarmantët dhe përhapësit e panikut. Syqetësia është e domosdoshme për çdo anëtar të Partisë si brenda ashtu edhe jashtë organizatës.

Teknika është përgjithësisht e dobët në organizatë. Në disa vende është e mjaftueshme për të përballuar nevojat e organizatave e në disa të tjera jo. Komiteti Qendror merr përsipër të plotësojë nevojat teknike të organizatave të varfëra në këtë anë. Të gjithë shokët duhet të mundohen me sa fuqi që kanë të përmirësojnë teknikën e organizatave tona, të ruajnë mirë vendet e teknikës.

Nga pikëpamja e financës, organizata është e dobët. Për këtë duhen bërë disa vërejtje. Mbledhja e kuotizacioneve (mujoreve) nuk bëhet në rregull. Po ashtu ngjet edhe me llogaritë e tyre, të cilat nganjëherë nuk mbledhen aspak, dhe kur mbledhen nuk i komunikohet dhe nuk i dërgohet nga ana e komiteteve qarkore Komitetit Qendror shuma e mbledhur. Nuk është kuptuar akoma në mënyrën e përshtatshme ndihma popullore, qëllimi i saj dhe, sidomos, domethënia e saj politike. Për arsye të kushteve të tashme të veçanta, ndihma popullore ndërrohet në fondin për çlirimin nacional. Ndihamat për këtë fond kërkohen nga të gjithë shqiptarët e ndershëm, të cilët e kanë në zemër lirinë e Shqipërisë dhe duan ta ndihmojnë Luftën nacional-çlirimtare. Për këtë qëllim organizohen këshillat për fondin nacional-çlirimtar të përbëra nga antifashistë të ndershëm.

Konsulta, pasi analizoi situatën politike të jashtme dhe të brendshme, pasi studjoi gjendjen në organizatë, konstaton se situata e tashme na vë në komunistëve detyra të reja me rëndësi historike. Konsulta konstaton se megjithëqë kemi shkuar mjaft përpara ne nuk kemi bërë aq sa duhej dhe sa mund të bënim. Përballë kësaj gjendjeje konsulta vendosi të merret përsipër nga organizatat e Partisë zbatimi i këtyre detyrave politike dhe organizative:

1) Të mobilizojmë turmat e gjera të qytetit e të fshatit në

Luftën nacional-çlirimtare për një Shqipëri të lirë demokratike popullore.

2) Të popullarizojmë luftën e drejtë që ndjekin Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara, [të Amerikës], bashkë me gjithë popujt e shtypur nga thundra e fashizmit. Ta lidhim sa më ngushtë Luftën tonë nacional-çlirimtare me këtë luftë, e cila është garancia më e sigurtë për çlirimin tonë nga zgjedha e fashizmit. Të popullarizojmë rolin e pararojës së URSS-it në këtë luftë çlirimtare.

3) Të demaskojmë çdo taktikë të re që fashizmi dhe agjentët e tij, qeveria e Mustafa Krujës përdor për të përçarë popullin dhe për të shtypur lëvizjen tonë nacional-çlirimtare.

4) Të popullarizojmë luftën tonë kundër zaptuesit fashist, luftë me një karakter nacional-çlirimtar, për ÇLIRIMIN E VËRTETË.

5) Të mos lejojmë asnjë shmangie ose keqkuptim në çështjen e Frontit të përbashkët Nacional-Çlirimtar të popullit shqiptar. T'u japim mundësi të gjitha forcave patriotike të ndershme të marrin pjesë aktive në Luftën nacional-çlirimtare duke u hapur atyre portat e njësive partizane. Por të ruhem njëkohësisht që të mos hyjë ndonjë element armik. Të jemi kurdoherë në ballë të Luftës nacional-çlirimtare duke u dhënë shembull të tjerëve.

Të luftohet shovinizmi dhe antagonizmi fetar.

6) Të organizohen këshillat nacional-çlirimtare me pjesëmarrjen sa me të gjerë të shqiptarëve të ndershëm të fshatit e të qytetit që duan me të vërtetë të luftojnë kundër fashizmit dhe për lirinë e Shqipërisë. Të ruhem nga krijimi i tyre në mënyrë artificiale.

7) Të organizohen njësitë partizane nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Të organizohen në ushtrinë fashiste këshillat antifashiste për Luftën nacional-çlirimtare.

8) Të shpjegojmë përpikërisht vijën e Partisë në popull me anë proklamata, konferencash, mbledhjesh të ndryshme, aksionesh, agjitacioni, propagande etj., duke ju drejtuar në mënyrë të veçantë turmave të fshatit e të qytetit e sidomos të varfërve.

Për ta forcuar organizatën, sa më tepër, është e nevojshme:

1) T'i lartësojmë kuadrot dhe t'i pregatisim për udhëheqës duke i përshkuar nëpër kurse të ndryshme, [duke bërë], referate, duke punuar veçanërisht Historinë e Partisë Komuniste (bolshevike) të URSS-it, materialin e Partisë si proklamata, rezolucione, qarkore etj.

2) Të luftojmë në organizatë me anë të bindjes dhe të spastrimit çdo rrymë, shmangie (deviacion), djathtas ose majtas, nga vija e Partisë. Të punojmë me këmbëngulje dhe durim bolshevik për përmirësimin dhe ngritjen e shokëve që kanë rënë në gabime ose në shmangie nga vija.

3) Të luftojmë pa mëshirë grupin e «Zjarrit», trockistët, Z[ai] F[undo], A[ristidh] Q[endro], N[iko] X[oxi] dhe të gjithë



armiqtë e Partisë, të cilët përpiqen me çdo mënyrë ta pengojnë punën e Partisë.

4) Të çmohet dhe të seleksionohet mirë shokët duke përjashtuar nga Partia pa mëshirë të gjithë elementët e pashërueshëm. Këtë mund ta bëjnë komitetet qarkore me propozim dhe në marrëveshje me celulën përkatëse.

5) Të zhvillohet ndjenja e inisiativës në të gjithë shokët dhe të luftohet përqëndrimi i punës në duar të disa shokëve.

6) Të luftohet tendenca e lënies pas dore të një sektori për t'u lëshuar e gjithë organizata në një sektor pune. Të ngjallet puna e Partisë kudo.

7) Të vendosen lidhje të ngushta në mes të forumeve më të larta dhe forumeve më të ulta, në mes të forumeve drejtuese dhe organizatave.

8) Të organizohet puna në celulë dhe në forume. Të bëhen në rregull mbledhjet e celulës. Të bëhet ndarja e drejtë e punës. T'i jepet çdo shoku puna që i përshtatet dhe të kontrollohet imtë puna e çdo shoku. Të vendoset përgjegjësia para Partisë për çdo detyrë të ngarkuar.

9) T'i vihet rëndësi e veçantë disiplinës dhe konspiracionit të drejtë, sot që shtypja fashiste po shtohet dita-ditës dhe kur reaksioni i brendshëm bashkë me fashizmin kanë bashkuar të gjitha forcat që të na luftojnë dhe mundohen të futin në radhët tona agjentë dhe provokatorë.

10) Të zbatohet sa më shpejt vendimet dhe direktivat e deritanishme organizative dhe politike të Komitetit Qendror, gjithashtu vendimet e marrura në konsultë, pse vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet roli drejtues i Partisë.

Konsulta konsideron se për ta mbajtur lart flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, për ta forcuar Partinë dhe për ta çliruar popullin shqiptar duhet që Partia jonë të jetë shembulli i organizimit dhe i disiplinës së hekurt bolshevike, të jetë e pajisur me teorinë leniniste-staliniane, e lidhur ngushtë me turmat e gjera të popullit, me konspiracion të ndërjegjshëm dhe udhëheqëse e vendosur e turmave popullore shqiptare në luftën për çlirimin nga zgjedha barbare fashiste.

Në mbylljen e punimeve, delegatët e organizatave qarkore të PKSH i drejtuan KQ të P[artisë] përsëritjen që vijon:

#### KOMITETIT QENDROR TË PK TË SHQIPËRISË

Aktivi i Partisë, i Partisë Komuniste Shqiptare, i mbledhur në konditat më të ashpra të reaksionit fashist ndër ditë me kaq rëndësi për fatin e popullit shqiptar i çon përsëritjen më të përzemërt Komitetit Qendror, atij Komiteti që diti të vërë komu-

nistët shqiptarë në rrugën e drejtë revolucionare, në rrugën e Partisë Bolshevike Lenin-Stalin, në rrugën e Internacionales Komuniste. Jemi të sigurtë se një komitet i tillë që frymëzon me aq siguri një mbledhje të tillë me kaq rëndësi për fatin e popullit shqiptar, do t'i drejtojë turmat e popullit shqiptar të shumëvuajtura në luftën e VËRTETË TË SHPËTIMIT, në Luftën nacional-çlirimtare, drejt një demokracie të vërtetë.

Duke e lidhur Luftën tonë nacional-çlirimtare me luftën heroike të Bashkimit të madh Sovjetik, pararoja lavdiplote në luftën kundër barbarisë fashiste, Partia jonë do t'i japë popullit shqiptar bukë, paqe dhe liri në një Shqipëri të lirë, demokratike popullore.

Të bindur në direktivat e Komitetit Qendror do ta ruajmë Partinë tonë si dritën e syve nga çdo armik i brendshëm dhe i jashtëm, do të dimë t'i zbatohet me vendosje dhe vetëmohim gjithë udhëzimet me rëndësi historike, që na janë dhënë. Luftës nacional-çlirimtare do t'i shkrijmë të gjitha forcat tona, për vdekjen e fashizmit dhe për lirinë e popullit.

Rroftë Komiteti Qendror!

Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Shqipëria e lirë!

Rroftë Partia Bolshevike dhe shoku Stalin!

Rroftë Internacionalja Komuniste!

VDEKJE FASHIZMIT—  
—LIRI POPULLIT!

#### AKTIVI I PARTISË I PK TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas kopjes së  
daktilografuar, që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## THIRRJE E K Q TË P K SH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR

Prill 1942

POPULL SHQIPTAR!  
PUNËTORË, FSHATARË, QYTETARË!

Është viti i tretë i luftës më të tmerrshme e më të përgjakshme që ka parë historia njerëzore dhe që është filluar nga imperializmi i ringjallur gjerman fashist, për të skllavëruar njerëzimin dhe për të kthyer në botë zinxhirët mesjetarë, errësirën dhe reaksionin. Kjo luftë, tmerret, frikësimet dhe egërsitë e së cilës nuk i mban mend njerëzimi, ka shkatërruar dhe ka shkatërruar shumë vende, ka skllavëruar shumë popuj të vegjël, ka rrënuar dhe djegur qytete e fshatra, ka zhdukur miliona e miliona jetë njerëzore, ka veshur në të zi miliona shtëpi, duke mbledhur në rrethin e saj të përgjakshëm të gjitha shtetet e botës dhe të gjitha kontinentet. Kuçedra e përgjakshme fashiste pasi ka përpirë dhe skllavëruar gati të gjithë Evropën, është kthyer me tërbim kundër Bashkimit Sovjetik, vendit paqedashës, të begatshëm dhe të lumtur, atdheut të punëtorëve e të fshatarëve, atdheut të socializmit, ku turmat punëtorë të qytetit e të fshatit mbi gërmadhat e shoqërisë së vjetër e të kalbur, nën drejtimin e udhëheqësve gjenialë Lenin e Stalin, kanë ndërtuar ndërtesën madhështore të kulturës dhe të përparimit. Pas njëzetekatër vjet pune dhe sakrificash mbijnjerëzore duke arritur rezultate gjiganteske, popujt e bashkimit të madh e vëllazëror të URSS-it kanë ndërtuar socializmin, një ndërtesë të re, një vend të ri dhe të begatshëm, kanë krijuar kushte deri tani të papara në ritmin e zhvillimit shkencor dhe të përparimit njerëzor, kanë krijuar pasuri të madhe kulturele të njerëzimit mbarë.

Në planet e tyre të errëta, bishat e egra të fashizmit hitlerian kanë kujtuar që me sulmin e papritur do t'i gjenin të pabashkuar dhe të papregatitur popujt e Bashkimit Sovjetik, që kollaj do të zhdukeshin fitoret e Revolucionit të madh socialist sovjetik e do

të kthenin aristokracinë, kontët dhe gjeneralët e carit në formën e re, me tiparet e luftëndezësit Hitler. Të mësuar nga fitoret e lehta e të shpejta në Evropë, të dëshiruar për plaçkitje, me egërsi janë munduar të shtien në dorë pasuritë e Bashkimit Sovjetik, Moskën e Leningradin, duke mos kursyer njerëzit dhe materialin luftarak. Hitleri ka mejtuar që për një kohë të shkurtër me egërsinë dhe sulmin e papritur do ta thyente Ushtrinë e Kuqe dhe do ta shkatërronte fuqinë e Bashkimit Sovjetik. Por në planet e tij është mashtruar tmerrësisht. Në vend të të gjitha këtyre që priste, ai ka ndeshur në qëndresën e fortë, të fuqishme dhe të padëgjuar deri më sot, në qëndresën e Ushtrisë së Kuqe, në njësinë e popujve të Bashkimit Sovjetik, të cilët, të mbledhur rreth Partisë së tyre Bolshevike si një njeri, janë ngritur për t'i ndaluar dhe për t'i dërmuar përparimet e bishës së çmendur fashiste. Derisa hordhitë zaptuese hitleriane shfrytëzuan momentin e befasisë, deri atëhere shënuan disa fitime tokësore. Ato e kanë paguar shtrenjtë, duke e mbjellë me varrezat e ushtarëve të tyre më të mirë, çdo pëllëmbë tokë sovjetike, përkohësisht të lënë nga Ushtria e Kuqe. Hordhitë e tërbuara hitleriane në marrëzinë e tyre të çmendur, kanë bërë egërsi të padëgjua në pjesën e zaptuar të tokës sovjetike. Ato kanë vrarë në masë fëmijë të pafajshëm, gra dhe pleq të pafuqishëm, kanë rrëzuar monumente kulturele duke shkatërruar çdo gjë sovjetike. Mbi ata bie përgjegjësia e rëndë për këto egërsi dhe kjo periudhë kohe do të vulozet patjetër me hakmarrjen dhe mallkimin e të gjithë popujve të qytetëruar.

POPULL SHQIPTAR, PUNËTORË, FSHATARË, QYTETARË!

Kanë kaluar tre muaj, që ka filluar ofensiva e madhe sovjetike, që kur hordhitë zaptuese hitleriane po marrin grusht pas grushti, duke pësuar humbje të rënda që po u jep Ushtria e Kuqe ngadhënjimtare në të gjitha frontet. Ajo vazhdimisht dhe sistematikisht po e godet duke e dhjetuar, duke e demoralizuar ushtrinë gjermane dhe duke përgatitur vdekjen e sigurtë të fashizmit. Për të ringjallur moralin e ushtrisë së vet Hitleri ka marrë në duart e tija të përgjakshme komandën, por ju e keni parë në realitet se ç'dobi i ka sjellë. Ushtria e Kuqe ka çliruar një pjesë të madhe toke sovjetike, ka marrë rishitas shumë fshatra e qytete, ka shpartalluar edhe zënë rob shumë armata të Hitlerit. Me fuqi më të fortë, me hov më të madh dhe siguri në fitore Ushtria e Kuqe është vërsulur për ta përzënë zaptuesin prej tokës së vet dhe për ta zhdukur nga faqja e dheut fashizmin.

Popujt e Bashkimit Sovjetik japin atë që kanë më të çmueshme, jetën e tyre për shpëtimin e vendit të vet, për shpëtimin e të

gjithë njerëzimit nga kobi fashist. Miliona bij e bija të tokës së madhe të Bashkimit Sovjetik në Ushtrinë e Kuqe, në njësitë partizane, në front, para dhe prapa frontit po tregojnë heroizëm deri sot të padëgjuar dhe po bëjnë thërrori të mëdha. Në këtë luftë titanike sytë e të gjithë popujve të robëruar janë drejtuar nga Bashkimi Sovjetik, gjithashtu simpatitë e të gjithë njerëzimit të kulturuar janë në anën e Bashkimit Sovjetik, sepse e dinë që lufton për një çështje të drejtë, për lirinë e vet, për lirinë e popujve të robëruar dhe të njerëzimit të munduar. Ushtria e Kuqe vazhdon asgjësimin e hordhive fashiste me një varg fitoresh të përditshme, me shpejtësi dhe forcë të rrufeshme. Shpejt fashizmi do të ketë dënimin e merituar për varrezat e mbjella nëpër botë. Në këtë luftë titanike Bashkimin Sovjetik e ndihmojnë dy fuqi të mëdha botërore, Anglia dhe Amerika, të cilat janë lidhur me Bashkimin Sovjetik për të shpëtuar njerëzimin nga murtaja fashiste hitleriane.

Hitleri bashkë me shërbëtorin dhe xhandarin e tij, Musolinin dhe qeveritë marioneta të vendeve të robëruara ka ndërmend të bëjë mobilizimin e fuqive të reja. Ai ka ndërmend t'i plotësojë radhët e ushtarëve të vvarë në front, ai don që të çojë me forcë në kasaphanë brezat e rinj të popujve të robëruar, do mish të ri për ushqim topash pasi po përgatit ofensivën e pranverës. E gjithë diplomacia fashiste është vënë në shërbim dhe ka vrapuar nëpër Evropën e robëruar, për t'i gjetur Hitlerit viktima të reja. Po për këtë gjë Mustafa Kruja ka shkuar deri në Romë. Ai ka pranuar për hesap të Musolinit gjakatar dhe të zotërisë së këtij, Hitlerit, të mbledhë nëpër vendin tonë të munduar vëllezërit tanë për t'i veshur me uniforma ushtarake, për t'i vënë të shuajnë lëvizjet nacional-çlirimtare të vendeve fqinje, për t'i tretur larg atdheut të tyre, në vende prej nga mund të mos kthehen më kurrë. Mustafa Kruja do ta paguajë me gjakun tuaj atë që ka shpenzuar nëpër Itali. Ai përgatiti ushtrinë, milicinë, merr policë të rinj, që të forcojë pozitën e fashizmit. Mustafa Kruja dhe klika e tij tradhëtare, për të na rrejtur më lehtë paraqiten si qeveri kombëtare. Por populli shqiptar nuk i ka mbyllur sytë edhe e ka treguar me demonstrata, me protesta, me dezertime nga ushtria se i di qëllimet e Mustafa Krujës dhe të klikës së tij tradhëtare. Ky bir bastard i popullit shqiptar i premtoi vendit ditë edhe më të këqia e me të vërtetë racionimet e bukës, të vajit, të vajgurit e të të gjitha sendeve ushqimore e pakësojnë çdo ditë më tepër ushqimin e popullit, ndërsa çmimet, taksat e haraçet po shtohen në mënyrë të papërballueshme. Bijtë e ndërgjegjshëm të popullit shqiptar nuk duan dhe nuk guxojnë të vihen në shërbim të zaptuesit dhe të bastardit tradhëtar Mustafa Kruja, po kanë për t'u bashkuar me Luftën e shenjtë nacional-çlirimtare, nuk lejojnë që zaptuesi të bëjë me ta bandat vëllavrasëse, që

zaptuesi të na mbytë me duart tona e që t'i shërbejnë zaptuesit për të shuar Luftën nacional-çlirimtare. Mustafa Kruja i është betuar Musolinit se do të luftojë bashkë me klikën e tij fashiste tradhëtare kundër çdo gjëje përparimdashëse në botë dhe kundër lëvizjes së popullit të vet. Ai është betuar se do të luftojë kundër Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës, kundër çetave partizane dhe popujve fqinjë. Në emër të kujt flet ai në këtë mënyrë? Mund të flasë në emër të kujtdo tjetër, por kurrë në emër të popullit shqiptar, ai gjaksor e tradhëtar i popullit shqiptar. Populli e di mirë se kush është armiku i tij i vërtetë. Ai e sheh qartas se e kanë mërzhitur robëria dhe zgjedha fashiste, se e shtrëngojnë në grykë duart e përgjakshme të tradhëtarit e të spiunit. Të tmerrshme janë vuajtjet dhe mjerimet e popullit në këto tre vjet robërie, shkatërrimesh, plaçkitjesh dhe djegiesh të popullit paqedashës...

Zaptuesi përmes agjentëve të tij don të sigurojë edhe më rezervë dhe të na e ndyjë emrin tonë duke dërguar me forcë bijtë tanë në luftë kundër popujve fqinjë.

#### POPULL SHQIPTAR!

Fashizmi i ndyrë, armiku i betuar i njerëzimit dhe i popullit tonë, sulmoi në befasi vendin tonë, thundra e tij e ndyrë lehtas i shkeli tokat tona të bukura në saje të zotërinjve tanë tradhëtarë, të cilët e kishin përgatitur sistematikisht këtë moment të zi të popullit tonë. U gjetëm krejtësisht të vetmuar, të tradhëtuar dhe të përçarë dhe armiku përfitoi për të na zaptuar shpejt.

Në pak ditë e humbëm pavarësinë tonë dhe zinxhirët e tmerrshëm të robërisë rënduan mbi ne. Plot tre vjet që armiku gjakatar na shtyp, na poshtëron, na grabit, na vret, na var, na shkretoi shtëpitë, na veshi në zi mëmat dhe motrat tona, na prishi zakonet e bukura, na çenoi nderin tonë.

Tokat tona janë bërë fushë lufte; fshatrat dhe qytetet tona janë bombarduar dhe djegur egërsisht prej fashizmit; në të katër anët e atdheut na janë vvarë djemtë e fëmijët tanë prej zaptuesit gjakatar.

Populli shqiptar krejt i plaçkitur prej hajdutëve me këmishë të zeze është i detyruar të vdesë urie, prej skamjes, prej papunësisë.

Zaptuesi i ndyrë s'kënaqet me kaq, ai ka ndërmend të na ndyjë emrin tonë të papërlyer, duke na hedhur në luftë për interesat e tij të poshtra e grabitëse, të na hedhë në luftë kundër fqinjëve tanë që luftojnë si dragonj për lirinë e tyre, të na hedhë në luftë kundër popullit tonë.

Zaptuesi fashist me anë të agjentëve të tij kërkon ta thyejë luftën tënde për çlirimin kombëtar. Ai po orvatet të hedhë gë-



njeshtra të ndryshme në radhët tuaja, që kështu të krijojë turbullira duke përhapur gënjeshtren se vendin tonë e kërcënon rreziku prej popujve fqinjë të robëruar, të cilët luftojnë për lirinë e tyre, dhe që janë nën skllavërinë e po atij armiku që shtyp dhe vendin tonë. Popull shqiptar, ora e çlirimit tënd tashmë ka tingëlluar. Të gjithë ata që thonë se kjo orë nuk ka ardhur dhe se «duhet pritur» duan të përfitojnë personalisht në kurriz të lirisë së popullit shqiptar, dëshirojnë të na mbajnë edhe nën robëri që në këtë mënyrë ta humbim të ardhshmen e popullit tonë. Ti e di se armiku është i demoralizuar, që armiku humb pozitë pas pozite prej grushteve të Ushtrisë së Kuqe, pëson humbje të mëdha prej goditjeve të rënda të popujve të robëruar. Në vendet fqinje, Jugosllavi e Greqi, çetat kreshnike partizane i japin grushte të forta armikut. Një ushtri kaq e demoralizuar si ajo e fashizmit italo-gjerman nuk mundet të luftojë kundër njësisë së luftës nacional-çlirimtare të popujve liridashës. Armiku fashist nuk është mposhtur krejtësisht, por është në shkatërrim e sipër. Të kishin mejtuar gjyshërit tanë ashtu siç mejtojnë ata njerëz të degjeneruar të popullit shqiptar, që thonë se s'duhet të luftojmë për çlirimin tonë, kurrë nuk do të kishin mundur të ruanin emrin dhe nderin tonë. Kushdo që merr pjesë në ushtrinë tradhëtare kundërrevolucionare që po përgatit Mustafa Kruja, do të quhet nesër tradhëtar dhe do të jetë përgjegjës para gjyqit të popullit. Prandaj mos merrni pjesë në aventurën e Mustafa Krujës. Të gjithë ju që e keni për zemër luftën çlirimtare, të gjithë ju që e doni lirinë tuaj e të popullit shqiptar të shumëvujtur, punëtorë, katundarë, intelektualë të ndershëm, ushtarë, xhandarë, nënoficerë dhe oficerë, popull shqiptar, paraqituni dhe formoni komandën e ushtrisë çlirimtare nacional-revolucionare, ku është vendi juaj i vërtetë dhe mos shkoni në ushtrinë tradhëtare, që po përgatit armiqët e Shqipërisë. Popull shqiptar, lufta jote për liri ka qenë shekullore e njihet nga historia. Popull shqiptar, ti ke mbajtur lart flamurin e lirisë e të pavarësisë që stërgjyshët e tu lavdiplotë e kanë dorëzuar brez pas brezi e dorë më dorë, duke luftuar gjithmonë për lirinë e atdheut të vet, ata nuk e kanë lënë me asnjë kusht të përlyhet emri i shqiptarit. Prandaj të mos e përlyejmë as ne, por të ndjekim rrugën lavdiplotë të stërgjyshëve tanë.

Në këtë ditë duhet të përbetohemi se do të luftojmë deri në spastrimin e fashizmit dhe se urrejtja jonë do të dërmojë zaptuesin e ndyrë dhe hyzmeqarët e tij, tradhëtarët e popullit tonë.

#### NACIONALISTË!

Mos lini të mashtroheni me gënjeshtër të ndryshme nga armiqët e popullit shqiptar! Vendi juaj i vërtetë është në radhët e

Luftës nacional-çlirimtare. Askush nuk do ta çlirojë vendin tonë veç luftës së vetë popullit shqiptar. Para historisë së popullit shqiptar një pjesë e madhe e përgjegjësisë ju bie dhe juve. Populli shqiptar pret prej jush që ta ndihmoni në Luftën nacional-çlirimtare. Për këtë shkak mos u largoni prej popullit, mos lini të mashtroheni nga gënjeshtër të ndryshme që përhapen nga Mustafa Kruja dhe agjentët e tij se goja liria dhe pavarësia e vendit tonë do të garantohen prej forcave fashiste gjermane. Prandaj shikoni se ku qëndrojnë forcat e vërteta kombëtare. Shikoni se si fashizmi gjerman është vënë poshtë, në frontin rus, prej Ushtrisë së Kuqe të fuqishme, e cila po shkatërron një mbas një vijat mbrojtëse gjermane. Garancia për kufitë e Shqipërisë nuk është tek gjakpirësit fashistë. Ku do të mundë zaptuesi të japë garanci për vendin tonë nesër, kur ai vetë të jetë i thyer dhe ta ketë humbur luftën? Garancia për kufitë e Shqipërisë është lufta jonë e lidhur me atë të Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës, me luftën e popujve vëllezër fqinjë dhe popujve të tjerë të robëruar që luftojnë heroikisht për lirinë e tyre. Vendi ynë do të mbetet i pavarur dhe i pandarë. Së bashku me mbarë popullin shqiptar ne duhet të luftojmë për lirinë dhe pavarësinë e tij. Prandaj mos shkoni dhe mos bini në pozita të gabuara e mos u besoni gënjeshtërve të disa individëve të paditur në politikë dhe përfitues. Mos bini në pozitat e atyre që spekullojnë emrin nacionalist. Të gjithë ata që nuk shkojnë në Luftën nacional-çlirimtare nuk janë nacionalistë dhe njerëz që dëshirojnë të mirën e popullit të vet. Të gjithë ju, patriotë të ndershëm, që e keni në zemër lirinë e popullit shqiptar, bashkohuni me ne dhe shkruhni në Frontin e vetëm Nacional-Çlirimtar, në luftën antifashiste!

#### F SHATARË!

Ju që jeni pjesa mbi kurriz të së cilës bie pesha më e rëndë e shfrytëzimit fashist, ju që e shihni djersën tuaj të ndërruar në pasuri të zaptuesit fashist dhe në mjete luftarake, që e shtojnë edhe më fort shfrytëzimin e skllavërimit tuaj, ju që frutin e mundimit tuaj e shihni të grabitur nga goja e fëmijëve tuaj për të mbajtur peshkaqenët e fashizmit, ju që tokën e brumosur me djersën e krahëve tuaj e shihni të shkelur nga çizmja e barbarisë fashiste, ju e shihni se si zaptuesi po e shfrytëzon vendin, po ju lë pa bukë, pa kripë, pa vajguri e pa atë që prodhon toka juaj. Ju që qysh tash hijsa e urisë ju kërcënon për vdekje, mos rri në heshtje, por merrni shembull prej fshatarëve sovjetikë dhe prej atyre të vendeve të robëruara! Kudo që të jeni mos e jepni bereqetin, vajin, bulmetin, frutin e punës suaj për gjakso-

rët fashistë që shkojnë të vrasin vëllezërit tuaj të vendeve të tjera! Bashkohuni me Luftën e hapët nacional-çlirimtare! Bëhuni strehë ndër fshatra e ndër malësi të çetave partizane që do të luftojnë për të drejtat tuaja, për lirinë e tokës suaj! Formoni këshillat fshatare për Luftën nacional-çlirimtare! Shkrihuni në njësi luftarake me punëtorët, të cilët janë kurdoherë në ballë të luftës kundër shtypjeve, mjerimeve dhe skllavërimeve!

#### PUNËTORE E PUNËTORE!

Punëtorët e punëtoret sovjetike përsëri po japin therori të përgjakshme e të rënda në luftën kundër armikut më të egër të klasës punëtore, fashizmit. Ju punëtorë dhe punëtoret të Shqipërisë duhet të zini vendin e parë në radhët e para luftarake, në luftën e sotme të shenjtë të popullit tonë për çlirimin kombëtar. Me këtë pjesëmarrje kryeni detyrën kundrejt popullit tuaj dhe kundrejt Bashkimit Sovjetik. Partia Komuniste, Partia juaj, ju thërret ju në luftë kundër zaptuesit dhe hyzmeqarëve të tij! Ju mbajtësit e përparimit e dimi fare mirë se ç'ju ka prurë fashizmi dhe sa e rëndë është pesha e tij e keni ndjerë në kurvizin tuaj. Mos lejoni që me ndimën tuaj të përfitojë armiku! Sabotoni çdo prodhim e çdo punë që i shërben zaptuesit! Shkatërroni të gjitha maqinat, depot e municionit dhe magazinat ushtarake e çdo gjë që i shërben armikut! Betohuni për luftë të papajtueshme kundër armikut! Krijoni këshillat për këtë luftë! Organizoni çetat partizane, të cilat do të luftojnë për një të ardhshme më të mirë e më të lumtur të popullit shqiptar!

#### RINI SHQIPTARE!

Miliona shokë tuaj luftëtarë të rinj po luftojnë në botën mbarë për të shkatërruar armikun më të madh të brezit të ri, fashizmin. Ti që kurdoherë ke qenë në krye të luftës për përparimin dhe lirinë e atdheut, ti që vazhdon me kryelartësi të mbash të ndezur zjarrin e atdhedashurisë, ti që je e ardhshmja e këtij kombi, ti që sheh para vetes të ardhshmen tënde të errët e të kërcënuar, ti nuk mund ta durosh zgjedhën poshtëruese në të cilën na ka hedhur zaptuesi, ti nuk mund ta durosh një skllavëri të tillë. Ti ke dhënë dhe po jep therori në këtë luftë. Forco dhe shtrëngo radhët e tua, vihu nën flamurin e Luftës së shenjtë nacional-çlirimtare! Duke dedikuar të gjithë heroizmin e zemrës tënde fisnike, formo frontin e pathyeshëm të brezit të ri në luftë kundër zaptuesit! Puno pa pushim që brezi i ri i qytetit dhe i fshatit, rinia punëtore dhe ajo intelektuale të jetë e grumbulluar rreth atyre që duan të

marrin pjesë në luftën që do t'i sigurojë atdheut tonë lirinë dhe ty të drejtat jetësore dhe kulture! Jep gjithshka prej vetes tënde për të asgjësuar gjakpirësin më të madh të brezit të ri dhe të jesh luftëtare e papërkulshme kundër tij! Të jesh e denjë për të qenë krah për krah me rininë sovjetike, e cila sot shkruan me gjak faqe lavdiplote të historisë së rinisë të njerëzimit mbarë!

#### NËNA, MOTRA, GRA SHQIPTARE!

Zaptuesi fashist që ka veshur në të zi me qindra e qindra prej jush, po i çon vëllezërit, burrat, djemtë tuaj, dritën e syve tuaj në kasaphanat e luftës, që ka veshur në zi edhe sa e sa motra tuaja të vendeve që luftojnë për lirinë dhe bukën e tyre kundër fashizmit gjakatar. Mos i lini të dashurit tuaj të vriten për armikun fashist, i cili në luftërat e tija ka vrrarë gra, pleq e fëmijë, na ka shkatërruar vatrat, na ka çuar në skamjen më të zezë! Mos duroni që fytyra juaj të skuqet prej fyerjeve të zaptuesit fashist! Luftoni edhe ju krah për krah me burrat kundër zaptuesit të vendit tonë që ju ka përulur, kërkon t'ju shnderojë dhe po ju turpëron!

#### KOMUNISTË TË SHQIPËRISË!

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë ju thërret që të mobilizoheni dhe të kryeni detyrën karshi popullit. Ju thërret të punoni pa u lodhur dhe pa pushim, të lidheni me shtresat më të gjera popullore, për t'u shpjeguar dhe për t'u treguar nevojën e Luftës nacional-çlirimtare, ju thërret të jeni luftëtarë të pafrikshëm për të drejtat e popullit. Me vetëmohimin tuaj jepni shembullin të tjerëve. Merrni shembull nga Partia Bolshevike e të jeni me të vërtetë në ballë të luftës popullore çlirimtare duke mos kursyer as jetën! Në këtë mënyrë keni për të qenë në vendet më të rënda dhe më të rrezikshme. Shokë komunistë, Partia juaj ju thërret që të depërtoni, të mobilizoni, të lajmëroni të gjithë ata që janë të ndershëm dhe që duan të derdhin gjak për lirinë! Shokë komunistë, ngrini lart flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe betohuni që do ta mbani lart dhe me nder këtë flamur në këtë luftë që shtrihet para nesh, për zhdukjen e armikut më të madh të njerëzimit, fashizmit!

Rroftë Lufta nacional-çlirimtare kundër zaptuesit të urreyer fashist!

Rroftë bashkimi i popullit shqiptar në luftën kundër zaptuesit!

Rroftë Shqipëria e lirë dhe e pavarur!

Rroftë vëllazërimi i popujve ballkanikë!

Rroftë fronti i përbotshëm i popujve liridashës të të gjithë njerëzimit përparimtar kundër barbarëve fashistë!

Rroftë Bashkimi Sovjetik, ndërtuesi i socializmit dhe mbartës i përparimit dhe i kulturës, vendi i begatisë dhe i vëllazërimit në mes të njerëzve dhe popujve!

Rroftë Partia Komuniste Bolshevike e Leninit dhe e Stalinit, udhëheqësja dhe organizatorja e fitoreve të Bashkimit Sovjetik!

Rroftë Ushtria e Kuqe, garanci e fitores së popujve mbi zaptuesit fashistë!

Rroftë Partia Komuniste e Shqipërisë!

Rroftë Stalini, udhëheqës i popujve të URSS-it dhe mësues e udhëheqës i madh i popujve të robëruar dhe i turmave të shfrytëzuara të gjithë botës!

**PËRPARA NË FRONT KUNDËR ZAPTUESIT FASHIST PËR LIRINË DHE TË ARDHSHMEN MË TË MIRË TË POPULLIT!**

**KOMITETI QENDROR  
I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË**

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**DIREKTIVA TË KQ TË PKSH NË LIDHJE ME KRIJIMIN E  
FRONTIT NACIONAL-ÇLIRIMTAR, KRIJIMIN E KËSHILLAVE  
NACIONAL-ÇLIRIMTARE, ORGANIZIMIN E GUERRILEVE  
DHE TË ÇETAVE PARTIZANE, FORCIMIN E PUNËS  
ORGANIZATIVE TË PARTISË**

[Qershor 1942]

Të dashur shokë,

Duke marrë parasysh situatën politike në të cilën ndodhemi, Komiteti Qendror po u dërgon gjithë qarkorëve e përgjegjësve të celulave, të cilët t'ua njoftojnë anëtarëve të celulave, direktivat e poshtëshënuara, që duhet të zbatohen përpikërisht prej të gjitha organizatave të Partisë.

Përpara organizatave tona të Partisë paraqiten këto detyra në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve politike si në Shqipëri, në Ballkan ashtu edhe në krejt botën. Këto detyra përcaktohen nga faktet që vijojnë:

1) Ndodhemi përpara ndërrimit të marrëdhënieve ndërkom-bëtare politike. Me fitoret e Armatës së Kuqe në frontin lindor krejt bota sheh qartas se katastrofa ushtarake dhe politike e Hitlerit është e pashmangshme dhe e afërme.

Në lidhje me këtë kanë filluar dhe ndërrimet në marrëdhë-niet ndërkombëtare politike, të cilat pasqyrohen dhe në vendin tonë.

2) Nga shkakut e terrorit të okupatorit kemi humbur mjaft aktivistë. Partia jonë është e re, kuadrot tanë të rinj dhe mungesa e eksperiencës ndihet në lidhjet e dobëta me turmat. Në shumë vende Partia jonë nuk ka hyrë fare sidomos nga pikëpamja orga-nizative dhe për këtë arsye ajo s'ka mundur të mobilizojë tur-mat dhe t'i çojë në luftë kundër okupatorit fashist. Për arsye të lidhjeve tona të dobëta me masat fashizmi zaptues ka mundur të mobilizojë një pjesë në milici, ushtri e polici.

Në lidhje me këtë gjendje politike dhe me gjendjen e brend-shme të Partisë sonë paraqiten detyrat që vijojnë:



1) Të luftojmë me këmbëngulje për krijimin e Frontit të përbashkët Nacional-Çlirimtar. Paralelisht me një veprim të tillë politik duhet të krijohen patjetër njësitet guerrile. Nga kjo luftë do të dalin çetat partizane.

2) Duhet të formojmë këshillat nacional-çlirimtare, të cilat duhet të jenë lidhjet e Partisë sonë me masat.

Këto këshilla duhet të formohen si në vendet e çliruara ashtu edhe në ato të paçliruara. Në këto këshilla duhet të ndodhen përfaqësuesit luftarakë të të gjitha rrymave politike në popull, të cilët janë për luftën vendimtare kundër okupatorit e veçanërisht punëtorët e bujqit e vobektë. Nëpër viset e çliruara këto këshilla duhet të jenë edhe organe për furnizimin material të njërive partizane. Me anën e këtyre organeve i tërë populli mobilizohet në kryengritjen e përgjithshme nacional-çlirimtare.

3) Kundër të gjitha metodave fashiste, komunistët t'u paraqiten masave të popullit për një *qeverim të vërtetë demokratik-popullor*, i cili do t'i sigurojë popullit shqiptar të tëra të drejtat demokratike.

4) Në vendin tonë duhet të zhvillojmë luftën ekonomike të masave, kundër mungesës së gjërave ushqimore, kundër spekulimit etj. Kjo gjë duhet të bëhet një nga format më të rëndësishme për hyrjen e masave në luftë.

5) Duhet të popullarizohet haptazi dhe si duhet *Bashkimi Sovjetik, sukseset e Armatës së Kuqe dhe lufta partizane kudo në botë*.

6) Sot duhet t'i japim një rëndësi të veçantë luftës në formë guerrile; kjo luftë bëhet prej njërive të organizuara prej Partisë, për të luftuar okupatorin.

a) Këto njësi përbëhen prej 5-8 ose 10 apo më shumë personash të vendosur për të bërë një aksion dhe që janë të vendosur t'i bëjnë luftë pa pushim okupatorit.

b) Këta rekrutohen në masat e gjera të popullit antifashist dhe në masat e gjera të rinisë, këta duhet të kenë një udhëheqës, shok të Partisë i cili i ka organizuar dhe të cilin këta duhet ta njohin si një komunist të mirë e si një udhëheqës të besuar.

Njësitë guerril mund të udhëhiqet [edhe] prej një luftëtari të bindur në Parti dhe në Luftën nacional-çlirimtare, prej një fshatari, një punëtori ose një intelektual të ndershëm, i cili akoma nuk është anëtar i Partisë, por jep një garanci të shëndoshë.

c) Çështjen e guerrileve shokët mos ta kuptojnë cekët, por atje ku ka mundësi të formohen çeta partizane, duhet që të formohen e mos të pritet të kalohet prej guerriles në çetë partizane d.m.th. të mos presim direktivë tjetër për formimin e çetës.

d) Sa herë që vepron guerrilja duhet të ketë shenjën e saj «flamurin e Shqipërisë me një yll të kuq mbi të».

e) Bazat e guerrileve duhet të vendosen në vende të afër-

me, ku jetojnë anëtarët e njësitit, në këtë bazë guerrilja vendos mjetet e punës e të mjekimit.

f) Njësitë guerril duhet të jetë i pajisur mirë me mjete luftimi, të cilat duhet të mundohet t'i gjejë vetë e në rast se ndonjë anëtar nuk mundet t'i gjejë ose t'i blejë atëhere interesohet Partia.

Veprimet e guerrileve duhet të jenë të vazhdueshme, duhet të dëgjim depot e armikut, duhet të sulmohen qendrat e milicisë, të karabinierisë, të Sim-it<sup>1</sup>, kazermat, mbledhje trupash, kolona në ecje, radiostacionet, telefonat, të vriten pa mëshirë oficerë, karabinierë italianë, grumbuj ushtarësh dhe gjithë agjentët e kolonës së pestë dhe sidomos spiunët e milicët.

7) Duhet që në çdo çetë partizane të formohen celulat; celulat duhet të jenë foleja e njerëzve më të mirë e më trima në çetë.

8) Njësitë partizan duhet të zhvillojë veprimtari politike dhe kulturalo-arësimore. Duhet që të gjithë luftëtarët e mirë dhe të ndershëm t'i shtiem në Parti dhe t'i edukojmë politikisht. Të tërë frikakët dhe të pabindurit përjashtohen pa mëshirë nga Partia.

9) Njësitë partizane duhet të zhvillojnë agjitacion dhe propagandë ndër masat punëtore dhe fshatare. Kudo që kalon njësitë partizan duhet të lërë gjurma politike dhe gjurma organizative.

10) Duhet me çdo mënyrë të forcohet veprimtaria organizative e Partisë sonë. Regjimi i zaptuesit dita-ditës do të jetë më i dobët, ndërsa lëvizja partizane do të jetë gjithnjë më e fortë. Gjerësia e kësaj lëvizjeje varet sidomos prej veprimtarisë së përgjithshme të punës sonë në masë. Komitetet lokale të Partisë, duhet të ndodhen në vendet e tyre. Në qoftë se u duhet të lëshojnë «terrenin», duhet patjetër të gjejnë zëvendësit e përshtatshëm, kuadrot të përpiqemi t'i zgjedhim në radhët e elementëve që kanë dalë më të aftë në luftëra.

Duhet me çdo mënyrë të forcohet veprimtaria e Partisë në masa, veçanërisht agjitacioni e propaganda. Të vazhdohet të forcohet e të përhapet sa më tepër puna në botimin e proklamave dhe të komunikatave të përditshme.

Të lartësohen e të edukohen kuadrot e rinj, sepse armiku në këtë pikëpamje na ka sjellë dëme të mëdha.

Rregullisht duhet të ngarkohen aktivistët në punë të ndryshme, secili shok duhet të shkojë në terrenin që i cakton Partia dhe të ndihmohet në punën e tij. Duhet një rreptësi e veçantë përse u përket detyrave dhe përgjegjësisë që marrin shokët. Partia do «rezultate» e jo shpjegime e fjalë.

11) Duhet të popullarizohet Partia jonë nëpër masa duke i

1 Sim-i (Servizio Informativo Militare) — Shërbimi informativ ushtarak i Italisë fashiste.

shpjeguar masës qëndrimin e Partisë në çdo çast dhe për çdo çështje. T'i mobilizojmë masat për realizimin e vijës së Partisë.

12) Duhet një kujdes i veçantë për punën e rinisë. Komitetet lokale janë të detyruara të ndihmojnë komitetet e rinisë për zbatimin e detyrave të tyre. Kjo ndihmë nuk duhet të bëhet shkak për të penguar iniciativën e të rinjve. *Duhet të ruhem i prejt qëndrimin sektar në punën e rinisë.*

13) Një rëndësi e veçantë duhet t'i jepet punës ndër gra. Në luftën guerrile, në luftën me çetat partizane, gratë do të jenë ndihmëse aktive, veçanërisht për ndihmë sanitare dhe mbledhje ndihmesh. Për një punë të tillë gratë duhet të jenë organizuar dhe të jenë mobilizuar.

\*  
\*  
\*

Këto detyra janë pa dyshim të vështira, por Partia jonë dhe organizatat e saja mund dhe duhet patjetër t'i zbatojnë. Prej shpejtësisë, prej elasticitetit, vendosjes dhe iniciativës, në zbatimin e këtyre detyrave varet dhe sukcesi i luftës sonë në etapën që hapet përpara nesh.

Të fala shoqërore  
P K SH

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## KONFERENCA E JASHTËZAKONSHME E PKSH

Qershor 1942

Konferenca e Jashtëzakonshme e PKSH u mbajt më 28 e 29 qershor 1942 në Tiranë. Në të muarën pjesë anëtarë të Komitetit Qendror, anëtarë të komitetit qarkor dhe komunistë të Tiranës. Ishin ftuar edhe fraksionistët Anastas Lula dhe Sadik Premte.

Konferenca u mblodh kryesisht për të marrë në shqyrtim punën anti-parti, fraksioniste dhe armiqësore të Anastas Lulës dhe Sadik Premtes ish-krerët e grupit të «Të Rinjve» si dhe të një numri elementësh të tjerë të këtij grupi. Konferenca dënoi rëndë punën e tyre dhe vendosi njëzëri përjashtimin nga Partia të Anastas Lulës, Sadik Premtes dhe të 8 shokëve të tyre, fraksionistë, ndërsa agjenti provokator i fashizmit Ludovik Nikaj u dënua me vdekje.

Menjëherë pas konferencës u mblodh më vete Komiteti Qendror, i cili përgatiti një rezolucion, në bazë të vendimeve të konferencës si dhe një qarkore për organizatat e Partisë. Rezolucioni është asgjësuar dhe nuk gjendet, ndërsa qarkorja është botuar në këtë vëllim.

Në këtë qarkore KQ vinte në dijeni gjithë Partinë për punimet e Konferencës së Jashtëzakonshme dhe mbi masat që u muarën kundrejt drejtuesve kryesorë të rrymës fraksioniste likuidatore. Njëkohësisht porosite-shin komitetet qarkore që të merrnin masa përjashtimi për të gjithë fraksionistët veprues nëpër qarqe.

Vendimi i Konferencës së Jashtëzakonshme të Partisë pati një rëndësi shumë të madhe për ruajtjen e unitetit dhe për forcimin e Partisë sonë.

**QARKORE E KQ TË PKSH ME RASTIN E DËNIMIT TË PUNËS  
ARMIQËSORE TË GRUPIT TË ANASTAS LULËS E SADIK  
PREMTES NË KONFERENCËN E JASHTËZAKONSHME  
TË PARTISË**

[Korrik 1942]

**Q A R K O R E**

Në Konferencën e Jashtëzakonshme të organizuar prej Partisë, muarën pjesë: delegati i Komitetit Qendror, disa nga krerët e vjetër të grupeve dhe disa shokë.

Pasi u përkujtuan shokët tanë Qemal Stafa, Nikolla Tupe, Hamdi Mëzezi, Ferit Xhajku, Perlat Rexhepi, Branko Kadia, Noka dhe Jordan Misja, të rënë si heronj në sheshin e luftës kundër okupatorit dhe kolonës së pestë, pasi u kujtua me admirim qëndrimi i shokëve dhe i miqve tanë që po dergjen sot nëpër burgjet e errëta të fashizmit barbar, që po tretien nëpër fushat e përqëndrimit jashtë Shqipërisë, nëpër ishujt e shkretët të Italisë fashiste, pasi u dënuan pa mëshirë të gjithë tradhëtarët, të gjithë spiunët, të gjithë agjentët e verbër të fashizmit, mbledhja arriti në këto përfundime:

Më 22 qershor 1941 Hitleri me ushtrinë e tij të tërbuar shkeli paktin dhe kufitë e Bashkimit Sovjetik. [Me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftë] fillon një epokë e re për gjithë botën, për gjithë popujt e botës. Lufta e dytë imperialiste mori një karakter tjetër: u transformua në një luftë të drejtë nga njëra anë.

Në njërën anë shikojmë fuqitë e hitlerizmit gjakatar që hodhi në tym e flakë pothuajse të gjithë Evropën, që shkeli me çizmen e tij afro 200 milion njerëz. Hitleri me këlyshët e tij, pasi skllavëroi gjithë popujt e kontinentit evropjan, u lëshua kundër URSS-it, atdheut fatlum, të punëtorëve dhe të fshatarëve.

Nga ana tjetër gjejmë forcat e gjalla të popujve sovjetikë që luftojnë për të mbrojtur tokat e tyre, qytetet, katundet dhe fushat që i kanë stolitur me punën dhe me djersën e tyre, gjejmë një shtet të një tipi të ri, një shtet socialist sovjetik, ku gjithë racat e popujt rrojnë në harmoni të plotë në bazë të punës, të

së drejtës e të lirisë që u garanton Kushtetuta Staliniane, gjejmë në Bashkimin Sovjetik qytetarin e rritur në shtetin e ri, i cili di se ç'mbron e pse duhet të luftojë; të luftojë jo vetëm për mbrojtjen e vendit të tij, por sidomos për t'i bërë varrin një herë e mirë hitlerizmit gjakatar. Në këtë luftë Bashkimi Sovjetik nuk është vetëm, por ka me vete të gjithë popujt e shtypur që po përpigën e po luftojnë kundër okupatorit fashist. Bashkimi Sovjetik ka me vete edhe demokracitë e mëdha: Ingliterën dhe Amerikën. Qëndrimi i qeverisë sovjetike, qëndrimi i Ushtrisë së Kuqe, qëndrimi i ekonomisë socialiste, qëndrimi dhe morali i popujve të URSS-it hapi sytë e të verbërve dhe veshët e të shurdhërve; gjithë botës ju mbush mendja se i vetmi popull që i qëndroi dhe po e ngordh hitlerizmin është Bashkimi Sovjetik. Sot ju mbush mendja se vetëm një luftë e vendosur antifashiste mund ta çlirojë botën nga kërcënimi dhe rreziku fashist.

Demokracitë e mëdha anglo-amerikane dhe të gjithë popujt e shtypur e kuptuan fare mirë këtë gjendje.

Kjo është arsyeja kryesore e formimit të frontit antifashist të 28 shteteve. Traktati i Londrës<sup>1</sup>, që siguron paqen 20 vjet pas rënies së fashizmit, siguron mosndërhyrjen në punët e popujve të tjerë, siguron paqen kolektive, është garancia për lirinë dhe independencën e popujve. Bashkimi Sovjetik, kampion i paqes kolektive që «në tribunën e Gjenevës» me Litvinovin<sup>2</sup>, ngriti zërin për lirinë e popujve (Kinë, Spanjë, Çekoslovakia, Shqipëri etj.) sot me heroizmin e bijve të vet, me gjakun e djemve të tij e vulosi vendimin e vdekjes së fashizmit dhe të lirisë së popujve.

Armiku është akoma i fortë, ka mbledhur gjithë rezervat e fundit, ka mobilizuar gjithë kolonën e pestë, e cila e lidhi fatin e saj me të, por është i plagosur rëndë dhe kur plagoset sigurisht do të përpiqet tamam si derri i egër kur plagoset, por fundin e ka të afërm dhe shkon patjetër drejt varrit. Përpjekjet e pareshtura, lufta partizane dhe rritja pa pushim e ndërgjegjes revolucionare të popujve të shtypur kanë shpërthyer si një vullkan në Evropën e robëruar. Fronti i dytë në Evropë është një nga pikat

1 Traktati i Londrës ose Pakti i Londrës u nënshkrua më 26 maj 1942 midis Bashkimit Sovjetik dhe Britanisë së Madhe për aleancë në luftë kundër Gjermanisë hitleriane dhe satelitëve të saj në Evropë si dhe mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke pas luftës.

2 Litvinov M. M. — (1876-1951) diplomat i njohur sovjetik. Që nga 1930 gjer më 1939 ka qenë komisar i popullit për punët e jashtme të BRSS.

Tribuna e Gjenevës — Lidhja e Kombeve, organizatë ndërkombëtare që ka ekzistuar midis Luftës së parë dhe Luftës së dytë botërore. Anëtare e Lidhjes së Kombeve ka qenë dhe Shqipëria. Bashkimi Sovjetik hyri në Lidhjen e Kombeve më 1934. Që nga tribuna e Lidhjes së Kombeve përfaqësuesit sovjetikë kanë mbrojtur me vendosmëri çështjen e paqes dhe të sigurimit kolektiv.



kryesore të traktatit anglo-sovjetik dhe ky front do të jetë një nga grushtet e fundit kundër fashizmit.

Sot Bashkimi Sovjetik është lidhja e vërtetë e gjithë forcave kundër fashizmit. Kjo lidhje bëhet kundër Hitlerit, i cili është koka e reaksionit dhe e fashizmit në botë.

Japonia u përhap aq shumë në botën e Paqësorit e në Kinë, sa sot po i ndjen grushtet e Kinës popullore, që po lufton që prej 5 vjetësh për lirinë e vet. Japonia, sot është e pazonja t'i mbrojtë të gjitha vendet e zaptuara.

Vendi ynë pati edhe ai fatin e zi të robërohej prej hordhive me këmisha të zeza të Musolinit. Ushtritë fashiste e zaptuan vendin tonë për të shtënë në dorë pasuritë e tokës shqiptare dhe për ta pasur si urë për qëllimet e tyre të errëta, për skllavërimin e popujve të tjerë të Ballkanit dhe për të furnizuar me armë dhe me mish për top luftën gjakatare që po bën Hitleri në frontin sovjetik. Populli shqiptar okupatorin e priti me armë. Ai filloi dhe e shtoi dita-ditës rezistencën e tij kundër zaptuesit gjakpirës dhe veglave të tija, tradhëtarëve të popullit shqiptar. Populli shqiptar nga rezistenca pasive u hodh në rezistencën aktive, doli në rrugë të shfaqë pakënaqësitë me demonstrata, me greva, më vonë me sabotazhe dhe me zhdukjen e agjentëve të poshtër e të rrezikshëm, me organizimin e çetave për luftën çlirimtare popullore.

Fashizmi dhe agjenti i tij Mustafa Merlika për të ndaluar hovin revolucionar të popullit tonë, mobilizuan milicinë dhe policinë, pjesën më të poshtër të popullit shqiptar, që ta hedhin në luftën vëllavrasëse. Lufta që po i bën populli shqiptar okupatorit na ka kushtuar neve me dyzina shokësh të vranë e të plagosur, e gjaku më i kulluar ka rrjedhur nëpër rrugët e qyteteve e të katundeve. Me qindra shokë sot po dergjen nëpër burgje e nëpër fusha përqëndrimi. Ja bilanci i luftës së popullit tonë heroik në ballë të të cilit e kemi për mburrje të gjendemi ne komunistët. Ne komunistët kemi dashur dhe duam më tepër se kushdo bashkim të gjerë e të vërtetë kundër okupatorit, ne duam t'i dalim armikut përballë, porsì bletë e plotë, por duam punë, aktivitet, luftë e jo llafe. Ne kemi vendosur që «derri do plumb» e si të tillë do ta luftojmë me çdo mënyrë. Sot kemi çeta rrallë e tek, nesër do të mbushen malet tona me «vullnetarë të lirisë», me partizanë që do t'i japin armikut grushte të forta gjersa ta ngor-dhin fashizmin dhe t'i japin popullit liri.

\*  
\* \* \*

Në Konsultën e parë të Aktivit të Partisë, u mar vendim që të gjithë elementët e infektuar nga fryma e grupeve dhe të luejtshëm të bindeshin dhe të hiqnin dorë nga puna e vjetër dhe të

përqafojnë direktivat e Partisë, u diskutua dhe u vendos gjithashtu të bëhej konferenca e vendit, e cila do t'i jepte Partisë komitetin qendror definitiv dhe direktivat e përgjithshme, por një punë e tillë nuk mund të bëhej në rast se radhët e Partisë nuk ishin të spastruara nga elementët e sëmurë dhe të luejtshëm.

Punojmë në një kohë kur armiqtë nuk na lejojnë të bëjmë diskutime të gjata, jetojmë në një kohë kur zhvillimet historike nuk mund të maten me periudha dhjetëvjeçare ose me vjete as me muaj, por me ditë dhe me orë; kur në ndeshjen gjiganteske zgjidhet fati i një sistemi shoqëror, i cili ka për t'u shkatërruar nga kontradiktat e tija dhe një sistemi, i cili ka për t'u zhvilluar në luftën më gjigande që ka parë njerëzimi.

Sot çështjet zhvillohen më me shpejtësi e më me kurajë gjithkund në botë. Kjo gjë ngjet edhe tek ne. Çështjet zhvillohen e shkojnë nga përlëshja, e cila ka për t'u kthyer në një kryengritje popullore të përgjithshme, në luftën kundër okupatorit të përgjakshëm, i cili prej gjirit tonë ka zhdukur një numër të mirë shokësh e në këtë punë e ndihmojnë tradhëtarët e popullit shqiptar.

Që të mundim t'u përgjigjemi detyrave aq të vështira e të rënda që paraqiten përpara nesh, ne duhet medoemos të kemi një mendim e shikim të njëjtë si në punën politike ashtu dhe në vetë organizatë (në të gjitha partitë e tipit të ri Lenin-Stalin duhet të ekzistojë njësi, kështu pra edhe Partia jonë duhet të bazohet në këto themele, sepse njësi është e domosdoshme, është kondita kryesore për mbarëvajtjen e Partisë).

Për arsye se puna është vazhduar nga grupashët dhe se Partia është formuar prej grupesh, ka në Parti elementë të pabesueshëm në punë, qëndrojnë elementë të luejtshëm, deri elementë që mundohen të krijojnë fraksione etj. Ne duhet ta kemi Partinë të pastër prej të gjithë këtyre elementëve; në qoftë se do t'u përgjigjemi realisht detyrave tona duhet ta kemi Partinë të fortë, se sipas fjalëve të mësuesve të mëdhenj të proletariatit, partia forcohet me spastrim, gjë që do të thotë se Partinë duhet ta spastrojmë prej të gjithë elementëve armiq, pa marrë parasysh nën ç'lëkurë janë fshehur ose veshur. Gota është mbushur plot e po derdhet, nuk ka qenë e mundur të rrimë më në pozitën e bindjes, është bërë ç'ka qenë e mundur që të largohet ky moment i padëshiruar, ja s'po mundemi që t'i largohemi. . .

Megjithëse nga ana e Partisë u bënë të gjitha tentativat, për t'i bindur e për t'i ngritur këta shokë të sëmurë, koha dhe faktet treguan se këta shokë vijuan në punën e vjetër të grupeve.

Këta shokë kanë kundërshtuar gjithmonë direktivat e Partisë: direktivën e moralit proletar, kundër vjedhjes, të punës me fshatarët, vijën e rinisë, konspiracionin, aksionet, kanë pasur shtyp të veçantë etj.

Kanë treguar pakënaqësi të vazhdueshme dhe që kalonin

prej njëres tek tjetra; kanë kritikuar<sup>1</sup> shokët e Partisë dhe sidomos forumet e Partisë.

Këto pakënaqësi dhe këto kritika kishin një karakter kolektiv dhe të organizuar, të ardhura në një kohë, po prej atyre njerëzve dhe mbi subjekte të caktuara.

Këto kundërshtime dhe pakënaqësi janë shfaqur nga disa shokë të grupit të «Të Rinjve» dhe kanë marrë një hov të madh në kohën kur fashizmi sulmon me gjithë egërsinë e tij Partinë tonë dhe në një kohë kur një pjesë e shokëve më të mirë si shoku Qemal Stafa e të tjerë bien viktima të terrorit të gjakatarit Mustafa Kruja dhe një pjesë tjetër burgosen e ndiqen. Këto sulme bëhen pa kurrfarë arsëye, në çdo kohë dhe në shumë vende. Një punë e tillë merrte karakterin e një fraksioni në gji të Partisë. Por nuk mundet dhe nuk guxohet të flitet kundër grupit si tërësi<sup>2</sup>; në prej atij grupi kemi mjaft shokë që janë shumë të vendosur dhe që qëndrojnë në radhët e para të Partisë.

Shokët më me përgjegjësi<sup>3</sup> që ishin të infektuar me këtë frymë grupi nuk pranuan në fillim të kësaj konference asnjë kritikë për punën e tyre. Ata refuzuan çdo gjë. Në fund të konferencës dolën me një autokritikë të përciptë, duke mos pranuar të gjitha kritikën e shokëve, por vetëm të disave dhe të referatit.

Ja, pra, disa pika më me rëndësi të autokritikës së tyre: ambicia, mbivlehtësimi i shokëve të grupit të «Të Rinjve» dhe nënvlehtësimi i shokëve të tjerë, mbajtja e lidhjeve të vjetra, përhapja e pakënaqësisë në shokët e tjerë, kritikë kundër shokëve dhe forumeve, kritika e vijës së Partisë, kritika për aksionet; ata pranuan se këto gjëra i kanë sjellë dëm të madh punës, qoftë nëse janë bërë me qëllim ose pa qëllim dhe se fajtorët kryesorë janë ata, sepse po të kishin dashur do ta ndalonin çdo pakënaqësi dhe çrregullim në radhët e Partisë.

1 Është fjala për kritikë të sëmure, për goditje me qëllim të caktuar kundër Partisë dhe udhëheqjes së saj. Pas krijimit të Partisë Anastas Lula dhe Sadik Premte, sa për sy e faqe urdhëruan shkrirjen e grupit të tyre në Parti, po nga ana tjetër, me njerëzit e grupit i vazhduan lidhjet jashtë Partisë, bile i forcuan më tepër. Veç kësaj ata ruajtën fshehurazi materialin propagandistik të grupit, shtypin, financën. Anëtarët e grupit të «Të Rinjve» muarën urdhër nga Anastas Lula dhe Sadik Premte që të godisnin dhe të pengonin organizimin e ri të Partisë e të Rinisë Komuniste, të godisnin vijën politike të Partisë, të dilnin në krye të komiteteve qarkore dhe organizatave të reja të Partisë njerëzit më të sëmure të grupit. Pikërisht këtë punë armiqësore fraksioniste dënon rëndë Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë.

2 Grupi i «Të Rinjve».

3 Anastas Lula dhe Sadik Premte.

Komiteti Qendror i Partisë duke marrë parasysh gjithë këto gjëra, vendosi të mbledhë një konferencë dhe pas një sqarimi të imtë të marrë vendime të prera karshi të tillë elementëve, puna e të cilëve sa vinte po merrte formën e një fraksioni në Parti.

Gjatë diskutimeve në konferencë u pa haptazi se parashikimet e Komitetit Qendror ishin të drejta e me vend.

Partia ka vendosur të marrë një qëndrim të caktuar për të spastruar radhët e saja, por pa i humbur kurrë nga syri këta elementë. Partia do të bëjë ç'është e mundur që t'i përkrahë dhe t'i ngrejë sa më lart dhe t'u japë dorën e të gjitha mundësitë për t'u kthyer prapë në radhët e Partisë dhe në rast se këta shkojnë më larg, atëhere Partia ka për të marrë masa.

Partia do të shikojë edhe elementët e dorës së dytë që kanë rënë në pozita të tilla dhe këta do t'i spastrojë pa kurrfarë mëshire.

Partia do të jetë e pamëshirshme për të gjithë ata elementë që fshehin lodrën e tyre dhe që nesër do të zbulohen patjetër.

Në spastrimin e Partisë mund të bjerë viktimë ndonjë shok i pafajshëm, po përsëri puna e tij do ta sjellë në gjirin e Partisë.

Duke qenë se Partia jonë është e re, do të bëjë ç'është e mundur që t'i mbajë radhët e saja të pastërta, të ketë anëtarë të një kualiteti të mirë që të çmojnë mbi çdo gjë tjetër njësinë e Partisë dhe disiplinën ndaj Partisë.

Sot që kemi një armik të tmerrshëm që na kërcënon me plumb dhe konop për çdo minutë, duhet që radhët tona t'i kemi homogjene dhe të çelnikta.

Shpresohet se të gjithë shokët kanë për të parë gabimet e tyre serioze dhe se këto gabime do t'i përmirësojnë. Mundet që këto gabime t'i përmirësojnë ndofta më mirë jashtë Partisë, sepse në Parti s'mundën t'i përmirësojnë. Të gjitha dënimet kanë karakter edukimi dhe përmirësimi.

Komiteti Qendror në bazë të gabimeve të bëra që prej kohësh, në bazë të kritikës dhe të autokritikës që u bë në konferencë dhe në bazë të raporteve dhe gjykimeve të shokëve e quan të domosdoshme dëbimin nga Partia të shokëve:

Dëbim për një kohë të pacaktuar:

A[nastas Lula] Qo[rrri]  
S[adik Premte] Xhe[pi]

H ..... Ag [ai]  
S ..... Jor ....  
Xh ..... Ra ....  
M ..... Çel .....  
Sh ..... Sha [ba]

### Dëbim për tre muaj:

J ..... Ba [iverbruk]  
Sh ..... Ka [mberi]  
K ..... Xhi [xhi]

Veçanërisht një vend kryesor zë agjenti provokator, Ludovik Nikaj, i cili është i dënuar me vdekje nga ana e proletariatit, si TRADHËTAR, AGJENT, PROVOKATOR DHE SHKELËS I MORALIT PROLETAR.

### KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

### THIRRJE E KQ TË PKSH DREJTUAR FSHATARËVE SHQIPTARË

Korrik 1942

#### KATUNDARË SHQIPTARË!

Zjarri i luftës ka rrëmbyer gjithë botën; me miliona njerëz janë çuar me armë në dorë dhe janë përlëshur në një luftë gjiganteske.

Nga njëra anë forcat e errësirës, forcat grabitëse dhe gjakatare fashiste, përpiqen të skllavërojnë botën, të thithin gjakun e popujve dhe, nga ana tjetër, forcat e përparimit, forcat e lirisë, të udhëhequra prej popujve kreshnikë të Bashkimit Sovjetik, duke pasur përkrah popujt demokratikë të Ingliterës dhe të Amerikës dhe gjithë popujt e robëruar, po u presin hovin hordhive gjakatare fashiste dhe po u pregatisin dita-ditës varrin.

Në kohën e gjakderdhjes më të madhe të krejt njerëzimit, pesha më e rëndë e kësaj kasaphane, e dashur dhe e shkaktuar prej kusarëve fashistë, rëndon mbi katundet dhe katundarët. Gjithmonë pesha më e rëndë e çdo lufte bie mbi popullin punëtor. Çdo vit me mijëra familje katundarësh ngelin pa bukë dhe vuajnë për të gjitha nevojat e para; mjerimi, zia, uria mbretërojnë në vatrat e tyre të mjeruara.

A e keni kërkuar ndonjëherë, vëllezër katundarë të Shqipërisë, shkaku e varfërisë, mjerimit, urisë, errësirës, që me shekuj ju kanë mbuluar dhe që nga viti në vit dhe dita-ditës po bëhen më të tmerrshme?

Katundarë të Shqipërisë, që gjithë vitin ju kullon gjaku në këmbë, që gjithë jetën i jeni mbërthyer tokës së vaditur me djersën tuaj dhe në shi e në dëborë, të zhveshur e kurdoherë të uritur, po derdhni gjithë forcat tuaja, gjithë mundin tuaj, përveç shtypjes dhe skllavërimit shekullor, fashizmi gjakatar dhe tradhëtarët e popullit tonë, armiq të betuar të punëtorëve dhe të katundarëve, po përpiqen t'ju hedhin përgjithmonë në hallin më të zi, në errësirën më të thellë, në skllavërimin e përrjetshëm.



Fashizmi zaptues italian ju turr vendit tonë si ajo bisha e uritur, u turr mbi fushat tona për të na skllavëruar, për të na grabitur, për të na gjakosur e për të na zhdukur. Ai zaptoi fushat e malet, kodrat e luginat dhe, kudo që shkeli çizmja e tij e ndyrë, aty s'mbiu më bar, fantazma e luftës e mbuloi vendin tonë të bukur. Fashistët e poshtër e bënë vendin tonë fushë lufte, qytetet dhe katundet i shkatërruan, ata mbollën tmerrin, mjerimin; bombat e tyre vranë popullin tonë, dogjën katundet tona, të cilat u bënë shenja lufte për aeroplanët e tyre; ata plaçkitën gjënë e gjallë dhe katandinë tonë për të ushqyer xhelatët e popullit shqiptar.

#### VËLLEZËR KATUNDARË SHQIPTARË!

Fashizmi i ndyrë, zaptuesi i vendit tonë, dhe tradhëtarët si Mustafa Kruja me shokë, përpiqen të na i rrëmbejnë tokat tona dhe të na i bëjnë pronë të hajdutëve fashistë; Mustafa Kruja, pjesëtari më i madh i shoqërive grabitëse italiane, po bën çmos për të hedhur në dorë pasuritë e vendit tonë; bankat fashiste përpiqen të na grabisin tokat që duhet të jenë prona juaj, se ju i punoni e dërsini; ata përpiqen që katundarët tanë të mos jenë veçse skllëvër të uritur, ata përpiqen të na rrëmbejnë çdo gjë që kemi, të na thithin gjithë gjakun tonë për të na lënë të vdesim urie dhe kështu të na shtypin më lehtë. Ata po na grabisin pasuritë e tokës dhe të nëntokës për të ushqyer armën e tyre të luftës, për të ushqyer hordhitë e tyre gjakatare, shtypësit e vendit tonë. Ata na rrëmbyen vajgurin e Kuçovës e të Patosit, ata po na rrëmbejnë mademet tona, po na marrin misrin, grurin, po na grabisin gjënë e gjallë, po na shkatërrojnë pyjet, po na vjedhin leshin.

Fashizmi gjakatar dhe tradhëtarët e popullit tonë përpiqen të na shkombëtarizojnë, të na zhdukin gjuhën amtare, bëjnë çmos për të korruptuar djemtë tanë, ata përpiqen të zhdukin zakonet tona të bukura: bujarinë dhe besa-besën e popullit tonë kreshnik, ata përpiqen t'i zëvendësojnë me veset e poshtra të fashizmit, me imoralitetin e tyre, ata përpiqen të na poshtërojnë, të shnderojnë gratë dhe motrat tona.

Fashizmi gjakatar, zaptuesi i vendit tonë dhe agjentët e tij, me tradhëtarin Mustafa Kruja në krye, po gjakosin popullin tonë. Ata me forcë po rrëmbejnë bijtë e katundarëve dhe të popullit dhe i dërgojnë të vriten për hesapin e xhelatëve Hitler e Musolin; ata mobilizojnë pjesën më të poshtër e më të dobët të popullit shqiptar në milici e në polici për ta shtënë në luftën më të tmerrshme, në luftën vëllavrasëse.

Armiku dhe veglat e tija të poshtra, me qeverinë tradhëtare

të Mustafa Krujës, po burgosin, po vrasin bijtë e popullit tonë. Ata përpiqen të na gjakosin me popujt fqinjë që luftojnë për lirinë e tyre. Ata përpiqen të na ndajnë në të krishterë, muhamedanë e katolikë.

#### VËLLEZËR KATUNDARË TË SHQIPËRISË!

Në këtë luftë të shenjtë për të fituar lirinë e përhershme, që po bën populli shqiptar, ju jeni faktorët më kryesorë të fitores sonë. Armiku e di që ju jeni forcat e gjalla të vendit, ai e di se bashkimi i forcave tuaja me tërë popullin shqiptar do të thotë vdekje e shpejtë dhe e tmerrshme e fashizmit. Apostafat për këtë arësye armiku dhe tradhëtarët kanë vënë gjithë forcat e tyre për t'ju shtrydhur, për t'ju grabitur e për t'ju lënë të vdisni urie. *Fashizmi po përpiqet t'ju rrëmbejë të gjitha ç'kini, ai ju la pa vaj, ai përpiqet t'ju marrë grurin, misrin, gazin, leshin, gjënë e gjallë.* Tradhëtari Mustafa Kruja mundohet dhe organizon grabitjet e katundarëve, fati i të cilëve është lidhur ngushtë me tokat e atdheut tonë, po mundohet t'ju pijë gjakun dhe djersën tuaj, o katundarë, të mbajë gjallë kusarët e Musolinit e të Hitlerit, përpiqet të mbajë në fuqi buxhetin e tyre ushtarak, e këtë vit tradhëtari Mustafa Kruja ju detyron që të jepni ç'është e mundur më tepër. *Armiku kërkon t'ju blejë me para një pjesë të dytë të bereqetit, me të cilat para ju s'mund të bleni kurrgjë. Ai ju ka dhjetëfishuar taksat, ju ka shtuar xhelepin dhe po i shton dita-ditës.* Mustafa Kruja e hoqi maskën tani, po e kërkon me ferman bereqetin dhe po u taks litarin të gjithë atyre katundarëve që duan ta mbajnë bereqetin për gojën dhe për fëmijët e tyre.

Tradhëtari Mustafa Kruja po përpiqet t'ju ushqejë me rrena dhe me demagogjinë e tij, t'ju flasë për një «Shqipëri të madhe», për një «Kosovë të çliruar».

Djallëzive të armikut, shtypjes që po na bën, duhet t'u përgjigjemi me armë, duhet ta bëjmë luftën tonë gjithnjë më të ashpër, duhet të mos e lëmë armikun asnjë minutë të veprojë me duar të lira në kurriz të popullit tonë. Çdo shqiptar i vërtetë duhet të bëhet i ndërgjegjshëm për detyrën e tij ndaj popullit tonë, ai duhet me krenari e vetëmohim të shpejtojë ditën e çlirimit të atdheut.

Katundarin tonë e kërcënon uria e tmerrshme, prandaj *mbani bereqetin tuaj për vete dhe për familjet tuaja, ndihmoni farefisn tuaj dhe mos i jepni asnjë kokërr të dhjetë qeverisë grabitëse, që më vonë, me spekulacion, do t'jua shesë dhjetë herë më shtrenjtë. Bashkohuni në çdo katund dhe katund me katund dhe mbronni me armë në dorë bereqetin dhe prodhimet tuaja që kërkon t'jua grabisë qeveria. Bereqeti, që ju e keni fituar me njëmijë mundime,*

është vetëm juaji dhe i askujt tjetër, prandaj mos ja dorëzoni askujt, e fshihni, i fshihni prodhimet, se ato janë tuajat dhe të familjeve tuaja. I fshihni se në dimrin që vjen uria do të bëjë hatanë në vatrën tuaja.

Duke mos dhënë bereqetin, taksat, xhelepin, ju keni bërë një pjesë të detyrës suaj karshi atdheut dhe njëkohësisht e keni ruajtur atë për familjet tuaja, që kërcënohen prej urisë. Me këtë mënyrë do të ndihmojmë luftën e popullit shqiptar, me këtë mënyrë do të shpejtojmë ditën e çlirimit, se jemi të bindur në fitoren tonë, në fuqitë tona të bashkuara, se atje ku është bashkimi, thotë një fjalë popullore, është fitimi.

#### KATUNDARË TË SHQIPËRISË!

Në këtë luftë të tërbuar, ku luhet fati i gjithë njerëzimit, populli shqiptar, me traditat e tija shekullore, me shpirtin e tij prej luftëtari lirishtës, po ndjek gjurmat e të parëve të tij që kanë luftuar për lirinë e atdheut kundër okupatorëve dhe tradhtarëve.

Armikut të betuar të vendit tonë, populli shqiptar i ka shpallur luftë të pamëshirshme.

Në fshatra e qytete bijtë e popullit tonë po luftojnë me tërbim zaptuesin e qelbur dhe tradhtarët, gjaku i kulluar i bijve tanë vadit rrugët e qyteteve e të katundeve të Shqipërisë, ata bien si trima për lirinë e vendit tonë, ata shkojnë në litar me buzë në gaz, se kanë kryer detyrën ndaj popullit të tyre, se ata s'mund të rronin dot pa liri, se ata s'mund të shihnin dot popullin e tyre nën zgjedhën më të ndyrë që ka parë vendi ynë. Hovi kryengritës i popullit tonë po shkon dita-ditës me vrull, populli ynë po bashkohet, po forcohet për të goditur pa mëshirë armikun dhe tradhtarët, populli shqiptar po bën ballin e përbashkët për të fituar lirinë, ai po bashkon forcat e tija me ato të popujve të Bashkimit Sovjetik, atdheut të punëtorëve dhe të bujqve, me ato të popujve demokratë, anglez dhe amerikan, ai po lufton krah për krah me popujt e tjerë të robëruar prej fashizmit, populli shqiptar po merr pjesë në luftë për shpëtimin e njerëzimit nga barbarët fashistë. Ashtu si qëmoti, kur stërgjyshët tanë, me flamurin e Skënderbeut luftuan pareshtur zaptuesin e vendit tonë, kështu dhe ne, bij të denjë të tyre, me flamurin e Skënderbeut të shkojmë në luftë kundër zaptuesit të ndyrë fashist dhe tradhtarëve, për çlirimin e vërtetë të popullit shqiptar.

KATUNDARË, MOS JEPNI TË DHJETËN, MOS JEPNI ASNJË THËRRIME GRURË, ASNJË FIJE LSHI!

MOS PAGUANI XHELEPIN DHE TAKSAT!

NDIHMONI LUFTËN E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR ZAPTUESIT, LUFTË ME ÇETA, ME SABOTAZHE!

POSHTË FASHIZMI GRABITËS DHE ZAGARI MUSTAFA KRUA E MILICËT!

POSHTË VËLLAVRASËSIT DHE VEGLAT E VERBËRA TË LUFTËS VËLLAVRASËSE!

RROFTË BASHKIMI I POPULLIT SHQIPTAR!

RROFTË LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR ZAPTUESIT!

RROFTË SHQIPËRIA E LIRË!

RROFTË PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË, FLAMURTARJA E LUFTËS PËR LIRI!

#### KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas kopjes së  
daktilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## KRYEARTIKULLI I NUMRIT TË PARË TË «ZËRIT TË POPULLIT»

25 gusht 1942

### «ZËRI I POPULLIT»

Ka një mision, ka një qëllim: të bashkojë të gjithë popullin shqiptar rreth e përqark këtij organi, të bashkojë çdo gjë që është e ndershme dhe antifashiste, pa marrë parasysh besimet, grupet politike, korrentet e ndryshme. «Zëri i Popullit» është i vendosur t'i bëjë luftë okupatorit.

Pse po del «Zëri i Popullit»?

Që t'i japë popullit tonë një udhë shpëtimi, t'i tregojë se kush e shkeli popullin shqiptar, se kush solli njëmijë e një të zeza, se kush e shkretoi vendin tonë me tym e me flakë më 1939, se kush e bëri gjysmën e Shqipërisë zjarr e pluhur një mot të tërë, se kush po e lë pa bukë popullin tonë, duke i marrë të gjitha produktet e vendit e të gjithë bereqetin. Kush e mori vajin, leshin e vajgurin që buron si ujë në tokën tonë. Kush e la katundarin pa bukë e pa kripë. Të gjitha këto të zeza i sjell vetëm okupatori e fashizmi italian dhe lufta që është vetëm e vetëm pjella e fashizmit.

Fashizmi italian, me anën e «Tomorit»<sup>1</sup> dhe të kalemxhinjve me rroga të majme, me çakallin Hilmi Leka<sup>2</sup> në krye, përpiqet të na e mbushë kokën se duhet të kënaqemi me kaq, mbasi është kohë luftime, por këta zotërinj të ushqyer mirë harrojnë të thonë se luftën nuk e suallëm ne, por vetë Duçja dhe okupatori fashist.

Populli shqiptar nuk i bëri ndonjë ftesë të posaçme katilit të Romës, bile okupatori e mban mend fare mirë se si e përcolli populli shqiptar më 1920<sup>3</sup>, apo këto i ka harruar Duçja dhe kalemxhinjtë e «Tomorit»?

1 Gazetë e përditshme fashiste (mars 1940 — shtator 1943).

2 Drejtor i gazetës fashiste «Tomori» dhe ministër i kulturës në qeverinë kuislinge të Mustafa Krujës.

3 Është fjala për luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesve impe-

Kush e gjakosi popullin tonë dhe kush e shpuri në vëllavrasje? Okupatori fashist. Pasi na rrëmbeu tokën dhe na shkeli të gjitha të drejtat që kishim fituar me rrëke gjaku, tani armatosi dhe mobilizoi pjesën më të poshtër të popullit tonë në milici, në karabinieri e në polici dhe i vuri të ndjekin djemtë e këtij populli, ajkën e rinisë e të luftëtarëve që e derdhin gjakun e tyre të kulluar vetëm për një qëllim të shenjtë: për një Shqipëri independente, të lirë e demokratike.

Qytete e katunde u skuqën me gjakun e djemve tanë, në Shkodër, në Durrës, në Tiranë, në Korçë, në Krujë me duzina djem ranë dëshmorë nga plumbat tradhëtare të armikut e të zagarëve të kolonës së pestë.

Sot me qindra djem shqiptarë po dergjen nëpër burgjet e errëta të xhelatëve tradhëtarë të popullit e të racës shqiptare, me qindra djem të shqipes sot po rrijnë majë shkëmbinjve të ishujve të egër të Italisë fashiste.

Që kur ka shkelur Italia fashiste në Shqipëri, populli ynë nuk ka parë një ditë të bardhë, por ka ditur edhe të luftojë, ka qëndruar si burrë, viktimat që ka dhënë ka ditur pse i ka dhënë. Viktimat, të burgosurit, të internuarit dhe partizanët e maleve dëshmojnë se si e urren populli Italianë fashiste.

Këto do t'i thotë popullit tonë gazeta e tij, tribuna e vërtetë e popullit shqiptar.

«Zëri i Popullit» do të demaskojë agjentin nr. 1 të fashizmit, Mustafa Merlikën. «Zëri i Popullit» do të demaskojë agjentët e luftës vëllavrasëse.

«Zëri i Popullit» do të demaskojë pa mëshirë demagogjinë fashiste të «Tomorit» dhe të kalemxhinjve të tij.

«Zëri i Popullit» do të grumbullojë rrotull tij të gjitha energjitë virile të popullit shqiptar, energjitë e gjithë atyre që e kanë marrë vesh një herë e mirë:

*Se liria fitohet,  
por nuk dhurohet.*

«Zëri i Popullit» do të jetë tribuna me kolona të hapura për të gjithë luftëtarët e lirisë, pa ndryshim klase dhe feje, për të gjithë ata shqiptarë që duan të na ndihmojnë me punë dhe jo me llafe për çlirimin e vërtetë të Shqipërisë.

«Zëri i Popullit» do të jetë tribuna e vërtetë e Zërit të Kushtrimit për Luftën nacional-çlirimtare, ku do të thuhet e do të këndohet lufta jonë kundër okupatorit gjakpirës.

rialistë italianë në Vlorë në vitin 1920. Lufta përfundoi me fitoren e forcave patriotike, të cilat i hodhën pushtuesit në det dhe çliruan krejt qytetin e Vlorës dhe rrethin e tij.



«Zëri i Popullit» do të jetë tribuna ku do t'i thuhet popullit e vërteta ashtu si e ka bërë mëma, e vërteta lakuriqe.

«Zëri i Popullit» do t'i tregojë këtij populli se ku i kemi miqtë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Ne e dimë se populli ynë në luftën për liri nuk është vetëm, por ka edhe shumë miq të fortë dhe të vendosur në botë.

Me ne janë gjithë popujt liridashës të botës, që nga Kina heroike gjer tek popujt heroikë të Jugosllavisë dhe të Francës.

Tre aleatë të mëdhenj luftojnë sot për një qëllim: të dërmojnë fashizmin.

Bashkimi Sovjetik, me Ushtrinë e Kuqe të katundarëve dhe të punëtorëve me shokun Stalin në krye, shkon në ballë porsidash me këmborë. Pas tij vijnë dy demokracitë e mëdha: Inglitera dhe Amerika, dy fuqi të mëdha me një ekonomi kolose, që po pregatiten për një front të dytë në Evropë<sup>1</sup>.

Prej ca kohësh më parë 28 shtete nënshkruan «Paktin e Londrës», që u garanton popujve liri dhe paqe kolektive, u garanton popujve zhdukjen definitive të fashizmit gjakatar.

«Zëri i Popullit» do të jetë tribuna e bashkimit, ku do të pasqyrohet lufta jonë për liri dhe lufta e popujve liridashës të Evropës.

Kjo është e vetmja ambicie që kemi ne të «Zërit të Popullit».

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit»

Botuar për herë të parë në «Zëri i Popullit», Nr. 1  
25 gusht 1942

1 Fronti i dytë në Evropë ishte vendosur të hapej nga aleatët e Bashkimit Sovjetik: Anglia dhe SHBA-ja, brenda vitit 1942. Por qeveritë amerikane dhe angleze nuk i mbajtën zotimet e tyre. Ato e hapën këtë front vetëm në qershor të vitit 1944.

## LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR KORÇËN MBI QËNDRIMIN NDAJ «BALLIT KOMBËTAR»

[Janar 1943]

Të dashur shokë,

Muarëm letrën tuaj dhe e kuptojmë fare mirë situatën kaotike të qarkut tuaj, situatë po e njëjtë si në të gjitha qarqet e tjera dhe që e ka shkakun te «Balli Kombëtar». Që të mund ta zgjidhim këtë problem, na duhet me kuptue ç'është ky «Balli Kombëtar» dhe me ra në bashkëfjalim me njerëzit përgjegjës të tij e me i vu pikat mbi «i» ose me e nda kashtën nga kokrra, se me të vërtetë në atë mes s'merr vesh qeni të zonë, megjithëse myteberët e mëdhenj të «Ballit» duan të paraqiten si një trup e me një mendim të njëjtë. «Balli» është një «ramassis»<sup>1</sup> elementësh me tendencë të ndryshme e të pathemel, por që për «dado» kanë fjalën nacionalizëm në gojë. Fazlliu<sup>2</sup> s'ka gabuar aspak kur thotë se në «Ballin» bëjnë pjesë «që nga diktatura (është për ta pyetur çfarë diktature) e deri te socializmi», por vetëm Fazlliu ka harruar të thotë që këta elementë s'kanë asnjë princip të qartë në kokë e këndeje rrjedh që të mos kenë një qëndrim «fixe»<sup>3</sup> të bazuar në parime të shëndosha. Këta elementë, pra, «që nga diktatura e deri te socializmi», kanë zgjedhur nga një njeri ose, më mirë të themi, janë zgjedhur në një komitet qendror e kanë për kryetar Lumo Skëndon<sup>4</sup>, dhe ky komitet qendror është gjenerali i pakualifikuar i një ushtrie «të madhe» (çdo shqiptar që s'është komunist, thonë ata, është i «Ballit», jo i organizuar, por shpirtërisht, por përsëri i «Ballit»), ushtri e madhe, por e pabindur, se populli s'pi ujë në mullirin e ty-

1 «Ramassis» (frëngj.) — grumbull sendesh pa vlerë.

2 Fazlli Frashëri, eksponent i «Ballit Kombëtar» në qarkun e Korçës.

3 Fixe (frëngj.) — i prerë, i pandryshueshëm.

4 Pseudonimi i Mithat Frashërit, kryetar i organizatës tradhëtare të «Ballit Kombëtar».

re. Por të shohim ç'ka brenda «Balli», që ata e quajnë si një organizatë. Brenda «Balli» është një shportë karavidhesh; një pjesë e tyre, që e quajnë veten të mëngjër e që thonë: «Ne jemi «Balli» i vërtetë», duan të luftojnë, këtë e thonë dhe e shkruajnë në organin e «Ballit»<sup>1</sup>, që e drejtojnë ata vetë në kundërshtim me pikëpamjet e komitetit qendror (natyrisht ata s'janë komunistë, njëri i bie gozhdës, tjetri patkojt). Një pjesë tjetër e do luftën, por jo si e bëjmë ne, një pjesë tjetër s'do të bëjë luftë, se konsumohen, por do organizim për të mbrojtur «kufitë etnike», të tjerë janë partizanë të «99 hileve dhe një trimërie», të tjerë partizanë të «berihajt» dhe të tjerë të fjalëve të mëdha, por të asnjë pune. Mbi të gjithë këta fryn «era e bashkimit të shenjtë» me fjalë, të gjithë kanë një admirim për luftën tonë, të gjithë respektojnë Lumo Skëndon, të gjithë e kanë kryetar, por të gjithë s'janë dakord me mendimet e tija, të gjithë do t'i dërgojnë ultimatum, por të gjithë të hidhen në grykë, kur i bën Lumos ndonjë kritikë të arësyeshme e me vend, kritikë, që ata ja bëjnë vetë. Kjo është pa e ekzagjeruar qendra e «Ballit», e cila ka lidhje me qarqet që i pasqyron ajo e Korçës me Fazlliu në krye.

*Duhet, pra, me qërue lakrat këtu brenda, sepse me të vërtetë është një pengesë e madhe, sepse s'duhet me harrue influencën e tyre individuale në Shqipëri, dhe këta kanë mundur të krijojnë një psikozë në popull që ekziston një organizatë nacionaliste, dhe që komunistët duhet të merren vesh me të e të bien dakord.* Partia jonë, pra, ka çuar shokë dhe u ka dhënë kompetencë të bisedojnë e të vendosin me «Ballin». Shokët kanë rënë në kontakt, si me të dërguarit e tyre, si individualisht. Të mos harrojmë se atje ka mjaft elementë të mirë e të vendosur, që duan me të vërtetë bashkim e luftë. Këta janë ata elementët e mëngjër, të cilët na thonë se i kanë dhënë ultimatum komitetit qendror dhe i thonë: «ose bashkim e luftë, ose ne po ndahemi prej «Ballit»». Me elementë të tjerë nacionalistë (natyrisht jemi duke folur për pezzo grosso-t<sup>2</sup>, se shtresat e unjta i kemi merak vetë) shokët kanë rënë në kontakt. Ata i kanë pritur aq mirë sa mënt i kanë puthur, duke lëvduar komunistët, Partinë, e duke u thënë se me gjithë zemër duan të bashkohen etj. etj. por bisedoni një herë me «Ballin Kombëtar», u kanë thënë. Tani kontaktet zyrtare janë në vazhdim dhe brenda 15-20 ditëve duhet të marrin formë të prerë, se këta miqtë një pjekje e shtynë 10-15 ditë dhe kjo rrjedh se kapot e komitetit qendror të tyre janë partizanë të «hiq e mos këput», derisa të thyhet fashizmi. Por tok me përfundimet që do

1 «Lufta e çlirimit kombëtar» organ i përmuajshëm i «Ballit Kombëtar» (nëntor 1942 — gusht 1943).

2 Pezzo grosso (ital.) — personalitet, njeri me influencë (me ironi).

të marrin bisedimet, shpresojmë se atje, brenda në «Ballin», mund të ketë fraksione, se një kala prej karte s'mund të qëndrojë në këmbë. «Politikanët e mëdhenj», që janë dërguar të bisedojnë me shokët tanë, po bëjnë po ato kritika që bën Fazlliu, por shpejt vihen në qoshe të murit, sepse pretendimet e tyre janë pa baza. P.sh. për Konferencën e Pezës, kur u thuhet se Konferenca e Pezës ka qenë hapi i parë i bashkimit dhe i organizimit të luftës, se në Konferencën e Pezës kishin marrë pjesë nacionalistë të vendosur e me pushkë në krahë, që pushkën e kishin shkrehur përmbi armikun, se atje kishin marrë pjesë edhe nacionalistë që sot bëjnë pjesë në «Ballin Kombëtar» e se «Balli Kombëtar» s'është thirrur aty për të vetmen arsye se nuk ekzistonte (e në qoftë se ata pretendojnë se ka ekzistuar, ne u përgjigjemi se ekzistencën e një partie politike, që nuk manifestohet me një trakt të paktën, s'mund të na e thotë falli ose gishti i vogël), *këta myteberë s'kanë se ç'thonë, por e pranojnë dhe s'kanë guxim ta mohojnë rëndësinë e saj.* Por dhe pretendimeve të tyre kundër konferencës do t'u gjendet fare lehtë ilaçi, se, kur s'pranojnë këtë byrek, u themi se jemi gati të bëjmë një byrek tjetër, për hir të lirisë së popullit tonë, dhe atje do të duket vendosja e tyre.

Sa për çetat e Bazit<sup>1</sup>, Myslimit<sup>2</sup> e Mestanit<sup>3</sup>, që thonë se janë hedhur me ta, ju mos u çuditni aspak në qoftë se një mëngjez merrni vesh të thonë se gjithë çetat partizane janë hedhur me ta, vetëm Pasho Koloneci<sup>4</sup> mund të presë shumë kohë armët nga Peza, të paktën të ruajë qylafet që i kanë çuar. Në organin e tyre do të shihni shumë xhevahire, këto mos t'ju mërzhitin, sikundër s'u mërzhitëm ne kënde kur këta shkruanin në organin e tyre se «Çeta e Safet Butkës<sup>5</sup> prej 1000 vetash po i shkon për ndihmë

1 Abaz Kupi (Bazi i Canës), komandant çete zogiste. Agjent i vjetër i Inteligens Servis-it anglez, eksponenti kryesor i organizatës tradhëtare «Legaliteti» (partia zogiste). U dërgua në Shqipëri nga anglezët në vitin 1941, me qëllim që të sabotonte Luftën nacional-çlirimtare. Në Konferencën e Pezës pranoi sa për sy e faqe programin e Frontit Nacional-Çlirimtar dhe u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar dhe më vonë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

2 Myslim Peza, komandant i çetës partizane të Pezës dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

3 Mestan Ujaniku, ish-komandant i çetës partizane të Skraparit. Gjatë luftës paraqiste lëkundje të theksuara dhe prirje për t'u bashkuar me «Ballin Kombëtar». Fill pas luftës, tradhëtoi, duke u bashkuar me grupet kundër-revolucionare të organizuara nga imperialistët anglo-amerikanë.

4 Pasho Koloneci, komandant çete balliste në qarkun e Korçës.

5 Eksponent dhe komandant çete i «Ballit Kombëtar» në Kolonjë.

Vlorës». Të kish pritur Vlora nga çeta e Safetit i kish mbirë bari mbi sy, si thonë andej nga ne.

Shokë, më falni që letrën e shkruaj me një ton të tillë për një punë me kaq rëndësi, por me të vërtetë pretendimet e këtyre «politikanëve» duhet të tregohen në këtë mënyrë, se s'janë përveçse dëckla.

Vetëm duhet të kemi parasysh një send: *luftën nuk mund ta bëjmë vetëm, por me gjithë popullin, dhe për këtë arsye me këta nacionalistë duhet ta marrim punën seriozisht*. Partia ka hyrë në bisedim me «Ballin», dhe do të merret një vendim e do të caktohet qëndrimi i tyre, i mirë a i keq, por kemi shpresa se do të përfundojmë në një rezultat të mirë. Nga ana tjetër, në qoftë se pikëpamjet nuk do të jenë të njëjta me të gjithë, ne do të vazhdojmë që një pjesë prej tyre ta bindim dhe atë pjesën tjetër, që s'pranon të luftojë, do përpiqemi ta neutralizojmë e ta ndalojmë të hidhet nga ana e armikut. Detyrë, pra, shumë e rëndë e delikate, që lyp takt politik, gjakftohtësi dhe dinjitet, se duhet të kemi parasysh që e kemi për detyrë të shkojmë e t'i bindim ata që s'na kuptojnë, por kur këta i vënë gurë rrotës, ne s'ju puthim gjunjët, por ua heqim kokës; *emrin e Partisë ne s'e përlyejmë*, kështu që me Fazliun e me nacionalistët e tjerë evitoni hëpërhë përpjekjet e fjalët e thata, por natyrisht asnjë koncesion, por kurdoherë brenda direktivave që sigurisht i keni punuar në gjithë shokët. Bisedimet që keni me ta s'duhet aspak të ndalojnë aksionet e punën; kritikave të tyre, që u bëjnë aksioneve ose shenjës partizane, përgjegjuni si u jeni përgjegjur, por me gjakftohtësi. Sa për Pasho Kolonecin, që mund të vejë me ta, do ishte mirë të ishte me ne, do ishte mirë të kishte shokë tek ai. Kini parasysh një gjë: bashkimi ynë do të bëhet me luftë. Prandaj, në qoftë se Pashos ja kanë ngatërruar mendjen, faji s'është përveçse i juaji, të paktën në princip, se s'e di situatën e Gorës, por po të dinin shokët, mundet që Pashua të mos ta trubullonte mendjen. Megjithatë, me njerëzit e çetave vullnetare duhet të krijoni një dashuri të madhe dhe të fitoni besimin e tyre, pastaj e shikon vetë nga eksperiencia Pasho Koloneci se qylafet mbeten qylafe e s'bëhen kurrë pushkë.

Sa për Ganiun<sup>1</sup>, nuk dimë se ç'ka bërë, që i është hequr komanda, sigurisht keni pasë arsye dhe keni bërë mirë, por mendimi ynë është të mos shkoni shumë thellë me Fazliun, derisa të marrë karar puna. Ganiu s'është anëtar partie, sigurisht do të jetë ndonjë ambicioz pa vlerë, dhe plehurat që hedhim ne në shportë, mos u çuditni, ata do t'i marrin përherë dhe do t'i bëjnë heronj; ata do të bëjnë hero Ganiun, ata do të bëjnë heronj

1 Gani Peqini, pasi u shkarkua nga detyra si komandant çete partizane, për paaftësi dhe pavendosmëri, dezertoj dhe kaloi me «Ballin Kombëtar».

Fallon<sup>1</sup>, e Fundon<sup>2</sup>, por ne do të dimë t'i vëmë në vend me gjithë kërcënimet e gjeneral Fazliut, si e quani ju, por, *shokë, sa duruam nuk do të durojmë, prandaj mos lini kusur për të mbrojtur Partinë dhe luftën tonë, por veproni me gjakftohtësi në çështjen me nacionalistët*.

Sa për punën e Fetahut<sup>3</sup>, kjo është më delikate. Këtu duhet të vini gjithë forcën tuaj me e bindë për rrugën e shtrembër, se situata e tij, meqenëse ka formuar çetë (?) dhe lufton, është në antipodë me atë të «Zjarrit». Nga ana tjetër, grupit të «Zjarrit» i bini rëndë, e demaskoni pa mëshirë. «Zëri i Popullit», që doli, ka një artikull për këta plehra, këndojeni dhe merrni qëndrim karshi «Zjarrit».

Ata shokët hëpërhë s'vijne, por ju, kur të lajmëroheni, të jini gati, por mundet që të lihet. Sidoqoftë, ju lajmërojmë.

Të fala të gjithëve

Taras

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë: «Enver Hoxha, Vepra vëllimi I». Tiranë, 1968

1 Dhimitër Fallo, renegat i lëvizjes komuniste, eksponent i «Ballit Kombëtar» në qarkun e Korçës.

2 Lllazar (Zai) Fundo.

3 Fetah Butka, eksponent i grupit të «Zjarrit». PKSH u përpoq ta bashkonte me Frontin Nacional-Çlirimtar, kurse ai dhe çeta e tij kaluan përfundimisht me «Ballin Kombëtar».



**«DIREKTIVAT E INTERNACIONALES KOMUNISTE<sup>1</sup>  
DHE LUFTA NACIONAL-ÇLIRIMTARE»**

*(Referat i mbajtur në mbledhjen e KQ të PKSH)*

[Shkurt 1943]

Në prakun e Luftës së parë botërore populli shqiptar nuk gjendej i bashkuar për t'i bërë ballë situatës së re që ishte duke u krijuar në Evropë. Shtetet e mëdha imperialiste, që haheshin në mes të tyre dhe përgatisnin kasaphanën e luftës së madhe, ndërhyjnë në vendin tonë dhe, kështu, asnjë zgjidhje nuk mund t'i jepej çështjes shqiptare. Gjatë kësaj lufte Shqipëria u shkel në një pjesë nga aleatët dhe në një pjesë tjetër nga perandoritë qendrore dhe këlyshët e tyre. Toka shqiptare u bë fushë lufte dhe populli vuajti të zita e ullirit; imperialistët kërkonin ta përdornin për mish topi. Pas luftës përsëri imperializmi i huaj kërkoi ta bëjë plaçkë tregu popullin shqiptar. Veçanërisht Italia, e cila më 1915 firmoi Traktatin e fshehtë të Londrës<sup>2</sup> për shtrirjen e saj në Shqipëri (traktat që e shpallën publikisht sovjetët) u bë e rrezikshme për të ardhmen e popullit shqiptar dhe nuk e hoqi ushtrinë e saj nga një pjesë e tokës shqiptare. Populli shqiptar përpara këtij rreziku, me fuqitë e tija të vogla, ja nisi luftës kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. Në Lushnjë u bë kongresi që përmblihte përfaqësuesit e vërtetë të popullit, patriotët të ndershëm, që hodhën bazat e pavarësisë shqiptare dhe të shtetit shqiptar. Kongresi i Lushnjës ishte kurorëzimi i përpjekjeve dhe i sakrificave të popullit me nacionalistë të ndershëm në

1 Në dhjetor të vitit 1942 PKSH i erdhën direktivat e Komitetit Ekzekutiv të Internacionales Komuniste mbi luftën nacional-çlirimtare.

2 «Traktati i Londrës» u përfundua në mënyrë të fshehtë në 26 prill 1915 midis qeverive të Antantës (Angli—Francë—Rusi) dhe Italisë. Sipas këtij traktati Italisë i njihej sovraniteti i plotë mbi Vlorën, rrethet e saja dhe mbi ishullin e Sazanit. Një pjesë tjetër e gjerë e tokës shqiptare u jepej shteteve fqinjë.

krye, i Luftës nacional-çlirimtare për të fituar të drejtat e tija politike. Qeveria tradhëtare e Durrësit, vegël e Italisë, u rrëzua përpara frymës revolucionare të popullit. Populli i qytetit të Vlorës dhe fshatarët e tij rrëmbyen armët, dhe bashkë me këta me mijëra vullnetarë, nga të katër anët e Shqipërisë, të bashkuar nga një ideal i përbashkët — dëbimi i okupatorit, bënë një luftë heroike dhe hodhën në det zaptuesin. Shenjat e kësaj lufte mbetën të gjalla në popullin shqiptar dhe një urrejtje e madhe ju fut në shpirt për okupatorin.

Qeveria popullore e atëhershme e Tiranës nuk diti t'u bënte ballë problemeve ekonomike, shoqërore, politike të brendshme si dhe situatës së jashtme. Rinia shqiptare filloi të organizohet. Krijohet shoqëria «Bashkimi»<sup>1</sup> me qëllim që t'u bëjë luftë tradhëtarëve reaksionarë të brendshëm dhe rrezikut imperialist të jashtëm; ajo, e formuar prej elementëve më të ndërgjegjshëm të çështjes kombëtare, mundohet ta drejtojë popullin, duke e edukuar politikisht drejt mbrojtjes së interesave të tij ekonomike, shoqërore dhe politike me një karakter popullor dhe demokratik. Reaksioni, me anën e imperializmit të huaj, rrëzon qeverinë me forcë dhe bëhet zot me anë të diktaturës personale dhe bashibozuke të Ahmet Zogut dhe klikës së tij. Sistemi reaksionar i regjimit të tij dhe lidhja e mëpastajme e Zogut me Italinë sollën pakënaqësi në patriotët shqiptarë, të cilët, bashkë me të emigruarit jashtë atdheut, u munduan me anë të kryengritjeve të rrëzonin Zogun dhe të largonin rrezikun italian, por, fatkeqësisht, të gjitha tentativat dështuan, mbasi këta nuk kishin masën e gjerë të popullit me vete. Drejtuesit e këtyre lëvizjeve, që shumë herë nuk kanë pasë vendosjen e duhur, nuk i organizuan këto në shkallë të gjerë, nuk e përgatitën popullin, që e urrente regjimin e Zogut dhe Italinë fashiste. Rreziku i fashizmit italian po bëhej më i afërt, dhe populli shqiptar në asnjë mënyrë nuk deshte të pranonte dhe të kishte fatin e keq të Abisinisë dhe të Spanjës. Italia fashiste, me tradhëti dhe me forcë, dhe duke përfituar nga politika e gabuar e qeverisë së atëhershme, qeveri që i kishte lidhur fatet e saja me ato të Italisë, skllavëroi vendin tonë. Populli shqiptar e priti me pushkë fashizmin italian. Më 7 prill të 1939-s në Durrës, në Vlorë, në Sarandë, në Shëngjin u derdh gjak shqiptari për mbrojtjen e vendit të vet. Rinia, populli, luftuan në një luftë të pabarabartë kundër okupatorit.

1 Shoqëria «Bashkimi» u krijua me iniciativën e Avni Rustemit dhe të bashkëpunëtorëve të tij në tetor të vitit 1922 në Tiranë. Kjo shoqëri zhvilloi një veprimtari të gjerë e të gjithanshme politike për mobilizimin e masave popullore në luftën për demokratizimin e vendit. Ajo luajti një rol të shquar në organizimin e Revolucionit demokratik të Qershorit të vitit 1924.

Populli shqiptar e kuptoi fare mirë pse kishte ardhur fashizmi në Shqipëri; ai i dinte fare mirë qëllimet imperialiste të tija; ai i mbante mend dhe i dinte mizoritë, vuajtjet, grabitjet dhe internimet e 1920-s. Ai e dinte se fashizmi ishte shkaktari që gjatë regjimit të Zogut, me traktatet ekonomike dhe politike të imponuara prej tij, shkatërroi ekonominë e vendit, tregëtinë, bujqësinë dhe blegtorinë. Me ardhjen e Italisë fashiste në Shqipëri rifilluan në shkallë më të gjerë grabitjet, poshtërsitë, vuajtjet morale, internimet, burgimet, vrasjet. Fashizmi italian mori në dorë aparatit e shtetit shqiptar dhe e italianizoi. Kudo funksionarët italianë, veçanërisht në punërat drejtuese, zëvendësuan nëpunësit shqiptarë, të cilët mbetën si kukulla pa asnjë përgjegjësi. Shkollat, bazat e edukimit të rinisë shqiptare, filluan të italianizohen. Drejtësia shqiptare zëvendësohet nga gjyqet e jashtzakonshme ushtarake. Xhandarmëria dhe ushtria shqiptare suprimohen. Administrata bëhet vegël e karabinierisë dhe e Luogotenencës për të shtypur popullin shqiptar. Nuk mbeti shoqëri italiane pa derdhur kapitale të saja në tokën shqiptare; u mobilizuan tregëtia dhe mjetet e transportit. Bankat dhe shoqëritë bujqësore spekulonin në kurriz të popullit punëtor dhe zaptosin tokat e bujkut shqiptar. Shkurt, fashizmi shtiu në dorë shtetin shqiptar dhe pasuritë e vendit. Ja bilanci i veprimtarisë fashiste në vendin tonë. Ja, pra, sepse populli shqiptar e urren okupatorin. Ja sepse populli shqiptar filloi rezistencën për të mbrojtur të drejtat e tija jetike, rezistencë që u shpreh me forma të ndryshme: me propagandë, me agjitacion, greva, me demonstrata, me sabotazhe dhe me luftë çetash. Rinia që e para që ja nisi luftës dhe u vu në ballë të Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar kundër okupatorit. Populli shqiptar e kuptoi se vetëm me luftë mund t'i bëjë ballë rrezikut të zhdukjes nga faqja e dheut të kombit shqiptar nga fashizmi italian, ai e kuptoi se vetëm me anë të Luftës nacional-çlirimtare do të mundë të fitojë lirinë e vet. Këtë gjë e ndjeu i madh e i vogël. Populli, kur i është dhënë rasti, nuk ka munguar të shfaqë sheshit urrejtjen e tij për okupatorin dhe t'i japë grushtë: grushte morale, duke sabotuar propagandën e tij gënjeshtarë që bënte me anë të Partisë Fashiste Shqiptare dhe të Luogotenencës, grushte vdekjeje, duke sabotuar aparatit e tij shtypës, aparatit ushtarak me anë të sabotazheve. Populli shqiptar ka qenë gjithmonë gati që të hidhet në zjarr. Mjafton që ai të ketë udhëheqës të vendosur. Shembullat janë konkrete: demonstratat e 28 Nëntorit të 1939-s, ato të 28 Nëntorit të 1941-së e 42-së, sabotimi i luftës kundër Greqisë, demonstratat e 7 prillit, demonstratat e Tiranës dhe të Korçës kundër fashizmit dhe kundër përçarjes së popullit, demonstrata për bukë dhe, veçanërisht, demonstratat e fundit, me rastin e reprezaljeve të Vlorës, që u bënë në Tiranë, Durrës,

Kavajë, Elbasan, demonstrata me rastin e vdekjes së dëshmorit Shenasi Dishnica, që u bë në Tiranë dhe në Fier<sup>1</sup> (dyqanet mbyllen, nëpunësit lënë zyrat, rinia lë shkollat, punëtorët lënë punën, dhe të gjithë së bashku shpërthejnë në demonstrata antifashiste). Në Skrapar dhe në Vlorë katundarët bashkë me çetat luftojnë kundër fuqisë fashiste.

Terrori fashist nuk e ka trembur popullin shqiptar, përkundrazi, urrejtja e tij kundër zaptuesit dhe tradhëtarëve shtohet akoma më tepër. Lufta nacional-çlirimtare dalngadalë merr një karakter të përgjithshëm. Fashizmi ha kudo dru, si në qytet ashtu edhe në fshat.

Në luftën që bën sot populli shqiptar rolin kryesor udhëheqës e luan Partia Komuniste, e cila ka marrë pjesë aktive në këtë luftë dhe nuk ka ndënjur si spektatore duke shikuar të lëvizë masa e popullit. Komunistët kanë qenë në radhët e para, dhe gjaku i dhënë prej këtyre dëshmon vendosjen e tyre për këtë luftë që bën populli shqiptar. Partia Komuniste u bë motori i lëvizjes së popullit kundër zaptuesit dhe tradhëtarëve. Partia, që në formimin e saj, i shpjegoi popullit veprimet dhe qëllimet e fashizmit në Shqipëri. Populli, që gjer atëherë nuk kishte pasur një parti drejtuese ashtu si duhej, përqafoi dhe përvetësoi parullat, direktivat e Partisë Komuniste dhe në bazë të tyre ja nisi luftës. Përpara formimit të Partisë Komuniste as komunistët, as nacionalistët e ndershëm nuk ishin në gjendje të fusnin popullin në lëvizje dhe ta drejtonin në një luftë kundër fashizmit. Mungonte puna organizative e lëvizjes, e domosdoshme për të luftuar ashtu si duhet fashizmin italian...

Internacionalja Komuniste ishte interesuar që me kohë për një veprimtari komuniste në vendin tonë. Pas vitit 1924 shkuan në Bashkimin Sovjetik disa të rinj nga të emigruarit politikë, për t'u edukuar dhe për t'u bërë militantë komunistë, në mënyrë që këta, kur të ktheheshin në vendin e tyre, të bëheshin pionierë të lëvizjes revolucionare të popullit shqiptar kundër imperializmit të huaj dhe feudalizmit të brendshëm. Por pjesa më e madhe që u kthye në Shqipëri i neglizhoi këto detyra, harroi misionin e lartë që i ishte ngarkuar nga proletariati ndërkombëtar. Disa nga këta u bënë oportunistë, socialdemokratë dhe me predikimet e tyre, sjelljet e tyre, veprat e tyre, komprometuan në sytë e popullit punën komuniste. Populli priste nga këta ushqim të shëndoshë, punë komuniste të vërtetë. Një palë tjetër krijoi tarafet, futi në shpirtin e komunistëve të rinj, të etshëm

<sup>1</sup> Është fjala për demonstratat e organizuara në Tiranë dhe Fier në janar të vitit 1943 me rastin e përcjelljes për në qytetin e Fierit të trupit të dëshmorit Shenasi Dishnica, i vrarë nga pushtuesit fashistë në Tiranë më 22 janar 1943.

për punë, frymën e grupit. Vetëm një shok, Ali Kelmendi, që për çështjen komuniste dha jetën e tij dhe emrin e të cilit ne, komunistët, lypset ta mbajmë lart, përhapij vijën e drejtë të Internacionales Komuniste. Vetëm ai e përmbushi detyrën e pionierit komunist ashtu si duhet. Ai kudo që shkonte futej në masat dhe formonte rrethe. Në Korçë hodhi bazat e para për organizimin e një pune me të vërtetë komuniste, duke vënë në lëvizje punëtorinë.

Internacionalja Komuniste edhe një herë tjetër ka pasë dërguar direktiva<sup>1</sup> por fatkeqësisht ato nuk u zbatuan, sepse atëherë ekzistonin grupet, përçarja në mendime, mospregatitja politike e shokëve, kështu që nga disa nuk u pranuan fare dhe nga ata që u pranuan nuk u aplikuan. Pra, shohim se atëherë direktivat u sabotuan nga që nuk gjetën fushë të favorshme. Sot është për herë të dytë që Internacionalja Komuniste na dërgon direktiva, por këto na gjejnë të bashkuar, me kuadro drejtues të shëndoshë, me vijën politike të caktuar dhe të drejtë, me një fjalë, na gjejnë të pregatitur dhe të fortë. Por gjersa t'ja arrinte kësaj gjendjeje Partia Komuniste duhej të kalonte një rrugë plot me pengesa. Partia Komuniste e Shqipërisë mundi të bashkonte grupet, të eliminonte elementët e dobët, grupashët, fraksionistët, oportunistët, të plogët, të edukonte shokët me një vijë politike dhe edukatë të shëndoshë, me shpirt leninist-stalinian, t'i lidhte këta me masën e popullit dhe të bënte veprime (greva, demonstrata, sabotazhe, aksione çetash, agjitacion e propagandë e të tjera) kundër okupatorit. Partia Komuniste u bë shtylla kryesore e Luftës nacional-çlirimtare të popullit kundër fashizmit italian. Komunistët derdhën gjakun e tyre në këtë luftë dhe vazhdojnë ta derdhin. Partia Komuniste arriti të hiqte dyshimin për fitoren, dyshim që e mbillnin zaptuesi, tradhëtarët dhe kolona e pestë me anë të propagandës gënjeshtare dhe të frikës. Partia Komuniste është një parti që ka dalë nga lufta: nga lufta e grupeve dhe nga ajo kundër okupatorit. Nga kjo luftë e dyfishtë shokët komunistë fituan eksperiencë në luftën ideologjike dhe në atë praktike dhe kështu mundën të gjenin rrugën e vërtetë komuniste. Kjo luftë spastroi, forcoi dhe zgjeroi radhët e Partisë, në mënyrë që kjo të bëhej monolite dhe e zonja të drejtë lëvizjen e popullit tonë kundër zaptuesit.

Internacionalja Komuniste, duke parë këtë punë të pastër që bëri Partia jonë, e njohu këtë si pjesëtare të saj. Përpjekjet e shokëve nuk kanë qenë të kota. Pikërisht ne u njohëm, pasi ne punonim në bazë të direktivave të Internacionales Komuniste, e cila sot, me njohjen e saj zyrtare të Partisë Komuniste, vulos

<sup>1</sup> Është fjala për direktivat që i dërgoi Internacionalja Komuniste, lëvizjes komuniste shqiptare në vitin 1937.

punën tonë komuniste. Kjo njohje ka një rëndësi të veçantë sot, mbasi kjo bëhet në një kohë lufte, në një kohë shumë të zorshme, dhe Partia Komuniste, me punën e saj të pastër, të shëndoshë, të drejtë dhe me gjakun e anëtarëve të saj, arriti ta fitojë këtë të drejtë. Lypset të jemi kryelartë për këtë, sepse kjo rrëfen se ne kemi fituar një të drejtë që e kemi merituar. Por prej kësaj të drejte rrjedhin edhe detyrime, dhe detyra më e madhe është të forcojmë radhët e Partisë me kuadro të shëndoshë dhe të veprojmë në bazë të direktivave të Internacionales Komuniste. Të kemi vendosje në punën tonë, se lufta bëhet me vepra dhe jo me fjalë. Armiku është i fortë dhe ne duhet të dimë ta luftojmë dhe të jemi të pregatitur për këtë luftë. Duhet të eliminohen elementët oportunistë, socialdemokratë, fraksionistë, trocistë dhe sabotatorë të direktivave të forumeve më të larta dhe të Internacionales Komuniste. Duhet t'i kemi sytë të hapura karshi elementëve të «Zjarrit» dhe atyreve si Z. F. dhe A. Q. Këta elementë, që dalin gjoja me parulla komuniste, janë shumë herë më të rrezikshëm se armiku direkt. Këta sjellin përçarje në mendimet e shokëve komunistë dhe mosbesim në direktivat e Partisë. Parullat e tyre antileniniste-staliniane, kundër vijës së sotme të Internacionales Komuniste, përçajnë Frontin e përbashkët Nacional-Çlirimtar, duke i ndarë komunistët nga nacionalistët. Ata janë kundër Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar, me parullat e tyre ekstremiste dhe antimarksiste fusin në rrethet e nacionalistëve dyshimin se komunistët nuk luftojnë për çlirimin e Shqipërisë, por për komunizmin; ata nuk njohin luftën e përbashkët që bën sot Bashkimi Sovjetik me demokracitë e mëdha dhe me popujt e tjerë të shtypur; ata nuk njohin koalicionin e përbashkët të gjithë botës mbarë kundër fashizmit, imperializmit më të rrezikshëm dhe më barbar që ka parë bota. Ata, duke ndjekur këtë politikë, bëhen vegla të okupatorit, dhe asnjë marrëveshje nuk mund të bëhet me ta, por, si tradhëtarë që janë, lypset të demaskohen dhe të dënohen si të tillë nga populli.

Nuk na lejohet më në Partinë tonë të gjejnë strehë elementë që duan të prishin punën e Partisë, që duan ta pengojnë Partinë në ecjen e saj në Luftën nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Duhet të jemi vigjilentë dhe të mos kemi asnjë mëshirë për këta elementë, që duan t'u vënë gurë rrotave të Partisë. Dënimin më të madh meritojnë të tillë elementë.

Tani nuk na lejohet më të bëjmë gabime dhe të mos zbatojmë direktivat e dhëna nga forumet më të larta, në të cilat sot, më tepër se kurrë, duhet të kemi besimin më të madh. Sot jemi përgjegjës për veprat tona, jo vetëm përpara popullit shqiptar, por edhe përpara proletariatit ndërkombëtar, përpara Internacionales Komuniste. Vetëm një parti e organizuar dhe e edukuar politikisht në këtë mënyrë mund të jetë e denjë të mbajë emrin



e anëtares së Internacionales Komuniste dhe të meritojë këtë emër. Kjo gjë varet nga ne, nga puna jonë komuniste.

Direktivat që na dërgon Internacionalja Komuniste janë:

1) Organizimi dhe zhvillimi i Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar kundër italianëve dhe gjermanëve.

2) Krijimi dhe forcimi i Frontit Nacional-Çlirimtar me të gjithë patriotët, duke evituar, tani për tani, parullat që dalin jashtë kuadrit nacional-çlirimtar të Shqipërisë.

3) Me futë në udhëheqjen e luftës partizane, përveç komunistëve, sa më shumë patriotë dhe nacionalistë të ndershëm shqiptarë.

Duke i analizuar këto direktiva shohim se këto na rrëfejnë rrugën tonë të tanishme, detyrat tona të afërme, na hapin perspektiva të gjera për t'u futur në masë dhe për të mobilizuar gjithë popullin shqiptar kundër zaptuesit. Duhet që këtë luftë ta organizojmë dhe ta bëjmë tok me popullin, se Partia jonë është një parti e popullit, që ka në programin e saj mbrojtjen e interesave të tija. Ta mobilizojmë popullin, ta fusim në lëvizje dhe të gjitha energjitë e tija revolucionare t'i drejtojmë kundër një objekti të caktuar të përbashkët: kundër zaptuesit, kundër fashizmit italian dhe atij gjerman. Lufta nacional-çlirimtare nuk është një luftë kuadrosh, por një luftë masash të gjera të frymëzuara dhe të drejtuara nga Partia. Këtu shohim se Partia Komuniste, si pararojë e kësaj lufte, si pjesa më koshiente e popullit shqiptar, ka një detyrë delikate, atë të udhëheqjes të të gjithë popullit, bashkë me pjesën nacionalistë koshiente dhe të vendosur. Partia e ka në ballë të programit të saj Luftën nacional-çlirimtare dhe derdh të gjitha energjitë e saja për zhvillimin, organizimin dhe drejtimin e gjithë forcave antifashiste të popullit tonë kundër okupatorëve italianë e gjermanë. Populli e urren okupatorin, dhe ne lypset ta mobilizojmë, si edhe të gjitha tendencat politike të nacionalistëve të ndryshëm, kurse ato forca që nuk mund t'i mobilizojmë, duhet t'i neutralizojmë. Asnjë rezervë forcash nuk lypset të mbetet në duart e okupatorit. Zaptuesi duhet të izolohet dhe të luftohet me tërbimin më të madh, dhe për këtë, urrejtjen që ka populli, duhet ta kthejmë në një luftë të hapur kundër fashizmit. Populli shqiptar e do lirinë dhe nuk është kursyer gjatë historisë së tij, siç është thënë më lart, të luftojë imperializmin e huaj që ka dashur ta skllavërojë vendin tonë. Ai urren fashizmin italian si armik direkt, por edhe nazizmin gjerman, si armik bashkëpunues i të parit. Të dy duhen demaskuar. Partia Komuniste e Shqipërisë që në fillim e kuptoi rëndësinë që ka Lufta nacional-çlirimtare për edukimin politik të popullit, për çlirimin e tij nga fashizmi. Por për t'ja arritur këtij qëllimi të fundit më përpara duhet të thyhen zinxhirat që i ka hedhë popullit fashizmi, dhe këto zinxhira mund të këputen

vetëm me anë të Luftës nacional-çlirimtare, që bashkon të gjitha forcat luftuese të popullit. Revolucioni bolshevik, na thotë Stalini, nuk do të kishte triumfuar, në qoftë se proletariati rus nuk do të kishte simpatinë dhe ndihmën e popujve të shtypur nga regjimi carist. Por për të fituar këtë simpati dhe ndihmë të tyre i duhej më përpara të këpuste zinxhirat dhe t'i shpëtonte nga thundra e imperializmit carist, armik i përbashkët. Kështu që e mundur të vendosej rendi sovjetik dhe të krijohej ai organizim i mrekullueshëm i bashkëpunimit të të gjithë popujve që quhet URSS. Edhe sot, në qoftë se popujt e shtypur nuk luftojnë armikun e përbashkët, armikun më të rrezikshëm, fashizmin, kurrë nuk do të mundin të fitojnë lirinë e tyre, dhe proletariati ndërkombëtar kurrë nuk do të mundë të bëjë revolucionin e vet. Dhe populli shqiptar kurrë nuk do të mundë të fitojë lirinë e tij, në qoftë se nuk zhduk më përpara fashizmin, armikun e përbashkët që shtyp fshatarin, punëtorin, intelektualin, tregëtarin dhe kapitalistin e vogël, me një fjalë, popullin. Partia Komuniste e Shqipërisë kurrë nuk do të mundë të përmbushë programin e saj maksimal, në qoftë se më përpara nuk shfaros fashizmin që shtyp popullin, që nuk e lë të zhvillohet ekonomisht, politikisht dhe nuk i jep liri.

Ja, pra, rëndësia e Luftës nacional-çlirimtare për popullin shqiptar dhe për Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Organizimi dhe zhvillimi i Luftës nacional-çlirimtare bëhen me mobilizimin e popullit në çështje konkrete dhe aktuale, çështje që e prekin drejt për së drejti dhe që ai i ka parasysh ditë për ditë, në çështje, për të cilat ai është gati të bëjë çdo sakrificë. Duhet që gjithë vëmendja e tij, gjithë vullneti i tij, të gjitha energjitë e tija, të koncentrohen rreth një objekti të caktuar dhe të pasqyruar me të gjitha karakteristikat e tija në luftën kundër fashizmit barbar dhe skllavërues, kundër tradhëtarëve, veglave të tija, kundër fashizmit, që i rrëmben popullit bereqetin, tokën, mallin, shtëpinë, tregëtinë dhe e lë pa bukë.

*Mobilizimi i gjithë forcave patriotike duhet të bëhet nga poshtë dhe nga lart.*

*Nga poshtë* katundaria duhet të zërë vendin e parë. Ajo është klasa më e madhe e popullit tonë, por edhe më e vuajtura, që dita-ditës është në rrezik të varfërohet nga fashizmi, i cili rrëmben bereqetin dhe tokën. Fashizmi shumë herë e ka shfrytëzuar atë, duke përfituar nga mosditja e saj, si rezervë forcash kundër Luftës nacional-çlirimtare (p.sh. milici, fuqi bashibozuke etj.). Ajo duhet të bëhet shtylla kryesore e luftës, fuqitë e saja janë shumë të mëdha, por vetëm se ajo duhet të vihet në lëvizje, duhet t'i shpjegohet kjo luftë dhe ta kuptojë atë. Nuk kemi punuar aq sa duhet me fshatarësinë, nuk kemi lodhur këmbët që të vemi në fshat dhe t'ua qajmë hallet sa duhet katundarëve.

Kemi punuar nëpër qendrat, por jo në rrethet, në katundet, që në shumë vende i kemi lënë mbas dore. Atje ku kemi vajtur dhe ku kemi ditur të punojmë, kemi pasur simpatinë dhe ndihmën më të madhe. Katundari ynë është i mirë, i ndershëm dhe revolucionar, mjafton që ne të dimë se ku ta prekim për të zgjuar në shpirtin e tij interesimin për Luftën nacional-çlirimtare. Duhet t'i shpjegojmë se shkaktari i vuajtjeve të tija tani është fashizmi, dhe vetëm me zhdukjen e këtij ai do të mundë të përmirësojë gjendjen e tij ekonomike.

Masat punëtore nuk kemi ditur t'i grumbullojmë dhe t'i organizojmë. Partia Komuniste e Shqipërisë duhet të jetë një parti punëtorësh dhe katundarësh, që janë elementët më të vendosur për çështjen tonë. Ne, që të mund t'i mobilizojmë punëtorët, duhet t'i afrojmë, duhet të bëjmë jetën e tyre, të rrojmë me ta dhe bashkë me ta të shkojmë përpara kundër fashizmit. Punëtori vuan nga fashizmi, i cili e lë pa punë, e hedh në rrugë dhe sot, më tepër se kurrë, e lë pa bukë. Mundësitë e punimit me klasën punëtore janë shumë të mëdha, sepse ajo është klasa që e ndjen më tepër se kushdo tjetër Luftën nacional-çlirimtare. Ajo duhet të marrë pjesë aktive dhe udhëheqëse.

Intelektualët e shohin me simpati lëvizjen tonë, por një pjesë është oportuniste dhe shumë herë është bërë vegël e okupatorit, duke u tërhequr nga jeta e rehatillëkut, por nuk lypset të harrojmë se një pjesë qëndron në krye të lëvizjes dhe është e vendosur që ta luftojë fashizmin. Fashizmi e ka shtypur intelektualizmin e vërtetë. Intelektuali që kërkon liri mendimi, liri veprimi, duhet të jetë i pari për këputjen e zinxhirave të fashizmit, helmuës i mendjes dhe korruptues i shpirtit. Intelektualët akoma nuk kanë një ide të qartë mbi lëvizjen tonë, dhe detyra jonë është që t'i afrojmë, t'i sqarojmë aty ku janë të errët, t'u rrëfejme rrugën e vërtetë që duhet të ndjekë sot një intelektual i ndershëm shqiptar. Energjitë, të shpërndara dhe me drejtime shumë herë të pacaktuara të intelektualëve tanë, duhet t'i kanalizojmë dhe t'i drejtojmë kundër një objekti të caktuar, kundër fashizmit, armikut më të madh të zhvillimit të mendjes.

Rinia është bërë flamurtare e luftës së sotme. Ajo është e para që e tundi zgjedhën e okupatorit. Shpirti i saj i njomë nuk mundi të duronte atmosferën mbytëse dhe korruptuese, ku deshi ta hidhte fashizmi. Ajo nuk deshi të pranonte të bëhej lodër e okupatorit. Asaj kurrë nuk i është trembur syri dhe kudo është hedhur me zell dhe me vetëmohim të pashoq. Ajo bëri sakrificat më të mëdha dhe dha heronj të një epepeje të re shqiptare. Lufta për çlirimin e atdheut i është rrënjësuar në shpirt, i është bërë një besim, një ideal.

Rinia e qendrave, dhe më tepër ajo shkollore, pothuajse është e mobilizuar e tëra. Edukata fashiste, në vend që ta degje-

neronte dhe ta hidhte në korupsion, përkundrazi, e revoltoi atë dhe demaskoi propagandën gënjeshtare fashiste, e cila u mundua që të zhdukte ndjenjat kombëtare.

Rinia punëtore, që sot shfrytëzohet në kulm prej sistemit fashist, nuk është grumbulluar dhe organizuar ashtu si duhet, megjithëse është kurdoherë gati, e vendosur dhe me disiplinë proletare për çdo veprim.

Rinia fshatare, në përgjithësi, ka mbetur pas, dhe ky është faji i shokëve, të cilët nuk janë interesuar, nuk i kanë dhënë rëndësinë e duhur. Rinia fshatare mund të lozë një rol kryesor në luftën e çetave; ajo, bashkë me gruan fshatare, do të jetë ndihma më e shëndoshë për luftëtarët e lirisë.

Gruaja shqiptare është e shtypur nga fashizmi, nga traditat dhe ligjet borgjeze e feudale; ajo e ndjen më tepër se kushdo tjetër luftën tonë, në të cilën ajo sheh edhe çlirimin e saj; ajo është gati të bëjë çdo sakrificë për burrin e saj, për vëllanë e saj, për djalin e saj që luftojnë. Me ndihma, me rolin e saj si infermiere dhe me armë, siç është bërë në Bashkimin Sovjetik, do të arrijë të lozë një nga rolet kryesore në Luftën nacional-çlirimtare. Duhet të formojmë frontin e përbashkët antifashist të gruas shqiptare. Si punojnë shoqet tona ashtu duhet të punojnë edhe gratë e popullit, sepse edhe ato e ndjejnë këtë luftë.

*Mobilizimi nga lart* mund të bëhet, duke u bashkuar me të gjitha tendencat politike antifashiste. Disa nga nacionalistët, pas ardhjes së Italisë në Shqipëri, ndenjnë pak a shumë pasivë karshi përhapjes së influencës fashiste, por të tjerë morën një qëndrim aktiv kundër fashizmit, duke ndihmuar lëvizjen nacional-çlirimtare, të filluar nga rinia, e cila dha shenjat e para të një rezistence aktive me anë demonstratash. Lufta italo-greke e rrëzoi prestigjin e fuqisë fashiste në sytë e popullit dhe të nacionalistëve, dhe këta filluan ta kuptojnë më qartë lëvizjen antifashiste. Me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftë, lufta imperialiste, që u shpërthye nga fashizmi, mori një karakter tjetër, një karakter çlirimtar. Bashkimi Sovjetik bënte një luftë mbrojtjeje të tokave të tija, dhe rezistenca e tij kundër gjermanëve ngjalli shpresa të mëdha fitimi në popujt e shtypur. Partia Komuniste e filloi hapur luftën kundër okupatorit, dhe pjesa e ndershme nacionaliste e ndihmoi me vendosje këtë luftë. Nacionalistët panë se i vetmi shpëtim për Shqipërinë ishte që populli shqiptar të bashkohej dhe të luftonte okupatorin, siç bënin edhe popujt e tjerë të shtypur, dhe kjo luftë të shkonte paralel me atë që bënin Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë e mëdha. Parulla e dikurshme «s'ka ardhur koha», që ishte bërë motoja e disave, që hiqeshin si nacionalistë, mori fund. Partia Komuniste e nisi luftën dhe shkonte përpara me hapa të mëdha. Parullat e saja gjënin simpati në popull, sepse ato shprehnin dëshirën e tij. Disa



nacionalistë na akuzuan si ekstremistë, se gjoja ne shkonim shumë në të majtë dhe disa nga këta gjetën këtë pikë si shkak justifikimi për mosmarrje pjesë aktive në Luftën nacional-çlirimtare bashkë me Partinë Komuniste. Nacionalistët e ndershëm simpatizuan Partinë tonë, lëvizjen tonë, vendosjen tonë për të luftuar fashizmin. Sa për parullat, për të cilat na akuzonin si ekstremistë, Partia Komuniste i ka hedhur këto:

1) — për të forcuar kuadrot që sapo dilnin nga lufta e grupeve, në mënyrë që të formohej një ndërgjegje me të vërtetë komuniste.

2) — për t'i dhënë popullit të kuptojë se ç'është komunizmi, Bashkimi Sovjetik, Ushtria e Kuqe, shoku Stalin, meqenëse komunistët e grupeve kishin punuar me maskë dhe puna komuniste nuk ishte popullarizuar në popull. Ishte i nevojshëm ky popullarizim, që t'i hiqeshin nga mendja popullit të gjitha ato paragjykime antikomuniste, që klasa borgjeze dhe fashizmi ja kishin futur në tru, dhe populli të fitonte besim në fitoren e popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të merrte si bazë për Luftën nacional-çlirimtare të tij shembullin e Bashkimit Sovjetik.

Gjendja ndërkombëtare dalngadalë ndryshonte në favor të aleatëve. Brenda në Shqipëri fillojnë sabotazhet, aksionet, veprimet e çetave partizane (aksioni i parë i Skraparit). Lufta nacional-çlirimtare merr një hov të gjerë. Gjendja u poq për krijimin e një Fronti të përbashkët Nacional-Çlirimtar, gjë që pjesa më e vendosur e nacionalistëve e gjeti të favorshme. Me iniciativën e Partisë delegatët e ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, përfaqësuesit e të gjitha tendencave të nacionalizmit shqiptar, të Partisë Komuniste të Shqipërisë, të rinisë nacionaliste, të Rinisë Komuniste dhe të rinisë popullore femërore shqiptare, të udhëhequr nga qëllimi i shenjtë për çlirimin e Shqipërisë nga thundra e Italisë fashiste dhe nga tradhëtarët e shitur tek i huaji, mbasi shqyrtuan mirë situatën e jashtme dhe gjendjen në Shqipëri dhe, veçanërisht, mbasi theksuan dëshirën dhe nevojën për organizimin e gjithë energjive, për bashkimin e plotë të tyre në Luftën nacional-çlirimtare zgjodhën Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar (të përkohshëm), i cili merrte përsipër krijimin e këshillave në të gjitha krahinat. Rëndësia e kësaj konference ka qenë e madhe, sepse bashkoi popullin në luftë kundër okupatorit. Shembullin e Pezës duhet ta vazhdojmë. Ai që hapi i parë dhe tani duhet të hedhim hapin e dytë, që kështu të shkojmë përpara. Ai që kontakti i parë me nacionalistët dhe përfitimet kanë qenë të mëdha. Masat popullore u futën në lëvizje, nacionalistët, që gjer dje rrinin inaktivë, filluan të na afrohen dhe të simpatizojnë lëvizjen tonë. Rrethi i simpatizantëve dhe i miqve tanë u shtua, lëvizja u zgjerua më tepër dhe mori një karakter të përgjithshëm. Shumë mosmarrëveshje dhe keqkuptime midis

nacionalistëve dhe Partisë Komuniste u sqaruan, dhe populli nuk e sheh më komunizmin si një gogol dhe komunistët si njerëz «pa atdhe», siç don t'i prezantojë fashizmi. Ky që hapi i parë për krijimin në formë organizative të frontit të përbashkët. Ky që një sukses i madh politik për Partinë Komuniste, megjithëse ky nuk u konkretizua siç duhej, sepse të gjithë nacionalistët nuk binin dakord në mes tyre dhe një pjesë e këtyre dyshonin në fitoren e frontit antifashist (ofensiva gjermane e verës).

Këshillat kanë një rëndësi të madhe për luftën, ato janë organet më demokratike dhe mobilizojnë gjithë popullin e çdo kategorie dhe të çdo tendence në luftën kundër fashizmit.

Ja se si i përkufizon rezolucioni i Konferencës së Pezës:

«Ndër vendet e paçliruara këshillat janë organe lufte, bashkojnë të gjitha forcat popullore çlirimtare, bëjnë agjitacion dhe propagandë, udhëheqin luftën politike kundër armikut okupator, mobilizojnë masat popullore për luftën çlirimtare dhe njëkohësisht bëjnë mobilizimin material të sendeve të nevojshme për luftën; këshillat do të jenë *këshilla masash të gjera*, që të grumbullojnë turma të gjera popullore. Këshillat sigurojnë armë për partizanët dhe vullnetarët e lirisë dhe i mbajnë me ushqime. Popullarizojnë Luftën nacional-çlirimtare, lajmërojnë lëvizjet e armikut, fuqinë e tij, e të tjera. Këshillat formojnë dhe organizojnë shtypin, propagandën, agjitacionin, organizojnë sabotazhin (beteqet, të dhjeta, lesh, etj., çdo ndërhyrje të okupatorit, banka, shoqëri anonime, monopole, shoqëri bujqësore). Luftë të organizuar kundër bankës bujqësore, kundër shoqërive anonime, që kërkojnë t'i rrëmbejnë tokën fshatarit, luftë kundër atyre që u japin toka dhe koncesione të ndryshme italianëve, luftë kundër gjithë agjentëve përfitues në kurriz të popullit me ndërmjetësim të okupatorit. Këshillat demaskojnë të gjithë përfituesit dhe ndërmjetësit e okupatorit, popullarizojnë kryengritjen e përgjithshme si një etapë të fundit, si një rrjedhje të luftës partizane, organizojnë dhe pregatisin opinionin publik, burra dhe gra. të rinj dhe të reja.

Në tokat e çliruara këshillat nacional-çlirimtare bëjnë detyrën qeveritare, por jo atë ushtarake. vënë rregullin dhe qetësinë, bëjnë luftë kundër tradhëtarëve, bëjnë kontrollin e qarkullimit të personave, luftojnë kriminalitetin, vjedhjen etj. Në bashkëpunim me organet ushtarake, këshillat bëjnë luftë kundër kolonës së pestë, kujdesohen për ekonominë dhe ushqimin e popullit, organizojnë tregëtinë dhe financat, sigurojnë ushqimet dhe gjërat e nevojshme për çetat partizane dhe njësitë vullnetare, zhvillojnë arësimin dhe punën e edukatës popullore, shumojnë dhe grumbullojnë materialin për propagandë dhe agjitacion, si shtypshkronja, radio etj. Bëhet mobilizimi politik për Luftën nacional-çlirimtare. forcohet fuqia e këshillave dhe luftohet çdo armik e çdo rrezik. Për disa gjëra bëjnë gjuqje të vogla dhe veçanërisht



duhet që këto këshilla të pajtojnë gjaqet, sidomos sa kohë që është okupatori në vendin tonë. *Rëndësia e këshillave nacional-çlirimtare është e madhe.* Me anë të këtyre bëhet qeveria, mobilizohet populli në luftë e në kryengritje. Ja, pra, *rëndësia e tyre*».

Shohim, pra, se Partia Komuniste e Shqipërisë ka zbatuar pikërisht direktivat e Internacionales Komuniste për të krijuar dhe forcuar Frontin Nacional-Çlirimtar me të gjithë patriotët shqiptarë, megjithëse suksesi nuk qe i plotë. Vetëm kur të arrijmë të organizojmë gjithë masën e popullit mund të themi se e kemi përmbushur direktivën e Kominternit. Sot kemi një grup nacionalistësh, që quhet «Balli Kombëtar». Këtu janë grumbulluar njerëz nga të gjitha tendencat politike, por akoma nuk ekziston një organizim i shëndoshë. Aty ka njerëz, nga të bazës, që duan ta luftojnë me gjithë mend fashizmin, që e kanë kuptuar rëndësinë e Luftës nacional-çlirimtare, ka edhe të tjerë që nuk kanë një vendosje të fortë dhe pak a shumë anojnë nga oportunitizmi dhe okupatori. Detyra jonë është që të bisedojmë me këta, t'i bindim për bashkëpunim dhe për një luftë direkte kundër okupatorit.

Ka nacionalistë që janë të izoluar dhe që akoma s'e kanë kuptuar Luftën nacional-çlirimtare. Ne duhet t'i afrojmë, t'u shpjegojmë atyre luftën tonë dhe t'i bindim që të hidhen në luftë.

Ka zogistë, dhe me këta lypset të bëjmë politikë afrimi dhe bashkëpunimi.

Është kleri katolik, i cili është i organizuar dhe përfaqëson një fuqi politike pak a shumë nën influencën e okupatorit. Puna jonë e do që ne t'i afrojmë, t'u zgjasim dorën dhe t'i bindim për bashkëpunim të gjithë ata elementë që e kanë kuptuar rolin e poshtër të okupatorit dhe janë të vendosur ta luftojnë.

Kemi edhe grupin e «Zjarrit», për të cilin janë dhënë shpjegime më lart.

Kemi filogjermanët, të cilët lozin rolin e kolonës së pestë dhe të përçarjes së Frontit Nacional-Çlirimtar. Këta duhet t'i demaskojmë si fashistë, si tradhëtarë të shitur tek armiku.

Shohim, pra, se rrethi është i gjerë dhe kërkon punë me mend, me vullnet dhe me vendosje. Komunistët duhet të marrin pjesë aktive në këtë luftë dhe t'u shpjegojnë të gjithëve përse luftojnë. Ata kanë një gjuhë të sqartë dhe të vërtetë për të gjithë: luftojnë për çlirimin kombëtar nga armiku i përbashkët, fashizmi, për vetëvendosjen e popullit, për një Shqipëri Demokratike Popullore. S'duhet të dalim me parulla ekstremiste, me parullat e revolucionit komunist, por me parulla nacional-çlirimtare, përndryshe do të sjellim përçarje në frontin e përbashkët. Komunistët luftojnë sot për lirinë e Shqipërisë dhe jo për komunizmin. Sot dalim me parulla nacional-çlirimtare, pa e humbur individualitetin e Partisë. Duhet të popullarizojmë veprat

tona, heronjtë tanë dhe Bashkimin Sovjetik, si pararojë e luftës çlirimtare të popujve të shtypur. Parullat tona të jenë parulla të zgjeruara, plot kuptim, të qarta, por gjithmonë brenda kuadrut nacional-çlirimtar. Po japim disa shembulla:

Rroftë bashkimi i popullit shqiptar në luftë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve të vendit!

Vdekje okupatorit fashist dhe tradhëtarëve të atdheut tonë!  
Jashtë zaptuesi fashist!

Rroftë lidhja me besa-besë e popullit shqiptar kundër zaptuesit!

Rroftë vëllazërimi i popujve të robëruar në luftë kundër okupatorit!

Rroftë Ushtria Nacional-Çlirimtare e Partizane Vullnetare e lirisë!

Rroftë aleanca e madhe antifashiste!

Rroftë Fronti Antifashist Nacional-Çlirimtar!

Rroftë Shqipëria e lirë dhe demokratike!

Rroftë Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar!

Rroftë PKS, luftëtarja e vërtetë për çlirimin e Shqipërisë!

Rroftë Bashkimi Sovjetik, flamurtari i luftës kundër fashizmit për çlirimin e popujve të robëruar!

Këto janë parullat nacional-çlirimtare, parulla të zgjeruara, por që ndryshojnë nga ato të nacionalistëve shovinistë, dhe Partia nuk e humbet personalitetin e saj. Ne duhet të zgjojmë në shtresat e gjera të popullit (katundarë, punëtorë etj.) interesin më të madh për parullat dhe për luftën tonë. Kur të na pyesin se ç'është Partia Komuniste, ç'është komunizmi dhe si do të vendoset këtu në Shqipëri, ne duhet t'u japim përgjegjen tonë komuniste për t'u shpjeguar hallet e tyre dhe për të gjetur ilaçin. Ne nuk jemi oportunistë dhe nuk i kemi harruar aspak detyrat tona më të largëta, por përpara se të arrijmë në atë fazë duhet të plotësojmë detyrat tona më të afërta: Luftën nacional-çlirimtare.

Roli i Partisë në këtë luftë duhet të jetë frymëzues, udhëheqës, jo me fjalë dhe me dekrete, por me punë konkrete, duke u futur në masat, në jetën e tyre praktike dhe duke u afruar me nacionalistët. Komunistët duhet të jenë në radhë të parë trim, të vendosur dhe me vijë politike të qartë për çështjet aktuale që i interesojnë popullit. Partia është shtylla kryesore e Luftës nacional-çlirimtare, por edhe nacionalistët e ndershëm dhe të vendosur duhet të marrin pjesë aktive në udhëheqjen e kësaj lëvizjeje. Partia Komuniste, bashkë me nacionalistët, si një blok i vetëm antifashist, me vijë dhe qëllime të caktuara do të prijnë popullin në luftën kundër okupatorit. Gjendja e sotme politike e jashtme, si dhe ajo e brendshme, është shumë e favorshme për një bashkëpunim të ngushtë me nacionalistët. Në frontin sovjetik Ushtria e Kuqe po del e fortë më tepër se kurrë, dhe ofensiva e saj po merr përpjesëtime të mëdha dhe katastro-

fike për nazizmin gjerman dhe këlyshët e tij. Kudo në Evropë popujt e shtypur po marrin frymë dhe po fillojnë lëvizjen kryengritëse. Qeverive kukulla dhe tradhëtarëve po u dridhen këmbët. Në Mesdhe perandoria fashiste mori fund, fuqitë aleate janë gati për të likuiduar forcat italo-gjermane në Tunizi dhe kërcënimi kundër Italisë bëhet më i afërt dhe më i rrezikshëm. Gjendja e brendshme ka bërë ndryshime të mëdha. Qeveria e Mustafa Krujës, qeveri e tmerrit fashist, jep dorëheqjen ngaqë nuk i bën dot ballë situatës së krijuar në saje të Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Fashizmi e humbet kontrollin e timonit dhe vret njerëzit e tij. Ai fillon reprezaljet, që kështu të mundë, me anë të frikës, të ndalojë luftën kundër tij. Por edhe këtu falimenton, sepse populli nuk trembet (demostratat e fundit). Qeveria e re, e shtyrë nga Luogotenenca, përpigjet me anë të kompromiseve të përçajë frontin e përbashkët. Këto janë shenja dobësie të fashizmit italian dhe të tradhëtarëve, dhe populli e ka kuptuar këtë lodër dhe ai, më tepër se kurrë, gjendet i vendosur për të luftuar armikun. Demonstratat e fundit provojnë se populli është i bashkuar dhe është gati të luftojë. Kjo shtytje për bashkëpunim, që vjen nga poshtë, sigurisht që do të influencojë mbi ata nacionalistë që e heqin punën zvarrë, hiq e mos këput. Bashkimi nga poshtë do të sjellë vetëvetiu, në qoftë se ne dimë të punojmë, bashkimin edhe nga lart, kështu që lufta çlirimtare do të marrë një karakter të përgjithshëm.

Kjo luftë bëhet me anë të njësiteve guerrile, të çetave partizane dhe vullnetare. Roli i çetave partizane është kolosal. Një burim i tyre janë anëtarët e Partisë. Komunistët janë në vijë të parë, por çeta duhet të ketë sa më shumë njerëz të popullit dhe nacionalistë; ajo nuk është ushtri e Partisë, por e popullit. Në çetë ekziston celula dhe komisari politik, por kjo nuk do të thotë se çeta partizane duhet të mbetet një çetë kuadrosh. Në çetë komunistët luftojnë jo vetëm me pushkë, por edhe me penë, me agjitacion, me propagandë dhe me konferenca. Çeta mobilizon popullin, mobilizon fshatarësinë dhe mbron interesat e saja. Komunistët duhet të lozin një rol drejtues në bazë të Luftës nacional-çlirimtare, por me bindje, me siguri, me disiplinë, me qartësi politike dhe jo me aventura, kështu që këta të fitojnë simpatinë e gjithë pjesëtarëve të çetës dhe të rrethit ku ajo vepron. Çeta duhet të ketë një karakter popullor dhe, për t'ja arritur këtij qëllimi, duhet të fusim, na thotë direktiva, në udhëheqjen e luftës partizane, përveç komunistëve, sa më shumë patriotë dhe nacionalistë të ndershëm shqiptarë. Në Konferencën e Pezës u pranua se shtabi madhor do të dilte prej luftës nga elementë komunistë dhe nacionalistë të vendosur për luftë. Partia ka organizuar çeta, por këto nuk përmbajnë sa duhet nacionalistë. Çetat duhet të jenë të popullit, në to lypset të futen

të gjithë ata që duan të luftojnë pa dallim tendencash politike, dhe nga çetat të hidhemi më vonë në ushtri popullore, kur lufta do të bëhet dhe me truparmatë. Në shtabet madhore të marrin pjesë nacionalistë të ndershëm që kështu lëvizja të marrë një karakter të përgjithshëm. Komunistët nuk duhet të shkojnë me prapamendime. Populli i njuh se kush janë komunistët dhe e di se ata dalin me ballë të hapur; këta nuk duhet të kenë ndrojtje nga nacionalistët e vendosur, por, përkundrazi, midis luftëtarësh që përpigjen për një qëllim të përbashkët, duhet të ekzistojë sinqeriteti më i madh. Lufta e përbashkët, gjaku i derdhur së bashku, do të na japin besim njëri tek tjetri dhe do të na çojnë përpara gjer në fitoren e popullit kundër zaptuesit. Shohim, pra, se detyrat e komunistëve janë të mëdha dhe nga ata kërkohet punë e jo fjalë. Për t'i realizuar të gjitha këto direktiva që na dërgon Internacionalja Komuniste duhet të jemi të organizuar mirë, me pikëpamje të qarta, duhen hedhur jashtë Partisë të gjithë ata që nuk e kuptojnë vijën e Luftës nacional-çlirimtare dhe që sabotojnë këto direktiva. Pa formimin e frontit të përbashkët është e pamundur që t'ja arrijmë fitores, pa këtë front, fashizmi do të na izolojë dhe do të gjejë mundësinë pastaj që të na shkatërrojë. Këto direktiva, që kanë për qëllim t'i afrojnë nacionalistët dhe jo t'i largojnë, duhet të zbatohen pikë për pikë. Të demaskojmë dhe të luftojmë vetëm ata që bëjnë lodrën e okupatorit. Me nacionalistët duhet të kemi një sjellje dhe vijë politike të tillë që me parullat tona të mos i ofendojmë kurrë idetë dhe principet e tyre. Duhet të dimë se Lufta nacional-çlirimtare është jeta jonë e sotme dhe e ardhme dhe pa atë nuk mund të shkojmë përpara, por, përkundrazi, do të shkatërrohem. Këto direktiva duhet të zbatohen plotësisht, sepse është rrezik të shkohet në vëllavrasje, të përçahet populli në dy kampe, në njërin komunist dhe në tjetrin nacionalist; kjo është e keqja më e madhe që mund t'i bëjmë popullit tonë, Partisë dhe çështjes sonë, për të cilën luftojmë. Fashizmi përçarje kërkon dhe atë po mundohet ta bëjë; ai e di se një popull të bashkuar, të vendosur për luftë asgjë nuk mund ta trembë dhe ta shkatërrojë, as edhe masat më barbare, si p.sh. reprezaljet etj. Prandaj duhet t'i vihem me tërë vendosjen tonë zbatimit të këtyre direktivave kaq të qarta dhe të drejta, që na dërgon Internacionalja Komuniste, dhe të jemi të sigurt se, po t'i zbatojmë këto, do të shkojmë gjithmonë përpara, Partia do të forcohet, fashizmin do ta zhdukim, populli do të fitojë lirinë e tij dhe nesër do të jemi në gjendje për të përmbushur programin tonë maksimal.

Botohet sipas kopjes së  
daktilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë:  
«Enver Hoxha. Vepra, vëllimi 1». Tiranë, 1968

## KONFERENCA E PARË E VENDIT E PKSH

Mars 1943

Konferenca e parë e Vendit e PKSH u mbajt në Labinot afër Elbasanit më 17-22 mars 1943. Në konferencë muarën pjesë 70 delegatë e të ftuar. Delegatët qenë zgjedhur në konferencat qarkore të Partisë, të cilat ishin zhvilluar gjatë shkurtit e në fillim të marsit. Ata përfaqësonin afër 700 anëtarë partie.

Vendimi për thirrjen e Konferencës së parë të Vendit të PKSH qe marrë që në Konsultën e parë të Aktivit të Partisë në prill 1942. Nuk qe e mundur që të thirrej më parë konferenca për arsye se Partisë ju desh në këtë kohë të angazhohej në një luftë të ashpër kundër fraksionistëve me Anastas Lulën dhe Sadik Premten në krye, të shkatërronte fraksionin dhe të forconte unitetin ideologjik dhe organizativ të Partisë.

Kjo u arrit pas Konferencës së Jashtëzakonshme të Partisë, e cila u mbajt në qershor 1942.

Për thirrjen e Konferencës së parë të Vendit KQ i PKSH kërkoi aprovimin e Internacionales Komuniste. Aprovimi erdhi në dhjetor të vitit 1942; njëkohësisht Kominterni i dërgoi Partisë sonë edhe direktivat në lidhje me Luftën nacional-çlirimtare në vendin tonë.

Rendi i ditës së konferencës ishte: 1. Raporti organizativ, 2. Raporti politik, 3. Lufta nacional-çlirimtare, 4. Ushtria Nacional-Çlirimtare, 5. Zgjedhja e Komitetit Qendror. Përveç këtyre ai kishte edhe këto nënpika: Bashkimi luftarak i punëtorëve dhe i fshatarëve; gruaja dhe roli i saj në Luftën nacional-çlirimtare; rinia; teknika; financa; konspiracioni.

Shoku Enver Hoxha në konferencë mbajti raportin organizativ.

Konferenca aprovoi njëzëri vijën e drejtë dhe gjithë veprimtarinë e KQ të Përkohshëm të PKSH si dhe luftën e vendosur dhe parimore të tij për shkatërrimin e fraksionit të Anastas Lulës dhe Sadik Premtes.

Si në vlerësimin e çështjeve që u ngritën në konferencë ashtu dhe në marrjen e vendimeve u vërtetua një unitet i plotë. Konferenca u zhvillua nën flamurin e marksizëm-leninizmit dhe tregoi se Partia jonë e re brenda një viti e ca që ishte krijuar kishte mundur të siguronte unitetin e saj të mendimit dhe të veprimit dhe të arrinte suksese shumë të mëdha në lidhjen e saj me masat, në krijimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë,

në mobilizimin dhe bashkimin e popullit shqiptar në Luftën nacional-çlirimtare, në përgatitjen e forcave të armatosura të popullit shqiptar. Në mënyrë të veçantë u theksua në konferencë besnikëria e Partisë sonë ndaj marksizëm-leninizmit si dhe dashuria e pakufishme e Partisë dhe e popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë së Kuqe çlirimtare.

Konferenca vuri për detyrë të forcohej akoma më shumë lidhja e luftës sonë me atë të Bashkimit Sovjetik.

Konferenca e parë e Vendit e PKSH vendosi krijimin e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare. Në bazë të këtij vendimi më 10 korrik 1943 u krijua Shtabi i Përgjithshëm i UNÇI.

Konferenca zgjodhi Komitetin Qendror të PKSH me 15 anëtarë dhe 5 kandidatë. Shoku Enver Hoxha u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i PKSH.

Konferenca e parë e Vendit pati një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për forcimin e gjithanshëm të Partisë dhe për zgjerimin e Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar.



## REZOLUCIONI I KONFERENCËS SË PARË TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

17 mars 1943<sup>1</sup>

### REZOLUCION

#### I KONFERENCËS SË PARË TË VENDIT TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

I

Jemi në vitin e katërt të luftës botërore, e cila e nisur me karakter imperialist, u shndërrua në luftë nacional-çlirimtare, pas sulmit tradhëtar të Gjermanisë naziste dhe të satelitëve të saj kundër Bashkimit Sovjetik, kundër atdheut të punëtorëve dhe të fshatarëve, vendit ku popujt jetojnë të lirë dhe të lumtur, ku janë zhdukur klasat, ku është zhdukur shfrytëzimi i njeriut prej njeriut dhe shtypja e kombit prej kombit, kundër vendit që kishte shfaqur politikën e tij paqedashëse në Lidhjen e Kombeve, në pakte mossulmimi, në pakte ndihme reciproke kundër agresorëve dhe në pakte miqësie. Bashkimi Sovjetik ka mbrojtur gjithmonë interesin e popujve të vegjël, pa ndërhyrje në çështjet e tyre të brendshme. Me plasjen e luftës së dytë imperialiste ai është përpjekur të lokalizojë konfliktin dhe ta mbajë larg kufive të tij. Aty maqina e luftës e Hitlerit për të parën herë mbeti, pse nuk gjeti më para vetes ushtri të papregatitur, nuk gjeti popuj të dezorientuar nga kolona e pestë, nuk gjeti tradhëtarë si në gjithë Evropën borgjeze, ku qeveritë tradhëtare kishin pregatitur terrenin për ardhjen e Hitlerit. Aty ushtria ka lindur nga populli dhe me koshiençë u shërben interesave të tij, ajo po mbron veprën e madhe të Revolucionit të Tetorit, Bashkimin Sovjetik. Kjo ushtri ka ndaluar dhe po zbraps sulmet e hordhive fashiste. Ofensiva e madhe e Ushtrisë së Kuqe fitimpru-

<sup>1</sup> Është vënë data e fillimit të konferencës.

rëse, e filluar në fund të vitit 1942, ka çliruar qytete dhe krahina duke asgjësuar armata të tëra të armikut. Në frontet e ndryshme, në Moskë, në Leningrad, në Tula, në Stalingrad, në tokat sovjetike mbeti ushtria më e zgjedhur e Hitlerit. Mbrojtja heroike e Stalingradit habiti gjithë botën dhe tregoi haptazi forcën e Ushtrisë së Kuqe.

Hitleri kujtonte në fillim të pushtonte URSS-in dhe të asgjësonte Ushtrinë e Kuqe pas një sulmi të rrufeshëm dhe brenda një kohe të shkurtër, po rezistenca heroike dhe strategjia e Ushtrisë së Kuqe ja trazoi planet dhe e shndërroi në luftë të gjatë. Hitleri mendonte të bënte më vonë luftë pozicioni, por sulmet e fuqishme të Ushtrisë së Kuqe e luajtën nga vendi, e zbrapsën dhe po e zbrapsin dita-ditës. Lufta bëhet gjithmonë më e reptë dhe maqina e luftës e Hitlerit po dëmtohet rëndë. Gjermania fashiste ka pësuar humbje të pazëvendësueshme në ushtarë dhe në lëndë luftime, ekonomia e saj po shkatërrohet, kurse Bashkimi Sovjetik është i pashterueshëm në njerëz dhe në material. Disfatat e vazhdueshme dhe vuajtjet e kanë tronditur popullin gjerman, i cili nuk e sheh mbarimin e kësaj luftime, . . . dhe kanë filluar të demoralizojnë ushtrinë e Hitlerit; kurse morali i Ushtrisë së Kuqe dhe i popujve të Bashkimit Sovjetik qëndron i papërkulshëm; urrejtja e popujve të robëruar po transformohet në luftë të hapët me armë dhe po bëhet një rrezik i madh për Hitlerin e Musolinin.

Hitleri shpresonte t'i kthente Anglinë dhe Amerikën nga ana e vet, mendonte të izolonte URSS-in dhe të krijonte mundësinë e një kryqëzate kundër tij, por në saje të fuqisë dhe të politikës së zgjuar të Bashkimit Sovjetik, Anglia një muaj pas agresionit fashist kundër URSS-it erdhi me te në një marrëveshje, e cila më vonë u përforcua nga aleanca e fortë e Londrës dhe e Uashingtonit për luftën e përbashkët kundër fashizmit, për hapjen e frontit të dytë dhe për çlirimin e popujve të robëruar, pa ndërhyrje në çështjet e tyre të brendshme dhe në mënyrën e regjimit; kjo aleancë ka efekt deri në njëzet vjet pas luftime. Për të luftuar rrezikun fashist popuj e kombe përparimdashëse u solidarizuan dhe hynë në rrugën e luftës së përbashkët kundër armikut të përbashkët. Tentativat e Hitlerit për të izoluar URSS-in dështuan, koalicioni u formua, por kundër Gjermanisë naziste dhe aleatëve të saj, Hitleri mbeti vetë i izoluar.

Sinqeriteti i aleancës ndërmjet Sovjetëve dhe Demokracive realizohet dhe vërtetohet me vetë luftën e tyre.<sup>1</sup> Ky sinqeritet

<sup>1</sup> Aleanca (koalicioni) anglo-sovjeto-amerikane u krijua në Luftën e dytë botërore pas sulmit të Gjermanisë hitleriane kundër Bashkimit Sovjetik. Të detyruar nga kërkesat e shumicës dërmuese të popujve për krijimin e një fronti të vetëm luftime kundër fashizmit, si dhe nga gjendja jo e favor-

ka një garanci të shëndoshë te vullneti dhe te bashkimi i këtyre tre popujve të mëdhenj. Konferenca e Kazablankës<sup>1</sup>, deklaratat e Çerçillit, Idenit dhe Ruzveltit dhe manifestimet popullore të zjarra dhe të vazhdueshme në rrugët e Londrës, të Nju Jorkut, të Uashingtonit na tregojnë se hapja e frontit të dytë është iminente. Kjo gjë bëhet siguri për ne kur sjellim ndërmend fjalët e shokut Stalin:

«Shpesh pyesin: Me gjithë këto a do të ketë front të dytë në Evropë? Po do të ketë, shpejt ose vonë, por do të ketë. Dhe do të ketë jo vetëm sepse ai na nevojitet neve, por edhe para së gjithash, sepse ai u nevojitet jo më pak se neve aleatëve tanë. Aleatët tanë nuk mund të mos e kuptojnë që, pas daljes së Francës jashtë luftimit, mungesa e një fronti të dytë kundër Gjermanisë fashiste mund të përfundojë keq për të gjitha vendet liridashëse, duke përfshirë edhe vetë aleatët tanë»<sup>2</sup>.

Në krye të këtij bashkimi të popujve liridashës qëndron Bashkimi Sovjetik i cili mban mbi supet e tij peshën më të madhe të luftës. Popujt e gjithë botës shohin tani me sytë e tyre forcën dhe fitoren e sigurt të Bashkimit Sovjetik dhe të aleatëve të tij mbi fashizmin, popujt e robëruar po e sigurojnë lirinë dhe

shme që u krijua në Evropë pas disfatës së Francës, Anglia dhe SHBA-ja u shtrënguan të hynin në aleancë me BRSS kundër Gjermanisë hitleriane. Gjatë luftës për këtë qëllim u nënshkruan traktate dhe marrëveshje të për-bashkëta, u zhvilluan takime dhe konferenca të udhëheqësve të tri shteteve, Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe SHBA-së si Konferenca e Teheranit në nëntor-dhjetor 1943, Konferenca e Jaltës (Krime) në shkurt 1945. Krijimi i aleancës anglo-sovjeto-amerikane u përgjigjej interesave të të gjithë popujve paqedashës. Me gjithë përpjekjet e pareshtura, nga njëra anë të hitlerianëve, dhe nga ana tjetër të qarqeve reaksionare në SHBA dhe Angli për ta prishur aleancën dhe për ta izoluar Bashkimin Sovjetik, koalicioni anglo-sovjeto-amerikan qëndroi deri në shkatërrimin e plotë të blokut agresiv fashist. Ky koalicion luajti një rol historik në Luftën e dytë botërore me gjithë dallimet parimore në qëllimet e luftës të palëve pjesëmarrëse, Bashkimit Sovjetik dhe shteteve imperialiste, SHBA-së dhe Anglisë.

1 Konferenca e Kazablankës u mbajt në Kazablankë (Marok) prej 14 deri 26 janar 1943, me pjesëmarrjen e kryeministrit të Anglisë, Çerçillit dhe presidentit të SHBA-së, Ruzveltit, si dhe të shefave të shtabeve të përgjithshme të dy vendeve dhe këshilltarëve të tyre.

2 J. V. Stalin. «Mbi luftën e madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik», botim i MMP. Tiranë, 1952, f. 60.

indipendencën me luftën e tyre dhe duke u lidhur me luftën e Bashkimit Sovjetik dhe të aleatëve të mëdhenj.

Lufta dhe zbarrimi i aleatëve anglo-amerikanë në Afrikë dhe ofensiva e tyre e madhe ajrore mbi objektivat industriale dhe ushtarake të Gjermanisë, Italisë dhe Evropës Perëndimore e kanë shtrënguar Hitlerin në një unazë të hekurt. Lëvizja nacional-çlirimtare e popujve të robëruar, me partitë komuniste në krye, ka marrë një hov të madh duke mbërritur në luftë me armë.

Hitlerit nuk i mjafton më ushtria e vet për t'u bërë ballë sulmeve të koalicionit të madh antifashist, punëtorët për të bërë fortifikata dhe për të prodhuar material luftime gjithashtu nuk i mjaftojnë, lufta po i asgjëson ushtrinë më të mirë, rezervat po i mbarohen. Për këtë arsye i ndihmuar nga kuislingët e ndryshëm ai mundohet me forcë dhe me çdo mjet të mobilizojë të tërë Evropën për të nxjerrë sa më shumë ushtarë, sa më shumë punëtorë skllëvër. Tani që gjendet në rrezik të madh, që po pëson disfata pas disfatash në frontin lindor dhe në atë të Afrikës, që po kërcënohet nga fronti i dytë dhe nga hovi i luftës nacional-çlirimtare të popujve të robëruar, ai trumbeton «rrezikun bolshevik» dhe në këtë mënyrë mundohet të përçajë aleancën anglo-sovjeto-amerikane dhe të mobilizojë reaksionin e gjithë botës dhe veçanërisht të Evropës. Për këtë gjë është mobilizuar e gjithë kolona e pestë, të gjithë tradhëtarët me Petenin, Lavalin, Antoneskun, Kuislingun<sup>1</sup> dhe veglat e tjera të fashizmit në krye. Por aleanca dita-ditës forcohet. Grabitjet sistematike, terrori dhe mjerimi në të cilin i ka zhytur fashizmi, disfatat e fashizmit në frontet e ndryshme dhe veçanërisht në frontin lindor dhe afrimi i hapjes së frontit të dytë, i bën popujt e robëruar të Evropës të bashkohen dhe të mblidhen rreth kësaj aleance të fuqishme dhe të luftojnë me armë në dorë okupatorin. Lufta nacional-çlirimtare në Ballkan ka pasur një karakter shumë të ashpër dhe

1 Peten H. F. — mareshal, tradhëtar i popullit francez. Pas pushtimit të Francës nga Gjermania fashiste më 1940 ishte një nga krerët e qeverisë fashiste franceze të Vishisë së bashku me P. Lavalin. Më 1945 u dënua me vdekje për tradhëti të lartë, por nuk u pushkatua me ndërhyrjen e imperialistëve anglo-amerikanë.

Pjerr Laval kryesoi qeverinë prohitleriane franceze të Vishisë (1942—1944).

Antonesku J. — Shih në këtë vëllim, f. 28.

Kuislingu — kryetar i fashistëve norvegjezë. Veproi tradhëti për pushtimin e Norvegjisë nga Gjermania hitleriane në vitin 1940. Kryeministër i qeverisë tradhëtare të Norvegjisë. Emri kuisling ka hyrë si sinonim i fjalës tradhëtar.

pas përpjekjes së Hitlerit për mobilizimin, është ashpërsuar edhe më tepër, deri në luftë me armë, si në Greqi, në Bullgari, te ne dhe, veçanërisht, në Jugosllavi, ku ushtria nacional-çlirimtare është zhvilluar në armata dhe ka çliruar një pjesë të madhe të vendit.

Lufta nacional-çlirimtare e popujve të Ballkanit hap perspektiva të reja para këtyre popujve, zhvillon vëllazërimin e tyre dhe zhdukjen e antagonizmave kombëtare, nga të cilat Hitleri dhe Musolini kërkojnë akoma të përfitojnë. Ushtria që këta kanë në Ballkan u duhet për frontet e tjera dhe për vendet e tyre të kërcënuara nga fronti i dytë, prandaj me anën e tradhëtarëve të popujve të Ballkanit, Antoneskut, Borisit, Paveliçit, Nediçit, Merlikës, Bushatit<sup>1</sup> etj. mundohen të zhvillojnë shovinizmin dhe t'i shtien këta popuj në vëllavrasje, që kështu të mbytin aty lëvizjen nacional-çlirimtare me vetë duart e këtyre popujve, mundohen të organizojnë armatën e Ballkanit prej vetë ballkanasve, për t'u shërbyer interesave të fashizmit, të shuajnë luftën nacional-çlirimtare për të përballuar hapjen eventuale të një fronti të dytë. . .

Përpjesëtimet e mëdha që ka marrë lufta në frontin e Mesdheut dhe dobësimi i madh dhe i vazhdueshëm i Italisë hapin perspektivën dhe forcojnë lëvizjen antifashiste dhe antilufte në Itali dhe mundësitë e shpëputjes së saj nga Boshti. Kjo gjë do të kishte sigurisht konsekuenca të mëdha në Ballkan dhe sidomos në Shqipëri.

Shkatërrimi i sigurtë i fashizmit, tmerri i luftës, shkatërrimi i ekonomisë, roli i fuqive revolucionare në luftën nacional-çlirimtare, rëndësia dhe roli i Bashkimit Sovjetik në këtë luftë çlirimtare, po hapin perspektivën e çlirimit definitiv përpara masave të shtypura dhe punonjëse.

<sup>1</sup> Borisi III — mbret i Bullgarisë (1918—1943). Në vitet e luftës së dytë botërore ai e futi Bullgarinë në aleancë me Gjermaninë hitleriane duke e bërë satelite të saj.

Paveliç, Nediç — tradhëtarë të popullit jugosllav, agjentë dhe bashkëpunëtorë të pushtuesve gjermanë, drejtues të forcave reaksionare fashiste kundër lëvizjes nacional-çlirimtare jugosllave.

Merlika — Mustafa Kruja, një nga krerët tradhëtarë fashistë dhe kriminel lufte nga më kryesorët të popullit shqiptar, agjent i Italisë fashiste, kryesoi qeverinë kuislinge shqiptare prej vitit 1941 deri në janar 1943.

Maliq Bushati — tradhëtar dhe kriminel lufte i popullit shqiptar, një nga eksponentët e «Ballit Kombëtar»; erdhi në krve të qeverisë fashiste kuislinge pas Mustafa Krujës dhe Eqrem Libohovës dhe e kryesoi këtë qeveri prej shkurtit deri në maj 1943.

Regjimi i mëparshëm, me politikën e tij e kishte izoluar Shqipërinë nga bota e jashtme dhe i kishte lejuar Italisë fashiste të ndërhynte në punët e brendshme, duke lehtësuar kështu përgatitjen e okupimit të vendit. Ai i dha Italisë koncesione të mëdha ekonomike dhe u besoi instruktorëve të saj organizimin e Ushtrisë Kombëtare. Oficerë dhe propagandistë fashistë u përhapën në të gjithë Shqipërinë dhe duke përfituar nga kalbësia e aparatit shtetëror blenë njerëz të vetë regjimit dhe përgatitjen sistematikisht dhe organizuan kolonën e pestë. Në këto veprime u shquan gjeneral Pariani, Jakomoni, Xhiroja<sup>1</sup> dhe disa ndihmës të tyre të vendosur. Duke marrë parasysh këto, duke shtuar dhe atë që regjimi nuk ishte i lidhur ose ishte i lidhur fare dobët me popullin duket e çartë arësyeja pse Italia e theu lehtë rezistencën tonë. Grupet e ndryshme ushtarake që u grumbulluan në vendet e ndryshme të Shqipërisë dhe në çastin e fundit nuk qenë në gjendje të paraqesin kundërshtime serioze, pse ishin të paarmatosura mirë dhe të tradhëtuara prej klikës sunduese.

Fashizmi porsa vuri këmbë në Shqipëri filloi një fushatë demagogjike në shkallë të gjerë. Ai doli si «shpëtimtari» i popullit shqiptar nga sundimi i rëndë i Zogut, thirri se do të sillte drejtësinë dhe mirëqenien ekonomike dhe se do të vinte në vend gjithë padrejtësitë e Zogut. Me këtë mënyrë ai diti të afrojë një pjesë të kundërshtarëve të regjimit të mëparshëm dhe armiqtë personalë të Zogut ose të rrethit të tij. Ai diti t'i shfrytëzojë antagonizmat fetare. Tradhëtarët, armiqtë personalë të Zogut dhe sahanlëpirësit e ndryshëm u bënë vegla të mira në duart e tija për skllavërimin e popullit.

1. — Konferenca e parë e Vendit konstatoi se fashizmi u mundua të legalizojë zgjedhën e tij duke na lejuar gjoja një parlament dhe duke na vënë në krye qeverinë gjoja shqiptare të Shefqet Vërlacit me program që t'ja bëjë të pranueshëm popullit shqiptar okupacionin.

1 Gjeneral Pariani u dërgua në Shqipëri prej Musolinit në vitin 1928, së bashku me 40 oficerë të tjerë italianë, me qëllim që të organizonte ushtrinë shqiptare të Ahmet Zogut. Ai zhvilloi në Shqipëri punë agjenturale për të përgatitur fushën e një pushtimi të plotë të Shqipërisë. Pariani ishte një nga organizatorët kryesorë të pushtimit fashist të vendit tonë më 1939. Ai cilësohej nga fashizmi italian si një njohës i thellë i Shqipërisë. Pas largimit të F. Jakomonit, në mars 1943, u emërua mëkëmbës i mbretit dhe i Musolinit në Shqipëri.

Xh. Xhiro — hierark fashist italian. Specialist për çështjet shqiptare në planet e qeverisë fashiste italiane për pushtimin e Shqipërisë.



✦ Populli shqiptar nuk kishte një përgatitje politike. Ai e urrente okupatorin, por... nuk e njihje sikundër nuk njihje dhe fashizmin nga shkaku i mungesës së një partie politike përparimdashëse e cila të mundte të krijonte me kohë një front antifashist. Për këtë ai në kohët e para u mashtrua deri-diku nga fashizmi. Demagogjia mashtruese u shndërrua në «prosperitet»<sup>1</sup>, sidomos në fushën ekonomike. U hap punë, mëditjet e punëtorëve u ngritën dhe kjo gjë në fillim e gënjeu popullin, i cili vuan-te nga një krizë e rëndë ekonomike. Fashizmi premtoi se do të bënte rrugë nga të katër anët, do të bënte bonifikime, do të hapte kanale, miniera, do të krijonte industri, me pak fjalë do ta bënte Shqipërinë një «xhenet», ku të kishte të gjitha të mirat, e sidomos «punë e bukë». U krijua në fillim një farë prosperiteti ekonomik por ky prosperitet ishte më tepër në dukje se sa në realitet. Në të vërtetë okupatori shtiu në dorë të gjitha pasuritë e vendit, shfrytëzimi i nëntokës u bë e drejtë ekskluzive e shoqërive italiane, doganat u muarën në koncesion nga dogana mbretërore e Italisë kundrejt një shpërblym qesharak, sendet e nevojës së parë u monopolizuan nga entet e mëdha italiane, të cilat u jepnin edhe tregëtarëve të mëdhenj, tradhëtarëve dhe spekulatorëve ndonjë kockë. Ekonomia jonë u shkatërrua.

✦ Porsa filloi lufta me Greqinë gjendja ekonomike e vendit tonë e cila kishte filluar qysh më parë të largohej nga ky «prosperitet» me hapa të mëdhenj, u bë katastrofale, sidomos për shtresat e ulta, punëtorinë dhe fshatarësinë puna u pre, çmimet u ngritën pa masë, sendet filluan të mungojnë nga tregu. Aty ku qe shesh lufte, në krahinat e Jugut, me mijëra familje mbetën pa shtëpi, bujqësia dhe sidomos blegtoria u shkatërruan.

✦ Pakënaqësia e popullit po shtohet dita-ditës; urrejtja e tij e mëparshme kundër okupatorit mori formën e kundërshtimit të hapët me ngjyrë politike. Populli filloi të dalë nga indiferentizmi i kohëve të para dhe me hove gjithmonë më të mëdha, filluan grevat dhe demonstratat (Shkolla Teknike, Gjimnazi i Shkodrës, Tregëtarja e Vlorës, Fabrika Stambles, demonstrata e 28 nëntorit 1939 në Tiranë e në Korçë), filloi demaskimi i hapët i fashizmit në popull, lëvizja nacional-çlirimtare filloi të përfshijë masat e gjera.

✦ Qeveria e Vërlacit jo vetëm nuk qe në gjendje të zhdukte urrejtjen e popullit kundër okupatorit, jo vetëm nuk mundi ta bënte mik popullin me okupatorin, por sidomos edhe ajo nuk ishte më e përshtatshme të luftonte lëvizjen nacional-çlirimtare që po forcohej. Fashizmi e kuptoi mirë rrezikun e kësaj lëvizjeje dhe mendoi që ta shtypë që në hapat e parë me çdo mjet, me intriga, me demagogji dhe sidomos me forcë, për të mundur

kështu të kishte Shqipërinë shërbëtore të urtë dhe bazë të mirë për të siguruar dhe për të forcuar pozitën e tij në Ballkan. Qeveria e Vërlacit u tregua e dobët; për zbatimin e kësaj politike duhej një vegël tjetër. Këtë fashizmi e gjeti në personin e Mustafa Krujës, i cili veprën e tij tradhëtare e kishte filluar me kohë.

2. — Mustafa Merlika e filloi karrierën e tij të ndyrë me pjesëmarrjen në qeverinë tradhëtare të Durrësit më 1918<sup>1</sup> dhe me sabotimin dhe luftën kundër Kongresit të Lushnjës. Vazhdoi politikën e tij tradhëtare, e cila doli në shesh më 7 prill 1939 edhe jashtë Shqipërisë ai është figura më e ndyrë e tradhëtarëve të 7 prillit, ishte dhe është tipi më i regjur i tradhëtarit të shitur. Duke hipur në krye të qeverisë i hyri veprës së tij gjakatare duke pasur si qëllim kryesor të përçajë lëvizjen kundër okupatorit me manevra politike dhe me intriga dhe njëkohësisht ta shtypë me anë të forcës.

Qeveria shihte në Partinë Komuniste armikun e papajtuashëm të fashizmit dhe forcën më të gjallë dhe më të aftë për të organizuar Luftën nacional-çlirimtare, për këtë arsye ajo u mundua ta shkatërrojë dhe ta izolojë Partinë Komuniste nga populli duke paraqitur çdo lëvizje masash, çdo kundërshtim ose protestë që i bëhej asaj dhe okupatorit si lëvizje me karakter thjeshtësisht komunist. Me këtë ajo përpiquej t'i largonte nacionalistët nga lëvizja nacional-çlirimtare dhe t'i shtinte gradualisht në pozitat e saja, të ftohte popullin dhe patriotët kundrejt Partisë dhe kundrejt lëvizjes. Kështu tradhëtari Merlika donte ta bënte të pamundur krijimin e një Fronti Nacional-Çlirimtar, nga i cili trembej për vdekje padroni i tij, okupatori. Paralelisht me këtë ai zhvilloi një politikë shoviniste, trumbetoi pa pushim rrenën e «Shqipërisë së madhe», të cilën e nënvizoi si sukses dhe vepër të fashizmit dhe të politikës së tij dhe njëkohësisht «rrezikun serb e grek» që të shtrembëronte ndjenjat kombëtare dhe të krijonte preokupime të pavend për nacionalistët dhe ta shtynte kështu në pozita që jo vetëm nuk e dëmtonin okupatorin, por ja lehtësonin barrën, pse shkaktonin diversion dhe vëllavrasje në Ballkan. Për të bërë të pamundur krijimin e Frontit Nacional-Çlirimtar, për të grumbulluar sa më tepër njerëz e forca rreth okupatorit, ju drejtua reaksionarëve, nacionalistëve, bajraktarëve, të

<sup>1</sup> Qeveria e Durrësit u krijua në dhjetor 1918 nga i ashtuquajturii Kongresi i Durrësit, i cili u organizua me iniciativën e pushtuesve italianë, nga agjentët shqiptarë të Italisë dhe nga çifligarët e mëdhenj. Kjo qeveri zbatoi një politikë antishqiptare, kolonizuese proitaliane. Ajo u përpoq me çdo mënyrë duke përdorur edhe armët që të ndalonte mbledhjen e Kongresit të Lushnjës në janar 1920. Pas krijimit të qeverisë shqiptare nga Kongresi i Lushnjës qeveria e Durrësit u shkatërrua në shkurt 1920. Në qeverinë e Durrësit bënte pjesë edhe Mustafa Kruja.

<sup>1</sup> Prosperitet (ital.) — lulëzim ose zhvillim.

arratisurve dhe kujtdo që mundi. Përfitoi nga atantizmat<sup>1</sup> e shumë nacionalistëve për të përhapur idenë se duhet të kemi një aparat të fortë shtetëror shqiptar për të luftuar Italinë «kur të vinte koha» dhe sidomos për të qenë në gjendje të mbrojmë «Shqipërinë e madhe» nga invazioni serb dhe grek; me këtë donte të justifikonte dhe të lehtësonte mobilizimin e milicisë dhe të ushtrisë. Është për të vënë re se ai bënte çmos për të shuar lëvizjen e popullit shqiptar me forca mercenare dhe reaksionare të brendshme, duke kursyer forcat e okupatorit, të cilat nevojiteshin në frontet e ndryshme jashtë Shqipërisë.

Përpjekja e Merlikës për të bashkuar rreth vetes nacionalistët dhe për t'i bërë pjesë integrante të tradhëtisë së tij dhe të kompromisit, pati në fillim një farë suksesi, sikundër pati dhe rekrutimi i milicisë. Shumë reaksionarë u bashkuan me të dhe e ndihmuan në intrigat e në masat e tija terroriste kundër popullit, disa nacionalistë u mashtruan nga demagogjia e tij dhe bashkëpunuan deri-diku me të ose nuk e kundërshtuan. Merlika u lidh ngushtë me disa njerëz që kishin vënë përpara çdo gjëje interesat e tyre të ngushta, të cilët nuk e donin dhe nuk kishin besim në zhvillimin e Luftës nacional-çlirimtare. Duke përfutur nga influenca që kishin disa tradhëtarë të shitur dhe nga gjendja ekonomike e malësive tona, ai mundi të mobilizojë një numër mjaft të madh milicësh. I përdori këta kundër luftës së popullit që ashpërsohej dita-ditës nëpër demonstrata, aksione sabotazhi dhe përpjekje me armë. Qeveria e tij u bë qeveria e reaksionit gjakatar dhe e terrorit. Ai luftoi me tërbim të gjithë patriotët, të gjithë ata që ishin kundër okupatorit, pa mëshirë vrau, vari, burgosi dhe internoi me qindra njerëz, sulmoi dhe dogji katunde e shtëpi në mes të qyteteve. Por lëvizja e popullit shqiptar nuk u shua, përkundrazi është bërë dita-ditës më e fuqishme dhe u përforcuan çetat partizane dhe vullnetare. Partia Komuniste ka qenë organizuesja dhe udhëheqësja e vërtetë kundër këtij reaksioni të padëgjues, ajo ka qëndruar kurdoherë në ballë të luftës; kurdoherë ajo është përpjekur të bashkojë të gjithë nacionalistët e ndershëm dhe patriotë kundër okupatorit, ajo u bë inisiatorja dhe organizoi në shtator të vitit 1942 një konferencë të gjerë<sup>2</sup>, ku muarën pjesë shumë nacionalistë me tendencë të ndryshme politike. Aty u hodhën bazat e këshillave nacional-çlirimtare, organe të kësaj lufte dhe të pushtetit demokratik popullor. Kjo konferencë bëri

<sup>1</sup> Atantizma — term në gjuhën frënge, i përdorur që prej vitit 1918 për të karakterizuar një politikë oportuniste të qëndrimit në pritje, gjoja për një moment më të volitshëm veprimi apo aksioni.

Këtë politikë ndiqte edhe «Balli Kombëtar» në luftën kundër pushtuesit.  
<sup>2</sup> Është fjala për Konferencën nacional-çlirimtare të Pezës, që u mbajt më 16 shtator 1942.

një hap të madh drejt bashkimit dhe formimit të Frontit Nacional-Çlirimtar; me këtë konferencë ju dha mundësia të gjithë atyre që e duan Luftën nacional-çlirimtare që të marrin pjesë aktive në të.

Forcimi i frontit kundër fashizmit, forcimi i pozitave të aleatëve, sukseset e Ushtrisë së Kuqe dhe të luftës nacional-çlirimtare në Evropë, shkatërrimi i ekonomisë së vendit, mungesa e ushqimeve, grabitjet sistematike të fashizmit, demaskimi i demagogjisë së Merlikës përta i përket tentativës për të mobilizuar ushtrinë në favor të okupatorit, rekrutimit të milicisë dhe shkëputjes së kushteve më të favorshme për pavarësinë tonë nga ana e armikut, ja bënë të qartë popullit se duhet të luftojë kundër okupatorit.

Zgjerimi i vazhdueshëm i lëvizjes nacional-çlirimtare pati si jehonë imediate deklaratat e Hullit, Idenit dhe Molotovit, ku njëhej solemnisht liria dhe pavarësia e Shqipërisë. Këto deklarata kanë pasur një efekt politik në nacionalistët dhe në popullin tonë. Deklaratat kanë diskredituar dhe më fort politikën e Merlikës në popull dhe kanë shkëputur shumë nacionalistë që ndodheshin akoma me të. Merlika mbeti me një pjesë të tradhëtarëve të njohur në popullin shqiptar. Tentoi edhe një herë (nëntor 1942) me një apel patetik demagogjik, të shkatërronte bashkimin e popullit, të shuante Luftën nacional-çlirimtare dhe kështu të shpëronte pozitën e tij të tronditur. Por lufta gjithnjë më tepër është ashpërsuar dhe forcuar duke grumbulluar rreth vetes gjithnjë më tepër elementët atdhedashës.

Politika e Mustafa Merlikës falimentoi. Fashizmit i duheshin vegla të tjera për të shtypur lëvizjen nacional-çlirimtare.

3. — Në vend të Merlikës erdhi Eqrem Libohova me qeverinë e tij, rrotull së cilës fashizmi kishte shpresë të grumbullonte forca të reja nga radhët e nacionalistëve për të përmirësuar gjendjen e vet nga të pakënaqurit e qeverisë së mëparshme edhe të afronte popullin duke e mashtruar me gjoja reforma. Në të vërtetë fashizmi nuk ju kursye pretimeve këtë radhë; për t'i dhënë kredi qeverisë së re ai premtoi reforma mbi reforma dhe e paraqiti punën sikur qeveria kishte pranuar të vinte në fuqi vetëm pasi i kishin qenë pranuar nga ana e okupatorit kondita të shëndosha vetëqeverimi. Por kjo gjë nuk pati suksesin e shpresuar, populli nuk u gënjye dhe qeveria nuk kishte influencë të mjaftueshme që t'i imponohej.

Në realitet qeveria e Libohovës u bë urë për sjelljen e qeverisë së Bushatit. Ajo vazhdoi me metodat e Merlikës. Gjatë asaj qeverie u muarën peng dhe u pushkatuan djem të popullit dhe vazhdoi terrori po me atë ashpërsi. Kjo gjë shkaktoi demonstrata madhështore në shumë qytete të Shqipërisë dhe ashpërsimin e luftës nga ana e popullit. Nga këto demonstrata, nga vazhdimi



dhe ashpërsimi i paprerë i luftës, fashizmi pa se nuk kishte zgjedhur veglën më të përshtatshme për politikën e tij.

4. — Qeveria e Maliq Bushatit, pasardhëse e qeverisë Libohova, ka si qëllim kryesor të grumbullojë të gjithë elementët reaksionarë në mënyrë direkte ose indirekte për të përçarë lëvizjen nacional-çlirimtare dhe së bashku me forcat e fashizmit të shuajë këtë lëvizje, për të bërë atë që s'mundi ta bënte qeveria e Merlikës dhe e Libohovës. Kjo përdori një taktikë të re. Mundohet të forcojë kolonën e pestë si një nga mjetet më të mira për të mbjellë ndarjen, mundohet të ngjallë dhe të forcojë shovinizmin, për të larguar nacionalistët nga lufta e vërtetë dhe për të na futur në kasaphanë me shtetet fqinje. Për këtë arsye nxjerr edhe një herë parullën e një «ushtrie dhe xhandarmërie shqiptare» e një farë independence të qeverisë kundrejt okupatorit; njëkohësisht nxjerr edhe parullat «Roja e Shqipërisë së madhe» dhe «rreziku grek e serb». Ajo vazhdon politikën e qeverisë së Merlikës, por me një platformë më të gjerë dhe më të përshtatshme për të ardhur në kompromis me nacionalistët, gjë e cila i nevojitet shumë okupatorit. Ajo mbështetet përgjithësisht mbi elementin e lidhur me Merlikën, mbi elementin reaksionar, atë që kishte qëndruar larg Merlikës dhe mbi gjithë të shturit dhe oportunistët.

Fashizmi e ka kuptuar se politika e tij në qeverinë e Merlikës ishte e ngushtë dhe nuk kishte elasticitetin për t'u hapur derën e kompromisit nacionalistëve, ai e ka kuptuar se duhen bërë ndryshime të tjera, u duhet dhënë më mirë iluzioni i vetëqeverimit nacionalistëve. Me këtë mënyrë ka më tepër mundësi që të lidhen pas qerres së fashizmit elementët reaksionarë dhe nacionalistët konservatorë dhe me anën e këtyre të largohet një pjesë e nacionalistëve nga lufta dhe të thyhet kështu Fronti Nacional-Çlirimtar. Njëkohësisht me këtë politikë, ai përpiqet për të forcur pozitën e tij me masa më të ashpra ushtarake. Për këtë gjë erdhi gjeneral Pariansi si mëkëmbës, njëri nga njerëzit më besnikë të regjimit fashist, njeriu që përgatiti ushtarakisht okupacionin dhe prandaj e njeh shumë mirë Shqipërinë.

5. — Konferenca e parë konstatoi se është duke u bërë një farë diferencimi në radhët e nacionalistëve në raport me Luftën nacional-çlirimtare dhe me Partinë Komuniste. Po dallohet pjesa e nacionalistëve reaksionarë, e cila bashkëpunon në mënyrë direkte ose indirekte me qeverinë e Maliq Bushatit. Dallohen gjithmonë më tepër nacionalistët që e kanë kuptuar se Lufta nacional-çlirimtare është mjeti i vetëm për të fituar independencën. Por ka një pjesë të nacionalistëve, të cilët janë në pozita neutrale; ata nuk e kanë kuptuar akoma karakterin e Luftës nacional-çlirimtare, nuk kanë besim te forcat e popullit dhe në humbjen e shpejtë të fashizmit. Kjo pjesë mund të luajë një rol me rëndësi

në Luftën nacional-çlirimtare dhe prandaj nuk duhet nënvleftësuar dhe neglizhuar.

Një pjesë e nacionalistëve është grumbulluar në «Ballin Kombëtar». Aty në përgjithësi nuk ka pikëpamje të njëjta dhe të qarta përse i përket Luftës nacional-çlirimtare, pjesëmarrjes në qeverinë e tanishme dhe disa çështje të tjera politike. Aty ka një pjesë të madhe, dhe sidomos poshtë, që e do Luftën nacional-çlirimtare dhe ka shumë mundësi që të hyjë në rrugën e vërtetë të kësaj lufte. Shumë elementë të «Ballit» kanë luftuar dhe vazhdojnë të luftojnë me armë në dorë kundër okupatorit. Me këta ka shumë mundësi që të bëhet një front luftarak nacional-çlirimtar i përbashkët.

Por është për t'u shënuar se një pjesë e krerëve të «Ballit» është thellësisht konservatore dhe bie në pozitë të kompromisit. Ata bëjnë politikë me dy faqe, mendojnë të jenë në lëvizjen nacional-çlirimtare dhe të mos e prishin me okupatorin, mendojnë të kalojnë nga kolltuku në kolltuk dhe ta mbajnë kolltukun sido që të ndryshojë situata.<sup>1</sup> Ata nuk duan akoma të kuptojnë se ajo politikë e vjetër ka falimentuar dhe nuk mund të zgjidhë kurrëgjë, veç interesave të tyre të ngushta. Ata tremben nga Lufta nacional-çlirimtare sepse shohin se lufta i mbyll derën çdo kompromisi me okupatorin dhe nuk lejon manevrime, sepse shohin se lufta e bën koshient popullin dhe e shpëton nga ata që e mashtrajnë, nga ata që e shfrytëzojnë për interesat e veta personale, sepse shohin se lufta do t'ua rrëzojë influencën atyre kundrejt popullit dhe do të nxjerrë në krye elementin më të ndërgjegjshëm për interesat e popullit. Mund të shënohet se po duken shenjat e para (konturet) të formimit të partive borgjeze, të cilat shpëputen nga krerët reaksionarë nacionalistë (Korçë: «Radikal-nacionalistë»; Shkodër: «28 Nëntori» etj.).

<sup>1</sup> Në fakt udhëheqja e «Ballit Kombëtar» kishte që me kohë lidhje të rregullta me autoritetet pushtuese italiane. Siç u vërtetua më vonë «Balli Kombëtar», si organizatë u krijua me ndihmën e vetë okupatorëve fashistë. Në kohën kur zhvillohej Konferenca e parë e Vëndit e PKSH akoma nuk dihej se pikërisht në këtë kohë, më 15 mars 1943 dy nga anëtarët e Komitetit Qendror të «Ballit», Ali Bej Këlcyra dhe Nuredin Bej Vlora nënshkruan në Tiranë me kryekomandantin e trupave pushtuese italiane gjeneral Dalmacon protokollin famëkeq «Dalmaco-Këlcyra», i cili tregon hapur bashkëpunimin kriminal të «Ballit Kombëtar» me pushtuesit fashistë. Duke folur në emër të «nacionalistëve shqiptarë» dhe duke pasur «pëlqimin e plotë të shkëlqesisë së tij Maliq Bushatit», me këtë protokoll ata e siguronin gjeneral Dalmacon, se «asnjë lëvizje kryengritëse nuk do të ngjajë në Shqipërinë Jugore», se do të përdorin gjithë influencën e tyre për të ndaluar sulmet dhe aktet e sabotimit kundër pushtuesve italianë.



1. — Konferenca e parë e Vendit konstatoi se lëvizja nacional-çlirimtare është duke u shtuar dita-ditës, ajo ka zënë rrënjë në popull dhe është duke grumbulluar rreth saj gjithmonë më tepër forcat e gjalla të popullit, patriotët e ndershëm dhe koshientë të momentit politik që po jetojnë, janë duke marrë pjesë gjithmonë më tepër në lëvizje, duke mobilizuar kështu shtresa gjithmonë më të gjera të popullit. Në bashkimin e popullit shqiptar janë bërë shumë hapa përpara. Këshillat nacional-çlirimtare dhe çetat partizane dhe vullnetare janë shprehje e gjallë e kësaj jete të re bashkimi dhe lufte që po lind në Shqipëri.

Hovi i Luftës nacional-çlirimtare, aksionet me sukses mbi armikun ja kanë nxjerrë popullit frikën dhe i kanë ngjallur besimin në forcat e veta.

Partia Komuniste ka qenë e para që ka lëshuar zërin e kushtrimit për bashkimin e popullit shqiptar, ajo ka qenë e para që e ka kërkuar me këmbëngulje dhe në mënyrë konkrete këtë bashkim, ajo vazhdimisht dhe me fuqi ka thirrur dhe po thërret për bashkimin e të gjitha forcave të gjalla, e të gjitha rrymave politike kundër okupatorit.

Partia Komuniste ka qenë në ballë të lëvizjes nacional-çlirimtare, ka qenë në ballë të luftës, ajo e ka mobilizuar popullin dhe e ka hedhur në luftë jo vetëm me anë të agjitacionit e të propagandës, por sidomos me anë të luftës.

Ushtria Nacional-Çlirimtare e popullit shqiptar, si rezultat i pjesëmarrjes më të gjerë të popullit në këtë luftë, është në rrugë realizimi.

2. — Konferenca e parë e Vendit konstatoi se vija politike e Partisë ka qenë e drejtë dhe se janë mbërritur suksese të rëndësishme, por jo të mjaftueshme. Që të mund të shkojmë me hapa të sigurtë drejt kryengritjes së përgjithshme të popullit tonë, ajo u ngarkon anëtarëve të Partisë këto detyra:

a) Të gjitha organizatat dhe anëtarët e Partisë të kuptojnë mirë se në çfarë etape ndodhemi, të kuptojnë mirë Luftën nacional-çlirimtare dhe se çdo dalje nga kuadri i kësaj lufte do t'i sjellë dëme të mëdha luftës vetë dhe Partisë sonë.

b) Duhet që të gjithë anëtarët e Partisë të dinë të orientohen në këto kohë të ndërlikuara dhe të jenë në gjendje të kalojnë të gjitha pengesat që u dalin përpara; të gjithë të punojnë për mobilizimin sa më të gjerë të popullit, për të mobilizuar sa më shumë ushtarë duke krijuar çeta dhe batalione të reja dhe duke forcuar ato të vjetrat, duke shkuar drejt njësave sa më të mëdha dhe drejt krijimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare; të luftojmë dhe të zhdukim sektarizmin përsa i përket mobilizimit të luftëtarëve në çetat partizane e vullnetare.

c) Të bëhet në popull shpjegimi i nevojës dhe i qëllimit të Luftës nacional-çlirimtare, shpjegimi dhe popullarizimi i luftës sonë dhe i sukseseve të saj, mobilizimi politik i popullit për luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve të vendit, për një Shqipëri të lirë, të përtëritur, indpendente dhe demokratike, ku populli shqiptar do të ketë jetën më të mirë dhe më të lumtur.

ç) Të realizojmë dhe të forcojmë bashkimin e popullit shqiptar, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, tendencat dhe rrymat politike dhe fetë e ndryshme, duhet të kemi durim dhe të mbërrijmë bashkimin e sigurtë ose bashkëpunimin me nacionalistët.

d) Të kemi kujdes për njerëzit që e duan Luftën nacional-çlirimtare edhe për ata që janë të pabindshëm dhe të luejtshëm, për të cilët duhet të kemi durim më të madh për t'i bindur dhe për t'i bërë aleatët tanë se «më mirë është një aleat qoftë dhe i luejtshëm se sa një armik».

dh) Të organizojmë ndër fshatra dhe qytete këshillat nacional-çlirimtare, të cilat do të jenë me të vërtetë organet e pushtetit demokratik popullor dhe të Luftës nacional-çlirimtare, të cilat do të shkatërrojnë pushtetin fashist.

3. — Duhet të popullarizojmë:

a) Bashkimin Sovjetik, atdheun e punëtorëve e të fshatarëve, veprën e shkëlqyeshme të Lenin-Stalinit, vendin ku është zhdukur shtypja e kombit prej kombit dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, mbajtësin e fuqishëm të luftës për çlirimin e popujve të robëruar nga fashizmi;

b) Ushtrinë e Kuqe lavdiplote dhe fitimprurëse, e cila po shpëton njerëzimin nga bisha fashiste dhe po u sjell popujve të robëruar lirinë e po habit njerëzimin me heroizmat e saj;

c) Koalicionin e fuqishëm të aleatëve tanë anglo-sovjeto-amerikanë që po përgatit dhe po shpejton vdekjen e fashizmit;

ç) Luftën heroike të popujve të robëruar që po i shkakton humbje të mëdha fashizmit dhe që ndihmon luftën e popullit tonë e sidomos luftën e popujve të Ballkanit; të zhvillojmë dhe të forcojmë vëllazërimin ndërmjet popujve ballkanas;

4. — a) Duhet të popullarizojmë Partinë Komuniste si flamurtare të luftës për çlirimin e popullit nga fashizmi, për të drejtat e shtresave të ulta;

b) Me anë të agjitacionit dhe të propagandës duhet të bëhet demaskimi i fashizmit në popull, shpjegimi i të gjitha krimeve të tij, vrasjeve, grabitjeve, dhunimeve, mashtrimeve, të jenë të squet karshi kolonës së pestë dhe ta demaskojnë; të bëhet demaskimi i të gjithë tradhëtarëve dhe të shiturve të vendit, vegla të okupatorit me qeverinë e Maliq Bushatit në krye, e cila mundohet të formojë ushtrinë dhe xhandarmërinë si «Rojen e Shqipërisë së madhe», por në realitet rojen e interesave të okupatorit,

i cili don të vazhdojë luftën me një mënyrë të re kundër lëvizjes nacional-çlirimtare.

c) Duhet qëndrim politik i drejtë dhe i menjëhershëm mbi çdo çështje me rëndësi.

Në këtë mënyrë do të drejtojmë me sukses Luftën nacional-çlirimtare në kryengritjen e popullit tonë.

#### IV

1. — Konferenca e parë e Vendit përshëndeti me një zë direktivat dhe ndihmën e I[nternacionales] K[omuniste], e cila ja ka dhënë Partisë sonë në momentin e duhur, me të cilat është mundur të mbahet qëndrimi mbi Luftën nacional-çlirimtare, si dhe lejen dhe këshillat për vetë konferencën dhe zgjedhjen e një Komiteti Qendror Definitiv.

2. — Konferenca I pasi i dëgjoi, i pranoi unanimisht referatet organizative, politike të Luftës nacional-çlirimtare dhe të tjerat.

3. — Konstatoi se KQ Provizor ka hedhur themelet e Partisë, ka zbatuar me përpikëri dhe me plan vijën e drejtë për organizimin dhe forcimin e kësaj dhe për centralizimin në Parti, konstatoi se KQ Provizor i ka dhënë organizatës vijën e drejtë politike e organizative dhe ka ditur ta shkëputë nga mënyra e vjetër e dëmshme e punës dhe ta udhëheqë drejt forcimit dhe njësimi, kështu që numri i anëtarëve në Parti është shtuar brenda një viti e gjysmë 270 për qind, i ka dhënë Partisë ritmin e punës, ka krijuar organizatën e rinisë, duke bërë kështu të mundur afrimin e masave të gjera të rinisë rreth Partisë, e ka çuar Partinë me hapa të sigurtë drejt Konferencës së Vendit.

4. — Konferenca e parë përshëndeti qëndrimin e drejtë që ka marrë KQ Provizor karshi grupit të «Zjarrit», masat energjike në kohën e duhur për spastrimin dhe forcimin e Partisë dhe ndihmën e vazhdueshme që u ka dhënë anëtarëve mbi rrezikun e grupazhit.

5. — Konferenca konstatoi se nga shkëputja nga masat që ekzistonte në grupet e mëparshme, Partia është hedhur në punë me to. Kohët e fundit i është dhënë më tepër rëndësi punës me shtresat e varfëra, punë së cilës i janë parë sukseset e para.

Është ngjallur dhe forcuar në popull urrejtja kundër okupatorit, është ngjallur besimi në veten e tij dhe në forcat e gjalla. Prej aktivitetit të shokëve tanë, prej aksioneve dhe prej luftës është zhdukur nga masat ajo frikë e mëparshme që i bënte ta mbivlerësonin forcën e armikut dhe është ngjallur sidomos në disa qarqe besimi në Luftën nacional-çlirimtare dhe në fitoren.

Me parashtrimin e vijës së drejtë politike dhe me organizimin e luftës kundër okupatorit u ngjall në masat besimi në Partinë, populli pa tek Partia Komuniste udhëheqësen e sigurtë drejt fitores mbi okupatorin, pa tek Partia faktorin kryesor, nxitësin e lëvizjes antifashiste nacional-çlirimtare. Është popullarizuar Bashkimi Sovjetik për të cilin është ngjallur në popull dashuri dhe besim i madh, si atdheu i punëtorëve dhe i fshatarëve, si flamurtar i luftës për çlirimin e popujve të robëruar, është ngjallur dashuri dhe besim në Ushtrinë e Kuqe lavdiplote dhe fitimtare. Është punuar dhe janë mbërritur deri-diku rezultate në fushën e bashkimit të popullit tonë (Konferenca e Pezës, këshillat nacional-çlirimtare dhe çetat partizane dhe vullnetare). Partia ka marrë qëndrim të qartë në ngjarjet me rëndësi politike dhe ajo ka marrë qëndrimin dhe me anë traktesh, proklamata, me anë të organit të saj «Zëri i Popullit» ka shtypur lajmet në çdo qark, ajo ka përkthyer e shtypur broshura dhe libra marksiste-leniniste për lartësimin e kuadrove, është punuar në radhët e ushtrisë shqiptare dhe janë shënuar suksese; ushtria ka abstenuar nga veprimet në favor të armikut dhe në pjesë të vogla ka dezertuar herë pas here nga radhët e saja, për t'u bashkuar me çetat partizane dhe vullnetare. Në ushtrinë e okupatorit janë hedhur trakte në gjuhën italishte, janë shpërndarë komunikata dhe organi central i Partisë Komuniste Italiane «Unita».

6. — Qëndrimi i ashpër dhe njëkohësisht i drejtë i Partisë kundrejt grupit të «Zjarrit» ka shkaktuar shkëputjen e elementëve të shëndoshë të këtij grupi nga tradhëtari dhe kompromisaxhiu, arqiomarksisti «Zjarri» — Zisi Andrea, dhe kthimin e tyre në pozita të drejta.

7. — KQ Provizor ka ditur ta ruajë Partinë nga armiqtë e saj të betuar trockistët, arqiomarksistët, nga armiqtë e brendshëm dhe nga elementi antiparti përgjithësisht dhe të krijojë unitetin.

#### V

1. — Konferenca e parë konstatoi se këto grupe në përgjithësi nuk ishin të lidhura me masat, ishin larg nga puna e vërtetë komuniste, ishin në kundërshtim me njëri-tjetrin, kundërshtim që shkonte deri në luftë të ashpër. Mbizotëronte në to fryma e ngushtë e sektarizmit, oportunizmi dhe lokalizmi. Moshbattimi në jetë i vendimeve të Kongresit VII IÇK shkaktoi gabime të rënda politike dhe organizative dhe shmangie teorike. Është shfaqur në mënyrë të dukshme teoria e kuadrove, mohimi i ekzistencës së proletariatit në Shqipëri dhe si rrjedhim mohimi i mundësisë së ekzistencës së një partie komuniste. Është lavdëruar gjoja

për lidhje me IK dhe janë bërë mashtrime me një vulë<sup>1</sup> që pretendohet të ishte e Partisë Komuniste Shqiptare. Janë formuar celula të ngushta (prej 2 ose 3 personash) të shpëputura nga masat dhe me konspiracion të kalbur. Këto grupe kishin kontakt me elementë arqiomarksistë dhe trockistë dhe elementë politikisht të dyshimtë, të cilët ushtronin një influencë të madhe mbi to. Oportunizmi i tyre arriti deri në kompromis me tradhëtarin, trockistin Zai Fundon. Mbi të gjitha, ato nuk kanë marrë ose nuk kanë ditur të marrin qëndrim të caktuar në momentet politike me rëndësi, dhe kur kanë marrë kanë rënë në gabime. Lufta që ka ekzistuar në mes të tyre nuk u ka lejuar që të merrnin qëndrimin e duhur: a) në lëvizjet e ndryshme që janë bërë në Shqipëri, në çështjen e brendshme me rëndësi të vendit në 7 prill 1939; b) në luftën e dytë imperialiste; c) në luftën italo-greke dhe italo-jugosllave.

Është për t'u shënuar se gjatë kësaj kohe janë lëshuar herë pas here trakte, por ata kanë pasur parulla të gabuara, në ato është shkruar për Shqipërinë sovjetike, për Shqipërinë komuniste. Në agresionin fashist kundër URSS-it është marrë një qëndrim deri-diku i mirë, por janë lëshuar parulla të gabuara ose të parakohshme si ajo: «të thërresim popullin për kryengritje» pa pasur lidhje me të dhe pa bërë asnjë përgatitje.

Këto grupe kanë dhënë elementët e parë për formimin e Partisë dhe kanë popullarizuar deri-diku komunizmin por në mënyrën e tyre duke u fshehur prapa nacionalizmit<sup>2</sup> («Bota e re» dhe shfrytëzimi i disa rasteve legale). Këto janë për t'u shënuar si sukseset e tyre.

2. — Kanë rënë në gabime të rënda organizative. Më 1939 grupet kanë krijuar ndërmjet tyre një KQ në baza të pasinqerta dhe organizativisht të gabuara, i cili, siç ishte e natyrshme u prish më 1940; ata kanë vazhduar kështu më ashpër luftën ndërmjet tyre, të cilën për ta pushuar më vonë më 1941 kanë zgjedhur një komision arbitrazhi gjoja për të bërë një lloj koordinimi të veprimeve të tyre, i cili nuk pat sukses sepse s'kishte asnjë të drejtë dhe sepse organizativisht ishte krejtësisht i gabuar. Në nëntor 1941 kanë pranuar të shkrihen të gjithë në një parti

1 Është fjala për grupin e «Zjarrit», udhëheqja e të cilit, duke mashtruar pa pikë turpi, lëvdohej se kishte lidhje me Internacionalen Komuniste, bile, se mbante dhe «vulën» e Kominternit. Për këtë, grupi i «Zjarrit» pretendonte se vetëm ai kishte të drejtë të quhej Partia Komuniste Shqiptare.

2 Është fjala për shfrytëzimin e mundësive legale nga ana e grupeve komuniste, veçanërisht nga grupi i Korçës, i cili organizoi në shumë raste front të përbashkët me një numër nacionalistësh si në zgjedhjet bashkiake etj., nxori revistën legale «Bota e re», u fut në organizatat sportive të rinisë, të krijuara nga regjimi i Zogut etj.

dhe për këtë arsye kanë mbërritur në një mbledhje të përfaqësuesve të tri grupeve kryesore komuniste. Pas kësaj mbledhjeje është formuar menjëherë një KQ Provizor nga elementët që jepnin garancitë e duhura.

## VI

1. — Konferenca e parë e Vendit konstatoi se për të mbërritur në rezultate konkrete, për të krijuar njësinë në Parti, është dashur të kapërcehen pengesa të mëdha. Kanë penguar zhvillimin e drejtë të punës dhe orientimin e shpejtë të shokëve në punën e re të Partisë: sektarizmi, lokalizmi, konspiracioni i kalbur, familjariteti i sëmure, të gjitha mbeturina të trashëguara nga puna e vjetër e grupeve; rryma e grupit e cila është shfaqur sidomos në disa tipa ambiciozë të sëmure (Anastas Lula-Qorri, Sadik Prente-Xhepi me disa elementë rreth tyre, si dhe disa elementë të tjerë nga grupet e ndryshme) që kanë sabotuar punën e Partisë, ku janë munduar të bëjnë fraksion dhe që Partia në saje të zgjuarësisë së saj kur ka parë se nuk hynin në rrugën e drejtë, ka zhdukur punën e tyre të dëmshme të krijimit të fraksionit dhe inisiatorët janë hedhur jashtë Partisë si dhe ndihmësit e tyre; mosbesimi në suksesin, me të cilin disa shokë e kanë parë krijimin e Partisë, qëndrimi në dy karrige i disa shokëve, të cilët kanë lëvizur prej partie në miqtë e vjetër të grupit, të pabindur në çështjen e Partisë dhe inaktiviteti i tyre ka ndihmuar objektivisht aktivitetin shkatërrimtar të grupazheve.

2. — Konferenca e parë konstatoi se gjatë punës në Parti ka pasur gabime dhe lëshime: a) është nënçmuar rreziku i elementëve antiparti, trockistë, arqiomarksistë dhe i elementëve të hedhur jashtë Partisë. Anëtarët e Partisë nuk e kanë njohur mirë rrezikun trockist dhe prandaj nuk kanë ditur të luftojnë kundër tij; b) në punën me nacionalistët anëtarët e Partisë nuk kanë pasur kurdoherë pikëpamje të qarta. Disa nga këta duke mos kuptuar rolin e Partisë në këtë luftë kanë rënë në pozitën e nacionalistëve, të cilët duan që Partia të humbë personalitetin e saj dhe të shkrihet në lëvizjen nacional-çlirimtare, ata kanë pranuar nga nacionalistët idetë borgjeze dhe kanë dashur t'i importojnë në Parti. Këto mendime të çojnë drejt likuidimit të Partisë. Disa të tjerë kanë mbajtur me nacionalistët një qëndrim të ashpër dhe të papajtuësëm me vijën e drejtë të Luftës nacional-çlirimtare për realizimin e frontit të përbashkët kundër okupatorit. Në përgjithësi është kujtuar se puna me nacionalistët përmblidhet e tëra në bisedimet dhe në kombinacionet që mund të bëheshin me krerët e tyre, për këtë arsye nuk i është dhënë rëndësia e duhur punës nga poshtë; c) në grumbullimin e të gji-



tha forcave patriotike është dukur aty-këtu sektarizmi, i cili është shkaktuar nga moskuptimi i luftës dhe i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, dhe nga moskuptimi i rolit të Partisë në këtë luftë dhe është forcuar nga direktiva e marsit 1942 mbi organizimin e njëjve partizane, të cilat cilësoheshin si «fuqitë e armatosura të Partisë», e cila [direktivë] ka pasur karakter izolimi të Partisë në këtë luftë. Por kjo direktivë nuk është zbatuar pse është shtyrë nga një tjetër [direktivë] e dhënë më vonë në qershor 1942, dhe pse në atë kohë njësitë guerrile dhe çetat ishin në përgatitje. Kuptimi i ngushtë i Luftës nacional-çlirimtare ka shtyrë disa organizata, sidomos atë të Vlorës, t'i konsiderojnë këshillat nacional-çlirimtare si organizata të Partisë.

3. — a) Kuptimi i ngushtë i punës me rininë ka shkaktuar sektarizëm në mobilizimin e masave të gjera të rinisë dhe tendenca paralelizme me Partinë; b) shumë herë shokët nuk kanë qenë në gjendje të orientohen në situatat dhe kanë rënë në pozitë të turmës. Nga kjo rrjedh që parulla të pakontrolluara janë përvetësuar prej shokëve dhe janë dukur aty-këtu në komunikata dhe demonstrata; c) ka ndodhur që kanë depërtuar në radhët e Partisë elementë të pakontrolluar mirë, nga pazgjuetësia e shokëve; ç) është kufizuar shumë herë për të bërë agjitacion e propagandë dhe jo më për t'u lidhur organizativisht me masat e popullit, gjë që është shfaqur më shumë në fshat; d) është ngatërruar simpatia me influencën dhe për këtë arsye është shfaqur shpeshherë një optimizëm i ekzagjeruar që i ka bërë shokët të kënaqen me rezultate të vogla; dh) nuk i është dhënë rëndësia e duhur punës ndër punëtorët, ndër masat e gjera të punëtorëve, si në Kuçovë, në Selenicë, në punëtorët e skelave, në ata të grumbulluar në kantiere, punëtoritë e qyteteve dhe vendeve të tjera dhe në punëtorët zanatçinj, nuk është ndërhyrë fare ose është ndërhyrë fare pak; e) në krahinat e Veriut është punuar fare pak dhe sidomos, në atë të Kukësit, ku organizativisht nuk është bërë asnjë hap.

4. — a) Lartësimi i kuadrove nuk ka qenë i mjaftueshëm. Nuk u janë besuar funksione me përgjegjësi shokëve të rinj dhe kështu është monopolizuar puna në duart e disave; b) është shënuar gjithashtu një mungesë inisiative nga ana e shokëve; c) është kaluar shumë herë nga konspiracioni i tepëruar në dekonspiracion, që bashkë me mosditjen për t'u orientuar në kohë, reaksioni ka shkaktuar humbje në kuadro (Tiranë, Shkodër); ç) ka munguar ashpërsia e duhur kundër elementit grupash, shumë herë nuk janë parë në dritën e vërtetë gabimet dhe lëshimet, kështu që ka munguar qëndrimi i drejtë dhe rreptësia e duhur.

5. — Konferenca konstatoi se nga ana e organizatave të ndryshme janë vërtetuar gabime dhe lëshime, në Korçë janë shfaqur shënja lokalizmi dhe ka munguar urrejtja kundër ar-

mikut, në Shkodër shënja lokalizmi, plogështie dhe vazhdimi i gjurmave të vjetra në punë (sektarizëm); në Gjirokastrë lidhja e dobët me KQ ka shkaktuar që direktivat e KQ të interpretohen keq<sup>1</sup>.

Në të gjitha organizatat nuk i është dhënë rëndësi e duhur çështjes organizative si çështja më kryesore në Parti, janë vërtetuar dhe gabime e lëshime të tjera të një rëndësie më të vogël.

Duke marrë parasysh sukseset e mëdha që ka pasur Partia jonë brenda kësaj kohe të shkurtër, konferenca e parë ka konstatuar dhe mjaft mungesa, lëshime dhe plogështi dhe paraqet para anëtarëve detyrat që vijnë:

### Puna ndër punëtorë

Megjithëse është kaluar prej mënyrës së punës së vjetër në punën e re, prapë nuk është bërë aq sa ka qenë e mundur në masat punëtore (si në qendrat industriale të Kuçovës, Selenicës etj.). a) Për këtë gjë duhet të forcohet puna në këto qendra për t'u lidhur organizativisht me këto, që janë masat më përparimdashëse të vendit tonë, që janë masat më të shtypura e më të shfrytëzuara; në minierat dhe fushat vajguore, fabrikat dhe kantieret e ndryshme duhet të punojmë gjithashtu me punëtorët zanatçinj, të cilët përfaqësojnë pjesën më të madhe të punëtorisë. b) Duhet të futemi sa më thellë në masat e punëtorëve dhe që aty të nxjerrim anëtarë të vendosur për Partinë, duhet t'u hapim punëtorëve dyert e Partisë e sidomos sot. c) Duhet të shumojmë radhët e partizanëve me punëtorë, kështu që Lufta nacional-çlirimtare të bazohet gjithmonë në elementë të shëndoshë dhe të vendosur për të luftuar armikun deri në fund.

1 Është fjala për gabimet e rënda të kryera nga ish-Komiteti qarkor i Partisë për Gjirokastrën gjatë vitit 1942. Komiteti Qendror i Përkohshëm i Partisë kishte vënë re se Komiteti qarkor për Gjirokastrën nuk mbante lidhje me Komitetin Qendror, se në të dukeshin hapur prirjet e shkapitjes dhe të veprimtimit jashtë kontrollit nga lart. Këto prirje çonin drejt një fraksioni të rrezikshëm në Parti. Për këtë KQ i PKSH në gusht të vitit 1942 i dënoi rreptë gabimet e Komitetit qarkor të Gjirokastrës duke i dhënë atij një vërejtje të rëndë. Përgjegjës kryesor ishte Bedri Spahiu, që kryente në atë kohë funksionin e sekretarit politik të komitetit qarkor.

Komiteti qarkor i Gjirokastrës, nën influencën e Bedri Spahiut i kundërshtoi konkluzionet dhe masat e Komitetit Qendror. Përpara kësaj gjendjeje KQ i PKSH u detyrua ta shpërndante Komitetin qarkor të Partisë për Gjirokastrën në tetor 1942. Në vend të tij u zgjodh një komitet qarkor i ri.

## Puna në fshat

Punës në fshat duhet t'i jepet një rëndësi e veçantë sepse fshatarësia përbën shumicën e madhe të popullit tonë dhe prandaj aty duhet të jetë burimi i fuqive kryesore për luftën e sotme. Për këtë gjë komunistët duhet: a) të bëjnë mobilizimin e gjerë të masave fshatare për Luftën nacional-çlirimtare, pa marrë parasysh diferencën ndërmjet të pasurve dhe të varfërve; b) me anë të aksioneve, konferencave dhe meetingjeve të bëjmë mobilizimin për çetat partizane dhe vullnetare sulmuese dhe territoriale si dhe organizimin dhe forcimin e këshillave nacional-çlirimtare; c) të organizojmë masat fshatare dhe t'i çojmë në luftë, duke i mobilizuar për çështjet e përditshme, për taksat, gjobat, spekulimet dhe grabitjet e tjera të ndryshme të fashizmit; ç) të përhapim në fshatra jetën kulturele duke hapur kurse kundër analfabetizmit dhe kurse të tjera për t'u dhënë kështu mundësi fshatarëve që të kulturohen, për t'u dhënë atë që të gjitha regjimet e mëparshme ua kishin mohuar; kjo duhet të bëhet sidomos në vendet e çliruara; d) të mobilizohen për kundërshtimin me armë kundër çdo grabitjeje nga ana e okupatorit dhe e shërbëtorëve të tij; dh) të krijojmë me punë të pareshtur njësinë luftarake në mes të punëtorëve dhe të fshatarëve, njësi e cila do të jetë arma më e sigurtë në luftën e sotme nacional-çlirimtare; e) t'u shpjegojmë punëtorëve dhe fshatarëve të varfër se ata janë aleatë natyralë dhe se me luftë të përbashkët do të lirohen nga mjerimet, uria dhe shtypja dhe do të realizojnë një jetë më të mirë dhe më të lumtur.

### Puna në Ushtrinë Partizane dhe Vullnetare Nacional-Çlirimtare Shqiptare

Që të mund të bëhet Partia jonë udhëheqësja e vërtetë e Luftës nacional-çlirimtare, duhet të kuptojmë rëndësinë e formimit dhe forcimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Gjithë anëtarët duhet ta kenë të qartë që sot sektori kryesor i punës është ky, dhe se në këtë sektor megjithëse është punuar dhe janë mbërritur rezultate, këto rezultate nuk kanë qenë të mjaftueshme. Për këtë gjë është e nevojshme: a) që organizatat tona duhet të derdhin të gjithë aktivitetin e tyre për të mobilizuar sa më shumë popull nëpër njësitë partizane dhe vullnetare e sidomos prej fshatarëve dhe prej rinisë; b) të krijojmë prej një-sive partizane e vullnetare Ushtrinë Nacional-Çlirimtare të rregullt, e cila do të jetë fuqia e tmerrshme kundër okupatorit dhe garancia e sigurtë dhe e fuqishme për çlirimin e popullit; c) duhet në të gjitha njësitë dhe organizatat e Partisë të zhvillojnë punën

politike në shkallë të gjerë dhe të punojnë pa pushim duke shpjeguar qëllimin e Luftës nacional-çlirimtare, të vënë në dijeni luftëtarët mbi ngjarjet në botë dhe tek ne, të jenë shembull i disiplinës, i vendosjes, i vetëmohimit dhe guximit; të zhvillojnë dashurinë dhe shoqërinë ndërmjet luftëtarëve; ç) t'i bindim për nevojën e aksioneve kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij, tradhëtarëve të vendit, duke zhdukur çdo oportunitet që duket në këtë drejtim; d) të plotësojmë radhët e Partisë me luftëtarët më të mirë, më të vendosur, më të disiplinuar.

## Puna në rini

1. Konferenca e parë e Vendit konstatoi se me krijimin e organizatës së Rinisë Komuniste, me vijën e drejtë dhe me ndihmën e dhënë prej KQ Provizor të Partisë puna me rininë është vënë në rrugën e drejtë dhe janë arritur suksese të rëndësishme. Por megjithatë në Rininë Komuniste nuk përfshihen masa të rinisë; kjo ka rrjedhur ngaqë shokët nuk e kanë kuptuar mirë vijën e punës në rini dhe nuk kanë punuar sa duhet dhe me kujdesin e duhur.

Duke marrë parasysh se rinia është burimi i gjallë i fuqive të reja të Partisë, se rinia është fuqia e pashtershme e Luftës nacional-çlirimtare, përpara organizatave dhe anëtarëve të Partisë paraqiten këto detyra: a) të kuptohet mirë vija e Partisë me rininë; b) të vihet në dijeni rinia jonë mbi jetën e lumtur dhe kulturele dhe mbi luftën heroike të rinisë së URSS-it, e cila na jep shembull se si i shërbehet popullit të vet. Gjithashtu të vihet në dijeni mbi luftën plot vetëmohim dhe trimëri të rinisë së popujve të robëruar, po në këtë rrugë duhet edhe ne të drejtojmë rininë në këtë luftë të shenjtë çlirimtare të popullit tonë; c) t'i shpjegohet rinisë se çka i ka prurë reaksioni dhe fashizmi; ç) t'i jepet ndihmë më e madhe nga ana e shokëve këtij sektori kaq me rëndësi; d) të grumbullohet rinia e fshatit dhe e qytetit me anë të mbledhjeve, konferencave, shoqërive sportive, kulturele e të tjera dhe të ndihmohet rinia komuniste për të tërhequr rininë nga çdo influencë e fashizmit, të grumbullohet rinia antifashiste dhe të drejtohet në luftën kundër okupatorit për një të ardhshme më të mirë dhe më të lumtur.

## Puna me gra

1. Konferenca e parë e Vendit konstatoi se pas formimit të Partisë janë hedhur hapat e parë në punën me gra dhe është ndërhyrë deri-diku në masat e grave të qytetit, sidomos në intelektualët, por ende jo në punëtorët e në fshataret.

Megjithëse gruaja tek ne gjendet në kondita të veçanta dhe të vështira, në disa krahina nën ferexhe, me gjithë gjurmët e skllavërisë shekullore dhe të shtypjes së rëndë të okupatorit fashist, i cili i pruri gruas shqiptare mjerime, vuajtje, shnderime, shokët tanë nuk i kanë vënë ende rëndësinë e duhur këtij sektori të punës dhe nuk kanë punuar aq sa kanë pasur mundësi.

Duke marrë parasysh rëndësinë e rolit të gruas në shoqëri dhe veçanërisht në Luftën nacional-çlirimtare, para organizatave dhe anëtarëve të Partisë paraqiten këto detyra: a) të mobilizohen masat e gjera të grave për nevojat e para të jetesës; b) të formohet fronti antifashist i gruas shqiptare, duke organizuar këshillat antifashiste të grave, të cilat do të grumbullojnë dhe do të mobilizojnë masat e grave të çdo shtrese shoqërore e të çdo tendence politike; c) duhet të organizojmë mbledhje, konferenca, kurse kundër analfabetizmit, kurse infermiere e të tjera; ç) të mobilizohen gratë për Luftën nacional-çlirimtare dhe të marrin pjesë aktive në të në mënyra të ndryshme (luftëtare, infermiere etj.) dhe kështu të luftojnë për çlirimin kombëtar dhe për një të ardhshme më të lumtur.

#### **Ndihma viktimave të reaksionit dhe rëndësia e fondit nacional-çlirimtar**

Me luftën që bën populli ynë me Partinë Komuniste në krye kundër okupatorit të ndyrë dhe tradhëtarëve të popullit tonë ka pasur dhe ka për të pasur shumë viktima për të ndihmuar. Prandaj duhet të mobilizohet i tërë populli. Armiku okupator vazhdon me terrorin e tij të shtypë popullin, reaksioni rritet gjithnjë si dhe numri i atyre që kanë nevojë për ndihmë. Prandaj është e nevojshme të kujdesohemi seriozisht dhe t'i përvishemi punës sistematikisht për të ndihmuar viktimat e reaksionit. Që të mund të vazhdojmë Luftën nacional-çlirimtare si duhet, është e nevojshme të krijojmë rrjetën e fondit nacional-çlirimtar që do të shtrihet në të gjitha këshillat nacional-çlirimtare dhe i cili duhet të derdhë aktivitetin më të madh për mbledhjen e ndihmave në të holla, në ushqime e në të tjera lëndë për të ndihmuar Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, familjet e luftëtarëve të vrarë ose që ndodhen në radhët e kësaj ushtrie, ata që janë djegur ose [kanë] ikur nga vatrata e tyre para okupatorit dhe familjet e varfëra. Kësaj pune organizatat duhet t'i japin një rëndësi të veçantë; në këtë mënyrë bëhet lidhja e ushtrisë me popullin dhe e popullit me luftën.

#### **Detyra organizative**

1. — Konferenca e parë e Vendit e Partisë Komuniste Shqiptare paraqiti si detyra më kryesore para të gjitha organizatave dhe të gjithë anëtarëve forcimin dhe zgjerimin e organizatave të Partisë, forcimin e njësisë së Partisë dhe ngritjen e kuadrove. Këto detyra, sot që gjendemi në Luftën nacional-çlirimtare, janë akoma më kategorike, më të mëdha dhe më me përgjegjësi. Për këtë gjë: a) duhet të forcojmë punën e celulave, si në terren ashtu edhe në U[shtrinë] P[artizane] dhe V[ullnetare] N[acional]-Ç[lirimtare] Sh[qiptare], të ndajmë punën në mënyrë të drejtë në to, t'i mbledhim patjetër rregullisht; b) t'i kushtojmë kujdes të veçantë zhvillimit të celulave në punëtori; c) të krijojmë organizata të Partisë në fshat, se pa ato puna e Partisë dhe e Luftës nacional-çlirimtare nuk do të ketë sukses; shokët duhet të kenë kujdesin më të madh në këtë gjë e sidomos ata që punojnë në krahinat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut; ç) të zhdukim sektarizmin e vjetër përsa i përket futjes në Parti të anëtarëve të rinj, sidomos sot që ndodhemi në Luftën nacional-çlirimtare ku lindin luftëtarë të vendosur, të disiplinuar, të dhënë e të guximshëm; d) sot sidomos organizatat duhet t'i kushtojnë kujdes futjes së grave në Parti dhe veçanërisht grave të shtresave të varfëra të fshatit e të qytetit dhe t'i ngrënë këto politikisht, kështu që të bëhen udhëheqëse; dh) duhet të punojmë në ushtrinë shqiptare për ta prurë në pozitë e Luftës nacional-çlirimtare, gjithashtu në atë të okupatorit duke krijuar aty këshilla antifashiste dhe antilufte.

2. — Kuadri ynë i ri nuk do të mund të kryejë me sukses detyra të shumta dhe të ndryshme dhe nuk do të mund të dallojë ndryshimin ndërmjet çështjeve aktuale kryesore dhe çështjeve të vogla në këtë situatë të komplikuar, në qoftë se nuk punohet mjaft për ngritjen e nivelit politik dhe teorik të tij; për këtë arsye Konferenca e parë i ngarkon udhëheqjes: a) të bëjë luftë energjike kundër paditurisë, sepse nga kjo rrjedhin shumë gabime dhe devijime; b) të bëhet çmos për t'u dhënë mundësi anëtarëve që sa më shpejt dhe me baza të shëndosha të marrin mësim me frymë marksiste-leniniste dhe të lartësohen në këtë drejtim; c) të stërviten anëtarët që të mësojnë edhe në këtë kohë lufte, sepse sidomos sot është më e madhe nevoja; të luftojmë dhe të zhdukim pikëpamjen që kanë akoma shumë shokë se sot është koha e luftës dhe jo e librit, bashkë me pushkën duhet edhe libri; ç) i ngarkohet udhëheqjes shumëzimi i literaturës marksiste-leniniste dhe vazhdimi i shumëzimit të Historisë së Partisë Komuniste (bolshevike) të URSS-it, e cila është një pasuri e paçmueshme e një eksperiencë e madhe që na mëson se si të krijojmë dhe të lartësojmë kuadrot, se si të luftojmë



oportunizmin dhe devijimet e ndryshme dhe se si të përvetësojmë teorinë marksiste-leniniste; d) të kapërcejmë pengesat dhe vështirësitë që paraqiten dhe të organizojmë një kurs për Historinë e Partisë Komuniste (bolshevike) të URSS-it për lartësimin e shokëve; dh) t'u japim mundësi shokëve që të mësojnë në rrethe (kruzhok) ose individualisht; e) të mësohen shokët që ta punojnë materialin e Partisë dhe të kenë kujdes për të; ë) shokët udhëheqës duhet të kenë marrëdhënie të ngrohta dhe shoqërore me shokët e tjerë; f) duhet të luftohet çdo shenjë qëndrimi komanduesi në radhët e Partisë.

3. — Dukjet sektare brenda në Parti duhet të zhduken: a) duhet t'u jepet mundësi shokëve që të shfaqin cilësitë e tyre dhe të vihen në vendet më të përshtatshme ku mund të japin më shumë për Partinë; b) të zhduket frika për t'i vënë shokët e rinj në vende me përgjegjësi; c) të zhvillohet inisiativa mbasi kjo mungon përgjithësisht te shokët; ç) shokët ose forumet më të ulta nuk duhet të presin çdo gjë nga lart, për këtë gjë shokët duhet të jenë të aftë të përballojnë situatën; d) në Parti besohet dhe kontrollohet; kontrolli i cili duhet të jetë i vazhdueshëm bëhet për përmirësimin e kuadrove; në këtë mënyrë zgjidhen kuadrot dhe zhvillohet kujdesi për ta; dh) duhet të zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë te anëtarët dhe sidomos te shokët udhëheqës.

4. — Përsa i përket zgjuetësisë<sup>1</sup> është bërë mjaft por jo aq sa duhet, a) duhet të zhvillohet në shokët zgjuetësia kundër provokacionit që armiku mundohet me çdo mënyrë të futë në radhët tona, kundër armiqve të fshehtë; b) të luftohet importimi i çdo ideje të huaj të cilën armiqtë tanë të ndryshëm mundohen ta futin në radhët tona; c) të luftohet çdo mbeturinë negative e vjetër që ka mbetur si trashëgim te shokët; ç) duhet të luftohen pa mëshirë deviatorët e ndryshëm dhe të mos lëmë kështu që të hyjë asnjë sëmundje në radhët tona; d) të jemi vigjilentë përsa i përket pranimit të anëtarëve të rinj; celula ka të drejtë të plotë të pranojë anëtarë të rinj përveç të përjashtuarve, pa pritur vendimet e forumeve më të larta; anëtarëve të rinj duhet t'u shpjegohet q'është Partia, roli dhe rëndësia e saj.

5. — Duhet të luftojmë pa mëshirë kundër elementëve trockistë, kundër të gjithë deviatorëve dhe armiqve të Partisë; duhet të merret seriozisht spastrimi i Partisë nga elementët e luejtshëm, inaktivë dhe të pavendosur dhe sidomos nga elementët grupashë. Organizatat dhe anëtarët duhet të vazhdojnë pa mëshirë luftën kundër armikut të I[nternacionales] K[omuniste] dhe të Partisë sonë, trockistit Zai Fundo dhe elementëve të ndryshëm trockistë: Dhimitër Fallos, Aristidh Qendros, Niko Xoxit,

<sup>1</sup> Zgjuetësisë — vigjilencës

Niko Kondit, Andrea Zisit etj. Nuk duhet harruar se Zai Fundo dhe disa plehra të tjerë trockistë kanë lidhje dhe influencë mbi disa patriotë të ndershëm, prandaj është detyrë e organizatave dhe e shokëve për t'i demaskuar hapur këta banditë.

6. — Pasi armiku po mundohet me çdo mënyrë të zbulojë organizatat tona paraqitet si detyrë të forcojmë konspiracionin dhe kështu të mos i japim mundësi armikut të na dëmtojë. Duhet gjithashtu të përforcojmë dhe të çelnikosim disiplinën në radhët tona.

Duhet të nënvizohet se qëndrimi i shokëve tanë karshi pushtetit të okupatorit ka qenë përgjithësisht i mirë. Partia jonë e re mbahet krenare me këtë gjë. Por ka pasur edhe disa që kanë pasur një qëndrim të dobët, ndërmjet të cilëve provokatori i ndyrë Ludovik Nikaj.

Duhet që të gjithë shokët që bien në duart e armikut të qëndrojnë ashtu siç u ka hije anëtarëve të Partisë Komuniste, duke ngritur përmbi të gjitha emrin e Partisë, duke mbrojtur gjithmonë interesat e saj dhe të popullit tonë.

\*  
\* \*

Konferenca ka për të bërë një kthesë të madhe në punën e Partisë, ku është shfaqur uniteti i plotë, ku të gjithë anëtarët janë të gatshëm për luftë të pamëshirshme kundër çdo të mete të dëmshme për spastrimin e radhëve të Partisë dhe për përforcimin dhe zgjerimin e saj. Konferenca ka kuptuar rëndësinë e disiplinës dhe se çfarë rreziku janë për Partinë tonë banditët trockistë dhe elementët deviatorë, të cilët Partia është gati t'i bëjë të padëmshëm.

Megjithëse para Partisë sonë të re paraqiten detyra të shumta dhe të rënda ajo do të shkojë me krenari drejt fitores definitive nën flamurin e IK, të Leninit dhe të Stalinit, dhe do të plotësojë detyrën karshi masave punonjëse dhe karshi popullit tonë.

Duhet të jemi të pamëshirshëm dhe në radhët e para të luftës kundër armikut të betuar të njerëzimit dhe të popullit tonë, kundër fashizmit.

Duhet të krijojmë dhe të spastrojmë Partinë si na ka mësuar i madhi Lenin, si na ka mësuar i madhi Stalin, duke krijuar partinë më revolucionare dhe të marrim vend të merituar në radhët e lavdishme të IK.

*Botohet sipas kopjes së  
shpërndaruar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## THIRRJE E KQ TË PKSH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR

7 prill 1943

POPULL SHQIPTAR!

Katër vjet me radhë po rëndon mbi popullin shqiptar zgjedha e robërisë fashiste. Më 7 prill 1939 fashizmi italian shkeli tokën tonë dhe katër vjet me radhë ai u mundua ta bëjë popullin shqiptar skllav të bindur në interesat e tij grabitëse dhe gjakatare. Por 7 prilli i vitit 1943 e gjen fashizmin kudo në botë në rrugën drejt varrit dhe popullin tonë në luftë të armatosur kundër zaptuesit dhe hyzmeqarëve të tij.

Ofensiva e madhe sovjetike po i shkakton fashizmit disfatat më të tmerrshme. Me miliona gjermanë u vranë dhe po vriten në fushat e Rusisë, armata të tëra të Hitlerit po asgjësohen dhe po zihen rob, katunde dhe qytete po çlirohen nga tirania fashiste. Stalingradi u bë varri i ushtarëve më të zgjedhur të Hitlerit dhe Ushtria e Kuqe po shkon dita-ditës nga fitorja në fitore drejt çlirimit të tokave sovjetike, drejt asgjësimit të plotë të ushtrive hitleriane, drejt zhdukjes së plotë të fashizmit nga faqja e dheut. Vetëm popujt e Bashkimit Sovjetik, të njëjtë në një bllok të përbashkët, popujt që kanë jetuar 25 vjet rresht të lirë dhe të lumtur, vetëm këta popuj, me Ushtrinë e Kuqe heroike mundën të qëndrojnë për kaq kohë kundër ushtrisë gjermane dhe duke e dërmuar tmerrësisht t'i japin grushte vdekjeje. Ushtria e Kuqe e tregoi se si korren fitoret dhe fitimet e lavdishme të saj po shpejtojnë dita-ditës çlirimin e popujve të robëruar nga fashizmi.

Aleatët e mëdhenj anglo-amerikanë po i japin grushte fashizmit. Sulmet ajrore mbi Italinë dhe Gjermaninë, zbarkimi në Afrikën Veriore dhe thyerja e ushtrive gjermano-italiane në Tripoli po shpejtojnë çeljen e frontit të dytë në Evropë. Lufta nacional-çlirimtare e popujve të robëruar ka marrë përpjesëtime të mëdha dhe po shkon duke u forcuar dita-ditës në të gjithë Ev-

ropën. Me goditjet e forta që po i jep koalicioni sovjeto-anglo-amerikan forcohet dhe po realizohet fronti i madh antifashist.

Përpara kësaj situate të dëshpëruar dhe disfate të paevituar fashizmi përpiqet të luajë kartën e tij të fundit. Ai mobilizon me forcë Evropën e skllavëruar për ta bërë mish për topa dhe për të mundur kësisoj të mbushë radhët e ushtrisë së tij të dërmuar nga grushtet e rënda të aleatëve.

POPULL SHQIPTAR, PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË  
DHE INTELEKTUALE ATDHEDASHË!

7 prilli është dita e robërisë, dita e zisë, është dita e zgjedhës së rëndë të okupatorit, e tradhëtisë së ndyrë, por është njëkohësisht dhe dita e dëshmorëve të popullit. Më 7 prill fashizmi italian u shtrua në vatrat tona dhe filloi sistematikisht luftën e tij të poshtër për zhdukjen e qenies së popullit shqiptar, zakoneve, gjuhës dhe traditave të popullit tonë, ai përgatiti grabitjen e pasurisë shqiptare; bankat dhe shoqëritë e mëdha italiane shtinë në dorë pasuritë e vendit dhe filluan të hipotekojnë tokat; ai përvetësoi gjithë ekonominë e vendit tonë për të ndihmuar ekonominë e tij luftarake; prodhimet e fshatarit shqiptar u grumbulluan nga entet grabitqare të Romës e të tradhëtarëve të vendit tonë. Kosëri i urisë po shkreton dhe kërcënon vatrat tona. Fashizmi e bëri vendin tonë vend armësh dhe fushë lufte për qëllimet e tij grabitëse; ai na dogji dhe hodhi në mjerim krahina të tëra. Na dha një qeveri kukull, që të mund të na grabiste, të na fashistizonte, të na lidhte më mirë pas qeverisë së tij. Fashizmi dhe tradhëtarët u përpoqën të mobilizojnë djallërinë shqiptare me një ushtri vegël të ushtrisë së tij të turpshme dhe të na lyente duart me gjakun e popujve me aventurat e tija të poshtra; ai u përpoq të na zhdukte rininë dhe ta bënte atë një rini pa ndjenja e pa shpirt, ta bënte skllave dhe ta përdorte për qëllimet e tij. Rrena, demagogjia dhe grabitja u pasuan nga shtypja dhe nga reaksioni i tërbuar. Në burgje, në fusha përqëndrimi u bënë torturat më të egra mbi djemtë e popullit tonë që luftuan zgjedhën; ekzekutimet e patriotëve të marrë peng dhe ekzekutimet në masë kanë qenë dhe janë arma e tij e preferuar. Por dita e 7 prillit u bë dita e bashkimit të gjallë të popullit tonë, u bë dita e kushtrimit dhe e luftës së pamëshirshme për çlirimin e popullit tonë nga zgjedha e huaj. Populli shqiptar nuk i hodhi armët, ai grumbulloi forcat dhe në greva e në demonstrata u gjakos me okupatorin dhe ushtarët e tij. Gjaku i djemve të popullit vaditi rrugët e qyteteve dhe të fshatrave e zemrat e shqiptarëve u bashkuan dhe u forcuan në luftën për liri. Zaptuesi dhe tradhëtarët mobilizuan milicinë dhe e hodhën në vëlla-

vrasje; fshatrat u dogjën prej kriminelëve fashistë dhe shërbëtorit Merlikë si masë reprezalje dhe terrori. Banditët fashistë, që kanë rënë në nivelin e shtazëve, djegin, vrasin dhe në gjak, vuajtje e lot shkatërrojnë fshatrat dhe qytetet tona, por nga këto gërmadha të lyera me gjak e lot dalin vuajtjet, dëgjohet zëri i urrejtjes së tmerrshme dhe i hakmarrjes së popullit të robëruar. Populli shqiptar nuk u tremb aspak nga vdekja, as nga djegia, por rroku armët dhe doli malit për të fituar lirinë, për të mbrojtur nderin dhe vatrat, që po i shkelte dhe po i digjte armiku. I tërë populli ushqen një qëllim, vdekjen e fashizmit italian e gjerman dhe të bandave fashiste të cilat populli ynë i urren me gjithë shpirt.

Partia Komuniste Shqiptare, pjella e popullit, e lidhur ngushtë me popullin tonë, vuri gjithë forcat e saja për mbrojtjen e vendit dhe të interesave të tij. Për çlirimin e atdheut anëtarët e saj më të zgjedhur sakrifikuan jetën dhe ranë heroikisht në rrugët e qyteteve dhe të fshatrave, në fusha e në male të Shqipërisë; të tjerë vazhdojnë luftën e ashpër duke qenë gjithmonë në rreshtat e parë dhe në vendet më të rrezikshme. Partia Komuniste që në fillim të kësaj lufte ka thirrur dhe po thërret patriotët dhe nacionalistët e ndershëm për krijimin e një fronti të përbashkët antifashist të të gjithë popullit shqiptar për çlirimin kombëtar. Partia Komuniste ka treguar dhe po tregon me vepra vendosjen, sinqeritetin dhe patriotizmin në luftë për çlirimin e atdheut dhe për krijimin e këtij fronti. Në këtë luftë çlirimtare ku luhet fati i popullit shqiptar, gjithë energjitë e shëndosha duhet të grumbullohen drejt një objekti të qartë: dëbimit të armikut. Kundër realizimit të këtij bashkimi armiku është përpjekur me forcë, me terror, me dhëpëri dhe me dallavere ta shpartallojë këtë front të përbashkët të popullit tonë. Tradhëtari Merlika përdori çdo mjet: demagogjinë, rrenën, «përrallën e Shqipërisë së madhe», për të shkëputur një pjesë të nacionalistëve dhe për ta bërë këtë vegël të tij, për të goditur me sukses patriotët shqiptarë dhe për të shuar Luftën nacional-çlirimtare. Tradhëtari Merlika nuk mundi të realizojë planin e tij djallëzor, se bashkimi i popullit tonë dita-ditës po forcohej dhe po realizohej në përpjekje dhe në luftë. Fashizmi me Mustafa Krujën kanë shtrënguar litarin rreth qafës së popullit shqiptar për ta trembur dhe për të lëkundur besimin në fitore. Këtë gjë ka vazhduar qeveria qesharake e Eqrem Libohovës, e cila kishte po atë mision si dhe kjo e Bushatit duke ndjekur kësaj veprën e përgjithshme të tradhëtarit Mustafa Kruja; por populli ynë dhe patriotët e ndershëm e dinë mirë ç'po u përgatit armiku dhe këta nuk do ta lidhin kurrë fatin e tyre me atë të bastardëve, të cilët e kanë lidhur me atë të Musolinit e të Hitlerit, pse çdo ndihmë që i jepet fashizmit dhe veglave të tija zgjat robërinë

e popullit tonë. Qeveria tradhëtare e Maliq Bushatit po vazhdon politikën kriminale dhe gjakpirëse të Mustafa Merlikës për të mashtruar disa nacionalistë dhe një pjesë të popullit dhe për të humbur kësajsoj objektivin e vërtetë të luftës kundër okupatorit. Me qeverinë e Bushatit dalin përsëri në skenë parullat «ushtria dhe xhandarmëria shqiptare» e një farë «indipendence të qeverisë kundrejt okupatorit», dhe njëkohësisht dalin parullat «Roja e Shqipërisë së madhe» dhe «rreziku grek e serb». Fashizmi me anë të tradhëtarit Bushati kërkon të shpartallojë Frontin Nacional-Çlirimtar dhe të shtypë luftën që bën populli ynë. Fashizmi nën hijen e këtyre manevrave përgatit fushën për masa të ashpra për të shtypur lëvizjen e popullit dhe në lidhje me këtë ai solli Parianin, një nga njerëzit më të besuar të tij, njeriun që ka përgatitur okupacionin italian në Shqipëri, armikun e betuar të popullit shqiptar.

**POPULL SHQIPTAR, PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË  
DHE INTELEKTUALË ATDHEDASHËS!**

Lodra e armikut është e qartë, ai mundohet të na përçajë, dhe kësajsoj të na skllavërojë më mirë. Para kësaj gjendjeje ne nuk duhet të rrimë me duar kryq, por duhet të ndjekim shembullin e lavdishëm të të parëve tanë që kanë derdhur gjakun, pse prej kësaj lufte varet e ardhshmeja jonë. Prandaj ne u drejtohemi të gjithë shqiptarëve të ndershëm që e duan me gjithë shpirt Shqipërinë, të bashkojnë të gjitha forcat e tyre dhe t'i vënë në shërbim të Luftës nacional-çlirimtare, të shtrëngojnë rreshtat e tyre në Frontin Nacional-Çlirimtar. Rrokni armët dhe bashkohuni me çetat partizane dhe vullnetare nacional-çlirimtare shqiptare dhe krijoni çeta të reja. Fati i vendit tonë varet nga lufta që po bëjmë dhe sa më e gjerë dhe e ashpër do të jetë kjo luftë kundrejt zaptuesit, aq me e shpejtë do të jetë dita e çlirimit.

**POPULL SHQIPTAR, KATUNDARË, PUNËTORË, QYTETARË  
DHE INTELEKTUALË ATDHEDASHËS!**

Ju që jeni shtylla e kombit tonë dhe që e ndjeni rëndë peshën e zgjedhës fashiste, forconi radhët tuaja dhe hidhuni si një trup i bashkuar në luftën për çlirimin e tokës sonë dhe për një të ardhshme të lumtur të popullit shqiptar. 7 prilli duhet të jetë dita e mobilizimit të fuqive të popullit shqiptar dhe pushkët tona le të buçasin në fusha dhe në male, t'i shkaktojnë vdekjen fashizmit dhe veglave të tija dhe të sjellin lirinë e popullit të shumëvujtur.



## NACIONALISTË DHE PATRIOTË SHQIPTARË!

Përpara ne të gjithëve paraqitet detyra e madhe dhe e shenjtë për të çliruar atdheun nga prangat e zaptuesit fashist. Flamurin e lirisë ta çojmë më lart dhe të bashkuar më tepër se kurrë t'i sulemi armikut me vrull për të fituar independencën e atdheut tonë të dashur. Të hedhim tej çdo mosmarrëveshje që pengon vrullin e luftës sonë, të shqelmojmë pa mëshirë pengesat që ndalin përpjekjet tona, të forcojmë bashkimin e gjithë popullit shqiptar dhe të luftojmë pareshtur kundër okupatorit dhe tradhëtarëve të vendit për një Shqipëri të lirë, independente dhe demokratike.

### RINI SHQIPTARË!

Ti që ke qenë në radhët e para të luftës për liri dhe independencë, që ke vaditur dhe po vadit me gjakun tënd të kulluar tokën e Arbërit, që ke dhënë fytyrat më heroike të Luftës nacional-çlirimtare, ti që ke qenë larg çdo kompromisi dhe paragjykimi, trashëgim nga okupacionet dhe influencat e huaja, që gjithmonë nuk ke menduar veç për të mirën e atdheut dhe të popullit, ti duhet të jesh flamurtarja e përpjekjes për bashkimin e popullit shqiptar, ti duhet të jesh shpirti i çetave partizane dhe vullnetare, sepse ekzistenca tënde është në rrezik dhe sepse ti lufton për një jetë më të mirë dhe për një të ardhshme më të lumtur.

### PARTIZANË DHE VULLNETARË!

Vazhdoni luftën guximtare kundër shkelësit të vendit tonë, ngrini lart e më lart flamurin e lirisë, për të cilin populli shqiptar me shekuj ka derdhur gjakun. Me tërbim dhe pa pushim bini armikut të urryer, zmadhoni dhe zgjeroni rreshtat tuaja dhe të bashkuar kësisoj do të shkoni drejt kryengritjes së përgjithshme.

### POPULL SHQIPTAR!

Lufta për çlirimin kombëtar nga zgjedha e fashizmit italian kërkon prej gjithë shqiptarëve kontributin e tyre. Asnjë shqiptar i ndershëm dhe atdhedashës nuk duhet të rrijë jashtë kësaj lufte. Në luftë për lirinë dhe fatlumturinë e Shqipërisë, populli shqiptar nuk është vetëm. Lufta e tij është e lidhur me luftën e Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës si dhe me luftën e

gjithë popujve të robëruar. Populli shqiptar lufton për një Shqipëri të lirë, independente dhe demokratike, lufton për një çështje të drejtë dhe do të fitojë.

POSHTË FASHIZMI I URRYER DHE VEGLAT E TIJA TRADHËTARË!

RROFTË BASHKIMI I POPULLIT SHQIPTAR NË LUFTË KUNDËR OKUPATORIT!

RROFTË LUFTA NACIONAL-ÇLIRIMTARE E POPULLIT SHQIPTAR!

RROFTË SHQIPËRIA E LIRË, INDEPENDENTE DHE DEMOKRATIKE!

RROFTË KOALICIONI I FUQISHËM SOVJETO-ANGLO-AMERIKAN!

RROFTË BASHKIMI SOVJETIK DHE USHTRIA E KUQE LAVDI-PLOTE QË PO I JEP GRUSHTE VDEKJEJE FASHIZMIT DHE QË SHPEJTON ÇLIRIMIN E POPUJVE!

RROFTË PARTIA KOMUNISTE SHQIPTARE QË QËNDRON E PAPËRKULSHME DHE NË RADHËT E PARA TË LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE!

### KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN E USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

10 prill 1943

KOMITETIT QARKOR...<sup>1</sup>

Shokut...

Ndodhemi në kohë të organizimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare; për këtë gjë dhe që të mund të drejtojmë lëvizjen nacional-çlirimtare, e cila po zhvillohet në kryengritje, është i nevojshëm krijimi i njëjësive më të mëdha si edhe i shtabeve më të larta. Sikundër që kemi biseduar dhe sikundër u vendos, krijimi i shtabit kryesor dhe i shtabeve të tjera është i domosdoshëm. Nga çështja teknike dhe praktike është parë që ekzistenca e çetave dhe veprimtaria e tyre nuk mund të drejtohen vetëm nga ana e udhëheqësve të çetës, por duhet që të krijohet shtabi i zonës së operacionit. . . .<sup>2</sup> Kjo është parë e arësyeshme, dhe zona. . . . do të jetë objektiva ushtarake e veprimtarisë suaj. Edhe një shpjegim të vogël para se të kalojmë në shpjegimin se si formohet shtabi. Përpara nesh po hapen perspektiva të mëdha për organizimin e njëjësive më të mëdha të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Partizane dhe Vullnetare Shqiptare (UNÇPVSH); tani s'na paraqiten vetëm aksione të vogla, por na paraqitet çështja e çlirimit të Shqipërisë, dhe kjo gjë nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë çetave, por ka nevojë për një ushtri të rregullt. Që të mund të bëjmë këtë gjë, duhet të bëhet mobilizimi i gjerë dhe krijimi i çetave, batalioneve, aradheve dhe njëjësive më të mëdha. Kalojmë tani në çështjet teknike të formimit të shtabit të zonës.

<sup>1</sup> Pikat janë të vetë dokumentit.

<sup>2</sup> Shtab zone u krijua vetëm për qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë, me emrin «Shtab i Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastrë». Në qarqet e tjera të vendit u krijuan shtabe qarqesh ose shtabe grupesh.

1) Duhet të përgatitet politikisht terreni për këtë gjë me nacionalistët e ndershëm të asaj zone, duke shpjeguar nevojën e krijimit të këtij shtabi. Këtë gjë duhet ta bëni së bashku me organizatën e. . . .

2) Pjesëtarët e domosdoshëm të shtabit janë: komandanti (i cili është mirë të jetë nacionalist i ndershëm), komisar politik, zëvendësit e tyre (në qoftë se keni kuadro për të vënë nënkomisar politik, mirë, nëse jo, bëni pa to), pjesa operative, d.m.th. një njeri dhe mundësisht edhe zëvendësi i tij, të cilët të kenë haber nga planet e luftës (nëse i pari është nacionalist, i dyti, zëvendësi, duhet të jetë patjetër anëtar partie). Këta janë pjesëtarët e domosdoshëm të shtabit të zonës. Përveç këtyre mund të jenë në shtab edhe disa persona të tjerë me influencë nga terreni. Detyra e shtabit është që të drejtojë të gjitha veprimet që do të bëhen në atë zonë. Këtij shtabi i drejtohen të gjitha shtabet dhe njësitë më të ulëta. Anëtarët e tij, pjesa e domosdoshme, qëndrojnë së bashku në një vend, prej të cilit mund të drejtojnë operacionet e zonës. Kjo gjë nuk duhet të kuptohet ngurt; kur ka veprime me rëndësi, një pjesë ose krejt shtabi mund të shkojnë për të drejtuar. Kjo zonë mund të ndahet vetëm në dy ose në tri pjesë. Aradha duhet të ketë shtabin e vet, përbërja e të cilit është si ajo e zonës; ajo duhet të ketë lidhjen e gjallë me anë të dy korrierëve shumë të vendosur dhe anëtarë partie, të cilët do të bëjnë postën e shtabit të zonës, prej të cilit do të merren udhëzimet e planet e luftës. Derisa të krijohen aradhet, po këtë gjë duhet ta bëjnë çetat e batalionit. Dy korrierë nga më të vendosurit, anëtarë partie, bëjnë lidhje me Shtabin kryesor të UNÇPVSH. Duhet gjithashtu të kemi lidhje me shtabet e zonave kufitare. Afër shtabit të zonës duhet të jetë intendenca e shtabit të zonës, e cila do të kujdeset për ushqime e veshmbathje të ushtrisë së zonës përkatëse, plaçkat që i zihen armikut nga ana e njëjësive të ndryshme i dorëzohen shtabit të zonës, i cili i shpërndan sipas nevojave.

Përsa u përket detyrave të komandantit e të komisarit politik nuk po ju shkruajmë, se ju i dini vetë. Po ju shkruajmë vetëm përsa i përket pjesës operative. Këta bëjnë planet e luftës (sulmet dhe ritiratat etj.) në bazë të informatave dhe të njohurive të tyre dhe i parashatrojnë në shtab për diskutim; pas vendimit të shtabit u shpërndahen direktivat ose urdhërat njëjësive të ndryshme të zonës përkatëse. Komisar politik ose zëvendësi mban lidhje me Partinë me anën e sekretarit politik të qarqorit të vendit ku ndodhet shtabi. Gjithashtu organizata e Partisë në ushtri duhet të derdhë aktivitetin maksimum; këtë aktivitet e ndihmon, e udhëheq dhe e kontrollon komisar politik ose zëvendësi.

Organizimi i shtabit të zonës është çështje urgjente për krahinën tuaj. Njëkohësisht e përsëris se duhet të marrin pjesë atje edhe nacionalistët të ndershëm me influencë dhe që e kanë marrë

me gjithë mend luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve të vendit.

Sikundër kemi biseduar na dërgoni sa më shpejt emrat e personave që mund të bëjnë pjesë në Shtabin kryesor të UNCPVSH.

Ndërkaq, duke organizuar shtabin, mos i pezulloni aksionet, por vazhdoni sipas planeve që kenit.

Me përshëndetje shoqërore  
Për Komitetin Qendror

*Shpati*<sup>1</sup>

PS — Udhëzimet me hollësi jua dërgojmë së shpejti; kjo letër le t'ju ndihmojë derisa t'ju çojmë direktivat e duhura.

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

<sup>1</sup> *Shpati* — një nga pseudonimet e shokut Enver Hoxha gjatë Luftës nacional-çlirimtare.

## QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME KRIJIMIN E ORGANIZATËS ANTIFASHISTE TË GRAVE SHQIPTARE

14 prill 1943

Të dashur shokë,

Në luftën kundër okupatorit fashist, në këtë luftë vendimtare për popullin tonë, gruaja lot një rol me rëndësi. Para këtij faktori të rëndësishëm të Luftës nacional-çlirimtare, organizatës i paraqiten disa detyra, nga të cilat më kryesorja është formimi i frontit antifashist të gruas shqiptare.

Për formimin e këtij fronti duhet të grumbullohen masat e gjera të grave të çdo kategorie e të çdo shtrese shoqërore. Konferencat janë mjeti më i mirë ku mund të grumbullohen gratë, por këto nuk do të jenë mbledhje akademike për të biseduar probleme jashtë jetës praktike; grumbullimi duhet të lindë prej nevojave të tyre konkrete — kërkesë buke, protestë kundër internimeve, protestë kundër kërcënimeve, pushkatimeve etj. Në këto mbledhje e konferenca nuk do të bëhet vetëm politikë e lartë, por do të flitet mbi nevojat e shtypjen e tyre, mbi armikun e urryer, fashizmin, mbi nevojën e luftës kundër tij dhe mbi detyrat që u përkasin në këtë luftë çlirimtare. Lufta do të na japë material për punën. Komunikatat, proklamatat, thirrjet e ndryshme të punohen herë pas here në mënyrë të thjeshtë e të kuptueshme. Me anë të këtyre e me anë të organeve të Partisë e të rinisë do të ngjallet në to urrejtja kundër armikut, do të theksohen barbarizmat e tija, djegjet, vrasjet e grave dhe të fëmijëve etj. Në këto mbledhje gjithashtu të flitet mbi higjienën, mbi rritjen e fëmijës, mbi mënyrën e punës dhe detyrat e ndryshme të një amvise të mirë. Kjo mundet t'u duket atyre e kotë dhe e papëlqyeshme, por



shoqet<sup>1</sup> ose ato që janë të përshtatshme për këtë punë duhet të kenë durim dhe t'u shpjegojnë grave në mënyrë që t'i bindin për nevojën e këtyre udhëzimeve. Do të jenë të vlefshme dhe do të na ndihmojnë në formimin e këtij fronti kurset e ndryshme për zhdukjen e analfabetizmit e sidomos ndër fshatra; kurse për pre-rije e qepje dhe kurse infermierie — këto të fundit janë të domosdoshme të formohen sa më parë, tani që lufta është duke u bërë çdo ditë më e ashpër. Duhet theksuar se në mbledhjet e ndryshme, në kurset, në konferencat duhet të marrin pjesë të gjitha ato që duan, me një mënyrë ose me një tjetër, të ndihmojnë luftën kundër fashizmit, të marrin pjesë të gjitha gratë e fshatit e të qytetit, që kanë në shpirt luftën kundër armikut, të çdo tendence e të çdo rryme politike — gratë antifashiste, zogiste, balliste, fetare —; të mos bëhet sektarizëm në këtë pikëpamje. Në ato qytete ku ka gra që janë nën influencën e «Ballit Kombëtar» të bashkëpunohet me to në mënyrë të plotë e të sigurtë.

Prej konferencave do të dalin këshillat antifashiste të grave. Këshillat formohen në këtë mënyrë: prej konferencës së mëhallës del këshilli i mëhallës, këtë e zgjedhin vetë gratë. Prej këshillave të mëhallave të ndryshme caktohet nga një grua, e cila do të bëjë pjesë në këshillin e qytetit. Ky këshill bëhet prej aq anëtareve sa të shikohet nevoja. Mund të formohen këshilla edhe sipas zanatit dhe profesionit. Prej mbledhjeve e konferencave në fshat del këshilli i fshatit, i cili lidhet me këshillin e qytetit. Kjo është mënyra demokratike, mënyra më e mirë dhe më e preferuar për formimin e këshillave. Por kjo nuk është e vetmja mënyrë; në rast pamundësie, për shkak reaksioni, zgjidhet më parë këshilli i qytetit nga lart prej grave më të përshtatshme e më aktive. Ky këshill merr përsipër të organizojë këshillat e mëhallave, të cilat caktohen prej këshillit të qytetit dhe nuk zgjidhen prej grave të mëhallës. Në këshillin e çdo mëhale duhet të marrë pjesë një shoqe, në qoftë se ka, por në këshillin e qytetit duhet patjetër. Këto këshilla të jenë shprehja e vërtetë e vullnetit të grave. Këto këshilla kanë për detyrë të grumbullojnë sa më shumë që të jetë e mundur masat e grave të fshatit e të qytetit rreth frontit antifashist të grave. Këto interesohen për agjitacion, propagandë, për furnizimin e çetave me çdo mjet, për kurset e ndryshme dhe për të shtuar radhët e partizanëve e vullnetarëve me vajza e gra luftëtare. Shoqet do të jenë luftëtarët më të mira dhe shembull për gjithë gratë e tjera.

Kur ka mundësi, një anëtare e këshillit të qytetit bën pjesë edhe në këshillin nacional-çlirimtar të atij qarku.

1 Anëtarët e Partisë.

Prej mbledhjeve të ndryshme duhet të përfitohet organizativisht, të formohen grupe edukative me vajzat dhe gratë më të mira e më të vendosura; prej këtyre të rekrutohen shoqe të reja që do të shtojnë radhët e organizatës.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror

Valbona<sup>1</sup>

Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë

1 Valbona — një nga pseudonimet e shokut Enver Hoxha gjatë Luftës nacional-çlirimtare.

**LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË  
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR KORÇËN  
MBI FORCIMIN E PUNËS ME RININË DHE MBI QËNDRIMIN  
NDAJ «BALLIT KOMBËTAR»**

[Prill 1943]

Të dashur shokë,

Mirë do të ishte të na shkruanit më me hollësi për punën e aksionit, sidoqoftë shikoni e kini mendjen që të bëhet në konditat më të mira për të pasur sukses. Mos harroni t'i vini një rëndësi të veçantë punës së organizimit si në Parti ashtu edhe në rini. I vini një kujdes të veçantë si organizimit ashtu edhe mobilizimit të rinisë; për mobilizimin do keni direktiva të veçanta (këto do t'ja dërgoni rinisë bashkë me këtë letër ose më vete). Me mobilizimin e rinisë duhet të keni mendjen mirë që të mos dekonspirohet puna, të mobilizohet sa më mirë, por duke pasur parasysh që rinia të mos çorganizohet. Me këtë rast do të forcohen çetat, si politikisht ashtu dhe ushtarakisht, do të marrin një hov të ri, ashtu si e do momenti dhe lufta jonë.

Në të dy krahinat ku ka reaksion më të madh mos të lihet puna pas dore, por t'i vihet një rëndësi e jashtzakonshme si organizimit ashtu edhe propagandës, pa lënë pas dore punën e aksioneve, që i nxjerrin frikën popullit dhe ngrenë prestigjin e luftës sonë e të Partisë.

Mos të harrojmë se gjendja ndërkombëtare është kurdoherë në favorin tonë.

*Puna e «Zjarrit»:* Merrni organizatën në dorëzim. Ata më të saktët i fusni në celula, *celula të veçanta ku të ketë një shok përgjegjës nga më të aftit prej shokëve të vjetër, disa të tjerë në grupe edukative.*

Me Fetahun<sup>1</sup> duhet të piqeni vetë, të fjaloseni gojarisht mbi të gjitha e të merrni një qëndrim të prerë, duhet ta bindni se ai

1 Fetah Butka.

ka fare kollaj mundësi të marrë komandën e një çete në Kolonjë e të marrë me vete të gjithë miqtë e tij që sot qëndrojnë me Safetin<sup>1</sup>; në interesin e Partisë është që të dalë si çetë partizane, ose fundja si një çetë vullnetare nën komandën e tij, me një komisar politik. Fuqitë tona nuk duhet të shpien ujë në mullirin e Safetit, sidomos sot që Safeti po bën manevra. Kjo nuk do të thotë që të bëheni hasmë me Safetin, por secili në pozitë të partisë së vet ose të idesë së vet. Në Kolonjë, po të punojnë shokët si duhet, edhe Fetahun i bie veçanërisht një detyrë ndaj Partisë, që besoj se do ta mbarojë me sukses dhe me sinqeritet (ky është qëndrimi ynë karshi Safetit tani për tani).

A. V. e fusni në Parti dhe, mbasi t'i shpjegoni detyrat e një anëtari të një partie të vërtetë komuniste, e lini në çetë bashkë me shokë të tjerë, kjo është detyra e tij dhe asgjë më tepër. Në përgjithësi duhet të keni pak durim, në fillim të përdorni bindjen, por sigurisht pa lënë kurrë pas dore rregullat themeltare të Partisë sonë, sot më tepër se kurrë.

Çështja e Mestanit<sup>2</sup> rregullohet lehtë, sigurisht Mestani qengj nuk është, por edhe shokët e Kolonjës do ta kenë marrë punën si kaluar që të vejë puna gjer në të sharë të tillë. Puna e Dangëllisë<sup>3</sup> të mbetet për në shportën e lugëve, psenë po e thotë letra e gjatë mbi punët ushtarake...

Për punën e ndërrimit të shokëve t'i fshini buzët, keni boll elementë, sa të punoni mirë vetë dhe të ndihni edhe krahinat e tjera; shkurt, Todo Mançon e nisni sa më shpejt për në Vlorë me anën e Skraparit e të Mallakastrës.

Sa për përçarjet që përpiqet të krijojë karabinieria, ju të mençëm jeni vetë, me atë rast demaskoni edhe të gjithë ata që bien në atë llum, por kini mendjen për punën e «Ballit» e të Safetit, mos të bini në provokacion. *Durim, shokë, ju i dini mirë këto punë!*

Ne dhe i gjithë populli shqiptar këto ditë, me rastin e 12 prillit<sup>4</sup>, pamë se ç'dallavera kanë bërë M. Kruja, Qazim Koculi, A. Këlcyra dhe shokët e tij më 1938—1939, besoj se e keni kënduar

1 Safet Butka.

2 Mestan Ujaniku. Këtu është fjala për një fërkim të vogël midis komandave të dy çetave partizane, të Skraparit dhe të Kolonjës.

3 Deri në fillim të vitit 1943, Dangëllia varej, për punët e Partisë, nga Komiteti qarkor i Korçës. Komiteti Qendror i PKSH vendosi që kjo krahinë të lidhej me qarkorin e Gjirokastrës dhe të futej në Zonën I Operative Vlorë—Gjirokastrë.

4 Më 12 prill 1939 «asambleja» fashiste e organizuar nga pushtuesit italianë shpalli «bashkimin personal» të Shqipërisë me Italinë dhe vendosi «t'i lutej» mbretit të Italisë, Viktor Emanuelit III të pranonte kurorën e Shqipërisë.

«Rojen Kombëtare»<sup>1</sup> të 13 prillit; aty keni plot xhevahire për të shkuarën e shumë ballistëve. Por puna është se ku e ka hallin armiku dhe tradhëtarët sigurisht që të mbjellin konfuzion në masat, të përcajnë lëvizjen tonë dhe të forcojnë reaksionin. Prandaj ne, para kësaj situatë, duhet të bëjmë përpjekje për një bashkim të sigurtë me elementët e pastër të «Ballit». Krerët e komprometuar do t'i ulin veshët dhe baza do ta shtyjë «Ballin» të afrohet me ne. Sigurisht kjo nuk do të bëhet automatikisht, por me punën tonë politike, duke nxjerrë në shesh rëndësinë e Luftës nacional-çlirimtare, të Partisë sonë e të patriotëve të ndershëm dhe pa njolla.

Mos të biem në politikën e nuses që vajti fjeti me mullixhinë nga inati i së vjehrrës, tamam ashtu si e bënë disa krerë të «Bashkimit Kombëtar»<sup>2</sup> më 1938—1939. Mos të harrojmë kurrë qëllimin kryesor: të bashkuar në luftë për vdekje kundër okupatorit e tradhëtarëve.

Kjo nuk do të thotë se me këtë rast disa krerëve të komprometuar të «Ballit» të mos u bëhet lëkura pesë pare, siç e meritojnë.

Sot u fillua të flitet për një krizë kabinetit. Ministri i brendshëm, Luogotenenca dhe Mustafai po i turren «Ballit», kërkojnë ta zgjerojnë reaksionin, Bushati me disa të tjerë rëndojnë nga një politikë «hiq e mos këput», s'u vjen mirë të kapin njerëzit e «Ballit». Të bëhet një trakt sa më parë kundër mobilizimit dhe xhandarmërisë.

### T a r a s

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë:  
«Enver Hoxha, Vepra, vëllimi 1». Tiranë, 1968

1 Gazetë e përditshme qeveritare fashiste (prill—maj 1943).

2 Organizatë tradhëtare e krijuar në vitin 1927 në emigracion, si fraksion i Komitetit Nacional-Revolucionar (Konare). Më 1938 krerët e kësaj organizate u bashkuan me grupin fashist të Mustafa Krujës. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste ata zunë pozita kryesore në qeveritë kuislinge, në partinë fashiste dhe në «Ballin Kombëtar».

## THIRRJE E KQ TË PKSH DREJTUAR FSHATARËVE DHE GJITHË POPULLIT SHQIPTAR

Qershor 1943

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT  
POPULL SHQIPTAR!

Sot që në fushat e Bashkimit Sovjetik hordhitë e Hitlerit pësojnë disfatat më të turpshme, kur ushtria gjermane me shpirt në dhëmbë përpiqet të zgjatë dhe ca kohë jetën e saj, Ushtria e Kuqe heroike po i jep grushte vdekjeje, sot që hordhitë fashiste, të komanduara prej Romelit, u shporrën nga toka e Afrikës, ku pësonan humbje të mëdha në njerëz e material, sot që lufta nacional-çlirimtare e gjithë popujve të robëruar ka marrë përpjesëtime të jashtëzakonshme dhe i shkakton fashizmit qederet më të mëdha brenda në «kështjellën e Evropës» e cila po kërcënohet nga të katër anët prej forcave aleate, Lufta nacional-çlirimtare e popullit tonë shkon dita-ditës duke u forcuar. Armiku po pëson disfata në çdo përpjekje që bën me forcat patriotike shqiptare, të cilat të grumbulluara në lëvizjen nacional-çlirimtare e godasin pa mëshirë për ta shporrur nga vendi ynë këtë armik të urreyer e gjakatar. Populli shqiptar e ka kuptuar se çlirimi i tij qëndron vetëm në luftën kundër zaptuesit, qëndron në një luftë të ashpër e plot sakrificë, përfundimi i së cilës do të jetë fitorja e popullit tonë. Populli shqiptar që ka derdhur gjakun pa e kursyer për të fituar lirinë e tij, ai që me Skënderbeun dhe me heronjtë e Rilindjes është përpjekur si luan për të thyer prangat e robërisë, sot përsërit historinë e tij dhe stërnipërit e atyre që vaditën me gjakun e tyre të kulluar tokën arbërore, sot kanë rrokur armët të bashkuar për të ndjekur shembullin e lavdishëm të stërgjyshëve të tyre heroikë.

Lufta jonë ka pasur fitime të shkëlqyera, ajo ka ngjallur adhurimin e botës së qytetëruar për popullin tonë të vogël, por kreshnik dhe po i siguron këtij independencën dhe e vë Shqipërinë në radhën e shteteve aleate që luftojnë errësirën fashiste.



## VËLLEZËR KATUNDARË!

Vitin e kaluar Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare, në një trakt<sup>1</sup> të tij, që kishte shpërndarë në gjithë Shqipërinë, ju bënte thirrje që të mos i jepej nga ana juaj asnjë kokërr bereqeti dhe prodhimi okupatorit dhe veglave të tija, dhjetarëve, që kërkonin të rrëmbenin bukën e gojës së popullit tonë për të ushqyer xhelatët e Musolinit që barbarisht po dëgjin fshatrat dhe qytetet tona, që po na vrasin pa mëshirë çiliminjtë, gratë, pleqë të djemtë tanë.

Shumë krahina e dëgjuan thirrjen tonë dhe s'ja dorëzuan armikut bukën e gojës të kalamajve të tyre. Ushtria e popullit shqiptar, çetat partizane e vullnetare nga ana tjetër, sulmuan depot dhe grurin e misrin që këta ua kishin rrëmbyer ja ndanë popullit.

Kusarët fashistë dhe hyzmeqarët e tyre sivjet më shumë se kurdoherë e kanë synë në bereqetin dhe prodhimet tuaja, që i keni vaditur me djersën dhe gjakun tuaj, ata i shikojnë me lakmi dhe përgatiten t'jua rrëmbejnë dhe kësisoj të na vdesin urie për të na robëruar më mirë.

## VËLLEZËR KATUNDARË!

Armikut barbar mos i dorëzoni asnjë kokërr gruri, asnjë fije leshi, asnjë kokë gjë të gjallë, asnjë kile bulmet. Këto i ruani për familjet tuaja. Kur të korrni dhe të shini, bashkohuni tok në katund dhe katund më katund e me armë në dorë, goditni pa mëshirë ata që do të guxojnë t'jua rrëmbejnë. Ushtria Nacional-Çlirimtare Partizane dhe Vullnetare, që është ushtria juaj do t'ju ruajë, do t'ju ndihmojë në mbrojtjen që do të bëni për shpëtimin e bukës së gojës dhe do të sulet kudo kundrejt atyre që do të kërkojnë t'ju grabitin bereqetin. Të mos jepni të dhjetat me asnjë mënyrë dhe të gjithë ata persona, cilëtdo qofshin dhe nën çdo petk dhe maskë politike që të fshihen, që do të bëhen dhjetarë do të dënohen si tradhëtarë të popullit shqiptar dhe kundër tyre do të merren po ato masa dhe do t'u bëhet po ajo luftë që i bëhet zaptuesit fashist, pse ata ndihmojnë fashizmin dhe shikojnë interesat e tyre personale.

1 Shih në këtë vëllim f. 89.

## POPULL SHQIPTAR! PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË DHE ATDHEDASHËS TË VËRTETË!

Fashizmi zaptues dhe hyzmeqarët e tij po përpiqen që me çdo kusht të grumbullojnë forcat e tyre për t'i hedhur në një përleshje të fundit; për t'i bërë ballë këtij rrebeshi duhet të forcojmë bashkimin tonë dhe njësinë e Luftës nacional-çlirimtare, duke grumbulluar të gjitha shtresat e vendit tonë. Përpjekjeve të armikut duhet t'u përgjigjemi me luftën më të ashpër se atje është shpëtimi ynë. Të luftojmë pa mëshirë përpjekjet e armikut që kërkon të mobilizojë një xhandarmëri gjoja shqiptare dhe këtë ta përdorë për qëllimet e tij të errëta. Asnjë djalë i popullit të mos vejë në radhët e xhandarmërisë që organizojnë armiku dhe tradhëtarët pse ata kërkojnë të na shtypin dhe të na grabitin bereqetin me anën e saj dhe të sjellin përsëri ditët e zeza të milicisë faqezezë të Mustafa Krujë tradhëtarit.

## POPULL SHQIPTAR!

Detyra e atdheut po ju thërret që nën flamurin e Skënderbeut të shtojmë dhe të forcojmë radhët e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare dhe për këtë luftë të shenjtë gjithë patriotët e vërtetë të japin çdo gjë për ta ndihmuar dhe forcuar. Të godasim pa mëshirë armikun dhe veglat tradhëtare, që të shpejtojmë çlirimin tonë dhe t'i sigurojmë vendit një të ardhshme më të lumtur e më të sigurtë.

**RROFTË SHQIPËRIA E LIRË, INDEPENDENTE E DEMOKRATIKE!**

**MOS I JEPNI ASNJË KOKËRR BEREQET ARMIKUT SE NË KËTË MËNYRË DO TË SHPEJTOJMË DITËN E ÇLIRIMIT!**

**ASNJË DJALË SHQIPTAR TË MOS SHKRUHET XHANDAR!**

**RROFTË BASHKIMI I POPULLIT SHQIPTAR NË LUFTË KUNDËR OKUPATORIT!**

**RROFTË USHTRIA JONË NACIONAL-ÇLIRIMTARE PARTIZANE E VULLNETARE!**

**RROF SHIN ALEATËT TANË BASHKIMI SOVJETIK, ANGLIA E AMERIKA!**

**KOMITETI QENDROR  
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARË**

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME LIKUIDIMIN E FRAKSIONIT TË SADIK PREMTE NË ORGANIZATËN E VLORËS

17 qershor 1943

### KOMITETIT QARKOR DHE SHOKËVE TË ORGANIZATËS SË VLORËS

Në bazë të raporteve të ndryshme të paraqitura prej komitetit qarkor të organizatës së atjeshme dhe në bazë të raportit të të deleguarit të Komitetit Qendror të dërguar apostafat në qarkun e Vlorës për të hetuar në vend situatën e krijuar prej tradhëtarit dhe armikut të Partisë Sadik Premte (Xhepit), po ju drejtojmë të gjithë juve këtë letër, e cila të këndohet në gjithë organizatën dhe të veprohet si më poshtë.

Që në formimin e Partisë elementi i sëmurë grupash, i udhëhequr nga Sadik Premte dhe Anastas Lula, duke përdorur tërë dinakërinë e tij, u përpoq për të shkatërruar themelet e Partisë sonë të re. Këta vunë në lëvizje çdo mjet, për të mbjellur në shokët mosbesimin ndaj Partisë, mosbesimin ndaj forumeve që drejtonin punën, mosbesimin në organizimin e lëvizjes e të luftës dhe këshillojnë moszbatimin e direktivave të lëshuara nga Komiteti Qendror.

Kundër këtyre elementëve grupashë Partia veprroi duke përdorur bindjen. Për një kohë të gjatë ajo i këshilloi dhe u tërhoqi vërejtjen se një punë e tillë, e bërë me plot koshiencë nga ana e tyre, ishte një punë antiparti dhe se kjo rrugë do t'i çonte në pozita të kritikshme dhe do të merreshin masa drakoniane kundrejt tyre në këtë rast.

Në Konsultën e parë të Aktivit të Partisë, rezolucionin e së cilës e keni kënduar dhe punuar, u muar vendim që të gjithë elementët e infektuar nga fryma e grupeve dhe të lëkundshëm të bindeshin dhe të hiqnin dorë nga puna e vjetër dhe të zbatonin direktivat e Partisë, se për t'u bërë ballë detyrave që na paraqiten dhe evenimenteve, që zhvillohen dhe rrokullisen me një shpej-

tësi të madhe, duhet medoemos të kemi në Partinë tonë një njësi të plotë mendimi dhe veprimi, një shikim të njëjtë, si në punën politike ashtu dhe në organizatën vetë. Megjithëse nga ana e Partisë u bënë të gjitha tentativat për t'i ngritur këta shokë të sëmurë, koha dhe faktet treguan se këta shokë vijuan punën e tyre të vjetër të grupeve. Këta shokë kanë kundërshtuar gjithmonë direktivat e Partisë: direktivën e moralit proletar kundër vjedhjes, të punës me fshatarët, vijën e rinisë, konspiracionin, aksionet, dhe pakënaqësia e tyre ka qenë e vazhdueshme, duke kritikuar shokët e Partisë dhe sidomos forumet e saja. Këto moskënaqësi dhe kritika kishin një karakter kolektiv dhe të organizuar.

Në momentet më kritike që kalonte Partia, kur reaksioni godiste pa mëshirë dhe shokët tanë nga më të mirët binin dëshmorë në fushën e nderit për lartësimin e Partisë sonë dhe për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha e huaj, Sadik Premte dhe Anastas Lula u përpoqën edhe një herë të realizonin ambiciet e tyre të ndyra të një pune antiparti, duke dashur të merrnin në dorën e tyre vendet udhëheqëse dhe, kësisoj, të rivendosnin përsëri punën e tyre të vjetër prej gangsteri.

Komiteti Qendror i Partisë, duke marrë parasysh të gjitha këto gjëra dhe duke parë se këta elementë nuk dëshironin të korrigjoheshin dhe të ndiqnin rrugën e vërtetë komuniste dhe pas një konference<sup>1</sup>, ku muarën pjesë Sadik Premte, Anastas Lula dhe shokë të tjerë, vendosi të marrë një qëndrim të caktuar për të spastruar radhët e Partisë dhe të jetë i pamëshirshëm kundër elementëve antiparti të çdo lloji dhe nën çdo petk që të fshihen. Pas kësaj konference Anastas Lula, Sadik Premte dhe disa shokë të tjerë u hodhën jashtë radhëve të Partisë; por përsëri u është theksuar këtyre elementëve grupashë se shpresohet që ata të shohin gabimet e tyre serioze dhe t'i përmirësojnë jashtë Partisë, se në Parti ata s'mund t'i përmirësonin.

Përpara gjithë organizatave të Partisë është vënë në dukje rreziku i madh që mund t'i sjellë grupazhi Partisë, dhe gjithë shokëve u është nënvizuar se lufta kundër grupashëve duhet të jetë e ashpër, se elementi grupash me çdo mënyrë përpiqet të shkatërrojë sistematikisht punën e ngrehur, duke sabotuar e shumë herë duke shkuar edhe në provokacion në favor të armikut. Elementët grupashë janë sëmundja e brendshme më e poshtër e Partisë, se ata përpiqen ta marrin kalanë nga brenda, duke përdorur dhe vënë në veprim çdo gjë që s'është komuniste. Gjithë shokëve të Partisë u është theksuar se duhet të kenë zgjuarësinë më të madhe, duhet të kenë sytë hapur mbi këta njerëz, mbi çdo

1 Është fjala për Konferencën e Jashtzakonshme të Partisë, mbajtur në fund të muajit qershor 1942.

gjest e fjalë të tyre dhe se s'duhet me asnjë mënyrë të harrohen këto mikrobe, le të jenë edhe jashtë radhëve të Partisë, se, si thotë shoku Stalin: «Sëmundja më e rrezikshme është ajo që harrohet»<sup>1</sup>. Lufta më e ashpër që mund t'u bëhet grupashëve është forcimi i organizatave tona, është ngritja e shokëve të Partisë në radhën e komunistëve të vërtetë, është zbatimi i direktivave të Komitetit Qendror në një mënyrë të përpiktë, është puna e palodhur e sistematike për kujdesimin dhe edukimin e kuadrove të reja të Partisë, në mënyrë që t'i bëjmë këto të afta për punë dhe për luftë. Forcimi i organizatave të Partisë me elementë të vendosur, të lartësuar si politikisht, teorikisht dhe organizativisht, është vdekja e paevitueshme e elementit grupash, se mikrobi mbin dhe shtohet kurdoherë në një trup të dobët dhe, përkundrazi, ai shfaroset në një trup të çelniktë. Dhe Partia jonë Komuniste duhet të jetë një parti e tipit Lenin-Stalin, një parti ku të ndjehet e pathyeshme njësia dhe disiplina e hekurt e vetëdijshme.

Veçanërisht organizatës së Vlorës, si shokëve udhëheqës ashtu dhe shokëve të Partisë, i është theksuar dhe vënë në dukje rreziku që vjen nga elementët grupashë. I është shpjeguar qëndrimi krejt negativ dhe antiparti i Sadik Premtes dhe i është theksuar me këmbëngulje se Xhepi është elementi më i rrezikshëm, më i pabesë, më dallaveraxhi që ekziston ndër elementët antiparti, dhe, për këtë arsye, kujdesi dhe vëzhgimi i punës së tij duhet të jetë një nga detyrat e shokëve drejtues dhe e shokëve të organizatës.

Mjerisht, jo vetëm që ky kujdes nuk është bërë, por ka munguar gati krejt zgjuarësia nga ana e shokëve dhe janë bërë lëshime dhe neglizhenca në punë, të cilat kanë favorizuar punën tradhëtare të Xhepit dhe të shokëve të tij. Duhet, pra, të bëjmë diagnozën e shëndoshë të kësaj sëmundjeje, se me të vërtetë atëherë do të gjejmë shërimin e saj dhe, si rrjedhim, do të shqelmojmë mikrobën dhe do të forcojmë Partinë.

Në organizatën tuaj gati është harruar rreziku i grupashëve, sido që në atë qark gjendej Sadik Premte, një nga elementët më të rrezikshëm e më të ndyrë. Karshi këtij që në fillim është mbajtur një qëndrim jo kategorik; dëbimi i tij nga Partia dhe dëmi që i kish sjellë punës u ishte komunikuar shokëve (jo të tërëve) me gjysmë zëri dhe as që u ishte vënë në dukje anëtarëve të Partisë e gjithë simpatizantëve rreziku që mund të vinte nga një element i tillë. Nga ana tjetër, vazhdimi i qëndrimit negativ të Xhepit nuk ju shtyu aspak të mendonit se ky element, për të cilin ishte harxhuar aq kohë për ta bindur e që nuk mund të vinte në rrugën e drejtë, por shkonte drejt tradhëtisë më të ndyrë, duhej demaskuar në popull, por është vazhduar të mbahet karshi tij një

<sup>1</sup> Shih: J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 348.

qëndrim plot neglizhencë. Xhepi, në heshtje, si ai mikrobi i fëlliqur, ka punuar sistematikisht kundër Partisë, duke përfitur nga lëshimet e shokëve drejtues dhe shokëve të organizatës. Dhe gabimet e lëshimet nga ana juaj kanë qenë mjaft të mëdha.

Në radhë të parë është neglizhuar puna organizative, çështja më me rëndësi dhe më kryesore e jona. Në një parti komuniste të tipit Lenin-Stalin të gjitha çështjet ndërlidhen ngushtë njëra me tjetrën dhe zgjidhja e këtyre çështjeve në bazë të direktivave përbën suksesin e paevitueshëm të Partisë dhe triumfin në çdo lëmë veprimi. Por, pa shikuar si duhet dhe pa i vënë rëndësinë më të madhe çështjes organizative, që është baza dhe pikënisja e çdo veprimi, sigurisht, puna do të çalojë dhe më të shumtat e herës do të shkojë në greminë. Këtë punë me kaq rëndësi jetike për Partinë tonë shokët e Vlorës s'e kishin çmuar aq sa duhet, dhe lëshimet që kanë bërë kanë shkaktuar situatën e krijuar prej tradhëtarit Sadik Premte dhe shokëve të tij. Është e rëndë dhe e çuditshme të kuptohet si mund të ngjasë që në qarkun e Vlorës, ku populli ka marrë armët dhe me tërbim po lufton krahu për krahu me shokët tanë, në vend që të kemi një organizatë të fortë, të disiplinuar, me elementë të sprovuar në zjarr e në flakë, të kemi një organizatë, ku tradhëtari Xhep përpiqet të hedhë rrënjët dhe të torpilojë Partinë. Kjo gjendje anormale s'mund t'i ketë rrënjët veçse në moskujdesimin plot përgjegjësi të gjithë shokëve të organizatës së Vlorës. Gati muaj me radhë nuk është shkuar për të kontrolluar e për të ngritur shokët e celulave, por këta janë lënë në fatin e tyre. Këta elementë, sigurisht të vendosur, të rekrutuar sipas parimeve të shëndosha, por të lënë pas dore pa i edukuar me frymën e Partisë, me disiplinën e saj dhe pa i ushqyer me direktivat e lëshuara nga Komiteti Qendror, janë bërë një fushë veprimi i elementëve grupashë dhe i përpjekjeve të tyre për krijimin e një pune antiparti.

Celula, që duhet të jetë për çdo anëtar partie shkolla e vërtetë komuniste, ku të armatoset me eksperiencën e përditshme të luftës së gjithë shokëve, me teorinë marksiste-leniniste dhe të mbrujë shpirtin e tij me ndjenja të larta bolshevike, për shokët e Vlorës celula ka qenë një gjë pa rëndësi, ku shokët mbledheshin në të harruar, por edhe atëherë jo për të rrahur çështjet me seriozitetin e një komunisti, që ka barrën e rëndë të jetë pararoja e popullit tonë, por për të kaluar radhën. Vetëvetiu vjen që këta shokë, të cilëve u dhimbet çështja dhe e duan me gjithë shpirt dhe derdhin gjakun pa u kursyer për Partinë, kanë formuar në tru një mënyrë veprimi dhe mendimi të tyre, duke kujtuar se kurdoherë dhe çdo gjë që bëjnë është në të mirën e Partisë. Këta shokë nuk kanë jetuar jetën e Partisë në gjithë luftën dhe përpjekjet e saj, dhe idealizimi i Partisë, jo i stabilizuar në themele të shëndosha, shkakton që, në rastet (që në qarkun e Vlorës s'janë



aspak të jashtëzakonshme) kur një shok përgjegjës ose një shok tjetër i organizatës bën ndonjë faj ose gabon, në shpirtin dhe në zemrat e tyre prej komunisti të paformuar të krijohet një deziluzion i madh, i cili i çorienton dhe, inkoshient, ata rrëshqasin në pellgun ku i pret elementi grupash, i cili i përdor për qëllimet e tija të errëta antiparti. Natyrisht, kur këta shokë të paformuar në deziluzionin dhe çorientimin e tyre nuk gjejnë përkrahje dhe nuk shohin krahun e shëndoshë që t'i ngrerë nga ajo gjendje e turbullt ku kanë rënë dhe t'u japë shpirtin, vullnetin dhe ndriçimin e komunistit të vërtetë, ata bëhen vegla të grupashit dhe viktima të armiqve të Partisë.

Lënja pas dore e punës ndër celula dhe, si rrjedhim, neglizhenca në punën e ngritjes së shokëve, ka shkaktuar që këta të jenë të huaj me direktivat e Partisë, të mos dinë se ç'është disiplina e hekurit dhe e vetëdijshme e Partisë, të mos dinë ç'është kritika dhe autokritika e shëndoshë komuniste, të mos dinë vleftën e organizimit dhe të centralizmit, të mos dinë të dallojnë interesin e lartë të Partisë përpara interesit dhe ambicies personale, të mos dinë ta duan shokun me atë dashurinë e shëndoshë, të sinqertë e pa njolla prej komunisti, dhe të mos dinë të urrejnë dhe të luftojnë pa mëshirë elementin e poshtër antiparti. Shokët e Vlorës, të huaj me këto parime bolshevike dhe të lënë pas dore prej shokëve drejtues për përmirësimin e tyre, kanë ushqyer në mënyrë koshiente ose inkoshiente punën tradhëtare të Sadik Premtes.

Nga ana tjetër, shokët drejtues të qarkut të Vlorës kanë punuar shumë herë me kriter të gabuar, duke ngritur e vënë në dukje elementë të dyshimtë, me një të shkuar jo të pastër, ambiciozë, dhe këtyre elementëve u janë dhënë detyra me rëndësi në Parti dhe në luftë. Shokët drejtues të Vlorës, me plot bindje, kanë dashur t'i lartësojnë këta shokë për të mirën e punës, por kanë harruar se në Partinë tonë ka kurdoherë besim, por ka edhe kontrollim. Dhe kontrollimi ka munguar. Kontrollimi i shëndoshë i punës së shokëve është mbarëvajtja e Partisë dhe forcimi i kuadrove të saja. Komunisti i vërtetë njihet kur ai gëzohet dhe kënaqet kur sheh se puna që i është ngarkuar kontrollohet me imtësi, jo për t'i gjetur gabimet, për ta unjur e nënvleftësuar, por për ta korrigjuar, për ta mësuar dhe lartësuar. Ky kontrollim është neglizhuar prej shokëve drejtues të Vlorës dhe shokëve të organizatës, dhe kjo ka shkaktuar që shpirtin të sëmure dhe elementë të pangritur dhe të paedukuar me frymën e Partisë të bëjnë gabime të shpeshta, dhe këto gabime të mbjellin moskënaqësi, moskënaqësi e cila është kthyer në urrejtje kundër një ose dy shokëve dhe më vonë, e trilluar nga elementët antiparti, në një moskënaqësi kundër forumeve drejtuese të Partisë.

Konspiracioni ka munguar gati krejt përsa u përket çështjeve organizative dhe ushtarake. Gjithë bota ishte në dijeni për

funksionimin e aparatit të Partisë në qarkun e Vlorës, dhe emra shokësh qarkullonin si të supozuar udhëheqës të punës.

Gjithashtu nuk është kuptuar si duhet roli i pararojës së Partisë sonë. Shokët e Vlorës s'e kanë çmuar sa duhet se anëtarët e Partisë janë pjesa më koshiente e popullit, udhëheqësit e vërtetë të turmave të gjera, por ata i kanë konfunduar rolet, dhe shumë herë kanë rënë në pozitat e turmave. Janë bërë gabime në zbatimin e direktivave të Luftës nacional-çlirimtare dhe shumë herë janë konfunduar këshillat nacional-çlirimtare me celulat e Partisë, nuk u është dhënë rëndësia dhe roli special këshillave në këtë luftë, dhe shumë herë populli është ngatërruar në punët e brenshme të Partisë.

Të gjitha këto lëshime nga ana e shokëve drejtues dhe shokëve të organizatës së Vlorës kanë qenë një armë, të cilën e ka përdorur elementi grupash, i kryesuar prej Sadik Premtes dhe Palit<sup>1</sup>, për të kurdisur veprimin e tij të poshtër.

Sadik Premte dhe Pali, për të përmbushur qëllimet e tyre, kishin filluar punën antiparti sistematikisht dhe me plot koshienca. Qëllimi i tyre ishte të grumbullonin rreth vetes një pjesë të madhe shokësh, tok me ta të rrëzonin qarkorin, të merrnin në dorë punën organizative, gjithashtu dhe komandat e çetave dhe, duke shpresuar të tërhiqnin në punën e tyre tradhëtarë e shokë të tjerë jashtë qarkut të Vlorës, ata i shkrojtën qarkorin të Gjirokastrës dhe, në këtë mënyrë, deshën t'i impononin Partisë vullnetin e tyre. Tradhëtarët, trockistët Sadik Premte dhe Pali, për këtë qëllim ishin marrë vesh edhe me elementë të jashtëm të Partisë, të cilët u kishin furnizuar armë dhe këshilluar e lehtësuar mënyrën e veprimit.

Ky akt rebelizmi kundër Partisë, i frymëzuar dhe i udhëhequr prej Xhepit dhe Palit, kishte si pjesëtarë kryesorë: Vangjon<sup>1</sup> (komandant çete dhe përgjegjës celule), Qazim Çakërrin (Difin, komisar politik dhe përgjegjës celule), Xhemil Çakërrin (komisar politik), Zeqon. Këta elementë Partia, me drejtësinë më të madhe, i kish ngritur nga radhët e shokëve të thjeshtë dhe u kishte besuar pozita me rëndësi, por ambicia e tyre e pafre-

1 Pali — Pali Tërova bashkëpunëtori më i afërt i Sadik Premtes në organizimin e revoltës kundër Partisë në krahinën e Vlorës. Ai mbeti deri në fund tradhëtar. U vra pas çlirimit të vendit në përpjekje me forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2 Vangjo — Ymer Hoxha, një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Sadik Premtes. Në dokumenta thuhet se Vangjoja u dorëzua në Parti dhe bëri autokritikën duke njohur fajin dhe tradhëtinë kundrejt Partisë. Në fakt autokritika ka qenë vetëm hipokrizi dhe mashtrim. Pas një kohe fare të shkurtër, ai dezertoi nga UNÇSH dhe u bë komandant çete balliste. U vra në përpjekje me partizanët.

nuar dhe mungesa e disiplinës dhe e bindjes ndaj forumeve dhe komandave shkaktoi që Xhepi dhe Pali t'i inkuadrojnë në radhët e tyre. Këta elementë mbanin lidhje të ngushta me Sadik Premten e Palin, të cilët i kishin studjuar pikat e dobëta të tyre dhe matur rëndësinë e influencën që mund të kishin këta shokë në radhët e Partisë dhe të opinionit publik. Kështu që këta elementë, Sadik Premte dhe Pali i përdorën si mbulesë për të zbatuar planin e tyre. Xhepi dhe Pali, të cilët rrinin zgjuar dhe informoeshin për gjithshka ngjiste në organizatë dhe prisnin momentin e favorshëm për ta goditur në shpinë Partinë, përkëdhelën ambiciet e këtyre elementëve dhe i nxitën me mënyrën e tyre dinake kundër shokëve të supozuar përgjegjës të punës së atjeshme, kundër vendimeve që merreshin, kundër direktivave të Partisë, kundër aksioneve, kundër vijës së Luftës nacional-çlirimtare dhe mundën që në shpirtat e këtyre shokëve të sëmurë të konkretizonin mërinë që ushqenin kundrejt Partisë, duke i armatosur këta për një luftë kundër forumit drejtues, të cilin e cilësonin si «klikë tradhëtarësh» dhe «bandë kriminelësh». Këta elementë të sëmurë dhe ambiciozë, me Xhepin dhe Palin në krye, me plot bindje, ju përveshën luftës kundër Partisë, ata shkonin sistematikisht në shumë shokë, të cilëve u ngjallnin dhe u ushqenin mërinë kundër forumit dhe, duke thyer çdo vijë organizative e disiplinore, i pregatisnin për marrjen pjesë në një konferencë që do të bëhej fshehurazi nga Partia për të gjykuar qarkorin dhe për të vënë ligjin e tyre. Këta zotërinj, për të gënjer shokët e pafajshëm, lëshuan parullën e kësaj konference, e cila është po ajo parullë e përhershme që karakterizon punën e poshtër trockiste: «Këtë e bëjmë për të mirën e Partisë — për të mirën e Partisë ne thyejmë çdo ligj dhe disiplinë që ka vendosur Partia — s'kemi gjë kundër Partisë, por udhëheqësit dhe forumet janë klikë tradhëtarësh dhe kriminelësh».

Tradhëtia i ka kurdoherë këmbët e shkurtra dhe sidomos në Partinë tonë, ku shokët e vendosur dhe që e duan me shpirt Partinë ruajnë me vigjilencë atë dhe radhët e shokëve. Kështu, kjo thikë, që i pregatitj Partisë prej tradhëtarëve Sadik Premte dhe Pali në bashkëpunim me Vangjon, Difin, Xhemilin, Zeqon, u zbulua, dhe, pa humbur kohë, Partia mori masa për likuidimin e gjendjes, duke ndjekur pa mëshirë tradhëtarët Sadik Premte e Pali dhe duke thirrur të tjerët, të cilët, mbasi të bënë autokritikën e tyre, në bazë të fajeve, të merrnin dënimin e merituar. Zbulimi i tradhëtisë solli panik në radhët e rebelëve, një pjesë e të cilëve, duke parë greminën ku i çonte Xhepi dhe Pali, u dorëzuan në Parti, një pjesë tjetër u arrestuan dhe Xhemil Çakërrri, i arrestuar për këtë faj, aksidentalisht ra viktimë e planit që kishin kurdisur për të goditur Partinë, duke u vrarë tok me Dyshekun.

Tradhëtarët Sadik Premte dhe Pali, duke e parë punën e

tyre të humbur e duke parashikuar dënimin e pamëshirshëm që meritonte tradhëtia e tyre, u tërhoqën me të shpejtë në krahinën e Mesaplikut dhe të Dukatit dhe atje alarmuan popullin, duke përdorur fjalët më të dobëta dhe shpifjet më të poshtira kundër Partisë dhe shokëve. Qëllimi i tradhëtarëve ishte të gjenin një mbështetje në popull për të shpëtuar kokën e tyre, të gjenin atë mbështetje që kujtonin më parë se e kishin në shokët që gënjen e që u rrëzuan si kështjellë prej karte. Sadik Premte dhe Pali u munduan që në mes të tyre dhe Partisë të vinin popullin si një barrikadë shpëtimi të fundit. Prej tyre populli u vu në dijeni të gjithë punës organizative, të shokëve që supozoheshin të ishin udhëheqës si dhe të lidhjeve organizative. Shpifje të ndyra dualën prej gojës së tyre, me qëllim që të diskreditojnë Partinë dhe shokët; njëkohësisht Xhepi dhe Pali u munduan të pregatisnin popullin për një goditje me armë kundër shokëve të Partisë dhe çetave partizane. Duke përfitur edhe nga vrasja aksidentale e Xhemil Çakërrit dhe e Dyshekut, ata u përpoqën të ngjallnin në fafesisin e tyre ndjenjën e hakmarrjes e të gjakut.

Mirëpo çdo ditë që shkonte ishte një disfatë për tradhëtarët dhe, nga ana tjetër, një fitim për Partinë dhe për drejtësinë e saj të madhe. Populli u ndriçua mbi situatën dhe punën tradhëtare të Xhepit dhe të Palit, ai pa qartazi se këta ishin armiq të Partisë dhe të popullit dhe i la vetëm këto mikrobe të vendit tonë, të cilët janë struktur, si kriminelë të vërtetë që janë, në një kënd të fshatit të Gjormit, duke pritur dita-ditës shpatën e Damokleut, që do t'u bjerë mbi krye për t'i spastruar përgjithmonë. Banditët trockistë, Xhepi dhe Pali, me dy-tre bashkëpunëtorë të tyre, mundohen të gjejnë përkrahjen e fundit ndër fshatarët e Gjormit, por, patjetër, fshatarët patriotë të Gjormit, ata që luftuan tok me shokët e Partisë kundër invaduesit barbar, në vend që t'i përkrahin do t'u japin shqelmin këtyre tradhëtarëve, që kanë ngritur krye kundër Partisë dhe që kërkojnë disfatën e popullit tonë. Drejtësia e Partisë është e pamëshirshme për tradhëtarët, për trockistët Xhepi e Pali, dhe për të gjithë ata që do ta lidhin fatin dhe jetën e tyre me këta banditë.

Nga ana tjetër Partia, duke pasur kurdoherë për parim t'i ngrrej shokët që kanë rënë viktimë të grupashëve, me gjithë gabimet e tyre shumë të rënda, përdor bindjen dhe përpiqet me çdo mjet për t'u dhënë dorën e për t'i ngritur nga llumi ku janë futur; atyre Partia u tregon rrugën e drejtë që duhet të ndjekin, u jep mundësitë të korrigjohen dhe të tregojnë me prova bindjen e tyre për gabimet që kanë bërë, për dëmin që i kanë sjellë punës dhe me përpjekje e me luftë të tregojnë dashurinë për Partinë dhe për çështjen.

Prandaj Vangjon e Zeqon, të cilët u dorëzuan në Parti dhe bënë autokritikë, duke njohur fajin e madh të tyre dhe tradhëtinë që po pregatisnin kundër Partisë, Komiteti Qendror i përjashtoi nga Partia dhe u jep rastin, në radhët e çetave partizane, të tregojnë me fakte pendimin, bindjen dhe dashurinë për Partinë dhe për popullin.

Qazim Çakëri (Difi) përjashtohet nga Partia dhe, mbasi refuzoi të marrë pjesë në çetat partizane, ku e urdhëroi Partia të vente për të treguar me fakte njohjen e gabimeve të tij e për të dhënë prova për ndreqjen e tij, të mbahet nën vëzhgimin më të madh dhe, në rast se shihet se aktiviteti i tij drejtohet kundër Partisë, të merren masa drakoniane kundër tij. Por përsëri të përdoret karshi tij mënyra e bindjes.

\*  
\*  
\*

Ky pësim duhet të jetë një mësim për gjithë organizatat e Partisë e sidomos për organizatën e Vlorës.

Gjithë shokët mund të këqyrin dhe të realizojnë se deri ku mund të vejë aktiviteti kriminal i grupshëve. Këta elementë grupshë trockistë e tradhëtarë shoku Stalin i cilëson kështu:

«Trockizmi i sotëm nuk është një rrymë politike në klasën punëtore, por një bandë pa parime e pa ideale, sabotatorësh, diversantësh, informatorësh, spiunësh, vrasësish, një bandë armiqsh të betuar të klasës punëtore në shërbim të organeve të zbulimit të shteteve të huaja»<sup>1</sup>.

Këta elementë shesin atdheun, nderin, ata trafikojnë çdo të fshehtë të Partisë për të mbërritur në fuqi, ata i vënë zjarr gjithë shtëpisë, ata lidhen me armiqtë e Partisë e të atdheut, ata i hapin portat armikut vetëm e vetëm për të përmbushur qëllimet e tyre të turpshme, qëllimet e tyre prej kriminelit të klasës më të ulët. Këta elementë trockistë fshehin nën maskën e rregulluar më së miri fizionominë e vërtetë të armikut të betuar të popullit. Trockistët e poshtëri si Xhepi e Pali bëjnë pjesë në atë bandë kapitulluesish që fshihen nën maskën e frazave «revolucionare» hysterike dhe provokuese dhe, nga ana tjetër, kurdoherë i kurorëzojnë veprimet e tyre duke u bashkuar me armiqtë e Partisë.

Tradhëtarët Xhepi dhe Pali s'humbisnin asnjë rast për të shfryrë kundër vijës politike të Partisë, të cilën e luftonin me fraza të majta, duke e akuzuar shumë «të butë» karshi rrymave

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 100.

të tjera politike. Xhepi bëri ç'mundi për të sabotuar përpjekjet dhe frutin e punës së shokëve, duke shkatërruar gjithë këshillat nacional-çlirimtare të një krahine dhe, me qëndrimin e tij provokues, e hodhi popullin në prehrin e reaksionit. Xhepi tok me Palin mallkonin dhe shanin elementë të ndryshëm me tendenca politike jokomuniste me qëllim që të dobësonin lëvizjen nacional-çlirimtare; dhe vepra e tyre tregoi objektivin që ndiqnin: dobësimin e Partisë, shkatërrimin e saj dhe bashkëpunimin e ngushtë me elementë jashtë Partisë; faktet tregojnë se këta ishin lidhur ngushtë dhe ndihmoheshin me armë prej elementëve të tillë.

Por tani maska e tyre u çorr, fytyra e tyre e vërtetë prej banditi u pa prej të gjithëve, u dukën të qarta qëllimet e tyre të turpshme. Me rrena ata mundën të tërhiqnin në krimin e tyre të poshtëri disa njerëz të izoluar, ata u përpoqën të gënjenin popullin, por ata s'kanë dhe s'do t'i kenë kurrë masat me vete, se

«. . . kanë frikë, — si thotë shoku Stalin, — t'i tregojnë klasës punëtore fytyrën e vet të vërtetë, kanë frikë t'i shfaqin asaj qëllimet dhe detyrat e veta të vërteta, munden t'ja fshehin klasës punëtore fizionominë e vet politike, duke pasur frikë se mos klasa punëtore po të marrë vesh synimet e tyre të vërteta do t'i nëmë ata, si njerëz të huaj për të, dhe do t'i largojë nga vetja»<sup>1</sup>.

Lufta jonë kundër këtyre armiqve të poshtëri duhet të bëhet me ashpërsinë më të madhe, dhe që të mundim ta luftojmë këtë sëmundje të ndyrë duhet t'i urrejtmë këta njerëz dhe pa mëshirë t'i godasim, kudo që t'i gjejmë e në çdo rast që manifestohen. Por lufta kundër këtyre elementëve nuk bëhet duke konstatuar vetëm faktet dhe të lidhim duart, por duke punuar e duke pasur zgjuarësinë më të madhe dhe kontrollin më të imtë në një punë të vazhdueshme. Duhet të dimë se elementët grupshë humbasin tokë dhe hedhin armët vetëm kur organizata jonë të jetë e shëndoshë, kur shokët tanë të jenë të vendosur, të ngritur në çdo pikëpamje dhe luftëtarë trima e të zgjuar në çdo fushë veprimi. Arritja e këtij qëllimi është vetëm në dorën tonë; është në duart tona të mbajmë organizatën pastër nga çdo element antiparti, është në duart tona të vëmë të gjitha forcat dhe mundin tonë për ta bërë organizatën një trup me një vitalitet të jashtëzakonshëm, t'i ndihmojmë shokët, t'i ngremë në radhën e komunistëve të vërtetë, t'i pajisim me virtytet e larta marksiste-leniniste, t'i ushqejmë me direktivat e Komitetit Qendror të Partisë dhe t'u fusim në zemër e në gjak fjalët e shokut tonë

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 98.



të madh Stalin: «Ta ruajmë Partinë si sytë e ballit». Këto kërkon prej jush Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe ai ka bindjen se shokët e organizatës së Vlorës do t'i kuptojnë gabimet dhe lëshimet e tyre, do të gjejnë ilaçin dhe shpejt, si u ka hije komunistëve, do të bëjnë përmirësime dhe përparime në pikëpamjet organizative; Komiteti Qendror i Partisë ka bindjen se lufta e brendshme kundër grupashëve dhe ajo e jashtme do të çelënikosë komunistët shqiptarë, të cilët do të ngrënë lart flamurin e Lenin-Stalinit dhe do të bëjnë që emri i Partisë sonë t'u fusë tmerrin armiqve të brendshëm e të jashtëm, ashtu si ngre shpirtrat dhe besimin e dashurinë e popullit për të.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Për Komitetin Qendror të Partisë  
Komuniste të Shqipërisë

*Shpati*

*Botohet sipas kopjes së  
shaptilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME KRIJIMIN E FORMACIONEVE MË TË MËDHA PARTIZANE DHE VEÇANËRISHT TË BRIGADËS I SULMUESE

20 qershor 1943

Të dashur shokë,

Tani që Lufta nacional-çlirimtare po merr një karakter të gjerë me formimin e zonave dhe të shtabeve të tyre, duhen formuar sa më shpejt dhe batalionet, të përbëra prej 2 deri në 4 çeta.

*Njëkohësisht duhet të zgjidhet një numër i caktuar nga partizanët më të mirë të çetave të vendit dhe që kanë marrë pjesë në një ose më shumë aksione për t'i dërguar në një vend të caktuar, ku do të formohet Brigada I e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Partizane dhe Vullnetare.*

Për këtë punë me kaq rëndësi t'u kërkohen komisarëve dhe komandantëve luftëtarët më të mirë, sipas caktimit të shifrave të qarkorit. Por kjo direktivë nuk duhet të kuptohet ngurt; formimi i Brigadës I dhe rekrutimi i anëtarëve të saj duhet të shërbejnë për t'i dhënë vrull formimit të batalioneve të zonës e jo si një pengesë. Formimi i Brigadës I si dhe formimi i batalioneve ngjall dhe forcon besimin në zhvillimin e luftës sonë drejt kryengritjes së përgjithshme.

Në Brigadën I dhe në batalionet e zonave të ndryshme, populli do të shohë bërthamën e shëndoshë e të sigurt të Ushtrisë NÇPVSH. Duhet, pra, të popullarizoni në luftëtarët Brigadën I.

Rëndësia e direktivës kërkon shpejtësi në rekrutimin e elementëve dhe në formimin e batalioneve. Me këtë rast shpejtoni mobilizimin sa më të gjerë të popullit që don të luftojë, veçanërisht të elementëve të rinj.

Po ju dërgojmë 10 kopje të një qarkoreje<sup>1</sup>. Kjo qarkore ka

<sup>1</sup> Është fjala për qarkoren e KQ të PKSH të 17 qershorit 1943. (Shih në këtë vëllim, f. 164.

një rëndësi të madhe dhe me kujdesin më të madh të punohet në të gjitha celulat e organizatave dhe në qarkorët.

Të mos shumëzohen kopjet, por të mos mbetet asnjë shok në errësirë dhe të punohet sa më mirë, se rëndësia e saj është e madhe.

Të fala shoqërore

### Shpati

NB — Batalioni përbëhet prej dy ose katër çetave dhe përbëhet prej 50 vetave e lart. Batalioni ka një komandant dhe një komisar, ashtu edhe një nënkomandant e një nënkomisar. Shtabet e batalioneve varen prej shtabit të zonës<sup>1</sup>.

Brigada do të ketë luftëtarë nga të gjitha anët e Shqipërisë dhe karakterin e një ushtrie të rregullt. Qarku juaj duhet të dërgojë 120 vetë për brigadën, dhe këta nën komandën e shokut Mehmet Shehu të nisen për në Vithkuq (Korçë) dhe të ndodhen atje më datën 25 korrik 1943. Këta luftëtarë të zgjedhur duhet të kenë armët më të mira.

Të çoni brenda datës 30 qershor në barangat e Zvarishtit një shok të mirë që të ketë edhe vesh «muzikal», se do të marrë pjesë në një kurs special. Tok me këtë shok duhet të çoni pajtjetër, po në barangat e Zvarishtit (Korçë), shokun telegrafist që kishit çuar një herë për çështjen e radios. Këta shokë do të mungojnë afro një muaj këtej.

Shoku Vjosa<sup>2</sup> do të qëndrojë këtej, prandaj më parë se të largohet duhet të rregulloni punën e atjeshme e sidomos zëvendësimin e tij në Mallakastër.

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

<sup>1</sup> Letra dërguar gjithë komiteteve qarkore të PKSH mbaron këtu; pjesa e mëposhtme e dokumentit ndodhet vetëm në letrën drejtuar Komitetit qarkor të PKSH për Vlorën.

<sup>2</sup> Pseudonimi i shokut Mehmet Shehu, kandidat i KQ të PKSH dhe sekretar organizativ i Komitetit qarkor të Partisë për Vlorën.

## PËRSHËNDETJE E KQ TË PKSH DREJTUAR KONFERENCËS SË PARË TË ORGANIZATËS SË RINISË KOMUNISTE SHQIPTARE<sup>1</sup>

Qershor 1943

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

### KONFERENCËS SË PARË TË VENDIT TË AKTIVIT TË RINISË KOMUNISTE SHQIPTARE

Shokë e shoqe,

Ushtria e Kuqe lavdiplote me popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik, nën udhëheqjen gjeniale të shokut të madh Stalin, i ka gjunjzuar hordhitë e Hitlerit. Nën grushtet e Ushtrisë së Kuqe, e ushtrisë së aleatëve anglo-amerikanë dhe të partizanëve dhe vullnetarëve të Evropës së robëruar po përgatitet shkatërrimi i fashizmit dhe çlirimi i popujve.

Populli ynë, që ka kaluar nëpërmjet vuajtjesh dhe mjerimesh të panumërta, e ka rrugën e ringjalljes në Luftën nacional-çlirimtare. Ne, komunistët, bijtë e këtij populli, kemi derdhur të tëra forcat tona në këtë luftë. Ne duam të shpëtojmë vendin tonë nga robëria fashiste, duam të çlirojmë popullin tonë. Rruga e shpëtimit është një dhe e vetme, dhe është ajo që ka zgjedhur vetë populli ynë, është ajo që ndjekim ne, është lufta e paprerë dhe pa kondita kundër okupatorit fashist.

Rinia shqiptare e ka përqafuar me entuziazëm këtë luftë të shenjtë, ajo ka përbuzur dhe ka luftuar kompromisin vëllavrasës e varrosës të independencës sonë dhe ka dalë në radhët e para të

<sup>1</sup> Konferenca e parë e Vendit të Rinisë Komuniste Shqiptare u mbajt më 9—13 qershor 1943 në Zaloshnjë të Skraparit.

Luftës nacional-çlirimtare. Partia Komuniste e Shqipërisë, në momentet më të vështira të luftës së saj kundër okupatorit dhe reaktionit të brendshëm të tërbuar, për qenjen dhe forcimin e saj, për zgjerimin dhe forcimin e Luftës nacional-çlirimtare, ka gjetur përkrahjen më të vlefshme të rinia e vendit tonë. Rinia Komuniste Shqiptare ka ditur të mobilizojë, të organizojë dhe të prijë masat e rinisë drejt çlirimit të tyre, drejt fitimit të një bote të re, pa robëri dhe pa fashizëm, që realizohet vetëm duke kaluar përmes Luftës nacional-çlirimtare. Rinia Komuniste ka dhënë shembullin e sakrificës dhe të vetëmohimit, ka dhënë shembullin e trimërisë, të ashpërsisë në luftë dhe të urrejtjes kundër okupatorit dhe tradhëtarëve; ajo i ka dhënë pa kursim atdheut tonë të dashur e të robëruar gjakun e saj, dëshmorët e saj.

KQ i PKSH i përulet kujtimit të dëshmorëve të rinj, i përulet kujtimit të drejtuesve të Rinisë Komuniste, që ranë në ballë të luftës, i përulet kujtimit të Qemal Stafës, sekretar politik i KQ të RKSJ dhe Misto Mames, anëtar i KQ të RKSJ.

Shokë e shoqe të rinisë,

Lufta nacional-çlirimtare na vë detyra të reja dhe të rënda, duhet ta forcojmë dhe ta bëjmë më të ashpër luftën kundër okupatorit. Duhet t'i shumojmë dhe t'i forcojmë radhët e çetave partizane dhe vullnetare, që të formojmë kështu një ushtri të fortë, Ushtrinë Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar, garanci për çlirimin e atdheut tonë. Duhet që radhët e ushtrisë sonë t'i mbushim me të rinj, me të rinj që kërkojnë me padurim t'i hidhen në fyt okupatorit të urryer.

Shokë e shoqe të konferencës,

Atdheu ynë i dashur është i robëruar. Zëri i tij e thërret rininë në luftë. Është detyra jonë dhe, para së gjithash, juaja, o shokë e shoqe të konferencës, që ta mobilizoni dhe ta organizoni rininë në këtë luftë të shenjtë. Duhet ta udhëhiqni rininë, ta pregatisni dhe ta forconi me punë e me luftë dhe ta bëni, kështu, një forcë më të madhe e më të gjallë për Partinë tonë Komuniste të re; duhet ta ngrini dhe ta edukoni rininë, që kështu radhët e saja të jenë një burim i pashtershëm elementësh të shëndoshë për të zmadhuar dhe për të forcuar radhët e Partisë sonë. Duhet ta drejtoni me kujdesin më të madh Rininë Komuniste, këtë organizatë kaq të çmueshme dhe kaq të dashur për Partinë; duhet ta mbroini nga çdo armik.

Shokë e shoqe,

Duhet t'i vëmë shpatullat Partisë sonë të re dhe t'u biem kokës pa mëshirë armiqve të saj të jashtëm dhe të brendshëm. Duhet t'u shtypim kokën rrymave dhe elementit trockist dhe

grupash, elementit të fëlliqur, dallaveraxhi dhe frikaman, që mundohet të dobësojë radhët e Partisë.

Shokë e shoqe të konferencës,

Kini parasysh shembullin e rinisë heroike të Bashkimit Sovjetik, e rinisë së Leninit dhe të Stalinit. Bëjani të njohur mirë rinisë shqiptare luftën heroike të rinisë sovjetike, vetëmohimin dhe sakrificat e saja, punën e saj, sukseset e saja.

KQ i PKSH ju përshëndet dhe ju uron sukses.

**RROFTË SHOKU I MADH STALIN!**

**RROFTË E PATHYESHMJA USHTRI E KUQE LAVDIPLOTE!**

**RROFTË BASHKIMI SOVJETIK, KËSHTJELLA E LIRISË!**

**RROFTË KOALICIONI I FUQISHËM ANGLO-SOVJETO-AMERIKAN!**

**RROFTË LUFTA NACIONAL-ÇLIRIMTARE E POPUJVE TË ROBËRUAR!**

**RROFTË BASHKIMI I POPULLIT SHQIPTAR!**

**RROFTË LUFTA NACIONAL-ÇLIRIMTARE E POPULLIT SHQIPTAR!**

**RROFTË PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË!**

**RROFTË BASHKIMI I RINISË ANTIFASHISTE SHQIPTARE!**

**RROFTË RINIA KOMUNISTE SHQIPTARE!**

**RROFTË KONFERENCA E PARË E VENDIT E AKTIVIT TË RINISË KOMUNISTE SHQIPTARE!**

Për KQ të PKSH

*Shpati*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjetet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



## QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME MASAT PËR ARMATOSJEN E UNÇSH

2 gusht 1943

GJITHË ORGANIZATAVE TË PARTISË

Duke marrë parasysh proporcionet e gjera që ka marrë Lufta jonë nacional-çlirimtare, sidomos në këto kohët e fundit, sasinë e madhe të luftëtarëve të rekrutuar në radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Partizane Vullnetare dhe mungesën e armatimeve në lidhje me situatën e krijuar, ndihet e nevojshme pajisja me mjete të ndryshme luftarake; prandaj duhet:

1 — Të kujdesemi dhe të kujdesemi seriozisht për gjetje armësh, të cilat mund edhe t'i blejmë. Duhet të blejmë sa të jetë e mundur më tepër armë, por natyrisht duhet të kemi sytë hapur e të mos i marrim me çmime të ekzagjeruara.

Armët mund t'i blejmë edhe nga italianët, mirëpo në të tilla raste duhet të jemi të kujdesshëm që të mos biem në kurthin e ndonjë provokacioni.

2 — Të bëjmë konferenca të ndryshme nëpër gjithë katundet, me anë të të cilave të vihet në dukje veçanërisht hovi i madh i Luftës sonë nacional-çlirimtare dhe rëndësia e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare, që është koka ushtarake e luftës sonë.

3 — Të mundohemi që, si rezultat i konferencave të bëra nëpër fshatra, të rekrutojmë luftëtarë të rinj të armatosur. Në rast se në terrenin ku kalojmë gjejmë njerëz me armë, që s'mund t'i rekrutojmë në radhët tona, duhet t'ua kërkojmë armët. Duhet pasur parasysh që kërkesa të mos bëhet në formë urdhëri dhe me forcë, por në mënyrë bindëse. Duhet t'ua paraqitim si detyrë kundrejt luftës dhe t'ua bëjmë të qartë se në këtë mënyrë ata ndihmojnë Luftën tonë nacional-çlirimtare.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror

*S h p a t i*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME DËNIMIN E MARRËVESHJES SË MUKJES

8 gusht 1943

Të dashur shokë,

Lajmërohem se ju është dërguar nga Tirana një trakt për t'u shpërndarë, i firmuar prej «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë», ku flitet për bashkimin e plotë të arritur në mes të Këshillit Nacional-Çlirimtar dhe «Ballit Kombëtar». Ky trakt është në kundërshtim me vijën nacional-çlirimtare dhe dezaprovet nga KQ i Partisë, prandaj, në rast se nuk e keni shpërndarë, çirreni dhe të mos flitet më; në rast se «Balli» ju kërkon shpjegime për këtë gjë, i thoni se duhet të realizohet një bashkim konkret në terrenin tuaj: një herë, të pushojnë luftën kundër lëvizjes n.-çl., të ndalojnë propagandën antikomuniste dhe kundër Partisë sonë, të spastrojnë radhët nga kriminelët dhe agjentët e fashizmit, të deklarohen haptazi dhe me fakte kundër fashizmit, siç bëjnë aleatët tanë Angli—URSS—Amerikë dhe pastaj mund të mbërrijmë në të tilla konkluzione. Në rast se trakti është shpërndarë nga ju ose nga «Balli», atëherë nënvleftësojeni, thoni se puna është të luftojmë me të vërtetë kundër okupatorit dhe për një Shqipëri demokratike, e jo për të firmuar letra që «Balli» deri tani i ka kundërshtuar dhe vazhdon t'i kundërshtojë haptazi me veprat e tija. Insistoni në popull mbi faktin se «Balli» ka sabotuar luftën tonë dhe po vazhdon ta sabotojë. Përmendni në konferenca dhe komunikata sabotimet dhe tradhëtitë që po bën «Balli» me fakte. Kjo nuk duhet bërë në formë lufte të hapët, por në formë apeli, për të hequr dorë nga këto gjëra që shkaktojnë përçarje dhe vëllavrasje. Kjo duhet të shërbejë për demaskimin e «Ballit» në popull dhe sidomos të krerëve të tij, kjo duhet të shërbejë për ta ndarë atë element të mirë që mund të ketë në «Ballin» nga «Balli» dhe sidomos për ta ndarë «Ballin» nga populli.

Duhet, shokë, të kuptojmë se «Balli» po mobilizohet për kolltuk, për të na luftuar, prandaj ne duhet të kemi kujdes të for-

cojmë radhët tona, të mobilizojmë popullin rreth nesh dhe të mos e lëmë reaksionin të na godasë dhe të na marrë frenat nga duart.

Qëndrimi ynë me «Ballin» është ai i pari. Jo bashkim për bashkim, se kështu i bëjmë varrin bashkimit, por bashkim me baza të shëndosha, d.m.th. pasi të bëjnë një rishikim të politikës së tyre, pasi të dënojnë politikën e tyre të mëparshme të gabuar dhe pasi të hyjnë në luftë.

Për këtë gjë, shokë, duhet të mobilizoni organizatën e tërë, t'i sqaroni shokët politikisht si duhet, të mobilizoni këshillat dhe miqtë. Agjitacioni ynë duhet ta mbulojë dhjetë herë atë të «Ballit».

Shokë, situata po ecën me hapa të shpejta, nuk duhet të na zërë gjumi në rrugë. Për të përballuar situatën, për të qenë kaluar mbi të, duhet të forcojmë organizatën mirë.

Kini kujdes, shokë, të kontrolloni dhe të ndihmoni celulat, që kështu të jenë me të vërtetë në lartësinë e duhur; kini kujdes të rregulloni grupet edukative, të rregulloni punën me simpatizantët dhe me miqtë, kini kujdes të forconi këshillat, t'i shtini në punë, forconi organizatën në Ushtrinë N.-Çl. (pa organizatë të Partisë në çeta s'ka Luftë nacional-çlirimtare). Por mos harroni t'i vini rëndësinë më të madhe forcimit të ushtrisë sonë, ta bëni luftëtare në kulm, ta pajisni mirë me armë.

Ndihmoni organizatën e rinisë dhe organizatën e gruas, vini rëndësi mobilizimit politik dhe ushtarak të rinisë, që është forca jonë më e gjallë.

Direktivat, përta i përket vijës politike që po ju komunikojmë, transmetojani mirë dhe organizatës së rinisë.

Ju, shokë, e kuptoni vetë se për të kryer të tilla detyra duhen kadro, dhe kadro të shëndosha. Partia jonë është Partia e punëtorëve, Partia e popullit që punon, prandaj duhen nxjerrë kadro të formuara mirë nga këta. Por duhet të punojmë për një gjë të tillë dhe jo të kufizohemi të lavdërojmë punëtorinë.

Shokë, ndajini mirë detyrat, ngarkojini mirë shokët me përgjegjësinë e duhur dhe përvishjuni punës. Ne e masim punën me rezultatet, prandaj, shokë, i presim këto sa më shpejt. Partia jonë është Parti masash dhe ka si objektiv që të jetë udhëheqësja e vërtetë e popullit shqiptar për fitoren e indipendencës së tij dhe të të drejtave të tija. Duhet këtë gjë ta kemi kurdoherë parasysh, kjo gjë duhet t'ju prijë dhe me këtë duhet t'i matni rezultatet.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të PKSH

*Shpati*

Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë

**LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË  
PKSH PËR VLORËN MBI FORMIMIN E SHTABIT TË  
PËRGJITHSHËM TË UNÇSH, MBI BISEDIMET ME  
«BALLIN KOMBËTAR» DHE DËNIMIN E OPORTUNIZMIT  
TË YMER DISHNICËS NË MUKJE<sup>1</sup>**

17 gusht 1943

Me shokun S. muarëm vesh për situatën e atjeshme si të organizatës ashtu dhe të ushtrisë dhe shpresojmë përta i përket të parës që me vullnet edhe me punë të pareshtur do të arrini në rezultate të mira. Përta i përket ushtrisë ju përgëzojmë për formimin e Shtabit të Zonës dhe hyrjen e tij në veprim. Kjo do të jetë një nga siguritë tona për forcimin e ushtrisë dhe të influencës sonë.

Pesë ditë më parë ju dërguam një qarkor<sup>2</sup> ku ju vinim në korrent për hedhjen e një trakti në Tiranë, i cili do t'ju jetë dërguar edhe juve për t'u shtypur dhe mënyrën si duhet të vepronit mbi këtë gjë. Këtu do të jap disa sqarime që ta kuptoni mirë si ngjau kjo gjë, ku e ka origjinën dhe masat që duhet të marrim si kundërveprim. Kam munguar t'ju shkruaj për zhvillimet e bisedimeve në Pezë, kjo është një e metë, por shkak është se kemi qenë shumë të okupuar. Formimi i Brigadës I, fillimi i punës me shtabin dhe hapat e parë, puna e Partisë në sektorin e Korçës si edhe koha e udhëtimeve nëpër rrugë, më kanë penguar t'ju shkruaj. Në Labinot u mbledhën gjithë anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm<sup>3</sup> me përjashtim të Kamber Qafmollës<sup>4</sup> dhe

1 Ky dokument gabimisht është lënë jashtë në botimin e vëllimit 1 të Veprave të shokut Enver Hoxha.

2 Shih në këtë vëllim qarkoren e KQ të PKSH 8 gusht 1943.

3 Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm u mbajt më 4 korrik 1943.

4 Kamber Qafmolla u la jashtë Këshillit të Përgjithshëm Nac.-Çl. në Konferencën e dytë Nac.-Çl. të Labinotit për shkak të mosaktivizimit të tij në Luftën nacional-çlirimtare.

Ndoc Çobës<sup>1</sup> të cilët u trembën të vinin. Kjo mbledhje pasi shqyrtoi situatën vendosi formimin e Shtabit të Përgjithshëm me këta persona: Spiro Moisiu, komandant, Enver Hoxha, komisar, dhe anëtarë: Bazi i Canës, Myslim Peza, Baba Faja, Haxhi Lleshi, Baca [Ramadan Çitaku], Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova, Mustafa Gjinishi, Bedri Spahiu, Dali Ndreu. . . U bisedua për zgjerimin e Këshillit të Përgjithshëm Nac.-Çl. dhe u pranua unanimisht këshilli i vjetër duke kooptuar dhe Sejfulla Malëshovën e Haxhi Lleshin. [U caktua dhe një] kryesi<sup>2</sup> e këshillit, që do të marrë përsipër të organizojë një konferencë të gjerë për të zgjedhur një këshill më të gjerë me elementë të tjerë të provuar gjatë një viti luftime. U diskutua qëndrimi sabotator i «Ballit» dhe mbi këtë pikë ishim që të gjithë të një vendimi dhe mendimi. Vetëm Bazi i Canës bëri objeksione për yllin duke e prezantuar këtë gjë sikur s'e pëlqen populli etj. dhe duke shtuar nga ana e tij se s'është aspak në kundërshtim me mbajtjen e yllit, «pse e keni lyer me gjak dhe me sakrifica, por nuk duhet me e vënë mbi flamur, mund ta veni kudo gjetkë». Pas disa diskutimeve ramë dakord duke i shpjeguar Bazit se çështjen e yllit s'e ngre populli, por e ngrenë ballistët dhe qëllimet e tyre i dimë fare mirë, por yllin në nuk mund ta heqim se ju dashka qejfi ballistëve, në këtë gjë mund ta diskutojmë kur ata të kenë hyrë në luftë dhe të jenë gjakosur mirë me okupatorin dhe jo të bëjnë një luftë të tillë, e cila na bëhet më shumë neve dhe aspak okupatorit. Bazi i pranoi këto arësye. U vendos gjithashtu që t'i bëhej edhe një herë thirrje «Ballit» duke thirrur disa krerë të tij dhe t'u thuhej haptazi qëllimi dhe vendimi i Këshillit [të Përgjithshëm] Nacional-Çlirimtar. U caktuan nga ana jonë delegatët që do të venin të bisedonin me ta dhe këta ishin: Bazi i Canës, Myslimi<sup>3</sup>, Ymeri<sup>4</sup>, Mustafa Gjinishi dhe Kamber Qafmolla në rast se ai pranonte pikëpamjen e këshillit mbi të gjitha ç'ishin vendosur në Labinot. U caktuan dhe pikat mbi të cilat do të bazoheshin bisedimet me «Ballin». Këto pika ishin: «Balli Kombëtar» të ndalonte luftën që u bënte këshillave dhe të hynte përnjëherë në luftë me prova dhe jo me fjalë, të pranonte të hynte në këshillat nacional-çlirimtare dhe të merrte pjesë në një konferencë të

1 Ndoc Çoba më vonë dezertoi përfundimisht nga Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, duke u bërë bashkëpunëtor i pushtuesve gjermanë.

2 Në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm në korrik të vitit 1943, bëhet fjalë për formimin e një sekretariati që do të merrej me punët e përditshme të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

3 Myslim Peza

4 Ymer Dishnica

gjerë ku do të merrnin pjesë përveç Këshillit Nacional-Çlirimtar e «Balli» dhe një numër i madh patriotësh të tjerë të ndershëm. Njëkohësisht «Balli» të qëronte nga radhët e tija elementët kompromisaxhinj si Ali Këlcyra me shokë. Veçanërisht ju theksua Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit për qëndrimin që duhet të mbanin, si komunistë që ishin, duke ditur fare mirë se ç'ishte «Balli», manevrat dhe lojën e tij.

Pasi u ndamë nga Labinoti, pas 10 ditësh marrim letrën e parë të Ymerit ku na shkruan në esencë këto: Në një takim të parë<sup>1</sup> që patën me Lumo Skëndon dhe Hasan Dostin pas shumë diskutimeve dhe lëkundjeve nga ana e këtyre të fundit vendosën që konkluzionet e bisedave t'i hidhnin në një procesverbal dhe ky procesverbal u bë dhe u nënshkrua prej të dy palëve dhe ja pikat kryesore që na shënonte Ymeri në letrën e tij, (po i vë tekstualisht se kanë rëndësi të madhe)<sup>2</sup>:

I) Luftë imediate zaptuesit fashist.

II) Të dy organizatat pranojnë idenë themeltare të formimit të një komiteti të përbashkët me emrin «KOMITETI PËR SHPËTIMIN E SHQIPËRISË».

III) Luftë për një Shqipëri të lirë independente dhe demokratike të vërtetë.

IV) Komiteti ka për program gjithashtu çlirimin e Shqipërisë së 1913-s dhe, për viset e tjera të banuara prej shqiptarësh, reklamën të drejtën universale të vetëvendosjes së popujve të garantuar edhe prej Kartës së Atlantikut<sup>3</sup>. Mbasandaj në letër Ymeri zgjatej mbi konsideracionet e tij dhe vërejtjet mbi njerëzit e «Ballit» duke treguar dallaveren e «Ballit» që përpiqet «të hyjë pa luftë në histori», «që të marrë frenat e lëvizjes» etj. Mbasandaj shtonte vërejtjet e tija «që evenimentet po rrokullisen», «që rënia e Duçes do të ketë reperkusione të mëdha», «që gjithë bota ishte në ethe», «që edhe ata ishin në ethe» etj. etj. Këtë letër as që e përfundon, pse shkoi të piquej me delegatët e «Ballit» në një fshat të Dajtit. Kjo ishte brendia e letrës dhe ne s'kuptuam asgjë nga kjo letër e nga këto bisedime që të mundnim ta ndihmonim. Shikua katër pika të thata nga të cilat pika e dytë ishte e errët, por prapëseprapë [ishte] në procesverbal, [kurse] për pikat që ne kishim vendosur në Labinot dhe që duhej të diskutoheshin asnjë

1 Takimi i parë me krerët e «Ballit Kombëtar» është bërë më 26 korrik 1943 në Tapizë.

2 Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 1, f. 326-334, 339-341.

3 Karta e Atlantikut — deklaratë zyrtare e kryetarëve të qeverive të SHBA-së dhe Anglisë nënshkruar më 14 gusht 1941, me anën e së cilës njiheshin sovraniteti i popujve të pushtuar nga shtetet fashiste dhe të drejtat e tyre për të zgjidhur vetë pas luftës formën e qeverimit. BRSS u bashkua me Kartën e Atlantikut më 24 shtator 1941. Më 1942 aderuan në të 26 shtete.



fjalë për to në letër. Meqenëse afati që ne u kishim dhënë që të qëndronin atje kishte shkuar dhe rezultati i letrës së parë që na dërgoi ishte insinjifiant<sup>1</sup> ne i shkruam që të ktheheshin.

Marrim një letër të dytë nga Ymeri ku na shkruante në esencë këto: Në mbledhjen e dytë<sup>2</sup> që patën me «Ballin» dy pika kryesore ua ngatërronin hesapin: e para «Shqipëria etnike», shpallja e independencës dhe e dyta rrëzimi i vendimit të Asamblesë së 12 prillit. «Ndalesën e «Shqipërisë etnike» e kapërcyem me një formulë as femër as mashkull, por si atë që ju shkrova në letrën e parë». «Ndalesën e dytë, vazhdon në letër Ymeri, e kaluam duke ja lënë në dorë një komiteti definitiv që do të caktohet para 8 gushtit». Këto përmbante letra e dytë dhe asgjë më tepër; as që do të hedhim një trakt, as të kërkonin mendimin për hedhjen e këtij trakti, vetëm thoshte se duhet të venim ne afër Tiranës ose t'u dërgonim direktivat para datës 8 [gusht].

Ne ju përgjegjëm se s'jemi dakord me ato që po bisedonin ata, se koha s'ishte për të shpallur independencën e Shqipërisë, por «Balli» duhej t'i shpallte më parë luftë Italisë dhe se «Balli» me këto manevra do të fshijë të shkuarën e tij të zezë, do të hyjë në histori dhe se do të rrëzojë me çdo kusht Asamblenë e 12 [prillit], sepse në të figurojnë gjithë ballistët. Nga ana tjetër u kujtonim detyrat që u ishin ngarkuar dhe pikat mbi të cilat u ishin thënë të bisedonin dhe i këshillonim që të mos vepronin në asnjë mënyrë jashtë tyre. Por këta as që pritën përgjigjen tonë dhe më 6-7 gusht hodhën traktin në emër të «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë» i cili flet për çdo gjë, por aspak për luftën kundër fashizmit, aspak për përpjekjet e Partisë sonë, por «luftë për një Shqipëri independente demokratike, popullore dhe për zbatimin e parimit të njohur universalisht e të garantuar nga Karta e Atlantikut të vetëvendosjes së popujve, për një «Shqipëri etnike»». Ky trakt për ne ishte një kapitullim përpara «Ballit», pse fshinte të gjitha përpjekjet tona, gjithë luftën tonë, këshillat nacional-çlirimtare, parullat me të cilat udhëhoqëm dhe frymëzuam luftën dhe nga ana tjetër «Balli» që ka bërë gjithë ato poshtërsira po na delte si shpëtimtari i Shqipërisë. Pas këtij trakti ne u dërguam gjithë organizatave të Partisë qarkore që sigurisht e keni marrë dhe keni vepruar.

Kjo gjë natyrisht do të ketë reperkusione në punën tonë, pse ne në asnjë mënyrë nuk do të pranojmë një gjë të tillë që të biem në pozitat e diktuar nga «Balli» dhe të pranuar prej Doktorit, asnjë parullë nuk do të ndërrojmë dhe as formën dhe

1 Insinjifiant (frëngj.) — i parëndësishëm.

2 Mbledhja e dytë me krerët e «Ballit Kombëtar» u mbajt më 1-2 gusht 1943 në Mukje afër Krujës.

emrin e këshillave nacional-çlirimtare. Ne do ta vazhdojmë luftën më të ashpër nën ato parulla dhe nën flamurin e Luftës nacional-çlirimtare. Për këtë arsye duhet të denoncohet trakti që është hedhur në emër të «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë» dhe sa për çështjen e bashkimit ne e bëjmë vetëm në këto kondita, që po ju shënojmë më poshtë:

1. — Luftë kundër fashizmit okupator dhe gjithë shërbëtorëve të tij.

2. — Bashkim në luftë, por jo në një luftë demonstrative e bërë me qëllim për të larë fajet e vjetra, për të marrë flamurin e luftës dhe me e sabotue luftën në një mënyrë tjetër, pse e para dështoi, por në një luftë të vërtetë, të ashpër dhe të paprerë kundër fashizmit okupator dhe tradhëtarëve.

3. — Gjatë kësaj lufte, si u caktua në pikën e sipërme do të arrijmë në formimin e një shtabi operativ të përbashkët për të gjithë Shqipërinë si edhe në shtabet operative të zonave.

4. — Këshillat nac.-çl. janë pushteti, i cili ka lindur nga populli dhe nga lufta dhe u zgjodhën në një mënyrë demokratike prej tij, prandaj si një pushtet i tillë demokratik-popullor duhet të pranohet prej të gjithëve.

5. — Për një Shqipëri independente, demokratike dhe ku populli vetë, pas luftës, do të vendosë formën e regjimit.

6. — Respektimin e Kartës së Atlantikut, të Traktatit të Londrës dhe të Uashingtonit në mes të URSS-it, të Anglisë dhe të Amerikës dhe në lidhje me të çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet pas luftës dhe vetë popujt e Kosovës e të Çamërisë, sipas dëshirës së tyre, do të vendosin për fatin e tyre. Ne do t'i japim gjithë mundësitë që të krijohet situata e tillë që çështja të zgjidhet me drejtësinë e plotë. Derisa fashizmi të zhduket detyra jonë kryesore patriotike është të frymëzojmë dhe të ndihmojmë që popujt e Kosovës e të Çamërisë të hyjnë në luftë kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij, se vetëm në këtë mënyrë ata do të sigurojnë jetën e tyre dhe të drejtën e vetëvendosjes.

7. — Ne jemi për një luftë të përbashkët me të gjitha rrymat politike të vendit, të cilat janë në luftë të paprerë, imediate dhe të rreptë kundër fashizmit okupator dhe shërbëtorëve të tij.

8. — Ne nuk bashkëpunojmë me «Ballin Kombëtar» si organizatë kompakte derisa «Balli» të ketë në radhët e tija njerëz që kanë lidhje me okupatorin, që sabotojnë Luftën nac.-çl. që bëjnë luftë kundër Frontit Nacional-Çlirimtar dhe kundër Partisë Komuniste dhe derisa ai të mbajë në radhët e tija elementë kriminelë dhe kusarë.

9. — Ne bashkëpunojmë me të gjithë ata elementë që deri tash s'kanë bërë krime në kurriz të popullit, por që kanë qëndruar në pozita të okupatorit dhe që këtej e tutje ndjekin vijën

e vërtetë të luftës dhe që do të largohen një herë e mirë nga ato pozita të gabuara ku i ka mbajtur propaganda armike.

Është e pamundur t'ju themi të gjitha mendimet tona për konsekuencat dhe situatat që mund të krijohen prej kësaj pozite. Ju duhet të thelloheni dhe t'i nxirrni vetë, por ne ju këshillojmë në përgjithësi se si duhet vepruar për ta zhdukur këtë situatë dhe jo vetëm ta zhdukim, por ta kapërcejmë në favorin tonë; atje do të duket vendosja jonë dhe aftësia e komunistëve në situatat më të vështira.

Gjëja e parë është me forcë organizatën dhe mos me lënë që të shfaqet asnjë lëkundje dhe moskënaqësi. Këtë gjë do ta bëni duke u shpjeguar qartazi vijën tonë të drejtë dhe për këtë punë janë përgjegjës delegatët dhe jo Komiteti Qendror dhe se një person ose dy mund të gabojnë, por Partia s'gabon dhe vija politike e saj nuk mund të lejohet të thyhet dhe të shtrembërohet. Nga ana tjetër, përnjëherësh, gjithë organizata duhet të mobilizohet dhe të shtrëngohen radhët e Partisë, të fillojnë konferenca të gjera dhe të gjalla në popull ku t'u tregohet qëndrimi ynë dhe qëndrimi i «Ballit», duke demaskuar të gjithë personat që kanë bërë dallavere, që kanë bërë poshtërsira dhe të kërkonin haptazi nga populli mendimin e tij që me këta njerëz nuk mund të bashkëpunohet. Si për shembull: Ali Këlcyra, ka bërë këtë e këtë, ky është njeri i poshtër, ky ka luftuar kundër lëvizjes, ky ka bërë kompromis me okupatorin, ky është edhe në «Ballë» prandaj ne s'mund të bashkëpunojmë me «Ballin» derisa ai të mos qitë jashtë elementë të tillë dhe në bazë të pikave që ju shkruajmë t'i tregojmë popullit se vetëm në këtë mënyrë ne pranojmë bashkëpunimin dhe bashkimin. Të mobilizohen këshillat, miqtë, anëtarët e Partisë, simpatizantët dhe të tërë të vihen në lëvizje. Të rikëndonin edhe qarkoren e parë që ju dërguam dhe të veproni edhe në bazë të saj duke forcuar organizatën. Shpejt do t'ju vijë dy trakte që do t'i shumëzoni dhe do t'i hidhni nga të katër anët dhe do t'i punoni kudo në konferenca e në mitingje me popullin. Njëri nga këto trakte do të jetë nga Komiteti Qendror si përgjegje akuzave që na bën «Balli» dhe tjetri nga ana e këshillit që do t'ju sqarojë edhe ca më mirë për qëndrimin tonë. Duhet sa më parë të lajmëroni dhe Gjirokastrën për këtë qëndrim dhe [ata] të veprojnë në këtë mënyrë...

Për çështjen e ushtrisë do t'i shkruajmë veç Komandës së Zonës nga ana e Shtabit të Përgjithshëm.

Më 15 të këtij u bë festa e brigadës, e cila pati një sukses shumë të madh. Më shumë se 1 000 vetë asistuan në ceremoninë, dhe parakalimi i brigadës me entuziazëm të madh u duartrokit prej popullit, prej gjithë këshillave të qarkut që kishin vrapuar të asistonin në themelimin e [njësisë] së parë të ushtrisë sonë të rregullt. Dhe me të vërtetë, shokë, ajo kishte pamjen e ushtrisë

së rregullt. U mbajtën fjalime të shumta, u kënduan këngë dhe pastaj u bë një piknik i madh ku s'dëgjohej përveçse këngë, fjalime dhe urrejtje për okupatorin. Kjo është një datë në historinë e lëvizjes sonë. Dhe ky shembull duhet për së shpejti të ndiqet prej të gjitha krahinave.

Miqtë aleatë as që i mbajnë premtimet që na kanë dhënë; fare pak armë po na hedhin, për të mos thënë aspak.

Situata në qarqet është e pandryshuar. Organizata e këtushme ka mjaft të meta dhe lëshime, shpresojmë se brigada këto pak kohë që do të qëndrojë këtu do t'i japë një impuls punës.

Po vë një letër brenda, të cilën e sjell një partizan i brigadës. Ju keni 800 stërlina që ju ka dhënë anglezi, nga këto 500 do t'ja jepni këtij [partizani] dhe do ta ndihmoni që të blejë sasinë e bereqetit dhe të depozitohet për Brigadën I në vendet që ju caktohen. Këto ushqime të mos preken. Të tërhiqni napolonat e tjerë që t'i përdorni për armë dhe këto armë të mbahen në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm.

Telegrafisti që erdhi një herë dhe iku përsëri duhet të niset sa më parë për tek vendi i parë dhe të mos vijë me mendje se do të kthehet prapë në shtëpi, por do të rrijë këtej. Kur të vijë tek vendi që erdhi më parë atje të kërkojë Nexhipin dhe ai e drejton ku duhet.

Me dr. Ymerin s'jemi pjekur edhe, por do të piqemi për së shpejti dhe do t'ju lajmërojmë për [këtë] çështje. Ju duhet të na jepni mendimin tuaj përsa ju shkruajmë në mungesë të një mbledhje të Komitetit Qendror, të cilën kemi ndërmend ta bëjmë për së shpejti dhe që do t'ju lajmërojmë për këtë gjë me kohë.

Duke ju çuar të falat e mia shoqërore si dhe të gjithë shokëve dhe veçanërisht të Halimit<sup>1</sup>.

Taras

Pas këtij gabimi që bëri Dr. asnjë ndarje mendimesh në mes shokëve të KQ të gjithë mendojnë njësoj dhe dezaprovojnë traktin dhe ç'ka bërë Dr.

Taras

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

1 Halimi — pseudonimi i Miladin Popoviçit

## DIREKTIVA E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME GJENDJEN E KRIJUAR PAS KAPITULLIMIT TË ITALISË FASHISTE<sup>1</sup>

10 shtator 1943

### GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË

Të dashur shokë,

Sigurisht jeni në korrent të situatës së krijuar, por megjithatë ne po ju vëmë në dijeni të gjendjes dhe të qëndrimit e masave që duhet të merrni, sidomos në lidhje me situatën e brendshme.

Ofensiva e madhe sovjetike, e kryer me një stil të gjerë dhe të ri, dhe në një front prej më tepër se njëmijë kilometrash gjerësi, shkon përpara, duke çliruar qytete dhe krahina të gjera. Kjo ofensivë kaq e fortë ka detyruar gjermanët jo vetëm të ndalohen, por të tërhiqen me humbje të panumërta. Po plotësohen fjalët e shokut Stalin, i cili ka thënë se «ne do të çlirojmë tokat tona nga okupatori fashist gjerman brenda një kohe të shkurtër, dhe ky do të pësojë disfatat më të turpshme». Qytete si Harkovi, Bjellgorodi, Orjoli, Stalinoja dhe gjithë baseni i Doncit janë përgjithmonë në duart e Ushtrisë së Kuqe heroike. Forcat e armatosura sovjetike, që dita-ditës shtohen e forcohen, të armatosura me materialin më modern, po marshojnë drejt Ukrainës me forca të dhjetëfishuara. Përpara tanksave, avionave dhe përpara strategjisë së shkëlqyeshme dhe gjeniale të shokut tonë të madh Stalin, banda e Hitlerit dhe strategjia gjoja e pamundshme e gjermanëve pësoi thyerjen e turpshme, dhe Ushtria e Kuqe lavdiplote, e udhëhequr prej Partisë Bolshevike të URSS-it, po pregatit çlirimin e shpejtë të popujve të robëruar, po pregatit një të ardhme të lumtur të popujve të robëruar.

Italia «u dorëzua pa kondita». Disfatat e vazhdueshme politike dhe ushtarake të pësuar nga fashizmi, si në Afrikë ashtu

<sup>1</sup> Akti i kapitullimit të Italisë fashiste u nënshkrua më 8 shtator dhe u shpall zyrtarisht më 8 shtator 1943.

dhe në Siqueli e gjetkë, shkaktuan rrëzimin e turpshëm të Musolinit dhe ardhjen në fuqi të qeverisë reaksionare të Badolios. Një nga shkaqet kryesore që detyruan rrëzimin e qeverisë Badolio është zhvillimi i lëvizjes së popullit italian, grevat madhështore të punëtorëve (proletariatit) të Veriut, të drejtuara nga Partia Komuniste Italiane heroike dhe nga partitë e tjera përparimdashëse. (Shënojmë se radio Londra nuk përmend fare Partinë Komuniste Italiane, çka është karakteristike, por Partinë Socialiste Italiane, si udhëheqëse të kësaj lëvizjeje, ashtu si bën për Partinë Socialiste Poloneze dhe për të tjera parti «përparimdashëse» socialdemokrate, «agrare» etj., si infeksion të jashtëm për t'u krijuar edhe në vende të tjera parti të këtij tipi, me qëllim që të përçajë forcat popullore në luftën e tyre çlirimtare dhe t'i shmangë nga objektivi i luftës së tyre. Në këtë mënyrë rrëzimi i Hitlerit dhe i Musolinit të mos ketë konsekuenca të rënda për reaksionarët dhe kapitalistët e Londrës dhe të Nju-Jorkut, të shkaktojë shpërndarjen e proletariatit, në radhë të parë, të forcave popullore dhe të ngjallë mosbesim në turmat. Po në këtë mënyrë kanë vepruar edhe në luftën e parë me partitë socialdemokrate, socialshoviniste, të kryesuara prej Kautskit, Shejdemanit, Ceretelit, Çernovit, Leginit e K<sup>o</sup>. Por partitë komuniste kanë eksperiencën e luftës së parë dhe do të dinë të orientohen në këtë situatë.)

Aleanca në mes të popujve anglez dhe amerikan, më një anë, dhe të Bashkimit Sovjetik, në anën tjetër, është një realitet, e lidhur fortësisht në luftë kundër fashizmit. Ajo është faza e veçantë dhe karakteristike e kësaj lufte, është aleanca që po forcohet si në mes të popujve anglez, amerikan dhe të Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe të popujve të robëruar.

Hitleri donte të zaptonte të gjitha vendet e botës dhe, në këtë mënyrë, cënonte qenjen nacionale të Anglitarëve dhe të Amerikës. Një nga shkaqet më kryesore të aleancës anglo-sovjeto-amerikane është ky. Por s'duhet të harrojmë se qeveritarët anglezë kanë refuzuar kërkesën e kësaj aleance shumë kohë më përpara nga ana e Bashkimit Sovjetik, derisa interesat e Anglitarëve u kërcënuan direkt nga ana e imperializmit gjerman, që u bë një rrezik real për Anglitarët. Është e natyrshme që në një situatë të tillë u arrit në një blok aleance kaq të fortë, në krye të të cilit qëndron Bashkimi Sovjetik. Në këtë mënyrë filluan të grumbullohen tepër e më tepër fuqi antifashiste rreth e përçark këtij bloku.

Në shtresat e larta «të popullit», dhe në vetë qeverinë angleze, ka elementë reaksionarë, të cilët duan të vendosin fuqi reaksionare ndër vendet e shtypura dhe bash për këtë arësye kanë formuar dhe tentojnë të formojnë në Londër qeveri reaksionare të vendeve të shtypura pas rënjes së Hitlerit. Po këto rrethe,



që kishin prurë Hitlerin dhe Musolinin në fuqi, tani përpiqen për ta ndërruar rrymën e luftës së sotme kundër Hitlerit dhe Musolinin në drejtimin, gjoja, të një Evrope të re, d.m.th. të një Versaje të re. Në këtë mënyrë ata kanë krijuar në Londër qeveri reaksionare të popujve të shtypur, me pretendimin se këto qeveri përfaqësojnë këta popuj, por që në të vërtetë ato nuk janë veçse vegla të këtij reaksioni për të shtypur lëvizjen nacional-çlirimtare të këtyre popujve. Nuk përjashtohet mundësia e formimit të një qeverie të tillë shqiptare në Londër ose ndihma për ta krijuar në vend, prandaj shokëve u drejtohem që në një rast të tillë të dinë të marrin qëndrim të caktuar. Disa persona të rretheve qeveritare si dhe disa gazetarë të mëdhenj si «sociologu» për «Evropën e re», Beverixh<sup>1</sup>, premuan ringjalljen e «Evropës së re» dhe ndihmë në rroba, ushqime, barëra etj. Ne jemi kundër mënyrës me të cilën ata e japin atë ndihmë dhe me çfarë tendence e japin. Shokët duhet ta kenë të qartë këtë gjë dhe ta studjojnë me vërejtje që agjitacionin e tyre mos ta drejtojnë kundër Anglisë dhe Amerikës në përgjithësi, me të cilat ne jemi në aleancë në këtë luftë, por kundër këtyre elementëve reaksionarë, të cilët ndodhen në qeveritë e këtyre vendeve.

Pas dorëzimit pa kushte të Italisë është krijuar një situatë e re jo vetëm në Itali por edhe tek ne. Gjermanët mundohen të marrin krejt fuqinë në dorë dhe kështu të okupojnë Shqipërinë «e okupuar». Në një situatë të këtillë paraqiten kundërshtime në mes të ushtarëve gjermanë dhe atyre italianë. Ndërsa qëndrimi ynë tani po ndryshon kundërshtime ushtrisë italiane, të cilën ne sot e shohim me sy tjetër. Duhet të qëndrojmë në shfrytëzimin e kundërshtimeve, të cilat po paraqiten dita-ditës më të thella. Në qoftë se kjo ushtri italiane nuk do të luftojë kundër nesh, ne do ta ftojmë në luftë me parullën «vëllazërim në luftë kundër Gjermanisë hitleriane» dhe ushtarët italianë do t'i konsiderojmë si vëllezër armësh; në rast të kundërt, në qoftë se do të vijojnë luftën kundër nesh, ne do ta bëjmë luftën me atë ashpërsi si kundër gjermanëve.

Më përpara që filluar diferencimi i reaksionit, veçanërisht ky diferencim duket fort e më fort jo në favorin tonë, por me forcimin edhe më tepër të reaksionit. Mund të shihet qartazi që rreth e përçark «Ballit» elementët reaksionarë po grumbullohen dita-ditës më tepër. Këta elementë reaksionarë dhe të «Ballit» përpiqen të marrin pushtetin dhe të vendosin qeverimin e tyre reaksionar. Këta përpiqen të forcohen, që kështu të përfitojnë nga eventualiteti i një zbarkimi të aleatëve.

Zbarkimi i aleatëve në Ballkan, ose edhe në Shqipëri, nuk

<sup>1</sup> U. Beverixh, ekonomist reaksionar anglez, mbrojtës i flaktë i rendit kapitalist.

është më një perspektivë shumë e largët<sup>1</sup>. Prandaj organizatat tona duhet të punojnë për të përballuar një situatë të tillë. Duhet që në rastin e zbarkimit të aleatëve, këshillat nacional-çlirimtare të jenë me të vërtetë pushteti i popullit, të mobilizojnë gjithë popullin rreth tyre dhe të mos lejojnë që forcat e tjera, si «Balli Kombëtar», të kenë influencë në popull. Duhet që Ushtria Nacional-Çlirimtare të jetë shumë e fortë, të ketë gjithë popullin pas dhe të mos lejojë që të ketë grumbullime të tjera ushtarake, kundërshtarë të saja, si p.sh. të «Ballit Kombëtar». Duhet të dini se fuqitë aleate të zbarkimit do të përkrahin të gjitha forcat shqiptare që do të gjejnë përpara, pa preferencë për ato të lëvizjes nacional-çlirimtare dhe, bile, po të marrim parasysh çështjen e Darlanit<sup>2</sup>, me preferencë për ato reaksionaret. Që të mund të evitohet një gjë e tillë, forcat nacional-çlirimtare duhet të fillojnë të imponohen që tani kudo dhe në rastin e zbarkimit t'u paraqiten aleatëve me anën e këshillave dhe Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, si i vetmi pushtet i popullit shqiptar. Aleatët duhet të jenë në Shqipëri me ushtritë e tyre vetëm për të thyer Gjermaninë me këlyshët e saj, por qeverimi i Shqipërisë duhet të jetë plotësisht në duart e lëvizjes nacional-çlirimtare, dhe këtë gjë aleatët duhet ta njohin. Prandaj, pra, që sot të gjitha organizatat me të gjitha forcat e tyre duhet të punojnë në këtë drejtim.

Ju e dini se marrëveshja e arritur me «Ballin Kombëtar» me krijimin e «Komitetit për shpëtimin e Shqipërisë» ka qenë në dëm të lëvizjes nacional-çlirimtare dhe të Partisë sonë dhe si e tillë është dezaprovuar nga Komiteti Qendror. Mbi këtë gjë ju kemi vënë me kohë në dijeni. Kjo marrëveshje na ka futur në pozita të vështira. Në momentin kur «Balli» duhej vënë me shpatulla në mur për aktivitetin e tij në favor të fashizmit okupator, në momentin kur «Balli» duhej paraqitur para popullit shqiptar si një organizatë përçarëse, që saboton sistematikisht të gjitha përpjekjet tona për një bashkim të shëndoshë të popullit tonë, ne i dhamë në dorë kartën e marrëveshjes, e një marrëveshjeje,

<sup>1</sup> Në atë kohë flitej se shumë shpejt do të kryhej një zbarkim i forcave aleate në Ballkan. Zbarkimin në Ballkan trupat anglo-amerikane nuk e kryen as në vitin 1943, as në fillim të vitit 1944. Kur Komanda aleate e Mesdheut kërkoi të zbarkonte ushtrinë e saj në Shqipëri me qëllim të caktuar për të shpëtuar reaksionin e brendshëm nga shkatërrimi i plotë e për të mos lejuar fitoren e revolucionit popullor, Komanda e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH nuk e lejoi një zbarkim të tillë.

<sup>2</sup> Darlani, admiral reaksionar francez, ish-kryekomandant i forcave të armatosura të qeverisë fashiste të Vishisë. Në nëntor të vitit 1942 u dorëzua rob te amerikanët në Afrikën e Veriut, të cilët duke ndjekur qëllimet e tyre imperialiste, e emëruan atë komisar të Afrikës Veriore Franceze.

siç e donte ai, për të intriguar më mirë në popull. Ishte momenti për të shpejtuar diferencimin në radhët e «Ballit», për të ndarë popullin nga «Balli», për të ndarë elementin e ndershëm, që kishte shkuar viktimë nga krerët reaksionarë, nga rruga oportuniste antipopullore dhe antipatriotike e politikës së «Ballit». Me këtë marrëveshje ne lejuam që «Balli» të lidhet më ngushtë me elementët që bënin presion brenda radhëve të tija për një marrëveshje me ne, lejuam që «Balli» të shtërngojë e të forcojë radhët e tija dhe të mbahet akoma i lidhur mirë me turmat që, të gënjyera prej tij dhe të pasqaruara politikisht, vazhdojnë ta ndjekin. Reaksioni dhe veçanërisht krerët e «Ballit» mendojnë tani të përcajnë radhët e Luftës nacional-çlirimtare, të konsolidojnë pozitat e tyre me anë manevrash politike; ata mendojnë të formojnë një parti socialdemokrate për këtë punë. Kanë qitur në krye të kësaj manevre elementë si Skënder Muçua dhe Hysni Lepenica që, reaksionarë në punë, pandehen fatkeqësisht si demokratë prej një pjese të popullit. Duhet të kemi kujdes që të mos bjerë në grackën e kësaj manevre ajo pjesë e lëvizjes nacional-çlirimtare që është e pasqaruar akoma, përse i përket bashkimit dhe se si mund dhe duhet të bëhet ky bashkim me «Ballin» dhe me rrymat e tjera jashtë lëvizjes sonë; duhet të kemi kujdes për elementin që ka hyrë në radhët e Partisë jo pas një pune të shëndoshë dhe që ka pasur lidhje të ngushta me elementë që janë kundër Luftës nacional-çlirimtare, duhet të kemi kujdes nga elementët që vijnë nga ish-grupi i «Zjarrit».

Për të sqaruar situatën, për të marrë qëndrim të caktuar karshi gjendjes së krijuar, që e nevojshme të mblidhej Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar dhe Konferenca e dytë e Vendit Nacional-Çlirimtare. Nuk që e mundur, nga shpejtësia dhe nga konditat në të cilat gjendemi, që të vinte një numër shumë i madh delegatësh. Në Konferencë u konstatua unanimitet në mendimet dhe veçanërisht përse i përket qëndrimit që duhet të kemi karshi «Ballit Kombëtar». Megjithëse për së shpejti do t'ju dërgojmë rezolucionin e Konferencës, prapë ne po ju japim të përmbledhura në pikat kryesore vendimet e saj:

««Balli Kombëtar» është një organizatë e lindur si reaksion kundër lëvizjes nacional-çlirimtare; ai ka rënë në manevrën e kurdisur prej armikut për të përçarë popullin shqiptar dhe për të shkaktuar vëllavrasje. I tërë reaksioni me ngjyrat e tija të ndryshme është futur dhe po futet në radhët e tija.

Qëndrimi ynë karshi «Ballit» duhet të jetë i rreptë dhe i drejtë. Duhet të demaskohet pa mëshirë politika oportuniste e tij, të luftohet fushata e tij demagogjike për bashkimin dhe të shpjegohet mirë se për bashkimin e vërtetë të

popullit shqiptar ka punuar me të tëra forcat e saja vetëm lëvizja nacional-çlirimtare, se bashkimi është një gjë që u intereson më tepër se kujtdo atyre që janë për luftën dhe lirinë e popullit, se bashkimi nuk mund të bëhet kur njëri shkon në një rrugë dhe tjetri në rrugën e kundërt, se bashkimi duhet të mbështetet në baza të shëndosha, përndryshe nuk është bashkim, por përçarje. Ne kërkojmë që «Balli Kombëtar» të heqë dorë nga politika e tij e gabuar dhe të hyjë në radhët e Frontit Nacional-Çlirimtar, duke pranuar programin e Këshillit. Megjithatë, që të mos lëmë të na ikë asnjë mundësi për bashkimin e popullit shqiptar, pranojmë edhe një bashkëpunim më të largët me organizatën e «Ballit Kombëtar», por ky bashkëpunim duhet t'u shtrohet këtyre konditave minimale: 1) luftë e menjëhershme dhe e paprerë kundër okupatorit fashist italian e gjerman; 2) luftë krah për krah me aleatët e mëdhenj anglo-sovjeto-amerikan, me popujt e shtypur dhe, veçanërisht, me lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve fqinjë të Jugosllavisë e të Greqisë; në konformitet me luftën e përbashkët të popujve liridashës, duke u mbështetur në Kartën e Atlantikut dhe në Traktatin e Londrës e të Uashingtonit, të pranohet politika e vetëvendosjes së popujve; çështja e Kosovës do të zgjidhet sipas dëshirës së popujve të Kosovës; 3) të njihen këshillat nacional-çlirimtare si i vetmi pushtet demokratik popullor dhe të insistohet mbi këtë pikë; 4) «Balli» të spastrojë radhët e tija nga elementët që kanë lidhje me fashizmin okupator, nga spiunët, nga kriminelët, nga spekulatorët e lidhur me klikat spekulonjëse të armikut për t'i hequr popullit bukën nga goja në këto kondita ekonomike të vështira luftime; 5) të pushohet menjëherë lufta dhe propaganda antikomuniste dhe kundër Partisë Komuniste, gjë që është në papajtimit me luftën për vendosjen e një demokracie popullore në Shqipëri.

Krerët e Dibrës, në pjesën më të madhe, shumë bajraktarë të Veriut dhe shumë persona me influencë në Shqipërinë e Jugut dhe të Mesme kanë qëndruar në pozita që u afrohen atyre të «Ballit». Krerët e Dibrës kanë bërë një «itifak»<sup>1</sup> ndërmjet tyre dhe një lidhje me armikun, që është njëlloj me protokollin Dalmaco-Këlcyra. Për këta, si dhe për të gjithë ata që janë jashtë lëvizjes nacional-çlirimtare, çështja e bashkimit ose e bashkëpunimit shtrohet si me «Ballin Kombëtar».

Në lidhje me kapitullimin e Italisë, konferenca vendos që t'u drejtohem italianëve të dorëzohen te ne, sepse ne jemi një fuqi aleate e anglo-sovjeto-amerikanëve. Në rast

se ata vazhdojnë qëndrimin e mëparshëm kundër nesh, ne gjithashtu vazhdojmë qëndrimin e mëparshëm dhe më të ashpër. Por duhet të marrim parasysh se armiku ynë kryesor sot është Gjermania dhe se ushtari italian don me çdo mënyrë të shkojë në shtëpinë e tij, prandaj ne duhet t'i drejtohem atij që të bashkohet me ne kundër gjermanëve ose të na japë armët. Duhet të insistojmë për çarmatosjen e ushtrisë italiane. Po në lidhje me situatën e re duhet që, sidomos në zonat e çliruara, këshillat nacional-çlirimtare të ushtrojnë me të vërtetë pushtetin dhe të zhdukin influencën e rrymave të tjera. Për këtë gjë të forcohen, sidomos nga pikëpamja organizative, këshillat nacional-çlirimtare, të krijohen këshilla në çdo fshat, të krijohen këshilla të komuneve, të nënprefekturave (jo të qytetit, por të gjithë nënprefekturës) dhe prefekturave<sup>1</sup>.

Ne mendojmë se me «Ballin Kombëtar» nuk do të jetë e mundur të arrihet në një marrëveshje. Mendojmë gjithashtu se «Balli» ka marrë një rrugë që do ta shpjerë patjetër në një përpjekje me ne, prandaj ne duhet të punojmë në drejtimin që vijon: me anë të një demaskimi të zgjuar dhe të një pune të palodhshme të diskreditojmë «Ballin» në popull, t'ja shkëpusim popullin dhe këtë ta lidhim me ne, të shkaktojmë divergjenca në vetë radhët e «Ballit», të krijojmë situata të përshtatshme për të shkakuar dhe për të shpejtuar diferencimin në radhët e «Ballit» dhe t'u biem kokës me zgjarësi dhe në mënyrë gjithmonë më vendimtare krerëve reaksionarë të tij; ta paraqesim mirë në popull «Ballin» si përçarës dhe shkaktar vëllavrasjeje, të bëjmë që populli ta shohë se politika e «Ballit» do na shpjerë në përpjekje me armë, të bëjmë që populli i tëri të revoltohet për këtë gjë dhe kështu përgjegjësitë historike të mosbashkimit të popullit shqiptar dhe të përpjekjes me armë të bien, siç është e vërteta, dhe kjo gjë të jetë e qartë për të gjithë në Shqipëri, mbi «Ballin Kombëtar»; të përgatitemi, të përgatisim të tërë ata të lëvizjes nacional-çlirimtare, të përgatisim popullin për një përpjekje me «Ballin»; «Balli» po e përgatit këtë përpjekje dhe nuk duhet të na gjejë me duar lidhur, nuk duhet në asnjë mënyrë që t'i lejojmë «Ballit» të përgatitet dhe të na godasë në konditat më të favorshme për të, duhet ta vëmë me shpatulla në mur dhe ta shtërngojmë që t'i qisë sheshit kartat e tija dhe, kështu, të mund ta godasim kur të jetë më e favorshme për ne, kur ta ketë kuptuar populli lodrën e tij dhe kur të bashkohet me ne kundër tij.

1 Në rregulloren e këshillave nacional-çlirimtare, të aprovuar në Konferencën e dytë Nacional-Çlirimtare, u ruajt ndarja e vjetër administrative (komunë, nënprefekturë dhe prefekturë).

Situata na shtërngon që të veprojmë, por që të veprojmë duhet të jemi të përgatitur, sidomos ushtarakisht. Organizimi dhe forcimi i njësiteve në qytete shtrohet sot si një problem urgjent dhe me shumë rëndësi. Njësitët duhet të jenë të pajisura mirë me revolvera e bomba dore dhe, mundësisht, me pushkë automatike (të bëjmë çmos t'i blejmë dhe t'ua marrim italianëve me çdo mjet dhe sa më parë këto armë, të mos presim asnjë ditë që të na i dërgojnë të tjerët). Njësitët të vihen nën komandën e njërit prej shoqëve më të mirë, më të zot dhe më të përshtatshëm të Partisë. Të studjojmë mënyrën e sulmimit të qendrave më me rëndësi të qytetit dhe veçanërisht të atyre ku ka armë. Të diktohen dhe të sulmohen qendrat e Gestapos dhe të komandave gjermane përgjithësisht. Të ekzekutohen spiunët më të rrezikshëm, agjentët e kolonës së pestë, njerëz, të cilët, të lidhur deri dje ngushtë me armikun, sot hidhen në ilegalitet ose futen në organizata të tjera si «Balli Kombëtar» për të organizuar luftën kundër lëvizjes nacional-çlirimtare dhe veçanërisht kundër Partisë sonë, si p.sh. Irfan Ohri, Qamil Xhani, Vehib Runa etj. Të ekzekutohen spiunët dhe agjentët e ushtrisë gjermane. Të krijohen në qytet vende të fshehta për armë, për ilegalë, për sigurimin e funksionimit të vazhdueshëm të organizatave tona dhe të njësiteve.

Të kemi kurdoherë parasysh që, në rast sulmi kundër qyteteve nga ana jonë, të kombinohen veprimet e guerrileve të brendshme me ato të çetave. Mos harrohet rëndësia e dokumentave ndër zyrat sekrete të armikut, të cilat duhet të bien në duart tona. Gjithë organizatat e Partisë, qysh tani, duhet të jenë të mobilizuara për çdo eveniment dhe të jenë gati për të përballuar çdo të papritur. Celulat e Partisë që do të jenë motori, i cili do të vëjë në lëvizje tërë popullin e qyteteve e të katundeve, duhet të spastrohen nga gjithë ata elementë që nuk do t'i kryejnë këto detyra me kaq rëndësi. T'u thuhet shoqëve të Partisë se sot është koha që ata të tregohen me të vërtetë prijësa të sigurt dhe guximtarë të popullit dhe të kuptojnë momentin vendimtar që po përshkojmë drejt marrjes së pushtetit. Celulat të jenë motori i grupeve të simpatizanëve dhe miqve të Partisë, të cilëve t'u theksohet se sot duhet të japin çdo gjë për çlirimin e atdheut dhe lartësimin e forcimin e Partisë sonë. Teknika e Partisë duhet të jetë e mobilizuar dhe të punojë ditë e natë, duke sqaruar popullin, me trakte e proklamata, për situatat e ndryshme që krijohen dhe evenimentet që rrokullisen, duke i treguar kurdoherë rrugën që duhet të ndjekë. Në çdo moment duhet të mbani qëndrime politike të qarta, në bazë të direktivave të Komitetit Qendror. Me mobilizimin e gjithë organizatës duhet të lidhni mobilizimin dhe përgatitjen e popullit për kryengritjen e përgjithshme. Duhet t'i dedikoni kujdes të madh mobilizimit dhe organizimit të rinisë, sepse rinia është në Shqipëri forca më e gjallë dhe më e shëndoshë e lëvizjes



nacional-çlirimtare. Për këtë gjë duhet t'i jepni ndihmën më të madhe rinisë.

Duhet të krijohen organizatat e Gruas Antifashiste dhe këto nuk është e thënë të grumbullohen në bazë të mëhallave ose të fshatrave, por mund dhe duhet të krijohen edhe në bazë të profesioneve ose në baza të tjera si p.sh., duke krijuar shoqëri për zhdukjen e analfabetizmit, për të krijuar punë për veshmbathjen e ushtrisë etj. Këtyre organizatave duhet t'u japim gjithë ndihmën dhe nga këto organizata të nxjerrim edhe elementë për Partinë.

Me kapitullimin e Italisë duhet të parashikojmë rezistencën gjermane, në kontinent dhe këtu në Shqipëri. Gjermanët po forcojnë buzëdetin tonë pjesërisht, për t'u mbrojtur nga zbarkimi i aleatëve. Nga ana tjetër fashistët gjermanë do të përpiqen të na godasin; gjithashtu do të mundohen të lidhin pas qerres së tyre reaksionin e brendshëm. «Balli Kombëtar» s'ka folur deri tani kundër nazizmit dhe, sigurisht, në «Ballin» po manifestohet që tani dëshira për një bashkëpunim me gjermanët. Sidoqoftë përsëri reaksioni do të përpiqet, në mos haptazi (se Gjermania po shkon drejt varrit) tërthorazi, t'u shtrijë dorën gjermanëve për të forcuar pozitën e veta të tronditura. Për këtë shkak duhet t'i gjykoni situatat me gjakftohtësinë më të madhe, duke qenë kurdoherë në ballë të situatës dhe të popullit.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të Partisë

*S h p a t i*

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

PS — Këto direktiva, pa qenë nevoja që t'u këndohen, duhet të punohen me të gjitha celulat e Partisë dhe në bazë të këtyre direktivave t'u jepen udhëzime gjithë organizatave të Partisë, deri në grupet e simpatizantëve. Veçanërisht të punohen në të gjitha celulat e çetave dhe batalioneve të qarkut tuaj.

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI FORCIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

23 shtator 1943

GJITHË ZËVENDËSKOMISARËVE POLITIKË TË ÇETAVE,  
BATALIONEVE DHE BRIGADAVE TË USHTRISË  
NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Që me krijimin e çetave tona të para partizane ishte e nevojshme dhe e domosdoshme krijimi i organizatës së Partisë në këto çeta. Në këtë luftë çlirimtare Partia jonë është udhëheqësja e vërtetë e masave të gjera të popullit e gjithashtu dhe e masave të luftëtarëve të grumbulluar në radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Në radhët e kësaj ushtrie të përbërë nga bijtë më kohshientë të popullit tonë, të përbërë nga punëtorët dhe katundarët në shkallë të gjerë, Partia jonë do të përhapë qëndrimin e saj të drejtë dhe do të krijojë e forcojë aleancën e punëtorëve dhe të fshatarëve, kusht me rëndësi për fitoren tonë; nga radhët e kësaj Ushtrie Popullore do të rekrutojë një pjesë të madhe të anëtarëve të saj, nga më të vendosurit e më trimat. Për këtë arsye, shokët e Partisë në çeta kanë në supet e tyre një detyrë me një rëndësi të jashtëzakonshme, të cilën duhet ta kryejnë me kujdesin më të madh, duke u gjendur kurdoherë në radhët e para të zjarrit, duke qenë organizatorët, agjitorët dhe propagandistët më të mirë.

Ju, shokë zëvendëskomisarë, Partia ju ka ngarkuar një barrë shumë delikate dhe me një rëndësi të madhe, ju ka ngarkuar organizimin dhe drejtimin e organizatës së Partisë në ushtri. Rëndësia e organizimit të Partisë në ushtri u është theksuar shumë herë dhe ky organizim duhet të bëhet menjëherë. Për këtë punë jeni përgjegjës tok me komisarët politikë, pse pa organizatë të Partisë në ushtri, ne nuk mund të kemi një ushtri ashtu si e dëshirojmë ne, ushtri që të kryejë misionin e madh dhe delikat. Në rast se nuk është organizuar Partia në formacionin ushtarak ku bëni pjesë, të veprohet pa humbur kohë në mënyrën e mëposhtme.

Duhet që në çdo formacion ushtarak, dhe që t'i përshtatet

këtij formacioni, të ketë një organizatë partie e cila do të përmbledhë në gjirin e vet gjithë anëtarët e Partisë të atij formacioni. Kjo organizatë do të udhëheqë jetën e ushtrisë; do t'i futë asaj shpirtin e disiplinës, të vendosjes, të vetëmohimit, të trimërisë; do ta bëjë atë koshiente për detyrën që i ngarkon populli dhe historia.

Në këtë celulë që të formohet, të zgjidhet sekretari i celulës në personin e zëvendëskomisarit politik, i cili duhet të jetë më i afti, më i vendosuri për Partinë dhe për luftën dhe më i zhvilluari politikisht dhe teorikisht; të ndahet puna në sektorë dhe për çdo sektor pune të caktohet një shok përgjegjës, i cili duhet në çdo mbledhje të japë hesap për detyrat që i ngarkohen për të zbatuar. Vetëm me një ndarje pune të shëndoshë dhe me ngarkimin me përgjegjësi të çdo shoku për sektor do të mund të bëjmë punë sistematike dhe të rregullt, por pa qenë kjo ndarje shkak specializimi vetëm në sektorin e ngarkuar, por përkundrazi kolaborimi<sup>1</sup> të jetë i vazhdueshëm dhe specializimi dhe përgatitja e shokëve të jetë e gjithanshme.

Pasi të organizohen celulat e çetave, të batalioneve, byrotë e batalioneve dhe ato të shtabeve dhe të lidhen këto organizativisht me anë të sekretarëve të celulave (zëvendëskomisarëve) njëra me tjetrën, të lidhen me Komisarin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, i cili do t'i drejtojë raportet në Komitetin Qendror të Partisë. Kjo lidhje organizative duhet të jetë shumë e shëndoshë dhe e shpeshtë, kështu që Komiteti Qendror të jetë në gjendje të dijë situatën e Partisë në ushtri dhe të japë gjithë ndihmën për mbarëvajtjen e saj. (Referati mbi Ushtrinë Nacional-Çlirimtare që ju është dërguar gjithë organizatave në terrene të ndryshme duhet t'ju ketë mbërritur me kohë dhe atë ta studjoni mirë e ta punoni. Ky referat do t'ju shërbejë pa masë për organizimin e Partisë në ushtri).

Celula e Partisë në ushtri ka për detyrë të lartësojë anëtarët e Partisë; këta nuk do të jenë vetëm luftëtarët më të mirë, por edhe udhëheqësit politikë më të sigurtë të popullit tonë, udhëheqës jo vetëm sot në këtë luftë, por në çdo moment e në çdo rrethanë. Edukimi dhe lartësimi i shokëve do t'i ndihmojë të vepronjë në situata të komplikuar e në zhvillimin e ngjarjeve të mëpërtejme, ku lufta jonë do të marrë pamje të tjera.

Duhet t'u ngarkoni anëtarëve të Partisë detyra sipas aftësisë së tyre, t'u kërkohen rezultate dhe të bëhen organizatorë dhe prisa politikë. Anëtarët e vjetër duhet t'u japin anëtarëve të rinj çdo ndihmë dhe të mos i trajtojnë me një mënyrë ushtarake të keqkuptuar e sidomos nëpërmjet urdhërave të rrepta të shtabeve, por t'i bindin shoqërisht. Duhet të vihet kujdesi më i madh për

1 Kolaborimi — bashkëpunimi.

t'i edukuar shokët në celula e në grupe si politikisht dhe ideologjikisht. Duhet të mos harrojmë se njohja e teorisë është arma kryesore kundër armiqve të popullit. Materiali që është nëpër duar ose ai që do t'ju vijë të mbahet me kujdesin më të madh dhe të punohet patjetër në mbledhje të veçanta të celulës.

Të rekrutohen në Parti të gjithë ata luftëtarë që në aksione janë treguar të vendosur për Partinë dhe për luftën, ata që janë me karakter dhe të ndershëm. Çetat e batalionet tona duhet të japin me duzina anëtarë të tillë që e meritojnë emrin e anëtarit të Partisë.

Me një punë të tillë ne mund të arrijmë që me të vërtetë të krijohet roli udhëheqës i Partisë në ushtrinë tonë. Ky rol udhëheqës nuk do të bëhet as me urdhër as me dekret as pse në shtabet e ushtrisë do të jenë shokët tanë, por do të bëhet vetëm në qoftë se shokët tanë do të jenë luftëtarët më të mirë dhe në qoftë se në ushtrinë tonë ndërtojmë organizatën e Partisë nga poshtë-lart, ta organizojmë si fuqi që do të udhëheqë mbarë ushtrinë. Roli udhëheqës i Partisë do të krijohet me punën e gjerë që do të bëjnë celulat ndër masat e gjera të luftëtarëve, me anë të komunistëve, anëtarë partie që janë anëtarë të shtabeve dhe që janë të obliguar<sup>1</sup> në disiplinën e Partisë në celulë. Duhet të kemi kurdoherë ndërmend se celulat nuk mund t'u japin urdhër shtabeve për veprime ushtarake se këta i marrin urdhërat nga shtabet më të larta të tyre, por celula ka rolin me rëndësi që të zhvillojë inisiativën e shtabit dhe nga ana tjetër bën që të zbatohen udhëzimet plotësisht dhe me kohë. Celula e Partisë ka një rol tjetër, sikundër e shihni dhe shtabi një rol tjetër. Këtë shokët duhet ta kuptojnë dhe ta dallojnë. Të evitohet gabimi që mund të ngjasë shumë herë që shtabi të marrë mbi vete gjithë punën në ushtri, gjë që është e gabuar dhe jo në vijë të drejtë, gjithashtu dhe komisarit të kryejë vetë gjithë punën e Partisë, gjë që është e gabueshme dhe e dëmshme, se komisarit politik i cili është përfaqësuesi i Partisë në ushtri ka për detyrë të mbrojë pikëpamjen politike të Partisë në ushtri, kurse puna e Partisë është shumë më e madhe dhe më e gjerë se sa detyra e komisarit politik.

Pra, shokë zëvendëskomisarë, punës së Partisë në çetat duhet t'i jepni rëndësi të madhe, pse ashtu si do të jetë celula në çetë ose në batalion, ashtu do të jetë dhe çeta dhe batalioni dhe nga puna e drejtë intensive e celulës varet puna e madhe e Partisë. Duhet të dini se detyra kryesore e celulës në çetë është ta ngrerë këtë si moralisht ashtu dhe politikisht për çdo veprim kundër çdo armiku dhe në cilëndo luftë që do ta thërriste Partia jonë. Duhet ta bëni gjithë çetën, me punën tuaj, të jetë e tëra e aftë për një agjitacion të gjerë kudo që shkel e lufton, duhet, me

1 Janë të obliguar — janë të detyruar.

punën tuaj, t'i bëni luftëtarët e çetës që të jenë shembull disipline, dashurie karshi popullit dhe me sjelljet e tyre të mira të fitojnë zemrën e popullit tonë.

Për kryerjen e këtyre detyrave me kaq rëndësi, ju shokë jeni përgjegjës përpara Partisë, por kjo nuk përjashton aspak përgjegjësinë e anëtarëve të tjerë të celulës. Duhet të bëhen çdo javë mbledhjet e celulave dhe në këto mbledhje të bisedohen me seriozitetin më të madh çështjet e ditës dhe të vendoset zgjidhja e tyre, të punohen dhe të zbatohen direktivat e Partisë dhe urdhërat e shtabeve ushtarake. Për shpjegimin e drejtë të qëndrimeve të Partisë janë përgjegjës sekretari i celulës dhe komisar i politik.

Komiteti Qendror i Partisë kërkon prej gjithë anëtarëve të Partisë në ushtri dhe në radhë të parë nga zëvendëskomisarët dhe komisarët, të kryejnë detyrat që u ngarkohen me përpikëri, të jenë të disiplinuar në direktivat e këtij komiteti dhe të organizojnë e të forcojnë organizatën e Partisë në ushtri, ta udhëheqin këtë ushtri me sigurinë më të madhe dhe me aftësinë e drejtësinë e plotë drejt fitores për çlirimin e popullit, drejt objektivave të shenjta të Partisë sonë Komuniste.

Konstatohet me keqardhje një burokratizëm në radhët e komisarëve dhe zëvendëskomisarëve. Këta, në vend që të jenë kurdoherë me masat e gjera të ushtarëve, të bëjnë jetën e tyre dhe të jenë kurdoherë pranë tyre për t'u dhënë çdo ndihmë dhe përkrahje si politike dhe ushtarake, ata qëndrojnë larg tyre duke u dhënë urdhëra në një mënyrë formale. Një punë e tillë jo vetëm që dëmton çështjen, por ul njëkohësisht prestigjin e Partisë në popull dhe turmat ushtarake. Në ushtri e në terren komisarët dhe zëvendëskomisarët neglizhojnë në përgjithësi të mbajnë konferenca të gjera duke pretenduar se janë kurdoherë në lëvizje ose janë të lodhur. Për anëtarët e Partisë nuk ka lodhje dhe justifikime.

Mbledhjet e celulave neglizhohen dhe për këtë jepet kurdoherë arsyeja e lodhjes dhe e lëvizjes; këto mbledhje me asnjë mënyrë të mos lihen pas dore pse pa u mbledhur në celulë nuk do të mundet kurrë të drejtohet ushtria drejt objektivave që kërkon Partia. Në celulë të bisedohen çështjet aktuale, të rrihen problemet me seriozitetin më të madh dhe t'u jepet zgjidhja e tyre, kështu që ato të mos ndodhen përpara situatave të papritura. Në këto momente përpara Ushtrisë Nac.-Çl. paraqitet urgjente marrja e pushtetit duke çliruar krahina e qytete dhe detyrat e anëtarëve të Partisë në këtë rast janë të rëndësishme dhe delikate. Ata do të jenë shtylla e organizimit të pushtetit si civil dhe ushtarak, ata do të jenë udhëheqësit e sigurtë të mbarë popullit. Gjithë shokët e Partisë duhet të dinë të përdorin stil të ri në çdo situatë që rrokulliset dhe t'ja adaptojnë luftës së

sotme strukturën e organizimit dhe mënyrën e luftës, të dinë të udhëheqin masat e gjera dhe të ngrënë nivelin ushtarak të shkëve në gradën më të lartë. Kryengritja e përgjithshme e vë anëtarin e Partisë të japë mendime të reja dhe për këtë arsye duhet që puna në celulë të bëhet intensive, punët që merren të kryhen dhe gjithsecili të jetë përgjegjës efektiv për zbatimin e detyrës. Nuk ka për anëtarët e Partisë ndjesë dhe justifikime. Të ruhen nga sektarizmi dhe interpretimi i ngushtë i detyrave të anëtarit të Partisë për punimin ndër masa dhe rekrutimin e anëtarëve të rinj, por kjo s'do të thotë se duhet të shkojmë në ekstremin tjetër e të futim çdo element në Parti. Puna e rinisë në ushtri është neglizhuar; ky është një gabim që s'falet pse çdo zëvendëskomisar politik duhet të dijë që rinia është një sektor nga më me rëndësi të Partisë, është një nga shtyllat e Luftës nac.-çl. është një nga sektorët më delikatë. Për këtë arsye duhet që në çdo celulë në ushtri të caktohet një përgjegjës për punën me rininë dhe ky e gjithë shokët e tjerë të celulës të zhvillojnë një aktivitet të madh, për të mobilizuar dhe organizuar rininë në organizatën e Bashkimit të Rinisë Popullore Antifashiste Shqiptare; të formohet në çdo fshat këshilli i Rinisë Antifashiste Shqiptare, të ndihmohet formimi i shoqërive të ndryshme të rinisë, si ato sportive, muzikore etj. me qëllim që të forcohet fronti antifashist i rinisë shqiptare. Çështja e rinisë të merret me seriozitetin më të madh dhe jo sikundër është lënë deri tash, sepse në rast se vazhdojmë kështu do të vijnë momente të këqia, që do të jetë zor t'i zotërojmë.

Në tokat e çliruara të formohen organizatat e Gruas Antifashiste dhe të theksoni kudo rëndësinë dhe rolin që luan gruaja në këtë luftë dhe kështu të përgatitim për gruan shqiptare fushën për fitimin e të drejtave të saja.

Këto udhëzime të studjohen mirë nga ju të gjithë dhe të zbatohen përpikërisht në jetë. Nga një zbatim i drejtë i tyre do të varet suksesi ynë.

#### KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Shënim:* Komiteti qarkor i terrenit që merr këtë qarkore ta punojë në qarkor dhe të shtypë aq kopje sa ka zëvendëskomisarë politikë në formacionet e Ushtrisë Nac.-Çl. të qarkut të tij. Këtë punë ta bëjë në lidhje me Shtabin e Zonës ose të grupit dhe të kujdeset që këto direktiva të mos bien në asnjë mënyrë në duart e armikut ose të atyre që nuk u drejtohen.

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



**LETËR E KQ TË PKSH MBI MASAT PËR FORCIMIN  
E PUSHTETIT TË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE  
DHE TË PARTISË, MBI QËNDRIMIN KUNDREJT «BALLIT  
KOMBËTAR», KUNDREJT «LEGALITETIT» DHE  
KUNDREJT MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE**

**1 tetor 1943**

SHOKUT...

*për veprim gjithë komiteteve qarkore të Partisë*

Ju kemi çuar disa letra; deri tani besojmë se i keni marrë dhe i keni punuar. Në këto momente paraqitet urgjente dërgimi i lajmeve dhe raporteve të imta nga ana juaj, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mundim të ndihmojmë shoqi-shoqin dhe t'u japim një zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë çështjeve që po rrokullisen.

Në radhë të parë na paraqitet *çështja e pushtetit*, dua të them vendosja kudo e këshillave nacional-çlirimtare, forcimi i tyre dhe mbrojtja e tyre nga çdo tentativë e «Ballit» ose e ndonjë partie tjetër, që do të përpiqet t'i sabotojë ose t'i luftojë haptazi. Për këtë punë nuk duhet të ketë dy kuptime: vetëm pushteti i këshillave duhet të ekzistojë dhe asnjë pushtet tjetër, nuk ka kompromis dhe dualitet në këtë gjë. Për këtë shkak ne duhet të jemi të zgjuar dhe jo të flemë e ta lëmë «Ballin» të hyjë në ndonjë vend dhe atje ai të bëjë ligjin e të vetëvendosë, kurse ne të lidhim duart dhe të kënaqemi me një luftë politike. Në këtë kohë forcat tona, që në shumë raste janë më të shumta se ato të «Ballit», presin duarlidhur që demaskimi i «Ballit» të bëhet komplet dhe pastaj të shohin a mund të veprojnë. Këtë e them që veprimet e ndryshme që kanë bërë shokët në krahina të na shërbejnë si mësim. Për shembull, në Gjirokastër ballistët hynë të parët në qytet me 600 bashibozukë, dhe Ali Bej Këlcyra, Bahri Omari dhe Koço Muka kanë marrë frenat dhe po shesin mend në Gjirokastër. Shokët tanë hynë më vonë në qytet me 1500 vetë, thonë, dhe në vend

që t'i spastrojnë këto plehra që andej, po kënaqen me një luftë politike kundër tyre, ndërsa gjatë kësaj kohe «Balli» vazhdon punën e tij<sup>1</sup>. Puna politike kundër «Ballit» nuk duhet të jetë e vetme në këto raste, ajo duhet të ndihmojë veprimet ushtarake, të cilat duhet të jenë decizive; nuk mjaftojnë mitingje dhe konferenca, por duhet menjëherë të merret pushteti, të organizohen komandat dhe të stabilizohet pushteti i këshillave, duke mbajtur disiplinën, rregullin, duke organizuar jetën në qytet dhe duke luftuar me ashpërsinë më të madhe dhe me pushkë në dorë të gjitha padrejtësitë dhe vjedhjet që i bëhen popullit nga kushdo që të jetë. Nuk duhet të qëndrojmë spektatorë përpara poshtërsive të «Ballit» dhe të presim që nga këto zheste «Balli» të demaskohet; ne duhet të ndërhyjmë dhe t'i godasim pa mëshirë. Asnjë hezitim kur është puna për të mbrojtur popullin. Ndryshe ne e kemi të humbur në goftë se veprojmë me zemër prej murgeshe. «Balli» nuk ta liron pushtetin, dhe askush tjetër, në goftë se nuk e rrëmben me forcë, se është e drejta jote dhe e popullit. Në Berat ngjet gjithashtu po ky avaz: nga një anë pushteti i «Ballit» e, nga ana tjetër, pushteti ynë dhe, nëpërmjet të dyve, xhandarmëria e vjetër mban qetësinë. Për «Ballin», të gjitha raportet që na vijnë nga shokët tanë s'kanë të tjera terma veçse këto: ««Balli» s'qenka gjë, ai demaskohet, ai bën gabime, ai udhëhiqet prej reaksionarëve, populli e urren» etj. etj. Për këshillat thuhet kudo në radhë të parë se janë të forta, të organizuara, por mjerisht «Balli Kombëtar» edhe në Berat është shtruar dhe po çjerr e pret si një pushtet më vete. Nga populli marrim vesh (se raporte andej na vijnë shumë rrallë, sëmundje kjo e gjithë shokëve, të cilët ende s'e kanë kuptuar rëndësinë e centralizimit të punës dhe mbajtjen në korrent të Komitetit Qendror) që vetë Abaz Ermeni del nëpër qytet dhe çjerr me duart e veta afishet e «Zërit të Popullit», që gjermanët janë tek ura e Hasan Beut dhe ata, mbasi kontrollohen prej shokëve tanë, kanë të drejtë të hyjnë në qytet dhe të blejnë plaçka<sup>2</sup>. Këto gjëra s'na besohen, s'na besohet që shokët tanë të kenë arritur në atë shkallë sa të bëjnë të tilla kompromise, por flitet me

<sup>1</sup> Pas kapitullimit të Italisë fashiste në shtator 1943, Komiteti qarkor i PKSH për Gjirokastrën që drejtohej nga Bedri Spahiu, nuk mori masa për shkatërrimin e aparatit të pushtetit të vjetër, por lejoi që ky aparat të vihej nën kontrollin e «Ballit Kombëtar» dhe të përdorej prej tij.

<sup>2</sup> Në shtator—tetor 1943 komanda partizane e qarkut të Beratit, që drejtohej nga Gjin Marku, pa dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm dhe në kundërshtim me vijën e Partisë lejoi hyrjen e lirë të forcave gjermane në Beratin e çliruar nga forcat e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Ky akt përbënte një faj shumë të rëndë dhe si i tillë u dënua nga Partia. Gjin Marku u përjashtua nga KQ i PKSH.

aq insistim në popull saqë shokët në Tiranë janë të alarmuar, se edhe «Balli» filloi të flasë për këtë gjë. «Perëndia» të na ruajë nga ata shokë që i kanë mentë prapa kokës! Prandaj këtë gjë t'ua fusni mirë në kokë shokëve. Përpara «Ballit» dhe kompromisaxhinjve të tjerë s'ka dobësi, rruga është e qartë dhe pa kthesa. Kthesa ka vetëm për ata që ishin të gënjyer dhe që pranojnë vijën tonë, por për të tjerët ka plumba kokës. Në lidhje me këtë duhet të dini se sot është momenti më shumë se kurrë që elementët e poshtër të qërohen, të qërohen pa mëshirë ata armiq të popullit që kanë sabotuar luftën, që janë vegla të okupatorit, që luftojnë komunizmin dhe Partinë tonë; mos u merrni me krymbat e vegjël, por me ata që kanë lojtur fillin e poshtërsive.

*Çështja e «Ballit Kombëtar»* duhet të merret me seriozitetin më të madh dhe, para së gjithash, për ta luftuar armikun më së miri duhet të njohësh forcat e tija, forcat reale dhe jo në tym. Për fat të keq, shokët tanë ende i bëjnë hesapet kaluar, pastaj kur vjen puna në gllup, si themi ne andej, ata fillojnë të flasin përçart. Mbaroi çështja e bashkimit me «Ballin», s'jemi më në atë periudhë, tani «Balli» duhet të demaskohet si një organizatë reaksionare që bën lodrën e okupatorit; njëkohësisht të demaskohen sistematikisht të gjithë krerët e tij, sidomos ata të krahinës suaj. Demaskimi të bëhet i vazhdueshëm; sikundër e shihni ne vemi drejt likuidimit të «Ballit» dhe jo drejt bashkimit me të. Ne bashkohemi vetëm me ata elementë që njohin gabimet e tyre, që pranojnë vijën tonë dhe hyjnë në radhët tona, dhe aspak me organizatën e «Ballit». Për këtë arsye në çdo moment dhe kudo «Ballin» duhet ta demaskojmë dhe të mos e lëmë në asnjë mënyrë që ai të zërë tokë. Nëse ai gjen rast të vendoset në ndonjë fshat a qytet, duhet të veproni përnjëherësh edhe politikisht edhe ushtarakisht kundër tij; në rast se ushtarakisht s'jeni në gjendje, duhet ta goditni politikisht, por s'duhet të harroni asnjë moment për të pregatitur grushtin që duhet t'i jepni ushtarakisht. S'ka rrugë tjetër.

Letrat tona dhe artikujt e «Zërit të Popullit» e të «Bashkimit» të mos jenë për shokët artikuj sa për të shkuar kohën, por artikuj direktivë, të cilët duhet të punohen. Këta artikuj duhet të shpërndahen me shumicë, duke i riprodhuar veç e veç e duke shënuar poshtë: «Marrë nga «Zëri» ose «Bashkimi»». Përveç kësaj, duhet t'ja shpjegojmë mirë popullit pse ne po e godasim kësisoj «Ballin», sepse shumë miq tanë, nuk e kuptojnë mirë fjalën bashkim: ne s'duam bashkim për bashkim, por bashkim të sinqertë dhe në luftë të ashpër e të paprerë kundër okupatorit.

*Çështja e një trakti që ka hedhur «Partia Nacional-Zogiste»* dhe që po e mbyll këtu brenda. Ç'qëndrim duhet të mbajmë ne në këtë rast dhe në ç'mënyrë duhet të përfitojmë? Ne mendojmë

se ky trakt është hedhur në një moment të keq për reaksionin dhe në një moment të favorshëm për ne. Ky trakt vjen kur reaksioni po i grumbullon të gjitha forcat e tija në «Ballin Kombëtar» për të na luftuar më mirë ne dhe lëvizjen nacional-çlirimtare. Me daljen e këtij trakti shumë vetëve u shkojnë të ngjethura në trup dhe fillojnë të mendojnë seriozisht për rrezikun e Zogut, që lufta kundër nesh i kishte bërë ta harronin për një moment. Këta njerëz, qofshin në «Ballin» qofshin jashtë «Ballit» por që tërë kohën s'kanë bërë tjetër, veçse na kanë hedhur gurë, e realizojnë vetë se kush mund të jenë ata që do të qëndrojnë ballë një rreziku eventual të Zogut; ata e dinë që s'do të jetë «Balli» ajo organizatë, përkundrazi «Balli» mund të hidhet edhe në prehrin e Zogut. Këta elementë, pra, që vënë gishtin në kokë dhe lëvizin në «Ballin», këta do të kërkojnë të afrohen me ne dhe të luftojnë «Ballin» e Zogun. Kështu, në radhët e reaksionit që grumbullohet në «Ballin», ky trakt do të jetë një nga shkaqet e përçarjes. Këto momente nuk duhet të na shkojnë pa përfituar prej tyre. Pra, këshilloheni të vazhdoni demaskimin e «Ballit» dhe njëkohësisht t'i bini kokës partisë zogiste. Në demaskimin e kësaj partie duhet të kemi kujdes që të mos biem në gabime e në kurthin që mund të ketë ngrehur okupatori; dua të them që ky demaskim të mos bjerë si bombë, në mënyrë që gjithë lufta jonë dhe kujdesi i popullit të drejtohet vetëm kundër rrezikut zogist dhe të harrohet objektivi kryesor që është lufta kundër okupatorit. Këtë trakt duhet ta demaskojmë si një trakt të një partie jopërparimtare, të një partie që objektivisht bën lodrën e okupatorit, sepse kjo parti gjoja nacionale, në vend që ta drejtojë gjithë aktivitetin e saj në luftë kundër okupatorit, sjell «sur le tapis»<sup>1</sup> çështjen e regjimit të Zogut dhe kërkon t'i imponojë popullit një regjim nga lart e kundër vullnetit të tij. Kjo parti doli dhe vepron jashtë Frontit Nacional-Çlirimtar, por çdo parti e tillë dhe çdo grumbullim forcash jashtë Frontit dhe Ushtrisë Nacional-Çlirimtare duhet të luftohet si parti që bën lodrën e armikut dhe si forcë bashbozuke, që përpiqet të sjellë ditë të zeza për popullin dhe të vendosë në vendin tonë regjime të klikave dhe të personave. Sa për Zogun, me anë të propagandës me gojë t'ja përsërisim popullit se kush është Zogu, se ç'ka bërë Zogu dhe se ai mund të bisedojë dita me ditë me Çërcillin. Fatin e popullit tonë do ta vendosë vetë populli dhe regjimin do ta zgjedhë ai vetë. Të demaskohen njerëzit që kanë firmuar traktin, si njerëz që deri dje kanë qenë të lidhur me okupatorin e që tani, kur po afrohet ora e drejtësisë, kërkojnë të gjejnë një strehë, ku të fshehin poshtërsitë e tyre, dhe këtë strehë ata nuk mund ta gjejnë veçse tek një parti e falimentuar si ajo zogiste. Sa për Bazin ju mund të

1 «Sur le tapis» (frëngj.) — në shesh.

thoni vetëm se ai me këtë trakt tregoi me të vërtetë qëllimet e tija, të cilat janë jashtë direktivave të Frontit Nacional-Çlirimtar. Deri tani ai s'ka hedhur asnjë pushkë kundër okupatorit, por nuk mund të themi se ka ndihmuar edhe fashizmin. Mirëpo ky trakt, në të cilin figuron edhe emri i tij, bën objektivisht lojën e okupatorit, se lë mënjanë luftën kundër këtij të fundit dhe hedh në shesh çështjen e regjimit dhe kërkon që këtë regjim t'ja imponojë popullit nga lart, kurse tani është momenti që të luftojmë okupatorin që është brenda; sa për regjimin, atë do ta zgjedhë vetë populli dhe askush tjetër. Ju, pra, duhet ta kuptoni mirë se si duhet të veproni për këtë gjë, sepse kjo është një çështje shumë delikate, nga e cila mund të përfitojmë; të veproni në një mënyrë që populli ta shohë haptazi se shpëtimi i tij, si nga okupatori ashtu edhe nga çdo armik i brendshëm, që kërkon të sjellë përsëri ditët e zeza, është vetëm Lufta nacional-çlirimtare, se për të përmbushur dëshirat e tija ai duhet të luftojë pa mëshirë okupatorin, tradhëtarët dhe çdo parti që përpiket të sabotojë luftën tonë, duhet të grumbullohet rreth këshillave, të forcojë ushtrinë e tij, Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Pra, demaskimi i kësaj partie të vijë progresivisht dhe të mos mërzhitemi që s'i vemi përnjëherësh deri në fund; së shpejti do të kemi rast që t'ja heqim fare petën byrekut. Ndodh një gjë, si e marrim vesh nga populli, dhe jo zyrtarisht, që Bazi nuk ka dijeni për këtë trakt (gjë që s'e besojmë) dhe që ky do ta përgënjeshtrojë, duke treguar se është besnik i lëvizjes nacional-çlirimtare. Sidoqoftë ne s'na pengon gjë që të godasim një trakt që është hedhur në popull. Nga ana tjetër, së shpejti do të mësojmë qëndrimin e Bazit, sepse Këshilli i Përgjithshëm do t'i kërkojë hesap dhe qëndrim të qartë.

Në bazë të traktit zogist dhe të udhëzimeve që japim më lart, ju mund të shkruani diçka në komunikatën që nxirrni në qytet.

*Çështja e Partisë* duhet të jetë për ju preokupacioni i parë, në mënyrë që ta bëni atë motorin e shëndoshë dhe të sigurt në çdo fushë veprimi, sidomos në këto momente kaq vendimtare. Partia jonë duhet të jetë në lartësinë e rastit. Kësaj gjëje mund t'ja arrini vetëm me një punë të rregullt dhe kur shokët të japin maksimumin e rendimentit dhe të mos i zërë gjumi, derisa puna të kryhet ashtu si duhet ta kryejnë komunistët dhe jo përciptazi. Duhet të forconi radhët e Partisë me elementë të rinj e të vendosur dhe t'i ruani këto radhë nga plehrat e sëmura, duhet t'i ngrini, si politikisht ashtu edhe organizativisht, dhe t'i bëni këta udhëheqës dhe administratorë. Të mbani çdo ditë konferenca, mitingje në popull, në rini dhe në gratë antifashiste. Të shumëzoni agjitacionin dhe propagandën me shkrim dhe kjo të bëhet një ushqim i përditshëm për popullin.

*Për çështjen e misioneve angleze*<sup>1</sup>, në qoftë se keni, qëndrimi kundrejt tyre duhet të jetë i qartë. Ato janë këtu përfaqësuese të ushtrisë angleze dhe si të tilla të përkrahin ata që luftojnë kundër okupatorit; në asnjë mënyrë ato s'kanë të drejtë të përzihen në punët tona të brendshme dhe ushtarake. T'u thuhet haptazi qëndrimi ynë karshi «Ballit» dhe çdo partie tjetër, dhe për çdo gjë që ato do të bëjnë në favor të tyre dhe në disfavor të luftës që bën populli shqiptar, do të jenë përgjegjës para qeverisë së tyre dhe para nesh. Në asnjë mënyrë të mos merren si arbitra për të zgjidhur çështjet tona dhe të «Ballit», këto ne i rregullojmë vetë; ato mund të veprojnë si t'u dojë qejfi, ne kemi për detyrë t'u bëjmë vërejtjet, sepse jemi në vendin tonë dhe jemi ne që bëjmë ligjin këtu; pastaj ne jemi të lirë të veprojmë ashtu si na e lyp interesi i vendit tonë, i popullit tonë dhe i luftës sonë, që është e lidhur ngushtë me luftën që bëjnë popujt e demokracive të mëdha dhe jo me ato që kërkon të bëjë misioni anglez në qarkun tuaj.

Ne i njohim kush janë amerikano-inglizët dhe nuk harrojmë për asnjë çast se ata janë kapitalistë, se ata janë kundër komunistit, kundër socializmit; as ata nuk harrojnë kush jemi ne, por as ne nuk harrojmë kush janë ata. Tani jemi në aleancë me ta kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman dhe ne i qëndrojmë besnikë kësaj aleance. Por ne nuk kemi lejuar dhe nuk do të lejojmë kurrë që ata të ndërhyjnë në punët e brendshme të Shqipërisë. E kaluara e hidhur e popullit tonë nuk do të përsëritet më. Këtë nuk do ta lejojnë PKSH dhe populli shqiptar.

Shumë të fala  
Për Komitetin Qendror të Partisë  
Komuniste të Shqipërisë

*Shpati*

*Botohet sipas kopjes së  
daktilografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

1 Që nga maji i vitit 1943 kishin ardhur në Shqipëri, pa u ftuar përfaqësues të Komandës anglo-amerikane të Mesdheut. Misionet anglo-amerikane morën përsipër me fjalë të ndihmonin Ushtrinë Nacional-Çlirimtare me armë dhe materiale të tjera luftarake të nevojshme. Në të vërtetë ata zhvilluan një veprimtari minuese dhe u bënë pengesë për zhvillimin e luftës kundër pushtuesve nazistë e veglave të tyre në Shqipëri.



**LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË  
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR GJIROKASTRËN  
NË LIDHJE ME QËNDRIMIN KUNDREJT  
«BALLIT KOMBËTAR», «LEGALITETIT» DHE MISIONEVE  
USHTARAKE ANGLEZE**

1 tetor 1943

**KOMITETIT QARKOR TË GJIROKASTRËS**

Të dashur shokë,

Muarëm letrën tuaj më datë 27.9.1943. Ju kemi çuar dy letra, ku ju jepnim udhëzime se si duhej të vepronit në rast se qyteti ishte i çliruar. Nga letra juaj kuptojmë një gjë, që «Balli Kombëtar», me forcat mercenare të tija, po bën ligjin në atë qytet, ai është i instaluar si pushtet dhe me njerëzit e tij, që arrijnë në 500-600 vetë, ai ka mbërritur të fusë terrorin në popull dhe të grabisë. Nuk kuptojmë një gjë në këtë mes. Si bëhet që forcat tona, që shkruani se arrijnë në 2000 vetë, janë të hyjnë njerëzit e «Ballit» në qytetin e Gjirokastrës, gjithashtu edhe të Delvinës, ndoshta edhe gjetkë? Na duket se e keni nënvleftësuar shumë forcën e «Ballit», i cili, ashtu si është, e bën punën e tij dhe s'na pyet aspak, kurse ne mbetemi vetëm në konstatime të përgjithshme, duke këqyrur që «Balli» po vjedh, që «Balli» po drejtohet prej reaksionarëve, që «Balli» po diskreditohet në popull, dhe me gjithë këto ai qëndron i shtruar në Gjirokastrë, kurse ju kënaqeni të bëni vetëm punë politike dhe t'i shihni me duar kryq këta maskarenj të veprojnë dhe të dalin e të mbajnë konferenca nëpër qytet. Diskreditimi i «Ballit» dhe urrejtja e popullit për të, na duket se duhet të na shërbejë për diçka, jo për të bërë polemikë me fjalë me Ali Këlcyrën me shokë: *por t'i spastrojmë ato plehra, me forcë e me armë të marrim pushtetin në dorë, të qërojmë vendin nga bashibozukët dhe të stabilizojmë rregullin e qetësinë. Të ngrehim përnjëherësh pushtetin e këshillave, dhe këtë ta mbrojmë me çdo kusht. Nuk duhet të kufizohemi vetëm me punë politike, por kjo punë politike duhet të forcohet me veprime ushtarake*

*dhe veprime energjike, derisa të mos ketë tjetër pushtet atje, përveç tonit. Këto janë detyrat tuaja imediate, që duhet t'i kryeni patjetër.*

Me majorin anglez qëndrimi juaj duhet të jetë i qartë. Ai është këtu përfaqësuesi i ushtrisë angleze dhe si i tillë do të përkrahë ata që luftojnë kundër okupatorit. Në asnjë mënyrë ai s'ka të drejtë të përzihet në punët tona të brendshme e sidomos ushtarake. T'i themi haptazi qëndrimin tonë karshi «Ballit Kombëtar», dhe për çdo gjë që ai do të bëjë në favor të tij dhe në disfavor të luftës që bën populli shqiptar, do të jetë vetë përgjegjës përpara qeverisë së tij dhe përpara nesh. Në asnjë mënyrë të mos merret si arbitër për të zgjidhur çështjet tona dhe të «Ballit», këto i rregullojmë vetë, ai mund të veprojë si t'i dojë qejfi, por edhe ne pastaj jemi të lirë të veprojmë ashtu si na e lyp interesi i vendit tonë, i popullit tonë, gjithashtu edhe i luftës sonë, që është e lidhur ngushtë me luftën që bëjnë popujt e demokracive të mëdha dhe jo me ato që mund të kërkojë të bëjë majori anglez. «Balli Kombëtar» mund t'i bëjë njëqind e një promemorie, ne promemoret ja bëjmë popullit tonë dhe aq na bën për punët që do të bëjnë Ali Këlcyra me Bahri Omarin e shokë. Punët tona të jenë kësisoj me majorin anglez.

Bashkimi me «Ballin Kombëtar» tani është një punë e vdekur dhe s'bisedohet më për atë punë. Tani bisedohet shpartallimi i «Ballit Kombëtar» dhe ata elementë që hiqeshin ballistë e që e kuptojnë punën e fëlliqur të «Ballit» duhet të futen në radhët tona. S'ka më bashkim me «Ballin», e zhdukni këtë iluzion, dhe as kemi ndonjë fitim për t'ja arritur kësaj pune. Me një organizatë që ka në shpirt kompromisin, që s'ka hedhur asnjë pushkë kundër fashizmit dhe që vazhdon të mos hedhë asnjë kundër gjermanëve, por i ndihmon këta për të na vrarë, me një organizatë që gjithë aktivitetin e saj e ka drejtuar kundër lëvizjes sonë, kundër komunizmit dhe Partisë Komuniste, s'kemi se si bëjmë bashkim. Për t'ja arritur këtij bashkimi kemi punuar kaq kohë, kemi bërë kaq përçapje, kemi bërë veshin të shurdhër përpara sharjeve të tyre të ndyra, kemi sakrifikuar shokë, që na janë vrarë poshtërsisht prej tyre, por tani është mbushur kupa. Ne «Ballin Kombëtar» do ta luftojmë si një organizatë reaksionare që i shërben armikut, dhe vetëm me ata njerëz që mohojnë të shkuarën e tyre në «Ballin», duke e demaskuar botërisht, tok me gabimet e tyre, dhe që pranojnë të hyjnë në radhët tona e të luftojnë okupatorin, vetëm me ata mund të bashkëpunojmë. Prandaj, demaskimi i «Ballit» dhe i eksponentëve të tij të bëhet në shkallë të gjerë dhe populli ta marrë vesh një herë e mirë se kush janë ata bukurshë. Luftën që po i hapim «Ballit» duhet t'ja shpjegoni mirë popullit dhe për t'ja shpjeguar duhet që ju ta keni kuptuar mirë esencën e kësaj lufte që po i bëhet kësaj organizate, duhet të keni

kuptuar mirë letrat tona si dhe artikujt e «Zërit të Popullit» dhe të «Bashkimit». Materialin propagandistik të mos ta prisni vetëm t'jua dërgojë Tirana, por ta riprodhoni vetë, sepse ju punoni në një qytet të lirë, kurse Tirana punon nën tmerrin e Gestapos dhe të agjentëve të saj.

Këto ditët e fundit u hodh një trakt nga «Partia Nacional-Zogiste». Poshtë këtij trakti figuronin emrat e Fiqri Dines, Muharrem Bajraktarit, Bazit të Canës, Myftar Kaloshit e disa majorëve zogistë të tjerë. Ky trakt thërriste popullin të shpallte lirinë nën flamurin e Zogut, «mbretit të dashur, yllit të Shqipërisë» etj. etj. gjëra të tilla. Kjo parti, sikundër edhe «Balli» e çdo parti tjetër që del dhe punon jashtë Frontit Nacional-Çlirimtar, duhet të luftohen si parti jopërparimtare, sepse objektivistët këto parti bëjnë lodrën e okupatorit, dhe çdo grumbullim ushtarak e komandë jashtë Ushtrisë Nacional-Çlirimtare janë grupe bashibozukësh, që përpiqen të sjellin në fuqi regjimin e vjetër dhe klika e persona në fuqi. Ky trakt i hedhur prej kësaj partie zogiste erdhi tamam në momentin e duhur për ne dhe bile të favorshëm, se në atë moment «Balli Kombëtar» përpiquej të grumbullonte rreth tij gjithë reaksionin dhe ta hidhte në luftë kundër nesh. Ngjet që në «Ballin Kombëtar» ka mjaft elementë antizogistë dhe që tmerrohen nga ardhja e Zogut këtu. Këta elementë, që deri dje na luftonin, e kishin harruar Zogun ose e quanin një rrezik të largët dhe do të mundnin me «organizimin e tyre» ta luftonin, por tani atyre u shkojnë ethe në kurriz, se e dinë fare mirë sa forca ka «Balli» dhe ç'elementë ka në «Ballin» «të aftë për të luftuar një rrezik zogist». Ata e dinë, nga ana tjetër, se kush janë ata që do ta luftojnë realisht kthimin në Shqipëri të një regjimi të tillë. Kështu që këta njerëz do të kërkojnë një mbështetje, dhe këtë mbështetje do ta gjejnë vetëm te ne. Prandaj ata do të fillojnë të tërhiqen nga «Balli» dhe të afrohen me ne. Nga ana tjetër, shumë njerëz kanë qëndruar deri tani indiferentë, por kur shohin se flitet për një ardhje të Zogut në fuqi, ata frikësohen. Populli, po ai malm, në shumicën më të madhe është antizogist. Në këtë situatë ne, po të dimë të veprojmë, mund të përfitojmë shumë si në likuidimin e «Ballit», si në likuidimin e zogistëve dhe diskreditimin e kësaj tentative të tyre, ashtu edhe në forcimin e pozitave tona. Tani ju duhet njëkohësisht të vazhdoni demaskimin e «Ballit» e të të gjithë atyreve që e udhëheqin, veçanërisht në krahinën tuaj dhe, nga ana tjetër, të luftoni çdo parti tjetër që vepron jashtë lëvizjes nacional-çlirimtare. Kjo s'do të thotë se jemi kundër formimit të partive të ndryshme politike, por këto parti, që të mund të formohen, duhet që në programin e tyre të kenë në ballë të parë luftën kundër okupatorit, luftën me prova dhe jo me fjalë dhe këto parti të marrin pjesë në Frontin Nacional-Çlirimtar, duke pasur të drejtë të ruajnë individualitetin e tyre. Për çështjen e Zogut, me anën e

propagandës mund t'i themi popullit se «Zogu është ky», se «ka bërë këtë, ose atë», se «ai në vend që të luftonte, shkoi pa hedhur asnjë pushkë», se «Zogu po të ishte nga ata burra, duhej të vinte të luftonte dhe jo të bënte qejf andej», se «Çerçilli mund të fjaloset dita me ditë me Zogun, neve aq na bën», se «për fatin tonë nuk do të vendosë as Zogu as Çerçilli, por do të vendosim ne vetë, me armët që kemi në dorë, dhe këtë të drejtë na e ka siguruar lufta jonë, na e siguron lufta e popujve përparimdashës në botë dhe, në radhë të parë, Bashkimi Sovjetik». (Këtu të propagandoni në shkallë të gjerë Bashkimin Sovjetik, ofensivën e tij të shkëlqyer dhe dërgimin në Algjeri të Vishinskit, i cili do të bëjë pjesë në komisionin e zbatimit të armëpushimit me Italinë dhe do të ndihmojë në zbatimin e vetëvendosjes së çdo populli që çlirohet nga okupatori). Të demaskohen njerëzit që kanë firmuar këtë trakt, si Fiqri Dinja e të tjerë, të cilët deri dje kanë bërë lodrën e armikut, kurse tani, që po u afrohet ora e drejtësisë, kërkojnë të gjejnë një strehë, ku të fshehin poshtërsitë e tyre dhe, sigurisht, këtë strehë nuk mund ta gjejnë veçse në një parti të falimentuar si ajo e Zogut. Sa për Bazin e Canës, ju mund të thoni vetëm që ai me këtë trakt tregoi me të vërtetë qëllimet e tija, të cilat janë jashtë direktivave të Frontit Nacional-Çlirimtar. Deri tani ai s'ka hedhur asnjë pushkë kundër okupatorit, por nuk mund të themi se ka ndihmuar edhe fashizmin. Por trakti, në të cilin figuron edhe emri i tij, bën objektivistët lodrën e okupatorit, sepse hedh në shesh çështjen e regjimit dhe kërkon që këtë regjim t'ja imponojë popullit nga lart, kurse tani është momenti të luftojmë okupatorin që kemi brenda; sa për regjimin, atë do ta zgjedhë vetë populli dhe askush tjetër. Ju, pra, duhet ta kuptoni mirë se si duhet të veproni, sepse kjo është një çështje shumë delikate, nga e cila mund të përfitojmë shumë, por edhe të humbasim. Duhet të mos harroni se në këtë mes mund të ketë gisht edhe armiku, i cili kërkon të mbjellë diversione dhe luftën tonë ta drejtojë kundër njëri-tjetrit, domethënë që ne të harrojmë luftën kundër gjermanëve dhe ta drejtojmë gjithë aktivitetin tonë kundër shoqi-shoqit dhe kundër partive të ndryshme; prandaj për ne mbetet kurdoherë si objektiv kryesor lufta kundër okupatorit dhe, krahas me këtë, lufta kundër tradhëtarëve nën «soldën»<sup>1</sup> e Gestapos, lufta kundër reaksionit, që përpiqet të grumbullohet në «Ballin» dhe në parti të tjera si ajo e Zogut. Të veproni në një mënyrë që populli ta shohë haptazi se shpëtimi i tij, si nga okupatori ashtu edhe nga çdo armik i brendshëm që kërkon të sjellë përsëri ditët e zeza, është vetëm Lufta nacional-çlirimtare, këshillat nacional-çlirimtare dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare, se për të përmbushur dëshirat e tija ai duhet të luftojë pa mëshirë okupatorin, tradhëtarët dhe çdo parti

1 Nën «soldën» — në shërbim.

që përpiqet ta sabotojë luftën tonë, duhet të grumbullohet rreth këshillave, të forcojë ushtrinë e tij, Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Demaskimi i partisë zogiste të bëhet progresivisht, pa u shpejtuar, në mënyrë që të mos bjerë si bombë dhe populli të mos mendojë vetëm për rrezikun zogist. Kini durim, se çështja e Zogut do të na preokupojë edhe pak, dhe do të kemi rast që t'ja heqim fare petën byrekut, bile fare shpejt. Pse ndodh një gjë, si e marrim vesh jozyrtarisht, që ky trakt është hedhur pa lejen e Bazit të Canës (gjë që s'e besojmë) dhe që ky do ta përgënjeshtrojë, duke treguar se është besnik i lëvizjes nacional-çlirimtare. Sidoqoftë ne s'na pengon asgjë që të godasim një gjë që hidhet në popull dhe që e këndon populli. Nga ana tjetër do të shohim shpejt qëndrimin e Bazit pse, sigurisht, Këshilli i Përgjithshëm Nac.-Çl. do t'i kërkojë hesap. Bashkangjitur po ju vëmë edhe një kopje të këtij trakti, dhe në bazë të këtij, në bazë të udhëzimeve që ju japim më lart, duke mos harruar asnjë minutë objektivin kryesor, demaskojeni edhe në rrethin e Gjirokastrës, kështu populli të shohë se ne jemi me të vërtetë mbrojtësit e të drejtave të tija. Sigurisht, «Balli» s'do të mbajë qëndrim dhe kjo do të jetë një fitim për ne. Për këtë trakt këndon edhe «Zërin e Popullit» të ardhshëm dhe i lexoni artikujt jo veresie, por si artikuj ku jepen direktivat e punës. Ndër artikujt e «Zërit» dhe të «Bashkimit» ju do të shihni direktivat e Partisë sonë dhe ato të Këshillit Nacional-Çlirimtar.

Ju rekomandojmë, në radhë të parë, të kini kujdesin më të madh për Ali Bej Këlcyrën, ai element aq i poshtër nuk duhet të ekzistojë më.

Duhet tani, që jeni në një qytet të lirë, të forconi radhët e Partisë dhe këto t'i ngrini politikisht, të mbani çdo ditë konferenca e mitingje të gjëra të popullit, të rinisë dhe të gruas antifashiste, të organizohen klube, ku të mblidhet populli dhe t'i jepet çdo këshillë që i shërben luftës sonë.

Të na mbani në korrent për çdo gjë që ngjet andej dhe për çdo ndihmë që mund t'ju japim. Për çdo gjë që s'mund ta zgjidhni dot, na lajmëroni me urgjencë. Këndej do t'ju mbajmë në korrent për çdo gjë që ngjet e që duhet dhe ju andej të mbani një qëndrim politik.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të Partisë

*S h p a t i*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**DIREKTIVA E KQ TË PKSH PËR FORCIMIN E LIDHJEVE  
ME BASHKIMIN SOVJETIK, PËR QËNDRIMIN KUNDREJT  
«BALLIT KOMBËTAR», «LEGALITETIT» DHE MISIONEVE  
USHTARAKE ANGLEZE, PËR FORCIMIN E FRONTIT, TË  
KËSHILLAVE DHE TË USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE,  
PËR FORCIMIN E PARTISË DHE TË ORGANIZATAVE  
TË TJERA ANTIFASHISTE**

3 nëntor 1943

KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË  
KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

Të dashur shokë,

Ju e dini se prej kohësh situata është kthyer në favor të koalicionit antifashist. Faktori kryesor për këtë ndryshim ka qenë Ushtria e Kuqe heroike. Që prej Stalingradit e deri më sot ajo s'i ka dhënë asnjë minutë pushim ushtrisë gjermane, që po kalon nga tërheqja në tërheqje, nga disfata në disfatë, duke shkuar drejt katastrofës. Ofensiva e madhe sovjetike mbi Dniepër është në zhvillim të plotë. Sukseset e para dhe të mëdha taktike janë duke u shfrytëzuar në mënyrën më të mirë nga strategjia gjeniale e Stalinit dhe nga trimëria e Ushtrisë Sovjetike. Gjermania ecën drejt një disfate decizive. Rezervat e saja nuk janë më të mjaftueshme për të përballuar frontet kaq të gjëra dhe situata kaq kritike. Disfatat e pareshtura ushtarake e kanë ulur pa masë moralin e ushtrisë gjermane dhe të popullit gjerman, i cili po fillon të ngrëjë krye kundër nazistëve. Ushtria gjermane e mundur, e lodhur, e gjakosur, po hyn në dimrin e tretë në tokat sovjetike. Ajo do të ketë përballë ushtritë e freskëta dhe të stërvitura mirë të Sovjetëve, që do ta godasin dita-ditës më shumë dhe më rëndë, derisa ta shpartallojnë.

Në një situatë të tillë hapja e një fronti tjetër të madh në Evropë nga ana e aleatëve do të shpejtonte katastrofën për Gjermaninë. Ju e dini se kontributi anglo-amerikan në këtë luftë ka qenë dhe është shumë më i vogël se ai i Bashkimit Sovjetik. Kjo pikë, patjetër, do të ketë qenë një nga çështjet e bisedimeve në



Konferencën e Moskës<sup>1</sup>, domethënë se si të shpejtohet mbarimi i luftës, që konkretisht do të thotë se si aleatët anglo-amerikanë të marrin pjesë në një shkallë shumë më të gjerë në luftë.

Hitleri sheh se ushtarakisht e ka të humbur luftën. Vetëm një kompromis mund ta shpëtojë atë, prandaj ai manevron me të gjitha forcat e tija për të mobilizuar reaksionin ndërkombëtar. Këtë taktikë ai e ka ndjekur qëkur ka ardhur në fuqi dhe veçanërisht kur shpresonte të shkatërronte Ushtrinë e Kuqe. Por nuk duhet të harrojmë se këtë taktikë ai dje e përdorte për të sulmuar, kurse sot e përdor për t'u mbrojtur, për të shpëtuar kokën. Ai mundohet të ngjallë reaksionin në Angli dhe në Amerikë dhe të lidhet ngushtë me të, të influencojë kështu në politikën anglo-amerikane dhe të arrijë një kompromis, ku të sigurojë një pjesë të grabitjeve të tija. Por për t'i lënë kohë kësaj manevre që të zhvillohet dhe për ta bindur reaksionin anglo-amerikan se ai do të jetë një aleat i tij i vlefshëm, Hitlerit i duhet të mos jetë në kondita inferioriteti të madh. Edhe kjo është një arsye për të cilën ai ngul këmbë me tërbim për të qëndruar në Dniepër.

Që tani shihet se kjo manevër e Hitlerit ka dështuar. Ka dështuar, sepse popujt anglez e amerikan po hyjnë dita-ditës në luftë të hapët kundër reaksionit të brendshëm dhe metodave të tija dhe janë një fuqi e madhe që e tremb reaksionin dhe e bën të hezitojë. Ka dështuar, sepse politika anglo-amerikane nuk mund të futet në një aventurë kaq të rrezikshme. Por ka dështuar sidomos sepse ofensivat sovjetike, veçanërisht ajo mbi Dniepër, po i thyejnë brinjët Hitlerit, i kanë çelënikosur popujt liridashës dhe po i mobilizojnë dita-ditës kundër Gjermanisë dhe fashizmit.

Reaksioni, pra, nuk mund të shpëtojë duke pasur si flamur Hitlerin. Prandaj ai po përgatitet për një manevër të gjerë, e cila dhe ka filluar të duket: puna është të përgatitet terreni për t'i dalë përpara Ushtrisë së Kuqe dhe lëvizjeve nacional-çlirimtare pas disfatave të tjera që do të ketë ushtria gjermane. Këto gjëra vihen re sidomos në vendet e pushtuara, vihen re në Jugosllavi me Drazha Mihajloviçin<sup>2</sup>, në Shqipëri me «Ballin Kombëtar» e me

1 Konferenca e Moskës e tre ministrave të punëve të jashtme të BRSS, të Britanisë së Madhe dhe të SHBA-së u mbajt më 19-30 tetor 1943. Në këtë konferencë u pranua si detyrë kryesore: shkurtimi i afatit të Luftës së dytë botërore, hapja sa më parë e frontit të dytë, forcimi i bashkëpunimit midis aleatëve në luftë dhe vazhdimi i këtij bashkëpunimi pas luftës.

2 Mihajloviç, gjeneral reaksionar jugosllav, udhëheqës i forcave reaksionare serbe në luftë kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Jugosllave gjatë Luftës së dytë botërore. Agjent dhe shërbëtor i imperializmit anglez, u emërua ministër i luftës më 1942 në qeverinë kukull jugosllave në Londër. Bashkëpunoi fshehurazi dhe në shumë raste haptazi me pushtuesit fashistë gjermanë, kundër lëvizjes nacional-çlirimtare të popullit jugosllav.

të tjerë; këto gjëra vihen re në qëndrimin e aleatëve të Gjermanisë: Rumani, Hungari, Finlandë.

Cili do të jetë qëndrimi i Anglisë dhe i Amerikës karshi kësaj manevre të reaksionit? E para e punës duhet shënuar se Anglia dhe Amerika nuk është e mundur ta shtypin reaksionin në Evropë, por vetëm duan ta shpëtojnë nga Hitleri. Ato njohin akoma Drazha Mihajloviçin dhe bile e ndihmojnë. Ne shohim, me çështjen e Sikorskit<sup>1</sup> dhe me sjelljet e vetë misionit anglez këtu ndër ne, se ata mundohen të ngjallin e të forcojnë lëvizjen reaksionare kundër lëvizjeve nacional-çlirimtare. Në Konferencën e Moskës sigurisht kjo ka qenë një nga pikat e bisedimeve.

Lëvizjet nacional-çlirimtare në Evropë janë duke fituar dita-ditës terren; masa të gjëra populli po zgjohen dhe po mobilizohen rreth tyre.

Në Itali reaksioni me Badolion<sup>2</sup> e Viktorin dhe tërthorazi me përkrahjen e ushtrive aleate mundohet të vendosë me metoda të tjera sundimin e tij. Ai mundohet veçanërisht të godasë Partinë Komuniste Italiane dhe ta largojë nga skena politike, sepse ajo është partia më e lidhur me masat, sepse ajo është partia që i shtyp kokën reaksionit dhe që udhëheq popullin për të vendosur pushtetin e tij. Përpjekjet e popullit italian dhe veçanërisht ato të Partisë Komuniste Italiane rrezikojnë dita-ditës më tepër reaksionin dhe e shtërngojnë Badolion të ndërrojë gjithmonë metoda.

Okupatori gjerman ka filluar një fushatë të gjerë në të katër anët e Evropës për të mobilizuar reaksionin dhe për të rrejtur popujt me parulla nacionaliste demagogjike që të çojnë vetëm në luftë kundër lëvizjeve nacional-çlirimtare. Kudo Hitleri po përgatit dhe po organizon në Evropë luftën kundër partive komuniste, kundër ngritjes së pushtetit popullor. Rreth këtij flamuri mbledhet reaksioni. Këtu armiku ka armën kryesore. Këtë duhet ta godasim.

Më tepër se kudo në Ballkan armiqtë e lëvizjeve nacional-çlirimtare, me Hitlerin në krye, mundohen të shfrytëzojnë antagonizmat kombëtare për të forcuar frontin antikomunist të reaksionit, që Hitleri e ka emëruar «Federacioni Ballkanik» dhe në vend që të luftojë kundër zbarkimit eventual të aleatëve, po lufton dhe do të luftojë lëvizjet nacional-çlirimtare të Ballkanit.

Me ndihmën e reaksionarëve shqiptarë Hitleri mundohet të mobilizojë popullatën shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë

1 V. Sikorski, udhëheqës reaksionar polonez. Kryesoi qeverinë e mërguar poloneze në Londër (1939-1943). U shërbente qarqeve imperialiste anglo-amerikane.

2 Badolio, udhëheqës ushtarak dhe politik italian. Kryeministër i qeverisë italiane pas rënjes së qeverisë së Musolinit (korrik 1943 — qershor 1944).

kundër popullatave serbo-malazeze-maqedone dhe ta përdorë çështjen e Kosovës për të hedhur mjegull dhe diversion në radhët e popullit shqiptar si dhe për të shtytur pseudopatriotët të luftojnë lëvizjen nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Me ndihmën e shovinistëve të brendshëm ai mundohet të lidhë opinionin publik të këtushëm me politikën antiserbe dhe antigreke, që të çon në përleshje me armë kundër fqinjëve tanë, që shkakton diversione në lëvizjen tonë nacional-çlirimtare dhe që shërben si bazë për organizimin dhe forcimin e partive nacional-shoviniste, antinacional-çlirimtare dhe antikomuniste.

Afrimi i përfundimit të luftës kundër Gjermanisë dhe këlyshëve të saj, nga njëra anë, dhe forcimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare dhe i lëvizjes sonë përgjithësisht, nga ana tjetër, e kanë zgjuar popullin dhe e kanë afruar më tepër me luftën tonë. Në çdo anë të Shqipërisë simpatia për ne po shtohet dita-ditës dhe bashkë me të edhe influenca jonë. Por kjo gjë ka shtënë në aktivitet të madh edhe reaksionin, i cili po mobilizohet dhe po mundohet të mobilizojë masat rreth tij për ta kthyer situatën në favor të vet.

Ju e dini se ç'është dhe ç'bën «Balli Kombëtar», dini gjithashtu qëndrimin që duhet të kemi ne karshi tij. Me qarkoren e datës 10 shtator 1943 të Komitetit Qendror kjo shpjegohet mirë. Mund të riktheheni në të. Tani një gjë duket haptazi dhe kjo është se «Balli Kombëtar» bashkëpunon në të gjitha mënyrat dhe me këdo kundër lëvizjes nacional-çlirimtare, bashkëpunon veçanërisht me okupatorin gjerman. Në Fier e në Lushnjë «Balli» ka marrë komandën e qytetit nën hijen e bajonetave gjermane dhe kapërcen dita-ditës më tepër në poshtërsi dhe në luftë të pabesë kundër nesh. Kudo në vendet e tjera ai bashkohet me gjermanët për të na luftuar me pushkë, me spiunllëk dhe me propagandë. Përveç rolit të Isa Toskës ai mundohet edhe të ruajë një farë independencë si dhe dukjen e një farë ilegaliteti karshi okupatorit gjerman, që të mos konsiderohet nga populli si vegël e Gestapos, kështu që të ketë nesër kredinë e duhur për të trashëguar sundimin e Hitlerit në Shqipëri dhe për të manevruar më lehtë. «Balli» preokupohet për të mobilizuar fuqi sa më të mëdha që të jetë e mundur, të çfarëdo tipi qofshin, për të luftuar sot dhe sidomos nesër, Partinë Komuniste, lëvizjen nacional-çlirimtare dhe për të shtypur popullin shqiptar.

Por reaksioni e sheh se «Balli» vetëm nuk mund të luftojë me sukses lëvizjen tonë dhe mundohet të organizojë dhe të mobilizojë forca nën flamuj të ndryshëm. Ai nxjerr në skenë figura të reja, që kanë një farë konsiderate në opinionin publik, si Mehdi Frashëri, nxjerr në skenë njerëz që gjatë regjimeve të kaluara me sundimin e tyre, ushtronin influencë në disa krahina, si Zogu.

Qëllimi i armiqvet tanë është që të mobilizojnë sa më tepër

forca rreth reaksionit, ta organizojnë këtë sa më mirë, në një ose në shumë grupe, në qeveri të Gestapos ose jashtë qeverisë, por kundër nesh, dhe vetëm kundër nesh. Ka tendencë që grupet reaksionare të centralizohen. Mehdi Frashëri tani (mundet ndonjë tjetër më vonë) ka dalë si një nga figurat politike rreth të cilit do të fillojë të bëhet ky grumbullim. Mustafa Kruja, Kolë Biba, Gjon Marka Gjoni, Shefqet Vërlaci e të tjerë reaksionarë, forcat e të cilëve nuk janë më të vogla se të të tjerëve dhe të cilët ishin në shërbim direkt të fashizmit italian, janë edhe ata në manevrën e madhe dhe të kombinuar antinacional-çlirimtare.

Këto kohët e fundit shihet një aktivitet i madh i zogistëve me Fiqri Dinen<sup>1</sup> dhe bajraktarë të Veriut në krye. Ata mundohen të organizohen rreth figurës së Zogut, të krijojnë një parti të fortë dhe të përgatitin terrenin (sidomos forcat) për kthimin e tij dhe të regjimit të mëparshëm. Kartën e Zogut po e përkëdhelin edhe gjermanët me emërimin e një «Këshilli të Regjencës», me kthimin e statutit të Zogut, me kthimin e pasurive të konfiskuara. Kartën e Zogut po e luan reaksioni, duke u rezervuar që ta skartojë ose ta luajë më haptas nesër. Ka filluar të përdoret figura e Zogut si gogol për të larguar masat nga lufta, si figurë e vetme që mund të shpëtojë reaksionin nga lëvizja jonë, ose, si thonë ata, «të shpëtojë Shqipërinë nga anarkia». Fjalët e shumë ballistëve dhe të shumë reaksionarëve të tjerë, që thonë se komunistët do të na detyrojnë të bashkohemi me Zogun, gazeta «Atdheu»<sup>2</sup> si edhe shumë reklama që i bëhen Zogut lart e poshtë, janë procesi i një manevre që ka për qëllim të mobilizojë reaksionin rreth Zogut.

«Balli Kombëtar» dhe gjithë reaksioni flasin për anarki, për kaos, për ngatërresa që po ngjasin në vendin tonë, ku, thonë ata, s'po merr vesh i pari të dytin. Duan të akuzojnë lëvizjen nacional-çlirimtare dhe Partinë tonë si shkaktare të kësaj anarkie, duan ta paraqitin Partinë tonë si një parti që është kundër rregullit dhe që nuk mund të sjellë veçse kaos dhe anarki.

Okupatori gjerman mundohet t'i japë Shqipërisë ngjyrën e një vendi independent; për këtë gjë duhet të ketë një aparat të shtetit në duar të shqiptarëve dhe një forcë ushtarake shqiptare, të cilat të bëjnë, si shërbëtorë të bindur, punën e Hitlerit, d.m.th. të luftojnë energjikisht lëvizjen nacional-çlirimtare. Reaksioni kurrë si sot nuk ka pasur kaq frikë nga lëvizja jonë dhe nuk ka qenë kaq i bashkuar të na luftojë me gjithë forcat e tija. Kështu që ai merr me gëzim dorën që i shtrin Hitleri, duke u përpjekur që lidhja me okupatorin të mos duket haptazi, në mënyrë që me shkatërrimin e fashizmit të mos shkatërrohet edhe ai vetë. Reak-

1 Eksponent zogist dhe kryeministër kuisling (korrik—gusht 1944).

2 Organ kryesor i organizatës tradhëtare të «Legalitetit» (tetor 1943—gusht 1944).

sioni përpiqet të luftojë lëvizjen tonë gjatë okupacionit gjerman, të forcohet gjatë këtij okupacioni dhe ta vendosë më lehtë sundimin e tij më vonë, sepse edhe ai vetë është i bindur se Gjermania e ka luftën të humbur.

Manevra tjetër që përdorin armiku dhe reaksioni e që ju vetë e keni konstatuar në terren, është çështja e bashkimit, i cili kërkohet që prej Mustafa Krujës e deri te «Balli Kombëtar». Me këtë manevër ata duan dhe përpiqen të gënjejnë popullin dhe lëvizjen nacional-çlirimtare e sidomos duan që Partinë tonë Komuniste ta paraqesin si shkaktaren e mosbashkimit. Ky bashkim kërkohet me çdo kusht dhe me të gjithë: me Zogun, me «Ballin», me Mustafa Krujën, me «Komitetin Ekzekutiv»<sup>1</sup>, me «Këshillin e Regjencës» bile edhe me nazizmin gjerman. Këtë bashkim kërkon reaksioni. E kuptoni vetë se kjo fushatë e madhe «vëllazërimi» ka për qëllim ta largojë popullin nga Lufta nacional-çlirimtare, ta dezorientojë, t'i paraqesë tradhëtarët si patriotë përpara popullit, ta likuidojë lëvizjen tonë dhe ta vërë popullin nën udhëheqjen e reaksionit. Flasin e bëjnë fushatë për bashkimin e nacionalizmit shqiptar, ndërsa Partinë Komuniste dhe komunizmin i paraqesin si një parti të huaj dhe ideologji të huaj e në luftë të pamëshirshme kundër nacionalizmit shqiptar. Qëllimi i tyre është të shkëputin ata që s'janë komunistë nga lëvizja nacional-çlirimtare, të izolojnë Partinë tonë dhe ta qëllojnë më lehtë, duke e quajtur shkaktarë të përçarjes, të terrorit dhe të vëllavrasjes. Mbi të gjitha ata përpiqen ta paraqesin Partinë tonë si një parti që punon kundër interesave kombëtare.

Përpara kësaj situatë të jashtme dhe të brendshme, cili duhet të jetë qëndrimi i gjithë anëtarëve të Partisë dhe në ç'mënyrë ata duhet të veprojnë?

Duhet t'i kemi sytë drejt Moskës dhe çdo gjë ta shohim nën prizmin e luftës që bën Bashkimi Sovjetik, sidomos tani që u zhvillua Konferenca tripalëshe<sup>2</sup>. Vendimet e marrura në këtë konferencë dhe politikën sovjetike ne duhet t'i tretim dhe t'u kon-

1 Komiteti Ekzekutiv u krijua nga pushtuesit hitlerianë më 14 shtator 1943, si «qeveri e përkohshme» e Shqipërisë që përbëhej nga reaksionarë të njohur, bashkëpunëtorë të ngushtë të pushtuesve fashistë italianë e gjermanë, me Ibrahim Bej Biçakun në krye.

Me 18 tetor pushtuesit gjermanë mbledhën një «asamble kombëtare» të Shqipërisë me anën e së cilës krijuan regjencën me Mehdi Bej Frashërin në krye dhe qeverinë kuislinge (në vend të Komitetit Ekzekutiv) me Rexhep Mitrovicën si kryeministër.

Pikërisht ditën e hapjes më 18 tetor Ushtria Nacional-Çlirimtare goditi me top asamblenë tradhëtare si përgjigje të popullit shqiptar.

2 Konferenca e Moskës e tre ministrave të punëve të jashtme të BRSS, të Britanisë së Madhe dhe të SHBA-së.

formohemi pikë për pikë, se vetëm në këtë mënyrë nuk do të gabohemi gjatë luftës sonë. Duhet të popullarizojmë në shkallë të gjerë sovjetët dhe luftën gjiganteske që po bën Bashkimi Sovjetik dhe të ngjallim në popullin tonë dashuri dhe respekt për URSS-in, për Ushtrinë e Kuqe dhe për Stalinin; duhet që populli ynë ta ketë kuptuar mirë se Bashkimi Sovjetik është ai që do të mbrojë kundër çdo dallge reaksioni interesat dhe lirinë e popujve të vegjël. Me një punë të tillë të mbërrimë që Bashkimi Sovjetik të shihet me bindje prej popullit tonë si aleati më i sinqertë. Nuk duhet të trembemi se mos shkojmë majtas, duke popullarizuar URSS-in, por përsëri duhet të kemi kujdes të mos biem në provokacion dhe të arrijmë në rezultate të kundërta me qëllimet tona.

Duhet të popullarizojmë luftën nacional-çlirimtare të të gjithë Evropës dhe veçanërisht të jugosllavëve dhe të grekëve. Duhet ta shtrojmë haptazi, pa ndrojtje, problemin e vëllazërimit tonë me popujt jugosllavë dhe grek. Të demaskojmë pa mëshirë reaksionin dhe shovinizmin, që mundohet të na vërë në luftë me fqinjët, ta bindim popullin se interesi i lartë i atdheut kërkon që të jemi të vëllazëruar me popujt grek e jugosllavë, t'ja heqim maskën shovinizmit, që mundohet të dalë si mbrojtës i Shqipërisë nga të huajt dhe t'i tregojmë botës se ne dhe vetëm ne (lëvizja nacional-çlirimtare) e mbrojmë Shqipërinë nga okupatorët dhe nga imperializmat e huaja. Duhet ta bindim popullin se lëvizja nacional-çlirimtare greke dhe jugosllave jo vetëm që nuk e cënon independencën tonë, por ndihmon për ta fituar.

Për «Ballin Kombëtar». — Në qarkoret tona të ndryshme jua kemi theksuar shumë herë se ç'është «Balli Kombëtar» dhe qëndrimin tonë karshi tij. «Balli Kombëtar», çerdhja e reaksionit, duhet luftuar pa mëshirë. Në Konferencën e dytë Nacional-Çlirimtare u theksuan qëndrimi ynë dhe konditat për bashkim ose bashkëpunim me të gjithë ata që janë jashtë Frontit Nacional-Çlirimtar dhe me «Ballin Kombëtar». Përsa u përket elementëve të papërlyer ose të gabuar deri dje dhe që gjejnë rrugën e drejtë, qëndrimi ynë duhet të jetë qëndrimi i caktuar në rezolucionin e asaj konference. Përsa i përket bashkimit ose bashkëpunimit me reaksionin ose me «Ballin Kombëtar» si organizatë, kjo çështje nuk shtrohet më, por shtrohet çështja se si t'i luftojmë ata. «Balli Kombëtar» dhe çdo organizatë tjetër jashtë lëvizjes nacional-çlirimtare shkrihen me reaksionin. Në luftën që do të bëni kundër këtij reaksioni duhet të përpiqeni të shkaktoni diferencime në radhët e tija, dhe me elementin që largohet nga ai, të afrohem. Puna kryesore që duhet të keni parasysh është që ta ndani reaksionin nga populli dhe ta stërvitni këtë të fundit të hyjë në luftë kundër tij. Qëndrimi ynë i drejtë dhe i vendosur kundër reaksionit nuk duhet të na shpjerë në sektarizëm dhe elementët e gabuar e që e kuptojnë gabimin t'i përbuzim dhe t'i hedhim në shportën e reak-



sionarëve. Kini parasysh se në radhët e «Ballit Kombëtar» dhe të gjithë reaksionit ka shumë vetë të pasqaruar, viktima, që nuk e kuptojnë luftën tonë kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Është detyra jonë t'i sqarojmë, t'i afrojmë gjithmonë më tepër në pozitë tona dhe me qëndrimin tonë të drejtë, që nuk duhet të shkojë as në sektarizëm as në kompromis, t'i shkëputim një herë e mirë nga reaksioni. Duhet të mundohemi t'i shtërnojmë të gjithë të marrin pozita karshi situatës dhe t'i largojmë ata nga pozitë e pritjes «së momentit të përshtatshëm» për të hyrë në luftë kundër okupatorit ose për të na goditur prapa krahëve. Me këta elementë miqësia platonike e fjalët e bukura nuk duhet të mjaftojnë, sepse këto mund t'i bëjnë vetëm të fitojnë kohë, të ruajnë pozitë e tyre atantiste<sup>1</sup>, të kenë përkrahjen tonë sot, kështu që nesër, me «famën» e tyre «të mirë» në popull, të manevrojnë në kurrizin tonë. Por s'duhet ta kuptoni këtë qëndrim tonin si një përpjekje për t'i hedhur këta në krahët e reaksionit, përkundrazi, qëndrimi ynë duhet t'u japë të kuptojnë atyre të pavendosurve mirë e të pasqaruarve se duhet t'i lënë pozitë e pritjes, nga të cilat fiton vetëm armiku.

Për të mbërritur në këto rezultate duhet t'ja bëjmë të qartë popullit qëndrimin tonë, mendimin e Partisë sonë, vijën politike të saj. Popullit duhet t'i tregojmë se ç'ka bërë Partia dhe ç'po bën. Duhet të popullarizojmë në kulm Partinë tonë heroike, sakrificat në gjak që ajo ka dhënë për çlirimin e atdheut; duhet të vëmë në dukje rolin udhëheqës të saj në këtë Luftë nacional-çlirimtare, ngritjen e moralit e të vullnetit të popullit tonë, gjallërinë dhe heroizmin që ajo ka ngjallur në rininë shqiptare, shpirtin e sakrificës e të organizimit, i cili është një model. Duhet, gjithashtu, të jetë e qartë në popull se ç'është lëvizja nacional-çlirimtare, ç'janë këshillat dhe ç'është Ushtria Nacional-Çlirimtare; popullit duhet t'ja bëni të qarta qëllimet e armikut dhe të reaksionit, kur këta përpiqen të konfundojnë lëvizjen nacional-çlirimtare me Partinë Komuniste. Duhet të përpiqeni që ta zgjeroni Frontin Nacional-Çlirimtar dhe në të të grumbullohet gatë gjithë populli ynë, populli i ndershëm dhe luftëtar, populli që i dhimbet vatani dhe liria; me këtë mënyrë ta bindni popullin, dhe ky të shohë konkretisht se në Frontin Nacional-Çlirimtar janë grumbulluar të gjithë ata që luftojnë për interesin e Shqipërisë dhe për t'i bërë varrin okupatorit. Jashtë këtij fronti mund të ketë vetëm persona të shkëputur e që kanë vetëm një dëshirë të mirë: t'i shërbejnë çështjes kombëtare, porse konkretisht nuk i kanë shërbyer dhe vazhdimi i qëndrimit të tyre jashtë këtij fronti, në vend që t'i shërbejë, e dëmton. Përsa u përket grupeve ose partive politike që qëndrojnë jashtë këtij fronti ato duhet të luftohen si parti

<sup>1</sup> Pritjeje.

reaksionare, që direkt ose indirekt bëjnë lodrën e okupatorit, se reaksioni, që të mundë të gënjejë elementin me tendenca demokratike dhe ta shkëpusë këtë nga lëvizja nacional-çlirimtare ose që mos ta lërë të shkojë në këtë front, po mundohet të dalë në skenë me një «parti socialdemokrate» kukull. Elementë të «Ballit» si Skënder Muço, renegatë të Nacional-Çlirimtares si Sotir Kondi dhe agjentë të tjerë të reaksionit, po përpëliten të krijojnë parti të tilla po që nuk po guxojnë të dalin në shesh.

Populli duhet të shohë mirë se reaksioni është vegël e armikut. S'duhet të lejojë që të imponohet në popull pikëpamja e reaksionit se gjoja ndërmyjet nesh dhe këtij të fundit luftohet për çështje ideologjike; ne luftojmë kundër reaksionit, së pari, se ky është kokë e këmbë në shërbim të okupatorit dhe, së dyti, se ky punon për të përjetësuar regjimet antipopullore. Lufta jonë kundër reaksionit është një pjesë e luftës kundër okupatorit, prandaj është e pandarë nga kjo. Duhet t'ja bëni të kuptueshme popullit se fushata e reaksionit për bashkim është demagogji e fëlliqur dhe se ne duam bashkimin e vërtetë, se ne punojmë për këtë bashkim e se jashtë Luftës nacional-çlirimtare nuk ka dhe nuk mund të ketë bashkim. Duhet të kemi kujdes të madh dhe të bëjmë çmos që reaksionarët e lëvizjet e tyre t'i demaskojmë mirë si përçarës, si terroristë, si vëllavrasës. T'i theksojmë popullit se «rregulli» që kërkon reaksioni është okupacioni i huaj, është bajoneta e milicit, është kërbaci i spiunëve. Ata bëjnë çmos, duke paguar kriminelë e duke shpikur mënyra të poshtra, për të hedhur vendin në kaos dhe në anarki, ta lodhin popullin, ta gënjejnë dhe t'i imponojnë vullnetin e tyre, d.m.th. terrorin më të zi. Kur çetat tona ishin vetëm ndër malet e Shqipërisë, vjedhjet, hakmarrjet dhe çrregullimet filluan të zhduken, dhe fshatari ynë filloi të jetojë në një siguri që s'e kishte parë kurrë deri atë ditë. Me çetat e «Ballit» filluan krimet, vjedhjet, çrregullimet; nuk mund të ishte ndryshe, sepse këto kishin dalë për të prurë kaosin dhe anarkinë, që janë armiq të mëdhenj të lëvizjes nacional-çlirimtare. Kjo është e vërteta dhe jo e kundërta si mundohen të tregojnë reaksionarët.

Duhet të kemi një qëndrim të qartë karshi Zogut dhe zogistëve. Këta të fundit kanë filluar të lëvizin, disa duke vepruar individualisht, disa të tjerë pak a shumë të organizuar; një pjesë dëshiron të hyjë në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe disa të tjerë, si Bazi i Canës, janë prej kohësh, në këtë front, ku qëndrimi i tyre është i lëkundshëm. Pëshpëritet se është formuar një farë partie zogiste me Bazin dhe, patjetër, me gjithë elementët e falimentuar, si bajraktarët, parazitët të regjimit të Zogut, dhe reaksionarët që po lënë vaporin e «Ballit Kombëtar» që ka filluar të mbytet. Kjo parti thuhet se do të kërkojë të hyjë në Frontin Nacional-Çlirimtar. Të gjithë zogistëve të organizuar ose jo, me Zogun

bashkë, ne u themi në mënyrën më kategorike dhe çiltas se për të hyrë në lëvizjen nacional-çlirimtare duhet të pranojnë vijën e Këshillit Nacional-Çlirimtar integralisht, se duhet të mbyllin defterët e së kaluarës e se koha e vjetër nuk mund të përsëritet më, se duhet të mos e shtrojnë në asnjë mënyrë çështjen e regjimit, por të luftojnë për një Shqipëri të lirë demokratike dhe popullore, ku populli të zgjedhë regjimin që dëshiron vetë. Ata duhet të lënë mënjanë të gjitha pretendimet e tyre dhe bashkë me to edhe dallaveret. Ata duhet t'u hapin luftë gjithë reaksionarëve, armiq të luftës që bën populli shqiptar për t'u çliruar. Kësisoj u përgjigjemi ne zogistëve. Por ne nuk mund të humbim kohë në bisedime me ta; duket qartazi se ata po lëvizin për të luftuar; reaksioni i demaskuar me «Ballin Kombëtar» përpiket të gjejë flamuj të tjerë, me të cilët, qoftë nga brenda qoftë nga jashtë, të luftojë lëvizjen nacional-çlirimtare. Për këtë arsye le të fillojmë t'i demaskojmë dhe t'i luftojmë, duke ja paraqitur popullit në dritën e vërtetë, se ata nuk kanë bërë kurrgjë kundër okupatorit, por, përkundrazi, hapët ose tërthorazi, kanë bashkëpunuar me të dhe tani duan të përfitojnë nga lufta jonë për të rivendosur regjimin e skllavërisë. Mos të hezitohet t'i godasim edhe me armë ata njerëz që përpiqen (si p.sh. në Dibër, ku zogistët hëngrën një dru të shëndoshë nga ana e forcave tona) të pengojnë luftën tonë. Kundër zogizmit duhet të bëhet agjitacion në shkallë të gjerë në popull, por deri në një direktivë tjetër të mos zihet emri i Bazit të Canës, në trakte o komunikata. . .<sup>1</sup>. Kjo gjë nuk ju ndalon aspak të demaskoni gazetën «Atdheu», manevrat e zogizmit dhe zogistët e terreneve tuaja; nuk ju ndalon gjithashtu që të pregatitni terrenin për një fushatë të gjerë dhe për një luftë të hapët kundër Zogut, nuk ju ndalon që të flitni kundër Musa Jukëve dhe të ngjallni në popull antizogizmin.

Brenda në radhët e reaksionit ka dhe do të ketë patjetër divergjencë, por ne nuk duhet ta flemë mendjen dhe të shpresojmë shumë në këto, sepse reaksionarët kundërshtimet më të mëdha dhe armiqësinë e kanë kundër nesh e jo kundër njëri-tjetrit. Kjo s'do të thotë që ne të mos përfitojmë nga divergjencat e tyre.

Nepërmjet luftës politike kundër reaksionit, nepërmjet luftës me armë kundër forcave të armatosura reaksionare dhe, në radhë të parë, kundër okupatorit, populli do të mobilizohet rreth nesh gjithmonë më tepër, do të bëhet më koshient dhe do ta bëjë Luftën nacional-çlirimtare me të vërtetë luftë të tij. Për këtë arsye duhet të kemi kujdesin më të madh që të mos hidhemi vetëm kundër reaksionit, as në luftën politike as në luftën me armë, por

1 Në këtë kohë Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar nuk kishte përjashtuar akoma nga radhët e veta Abaz Kupin (Bazin e Canës) dhe e kish thirrur atë në takim për të sqaruar pozitën e tij.

të marrim edhe popullin me vete, sepse përndryshe populli fillon e mbetet si neutral dhe, duke qenë në këto pozita, ai mund të influencohet lehtë nga armiku. Okupatori gjerman dhe veglat e tij mundohen ta bindin popullin shqiptar se këtu s'ka okupacion dhe ta bëjnë që të harrojnë se këtu gjendet ushtria gjermane. Ky është një rrezik për ne, sepse e bën popullin që të largohet nga lufta. Duhet që, përveç luftës me armë kundër gjermanëve, të bëjmë edhe një luftë politike më të gjerë dhe më të thellë kundër demagogjisë naziste. Duhet të luftojmë asamblenë, komitetet, komisionet, këshillat e çfarëdo gjë të ngritur nga gjermanët. Të demaskojmë dhe të luftojmë rreptësisht tradhëtarët si Mehdi Frashëri, Fuat Dibra, Pater Anton Harapi, Lef Nosi<sup>1</sup> e të tjerë dhe të likuidojmë në popull besimin se gjoja këta nacionalistë, që s'janë veçse agjentë të Gestapos, e kanë marrë këtë detyrë të detyruar nga gjermanët, ose për «të mirën e Shqipërisë». Gjermanët me gojën e tradhëtarëve thonë se ne nuk ju ndjekim, prandaj mos na ndiqni. Pranimi i kësaj vije është kompromis, është mohim i Luftës nacional-çlirimtare dhe çon në likuidimin e lëvizjes sonë dhe në forcimin e pozitave të reaksionit. Prandaj duhet ta mbajmë popullin vazhdimisht në luftë kundër okupatorit dhe t'i ngjallim me të gjitha mënyrat urrejtjen kundër tij.

*Për këshillat nacional-çlirimtare.* — Kohët e fundit ju është dërguar Rezolucioni i Konferencës së dytë Nacional-Çlirimtare si edhe Statuti dhe Rregullorja e Këshillave Nacional-Çlirimtare. Nga ana tjetër, kurdoherë që Komiteti Qendror ju ka çuar letra e direktiva, ju ka theksuar veçanërisht rëndësinë e këshillave nacional-çlirimtare, rolin e tyre në këtë luftë dhe mënyrën e punimit në to. Ju këshillojmë që këto rezolucione, rregullore, qarkore t'i punoni me kujdesin më të madh dhe në terren t'i aplikoni në mënyrë që rezultatet të jenë konkrete dhe të shëndosha, sepse duhet të kuptoni mirë se këshillat nacional-çlirimtare s'janë gjëra formale, por bazat e regjimit demokratik dhe organizmat e vërteta të Luftës nacional-çlirimtare. Me gjithë këshillat e udhëzimet që ju janë dhënë nuk është arritur në rezultatet e duhura; në shumë vende nuk ekzistojnë akoma këshilla kurse në disa vende të tjera ato janë vetëm formale. Patjetër atje ku këshillat janë në këtë gjendje, atje reaksioni lëviz, atje ai bën fole, kurse ndër vende të tjera, ku ato janë ngritur në bazë të Statutit dhe të Rregullores, i gjithë populli merr pjesë në to, lufton dhe ndihmon pareshtr luftën. Që të mundin këshillat të punojnë si duhet, duhet të caktoni shokë që të merren me këtë punë dhe që

1 Mehdi Frashëri, Fuat Dibra, Lef Nosi dhe Pater Anton Harapi përbënin «Këshillin e lartë të Regjencës» të krijuar nga pushtuesit gjermanë në tetor të vitit 1943.



t'i kushtojnë aktivitetin më të madh kësaj çështjeje. Këta shokë jo vetëm t'i formojnë këto këshilla, por t'u japin gjallëri dhe jetë, t'u shpien eksperiencën dhe vullnetin e tyre, të ndihmojnë dhe të ngrenë të gjithë elementët nacionalistë që marrin pjesë në to dhe t'i bëjnë koshientë të detyrës që u ka ngarkuar populli. Këshilli duhet të mobilizojë tërë popullin dhe të bëhet një organizim i fortë me një aparat të shëndoshë organizativ. Në çdo fshat të formohen këshillat, të formohen këshillat e komuneve, nën-prefekturave dhe të qarkut dhe këto të lidhen ngushtë me Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, nga i cili do të marrin udhëzime e direktiva dhe të cilit do t'i dërgojnë çdo herë raporte të imta për veprimtarinë e tyre dhe për situatën politike të qarkut. Sikundër ju theksohet në qarkoret e mëparshme, që të mund të funksionojnë si duhet këto këshilla, duhet të formohen seksione të ndryshme në gjirin e tyre dhe këto seksione, duke pasur në krye nga një kompetent, të organizojnë punën, duke përfshirë të gjithë jetën shoqërore, politike të fshatit o të qytetit. Këshillat, në radhë të parë, duhet të mbledhin ndihma për ushtrinë tonë, të bëjnë fushata për dimër, i cili po afrohet i egër për luftëtarët tanë që janë nëpër male. Përsa u përket ndihmave në të holla duhet të kemi kujdes të mos i ngatërrojmë xhepat: fondi nacional-çlirimtar duhet të shkojë në duart e këshillave, të cilat ja japin Shtabit të ushtrisë dhe vetëm ndihmat e Partisë shkojnë në kasën e Partisë. Këtu duhet të keni kujdes të madh, sepse pasqyra e llogarive duhet të jetë e qartë. Direktivat që çohen prej Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çl. duhet që shokët e Partisë t'i punojnë nëpër këshilla dhe t'i bëjnë të qarta, t'i bëjnë të zbatohen jo me dekrete e me forcë, por me bindje. Literaturën që dërgon Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çl., si trakte o gazetën «Bashkimi», ta shpërndani në të katër anët e Shqipërisë, ta shumëzoni, po të keni mundësi, dhe ta punoni më së miri. Forcimi i këshillave nacional-çl. do të thotë forcim i luftës sonë, do të thotë çlirim i shpejtë i popullit dhe i atdheut tonë.

*Për Bashkimin e Gruas Antifashiste Shqiptare.* — Me autorizimin e Komitetit Qendror është marrë iniciativë dhe u është dërguar gjithë qarkorëve një qarkore<sup>1</sup>, me të cilën këshilloheni që të filloni punën për krijimin e organizatës së Bashkimit të Gruas Antifashiste Shqiptare. Kjo është një organizatë dhe jo një formulë e bukur për t'u përmendur në konferenca. Roli i gruas në këtë luftë është i madh dhe lufta e sotme me plot sakrifica e ka vënë në dukje, prandaj duhet të punoni me të ashtu si punohet me një organizatë. Duhet ta ngrini nga themelet këtë organizatë

1 Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me krijimin e Organizatës Antifashiste të Grave Shqiptare, 14 prill 1943. (Shih në këtë vëllim f. 155.)

dhe ta çimentoni, t'i jepni jetë dhe gjallëri këshillave të gruas antifashiste në mëhallë, në fshatra e në qytete. Të krijohen sa më parë këto këshilla dhe të mos mbetet vetëm një dëshirë e mirë. Shoqet tona t'ja kushtojnë punën më të madhe krijimit dhe forcimit të një aparati organizativ të shëndoshë të Gruas Antifashiste. Organizimi i shpejtë i këtyre këshillave do të shpejtojë Konferencën e Vendit të organizatës së Gruas Antifashiste Shqiptare. Prandaj ju duhet të keni kujdes që të zgjidhet aty këshilli i qarkut me anë të një konference të qarkut dhe të caktohen delegatet për Konferencën e Vendit. Me pëlqimin e Konferencës së dytë Nacional-Çlirimtare, Këshilli i Gruas Antifashiste të qytetit të Tiranës ka marrë përsipër organizimin e kësaj konference.

*Për Bashkimin e Rinisë Popullore Antifashiste Shqiptare.* — Në një qarkore të Komitetit Qendror të Rinisë<sup>1</sup>, drejtuar komiteve qarkore të rinisë, shpjegohet mirë se ç'është kjo organizatë, pse krijohet dhe si funksionon. Punojeni mirë atë qarkore. Duhet t'i jepet ndihma më e madhe komitetit qarkor të rinisë, që të organizojë konferencën e qarkut të Bashkimit të Rinisë Antifashiste, ku do zgjidhet komiteti i qarkut dhe delegatët për Konferencën e Vendit. Rinia Antifashiste brenda mundësive do të dërgojë delegatët e saj për konferencën e qarkut. Por ju mos pritni dhe bëjeni konferencën sa më parë, në prani të delegatëve ose të një delegati të këshillit nacional-çlirimtar të atjeshëm; në qoftë se vjen delegati i Rinisë Antifashiste mirë, në mos ardhte, puna le të vazhdojë.

Të keni kujdes që shokët e rinisë, që dërgoni në çeta ose brigada, t'i shoqëroni me shënime mbi punën e tyre dhe mbi aftësinë e tyre dhe të këshilloni shokët e çetave të grupit e të zonës që t'u japin përgjegjësinë e duhur, në mënyrë që shokët, të cilët mund të drejtojnë punën e rinisë, të mos ngarkohen me punë që mund t'i bëjë edhe një partizan i thjeshtë.

Për mbarëvajtjen e punës me rininë janë përgjegjës të gjithë shokët e Partisë; mungesa e interesimit nga ana juaj për këtë sektor mund të shkaktojë që rinia të fillojë të shkëputet nga Partia. Por interesimi nuk duhet të kuptohet në mënyrë të ngushtë, interesim nuk do të thotë të bësh kontroll të thatë dhe burokratik; interesim do të thotë të studjosh dhe të njohësh mirë vijën organizative të rinisë, problemet e saja, nevojat e saja në qarkun tuaj, t'i vish në ndihmë, ta këshillosh, ta udhëzosh dhe të dish ta shtiesh në punë dhe ta përdorësh sa më tepër për forcimin e Partisë sonë dhe të Luftës nacional-çlirimtare. Fatkeqësisht, ne konstatojmë se interesimi juaj për rininë ka qenë më tepër formal.

1 Qarkore e Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare «Mbi krijimin e organizatës së Rinisë Antifashiste Shqiptare», 20 shtator 1943.



Ne dëshirojmë dhe duhet të kemi patjetër përmirësime në këtë pikë, dhe në raportet tuaja që na çoni duhet të flitet për rininë, të flitet në mënyrë konkrete, ku të duket interesimi dhe kompetenca juaj.

*Për Ushtrinë Nacional-Çlirimtare.* — Problemi kryesor i Luftës nacional-çlirimtare është problemi i forcimit të ushtrisë sonë. Krahas me çështjen organizative të Partisë, çështja e ushtrisë duhet të preokupojë shokët udhëheqës dhe gjithë anëtarët e Partisë. Të dyja këto çështje janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, por në këtë pikë do të kufizohemi vetëm t'u bëjmë disa vërejtje përsa i përket çështjes ushtarake. Batalionet që ndodhen në qarkun tuaj duhet të jenë kurdoherë në ofensivë kundër armikut të jashtëm dhe të brendshëm, dhe, njëkohësisht, ushtarët tanë t'i lartësoni politikisht, në mënyrë që ata të bëhen koshientë për luftën që bëjnë. Nga ana tjetër, duhet të kryeni mobilizimin në popull, dhe ky mobilizim të mos ketë për qëllim grumbullimin e elementëve jo të përshtatshëm për luftë e që largohen në goditjen e parë me armikun, por në radhët e ushtrisë sonë duhet të mobilizoni fshatarë, punëtorë që e kanë në shpirt luftën për çlirim. Duhet të zgjedhim për ushtrinë tonë udhëheqës të përshtatshëm, trima dhe të ndershëm; nuk lejohet që ndër këto komanda të mbani elementë që mund të diskreditojnë dhe të pengojnë luftën tonë. Nga batalionet sulmuese duhet të rekrutoni elementët më të shëndoshë dhe më trima për të formuar brigadat, kur të merrni urdhëra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Shihet në radhët e ushtrisë sonë një farë burokratizmi, i cili duhet të zhduket, sepse pengon zhvillimin e luftës dhe i lejon shokët partizanë të gjejnë justifikime për plogështinë e tyre. Nga ana tjetër, kjo ngadalëson ritmin e luftës, e cila duhet të mbajë kurdoherë karakterin e një lufte guerriljeje e të shpejtë. Në disa qarqe ushtria jonë ka humbur deri diku atë ashpërsinë që duhet të ketë në luftë, dhe në disa vise të tjera disa çeta dhe batalione, në vend që të jenë kurdoherë në vende ku goditet armiku, përpiqen të shtrojnë gunat e të gjejnë kuartieret e dimrit. Që të mund të kemi një ushtri të fortë duhet patjetër që ju të interesoheni, të formoni Partinë në ushtri dhe shokët<sup>1</sup> të jenë udhëheqësit dhe ata që do t'i japin zjarr e gjallëri kësaj ushtrie. Deri tani nuk kemi parë që këto direktiva të merren me gjithë seriozitetin e duhur dhe të zbatohen. I jeni vënë çështjes ushtarake, keni mobilizuar masa, por këto nuk do të kenë atë gjallëri, në qoftë se u mungon udhëheqja e duhur nga Partia. Nuk mjafton, sikundër është në realitet (mjerisht i hidhur), të keni celula ndër batalione e ndër çeta, por duhet që këto celula të bëjnë me të vërtetë detyrën e tyre.

<sup>1</sup> Anëtarët e Partisë.

Shokë të Partisë në ushtri në shumë raste s'bëjnë tjetër, veçse merren me gjëra të vogla, si punë korrierësh e blerës plaçkash për çeta, punë që mund t'i bëjnë partizanë të thjeshtë, në vend që këta të organizojnë konferenca e kurse të ndryshme në ushtri. Kjo gjendje duhet patjetër të zhduket; mos dëgjohen më komisarët dhe zëvendëskomisarët të justifikojnë inaktivitetin e tyre, duke thënë se s'mund të mblihdnin dot celulën ose të bënin konferenca, pse kanë qenë në udhëtime e të tjera gjëra të tilla. Vetë karakteri i luftës sonë është lëvizës dhe prandaj s'është një justifikim për anëtarët e Partisë të mos bëjnë detyrën e tyre. Të këshillohen shokët që të ruajnë dhe të ngrenë emrin e Partisë në radhët e partizanëve, të jenë të ashpër ndaj gjithë anëtarëve të Partisë, e sidomos ndaj komisarëve e zëvendëskomisarëve, kur ata nuk bëjnë detyrën e tyre. Celulat e batalioneve e byrotë e shtabeve të kenë kujdesin më të madh që çdo shenjë dobësie nga ana e anëtarëve të Partisë, të mos lihet të shkojë pa u qortuar e pa u korrigjuar. Shokët tanë në ushtri duhet të jenë model për të tjerët. Provvë që qarqet e kanë lënë pas dore organizimin e Partisë në ushtri është fakti se numri i anëtarëve të Partisë në atë sektor nuk po shtohet; burimi i madh për anëtarë partie, luftëtarë të vendosur dhe të provuar, siç është sektori i ushtrisë, ka mbetur shterpë. Po formohen brigadat me elementë të ndryshëm të dërguar nga çdo terren, por mungojnë anëtarët e Partisë, sepse këta mungojnë në radhët e ushtrisë. Dhe për të kompletuar këtë mungesë detyrohemi t'i nxjerrim kuadro nga qytetet. Këtë gjë e themi vetëm për të treguar se sa pak punohet në ushtri, në atë sektor ku Partia jonë ka shpresat më të mëdha të rekrutojë anëtarët e Partisë nga shtresa katundare. Në këto momente, mobilizimi është në rendin e ditës dhe duhet të bëhet me sistem. Duhet një herë të studjohet nga qarkori se cilët janë anëtarët e Partisë që duhet të shkojnë në ushtri. Për këtë gjë duhet të kini parasysh që ndër qytete, duke mbajtur disa kuadro mjaft të shëndosha e të afta për të kryer punën, nuk duhet të sakrifikoni kuadro të tëra në rast të një reaksioni nga ana e armikut. Një pjesë të këtyre kuadrove duhet ta dërgoni në radhët e ushtrisë me detyra dhe udhëzime të caktuara. Nga ana tjetër t'u shpjegohet celulave rëndësia e mobilizimit dhe mënyra se si ta bëjnë; të pregatiten drejtuesit e rinisë, këshillat nacional-çlirimtare dhe grupet edukative për fushata të gjera mobilizimi. Në konferenca të gjera të popullit në qytete e fshatra, në konferenca të gjera të rinisë të shtrohet si pikë kryesore çështja e forcimit të ushtrisë dhe e mobilizimit. Në këto konferenca ose mitingje ata që janë gati të dalin në çetë, dhe sidomos shokët tanë të Partisë dhe të rinisë, të dalin në fund të bisedimeve dhe të thonë se do të shkojnë në ushtri, duke ftuar edhe të tjerët të venë me ta. Të bëhen fushata mobilizimi për brigadat, e veçanërisht në rininë e qytetit. Duhet ta shihni mirë e ta kuptoni një herë e përgjithmonë se pa

ushtri të organizuar, sidomos pa brigada të forta, nuk mund t'i bëjmë një luftë serioze okupatorit, nuk mund ta mobilizojmë gjithë popullin shqiptar, nuk mund t'ja thyejmë kokën reaksionit. Kur kërkohen elementë nga Shtabi i Përgjithshëm për brigadat e ndryshme që janë formuar, shokët e terreneve, në vend që të çojnë, sipas direktivave që u jepen, elementët më të zgjedhur e më luftëtarë, çojnë ata që u vijnë më për mbarë. Kjo tregon se shokët e Partisë s'u vënë veshin ose nënçmojnë rëndësinë e brigadave, që janë formacionet e vërteta të ushtrisë sonë të rregullt dhe që pak nga pak do të thithin gjithë elementët e shëndoshë për të krijuar, më në fund, ushtrinë tonë të vërtetë. Shokët e terreneve përgjithësisht e shohin punën ngushtë dhe pikëpamjet e tyre nuk dalin jashtë terrenit ku janë. Duke pasur frikë se mos dobësohet terreni, ata nuk shohin vlerën e madhe që ka brigada, e cila po të mbajë në gjirin e saj elementë qind për qind të vendosur do të jetë në gjendje të bëjë mrekullira dhe t'i japë ndihmën në çdo mënyrë dhe në çdo sektor terreneve të ndryshme ku ajo kalon. Prandaj duhen dërguar shokët më të mirë në ushtri e sidomos në brigada. Përgjithësisht ushtria jonë ka nevojë për komisarë, zëvendëskomisarë e shokë të zgjedhur, që ta ngrenë ushtrinë, t'i shumojnë celulatat në radhët e saja dhe t'i çelnikosin, që kështu të mos përsëritet më fakti i hidhur që në ushtrinë tonë të ketë celula që s'janë celula. Mos mbani të grumbulluar në qytet shokë të shumtë, por i dërgoni në ushtri. Në qytet, me një numër të vogël shokësh, por të vendosur, me një organizatë të Rinisë, me një organizatë të Gruas Antifashiste dhe me këshillat nacional-çlirimtare pa asnjë dyshim puna do të shkujtë mbarë. Është një krim që në ushtri, ku ka grumbullim, të mos kemi anëtarë të Partisë, të mos kemi celula, të mos kemi organizatë. Edhe shokët përgjegjës të punës, si anëtarë të qarkorit, sekretarë organizativë ose politikë, të lartësojnë sa më parë shokë të rinj dhe t'i lenë zëvendës në punët e tyre, sepse detyra shpejt do t'i thërresë që ata të hidhen në radhët e ushtrisë. Duhet të vendosim për këtë gjë dhe puna të mos hiqet zvarrë. Me një qarkore<sup>1</sup> drejtuar gjithë zëvendëskomisarëve politikë të reparteve të ndryshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare nga ana e Komitetit Qendror theksohet detyra e tyre dhe kujdesi që duhet të vënë për organizimin e Partisë në ushtri. Veçanërisht ju rekomandohet që të këndohet e të punohet referati mbi Ushtrinë Nacional-Çlirimtare<sup>2</sup>, i cili duhet të shumëzohet dhe të vihet në dorë të çdo anëtarit të Partisë. Ju është theksuar dhe herë të tjera se puna e Partisë në ushtri nuk varet nga komitetet qarkore. Përsa u përket brigadave, kjo është dhe mbetet fjalë për fjalë kështu. Përsa u përket batalioneve dhe çetave të grupit

1 Shih në këtë vëllim f. 199.

2 Referat i mbajtur në Konferencën e parë të Vendit të PKSH.

e të zonës, kjo nuk duhet të merret shumë ngurtë. Organizata e Partisë ndër to varet edhe ajo prej Komitetit Qendror, prej nga merr direktiva dhe ku raporton me anën e komisarit të Shtabit të Përgjithshëm, por vazhdon të mbajë lidhje dhe të ndihmohet nga komiteti qarkor i terrenit, për arësye se kanë mjaft punë të përbashkëta.

*Çështjet e brendshme të Partisë.* — Rëndësia e çështjes organizative të Partisë ju është theksuar në çdo letër, por nuk shihet në organizatat ai zell dhe ai kujdes i madh që shihej përpara për këtë çështje me kaq rëndësi. Kjo ka kaluar në dorë të dytë dhe është një gabim i madh, se duhet të dimë se pa pasur një parti të fortë, të organizuar më së miri me kuadro të shëndoshë dhe të edukuar, të dalë nga lufta e nga përpjekjet, rezultatet do të jenë të pakta. As ushtria, as rinia, as organizatat e tjera antifashiste nuk mund të jenë në lartësinë e duhur, në qoftë se organizativisht çalon Partia jonë. Që prej shokëve udhëheqës deri tek anëtarit i celullës e anëtarit i grupit simpatizant, duhet të shkunden një herë e mirë dhe t'i shohin punët dhe situatën më konkretisht. Barra që rëndon mbi supet e Partisë sonë, është jashtëzakonisht e rëndë dhe për ta ngritur këtë barrë e për të dalë matanë fitimtarë, duhet të kemi koskën e kurrizit të shëndoshë, duhet të kemi Partinë tonë të organizuar dhe të fortë, duhet t'i kemi shokët në lartësinë e duhur politike dhe ushtarake, që të mundin në këto momente e situata të vështira e decizive të përballin çdo të papritur dhe të orientohen pa u gabuar. Për këtë shkak duhet që shokët udhëheqës të ndihmojnë pareshtur shokët ndër celula, t'i ngrenë politikisht dhe teorikisht, t'u ngarkojnë punë me përgjegjësi, t'u kërkojnë rezultate. Në barazim me punën, që po zhvillohet e që zmadhohet, duhet që edhe ju të përdorni mënyra punimi të reja, se vetëm kështu mund të përballemi detyrat e domosdoshme që ju vihen përpara. S'është më ajo punë e vogël, kur në mbledhjet e qarkorëve diskutohej puna e pesë raporteve të ardhura nga celulatat, tani hapen para jush horizonte të gjera punimi. Për këtë shkak duhet të ndani punën, duke formuar rreth çdo përgjegjësi një rrjetë shokësh, simpatizantësh, miqsh dhe së bashku të kryeni detyrat që ju ngarkon mbledhja e qarkorit. Seksione të ndryshme duhet të formohen për shtypin e propagandën, për financën, për ushtrinë etj.

Shtypit e propagandës duhet t'i vini kujdesin më të madh. Komunikatat, traktet, gazetatat të shtypen me kujdes dhe të shpërndahen kudo në popull. Seksioni i propagandës duhet të jetë kurdoherë zgjuar, për të demaskuar çdo manevër të armikut dhe për të sqaruar shokët dhe publikun mbi çdo situatë. Këtë literaturë duhet ta punoni me kujdes në celula e në grupe, pse atje shokët do të mësojnë qëndrimin politik të luftës sonë dhe të Partisë.

Të shumëzohen broshurat dhe librat, sidomos «Historia e Partisë Komuniste (bolshevike)», dhe kjo jo vetëm që të vihet në dorë të çdo anëtarit të Partisë, por edhe të mbahen konferenca e kurse mbi të. Një punë e tillë do t'i ngrëjë shokët politikisht dhe do t'i pajisë ata me armën më të shëndoshë, që është teoria marksiste.

S'dëgjohet fare se në ç'gjendje janë financat e Partisë. Si po konstatojmë, ato janë të përziëra me fondin nacional-çlirimtar. Ky është një gabim, të cilin duhet përnjëherësh ta ndreqim. Kuotizacionet dhe ndihmat që mbliidhen për Partinë duhet të shkojnë në arkën e Partisë, s'ka gjë pse ato të prishen për nevojat e ushtrisë, por duhet patjetër të dihet kontributi në të holla që i ka dhënë Partia luftës. Janë neglizhuar krejtësisht fushatat që mund të bëhen për mbledhje ndihmesh për Partinë Komuniste. Këto fushata duhet të vihen në zbatim, pse janë edhe një mjet propagandistik.

Puna me nacionalistët, që është shumë delikate, duhet t'u ngarkohet shokëve të mirë, të cilët të dinë ta paraqesin si duhet vijën e Luftës nacional-çlirimtare, të dinë të dalin nga situata të vështira dhe t'u japin gjallëri e jetë këshillave nacional-çlirimtare. Organizata e Rinisë dhe ajo e Gruas Antifashiste duhet të ndihmohen seriozisht dhe në asnjë mënyrë të mos nënvleftësohen, sepse kur në mëhalla t'i kemi të forta këshillat nacional-çlirimtare, këshillat e rinisë, këshillat e gruas, ne e kemi mobilizuar të tërë mëhallën, e kemi hedhur të tërë në luftë. Këtu do të ndjehet nëse organizativisht Partia është e shëndoshë.

*Puna me misionet angleze.* — Në shumë krahina ndodhen misione angleze, të cilat përpiqen të futin hundët në çështjet politike e sidomos në çështjet e brendshme organizative dhe ushtarake tonat. Ato mundohen të bashkohen me reaksionarët, t'i organizojnë këta për t'i pasur vegla të tyre për kohën e zbarkimit. Këtë punë oficerët anglezë disa herë e bëjnë tërthorazi, disa herë hap-tazi. Atyre u duhet një lëvizje e fortë dhe me kredi në popull, prandaj përpiqen të ngrënë prestigjin e «Ballit Kombëtar», ta futin këtë në luftë kundër gjermanëve për ta pasur si mbështetje për më vonë. Por të mos harrojmë se atyre u intereson, para së gjithash, lufta kundër gjermanëve, të cilën këtu në Shqipëri e bën vetëm lëvizja nacional-çlirimtare, prandaj ata do ta ndihmojnë patjetër lëvizjen tonë. Duhet të kemi me ta një sjellje korrekte, por edhe një qëndrim të qartë dhe të prerë. Ata nuk duhet të përzihen në punët e brendshme, nuk duhet në asnjë mënyrë të merren si arbitra ndërmyjet nesh dhe reaksionit. Në u pëlqeftë lufta jonë kundër reaksionit mirë, përndryshe derën e kanë të hapur. Në rast se shihet se oficerët anglezë luajnë dallavere, në rast se ju keni fakte ose dokumenta mbi këtë gjë, atëherë të raportohet menjëherë në Shtabin e Përgjithshëm dhe, në qoftë se çështja është

e rëndë dhe puna s'pret, atëherë të shoqërohen pranë komandës së misionit anglez në Shqipëri (me anën e Shtabit tonë të Përgjithshëm); në asnjë mënyrë mos të lihen të futin hundët në punët tona, në ushtrinë tonë.

•  
•

Letrat ose raportet që i dërgohen Shtabit të Përgjithshëm, Këshillit të Përgjithshëm, Gruas Antifashiste dhe Rinisë Antifashiste duhet të përmbajnë gjëra në kompetencë të tyre dhe jo t'i shkruhet, p.sh., Shtabit për çështje partie, ose në të njëjtën letër që i shkruhet Shtabit, t'i shkruhet edhe Komitetit Qendror të Partisë, siç ka ndodhur shpeshherë. Letrat të kenë mirë adresën në krye.

Ju rekomandojmë edhe një herë kujdesin më të madh që qarkoret dhe letrat e Komitetit Qendror të ruhen dhe të mos bien në asnjë mënyrë në dorë të armikut; gjithashtu përmbajtja e tyre të mos bjerë në asnjë mënyrë në vesh të armikut. Nga qarkoret dhe nga letrat ju duhet të nxirrni vijën dhe taktikën, me të cilën do të punoni në organizatë, në popull dhe kundër armikut. Kjo nuk do të thotë se do të dilni në popull me qarkoret fjalë për fjalë. Ju theksojmë edhe që të gjithë anëtarët e qarkorit t'i këndojnë mirë qarkoret dhe letrat e Komitetit Qendror dhe, mundësisht, të mbliidhet herë pas here aktivi i qarkut ose vetëm i qytetit ose i krahinës dhe aty këto të punohen. Sidoqoftë në të gjitha celulat duhet të çohet fjala e Komitetit Qendror dhe të punohen direktivat e tija.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të Partisë  
Komuniste të Shqipërisë

*Shpati*

*Botohet sipas origjinalit, që  
gjetet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



**LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË  
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR BERATIN, ME  
ANËN E SË CILËS DËNOHEN LIDHJET E DOBËTA ME  
KOMITETIN QENDROR DHE KOMPROMISI ME  
GJERMANËT NË BERAT**

**5 nëntor 1943**

Të dashur shokë,

E morëm raportin tuaj pa datë, dhe me justifikimet që paraqitni për vonesën e raporteve. Komunistët nuk kërkojnë kurrë të gjejnë justifikime por mbarojnë punën që u ngarkohet me përpikëri. Nga shokët e Beratit s'kemi parë asnjëherë raporte si duhet dhe në kohën e caktuar. Dhe pas dy-tre muaj heshtjeje ju na bëni nga një raport, ku kërkon kurdoherë ndjesë për vonesën e tij. Të tilla mënyra punimi duhet të mbarojnë një herë e mirë, përndryshe do të merren masa, bile shumë rigorozë. Mënyra e punës suaj dhe e lidhjeve me Komitetin Qendror do të tregohet në gjithë organizatat si një shembull i keq, në mënyrë që të mos përsëritet më.

Kompromisi me gjermanët është një nga punët më të këqia që mund të ketë bërë një qarkor i Partisë. Të gjitha mund të priteshin, por një vepër e tillë nuk mund të pritej kurrë nga ju. Këto janë konsekuencat e shkaputjeve të lidhjeve me Komitetin Qendror. Ky kompromisi juaj me gjermanët do të jetë një nga pikat e bisedimeve të mbledhjes së ardhshme të Komitetit Qendror, ku do të merren vendime për këtë çështje.

Përsa i përket çështjes së Fierit, ai është i lidhur me Vlorën dhe s'është ndonjë çështje kaq e koklavitur si e tregoni ju. Kjo s'ju ndalon që në rast se keni material propagandistik me shumicë, gjë që nuk kujtojmë, t'ja dërgoni.

Qarkorja që ju çohet duhet të punohet me kujdesin më të

madh në qarkor, ku të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij si edhe Gjin Marku, i cili të thërritet apostafat për këtë gjë.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror

*Enver Hoxha*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

*Botuar për herë të parë:  
«Enver Hoxha. Vepra,  
vëllimi 2». Tiranë, 1968*

**QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME VENDIMIN PËR  
MBLEDHJEN E KONGRESIT I ANTIFASHIST  
NACIONAL-ÇLIRIMTAR DHE ZGJEDHJET E DELEGATËVE  
PËR NË KONGRES**

**16 prill 1944**

**GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË  
KOMUNISTE TË SHQIPËRISË<sup>1</sup>**

Të dashur shokë,

Përpara evenimenteve që rrokullisen me kaq shpejtësi, kur Ushtria e Kuqe heroike e udhëhequr me aq gjenialitet nga shoku ynë i adhurueshëm Stalin po i jep grushtet e vdekjes Gjermanisë hitleriane, kur ushtria e popujve të URSS-it me një sulm vendimtar dhe ngadhënjyes po marshon drejt Perëndimit, drejt zemrës së Gjermanisë, kur lëvizjet nacional-çlirimtare në gjithë Evropën po marrin një hov të madh, përpara zmadhimit dhe forcimit të Frontit dhe të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare, Partia jonë Komuniste ndodhet përballë momenteve me rëndësi të madhe historike. Në çdo kthesë të luftës sonë heroike Partia jonë Komuniste, udhëheqësja e vërtetë e kësaj lufte çlirimtare, ka marrë vendime të guximshme, vendime që kanë ngjallur në zemrat e gjithë shqiptarëve dashurinë e thellë dhe respektin më të madh për Partinë tonë kreshnike.

Partia jonë, shtylla e çelniktë e Luftës nacional-çlirimtare, ishte frymëzuesja dhe organizuesja e Konferencës së Pezës, ku u hodhën bazat e shëndosha të frontit, baza që u vaditën me gjakun më të kulluar të shokëve tanë trima dhe të gjithë luftëtarëve të popullit shqiptar. Këshillat nacional-çlirimtare u krijuan në baza demokratike dhe u bënë pushteti i vërtetë popullor, që ndihmoi dhe ndihmon pareshtur Luftën nacional-çlirimtare. Luf-

<sup>1</sup> Kjo qarkore u është drejtuar edhe seksioneve politike të brigadave të UNÇSH.

ta jonë ka arritur në një zhvillim aq të madh sa krahina të tëra kanë arritur të hidhen në kryengritje të përgjithshme; brigadat dhe batalionet tona po forcohen dhe shumëzohen dita-ditës.

Në një situatë të këtillë paraqitet e nevojshme dhe urgjente mbledhja e Kongresit Antifashist Nacional-Çlirimtar, kongres ku të dërgohen përfaqësuesit e vërtetë të popullit në luftë kundër fashizmit. Kryesia e Këshillit Nacional-Çlirimtar në mbledhjen e saj të 15 prillit vendosi të mblidhet ky kongres me rëndësi të madhe në historinë e popullit tonë. Sikundër e shënon dhe rezolucioni i Këshillit që po ju bashkangjitem e që do t'ju shërbejë për zgjedhjen e delegatëve, mbledhja e këtij kongresi ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Nga ky kongres do të dalë Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar. Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe qeveria provizore, që do të dalin nga ky kongres, do të kenë një reperkusion të madh, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë. Këto do t'i japin një hov të madh luftës sonë dhe marrëdhënjet tona me aleatët do të forcohen.

Për këto arsye gjithë shokët e Partisë duhet të vënë forcat e tyre që të sigurohet sukcesi i plotë në këtë punë. Varet nga ne që të zgjidhen delegatë të provuar në luftë, në radhë të parë anëtarë të Partisë, simpatizantë dhe miq të luftës. Të derdhet nga ana e gjithë shokëve një aktivitet i jashtëzakonshëm si nga Partia ashtu edhe nga organizata e Rinisë Komuniste dhe tok me këshillat nacional-çlirimtare të mobilizojnë gjithë popullin (në zonat e çliruara) dhe ky të marrë pjesë gjerësisht ndër mitingje. Të popullarizohet kongresi dhe të bëhet agjitacion në shkallë të gjerë me anë mbledhjesh dhe konferencash si edhe me anë mitingjesh, ku të marrë pjesë dhe ushtria. Në këtë mënyrë populli, që do të mblidhet në mitingje për të zgjedhur delegatët, të jetë i përgatitur për këtë eveniment me kaq rëndësi. Në vendet e çliruara të popullarizohet kongresi me anë shtypi dhe afishesh, të cilat të mbulojnë muret e fshatrave e të qyteteve që mund të jenë çliruara.

Që të evitohen gabimet, duhet të këndohen me vërejtje rezolucioni dhe letrat përcjellëse nga ana e Kryesisë dhe shokët që bëjnë pjesë në këshilla të sqarojnë ndër anëtarët e këshillave brendinë e këtij rezolucioni, që kështu të sigurohet sukcesi brenda afatit të caktuar. Nga ana tjetër anëtarët e Partisë dhe gjithë organizatat duhet të ndihmojnë me sigurinë më të madhe përcjelljen e delegatëve të vendeve të ndryshme për në zonat e lira. Çdo komitet qarkor të interesohet veçanërisht për delegatët e vendeve, për të cilët ju bashkangjitet letra. Ju theksohet edhe një herë rëndësia e çështjes dhe nuk lejohet asnjë shmangje ose neglizhencë për këtë punë me kaq rëndësi.

Gjithë komitetet qarkore duhet të na dërgojnë listën e anë-

tarëve të Partisë në terren dhe në ushtri tok me karakteristikat e tyre. Të na dërgohet gjithashtu lista e shokëve që bëjnë pjesë në komitete të Partisë dhe të rinisë tok me karakteristikat e tyre. Ata qarkorë që na i kanë dërguar këto lista të kenë kujdes që çdo muaj të na japin shënime për ata anëtarë të rinj që hyjnë në Parti dhe për ata që përjashtohen si edhe për ndonjë vërejtje që mund të kenë për ndonjë anëtar partie.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të Partisë  
Komuniste të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E ORGANIZATAVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

[Prill 1944]

GJITHË ZËVENDESKOMISARËVE TË BRIGADAVE,  
GRUPEVE E BATALIONEVE SI DHE  
SEKSIONEVE POLITIKE

Partia jonë, me qëndrimin e drejtë në luftë, me punën e saj organizative e politike, ka mundur të krijojë një ushtri të rregullt. Që kjo ushtri të jetë e fortë për të përballuar çdo vësh-tirësi, çdo reaksion dhe të mos lëkundet nga asnjë propagandë e armikut, që të përgatitet për t'u lidhur gjithmonë me ngushtë me Partinë tonë dhe që të jetë forca vendimtare për realizimin e qëllimeve tona, duhet të bëhet sa më shumë punë politike dhe organizative; duhen pasur organizata partie të forta me kuadro partie besnike, të dhëna e të afta me udhëheqë lëvizjen nacional-çlirimtare. Kështu, duke pasur organizatat të forta, do ta kemi dhe ushtrinë të fortë; kështu do të shfaqet roli udhëheqës i Partisë sonë si parti e vetme politike, që i ka treguar popullit rrugën e drejtë dhe që i prin sot me sukses në luftë.

Me zgjerimin e Luftës nacional-çlirimtare, me krijimin e konditave të reja, organizatave tona në ushtri u hapet një fushë e gjerë veprimi dhe u paraqiten detyra të reja. Organizatat në ushtri dhe anëtarët duhet të realizojnë rolin udhëheqës të Partisë, duhet të punojnë për lartësimin dhe vetëdijen politike të luftëtarëve, duhet të përgatitin një ushtri të fortë, të çelniktë dhe të vendosur. Në broshurën «Ushtria Nacional-Çlirimtare»<sup>1</sup> është paraqitur mënyra e punimit të Partisë në ushtri. Por janë bërë disa gabime nga mungesa e eksperiencës, prandaj e gjejmë të nevojshme të bëjmë disa plotësime dhe të paraqitim në mënyrë të qartë punën e Partisë në njësitë ushtarake që të mos

<sup>1</sup> Referat i mbajtur në Konferencën e parë të Vendit të PKSH.



përsëriten më gabimet dhe shokët të orientohen mirë në zbatimin e detyrave të tyre.

Kanë qenë disa moskuptime që e kanë penguar punën:

1) Nuk është kuptuar mirë roli udhëheqës që duhet të ketë Partia në ushtri.

a — Nuk është kuptuar mirë se komisarët politikë janë delegatë të Partisë, të cilët përpara popullit, dhe përpara njësisë ushtarake do të mbrojnë vijën e caktuar nga Partia jonë ndaj Luftës nacional-çlirimtare. Komisari politik bën pjesë në celulën e shtabit. Ky për të kryer plotësisht rolin e tij do të ketë përkrahjen e celulës në të cilën bën pjesë dhe me ndihmën e së cilës ai do të kryejë detyrën. Ky nuk mund të veprojë në emër të celulës ose të forumit përgjegjës pa marrë udhëzime dhe direktiva nga këto.

b — Nuk është kuptuar roli udhëheqës që duhet të ketë celula, byroja në batalion dhe forumet e tjera udhëheqëse të Partisë në njësitë më të mëdha dhe marrëdhënja e tyre me shtabet përkatëse.

c — Nuk është kuptuar mirë qëndrimi që duhet të kenë të gjithë anëtarët e Partisë në çetë. Këta duhet të dallohen nga të gjithë luftëtarët e tjerë, duhet të jenë shembull i trimërisë dhe i vendosjes. Me trimërinë, me vendosjen dhe me diturinë e tyre do të lartësojnë moralin e luftëtarëve dhe në konditat më të vështira nuk do të lejojnë demoralizimin dhe shpërndarjen e ushtrisë. Duhet të kujdesen më parë për partizanët pastaj për veten e tyre. Duhet të jenë shembull i durimit përpara çdo vuajtjeje, përpara urisë, lodhjes, reaksionit etj. Kur partizanët janë në një gjendje të vështirë, kur janë të plagosur, anëtarët e Partisë do të jenë të parët për t'u ardhur në ndihmë. Këta duhet të kenë marrëdhënje të ngushta dhe shoqërore me partizanët. Moskujdesia, kapadaillëku, arroganca i pengojnë këto lidhje dhe e bëjnë të zorshme dashurinë e luftëtarëve për ta. Vetëm duke vepruar kështu do të fitojnë dashurinë dhe besimin e partizanëve ndaj tyre, do të dallohen nga gjithë luftëtarët e tjerë. Mbi gjithë të tjerët do të jetë komisar politik, ai do të ketë cilësitë e sipërme, për të shoku Stalin ka thënë: «Komisari është udhëheqësi moral e politik i repartit të tij, mbrojtës i parë i interesave morale e shpirtërore... Komisar duhet të jetë babai e shpirti i repartit të tij»<sup>1</sup>.

2) Nuk është kuptuar rëndësia e madhe që ka kryerja e punës politike dhe organizative në ushtri.

Duhet të kemi gjithmonë parasysh dhe të ruajmë që vija ushtarake mos të dalë mbi atë të Partisë, d.m.th. anëtarët e Partisë

<sup>1</sup> Shih: «Josif Visarionoviç Stalin». Biografi e shkurtër. Tiranë, 1945, f. 41.

që kanë përgjegjësi ushtarake në njësinë, nuk duhet të kryejnë vetëm atë detyrë dhe të lënë pas dore detyrat e tyre të Partisë. Ndodh shpeshherë që disa njësi ushtarake si të tilla janë shumë të mira, por neglizhojnë anën politike të punës, luftëtarët zhvillohen vetëm nga një anë, ushtarakisht. Kjo gjë do të shkaktojë që në disa situata të vështira (si mosuksese në luftë, lodhje, mungesë ushqimi) propaganda e armikut ose e shpirtvegjëlve të sjellë rezultate të këqia.

3) Nuk është kuptuar rëndësia që ka kryerja e punës me plan.

Duhet që çdo punë të kryhet me një plan të caktuar; celula, byroja (krejt brigada), do të caktojnë planin që duhet të plotësohet nga mbledhja në mbledhje ose për një kohë më të gjatë. Në krejt njësinë (në kompani, batalion ose brigadë) duhet që puna të vazhdohet harmonikisht në çdo sektor dhe në çdo pjesë të njësisë, p.sh. nuk duhet të shkojë përpara puna në rini dhe të mbetet pas dore ajo politike ose në një batalion të shkojë puna shumë përpara dhe në një tjetër jo. Po të punohet me një plan të përbashkët, (në krejt njësinë do të punohet po një temë, do të rrihen po ato çështje, do të shpjegohet po një lëndë edukative etj.), atëherë realizohet uniteti i vërtetë në njësinë ushtarake.

Nuk është punuar me një plan të afërt ose të largët. Puna me plan do të shtojë aktivitetin e anëtarëve, do të forcojë kontrollin në punë, do të sigurojë zbatimin e përpiktë të direktivave dhe të udhëzimeve të Partisë e të forumeve përkatëse.

Përveç moskuptimeve që kanë qenë, janë bërë edhe disa gabime në punë.

Shpesh organizatat kanë qenë sektare në rekrutimin e anëtarëve. Lufta jonë, puna në situata të vështira dhe përpjekjet e vazhdueshme duhet të na kenë dhënë një kriter në rekrutimin e anëtarëve. Nuk duhet të kemi frikë të futim në Parti ata që janë me të vërtetë një garanci për ne, por nuk janë të lartësuar ose kanë disa të meta. Këta elementë do të lartësohen me punën tonë, do të përmirësohen me edukatën tonë. Organizatat tona në ushtri do të mbeten të dobëta në rast se do të mungojë puna organizative dhe nuk do të punohet në mënyrë që të rekrutohen elementë të dalë nga lufta dhe të lartësohen këta në çdo pikëpamje.

Në disa njësi ushtarake (brigada) përgjegjësa celule kanë qenë komisarët politikë të kompanive dhe kjo jo pse mungonin anëtarët e tjerë, por sepse komisar politik ishte shoku më i mirë dhe më i përgatitur. Kjo ka bërë që puna organizative të mos shkojë shumë përpara, sepse komisar politik ka shumë përgjegjësi dhe nuk mund t'i kryejë të gjitha siç duhet, gjithashtu kjo ka penguar që të ngrihen dhe të tjerë anëtarë dhe të fitojnë eksperiencë në punë. Edhe shokët e rinj, megjithëse nuk dinë të punojnë, duhet t'i ngarkojmë me përgjegjësi dhe t'i udhëzojmë si të punojnë.

Janë bërë dhe disa lëshime, të cilat me sqarimet që do të japim dhe me një aktivitet më të madh të shokëve, nuk do të përsëriten më. Të tilla janë sidomos mbledhja jo në rregull e celulave, moslartësimi i duhur i anëtarëve të Partisë, mungesa e kontrollit në kryerjen e detyrës etj.

Që të shkojë përpara puna organizative dhe ushtarake duhet celulat e shtabeve të dinë detyrat e tyre dhe marrëdhënjet që kanë me shtabet përkatëse.

*Celula e shtabit.* — Në celulën e shtabit bëjnë pjesë: komandanti, zëvendëskomandanti, komisar, zëvendëskomisar, intendent, përgjegjësi i agjit-propit, oficeri operativ, përgjegjësi i sanitetit, oficeri i informatave, por kjo nuk duhet të kuptohet në mënyrë të prerë. Nuk futen në celulë intendentit ose të tjerë në qoftë se nuk janë në atë lartësi për të qenë anëtarë të celulës së shtabit, p.sh. kur janë anëtarë të futur rishtas në Parti ose edhe kur janë të vjetër, por nuk janë në gjendje të ndihmojnë punën e celulës së shtabit, por përkundrazi e pengojnë.

Partia ose forumi superior i Partisë direktivat, udhëzimet e Partisë etj. i zbaton nëpërmjet të celulës në shtab. Për punën e tyre në vijën ushtarake, anëtarët e shtabit janë përgjegjës para komandës ushtarake më të lartë. Por anëtarët e shtabit që janë edhe anëtarë partie për gjithë punën e tyre janë përgjegjës edhe përpara Partisë. Në qoftë se në atë njësi ka funksionarë të Partisë (delegatë të Komitetit Qendror) këta marrin pjesë në celulën e shtabit kur ta gjejnë më të nevojshme. Në këtë rast do të jetë ky që do të japë vijën e Partisë. Shokët, anëtarë të shtabit, duhet të dinë se në celulë janë vetëm anëtarë të thjeshtë. Janë përgjegjës për punën e tyre përpara celulës, janë të detyruar të jenë të gjithë të disiplinuar dhe duhet të dinë se pa pëlqimin dhe dijeninë e celulës, nuk mundet të veprojnë. Anëtarët duhet të tregojnë karshi komandantit dhe komisarit nderimin e duhur të një ushtari të thjeshtë. Të gjitha urdhërat e komandantit dhe të komisarit shokët do t'i zbatojnë në mënyrë kategorike. Komandanti dhe komisar në celulë janë anëtarë të thjeshtë, zëvendëskomisar është anëtar i thjeshtë në njësinë. Kjo është marrëdhënja e drejtë ndërmjet shtabit dhe celulës, e kjo duhet të kuptohet mirë.

Vihet re se shumë shokë kujtojnë se celula e shtabit nuk është e nevojshme, por kjo pikëpamje është e gabuar. Shokët anëtarë të shtabit duhet të mësohen ta shikojnë jetën e batalionit dhe të shtabit në prizmin e Partisë dhe kanë nevojë të domosdoshme për lartësimin e tyre teorik e politik.

Detyra e celulës është të interesohet që të zhvillojë iniciativën në shtab, përta, përta e përta çështjes së aksioneve. Është detyra e shokëve të Partisë që ta përgatitin udhëheqjen e shtabeve të jetë e zonja për luftë, të jetë shembull i guximit dhe i disiplinës. Është

detyrë e celulës që të ngrejë e të forcojë autoritetin e shtabit dhe të anëtarëve të tij.

Në celulën e shtabit punohet si në çdo celulë tjetër partie dhe duhet sidomos kujdes që të ngrihen nga çdo pikëpamje anëtarët e celulës. Në celulën e shtabit çdo shok ka një sektor pune, p.sh. komisar ka përsipër zbatimin e vijës politike dhe ngritjen politike në përgjithësi, intendent merret me çështjet e ushqimeve etj. Për zbatimin e punës në sektorin e tyre bëjnë raportin në celulë dhe japin llogari për punën e tyre. Të gjithë anëtarët e celulës duhet të bëjnë kritikën e autokritikën e punës së tyre që ka të bëjë me mbarëvajtjen e punës së Partisë. Të gjitha propozimet rreth punës së organizatës së Partisë në batalion kjo celulë i jep nëpërmjet byrosë së Partisë (zëvendëskomisarit të batalionit), në brigadë nëpërmjet të zëvendëskomisarit të brigadës. Në mbledhjen e celulës i caktohet puna çdonjërit dhe në mbledhjen tjetër i kërkohet llogari për punën e kryer. Përta u përket planeve ushtarake, këto bisedohen veç prej komandës operuese. Për zbatimin e planit të caktuar jepet raporti në mbledhjen e celulës.

Shokët anëtarë të shtabit, para se të marrin ndonjë masë, duhet ta diskutojnë më parë këtë në celulë. Të gjithë anëtarët e celulës duhet të përkrahin mendimin dhe vendimin e shtabit, se ky është njëkohësisht dhe mendimi i tyre. Po të mos veprohet kështu, do të përfundojë që shtabi të mos mund të zbatojë masat e marrura, që të prishet uniteti i punës në mes të celulës dhe shtabit dhe që të mos realizohet roli udhëheqës i Partisë. Një lidhje e këtyllë ndërmjet masave që merr shtabi dhe celulës është sidomos e domosdoshme kur ka elementë fraksionistë, kur janë influenca të huaja, ndaj të cilëve celula e Partisë mund të caktojë qëndrimin e duhur.

Organizata e Partisë në njësi nuk mund të bëhet tutore e shtabit. Raporti duhet të jetë i atillë që Partia të jetë me të vërtetë udhëheqëse, por kjo gjë të mos guxojë të çënojë autonominë dhe iniciativën e komandës ushtarake, por vetëm të sigurojë zbatimin e direktivave të Partisë; nga ana tjetër komanda ushtarake të ketë mbështetjen dhe ndihmën e sigurtë për të gjitha çështjet e organizatave të Partisë si të faktori udhëheqës i Luftës nacional-çlirimtare.

Që të mund të realizohet roli i Partisë në çetë duhet që të ndihmohet puna e celulës, duhet të zhvillohet pa pushim jeta e Partisë, e kjo arrihet vetëm me organizimin e drejtë e të fortë të celulës komuniste.

*Celula e Partisë.* — Të gjithë anëtarët e Partisë në një çetë formojnë një celulë, kjo është njësi e Partisë në ushtri, një çetë — një celulë. Në qoftë se ka shumë anëtarë partie, celula mund të ndahet në grupe, por këto prapë mbeten të një celule dhe udhë-



heqës kanë po atë përgjegjës (grupet mund të formohen sipas togave e kjo ndodh kur kompania ka një numër të madh luftëtarësh).

Puna e celulës duhet të organizohet sipas sektorëve të punës së Partisë dhe në mënyrë që për çdo sektor të caktohet një shok përgjegjës që organizon punën në atë sektor e përgjegjet para celulës për sukseset ose mosesukseset. Nuk duhet të ketë specializim në punë, por të gjithë shokët duhet të punojnë në të gjithë sektorët e të fitojnë kështu eksperiencën e çdo pune partie. Puna e celulës duhet të organizohet gjithmonë duke pasur parasysh perspektivën e zhvillimit e punës në sektorët e caktuar, duke llogaritur që puna të zhvillohet në mënyrë harmonike nga të gjithë sektorët.

*Puna organizative.* — Të gjithë luftëtarët do të organizohen në grupe të ndryshme. E gjithë kompania duhet të jetë një grup edukativ, por meqenëse kjo është pak e zorshme, formohen dy ose më shumë grupe të Partisë (edukative), për edukimin e të cilave caktohet një shok përgjegjës në celulë për këtë punë; në qoftë se ky nuk ka mundësi ta kryejë këtë detyrë vetëm, caktohen më shumë. Me luftëtarët më të mirë dhe me ata që mund të bëhen më shpejt anëtarë partie punohet në mënyrë individuale, këta edukohen prej një ose më shumë shokëve të celulës, sipas mundësive dhe si të gjendet më e arësyeshme nga celula. Kur celula bën mbledhjen edukative, atëhere është mirë që të marrin pjesë edhe kandidatët e Partisë, por kjo të kuptohet mirë dhe jo të merret një numër i madh luftëtarësh në mbledhjen edukative të celulës.

Kur nuk ka celulë në kompani duhet të përpiqemi që të krijohet kjo sa më parë.

Në punën organizative çështja kryesore është që njësia të jetë krejt e organizuar. Çdo luftëtar duhet të marrë pjesë në ndonjë grup në qoftë se nuk është anëtar partie. Kur nuk ka celulë në kompani, atëhere merren ata luftëtarë që mund të bëhen më shpejt anëtarë partie dhe formohet një grup kandidatësh, çdonjërit i caktohet përgjegjësia e një sektori pune. Duhet të punohet shumë për lartësimin e tyre politik dhe teorik. Kur të jenë pregatitur për anëtarë partie atëhere transformohet grupi në celulë e nuk është nevoja të krijohet një grup tjetër, sepse do të mbetet si një celulë e dytë pranë celulës kryesore.

Në punën individuale duhet të mos harrohet që të punohet me të vjetërit, me ata të cilët nuk bëjnë pjesë as në grupet e rinisë dhe as në të Partisë. Këta kërkojnë një sjellje të veçantë dhe mënyra edukimi të ndryshme. Me këta duhet të shpjegohet situata politike në mënyrë të thjeshtë, të punohen disa artikuj, ata më aktualët dhe ata që u përshtaten më shumë atyre. Me anëtarët e

grupeve edukative, dhe sidomos me kandidatët, duhet të zhvillohet një punë intensive politike dhe edukative, në mënyrë që këta të lidhen sa më ngushtë me Partinë tonë, të ngjallet në ta dhe të forcohet besimi dhe dashuria ndaj Partisë. Në punën e celulës bëhet kritika dhe autokritika. Jo vetëm kritika e punës, por edhe ajo e qëndrimit dhe e jetës personale të çdo anëtari, të vetive të mira ose të të metave të tij, se vetëm kështu zhvillohet përgjegjësia e plotë e anëtarëve karshi Partisë.

Në mjaft njësi si batalione e brigada, ku ka luftëtarë të mirë e të vendosur, ka një numër fare të paktë anëtarësh partie. Këtu shihet mungesa e punës sonë organizative dhe pikëpamja sektare në rekrutimin e anëtarëve. Nuk duhet të jemi sektarë, por të jemi të guximshëm në rekrutimin e anëtarëve të rinj në Parti; nuk duhet të mendojmë se duke futur shumë në Parti do ta dobësojmë këtë. Partinë e dobësojmë nga puna jonë e paktë dhe e paorganizuar. Por nga ana tjetër nuk duhet të mendojmë se do t'i hapim dyert e Partisë nga të dy anët dhe të futim këdo. Duhet të rekrutojmë me një kriter të caktuar: të futim në Parti punëtorë, fshatarë, intelektualë të shëndoshë, të ndershëm e luftëtarë, elementë të vendosur, që e duan Partinë, që janë punëtorë dhe që kanë mundësi të shkojnë përpara etj. Organizatat i kemi të dobëta, sepse nuk kemi rekrutuar me kriter dhe ata që i kemi futur, nuk jemi përpjekur t'i lartësojmë.

Bëhen disa përjashtime pa vend. Anëtarët për të metat, për gabimet e tyre kritikohen, u hiqet vërejtja, këshillohen dhe bëhet çmos për përmirësimin e tyre; kur janë të pandërgjegjshëm atëhere përjashtohen. Përjashtimet e shumta, dezertimet etj. tregojnë mungesën e punës sonë organizative dhe moszgjuarësi në punë.

Duhet kujdes i madh që të spastrohen radhët e Partisë. Nuk duhet të ketë vend në celula, në ushtri për elementë fraksionistë, inaktivë, të dyshimtë dhe sidomos frikacakë. Spastrimi i radhëve e forcon Partinë.

*Puna me rininë.* — Në celulë caktohet një shok, i cili ka për detyrë të udhëzojë, të ndihmojë punën e rinisë, ka për detyrë të zbatojë vijën e Partisë në rini dhe për këtë është përgjegjës para celulës. Në një çetë ka vetëm një aktiv, që drejtohet prej një përgjegjësi, i cili është një i ri komunist që ka eksperiencë në punën e rinisë ose anëtar i Partisë, përgjegjës i rinisë në celulë. Përgjegjësi i aktivit, qoftë i ri komunist, qoftë anëtar i Partisë, udhëzohet prej komitetit të rinisë në batalion dhe i jep llogari komitetit për punën e tij që ka kryer. Anëtari i Partisë, përgjegjës i rinisë, raporton punën e tij që bën me rininë në celulë. Aktivi i rinisë është njëkohësisht dhe grup edukativ, por kur ka mundësi është mirë që të bëhen dy ose më shumë grupe edukative. Për edukimin e këtyre të rinjve kujdeset komiteti i rinisë në batalion



dhe ndihmohet për këtë punë nga celula. Rinisë duhet t'i jepen mundësitë për t'u lartësuar, për t'u pajisur me njohuritë marksiste-leniniste etj. Rinia Komuniste në ushtri, duhet të punojë gjithashtu në prapavijat me të rinj duke organizuar bashkimin e të rinjve, çetat e punës, mobilizimin e të rinjve, duke krijuar çeta të ndryshme etj. Ajo duhet të ndihmojë dhe në punë organizative, duke formuar organizatat e Rinisë Komuniste, në rast se kjo nevojë paraqitet nga organizatat e qarqeve.

*Komitetet e rinisë.* — E gjithë rinia komuniste që është në çetë duhet të organizohet; për këtë arsye është nevoja të krijohen komitetet e rinisë. Këto formohen prej shokëve që kanë më shumë eksperiencë në punën e rinisë (do të jenë në gjendje të udhëzojnë më mirë ata shokë, të cilët kanë qenë në terren anëtarë komiteti qarkor të rinisë; këta mund të jenë anëtarë të komiteteve të rinisë edhe në qoftë se kanë ndonjë përgjegjësi ushtarake: komisar dhe zëvendës; ky është një rast i rrallë). Komitetet e rinisë megjithëse do të kenë iniciativë të plotë në punën e tyre, do të udhëzohen dhe do të udhëhiqen nga forumet e Partisë e do të japin llogari për punën para tyre. Anëtarët e komitetit kanë lidhje direkte me përgjegjësit e aktiveve dhe me edukatorët e grupeve të rinisë, të cilët i udhëzojnë në punë dhe u kërkojnë raportin e punës. Megjithëse formohen komitetet e rinisë, përgjegjësi i rinisë do të jetë në byronë e Partisë. Përgjegjësi i rinisë në byronë e batalionit merr pjesë në komitetin e rinisë. Komiteti i rinisë ka lidhje dhe merr udhëzime nga zëvendëskomisari i batalionit (të kuptohet që kjo është një lidhje dhe udhëzim indirekt). Komitetet e rinisë të batalioneve udhëzohen dhe kanë lidhje direkte me komitetin e rinisë në brigadë.

*Puna politike, kulturalo-arësimore.* — Siç u theksua edhe më lart, nuk është punuar si duhet për lartësimin e luftëtarëve si edhe të kadrove të Partisë. Për këtë arsye shpeshherë ka ndodhur që në situata të vështira kanë dezertuar partizanë, gjithashtu dhe anëtarë partie nuk kanë mbajtur qëndrimin e duhur. Anëtarë partie disa herë nuk kanë mbajtur qëndrim politik të drejtë. Për këto e për të tjera raste është e domosdoshme në çetë puna politike kulturalo-arësimore, e cila ka për qëllim të shtojë dijenitë e përgjithshme dhe vetëdijen politike të luftëtarëve dhe me këtë të ndërtohet uniteti i fortë moral e politik i njësisë. Nga realizimi i unitetit politik dhe moral varet dhe aftësia e uniteti luftarak, pse njësisia, pa realizimin e unitetit moral e politik, nuk do t'u përgjigjet dhe detyrave të veta në pikëpamje ushtarake. Celula, pra, duhet t'i japë rëndësi këtij sektori pune, duhet të zhvillojë një punë intensive politike — punën kulturalo-arësimore duhet ta zbatojë Rinia Komuniste, duke i dhënë rinisë mundësinë që të zhvillojë inisia-

tivën e vet në këtë punë. I gjithë materiali politiko-arësimore duhet të punohet në çetë dhe, kur ky mungon, anëtarët duhet të pregatitin referate dhe këto të mbahen në konferenca të çetës.

Për këtë punë janë të domosdoshme konferencat, kurset e ndryshme dhe orët e mësimi. Në këto do të punohen tema që janë më aktuale e që u interesojnë më tepër luftëtarëve.

*Puna ushtarake.* — Celula duhet të nxjerrë eksperiencë nga lufta, të mësojë taktikën e luftës, të lartësojë udhëheqjen ushtarake. Me punën dhe me stërvitjet ushtarake duhet të mësohen luftëtarët që të përdorin armët e ndryshme, të përdorin të gjitha mjetet e luftës. Duhet të hiqet nga të gjithë ideja e gabuar se ne nuk kemi nevojë për ushtrime. Me anën e ushtrimeve partizani mëson jo vetëm të zotërojë armën, por forcohet dhe disiplina e puna në çetë. Me një punë ushtarake të mirë shtohet aftësia e çetës dhe e çdo individi për luftë, pregatiten dhe lartësohen udhëheqës të rinj ushtarakë. Këtë e drejton kryesisht udhëheqja ushtarake, shtabi, ndërsa celula duhet ta ndihmojë shtabin në këtë punë. Puna politiko-arësimore e kombinuar me atë ushtarake do të na japin njësi të forta, të shëndosha e të disiplinuar, të afta për të kryer aksione luftarake e politike.

*Puna në terren.* — Edhe këtë celula e ka si sektor pune. Celula e Partisë duhet ta bëjë të aftë e të lartësojë të gjithë çetën në nivelin e agjitorit në bazë të vijës së Luftës nacional-çlirimtare. Që të mund të kryejë detyrat e saj në terren me sukses, celula duhet të dijë gjithë format e punës së Partisë, si punën në rini, organizimin e këshillave nacional-çlirimtare, detyrat e bashkimit të rinisë, punën me gra etj. Përsa u përket konferencave në popull e mitingjeve, shokët e dinë se e kanë kurdoherë një detyrë që duhet ta kryejnë; për punë organizative do të punojnë vetëm atëherë kur dërgohen ose udhëzohen nga udhëheqësit e tyre. Për punën e kryer në terren celula duhet të kërkojë llogari për çdo anëtar.

*Byroja.* — Është udhëheqësja e Partisë në batalion. Byroja është përgjegjëse për marrëdhënjet në mes të Partisë dhe të komandës, për realizimin e rolit udhëheqës të Partisë. Byroja duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë forcimit të organizatave të Partisë, lartësimi të kadrove dhe pranimit të anëtarëve të rinj në Parti. Byroja duhet të kontrollojë punën e celulave, t'u japë atyre ndihmën, udhëzimet, direktivat e të ngrejë në një shkallë të denjë përgjegjësinë e celulës përpara Partisë dhe atë të anëtarëve para celulës. Gjithashtu ajo duhet të interesohet që puna e Partisë të zhvillohet pa u prerë, të zhvillohet në mënyrë harmonike në çdo sektor. Duhet të interesohet që në punë të mos ketë pengesa,

që asnjë celulë të mos mbetet prapa të tjerave në punë. Byroja cakton një plan, të cilin e konkretizon celulari në kompaninë e vet.

Për t'u plotësuar puna siç duhet në të gjithë sektorët, duhet t'i kushtohet një kujdes i veçantë lartësimi teorik e politik të anëtarëve të Partisë. Lartësimi i kuadrove do të shtojë ritmin në punë dhe do të na sigurojë përfundime më të frutshme. Duhet të ngjallet e të zhvillohet në anëtarë ndjenja e përgjegjësisë karshi Partisë, në mënyrë që të zbatohen me vullnetin më të madh udhëzimet dhe direktivat e Partisë. Për këtë lartësim përveç broshurave e lëndëve të tjera edukative, është e domosdoshme të punohet në celulë material aktual i Partisë, proklamatat e Komitetit Qendror, të forumeve të tjera të Partisë, ndonjë artikull politik nga «Zëri i Popullit», nga «Bashkimi» ose nga ndonjë revistë tjetër. Ky material do të punohet patjetër, se është garancia më e mirë që udhëzimet e direktivat e Partisë të kuptohen më mirë.

Me një udhëheqje të drejtë dhe me një aktivitet më të madh të anëtarëve, do të forcohen organizatat e Partisë në ushtri, do të spastrohen nga elementët e sëmurë, do të shtohen radhët e Partisë me punëtorë, fshatarë, intelektualë të shëndoshë, të ndershëm e luftëtarë, që janë gati t'i përballojnë gjithë vështirësitë e punës dhe të luftës, do të lartësohen kuadrot dhe kështu do të zbatohet vija që ka caktuar Partia; kështu të gjitha organizatat në ushtri do të kryejnë siç duhet të gjitha detyrat që u ngarkon Partia.

[Për Komitetin Qendror të PKSH

*Enver Hoxha*]

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

*Botuar për herë të parë:  
«Enver Hoxha. Vepra,  
vëllimi 2». Tiranë, 1968*

## THIRRJE E KOMITETIT QENDROR TË PKSH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E DITËS SË 1 MAJIT

1 Maj 1944

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

POPULL SHQIPTAR!

PUNËTORË, FSHATARË E QYTETARË!

Dita e [1] Majit, simbol i përpjekjeve vigane e të përgjakshme të popullit punëtor kundër shtypësve gjakpirës i gjen botën dhe popujt përparimtarë në përleshjen më të ashpër me fashizmin gjerman, shkelësin e të drejtave dhe të lirive të popujve. Kjo ditë feste e të gjithë popujve e gjen Ushtrinë heroike të Bashkimit Sovjetik të mbuluar me lavdi; armatat e kuqe po spastrojnë tokat e tyre me një heroizëm të papërshkrueshëm dhe po marshojnë drejt zemrës së Rumanisë, Hungarisë, Çekosllovakisë. Ofensiva e madhe e Ushtrisë së Kuqe paralajmëron suksese të reja dhe e bën shkatërrimin vendimtar të Gjermanisë hitleriane një çështje konkrete. Ushtria e Kuqe lavdiplote, e udhëhequr prej prisit dhe strategut gjenial, Stalinit, sot në këtë ditë feste popullore, duke shikuar me gëzim fitimet e tre vjet lufte, po shkon nga fitorja në fitore drejt shkatërrimit të plotë të fashizmit dhe e ndërëgjegjshme, ajo është duke kryer jo vetëm detyrën e shenjtë për të çliruar tokat e veta, por edhe popujt e robëruar të Evropës. Aviacioni anglo-amerikan, që ka marrë këto kohët e fundit proporcione të mëdha, po shkatërron sistematikisht qendrat kryesore industriale e strategjike të fortesës naziste. Aleanca ushtarake anglo-sovjeto-amerikane po forcohet dhe fronti i dytë që po përgatitet dita-ditës, qëndrojnë si shpata mbi kryet e Gjermanisë. Dita e 1 Majit i gjen popujt e robëruar në një luftë kryengritëse dhe në ofensivë të ashpër e të paprerë kundër okupatorit të vendit të tyre. . . Dita e [1] Majit e cila bashkon sot interesat e punëtorëve të vendit tonë me ato të krejt popullit shqiptar, e gjen këtë në këmbë dhe me

armë në dorë të luftojë me ashpërsi shkelësin e vendit të tij dhe kjo ditë Maji do të sjellë me vete për popullin tonë, që lufton heroikisht, frutet e aq sakrificave e të gjakut të kulluar që ka derdhur për çlirimin e Shqipërisë.

#### POPULL SHQIPTAR!

Kur hordhitë e Gjermanisë hitleriane dhe të fashizmit italian, me urë në dorë po i vinin zjarr gjithë Evropës, këmishët e zeza të Musolinit dhe milicët e Shefqet Vërlacit e të Mustafa Krujës, po mbillnin në atdheun tonë kob e zi. Ekzistenca jonë, tokat tona të vaditura me djersën dhe me gjakun e popullit fatkeq, kërcënoheshin të bëheshin prona e imperialistëve fashistë dhe e hyzmeqarëve të tyre. I shtypur, por i papërkulur, i hedhur në katastrofë nga regjimi tradhëtar i Zogut, por i pathyer, populli shqiptar grumbulloi energjitë e veta dhe u rreshtua krah për krah me popujt e tjerë liridashës në luftën çlirimtare të popujve. Në valën më të madhe të terrorit, që shpërtheu fashizmi italian dhe veglat e tija tradhëtare, Partia Komuniste Shqiptare, e përbërë nga bijtë më të ndershëm e më të vendosur të popullit tonë, ishte ajo që lëshoi zërin e kushtimit, që i bëri thirrje popullit shqiptar të rrokte armët për të luftuar zaptuesin e huaj, për të mbrojtur nderin, zakonet, pasurinë dhe për të fituar lirinë dhe independencën e vendit të vet. Anëtarët e Partisë Komuniste u hodhën në zjarrin e luftës dhe i dhanë të kuptojë popullit shqiptar se shpresat nuk humben dhe se për të fituar lirinë, duhej derdhur gjak, duheshin sakrificat dhe vetëmohim. Qindra e qindra anëtarë të Partisë, që ranë heroikisht në fushën e nderit u bënë pishtari i luftës çlirimtare. Bijtë e shqipes, pasardhësit e patriotëve të vjetër, të cilët me luftën e tyre e kanë mbajtur lart emrin e shqiptarit, ju përgjegjën thirrjes së Partisë Komuniste Shqiptare dhe i bashkuan forcat e tyre në Frontin e përbashkët Nacional-Çlirimtar.

Fronti Nacional-Çlirimtar u ngrit si një kështjellë e pathyeshme në mes të rrebeshit fashist, u rrit dhe u forcua në luftë e në përpjekje; gjaku i patriotëve që derdhej në male e qytete e ngriti lart emrin e shqiptarit. Malet u mbushën me luftëtarë, krisma e pushkës çlirimtare u dëgjua nga të katër anët e Shqipërisë dhe populli ynë fitonte dita-ditës besimin në forcat e veta. Burgimet, internimet, vrasjet dhe litari, që përdori armiku, nuk i trembën djemtë tanë, nuk e përkulën popullin shqiptar. Lufta jonë dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare, që çdo ditë plotësohej me djemtë më të zgjedhur të kësaj toke, u kallë drithmën okupatorit dhe shërbëtorëve të tij. Këta shihnin në luftën tonë vdekjen e tyre dhe me çdo kusht e me çdo mënyrë ndërnuarën veprat e tyre të poshtra që shkaktuan kaq gjakderdhje. Krahas me okupatorin

italian, më parë, dhe me fashizmin gjerman më vonë, doli në shesh gjithë ndyrësia e vendit tonë; tradhëtarët, që kurdoherë kishin luajtur me fatin e popullit për interesat e tyre të ndyra personale, luajtën rolin më të zi në dëm të luftës së shenjtë, në dëm të atdheut dhe të popullit. Këta tradhëtarë që nën maskën e nacionalizmit e të demokracisë fshihnin fytyrën e ndyrë të reaktionit tradhëtar dhe gjakpirës, formuan «Ballin Kombëtar» me tradhëtarët Lumo Skëndo, Ali Këlcyra, Hasan Dosti e tjerë, këta ndërnuarën bashkë me okupatorin veprën tradhëtare për të shuajtur luftën që bënte populli shqiptar, për ta mbytur këtë në gjak dhe për ta ndihmuar okupatorin në veprën e tij shfarosëse për popullin tonë. «Balli Kombëtar» u përpoq të përçante popullin, të shuante lëvizjen partizane me anë të parullave të tija pseudonacionaliste e pseudodemokrate duke akuzuar lëvizjen nacional-çlirimtare, si një lëvizje komuniste dhe duke përdorur sharjet dhe shpifjet më të poshtra kundër Partisë Komuniste, shtylla e çelniktë e luftës çlirimtare. «Balli» organizoi, nën bajonetat e armikut çetat e tija mercenare, të cilat i hodhi në luftën vëllavrasëse. Por lufta jonë e ashpër e demaskoi në popull «Ballin Kombëtar», organizatën tradhëtare. Populli shqiptar i gjykoi veprat e «Ballit» dhe pa me sytë e vet fytyrën e katilëve dhe të spiunëve të fashizmit që udhëhiqnin «Ballin» e që gjatë okupacionit bënë çmos me sharje e me shpifje, me demagogji e me armë të shuanin Luftën nacional-çlirimtare.

#### POPULL SHQIPTAR!

Pas robërisë së zezë fashiste italiane vendi ynë kaloi nën thundrën e tmerrshme të imperializmit të gjakosur hitlerian që e inauguroi hyrjen e tij në Shqipëri, duke hedhur të gjallë në flakë foshnjat, gratë dhe pleqtë shqiptarë. Ky armik i egër dhe i regjur në djallëzi përdori gjithë eksperiencën e vet për të shtypur popullin tonë, për të mbytur në gjak e në tmerr lëvizjen heroike nac.-çl. Që prej kuislingut Mehdi Frashëri e deri te «Balli Kombëtar» e «Legaliteti», i gjithë reaksioni shqiptar u grumbullua rreth bajonetave gjermane, rreth Gestapos së përgjakur. Çdo gjë e vunë në shërbim të tradhëtisë dhe për luftën vëllavrasëse. Kaosi dhe anarkia mbretëronin në vendet e okupuara prej tyre dhe kjo gjendje e krijuar apostafat ndihmohej prej terrorit më të zi që shpërthenin kuislingët mbi popullin e pafajshëm e të çarmatosur.

«Balli Kombëtar», vegla qorre e Gestapos, vuri në dispozicion të hapur të armikut bandat e tija katile, të cilat u hodhën si qentë kundër popullit dhe Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Organizata të ndryshme të patronuara nga okupatori dhe «Balli», u krijuan me



qëllim që të mbillnin mjegull në mendjen e popullit, që ta lëkundnin këtë nga besimi i fortë që kishte në Frontin Nacional-Çlirimtar, në Partinë Komuniste. Të tilla ishin «Bashkimi Kombëtar», «Partia Socialdemokrate», «Roja e Drejtësisë»<sup>1</sup> etj. Për t'i dhënë një vrull të ri luftës vëllavrasëse që përgatiti reaksioni e ashtuquajtura «Lëvizja e Legalitetit», doli në skenë me Bazin e Canës në krye. Kjo lëvizje nuk bën tjetër veçse lodrën e armikut. «Legaliteti» dhe njerëzit e tij që hiqen si mbrojtës të atdheut, s'kanë hedhur asnjë pushkë kundër okupatorit. Këta shtrojnë sot, kur Shqipëria ndodhet nën robërinë më të zezë gjermane, çështjen e regjimit të Zogut dhe në vend që të luftojnë gjermanët hitlerianë ata i kanë shpallur luftë popullit shqiptar. Lufta e tyre përmblihet vetëm në apologjinë e regjimit të Zogut dhe me përpjekjet për t'ja imponuar popullit këtë regjim. Por populli shqiptar as nuk rrehet, as nuk trembet, nuk rrehet nga demagogjia e një Bazi të Canës, që gjoja rri në mal, po bën pjekje fshehurazi në rrugën e Krujës me gjeneralin gjerman Shmoll e Xhafer Devën dhe lidh besën me ta, që nuk do të godasin shoqi-shoqin; ai nuk ka frikë nga Zogu dhe nga regjimi i tij tradhëtar pse populli ynë që përballon me aq sukses hordhitë hitleriane nuk do të lejojë kurrë që në vendin tonë të përsëritet koha e vjetër e të shkelë këmba e Zogut, shkaktarit të aq mjerimeve. Populli shqiptar i bashkuar kundër të gjithë këtyre tradhëtarëve, nga të cilët e ka hequr krejt besimin, ndjek rrugën e drejtë që i ka caktuar Fronti Nacional-Çlirimtar në krye të të cilit ndodhet Partia Komuniste Shqiptare.

#### POPULL SHQIPTAR!

Okupatori gjerman dhe reaksioni përpiqen të mbytin lëvizjen nacional-çlirimtare dhe të gënjejnë popullin për ta shkëputur nga lufta e tij. Por e vetmja rrugë e shpëtimit të popullit tonë është rruga që ka treguar Fronti Nacional-Çlirimtar, rruga e luftës. Në këtë rrugë ka hyrë një pjesë e madhe e popullit tonë, e cila me urrejtjen më të madhe dhe me përbuzje u ka kthyer krahët tradhëtarëve të ndyrë. Populli shqiptar ka kaluar në fazën e

<sup>1</sup> «Bashkimi Kombëtar», «Partia Socialdemokrate», «Roja e Drejtësisë». Organizata tradhëtare të krijuara nga fundi i vitit 1943 me inisiativën e pushtuesve fashistë gjermanë dhe misionëve angleze në Shqipëri si reaksion kundër Frontit Nac.-Çl. të popullit shqiptar. Pjesëmarrja në këto organizata ka qenë shumë e vogël dhe ato nuk luajtën asnjë rol të rëndësishëm. U shkatërruan brenda vitit 1944 si rezultat i demaskimit të tyre nga ana e Partisë Komuniste dhe e fitoreve të Ushtrisë N.-Çl. Shqiptare.

kryengritjes; kudo kërcet pushka çlirimtare dhe në zjarrin e luftës së ashpër kundër okupatorit dhe tradhëtarëve po lind Shqipëria e re, Shqipëria demokratike. Sot lypset më tepër se kurrë të bashkojmë forcat tona, të forcojmë rrethet e luftës dhe të hidhemi me vrull mbi armikun. Ashpërsimi i luftës sonë, do të thotë shpejtimi i ditës së çlirimit.

Partia Komuniste Shqiptare, që gjatë luftës kreshnike që ka bërë ka personifikuar vullnetin dhe dëshirat e zjarra të një populli luftëtar dhe lirisdashës, si kurdoherë po thërret gjithë popullin shqiptar të hidhet në Luftën nacional-çlirimtare me mish e me shpirt pse atje qëndron shpëtimi. Partia Komuniste u bën apel gjithë patriotëve dhe atdhedashësve të vërtetë, që deri tash s'kanë marrë pjesë aktive në këtë luftë, të hidhen sa më parë, se tash më tepër se kurrë ata duhet të tregojnë vendosjen e tyre. Thërret të gjithë ata që deri tash kanë qenë të gabuar nga propaganda e reaksionit, por që s'kanë lyer duart me gjak të popullit e të luftëtarëve të tij, të dezertojnë nga radhët e armikut dhe të japin prova, sa mos jetë vonë, të qëndrimit të tyre, të vendosmërisë së tyre për luftë.

Detyra karshi atdheut thërret të gjithë bijtë e ndershëm të këtij vendi të grumbullohen në Frontin Nacional-Çlirimtar, në radhët e Ushtrisë Nac.-Çl. për t'ja bërë armikut jetën të pamundur dhe për ta shpëtuar popullin tonë nga robëria.

#### PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË!

Liria nuk dhurohet, por fitohet me luftë e me përpjekje. Hitleri i thyer s'i ka hedhur armët, sido që shpresat për fitore janë zhdukur, ai përpiqet të zgjatë luftën dhe të ndihmojë disa klika reaksionare që nuk u pëlqen dhe s'duan zhdukjen e fashizmit. Dita e fitores së madhe po afrohet, prandaj mos u lëkundni, por hidhuni në rreshtat e Ushtrisë Nac.-Çl., në rreshtat e frontit tonë dhe vini gjithë fuqitë tuaja për mbërritjen e fitores. Për të gjithë është një detyrë e shenjtë të luftojnë për lirinë e popullit të vet. Shtoni aktivitetin tuaj, hiqni dorë nga shërbimi për armikun dhe kudo të ndihet forca jonë, armiku dhe tradhëtarët të mos gjejnë veçse plumba kryes.

#### PARTIZANË, KOMANDANTË, KOMISARË POLITIKË!

Ju jeni bijtë më të dashur e më të vyer të popullit. Ju që në këto dy vjet lufte, me shpirtin e sakrificës, me disiplinën dhe organizimin tuaj jeni bërë tmerri i armikut dhe i shërbëtorëve të tij, ju që duke ndjekur shembullin e lartë të Ushtrisë së Kuqe

heroike, keni mbajtur deri më sot me nder e me lavdi flamurin e luftës sonë, duhet sot më tepër se kurrë të shumëzoni përpjekjet tuaja, të jeni më tepër se kurrë të disiplinuar, të forconi radhët tuaja, të goditni pa pushim okupatorin. Dita e parë e Majit duhet të transformohet në një manifestim të madh të forcave tona me akte heroike kundër shkelësit të vendit tonë, si në tokat e çliruara ashtu dhe në ato të okupuara. Armët që keni në duar të mos i lëshoni derisa t'i siguroni popullit lirinë dhe drejtësinë e plotë në Shqipëri të lirë demokratike.

Përpara në luftë për çlirimin e popullit tonë!

Rroftë Dita e parë e Majit, festa ndërkombëtare e punës!

Rroftë Bashkimi Sovjetik mbrojtësi i pathyeshëm i popujve të shtypur e të skllavëruar!

Rroftë Ushtria e Kuqe heroike dhe prisi i madh shoku Stalin!  
Rrofshin aleatët e mëdhenj Angli, Bashkimi Sovjetik, Amerikë!

Rroftë vëllazërimi i popujve ballkanikë në luftë kundër fashizmit gjerman!

Rroftë Shqipëria e lirë, demokratike e popullore!

Rroftë Ushtria trime dhe e pathyeshme Nacional-Çlirimtare Shqiptare!

Rroftë Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar!

Rroftë Shtabi i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar!

Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

Vdekje okupatorit gjerman dhe shërbëtorëve të tij!

#### KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas kopjes së  
tipografuar që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

#### RAPORT PËRPARA PLENUMIT I TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË<sup>1</sup>

[15 maj 1944]

Të dashur shokë,

E ndjej për detyrë që, përpara se të fillojmë punën, me respekt të madh të kujtojmë qindra e qindra shokë udhëheqës dhe anëtarë të thjeshtë të Partisë që heroikisht ranë në fushën e nderit. Për këta shokë që pa kursyer asgjë, si ushtarë të bindur dhe të disiplinuar dhe me dashurinë e madhe për Partinë dhe për popullin, luftuan deri në pikën e fundit të gjakut të tyre, përulet me respekt flamuri ynë, dhe sakrificat e gjaku i tyre të jenë simboli i virtyteve të larta që karakterizojnë anëtarët e partive të tipit Lenin-Stalin. Lavdi anëtarëve heroikë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që ranë në luftë, duke ngritur lart e më lart emrin e Partisë dhe flamurin e Marks-Engels-Lenin-Stalinit!

Të dashur shokë,

U bë një kohë e gjatë që s'jemi mbledhur. Që prej Konferencës së parë të Vendit Plenumi i Komitetit Qendror nuk është mbledhur nga shkaku i mjaft pengesave teknike. Angazhimi i shumë shokëve të Komitetit Qendror në terrene të ndryshme, ku ishin dërguar për të ndihmuar organizatat dhe ushtrinë, lufta që po i bëhej okupatorit dhe peripecitë e saja e bënë teknikisht

<sup>1</sup> Plenumi I i KQ të PKSH i filloi punimet më 15 maj 1944 në Helmës të Skraparit. Ai përcaktoi detyrat për çlirimin e plotë të vendit dhe perspektivat për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit. Ky plenum aprovoi vendimin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar për thirrjen e Kongresit I Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe masat për formimin e Qeverisë së Përkohshme Demokratike dhe për shndërrimin e gjithë Ushtrisë Nacional-Çlirimtare në ushtri të rregullt.

mjaft të zorshme këtë mbledhje. Por këto pengesa ishin edhe të kapërcyeshme kur të ndjehej nevoja urgjente e grumbullimit dhe në rast se ndodheshim përpara evenimenteve me rëndësi të veçantë, ku duhej të përcaktohej një qëndrim i ri politik dhe organizativ në mënyrën e punimit dhe në lidhje me situatat e krijuara. Vija e punimit, e përcaktuar me aq urtësi nga Konferenca e Vendit, ishte e qartë e tejshikuese dhe, përpara evenimenteve dhe zhvillimit që merrte lufta pas Konferencës së Vendit, nuk na mbejtej veçse të zbatonim pikë për pikë në gjerësi dhe në thellësi vijën organizative dhe politike që na u përcaktua.

Sot u ndie e domosdoshme mbledhja e Komitetit Qendror, se evenimentet po rrokullisen dhe kristalizohen në një formë më të përcaktuar, se lufta jonë po zhvillohet në proporcione të mëdha dhe duhen marrë vendime të prera dhe decizive. Sot, përpara Partisë sonë dhe Komitetit Qendror të saj, shtrohen probleme jetësore, të cilat lypin një zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë, sepse këtej varet e ardhshmeja e luftës sonë dhe e popullit shqiptar. Në këtë kthesë me rëndësi të historisë sonë, që është rezultati i ngjarjeve të jashtme dhe i përpjekjeve të Luftës nacional-çlirimtare të vendit tonë, të udhëhequr prej Partisë Komuniste të Shqipërisë, mbledhja e Komitetit Qendror dhe vendimet që do të marrim do të luajnë një rol vendimtar, do të përcaktojnë për anëtarët e vet dhe për gjithë anëtarët e Partisë vijën politike dhe organizative të veprimit, vijë që do të shpejtojë çlirimin e vendit tonë nga thonjtë e okupatorit e të tradhëtarëve dhe do t'i drejtojë shokët drejt një organizimi të pushtetit në një formë më të lartë, të përshtatshme me rrethanat e sotme. Këto janë arsyeet e ngutshme dhe me rëndësi që e shtynë Byronë e Komitetit Qendror të thërresë plenumin në një mbledhje të jashtzakonshme, pa marrë parasysh pengesat teknike dhe vendin e zbrazët që do të lënë shokët e Komitetit Qendror në vendet udhëheqëse nga ku drejtonin punën dhe luftën.

## Shokë,

Në Evropë evenimentet po rrokullisen me shpejtësi të jashtzakonshme. Gjermania hitleriane, e plagosur rëndë nga goditjet e pareshtura që i ka dhënë Ushtria e Kuqe, po tronditet dhe ushtria e saj po humbet moralin dhe frymën sulmuese. Disfatat e njëpasnjëshme që ka pësuar ushtria gjermane kanë ngjallur moskënaqësi të madhe në popullin gjerman, i cili e ka humbur besimin në Hitlerin dhe në fitoren. Nga ana tjetër, ekonomia e Rajhut të tretë nuk është më në gjendje të përballojë nevojat e mëdha të popullit dhe ato të ushtrisë. Popujt e robëruar, që Hitleri u përpoq t'i përdorte si mish topi, s'kanë besim në qeveritë kuislinge

të tyre, dhe «pathyeshmëria» e forcave gjermane tani është një përrallë për ta. Si një bishë e plagosur ushtria gjermane po tërhiqet në Evropë, ku taktikisht do të mundohet të bëjë qëndresën e saj të fundit për të zgjatur edhe ca kohë jetën e vet. Kliqat reaksionare në gjithë Evropën, të cilave nuk u pëlqen zhdukja e fashizmit, sepse ekzistenca e tyre është e lidhur ngushtë me të, bëjnë çmos për ta ndihmuar Hitlerin; këto janë në shërbim të hapët të Gjermanisë hitleriane dhe me përpikëri zbatojnë direktivat e diktuar prej Gestapos në dëm të popujve të tyre. Planet e Hitlerit dhe të gjithë reaksionit u shkatërruan, dhe kjo në saje të Ushtrisë së Kuqe, e cila e ka mbajtur dhe e mban në kurrizin e vet peshën më të rëndë të kësaj lufte të madhe. Ajo, me strategjinë e saj ushtarake, që ka çuditur botën dhe që s'është parë në historinë e luftërave të popujve, i dha grushtin e vdekjes maqinës më të fortë ushtarake që ka parë bota. Njëri pas tjetrit u çliruan fshatra dhe qytete të Bashkimit Sovjetik. U çlirua Ukraina Sovjetike. Në një ofensivë të rrufeshme, e cila nuk do të ndalet, veçse kur Gjermania hitleriane të rrëzohet përdhe, Ushtria e Kuqe kaloi Dniestrin, Dnieprin dhe Bugun, ajo hyri në Besarabi dhe Bukovinë, doli në kufitë e Çekosllovakisë dhe tani po marshon drejt Rumanisë dhe Hungarisë, bastione vasale të Hitlerit në Evropë. Në frontin e Qendrës dhe të Veriut po përgatitet sulmi vendimtar që do të çlirojë përgjithmonë tokat sovjetike. Ushtria e Kuqe jo vetëm që ka marrë përsipër barrën e rëndë të spastrojës nga tokat e veta invazorin gjerman, por edhe spastrimin e shfarosjen e fashizmit dhe të ushtrisë hitleriane nga gjithë Evropa. Stalini, në fjalimin e tij të fundit<sup>1</sup>, tha se goditja për vdekje dhe spastrimi i hitlerianëve nga Evropa është një detyrë e rëndë, detyrë më e rëndë nga ajo që ka pasur deri tani Ushtria e Kuqe, se bisha naziste e plagosur rëndë do të përpiqet me çdo kusht të zgjatë jetën e vet dhe të mbrohet në Evropë. Ushtria gjermane duhet të goditet nga të katër anët; Ushtria e Kuqe duhet t'ja japë grushtin nga veriu dhe nga lindja, aleatët nga perëndimi dhe nga jugu, kështu, me veprime të kombinuara, do të shpejtohet thyerja e forcave gjermane. Ushtria e Kuqe, me moralin e saj të lartë, me armatimet e perfeksionuara, me dashurinë e madhe që është rrethuar nga të gjithë popujt e URSS-it dhe e udhëhequr nga strategu më i madh i kohërave të sotme, Stalini, është bërë mjeshtrë e mbaruar për detyrën e saj të rëndë, por glorioze. Krahas me sukseset ushtarake qëndrojnë edhe sukseset e mëdha politike që Bashkimi Sovjetik ka korrur në fushën ndërkombëtare. Pas Kon-

<sup>1</sup> Është fjala për urdhërin e Komandantit Suprem të Ushtrisë së Kuqe, J. V. Stalin, me rastin e 1 Majit 1944.



ferencës së Moskës, Konferenca e Teheranit<sup>1</sup> lidhi dhe më fort aleancën ushtarake dhe miqësore ndërmjet URSS-it dhe anglo-amerikanëve. Kjo konferencë dënoi me vdekje hitlerizmin dhe tentativat e tija për të përçarë aleatët. Kjo konferencë përcaktoi më qartë nevojën e domosdoshme të pjesëmarrjes aktive në luftë nga ana e anglo-amerikanëve dhe ajo ishte për popujt e robëruar një inkurajim dhe mbështetje e fortë për luftën e tyre çlirimtare. Popujt e robëruar rihorjuan besimin në Bashkimin Sovjetik, i cili lufton për çlirimin e gjithë popujve dhe për mbrojtjen nga çdo ndërhyrje e huaj në punët e tyre të brendshme.

Aleatët marrin pjesë të dukshme në shkatërrimin e fuqive hitleriane me bombardimet, por, duke marrë parasysh fuqitë që kanë grumbulluar, nuk japin rezultatet e pritura dhe veçanërisht ato që presin popujt e robëruar. Vetëm lufta ajrore nuk është e mjaftueshme për të shkatërruar hitlerizmin, është e domosdoshme edhe fuqia që të luftojë në tokë. Në rast se anglo-amerikanët futin shpejt në luftë të gjitha ato forca që kanë grumbulluar do të jetë më i shpejtë çlirimi nga Gjermania hitleriane.

Me avancimin e Ushtrisë së Kuqe po grumbullohen forcat patriotike të vendeve të ndryshme dhe kështu po lind dhe po forcohet lufta nacional-çlirimtare e popujve të robëruar nga Gjermania. Në ballë të këtyre luftërave çlirimtare të popujve shohim kudo partitë komuniste, të cilat udhëheqin luftën e popujve të tyre.

Në Jugosllavi veçanërisht lufta ka marrë një hov të madh. Lufta këtu s'është më ajo luftë e dy vjetëve më parë në formë guerriljesh, por është një luftë frontale dhe me një ushtri të madhe dhe të regjur në përpjekje të përgjakshme. Ushtria nacional-çlirimtare e popujve të Jugosllavisë dita-ditës po shtohet dhe bëhet strumbullari i vëllazërimit të të gjithë popujve të Jugosllavisë; njëkohësisht ajo është ngritur dhe armatosur vetëm e vetëm me përpjekjet dhe me gjakun e këtyre popujve. Kjo ka detyruar tradhëtarët të zbulojnë lodrën e tyre përpara popujve të Jugosllavisë dhe përpara të gjithë popujve të botës. Çetnikët e Drazha Mihajloviçit, qeveria tradhëtare e Jugosllavisë në Londër dhe kral Pjetri<sup>2</sup> shfaqën qëllimet e tyre shoviniste dhe u demaskuan gënjeshtër, tradhëtitë e spekulimet që kishin për qëllim të dobësonin frontin nacional-çlirimtar dhe luftën si dhe të grabitnin pushtetin.

1 Konferenca e Teheranit u mbajt prej 28 nëntorit deri më 1 dhjetor të vitit 1943 me pjesëmarrjen e kryetarëve të tri fuqive të mëdha aleate: J. V. Stalinit, U. Çerçillit dhe F. Ruzveltit. Aprovoi deklaratën mbi veprimet e përbashkëta në luftën kundër Gjermanisë dhe mbi bashkëpunimin e tri shteteve pas luftës. Gjithashtu vendosi që fronti i dytë në Evropë të hapet jo më vonë se 1 Maji 1944.

2 Pjetër II Karagjorgjeviç, mbret i Jugosllavisë në vitet 1934—1945.

Formimi i qeverisë provizore ishte një sukses i madh politik për luftën nacional-çlirimtare të Jugosllavisë. Ushtria jugosllave sot është në radhën e atyre ushtrive aleate që luftojnë okupatorin.

Bullgaria është një nga shtetet vasale të Hitlerit. Reakcioni bullgar i ka lidhur fatet e Bullgarisë me ato të Gjermanisë hitleriane dhe me atë ushtri që kanë formuar, ata kanë shtypur çdo lëvizje brenda në Bullgari dhe janë drejtuar edhe kundër lëvizjes nacional-çlirimtare në Jugosllavi e Greqi. Populli bullgar ka një dashuri të veçantë qysh prej kohërave të vjetra për popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik dhe, me gjithë terrorin dhe shtypjen sistematike nga ana e gjermanëve, ai po hidhet në luftën nacional-çlirimtare. Deklarata e shokut Dimitrov<sup>1</sup> drejtuar popullit bullgar ka caktuar rrugën që duhet të ndjekë ky popull. Me afrimin e Ushtrisë së Kuqe perspektivat janë të mira për një zgjerim të luftës nacional-çlirimtare të popullit bullgar dhe për një bashkëpunim të ngushtë midis popujve luftues të Ballkanit.

Lëvizja në Greqi ka marrë proporcione të gjera politikisht, por nuk kemi atë ashpërsi të nevojshme kundër reaksionit të brendshëm. Intrigat e huaja atje kanë gjetur fushë veprimi.

Në Itali, pas çlirimit të një pjese të saj prej anglo-amerikanëve, Badolio u mbajt në fuqi me përkrahjen e aleatëve dhe vazhdoi një politikë jopopullore. Por pas ndërmjetësimit të Bashkimit Sovjetik u dukën ndryshime në politikën e qeverisë italiane të Badolios<sup>2</sup>. Roli i Partisë Komuniste Italiane u bë i dukshëm në formimin e frontit antifashist dhe në zgjerimin e qeverisë së Badolios, ku marrin pjesë përfaqësues nga gjithë partitë dhe nga PKI shoku Erkoli. Nga moskënaqësia, protestat dhe demonstratat e popullit u rrëzua mbreti Viktor Emanuel, shkaktar i aq fatkeqësive dhe përkrahës kryesor i regjimit fashist që robëroi popullin italian dhe popujt e tjerë. Me organizimin e ushtrisë italiane dhe me luftën e partizanëve italianë në tokat e okupuara po duket zgjerimi i luftës nacional-çlirimtare italiane dhe forcimi i pozitave të përparimdashësve në tokat e çliruara. Në Veri të Italisë punëtorja ka marrë pjesë në përpjekje të ashpra dhe të përgjakshme kundër okupatorit gjerman dhe, megjithëse populli italian është i gjakosur prej shtypjes dhe sakrificave të

1 Është fjala për «Programin e Frontit Patriotik» të Bullgarisë, të hartuar nga Gjergj Dimitrovi dhe të transmetuar nga radio «Kristo Botev», më 17 korrik 1942.

2 Me ndërmjetësimin e Bashkimit Sovjetik, i cili në mars 1944 vendosi marrëdhënje diplomatike të drejtëpërdrejta me qeverinë italiane, në prill 1944 kabineti i Badolios u riorganizua duke u futur në të edhe përfaqësuesit e çjashtë partive të koalicionit antifashist italian, midis të cilëve edhe përfaqësuesit e Partisë Komuniste Italiane.

një luftë të gjatë, ku e kishte hedhur fashizmi, ai ka filluar të përtërihet dhe të ringjallet.

Në Francë lëvizja partizane ka marrë një hov të ri këto kohët e fundit, sidomos në Hot-Savua. Atje shohim zgjerimin e frontit nacional-çlirimtar dhe pjesëmarrja e komunistëve në qeverinë e De Golit është një hap përpara në lëvizjen e popullit francez. Shohim që kjo qeveri të marrë qëndrime të caktuara karshi elementëve të dyshimtë dhe bashkëpunëtorëve të tradhëtarëve të Vishisë. Heqja e Zhirosë<sup>1</sup> nga komanda e ushtrisë dhe izolimi i tij nga skena politike dhe ushtarake është karakteristike.

Në Poloni dhe Çekosllovakia, me afrimin e Ushtrisë së Kuqe, po gjallërohet lëvizja e këtyre popujve dhe njëkohësisht po krijohet qeveri të reja, të cilat përkrahen prej Bashkimit Sovjetik.

Lëvizjet nacional-çlirimtare në Evropë, të mbështetura nga Bashkimi Sovjetik, dhe krijimi i qeverive provizore, të dala nga lufta e popujve, janë një hap përpara dhe një garanci për një të ardhme më të mirë. Këto lëvizje vërtetojnë fjalët e Mollotovit se pas kësaj lufte do të kemi një varg revolucionesh. Klasa punëtore dhe partitë komuniste në botë do të luajnë një rol vendimtar për çlirimin e popujve dhe të kolonive.

Si paraqitet tek ne situata e brendshme aktuale? Me ardhjen e Gjermanisë në vendin tonë reaksioni filloi të grumbullohet dhe të organizohet më mirë. Nën okupacionin italian një pjesë e reaksionit, me «Ballin Kombëtar» në krye, u përpoq të zhdukte lëvizjen tonë nacional-çlirimtare dhe të përçante popullin shqiptar e ta tërhiqte këtë nga e vetmja rrugë e shpëtimit të tij, nga rruga që i kishte caktuar Fronti Nacional-Çlirimtar, fronti i luftës së pamëshirshme kundër okupatorit. «Balli Kombëtar», me parulla false dhe pseudonacionaliste, me kompromise të hapëta me okupatorin dhe kuislingët, u mundua të grumbullojë rreth vetes të gjithë elementët e poshtër dhe t'i organizojë këta në banda hajdutësh dhe kriminelësh për të na goditur me armë. Me ardhjen e gjermanëve, «Balli Kombëtar» u bë vegla e verbër e Gestapos. Gestapoja, e regjuri në këto punë dhe e pajisur me një eksperiencë të gjatë në grumbullimin dhe organizimin e reaksionit, ja filloi punës, duke shtënë në dorë të gjitha fijet e klikave reaksionare që vepronin haptazi dhe fshehurazi kundër lëvizjes sonë. Rreth qeverisë kuislinge të Mehdi Beut dhe të Rexhep Mi-

<sup>1</sup> Udhëheqës ushtarak e politik reaksionar francez. Gjatë viteve të Luftës së Dytë botërore u ka shërbyer interesave të imperializmit amerikan. Në qershor të vitit 1943 u caktua nga amerikanët president i «Komitetit të Çlirimit Nacional» të Francës. Duke qenë i komprometuar me politikën e tij reaksionare u hoq nga ky post në nëntor të vitit 1943, kurse në prill të vitit 1944 u hoq edhe nga posti i komandantit të forcave të armatosura të «Komitetit të Çlirimit Nacional» të Francës.

trovicës u grumbulluan që prej «Ballit Kombëtar», duke kaluar nga «Bashkimi Kombëtar», deri te njerëzit e «Legalitetit». Gjithë taktika e tyre ishte të na asgjësonin ushtarakisht, ta shkëputnin popullin prej nesh dhe politikisht të na diskreditonin. Një fushatë e gjerë propagandistike u zhvillua nga ana e tyre me një shtyp të madh dhe të organizuar, kurse, nga ana tjetër, përgatitej imtësisht ofensiva kundër forcave tona. Lufta e tyre bëhej me parullat e njohura antikomuniste dhe gjermanët e reaksioni përpiqeshin ta paraqitnin në popull lëvizjen tonë si një lëvizje thjesht komuniste. Parullat e «Shqipërisë së madhe», e «Shqipërisë independente» ishin në rendin e ditës; feudalët si Shefqet Vërlaci, Ibrahim Biçaku, Vrionasit vunë gjithë peshën e tyre për të grumbulluar elementët e tyre dhe i vunë këta në shërbim direkt të Gestapos. Me terror, me anarki, ata u përpoqën të lëkundnin popullin dhe t'i humbisnin këtij besimin në fitore. Me çdo mjet ata u përpoqën të shpartallonin edhe grumbullimin e rinisë, duke përdorur demagogji dhe terror.

U krijuan prej okupatorit dhe «Ballit Kombëtar» organizata të ndryshme gjoja me programe politike të caktuara, por të gjitha të lidhura ngushtë për një qëllim, për të luftuar popullin dhe lëvizjen tonë. Në këtë mënyrë ata donin të dezorientonin popullin dhe ta bënin këtë që të mos mundte dot të orientohesh e të ndiqte një rrugë të caktuar dhe të drejtë. Qëllimi i tyre ishte që ta bënin popullin të humbiste besimin te Partia Komuniste, e cila me vijën e saj të drejtë, me qëndrimin e pathyer dhe me sakrificat e mëdha që po bënte kishte fituar besimin e mbarë Shqipërisë. U krijua «Partia Socialdemokrate» prej agjentit të Gestapos Skënder Muços, e të tjerë elementëve ballistë, me qëllim që të shkëputnin elementët përparimtarë që ndodheshin në frontin tonë dhe të tërhiqnin elementët e lëkundshëm që ende s'kishin hyrë aktivisht në luftë. Të tilla ishin organizatat «Roja e Drejtësisë», «Partia Komuniste e vërtetë», e kryesuar prej tradhëtarit Sadik Premte. Këto organizata terroriste s'ishin veçse dora ekzekutive e Gestapos. Në luftën e ashpër që i bëhej Gjermanisë dhe reaksionit nga ana e Frontit Nacional-Çlirimtar, elementët të lëkundshëm, që vegjetonin në frontin tonë, si Bazi i Canës, treguan fytyrën e tyre të ndyrë prej reaksionari. Bazi i Canës, zogist, mori pjesë në Konferencën e Pezës dhe pranoi direktivat e caktuara prej kësaj konference. Ky element në ato momente paraqitesh antiitalian dhe kundër kuislingut Mustafa Merlikës, por aktiviteti i tij luftarak ishte zero. Ai nuk hodhi asnjë pushkë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve dhe as që pranoi të krijonte pushtetin e këshillave në vendet ku ai kishte influencë. Qëndrimi i tij në front bëhej dita-ditës i dyshimtë. Ai bënte mbledhje dhe pjekje me njerëzit e dyshimtë dhe me



të gjithë ata që ishin në luftë të hapët me frontin, si krerët e Dibrës dhe të Matit. Me ardhjen e okupatorit të ri dhe me ashpërsimin e luftës sonë kundër reaksionit dhe «Ballit Kombëtar» qëndrimi i Bazit u bë më i dukshëm dhe më konkret. Në mbledhjen e Mukjes, ku ishin dërguar shokët tanë, midis të cilëve edhe doktor Dishnica, për të biseduar për herën e fundit me «Ballin Kombëtar», Bazi i Canës e tregoi qëndrimin e tij kundër lëvizjes dhe influencoi edhe shokët tanë që të bien në një gabim të madh politik, në një gabim oportunist. Që prej bisedimeve të Mukjes Bazi i Canës filloi të bjerë në marrëveshje të hapët me kuislingun Mehdi Frashëri, me «Ballin Kombëtar» dhe krijoi «Legalitetin», organizatë zogiste, ose, më mirë të themi, «vazhdimësinë e regjimit të Zogut», si thotë ai, «regjim që duhet të jetë i vetmi» në Shqipëri, pse gjoja është legal, por është zhdukur nga Shqipëria prej forcës së armëve fashiste italiane. Me krijimin e «Legalitetit» gjermanët dhe reaksioni po krijojnë një armë të re për të përçarë popullin, për ta frikësuar këtë dhe për të grumbulluar më mirë reaksionin që po tronditej në radhët e «Ballit» dhe të organizatave të tjera tradhëtare. «Legaliteti», i përkrahur haptazi nga kuislingu Mehdi Frashëri, i cili ruan kultin e Zogut derisa arrin të vendosë në administratë tiparet e administratës zogiste në marrëveshje të drejt-përdrejtë me okupatorin gjerman, përpiket të grumbullojë rreth vetes gjithë bajraktarët e malësive dhe reaksionarët e ndryshëm për të na goditur dhe për të pregatitur ardhjen e Zogut në Shqipëri. Në shtypin e «Legalitetit» dhe të Bazit të Canës nuk bëhet asnjë fjalë për okupatorin, por gjithë lufta dhe propaganda e tyre përmbledhet në luftën kundër nesh dhe në apologjinë e Zogut e të regjimit të tij. Në Veri të Shqipërisë krerët e Dibrës mbajnë një attitude<sup>1</sup> të njëjlojtë me të gjithë reaksionin. Ata, nën okupacionin italian, kanë qenë vegla të tija dhe me armë kanë luftuar lëvizjen; tani, nën okupacionin gjerman, ata vazhdojnë po rrugën e tradhëtisë. Me Mehdi Frashërin dhe me reaksionarët e tjerë, si Bazi i Canës dhe elementë të «Ballit», ata janë në marrëveshje të plotë për të na luftuar. Të lidhur me reaksionarët e tjerë shqiptarë të Maqedonisë, si Xhem Gostivari e të tjerë, ata përpiqen të shuajnë lëvizjen tonë në ato rrethe.

Tradhëtari Mustafa Merlika, i lidhur ngushtë me Marka Gjonin e Mirditës, po organizon në Veri rezistencën dhe njëkohësisht mbrojtjen e tyre. Mustafa Kruja është në marrëveshje me Bazin dhe, sigurisht, me elementët e tjerë reaksionarë. Ata do të mundohen të bëjnë një blok kundër lëvizjes sonë. Sido që reaksioni nuk është ende i lidhur mirë në Veri, përsëri paraqitet i rrezikshëm për ne. Në Veri s'duhet të harrojmë edhe Muharrem Bajraktarin, i cili deri tani, nuk ka hyrë në luftë të hapët as kundër nesh, as

<sup>1</sup> Attitude (frëngj.) — qëndrim.

edhe kundër okupatorit. Një rol të madh ka luajtur dhe do të luajë kisha katolike, e cila ka një influencë në Shkodër dhe në malësi. Kisha katolike ka mbajtur një qëndrim negativ dhe profashist në kohë të okupacionit italian, dhe qëndrimi i saj tani, nën okupacionin gjerman, është i njëjlojtë kundër lëvizjes nacional-çlirimtare.

Nga të gjitha këto klika reaksionare, që paraqiten në skenën shqiptare, armiku okupator bën çmos që të përfitojë, t'i drejtojë dhe t'i hedhë ato në luftë kundër nesh, duke përfituar nga çdo kontradiktë e tyre që mund të kenë me njëri-tjetrin si dhe nga kundërshtimi kryesor që kanë kundër nesh. Gjermani okupator, që i përdori për një kohë të gjatë bandat kriminale të «Ballit» kundër nesh në formë bashibozuke, tani po i shndërron këto banda në një formë gjoja të rregullt ushtarake. Qëllimet e tija janë të shumta. Nga njëra anë, ai përpiket, së pari të ketë kurdoherë mercenarë për të përmbushur nevojat e tija këtu, duke i përdorur në vend të ushtarakëve të tij, që është i detyruar t'i heqë dhe të lerë vetëm një pakicë dhe, së dyti t'i ketë këta për më vonë të organizuar për me i dërgue atje ku do ndjehet nevoja, sikundër bën me polonezët, austriakët, francezët etj. Nga ana tjetër, me formimin e këtyre reparteve, nën maskën e një xhandarmërie ose ushtrie shqiptare, ai mban me shpresa reaksionin, i cili me çdo mjet përpiket të ketë një forcë të organizuar për të përballuar sulmet tona, si sot ashtu edhe nesër. Kjo xhandarmëri ose ushtri është shpresa e të gjithë reaksionarëve të ndryshëm, që prej krerëve të «Ballit Kombëtar» e deri te Bazi, dhe cilido prej tyre i jep ç'i mundet gjermanit zot, që të fitojë favorin me e përdorë gjithsecili për vete atë armë. Duhet të shohim se në radhët e reaksionit ka lëkundje dhe tronditje. Brenda në «Ballin Kombëtar» shohim një mosmarrëveshje në mes të krerëve, mirëpo një mosmarrëveshje që nuk i bën kurrë të harrojnë qëllimin e tyre kryesor, luftën kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Gjermanët, tok me reaksionarët, ndërmuarën ofensivën e madhe të dimrit kundër nesh, e cila dështoi, sepse ajo s'mundi t'ja arrinte qëllimit, qëllimit që kishte caktuar: asgjësimin të forcave tona ushtarake. Gati i gjithë reaksioni është në luftë të hapët me ne. Kudo që batalionet dhe brigadat tona po sulmojnë dhe sulmohen, ato gjejnë përpara bandat e reaksionit, të «Ballit», të Shefqet Vërlacit, të Ibrahim Biçakut, të «Legalitetit» dhe të këlyshëve të tyre. Në këto rrethana të jashtme dhe të brendshme lëvizja jonë ka kaluar me sukses përpara në etapa të ndryshme. Konferenca e Pezës, e cila hodhi themelet e Frontit Nacional-Çlirimtar, i dha mundësi dhe hov lëvizjes sonë të zgjerohet, si në çështjen e këshillave si organe të pushtetit, ashtu edhe në zhvillimin e luftës dhe të ushtrisë sonë. Këshillat nacional-çlirimtare u formuan si organe të vërteta të pushtetit popullor demokratik, në një pjesë të vendit ato funksionuan si duhej, kurse në disa vise të tjera ato mbetën të dobëta dhe rezul-



tatet e dhëna prej tyre kanë qenë të pakta. Fati i këshillave ishte i lidhur dhe me sulmet e armikut dhe të reaksionit. Në vendet ku armiku mund të hynte lehtë, atje ishte shumë e zorshme që këshillat të organizoheshin dhe të funksiononin si duhej. Në Veri të Shqipërisë ato u krijuan në një pjesë të Dibrës dhe në disa vise të Shkodrës e gjetkë. Në disa vende ne nuk kemi asnjë punë të organizuar, as edhe shokë që të punojnë ndër ato rrethe, atje reaksioni është mjaft i madh dhe ka nxjerrë pengesa për realizimin e punës sonë.

Fronti Nacional-Çlirimtar e ka pasur kurdoherë rrugën të qartë dhe të përcaktuar mirë dhe, me trakte e me qëndrime të ndryshme, si dhe me konferenca, ka sqaruar popullin në situata të ndryshme, si edhe është përpjekur të grumbullojë në front të gjithë elementët e ndershëm e luftëtarë, është përpjekur të futë në luftë të gjithë ata të mënjanuarit si dhe të gjithë ata që qenë të gabuar nga reaksioni dhe armiku, por që s'ishin përlyer me gjakun e popullit.

Në çdo kthesë të lëvizjes dhe të luftës, fronti ka ditur të mbajë qëndrime të caktuara dhe të prera. Karshi «Ballit Kombëtar» fronti ka mbajtur një qëndrim të drejtë. Ai i ka bërë thirrje «Ballit» të hidhej në luftë kundër okupatorit, por «Balli» nuk u hodh në luftë kundër armikut, por ndoqi rrugën e tradhëtisë dhe ka hapur luftën vëllavrasëse. Fronti u bëri thirrje elementëve të gënjyer që të dezertonin nga kjo organizatë tradhëtare.

Me zhvillimin e luftës dhe me zhvillimin e ushtrisë sonë u pa e nevojshme që të thërritej Këshilli në një mbledhje të jashtëzakonshme për të zgjedhur Shtabin e Përgjithshëm, për të riorganizuar këshillat dhe për të marrë një qëndrim të prerë kundër «Ballit Kombëtar» dhe reaksionit. Mbledhja e parë, që u bë në Labinot<sup>1</sup>, ka një rëndësi të veçantë, se ajo i dha ushtrisë sonë një udhëheqje të vetme, e cila mori përsipër drejtimin e luftës, forcimin dhe zmadhimin e ushtrisë sonë. Përveç kësaj, kjo mbledhje ka një rëndësi, se atje u muar qëndrimi i prerë karshi reaksionit, vegël e okupatorit, dhe atje u vendos dërgimi i një delegacioni që të bisedonte për herë të fundit me «Ballin». Ky ishte takimi i Mukjes. Bisedimet që u zhvilluan atje u bënë në momentin e kapitullimit të Musolinit. Në ato momente «Balli Kombëtar» kujtoi se kishte ardhur koha të merrte pushtetin dhe gati një pjesë e madhe e tij u hodh në «ilegalitet». Përveç kësaj ai ishte i tronditur nga brenda, se disa elementë, gjoja si më liberalë, ishin në kundërshtim me krerët e kësaj organizate dhe kërkonin prej tyre llogari

<sup>1</sup> Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar u mbajt më 4 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit.

për aktivitetin që kishin zhvilluar. Duke dashur të përfitojë nga gjendja politike dhe nga pjekja me delegatët tanë, «Balli Kombëtar» manevroi në mënyrë që bisedimet t'i udhëhiqte ai dhe të bënte të triumfonin tezat e tija. Mukja ishte një sukses për «Ballin» dhe një humbje për ne. Bazi i Canës atje tregoi qartë tendencat e tija. Sido që s'kish bërë kurrë luftë, me rrezimin e Musolinit lufta për të kishte mbaruar dhe përpiquej me çdo kusht të arrihej në një bashkim të sëmure dhe pa baza, duke lënë mënjane çdo kujtim të veprimeve të «Ballit» dhe të reaksionarëve të tjerë. «Balli» manevronte nga ana e tij për me e tërheq Bazin në anën e vet, për me e dobësue frontin dhe me e goditë më mirë. Në mbledhje nuk u biseduan fare, ose u biseduan në një mënyrë formale dhe si çështje të dorës së dytë të gjitha vendimet që ishin marrë në Mbledhjen e Labinotit, por u bisedua për një «Shqipëri etnike», u bisedua për «shpalljen e indipendencës», u bisedua për krijimin e një superorganizate dhe u vu «Balli Kombëtar», që kishte luajtur rolin më të zi, në një radhë me Frontin tonë Nacional-Çlirimtar. Në këtë mbledhje, përveç Dr. Dishnicës, që ishte caktuar prej Byrosë së Komitetit Qendror për të mbrojtur interesat dhe vijën e Partisë, ishte dhe Mustafa Gjinishi, i cili bëri po atë gabim. Në vend që shokët tanë të përfitonin nga tronditja e «Ballit» dhe të bënin diferencimin, ky i fundit forcoi pozitat e tija organizative. «Balli Kombëtar» arriti të shuajë moskënaqësitë në radhët e tija, të dalë në popull me të famshmin trakt të firmuar nga «Komiteti për shpëtimin e Shqipërisë» si një organizatë patriotike, që paska bërë për çlirimin e Shqipërisë aq sa ka bërë fronti ynë. Vendimet e Mukjes u hodhën tej, dhe karshi «Ballit» u muar qëndrim i prerë. Bazi i Canës u thirr të sqarohet, ai s'erdhi. Vetëm shumë kohë më vonë, pas Konferencës së dytë të Labinotit, Bazi i Canës erdhi në kontakt me delegatët e Kryesisë së Këshillit në Shëngjergj. Ai kishte përqafuar të gjitha parullat e «Ballit». Teza e tij ishte që ne të njihnim regjimin e Zogut dhe të bashkëpunonim jo më si front, por si një parti politike nën hijen e Zogut. Përveç kësaj ai kërkonte që ne të bashkëpunonim me «Ballin Kombëtar» dhe asnjë qëndrim nuk merrte karshi qeverisë kuislinge të Mehdi Beut. Bazi përpiquej të përsëriste Mukjen, dhe këtë herë ne të gabonim dhe të pranonim bashkëpunimin nën regjimin e «Legalitetit». Ne i paraqitëm Bazit vendimin dhe vijën tonë të patyeshme dhe të drejtë të frontit kundër okupatorit dhe reaksionit dhe i thamë që të linte mënjane tani për tani çështjen e regjimit të Zogut, çështje që do të zgjidhej pas luftës; i thamë se mund të bashkëpunonim me një parti politike zogiste, e cila duhet të hynte në Frontin Nacional-Çlirimtar, të hynte në luftë kundër okupatorit dhe të spastronte radhët e saja nga elementët tradhëtarë. Bazi s'pranoi asnjë nga këto propozime. Kryesia e Këshillit, me

rezolucionin e vet<sup>1</sup>, e hodhi Bazin jashtë nga Kryesia e Këshillit dhe nga Shtabi dhe e dënoi, duke e demaskuar në popull si element reaksionar në bashkëpunim të hapët me klikat reaksionare dhe me kuislingët e Tiranës.

Konferenca e dytë e Labinotit ishte një sukses për lëvizjen tonë. Atje morën pjesë një numër i madh delegatësh nga të gjitha anët e Shqipërisë, u zgjodh një Këshill i madh Nacional-Çlirimtar si edhe një presidium i gjerë. Por zhvillimi i Luftës nacional-çlirimtare dhe proporcionet që mori kjo, gjendja politike e jashtme dhe rrethanat e brendshme sot, na detyrojnë të marrim vendime më me rëndësi dhe të mbledhim një kongres për të zgjedhur Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar që do të ketë atributet e një pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, nga ku do të dalë Komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore. Byroja e Komitetit Qendror mendon se është momenti më tepër se kurrë që këto çështje me rëndësi duan një zgjidhje të shpejtë. Mbledhja e kongresit dhe zgjedhja e Këshillit Antifashist si dhe formimi i qeverisë provizore do të sjellin forcimin e luftës sonë, forcimin e pushtetit brenda si edhe ndryshime në marrëdhënjet ndërkombëtare në mes lëvizjes nacional-çlirimtare dhe aleatëve. Masat e popullit, që kanë marrë pjesë aktive në luftë, do të shohin te ky pushtet qeverinë e tyre dhe, nga ana tjetër, formimi i qeverisë provizore do të jetë një grusht kundër çdo tentative të reaksionit të jashtëm dhe të brendshëm për formimin e ndonjë qeverie reaksionare, qoftë nën Zogun, qoftë ndonjë tjetër qeveri pseudodemokrate. Shtrohet, pra, përpara Komitetit Qendror kjo çështje me rëndësi për vendin tonë, për të cilën duhet të shfaqim mendimet tona dhe të marrim vendime.

Që prej Konferencës së parë të Vendit e deri tani, lufta jonë ka marrë një hov të madh, Ushtria Nacional-Çlirimtare është zmadhuar e forcuar dhe ka shkuar në etapa të ndryshme. Nga njësitet e guerrilet e mëparshme dhe nga batalionet territoriale, që ekzistonin kur u bë Konferenca e Vendit, sot kemi një ushtri të rregullt, kemi një numër të madh brigadash dhe jemi në prakun e formimit të divizioneve. Kemi kaluar, pra, në një formë të re të ushtrisë sonë. Partia jonë ishte faktori kryesor dhe udhëheqësja e sigurtë e kësaj ushtrie. Në Konferencën e parë të Vendit është theksuar se shokët e Partisë duhet të kuptonin se sektori kryesor i punës ishte ushtria dhe që të mundej Partia të bëhej udhëheqëse e vërtetë e Luftës nacional-çlirimtare duhej të kuptonin rëndësinë e krijimit dhe të forcimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Konferenca na caktonte si detyrë që të grumbullonim dhe

<sup>1</sup> Është fjala për rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar të datës 7 dhjetor 1943 mbi përjashtimin e Abaz Kupti nga Këshilli i Përgjithshëm.

të mobilizonim në radhët e ushtrisë gjithë patriotët dhe luftëtarët e ndershëm, të mobilizonim katundarinë dhe të kalonim nga njësitet e vogla partizane në njësitet të mëdha dhe në një Ushtri të rregullt Nacional-Çlirimtare. E kemi plotësuar deri diku vendimin që u muar në atë konferencë. Kemi kaluar nga njësitet partizane në formacione të rregullta, të cilat janë bërë tmerr për okupatorin. Anëtarët e Partisë kanë treguar guxim, vendosje e zotësi ushtarake dhe janë shquar me gisht jo vetëm nga luftëtarët që udhëhiqnin, por edhe nga populli. Ushtria dhe populli panë me të vërtetë se Partia jonë është udhëheqësja trime dhe e urtë e kësaj lufte çlirimtare. Sot, që kemi në këmbë një numër brigadash të mëdha dhe jemi duke kaluar në divizione, parashtrohet përpara Komitetit Qendror çështja e gradave. Byroja ka vendosur që kjo çështje të bisedohet imtësisht, se ka një rëndësi të veçantë për ushtrinë tonë. Me dhënjen e gradave, ushtria jonë do të marrë formë më të plotë të një ushtrie të rregullt, do të dallohen të gjithë ata luftëtarë që kanë treguar zotësi ushtarake gjatë këtyre dy vjetëve luftë dhe, nga ana tjetër, do të forcohet edhe ca më shumë disiplina në ushtrinë tonë partizane.

### Shokë,

Konferenca e parë e Vendit ka qënë për Partinë tonë një eveniment me rëndësi të madhe, se atje u përcaktuan detyra të qarta, vija politike e punimit si dhe ajo organizative. Nga kjo konferencë doli Komiteti Qendror Definitiv, që mori përsipër zbatimin e punës në bazë të direktivave të Internacionales Komuniste. Direktivat e ardhura në një kthesë me rëndësi në historinë e popullit tonë, i hapën Partisë dhe luftës horizonte të gjera veprimi dhe u bënë faktor i rëndësishëm për zhvillimin me aq sukses të punës së Partisë, për rolin e madh që do të luante kjo gjatë kësaj lufte si dhe për zgjerimin e frontit dhe për organizimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Konferenca e parë e Vendit, e bërë në momente shumë të vështira ilegaliteti, ku merrnin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha organizatat e Partisë të vendit, tregoi forcën e Partisë sonë të re, vendosmërinë e anëtarëve të saj dhe vijën politike të drejtë. Konferenca e Vendit diti të orientojë anëtarët në momentet më të ndërlikuara dhe u dha mundësitë të kalojnë mjaft pengesa që u dolën përpara. Në radhë të parë, Konferenca e Vendit na vuri përpara problemin e forcimit dhe të zgjerimit të radhëve të Partisë, duke pasur kurdoherë parasysh që të mos cënohej njësia e Partisë dhe duke pasur kurdoherë sytë hapët kundër të gjithë elementëve të sëmurë dhe grupashë që përpiqeshin nga brenda të na dëmtonin. Ajo na mësoi të jemi në luftë të ashpër dhe të paprerë me të gjithë elementët antiparti, sepse, pa një luftë

të tillë dhe pa një pastrim radikal të këtyre elementëve, kurrë Partia nuk mund të shkonte përpara, kurrë nuk mund të kishte sukseset politike që ka korrur dhe kurrë nuk do të mundnim të zgjeroheshim dhe të forcoheshim organizativisht. Ajo na vuri përpara problemin me rëndësi të lartësimit të kuadrove të Partisë dhe të pajisjes së tyre me një njohuri të shëndoshë marksiste-leniniste si edhe me një eksperiencë praktike dhe ushtarake. Konferenca parashikoi me plot të drejtë nevojën e ngutshme të këtyre kuadrove, sepse na paraqiteshin përpara probleme me rëndësi si vendimi për luftë kundër okupatorit, formimi i Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Në kohën kur bëhej konferenca, Partia jonë po ndërmirte një punë me përgjegjësi të madhe dhe kuadri ynë i ri nuk do të mundte dot të kryente me sukses detyrat e shumta dhe të ndryshme dhe nuk do të mundte të dallonte ndryshimin midis çështjeve aktuale kryesore dhe çështjeve të vogla në situata të komplikuar, në qoftë se nuk punohej mjaft për ngritjen e nivelit politik dhe teorik të tij. Për këtë arsye Konferenca e parë e Vendit na vuri përpara problemin me luftue energjikisht kundër paditurisë, nga e cila rrjedhin shumë gabime dhe devijime. Konferenca e Vendit, ndërmjet të tjerash, konstatoi se s'ishte bërë mjaft për fshatarësinë dhe se duhej me çdo kusht të dyfishonim aktivitetin tonë për ta hedhur atë në luftë, për t'ja bërë të qartë këto direktiva të Partisë dhe për ta bërë atë faktor kryesor në këtë luftë si dhe mbështetje për Partinë tonë; në atë konferencë u theksua se s'ishte bërë mjaft për me forcue bashkimin e popullit shqiptar, për me organizue ndër fshatra dhe qytete këshillat nacional-çlirimtare, që do të ishin me të vërtetë organet e pushtetit demokratik popullor dhe të Luftës nacional-çlirimtare dhe që do të ishin, tok me Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare, ato që do të shkatërronin pushtetin fashist. Konferenca na theksoi se duhej popullarizuar Bashkimi Sovjetik, Ushtria e Kuqe, aleanca në mes të aleatëve si edhe lufta heroike e popujve të robëruar. Këto ishin, në përgjithësi, direktivat që muarën delegatët e Partisë në Konferencën e Vendit dhe që i shpërndanë në gjithë organizatat për t'i zbatuar në jetë dhe në luftë.

Deri ku organizatat tona të Partisë i kanë zbatuar këto direktiva? Kurdoherë është theksuar rëndësia e çështjes organizative. Kuptimi i vërtetë i kësaj çështjeje nga ana e anëtarëve, si udhëheqës ashtu dhe anëtarë të thjeshtë, do të ishte një faktor i rëndësishëm në mbarëvajtjen e Partisë, në zgjerimin dhe forcimin e radhëve të saja dhe në zhvillimin dhe zmadhimin e luftës dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Organizativisht Partia jonë është bërë më e fortë dhe ka bërë hapa përpara. Ajo është pasuruar me eksperiencën e vet dhe me eksperiencën e partive të tjera komuniste. Ajo është lidhur ngushtë me masat e popullit dhe sidomos në Shqipërinë e Jugut dhe në Shqipërinë e Mesme. Para konferen-

cës, organizata ishte hedhur në gjerësi dhe jo sa duhej në thellësi, dhe kjo u dha shokëve të kuptojnë se një punë e tillë nuk do të sillte përfitim të madh, se populli do të kishte vetëm një simpati për Partinë tonë, simpati që do të ndërrohej me fatin e ngjarjeve. Duhej që Partia jonë të kishte rrënjë të forta në popull, të lidhej ngushtë me të, të lidhej me shtresat fshatare dhe punëtores e të forconte influencën në këto shtresa të popullit. Në këtë drejtim punuan organizatat e Partisë, dhe kemi pasur rezultate të kënaqshme. Në radhët e Partisë sonë elementi fshatar nuk numërohet me gisht si përpara konferencës, por ai përbën një përqindje të madhe, gjithashtu edhe elementi punëtor dhe i vobektë. Shokët kuptuan rëndësinë e fshatit dhe mësuan se si hyhet në fshat, ata kuptuan se fshatarin e shtyn, më tepër se të tjerat, sistemi i skllavërisë fashiste, të hidhet në Luftën nacional-çlirimtare dhe të bashkohet e të lidhet ngushtë me Partinë tonë, mbrojtësen e interesave të tija kundër fashizmit robërues dhe shfrytëzues. Në qytete lufta ka shkuar më mirë. Numri i anëtarëve të Partisë është shtuar; puna në fshat gjithashtu është zgjeruar dhe është kuptuar më me seriozitet. Kështu i është dhënë rëndësi punës së këshillave nacional-çlirimtare dhe është kuptuar rëndësia e tyre. Zhvillimi i punës nuk ka pasur të njëjtin hov në Jug e në Veri. Në Jug puna mori një zhvillim më të madh, por në Veri ajo nuk pati po këtë rritje. Megjithëse organizata e Shkodrës ka përparuar, ajo nuk është çliruar prej atyre plogështive të vjetra. Në disa vise të Shqipërisë së Veriut, kemi disa pika mbështetjeje, po nuk kemi organizata partie, dhe shokët që kemi atje kanë mbetur të shkëputur.

Në Konferencën e parë të Vendit u konstata se që prej formimit të Partisë organizata e Rinisë Komuniste ishte zgjeruar dhe kishte arritur të grumbullojë rreth vetes një masë të Rinisë Antifashiste; kjo konferencë vuri përpara organizatës së Rinisë Komuniste këto detyra kryesore: forcimin e saj, mobilizimin e gjerë të rinisë në luftë dhe shtimin e kuadrove të Partisë me elementë të rinj. Në fillim Rinia Komuniste ishte fare pak e lidhur me fshatin dhe për këtë punë janë dërguar të rinj ndër krahina për të bërë mobilizimin e rinisë. Por organizata e rinisë ka pasur mjaft të meta dhe gabime që e kanë penguar të shkojë përpara. Është bërë specializimi në punët me rininë dhe kjo ka shkaktuar një paralelizëm me punën e Partisë dhe një farë independencë, gjë që mund ta largojë rininë nga udhëheqja e afërt e Partisë. Nga kjo mund të lindin shkëputje, megjithëse nuk ka asnjë simptomë. Nuk është kuptuar sa duhet roli i Rinisë Komuniste në Bashkimin e Rinisë Antifashiste. Është fshehur roli dhe ekzistenca e kësaj organizate. Kështu, organizata e Rinisë Komuniste ka humbur brenda asaj të Rinisë Antifashiste dhe ka punuar pak për të shtuar radhët e saja brenda kësaj organizate. Shokët e rinisë janë treguar sektarë në zgjerimin e kësaj organizate e sidomos me elementin



fshatar. Nuk është punuar për ngritjen politike dhe teorike të rinisë, botimet kanë qenë të pakta dhe gjëja më kryesore është se është folur pak për Partinë dhe për udhëheqjen e saj. Për të plotësuar këtë të metë dhe për të ndrequr gabimet janë bërë disa ndryshime në format organizative të rinisë. Janë hequr bërthamat që kishin arritur të merrnin formën e një forumi dhe që me pikëpamjet e tyre të ngushta pengonin zgjerimin dhe forcimin e radhëve të rinisë. Ky ndryshim do të ndihmojë zgjerimin dhe lartësimin e rinisë, rinia do të jetojë më afër Partisë dhe gjithë shokët e Partisë do të njohin punën e rinisë. Gjithashtu edhe në ushtri janë shpërndarë bërthamat e rinisë të batalioneve të rinisë dhe aktivitetet janë vënë në lidhje me përgjegjësin e rinisë në celulë. Do të krijohen dhe komitetet e rinisë ndër batalione dhe brigada, të cilat do të udhëheqin rininë në ushtri. Me një punë të vazhdueshme në organizatën e rinisë, me një rini luftarake, Partia jonë do të ketë mbështetje të fortë të rinia, prandaj duhet t'i vihet rëndësi kësaj çështjeje, dhe riorganizimi i Komitetit Qendror të Rinisë të merret në diskutim nga ju.

Në radhët e ushtrisë sonë është bërë mjaft punë, dhe për me e pasë këtë të fortë dhe të pajisur me të gjitha cilësitë morale që lyp kjo luftë, duke pasur kurdoherë parasysh rolin e madh që do të luajë në të ardhmen, duhej që të krijoheshin atje organizata të Partisë. Për këtë shkak shokët më të mirë, udhëheqësit që kishin fituar deri diku një farë eksperience ushtarake, politike dhe organizative, u hodhën në rreshtat e ushtrisë dhe ju përveshën punës për krijimin dhe forcimin e ushtrisë dhe të organizatës brenda në ushtri. Ata u përpoqën të mos ishin sektarë në rekrutimin e partizanëve dhe nga lufta të mundnin të nxirrnin elementët më të vendosur për Partinë. Njësitet dhe batalionet tona u mbushën me partizanë të rinj, me një shumicë të madhe katundarësh dhe këto njësitë u bënë brigada e u pritën me dashuri të madhe në popull, sido që ky është varfëruar nga lufta dhe ekonomikisht ndodhet në një gjendje të vajtueshme. Portat e Partisë u çelën për elementët e vendosur dhe që e donin Partinë e jepnin jetën për të. U krijuan celulatat në njësitë e ndryshme, u krijuan byrotë e batalioneve dhe këto u lidhën ngushtë me Komitetin Qendror të Partisë. Kështu që nga Konferenca e Vëndit e deri tani ne mund të themi se kemi një ushtri më të fortë, më të organizuar dhe kemi një organizatë partie të shëndoshë në këtë ushtri.

Me gruan janë bërë hapa të mëdha. Është zhdukur deri diku ajo frymë sektare që shihej ndër shokët përse i përket punimit në këtë sektor. Tani gruaja shqiptare merr pjesë aktive në luftën tonë, partizane të vendosura luftojnë me guxim në radhët e ushtrisë, dhe në terrene gruaja shqiptare jep një kontribut të madh. Organizativisht kemi bërë një hap përpara në këtë sektor, duke formuar këshillat e grave antifashiste në disa qytete e disa fshatra,

por duhet mjaft punë akoma që organizata e Bashkimit të Gruas Antifashiste të qëndrojë në një radhë me organizatat e tjera që luftojnë në frontin tonë.

Por nuk duhet që këto suksese të dukshme që kemi pasur në fushën organizative të na vënë në gjumë. Duhet të shohim me imtësi të metat, gabimet dhe lëshimet që janë bërë gjatë punës dhe luftës, t'i ndreqim këto gabime dhe të mos i përsëritim. Duke i njohur mirë shokët dhe organizatat, ne mund të shkojmë përpara. Sukseset të mos na verbojnë, pse bash për këto suksese armiku po shton goditjet kundër nesh, dhe një lëshim i vogël i kushton shumë Partisë dhe luftës.

Mjaft shokë nuk kanë qenë shumë vigjilentë për ruajtjen e radhëve të Partisë nga elementët e sëmurë grupashë. Me gjithë direktivat dhe vendimet e marrura në Konferencën e Vëndit kundër këtyre elementëve që paraqiteshin të rrezikshëm, disa shokë neglizhuan mjaft vëzhgimin e tyre dhe këta elementë e dëmtuan mjaft punën. Në Vlorë, ngaqë shokët e kësaj krahine nuk muarën masat e duhura kundër tradhëtarit Sadik Premtes, doli një farë fraksioni në atë krahinë, kundër të cilit u muarën masa dhe u ndalua me kohë. Megjithatë Sadik Premte, i cili i shpëtoi dënimit, mundi të tërhiqte disa elementë në tradhëtinë e tij, dhe sot i shohim këta elementë në radhët e armiqve më të mëdhenj të popullit tonë dhe të Partisë. Duhet të dimë se elementi grupash, i tronditur, kur Partia është në fitime, ringjallet dhe manifestohet në format e ndryshme. Kur reaksioni është i fortë dhe kur goditjet janë të rënda nga ana e armikut, atëherë ata bëjnë folenë në elementët e sëmurë e të lëkundshëm që vegjetojnë në radhët e Partisë dhe përpiqen të na godasin nga brenda. Këtë dimër, kur gjermani dhe reaksioni u përpoqën të na goditnin me forcë të madhe, u dukën lëkundje në disa elementë të dobët dhe moskënaqësi e kritika nga disa të tjerë. Tradhëtarët si Xhelal Staravecka e disa të tjerë u hodhën nga ana e armikut dhe na hapën një luftë të ndyrë, luftë që shkaktoi lëkundjen e një numri të rinjsh ende të paformuar dhe jo të regjru në luftë. Këto ngjasin, se shokët nuk bëjnë shumë kujdes dhe harrojnë shpejt dëmin e madh që i sjellin Partisë këta elementë. Armiku më i madh është ai që harrohet, thotë Stalini, dhe shokët tanë s'duhet të harrojnë fjalët e mësuesit tonë të madh. Shfaqje moskënaqësie dhe sëmundje grupazhi janë dukur në Berat, Tiranë, Gjirokastrë. Veçanërisht në Berat këto morën një formë të dukshme me tradhëtinë e Xhelal Staraveckës, i cili mori në prehrin e tij ata elementë tradhëtarë që dezertuan nga kjo organizatë. Në Tiranë lëkundje u shfaqën në radhët e disa të rinjve të gënjyer nga propaganda e renegatëve dhe e armikut, por që nuk patën rrjedhime serioze. Në Gjirokastrë gjithashtu këto shfaqje moskënaqësie dhe kritika, të ardhura prej elementëve intelektualë të sëmurë, s'kanë qenë serioze, por të mjafta për të bërë që

shokët të mos flenë. Duhet të kenë parasysh shokët se s'kemi aq kohë për me i bindë këta elementë të sëmurë, por duhet të marrim masa kundër tyre sa më parë. Në shumë raste shokët harrojnë rrezikun e madh që i vjen Partisë nga elementët trockistë të njohur. Asgjë s'duhet që t'i lëkundë këta shokë në besimin karshi masave që ka marrë Partia për ta. Trockisti Zai Fundo, i kthyer nga Italia në Kosovë<sup>1</sup>, është kurdoherë armik i betuar i Kominternit dhe i Partisë sonë. S'duhet aspak të harrojmë edhe trockistët Fallo, Zisi Andrea, Niko Kondi etj., të cilët zhvillojnë një aktivitet kundër nesh dhe janë në bashkëpunim të hapët me armikun.

Sado që organizatat tona kanë mbajtur kurdoherë qëndrime të qarta me anë të shtypit në çdo moment me rëndësi dhe kanë demaskuar okupatorin dhe shërbëtorët e tij, përsëri në shumë raste ato nuk kanë ditur të mbajnë qëndrime të prera dhe të zbatojnë imtësisht direktivat që u janë dhënë. Bazi i Canës e «Legaliteti» nuk janë demaskuar si duhet. Shokët janë kënaqur të riprodhojnë një rezolucion të Këshillit<sup>2</sup>, por nuk i kanë rënë problemit në kokë dhe ta demaskojnë Bazin dhe punën që bën ai në mënyrë që të mos mundë dot të gënjejë popullin me demagogjinë dhe qëndrimin e tij në mal.

Monopolizimi i punës vazhdon të shihet e të manifestohet jo vetëm ndër shokë që punojnë në organizatat e terrenit, por edhe në ato të ushtrisë. Shumë shokë bëjnë njëkohësisht punën e komisarit, të zëvendëskomisarit dhe të komandantit. Në terren gjithashtu nuk u lihet iniciativë shokëve të rinj. Kjo ka rrjedhimet e këqija se ndalon çdo iniciativë të shokëve, ndalon përparimin e tyre dhe pengon mbarëvajtjen e punës, qoftë edhe sikur ky monopolizim të bëhet pa tendencë.

Nga dobësimi i lidhjes së fortë me celulatat, shumë herë, në momente reaksioni, komitetet qarkore kanë qenë të shpëputura me celulatat dhe në pamundësi t'i udhëzojnë dhe t'i ndihmojnë tamam në momentet më të vështira. Në disa krahina shokët kanë lënë fare terrenin dhe janë larguar që të gjithë, pa marrë parasysh se lënja e terrenit në dorë të armikut shkakton një humbje të madhe për ne. Një gjë e tillë ka ngjarë në Vlorë. Komiteti qarkor i Vlorës ka humbur çdo lidhje me qytetin brenda. Megjithatë reaksioni atje ishte i madh dhe duheshin shpëtuar kuadrot nga goditjet e rënda të armikut, përsëri duheshin lënë disa anëtarë partie

1 Pas kapitullimit të Italisë fashiste Zai Fundo u dërgua nga Inteligens Servis-i në Kosovë për të përçarë lëvizjen nacional-çlirimtare. Në shtator 1944 u kap së bashku me misionet ushtarake angleze pranë forcave reaksionare dhe u dënua nga gjyqi partizan.

2 Rezolucionin e 7 dhjetorit 1943 të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

që të vazhdonin punën. Duhet, pra, të merren masa për ndreqjen e këtij gabimi sa më shpejt dhe të evitohet përsëritja.

Shokët e Gjirokastrës kanë bërë disa gabime organizative, të cilat duhet të mos përsëriten herë tjetër. Këto kanë edhe një karakter politik, se janë të lidhura me çështjen e minoritetit grek. Lejuan formimin e disa institucioneve krejt të ndryshme nga ato të frontit. Kjo shkaktohet ngaqë shokët s'e kanë të qartë çështjen e nacionaliteteve, çështje shumë delikate e që mund të na shkaktojë shumë dëm në qoftë se nuk jemi të kujdesur. Gabime të tjera kanë bërë në interpretimin e Rregullores së Këshillit të Përgjithshëm, dhe rezultatet kanë qenë në mbrojtjen e agallarëve dhe në dëm të bujqve, duke ndihmuar marrjen e së tretës prej këtyre elementëve që s'bënin pjesë as në frontin tonë, por mbanin shumë herë një qëndrim armiqësor kundër nesh. Një gabim tjetër i madh dhe i dëmshëm për Partinë e për lëvizjen është marrja e së tretës prej bujqve të Dishnicës gjoja në ndihmë të frontit. Me këtë gjë ata përpara bujqve s'bënin tjetër, veçse po atë punë që bënte edhe agai.

Dekonspirimi na ka shkakuar mjaft dëme. Me kapitullimin e Italisë shumë shokë, duke mos i peshuar aq mirë situatat, kujtuan se mbaroi lufta dhe filluan të punojnë e të veprojnë haptazi. Shokët e rinj dhe të panjohur prej armikut u zbuluan. Kjo shkaktoi goditje të rënda në kurriz të organizatave.

Për ngritjen e kuadrove kujdesi nuk ka qenë i mjaftueshëm, bile është lënë mangut. Kuadrot duhet t'i ngrinim dhe të kujdeseshim për to në një mënyrë të veçantë, se me kuadro bëhet çdo gjë. Shokëve nuk u është dhënë aq sa duhet ndihma të njohin teorinë marksiste-leniniste me anën e një organi të Komitetit Qendror, i cili na ishte vënë si detyrë nga ana e konferencës për ta nxjerrë dhe që ne ende nuk po e nxjerrim. Për t'i ngritur këto kuadro duheshin bërë konferenca dhe kurse të ndryshme, duhet t'u vinim në dorë literaturën marksiste-leniniste dhe sidomos «Historinë e Partisë Komuniste (bolshevike) të URSS-it». Përkthimi i historisë dhe riprodhimi i saj na ishte vënë si një detyrë kryesore nga ana e konferencës. Deri tani ne nuk kemi shtypur veçse dy kapituj. Ky është një lëshim që nuk na falet. Na ishte vënë si detyrë gjithashtu të bënim një kurs të lartë dhe ky të organizohej prej shokëve të Komitetit Qendror. Ky kurs ende nuk është bërë.

Një gabim tjetër, që shihet në shokët e Partisë në ushtri, është mospërfillja aq sa duhet e punës organizative në radhët e partizanëve. Çdo gjë i është kushtuar luftës me armë dhe pak interesim tregohet për ngritjen e kuadrove politikisht. Kjo është lënë në fatin e vet. Kuadrot më të shumtat e herës s'janë të zonjat të mbajnë një konferencë ose të zgjidhin ndonjë çështje që u del përpara. Disa komisarë politikë as që janë në korrent të direktivave dhe të qëndrimeve politike karshi rrymave të ndrysh-

me që paraqiten. Kjo rrjedh se nuk bëjnë një jetë intensive të Partisë dhe nuk kanë arritur të kuptojnë se celula është shkolla e vërtetë e komunistit. Në ushtri, ku duhet të kemi kuadro të forta, se atje shokët mbruhën në luftë e në përpjekje, ende shohim mungesa dhe lëshime. Në radhët e ushtrisë janë rekrutuar anëtarë partie, por në vend që këta të edukohen e të lartësohen, ata janë lënë pas dore. Përsa u përket disiplinës dhe respektit karshi udhëheqësve ushtarakë në detyrë ato janë të dobëta, dhe kjo rrjedh se janë kuptuar keq disiplina dhe respekti partizan. Disa nga repartet tona nuk kanë fituar ende frymën ofensive, por shumë herë ato vazhdojnë të bëjnë një luftë mbrojtjeje dhe, në rastet kur ato janë në luftë me armikun dhe e thyejnë këtë, nuk e vazhdojnë sulmin deri në shfarosjen e armikut. Disa herë në ushtri shihet në disa raste tendenca me shkue majtas dhe me ra në gabime politike. Kudo që shkohet nuk flitet veçse për Partinë, dhe disa shokë përgjegjës në ushtri e përdorin emrin e Partisë në vend të Frontit Nacional-Çlirimtar. Këtyre shokëve u duket sikur i sjellin fitim çështjes duke vepruar në këtë mënyrë, por kjo e dëmton luftën dhe frikëson ata elementë që nuk kanë simpati të veçantë për komunizmin, por që duan të luftojnë okupatorin dhe mund të bashkohen me frontin. Partia duhet të popullarizohet shumë, por të qëndrojmë kurdoherë brenda kuadrit të Luftës nacional-çlirimtare. Duhet me u vënë kujdes të veçantë njerëzve që e duan luftën, dhe ata elementë të pabindur dhe të lëkundshëm me i bindë me një durim të mjaftueshëm, duke u munduar t'i bëjmë aleatë, se është më mirë me pasë një aleat të lëkundshëm se sa një armik. Për këtë shkak duhet të jemi të zgjuar dhe të kemi kujdes në parullat tona, se lufta s'ka mbaruar.

Shokët në përgjithësi, qoftë në terren, qoftë në ushtri, çështjen e dashurisë së lirë e kanë keqkuptuar dhe shumë herë kanë gabuar. Dashurinë e lirë e kanë kuptuar ngurt dhe kanë marrë vendime disa herë të hidhura. Kjo çështje, aq delikate, duhet t'u bëhet e qartë të gjithë shokëve, sidomos shokëve të rinisë. Të mos lejohen shfaqje të imoralitetit, por të mos biem në pozitat e murgut për të shtypur çdo ndjenjë të pastër, çdo sentiment në të rinjtë.

Shokët e Partisë duhet, nga ana tjetër, të kenë kujdes në sjelljet e tyre, ata duhet të jenë shembull për të tjerët si në jetën personale ashtu edhe në luftë.

Kritika dhe autokritika ende nuk zhvillohen ashtu si duhet të ngjasë në një parti komuniste të vërtetë, kjo tregon papjekurinë e shokëve. Ka shokë që ndruhen të hapin zemrën, të pohojnë dhe të njohin gabimet, të korrigjohen, dhe kjo i shtyn në gabime më të mëdha e që dëmtojnë rëndë Partinë.

Në organizatat e terrenit si edhe në ushtri shihet një buro-

kratizëm i tepruar, i cili jo vetëm që frenon punën, por e bën këtë të dobësohet, kuadrove ua pret hovin e punës dhe i shtyn në dembellëk e në një punë rutine.

Në punën me këshillat nacional-çlirimtare shokët shumë herë kanë gabuar, duke zgjedhur elementë të papërshtatshëm në këto këshilla dhe ka raste që kanë sjellë këtu edhe elementë anti-popullorë. Disa herë puna bëhej formale dhe, duke mos ditur të sillëshin me elementët që merrnin pjesë në këto këshilla, ata u imponoheshin nga lart, duke vënë përpara autoritetin e Partisë. Shumë herë shokët nuk kanë kuptuar rolin e madh të këshillave dhe punën e tyre si organe të pushtetit demokratik, por i kanë përdorur këto vetëm për nevojat e ngutshme të ushtrisë.

Nga pikëpamja organizative para Komitetit Qendror paraqiten dy probleme, të cilat duhet të zgjidhen. Doktor Dishnica ka bërë gabimin e Mukjes, i cili i ka kushtuar mjaft Partisë dhe i ka dhënë një armë në dorë armikut dhe ballistëve për me e luftue Partinë si shaktare të prishjes së vendimeve të Mukjes. Për këtë gjë Byroja e Komitetit Qendror ka përjashtuar Doktorin nga Byroja dhe e paraqet çështjen përpara Komitetit Qendror<sup>1</sup>.

Gjin Marku ka bërë gjithashtu një gabim të madh, që e ka dëmtuar shumë prestigjin e Partisë; ky është kompromisi me gjermanët pas kapitullimit të Italisë. Një gabim themeltar të tillë nuk do të guxonte ta bënte as një anëtar i thjeshtë i Partisë dhe jo një udhëheqës, anëtar i Komitetit Qendror. Byroja kundër Gjinit s'ka marrë ende ndonjë masë, prandaj e paraqet çështjen para Komitetit Qendror dhe ky të marrë masat<sup>2</sup>.

## Shokë,

Duhet të gjithë ta kemi kuptuar rëndësinë e përgjegjësisë së punës që na është ngarkuar dhe nuk na lejohet më të bëjmë lëshime dhe gabime që dëmtojnë Partinë dhe luftën tonë. Duhet ne veçanërisht të bëjmë kujdes, se nga ne pret gjithë organizata, ne duhet të jemi shembull i mirë për anëtarët e Partisë dhe për gjithë popullin. Përpara nesh kemi luftime të reja dhe na duhet të marrim qëndrime që do të jenë vendimtare; për këtë shkak ne duhet të jemi të përgatitur, të kemi Partinë më të fortë se kurrë, me kuadro të shëndosha dhe të edukuara si ushtarakisht dhe politikisht, që të mundim kësisoj të përballojmë çdo situatë që do

1 Plenumi vendosi përjashtimin e Ymer Dishnicës nga Komiteti Qendror i PKSH.

2 Plenumi vendosi përjashtimin e Gjin Markut nga Komiteti Qendror i PKSH.



të krijohet. Para nesh paraqiten perspektiva të rëndësishme, për të cilat ne duhet të kemi parashikuar masat dhe qëndrimin tonë, së paku në vija të përgjithshme. Përpara ofensivës dhe avancimit të Ushtrisë së Kuqe drejt Rumanisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, ne duhet të forcohem si ushtarakisht dhe politikisht, dhe Partia jonë të grumbullojë rreth vetes gjithë popullin punëtor dhe fshatar, se me avancimin e Ushtrisë së Kuqe proletariati i gjithë Evropës, dhe i Ballkanit veçanërisht, në një kohë të afërme do të luajë një rol vendimtar. Partia Komuniste, udhëheqësja dhe pararoja e çelniktë e popullit në këtë luftë, do të ketë ndihmën më të madhe nga Bashkimi Sovjetik. Paraqitet eventalisht edhe mundësia e një zbarkimi aleat në Ballkan. Ky zbarkim duhet të na gjejë të fortë dhe të organizuar, që kështu të mos lejojmë që në një mënyrë ose tjetër, këta të ngatërrohen në punët tona të brendshme, dhe t'i bëjmë të respektojnë Kartën e Atlantikut dhe vendimet e marrura në Konferencat e Moskës e të Teheranit. Të mos harrojmë se në Angli dhe në Amerikë ekzistojnë reaksionarë, të cilët përpiqen të fitojnë luftën, duke pasur sa më pak dëme. Këta elementë, të cilëve u intereson zhdukja e fashizmit, se ky kërcënon ekzistencën e tyre, janë në luftë me Gjermaninë, por nuk i shohin me sy të mirë lëvizjet nacional-çlirimtare në Evropë, se njëkohësisht me zmadhimin e këtyre lëvizjeve, zvogëlohet posibiliteti i shfrytëzimit të popujve nga ana e tyre. Në një vend si Inglitera dhe Amerika, ku kapitali është i zhvilluar, nuk mund të jetë zhdukur influenca e tij, i cili i ka rrënjët mjaft të forta, si në rrethet qeveritare të këtyre vendeve ashtu edhe në ato ushtarake. Ngjet, pra, që këto shtresa reaksionare do të përpiqen të përkrahin dhe të gjejnë elementë për t'i përdorur si një kundërbalancim për forcat tona nacional-çlirimtare. Këto tendenca mund t'i shohim në oficerët e misionit britanik në Shqipëri. Këta s'mungojnë të bisedojnë me elementë reaksionarë dhe t'i përkrahin këta, t'i rehabilitojnë në sy të popullit, të dërgojnë misione tek elementët tradhëtarë si Bazi i Canës e krerët e Dibrës me të vetmin qëllim që t'i ngrënë përpara popullit për t'i përdorur më vonë. Këta oficerë bëjnë mjaft për të mos popullarizuar sa duhet lëvizjen tonë, dhe qëllimi kryesor i tyre është të kërkojnë të ndërhyjnë në punët tona organizative. Për këtë shkak ne duhet të kemi kujdesin më të madh dhe në asnjë mënyrë të mos lejojmë që këta të përzihen në çështjet tona organizative dhe të mos u japim asnjë informatë me karakter ushtarak e organizativ që mund të dëmtojë Partinë dhe Ushtrinë Nacional-Çlirimtare.

Duhet të kemi parasysh edhe një tërheqje eventuale të gjermanëve nga Shqipëria, dhe kjo gjë të mos na gjejë në befasi dhe të papregatitur. Duhet t'i përgatitim shokët në këtë drejtim dhe, nga ana tjetër, të zhdukim atë mentalitet që ndjehet në shumë

shokë e partizanë se me ikjen e gjermanëve ne i kemi mbaruar gjithë punët dhe presim këtë mbarim për të lëshuar armët e për të shkuar në shtëpi. Duhet t'ua bëjmë të qartë shokëve dhe ushtrisë se armët nuk do t'i lëshojmë kurrë, por do t'i mbajmë në dorë, derisa vendi ynë dhe populli shqiptar të ketë fituar liritë e plota dhe derisa të mos mbetet këmbë armiku në vendin tonë.

Duke përfituar nga eksperiencia e së kaluarës, veçanërisht që prej Konferencës së parë të Vëndit, duke mësuar nga gabimet tona, ne duhet të ecim përpara me hapa gjigante drejt bolshevizimit të Partisë dhe ta shohim kthjellë përfundimin e luftës dhe të ardhmen tonë. Garancia më e madhe për fitoren tonë është uniteti i Partisë. Kemi detyra karshi Partisë, karshi popullit tonë, duhet që këto detyra t'i kryejmë dhe të gjitha do t'i kryejmë, po t'i përvishemi punës me vendosje, duke mos kursyer as jetën tonë.

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

*Botuar për herë të parë:  
«Enver Hoxha. Vepra,  
vëllimi 2». Tiranë, 1968*

**QARKORE E KQ TË PKSH PËR POPULLARIZIMIN E  
VENDIMEVE TË KONGRESIT I ANTIFASHIST  
NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË PËRMETIT**

15 qershor 1944

**GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË  
ZËVENDËSKOMISARËVE  
SEKSIONEVE POLITIKE**

Të dashur shokë,

Në momentet kur Ushtria e Kuqe heroike ka shpërthyer ofensivën e madhe kundër okupatorit gjerman dhe ka çliruar Ukrainën, Besarabinë dhe Bukovinën, kur ajo po marshon mbi Hungarinë, Rumaninë dhe Çekoslllovakinë, duke i dhënë grushte vdekjeje armatave hitleriane, të cilat si bisha të plagosura po tërhiqen të thyera në kështjellën e Evropës për të bërë rezistencën e fundit, kur përpara Ushtrisë së Kuqe vihen detyra të rënda dhe të reja për të çliruar gjithë popujt e shtypur të Evropës dhe për të shfarosur murtajen hitleriane, në Evropë krijohen kondita të reja. Në saje të këtyre fitoreve të shkëlqyera të Ushtrisë së Kuqe, të udhëhequr nga strategu më i madh i kohërave të sotme, shoku Stalin, u krijuan konditat për aktivizimin e ofensivës aleate në Itali, për zhvillimin e madh të luftërave të popujve të robëruar dhe më në fund, për zbarkimin me sukses të aleatëve në Francë, zbarkim që është rezultat i kaq përgatitjeve dhe i Konferencës së Teheranit.

Krahas me zhvillimin e luftërave kundër okupatorit, po forcohet kudo pushteti demokratik i popullit e po merr forma konkrete, të cilat ndihmojnë zhvillimin e luftës me sukses, ndihmojnë grumbullimin e forcave të gjalla të çdo populli dhe forcojnë pozitën kombëtare dhe ndërkombëtare të këtyre popujve, pozita të bazuara në themele të shëndosha popullore dhe në parime demokratike. Në çdo vend të Evropës dhe veçanërisht në Jugosllavi, Francë, Çekosllavakia etj. u formuan komitete antifashiste, të cilat

kanë të gjitha atributet e qeverive provizore. Këto komitete kurorëzuan luftërat e përgjakshme të këtyre popujve kundër hitlerianëve dhe klikave reaksionare të lidhura ngushtë me okupatorin e që përpiqeshin me çdo kusht të dobësonin luftërat nacional-çlirimtare dhe të pengonin zhvillimin përparimtar dhe vullnetin e popujve. Në vende të tjera si në Itali, Bullgari etj. shohim pjesëmarrjen aktive të popullit në luftë dhe krijimin e forcimitin e frontit antifashist, i cili po marshon drejt konkretizimit të formave demokratike të shtetit, që do të eliminojnë në luftë e në përpjekje të gjitha mbeturinat fashiste dhe reaksionare që pengojnë zhvillimin e drejtë të luftës popullore.

Në vendin tonë, me zgjerimin dhe forcimin e frontit, me zmadhimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare dhe me çelnikosjen e saj gjatë kësaj lufte të përgjakshme që po bën populli ynë, përpara Komitetit Qendror të Partisë u shtruan probleme me shumë rëndësi jetike për popullin shqiptar dhe për zhvillimin e mëtejshëm me sukses të Luftës nacional-çlirimtare. Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e tij të jashtzakonshme<sup>1</sup>, mbasi shqyrtoi situatën, e pa të domosdoshme dhe urgjente mbledhjen e Kongresit I Antifashist, ku do të merreshin vendime me rëndësi historike. Për këtë gjë, dakord me Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, në qytetin e lirë të Përmetit u mbledhën në kongres të gjithë delegatët e popullit nga çdo anë e Shqipërisë dhe të zgjedhur në mënyrën më demokratike me anë mitingjesh të gjera dhe me vota të hapëta.

Kongresi I Antifashist hapi seancat e tij në mes të një entuziazmi të papërshkrueshëm të popullit dhe të ushtrisë dhe atje u muarën vendime me rëndësi për fatin e atdheut dhe të popullit tonë. Kongresi I Antifashist i dha Shqipërisë Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar me të gjitha atributet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv nga doli organi ekzekutiv dhe urdhërdhënës Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar me të gjitha atributet e një qeverie provizore.

1. — Kongresi i Përmetit, me rëndësi të madhe historike, shprehu vullnetin dhe dëshirën e zjarrtë të popullit tonë për të vazhduar luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve më me ashpërsi, deri në fitoren e plotë të armëve tona mbi hitlerizmin, për çlirimin e plotë të atdheut nga gjakpirësit reaksionarë, vegla të

<sup>1</sup> Është fjala për Plenumin I të KQ të PKSH që u mbajt më 15 maj 1944 në fshatin Helmës të Skraparit.

okupatorit, dhe për fitoren e të gjitha të drejtave të popullit shqiptar.

2. — Kongresi shfaq besimin e plotë tek aleatët e mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Amerika dhe se tok me ta dhe me gjithë popujt e robëruar populli shqiptar do të vazhdojë luftën deri në fund për shpëtimin e njerëzimit nga murtaja naziste.

3. — Kongresi shfaq bindjen dhe besimin e plotë se populli shqiptar, pjesëtar i blokut të madh antifashist, i mbështetur në deklaratat e Kartës së Atlantikut, të Konferencës së Moskës dhe të Teheranit, do të gëzojë të gjitha të drejtat që i garantojnë këto vendime historike dhe se do të qëndrojë në një radhë me të gjithë popujt përparimtarë të botës.

4. — Kongresi me entuziazëm të madh brohoriti për Partinë Komuniste të Shqipërisë, udhëheqësen e ndritur të popullit shqiptar kundër okupatorit dhe tradhëtarëve.

5. — Kongresi brohoriti në mënyrë të papërshekrueshme Ushtrinë tonë heroike Nacional-Çlirimtare, ushtrinë e popullit shqiptar për luftën e saj të drejtë, të paprerë dhe fitimtare, për aktet e saja heroike, që kanë çuditur botën dhe që kanë ngritur lart emrin Shqipëri, duke i siguruar një vend të shkëlqyer në radhën e popujve përparimtarë.

6. — Kongresi shfaq vullnetin dhe dëshirën e popullit shqiptar për bashkimin e vëllazërimin e gjithë popullit në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe pjesëmarrjen e të gjithë patriotëve të ndershëm në radhët e Frontit dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

Këto evenimente me rëndësi të jashtzakonshme për popullin tonë duhet t'i popullarizoni në shkallë të gjerë, gjithashtu dhe vendimet e marrura në këtë kongres t'ja bëni të ditura popullit duke ja bërë të qarta dhe të kuptueshme. Duhet të shumëzoni në një numër të madh materialin që ju dërgohet përsa i përket kongresit dhe ky material të punohet me kujdes në të gjitha celulat, byrotë e batalioneve dhe në aktivet si dhe në komitetet e rinisë. Nga punimi i mirë i këtij materiali dhe kuptimi i drejtë i tij varren efekti dhe rezultati që do të kemi. Nuk lejohen gabime në interpretimin e keq të vendimeve, të brendisë së tyre si edhe të nomenklaturës. Do të jetë një gabim në qoftë se veprohet ndryshe dhe do të na shkaktohen dëme. Për këtë arsye po ju japim disa sqarime suplementare.

1. — Kongresi I Antifashist, i dalë nga lufta, ku morën pjesë me qindra delegatë nga ushtria, nga organizatat e ndryshme dhe me tendenca politike antifashiste, që grumbullohen në Frontin

Nacional-Çlirimtar, të zgjedhur prej popullit në mënyrë demokratike, përfaqëson vullnetin sovran të popullit shqiptar. Kongresi krijoi organet politike, legjislativ dhe ekzekutive, të cilat përfaqësojnë popullin shqiptar, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

2. — Kongresi zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm, si trup kryesor legjislativ dhe ekzekutiv, që përfaqëson sovranitetin e popullit dhe të shtetit shqiptar. Kjo formë e pushtetit është e re dhe u përshtatet konditave të krijuara nga lufta. Këshilli i Përgjithshëm i përmbledh të dy pushtetet dhe është Këshilli që krijon organin ekzekutiv, Komitetin Nacional-Çlirimtar, i cili është përgjegjës për punët e veta përpara Këshillit dhe anëtarët që e përbëjnë mund të jenë ose jo anëtarë të Këshillit.

3. — Meqenëse Këshilli nuk ka mundësi të qëndrojë i tëri i grumbulluar, se s'e lejojnë konditat e luftës, ai zgjedh presidiumin e vet dhe ky është i veshur me të gjitha atributet e Këshillit të Përgjithshëm Nac.-Çl.

4. — Vendimet e marrura nga Këshilli Nac.-Çl. ose nga Kryesia janë ligje, të cilat vihen në zbatim prej organit ekzekutiv.

Të gjitha vendimet e marrura nga Këshilli Nacional-Çlirimtar duhet t'i studjoni me vërejtje të madhe, t'i kuptoni dhe nuk lejohen interpretime të gabuara. Këto vendime, mbasi të punohen mirë, t'ua bëni të kuptueshme gjithë këshillave, gjithë anëtarëve të tyre dhe të lehtësohet puna e këtyre jo duke ua imponuar, por duke ua mësuar me durimin më të madh, duke pasur kurdohërë kujdesin që këshillat të përfaqësojnë me të vërtetë pushtetin e popullit.

Deklarata dhe thirrja nga ana e kongresit duhet të bjerë në çdo dorë, deri në këndin më të humbur të Shqipërisë, dhe njëkohësisht duhet të popullarizohet kongresi, duke vënë në dukje rëndësinë e tij dhe momentin në të cilin u mbledh, si dhe veprën e tij historike.

Të popullarizohet në shkallë të gjerë Këshilli Nac.-Çl., përfaqësues i sovranitetit të popullit, dhe Komiteti Nacional-Çlirimtar.

Ju vihet nga ana tjetër si detyrë kryesore:

1) Të popullarizohet në shkallë të gjerë Partia jonë, udhëheqësja e kësaj lufte çlirimtare, organizuesja e ndritur dhe e përkulur e luftës së armatosur kundër okupatorit si dhe mbrojtësja e interesave të popullit që punon.

2) Të popullarizohet në çdo anë Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin. Por popullarizimi të mos mjaftohet vetëm duke thënë se është e vetmja forcë që theu armatat e Hitlerit etj., por se Bashkimi Sovjetik është udhëheqësi i masave punonjëse dhe që u dha këtyre kolektivitetin e lirë vëllazëror të njerëzve të lirë, një shoqëri të lulëzuar dhe jetë të begatshme. Vetëm rendi socialist munda të krijojë atë forcë të pathyeshme që është Ushtria e Kuqe,



e aftë për me përballue të gjitha vështirësitë. Sot asnjë vend, asnjë lëvizje a parti nuk mund të mos mbajë parasysh ekzistencën e Bashkimit Sovjetik si faktor vendimtar dhe të pakontestueshëm në zhvillimin e shoqërisë së sotme. Në këtë drejtim duhet ta popullarizoni Bashkimin Sovjetik dhe udhëheqësin gjenial, Stalinin, pavarësisht nga propaganda që do të bëjnë klikat e ndryshme reaksionare të vendit tonë...

4) Të popullarizohet lufta e popujve të robëruar, të popullarizohet vëllazërimi i popujve ballkanikë dhe t'i bëhet luftë propagandës shoviniste që kërkon të armiqësojë popullin tonë me popujt fqinjë.

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të PKSH

*Enver Hoxha*

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**QARKORE E KQ TË PKSH DREJTUAR KOMISARËVE DHE  
ZËVENDËSKOMISARËVE TË UNÇSH MBI FORCIMIN E PUNËS  
POLITIKE-EDUKATIVE NË USHTRINË  
NACIONAL-ÇLIRIMTARE**

16 qershor 1944

KOMISARËVE DHE ZËVENDËSKOMISARËVE TË USHTRISË  
NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Të dashur shokë,

Me zhvillimin e luftës u zhvillua dhe ushtria jonë, duke shumëzuar radhët e saja me partizanë të rinj dhe me udhëheqës ushtarakë dhe politikë. Kjo ushtri është e vendosur për luftë, se është e përbërë nga djemtë e popullit që kanë ndërë thellë shtypjen e okupatorit dhe të tradhëtarëve, se në pjesën më të madhe është e përbërë prej katundarëve të varfër, që me shekuj kanë vuajtur njëmijë e një të zeza e që tani, me okupacionin, ekzistenca dhe jeta e tyre është bërë skëterrë. Këta djem të popullit panë se lufta që u bëhej okupatorit dhe tradhëtarëve ishte e vetmja rrugë shpëtimi dhe për këtë arsye ata ju përgjegjën thirrjes sonë, rrokën armët për të na ndjekur në rrugën e drejtë që na ka caktuar Partia. Por nuk mjafton vullneti i mirë për luftë për t'i bërë të gjitha këto masa luftëtare koshiente për barrën e rëndë dhe të shumanshme, duhet që këto masa të edukohen politikisht dhe ushtarakisht, të dinë përse luftojnë dhe si të luftojnë, të njohin mirë armikun, forcat e tija, qëllimet dhe metodat që përdor dhe të zotërojnë vijën e luftës dhe taktikën luftarake tonën.

Është një fakt i pakontestuar se ushtria jonë është zmadhuar, por ky zhvillim në numër nuk ka shkuar paralelisht me zhvillimin politik dhe ushtarak të partizanëve, të komandantëve dhe të komisarëve, dhe ushtria jonë, sado që ka hyrë në rrugën e një ushtrie të tipit të ri, prapë është shumë larg synimit të dëshiruar dhe që e lypin rrethanat e sotme dhe konditat që do të krijohen nesër. Ushtria jonë Nac.-Çl. nuk paraqitet ende si një blok kom-

pakt me të gjitha cilësitë që lypsen dhe këtej duhet të nxjerrim një konkluzion, i cili duhet të na bëjë të mendohemi shumë që ushtrinë ta kemi të gjithë nën kontrollin tonë dhe të mos na ngjase që një pjesë e saj eventualisht të shkëputet ose me mbarimin e luftës të shturet, me që s'e ka kuptuar si duhet rolin e vetë madh.

Për këtë gjendje në ushtri përgjegjës kryesorë jeni ju, shokë komisarë politikë dhe zëvendëskomisarë, ju që përfaqësoni Partinë në ushtri, ju që çoni në masat luftuese fjalën, vijën, udhëzimet, vullnetin e çelniktë, disiplinën koshiente, idetë përparimtare të pararojës dhe udhëheqjes së ndritur të proletariatis dhe të popullit që punon. Për këtë shkak përgjegjësia juaj është e madhe përpara Partisë dhe nga ju varet formimi i ndërgjegjes politike në partizanët e ushtrisë sonë.

Puna politike dhe organizative që ju është ngarkuar, nuk është zbatuar si duhet; kjo ka pasur të meta, lëshime dhe gabime, të cilat kanë shkaktuar moslartësimin e kuadrove dhe të partizanëve. E meta kryesore e shumë prej jush ka qenë shablonizmi në punën tuaj d.m.th. se të gjitha udhëzimet dhe direktivat që ju janë dhënë, i keni kuptuar cekët dhe jeni përpjekur t'i zbatoni kallëp, pa i prekur e pa i bërë gjakun dhe mishin tuaj, kështu që të dinit t'i zbatonit në situata të ndryshme, duke ua përshtatur vendit dhe rrethanave dhe duke hedhur larg globalizmin. Jeni përqëndruar në çështje të përgjithshme pa ja përshtatur realitetit dhe kjo gjë ju ka mbajtur larg këtij realiteti dhe konkretizimit të punës që keni zhvilluar. Keni hedhur farën, por s'keni ditur të kujdeseni për bimën që lindi, e cila kërkon shumë kujdes e përpjekje për t'u rritur dhe zhvilluar. Kjo mënyrë pune ka shkaktuar që ju të mos njihni mirë njerëzit e reparteve tuaja, mos t'i njihni aftësitë e të metat e gjithsecilit për të mundur t'i zhdukni këto të meta dhe të zhvilloni kualitetet e tyre. Shumë njerëz në ushtri vijnë nga qytetet, të mësuar me një mënyrë pune tjetër, dhe në fillim në ushtri mund të dezorientohen, se në ushtri shumë gjëra janë ndryshe, kështu, ju që jeni të kualifikuar, t'i drejtoni këta elementë, të cilët mund të bëhen udhëheqës të mirë, por mund të bëhen edhe të pavlefshëm në rast se mungon kujdesi juaj.

Përveç asaj s'merrni përgjegjësi politike dhe ushtarake ose fare pak. Janë neglizhuar konferencat ndër partizanët dhe udhëheqësit dhe nuk zbatohen plane pune nga ana juaj. Puna juaj është shumë herë një punë e rastit, pa u menduar pak se nga puna juaj e rregullt varet forcimi i ushtrisë dhe influenca e Partisë në të.

Puna juaj në ushtri është pasqyra e Partisë, dhe partizanët shohin në ju udhëheqësin e ndritur të masave. Kur ju s'tregoni kujdesin e duhur për njerëzit, për ngritjen e tyre, kur nuk i

zgjidhni problemet si duhet, kur nuk jepni shembullin e guximit e të heroizmit, emri i Partisë errësohet, influenca e saj në masat dobësobet dhe mosbesimi në udhëheqjen fillon të hedhë rrënjë. Shumë prej jush e harrojnë detyrën e tyre të shumanshme, si politike ashtu dhe ushtarake, dhe nganjëherë interesohen mjaft për njerëz dhe neglizhojnë tjetrën ose interesohen për të dyja në mënyrë të përciptë.

Puna që do të bëni në reparte ndihmon organizatën e Partisë në ushtri; e rorcon atë, në qoftë se puna zhvillohet si duhet dhe e dobëson atë, në qoftë se ajo nuk shkon progresivisht. Organizata e Partisë në ushtri është pasqyra e punës së anëtarëve që punojnë në këtë sektor dhe, për fat të keq, organizata nuk është rritur aq tepër dhe të zotërojë në shumë anë punën që paraqitet. Ajo nuk mund ta zotërojë situatën, në rast se nuk forcohet me elementë të rinj, të shëndoshë, të vendosur, të cilët të lartësohen dhe të edukohen. Që të mund të kryeni me sukses barrën që ju ka ngarkuar Partia, duhet të ndryshohet stili dhe metoda e punës, kjo të marrë një impuls të ri; të mësoni që t'u hyni më thellë problemeve dhe t'i zgjidhni përnjëherësh, duke pasur kurdoherë parasysh direktivat. Të dini të gjeni dhe të njihni gabimet, t'i ndreqni këto dhe të mësoni prej tyre. Prej kuadrove të Partisë, sidomos prej atyre që punojnë në ushtri, kërkohet që të futen në punë me më shumë perspektiva dhe guxim, të futen në masa dhe pa ndrojtje të rekrutojnë anëtarë të rinj të Partisë, sidomos nga shtresat e varfëra fshatare.

Të keni kujdes të zbatoni drejt vijën e Partisë në ushtri, të mobilizoni masat katundare rreth ushtrisë sonë dhe këto të bëhen një faktor kryesor i luftës, këtë masë ta edukoni dhe këtej të dalin komandantë, anëtarë partie të zot, luftëtarë të vendosur për luftën dhe për Partinë. Duhet të kuptohet mirë roli i fshatarësisë në këtë Luftë nac.-çl., të dini që t'i afroheni fshatarësisë dhe veçanërisht në lidhje me luftën; të dini të kuptoni dëshirat e tyre dhe t'i zgjidhni më së miri dhe me drejtësi problemet që u interesojnë më tepër.

Ushtria jonë të ruajë kurdoherë karakterin popullor, si ushtri e vërtetë e popullit, dhe në lidhje me këtë, sjelljet e saj në popull duhet të jenë shembullore. Të mos lejohet në asnjë mënyrë keqpërdorimi dhe mënyra brutale që ndonjë mund të bëjë në popull, luftoni rebelizmin dhe shfaqjet anarkiste dhe dënoni me ashpërsi të gjithë ata që tentojnë t'i japin ushtrisë sonë ngjyrën e një ushtrie të parregullt, antipopullore. Ushtria jonë të jetë shembulli i drejtësisë për të pafajshmit dhe të gabuarit dhe e pamëshirshme për armiqtë e popullit. Ushtria duhet të jetë koshiente për rolin e saj sot edhe nesër, dhe çdo partizan duhet të dijë dhe të ketë kuptuar se armët, që me gjak ja kemi marrë armikut, ne edhe populli nuk do t'i lëshojmë nga duart deri në

fitoren e plotë. Kudo që të shkoni në masat e gjera fshatare të bëni konferenca, të regjistroni dëmet e bëra nga lufta, të mbani veçanërisht në shënim, dhe t'i vini në dukje, të gjithë kriminelët e luftës.

Të popullarizoni Partinë tonë në shkallë të gjerë, si udhëheqëse të luftës, të popullit, mbrojtësen e interesave të popullit që punon. Të popullarizoni blokun antifashist dhe të dini të popullarizoni Bashkimin Sovjetik jo vetëm si fuqi që po dërmon hitlerizmin, por më konkretisht, duke vënë në dukje nga ka rrjedhur ajo fuqi e madhe, rendi socialist, që ka lartësuar masat punonjëse, u ka dhënë lirinë, ka vëllazëruar popujt dhe ka krijuar kondita për krijimin e Ushtrisë së Kuqe heroike, ushtri e dalë nga gjiri i popullit, e pajisur me të gjitha virtytet morale që vetëm socializmi mund t'i japë njerëzimit. Në këtë drejtim të bëhet popullarizimi.

Shokë komisarë e zëvendëskomisarë, detyra juaj është një detyrë e lartë dhe nga kryerja e saj si duhet varet suksesi i sotëm dhe i nesërm. Ju dhe gjithë shokët e tjerë të Partisë në ushtri keni barrën ta bëni ushtrinë tonë të denjë e të fortë për realizimin e qëllimeve të larta që ju ka ngarkuar Partia dhe ju duhet të dini, si u ka hije komisarëve politikë dhe zëvendëskomisarëve, të ngrini lart emrin e Partisë dhe të mos preket autoriteti i saj.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Të fala shoqërore  
Për Komitetin Qendror të Partisë  
Komuniste të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet sipas kopjes që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## QARKORE E QK TË PKSH NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN E SEKSIONEVE TË EKONOMISË PRANË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE DHE ME ZGJIDHJEN E ÇËSHTJEVE EKONOMIKE TË KOHËS SË LUFTËS

3 gusht 1944

KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË

Të dashur shokë,

Po ju dërgojmë disa thirrje që u bëjnë teknikëve të ndryshëm shokët Medar Shtylla dhe Spiro Koleka. Këto thirrje i shumëzoni dhe i hidhni në vende ku ka teknikë të tillë, i ngjitni edhe në mure. Letrat personale që ju vëmë brenda, për disa teknikë, i shqyrtoni vetë dhe të gjithë atyre që qëndrojnë pak a shumë mirë ua dorëzoni dhe i ndihmoni të dalin në mal në qoftë se paraqiten. Ju dërgojmë dhe një kopje të disa qarkoreve dhe udhëzimeve nga Dikasteri i Ekonomisë<sup>1</sup>. Ky material u drejtohet këshillave të qarkut, por ju duhet ta shumëzoni dhe ta punoni në këshillin e qarkut me anën e shokëve që bëjnë pjesë atje. Më vonë do t'ju vëmë më me hollësi në dijeni se në ç'mënyrë do të funksionojnë seksionet e ndryshme në gjirin e këshillit. Por tani, me rastin që ju dërgojmë këtë material, duhet që në këshillin e qarkut, rreth të cilit do të ngrihen seksione, të caktohet një përgjegjës për ekonominë dhe ky të krijojë pranë këshillit një aparat të vogël, i cili do të ndihmojë për zbatimin e këtyre udhëzimeve që po ju japim. Materiali që çohet prej Dikasterit të Ekonomisë duhet të dërgohet në çdo këshill krahine, komuneje e fshati, ku të punohet dhe, ajo që është më me rëndësi, të vihet në zbatim. Lypset, pra, që çdo anëtar partie të ketë në kokë çdo gjë që

<sup>1</sup> Më 25 korrik 1944 Dikasteri i Ekonomisë i Komitetit Antifashist Nacional-Çlirimtar lëshoi dy qarkore mbi rimëkëmbjen e ekonomisë kombëtare (Shih: «Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar», f. 174—180, Tiranë 1962).



shkruhet atje dhe të dijë t'i zbatojë të gjitha ato që përmban programi i ekonomisë për kohën e luftës. Me rastin e punimit dhe vënjes në zbatim të këtyre udhëzimeve, sidomos shokët që punojnë në terren, duhet të rishikojnë qarkoret e ndryshme të dhëna për organizimin e këshillave dhe të komandave të vendit, të cilat duhet të forcohen për të genë në gjendje të zbatojnë këto udhëzime.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Për Komitetin Qendror të  
Partisë Komuniste të Shqipërisë

*Valbona*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

*Botuar për herë të parë:  
«Enver Hoxha. Vepra,  
vëllimi 2». Tiranë, 1968*

## **QARKORE E KQ TË PKSH NË LIDHJE ME DISA NDRYSHIME NË FORMAT ORGANIZATIVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE**

**17 gusht 1944**

**GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË  
KOMISARËVE TË DIVIZIONIT I DHE II SULMUES  
GJITHË ZËVENDËSKOMISARËVE TË BRIGADAVE  
DHE TË BATALIONEVE**

Me zmadhimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare dhe me krijimin e reparteve të mëdha si divizione dhe korparmata shihen të nevojshme disa ndryshime në format organizative të Partisë në ushtri si edhe krijimi i disa forumeve të tjera, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e plotë dhe në forcimin e Partisë në reparte të ndryshme.

Me marrjen e kësaj qarkoreje përnjëherësh drejtuesit e Partisë në ushtri ta vënë në aplikim, duke ua bërë të qartë gjithë anëtarëve të Partisë, gjithashtu gjithë komitetet qarkore të Partisë t'i punojnë këto direktiva në çdo celulë.

*Këto ndryshime konsistojnë në krijimin e komiteteve të Partisë në brigada e divizione si edhe në krijimin dhe organizimin e seksioneve politike në divizione dhe në brigada. Për Rininë Komuniste, në krijimin e komiteteve të rinisë në batalione dhe në brigada.<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> Udhëzimet që jepen në këtë qarkore të KQ të PKSH për krijimin e komiteteve të Partisë në divizione e brigada dhe krijimin e komiteteve të rinisë në batalione dhe brigada me anë të caktimit të anëtarëve të këtyre komiteteve dhe jo me anë të zgjedhjeve, për kushtet e luftës, nuk quheshin gabim. Në kushtet e luftës është i lejueshëm aplikimi i disa kufizimeve në demokracinë e brendshme të Partisë dhe pikërisht në çështjen e zgjedhjeve të organeve të Partisë. Ndërsa në kushtet e paqes të tilla kufizime nuk janë në asnjë mënyrë të lejueshme dhe quhen shkelje të rënda të parimeve organizative të Partisë marksiste-leniniste. Përsa i përket organeve politike

I. — *Komiteti i Partisë në brigadë.* Komiteti në brigadë formohet kur shihet se puna e Partisë nuk shkon mirë dhe zëvendëskomisari nuk është në gjendje të përballojë dot detyrën që i është ngarkuar dhe ka nevojë që të këshillohet. Mund të mos krijohet në rast se puna organizative e Partisë në brigadë shkon mirë dhe kur anëtarët e Partisë janë të ngritur. Në rastin e parë ky komitet formohet prej 3-7 vetash dhe zgjidhet prej aktivit të brigadës, të mbledhur në një konferencë ku marrin pjesë të gjithë drejtuesit politikë dhe ushtarakë (në këtë rast kur janë anëtarë partie). Në komitet zgjidhen shokët më të mirë, si komisari i brigadës, komisarë dhe zëvendëskomisarë të batalioneve. Zëvendëskomisari i brigadës merr pjesë në këtë komitet dhe është sekretari i komitetit. Në rast se në brigadë ka seksion politik, atëhere merr pjesë dhe përgjegjësi i seksionit politik. Komiteti i brigadës nuk ka pushtet, sikundër kanë komitetet e tjera të Partisë (komiteti qaror ose komiteti i rajonit), por është vetëm një komitet këshillues dhe udhëzues. Zëvendëskomisari i brigadës, që është njëkohësisht dhe sekretari i komitetit, mban lidhje me byrotë e batalioneve, merr raportet nga ata dhe flet mbi raportet në përgjithësi në komitet, por jo të raportojë. Zëvendëskomisari i brigadës mban gjithashtu lidhje me Komitetin Qendror dhe është direkt përgjegjës për punën e Partisë në brigadë. Anëtarët e komitetit të brigadës nuk kanë sektorë pune të ndarë, por shkojnë nëpër batalione dhe ndihmojnë udhëheqësit politikë e ushtarakë dhe gjithë anëtarët e Partisë duke i këshilluar. Mbledhjet e këtij komiteti s'janë të zakonshme dhe në një kohë të caktuar. Komiteti mbledhet kur shihet e nevojshme dhe e mundshme. Komiteti, sidoqoftë, është mirë të mbledhet në 15-20 ditë një herë. Pas çdo mbledhjeje komiteti duhet të nxjerrë konkluzione nga diskutimet e mbledhjes dhe në formë udhëzimesh t'i japë në organizatë. Në mungesë të ndonjë udhëzimi ose direktive të re, komiteti duhet të lëshojë pas çdo mbledhjeje ndonjë sqarim politik për organizatën. Anëtarët e komitetit në përgjithësi nuk mund të shkojnë nga një batalion në tjetrin, se s'mund të lënë mangut detyrat e caktuara që kanë, por kjo s'përjashton të drejtën të shkojnë ndër batalione të ndryshme po të gjejnë rastin. Kurse zëvendëskomisari i brigadës mund të shkojë kudo.

II. — *Komiteti i Partisë në divizion.* Komiteti i divizionit formohet prej zëvendëskomisarëve të çdo brigade, prej komisarit të

në ushtri (seksionet, degët politike) si në kohë lufte, ashtu edhe në kohë paqeje anëtarët e tyre emërohen nga lart dhe nuk zgjidhen.

Megjithkëtë në periudhën e Luftës nac.-çl. komitetet e Partisë të qarqeve ashtu edhe sekretarët e celulave të Partisë sonë nuk kanë qenë të caktuar nga lart, por janë zgjedhur.

divizionit, prej përgjegjësit të seksionit politik të divizionit. Më të shumtën e herës sekretari i këtij komiteti është komisari politik i divizionit, por s'përjashtohet që të jetë dhe një zëvendëskomisar i brigadës, që bën pjesë në atë komitet. Në çdo rast sekretari i komitetit duhet të jetë shoku më i mirë. Përgjegjësi i seksionit politik nuk mund të jetë sekretari i komitetit. Funkcioni i këtij komiteti është po ai i brigadës, por pushteti i tij është më i madh dhe më i rëndësishëm, se formohet prej shokësh të caktuar, që kanë një përgjegjësi të madhe. Anëtarët e këtij komiteti i japin raporte sekretarit të komitetit, por japin raporte dhe mbajnë edhe lidhje drejt me Komitetin Qendror. Çdo direktivë që vjen nga Komiteti Qendror diskutohet prej tyre dhe gjendet mënyra se si ta zbatojnë më mirë në organizatë. Mbledhjet e këtij komiteti të bëhen po në atë mënyrë dhe po me atë kriter si ato të brigadave. Pas çdo mbledhjeje komiteti i divizionit, sikundër ai i brigadës, duhet të lëshojë për organizatën qoftë një udhëzim politik, qoftë një direktivë pune, e të tjera.

Në asnjë nga këto komitete nuk merr pjesë përgjegjësi i rinisë në brigadë ose anëtari i seksionit politik për rininë në divizion. Përgjegjësi i rinisë në brigadë mban lidhje me zëvendëskomisarin e brigadës dhe me Komitetin Qendror të Rinisë.

III. — *Seksioni politik i brigadës.* Këtu nuk do të flasim për rëndësinë e seksionit, e cila ju është shpjeguar nga një direktivë e mëparshme, por për disa ndryshime që bëhen në të. Seksioni politik duhet të ketë vetëm tre vetë, të cilët duhet të punojnë në këta sektorë:

1) sektori organizativ; 2) sektori politiko-ushtarak; 3) sektori i rinisë.

Seksioni politik në mbledhjen e tij bisedon për çdo punë në përgjithësi, por mbledhja e tij nuk duhet të ketë karakterin e një mbledhjeje celule me rend dite, me situatë politike etj., por atje duhet të rrihen problemet organizative të Partisë, dobësitë dhe mbarëvajtja e ushtrisë dhe e rinisë. Në mbledhjet e tyre merr pjesë dhe zëvendëskomisari i brigadës. Anëtarët e seksionit politik s'japin kurrë direktiva, por ndihmojnë me këshilla. Raportet e anëtarëve të seksionit politik i merr përgjegjësi i seksionit, që është ai i sektorit organizativ. Ky i fundit ka lidhje vetëm me Komitetin Qendror. Seksioni politik duhet të interesohet shumë për punët në terren.

IV. — *Seksioni politik i divizionit.* Me krijimin e seksionit politik të divizionit suprimohen të gjitha seksionet politike të brigadave që përfshihen në divizion. Në këtë seksion ka pesë shokë, tre prej të cilëve kanë sektorë pune të caktuar njësoj si ata të seksionit të brigadës dhe dy të tjerët s'kanë sektorë pune të cak-

tuar. Këta bëjnë po ato mbledhje dhe po me atë karakter që bëjnë seksionet e brigadave, dhe raportet i merr kurdoherë përgjegjësi i sektorit organizativ, i cili ka vetëm lidhje me Komitetin Qendror. Përgjegjësi i seksionit politik të divizionit (organizativi) është njëkohësisht dhe anëtar i komitetit të divizionit, por ky atje është më tepër dëgjues dhe këshillues; ky nuk raporton dhe nuk jep direktiva, por mban kurdoherë lidhje me Komitetin Qendror si përgjegjës i seksionit politik. Komisari i divizionit dhe sekretari i komitetit të divizionit mund të venë në mbledhjet e seksionit politik të divizionit, kur ky bën mbledhjet nëpër repartet e tij, dhe e kanë për detyrë të venë. Mund të venë gjithashtu edhe anëtarët e komitetit të divizionit, kur t'ua permetojë koha. Seksioni politik bën edhe mbledhje ku nuk merr pjesë asnjë nga këta, dhe këto mbledhje bëhen kur bisedohet për komitetin, për shokë të ndryshëm, etj. me këtë karakter.

Përgjegjësi i seksionit politik (organizativi) i divizionit është për çështje organizative të Partisë, e sidomos për forcimin dhe shtimin e radhëve të Partisë, përgjegjës përpara Komitetit Qendror. Ky, përveç punës që bën me zëvendëskomisarët e brigadave dhe të batalioneve, në mënyrë që puna të shkojë përpara dhe mbarë, ka të drejtë të marrë edhe vetë iniciativa në këtë drejtim, por për çdo gjë që bën, si mbledhjet me shokët, me udhëheqësit, me partizanët, ai duhet të vërë në korrent sekretarin e komitetit të divizionit si edhe zëvendëskomisarin e repartit ku ka vepruar. Anëtarët e seksionit politik të divizionit respektohen prej udhëheqësve të divizionit, prej komisarit, prej zëvendëskomisarëve të brigadave dhe njihen prej tyre si delegatë të Komitetit Qendror. Përpara komandave të divizionit e të brigadave gjithashtu duhet të fitojnë respektin me anë të punës dhe të këshillave të drejta, e sidomos të pyeten kurdoherë për çështje që kanë lidhje me anëtarë të Partisë, si punë gjyqesh etj. Kurrë këta s'mund të abuzojnë me funksionin e tyre. Në celulat e në byrotë, kur shkojnë, këta s'kanë të drejtë të thonë se janë delegatë të Komitetit Qendror, por anëtarë të seksionit politik. Këta kanë të drejtë të shkojnë kudo, si në organizatat e Partisë, si në shtabet, dhe kudo në punët e ushtrisë, të formacionit ku bëjnë pjesë, qoftë në divizion, qoftë në brigadë.

Funksioni i anëtarëve të seksionit politik, qoftë të brigadave, qoftë të divizioneve, duhet të kuptohet drejt dhe të mos bihet në gabime që janë shënuar shumë herë në praktikë. Anëtarët e seksionit politik nuk kanë të drejtë të japin urdhëra dhe direktiva, ata janë këshillues dhe me këshillat e tyre bindëse ata ndihmojnë anëtarët e Partisë, udhëheqësit politikë dhe ushtarakë; ndihmojnë në kuptimin e drejtë dhe në zbatimin e plotë të direktivave të Partisë; ata mbrojnë vijën e Partisë dhe ndihmojnë forcimin dhe shumëzimin e radhëve të saja.

*Shënim.* Komisari i korpusit ka të drejtë të vejë në të gjitha organizatat e Partisë të repartit të vet dhe të japë ndihmën e plotë dhe eksperiencën e tij të madhe. Komisari politik i brigadës, përveç detyrave të veta, ka të drejtë dhe duhet të ndihmojë punën e Partisë në repartin e vet dhe në terren.

V. — *Komiteti i Rinisë Komuniste në batalion dhe në brigadë.* Në çdo kompani batalioni ka një aktiv të Rinisë Komuniste, ku marrin pjesë vetëm ata të rinj që meritojnë këtë emër; të tjerët janë rini antifashiste, por jo të organizuar në një organizatë të Rinisë Antifashiste<sup>1</sup>. Prej sekretarëve të aktiveve të kompanive formohet komiteti i rinisë në batalion. Këta mund të jenë ose jo anëtarë partie. Përgjegjësi i rinisë në batalion, i cili merr pjesë në byronë e batalionit, bëhet sekretari i komitetit të rinisë. Sekretari i komitetit të rinisë ka lidhje me zëvendëskomisarin e batalionit si edhe me komitetin qarkor të rinisë në terrenin ku ndodhet. Në rast se ky batalion është inkuadruar në brigadë, atëhere sekretari i komitetit të rinisë, përveç lidhjes që ka me zëvendëskomisarin, ka lidhje dhe me përgjegjësën e rinisë në brigadë. Të gjithë sekretarët e komiteteve të batalioneve formojnë komitetin e rinisë së brigadës. Sekretari i këtij është përgjegjës i rinisë në brigadë dhe duhet të bëjë jetë partie ose në celulën e shtabit të brigadës, në rast se është i lartësuar dhe nuk pengon punën e shtabit, ose në një celulë afër shtabit, si në atë të korrierëve. Ky mban lidhje me zëvendëskomisarin e brigadës dhe me Komitetin Qendror të Rinisë. Në rast se brigada është e inkuadruar në divizion, atëhere ky vazhdon të mbajë lidhje me anëtarin e seksionit politik të divizionit për rininë. Anëtarin e seksionit politik të divizionit për rininë mban lidhje drejtpërdrejt me Komitetin Qendror të Rinisë Komuniste.

Sekretari i komitetit të rinisë në batalion, i cili bën pjesë në byronë e batalionit, duhet të bëjë jetë partie në një celulë: në rast se është i lartësuar, në mënyrë që të mos pengohet puna e celulës së shtabit të batalionit ai bën pjesë në këtë celulë. Në rast të kundërt, ai duhet të bëjë pjesë në një celulë të formacioneve që janë pranë shtabit, si celula e armëve të rënda ose e korrierëve.

*Shtojcë.* Në kompani ku ka celula partie nuk duhet të ketë

<sup>1</sup> Gjatë kohës së luftës, në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare kishte vetëm organizata të Rinisë Komuniste në kompani, ndërsa organizata të Rinisë Antifashiste, si në terren, nuk kishte.



grupe edukative të Partisë. E gjithë kompania duhet të jetë një grup edukativ. Në kompani ka vetëm kurse kandidatësh partie<sup>1</sup>.

*Enver Hoxha*

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

<sup>1</sup> Kurset e kandidatëve krijohen për herë të parë në Partinë tonë në gusht të vitit 1944, pranë çdo celule partie, si në ushtri, ashtu edhe në terren. Në kurs merrnin pjesë njerëzit që kishin kushtet më të mira për t'u bërë anëtarë partie. Stazh të caktuar për kandidatët nuk kishte. Në fillim me ta bëhej punë më vete për t'i përgatitur për anëtarë partie, ndërsa në mbledhjet e celulës nuk merrnin pjesë.

Përpara se të krijoheshin kurset e kandidatëve pranë çdo celule të Partisë ekzistonte grupi i simpatizantëve, i cili më vonë u quajt grupi edukativ. Në këto grupe merrnin pjesë njerëzit që ishin më afër Partisë dhe kishin perspektivë për t'u bërë anëtarë partie.

**UDHËZIME TË KQ TË PKSH NË LIDHJE ME KRIJIMIN  
E KOMISIONEVE PËR ZBULIMIN E KRIMINELËVE TË  
LUFTËS, KOMISIONEVE TË ASISTENCËS SOCIALE,  
KOMISIONEVE PËR SHQYRTIMIN E FITIMEVE TË  
LUFTËS NGA TREGËTARËT DHE NË LIDHJE ME  
PUNËN QË DUHET TË BËJNË KËTO KOMISIONE**

28 dhjetor 1944

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH

Të dashur shokë,

Për pesë vjet rresht luftë të paprerë kundër okupatorit fashist dhe tradhëtarëve populli ynë rezistoi, u dogj e u poq, por kurrë nuk u përkul. Lufta ka qenë e tmerrshme, por dhe dëmta që kanë ardhur si konsekuencë e kësaj kanë qenë shumë të mëdha. Krahina të tëra janë djegur nga okupatori dhe një numër i madh janë vrarë nga terrori që armiku dhe tradhëtarët përdorën për ta përkulur popullin tonë. Populli i duroi të gjitha mizoritë e armikut dhe u lidh me lëvizjen tonë, ai u mobilizua i tërë në bazë të parullave të Partisë sonë dhe duke pasur besim ndër ne na ka ndjekur gjer më sot. Sot populli kërkon prej nesh atë që i kemi premtuar, ai e do zgjerimin dhe përforcimin e Frontit, por jo me kriminelë, por me njerëz të ndershëm që kanë luftuar për të mirën e tij ose me njerëz që të gënjyer gjer dje sot janë kthyer në rrugën e drejtë dhe janë gati për të vënë në veprim të gjitha energjitë e tyre për të ndihmuar në veprën e madhe të rindërtimit, *por populli nga ana tjetër kërkon dhe e do dënimin e kriminelëve të luftës, ai kërkon që pas kësaj lufte të përgjakshme që bëri, të arrijë në një ndryshim të jetesës së tij.*

Ne, për fatin e keq, dimë vetëm që krahina të tëra në Shqipëri janë djegur e shkatërruar, dimë se shumë njerëz janë vrarë dhe terrorizuar nga armiku dhe kriminelët e brendshëm, por asnjë statistikë të sigurtë nuk kemi mbi këta kriminelë e mbi këto dëme. Ka qenë një mungesë e madhe e jona e të gjithë organizatave tona që nuk janë përkujdesur për këtë vepër me kaq

rëndësi, megjithëse nga kanale të ndryshme janë bërë shumë herë kërkesa.

Prandaj kërkohet nga organizatat e Partisë që t'i vënë një rëndësi shumë të madhe çështjes së kriminelëve duke i kategorizuar mirë këta, çështjes të të dëmtuarve nga lufta dhe të të vrarëve, duke nxjerrë në këtë mënyrë statistika të sakta.

Komiteti Qendror i Partisë ngarkon dhe i vë përpara përgjegjësisë të gjitha komitetet qarkore për kryerjen e këtyre veprimeve me kaq rëndësi të madhe. Do të krijohen pranë çdo prefekturë komisione të ndryshme, të cilat do të drejtohen nga komisionet qendrore dhe këto komisione janë:

1) Komisioni i zbulimit të krimeve dhe të kriminelëve të luftës, komision me shumë rëndësi, i cili duhet të krijohet me urgjencën më të madhe brenda një kohe shumë të shkurtër dhe të formohet në mënyrë të tillë që përfundimet e tij të jenë të shpejta e të frutshme. Gjithë Rinia Antifashiste, Gruaja Antifashiste dhe i gjithë populli duhet të mobilizohen e t'u vijnë në ndihmë komisioneve. Të bëhen hetime të sigurta, të formohen statistika për dëmet, për të vrarët dhe të terrorizuarit nga lufta. Delegatët e Rinisë, të Gruas Antifashiste e të Frontit që do të marrin pjesë në këto komisione duhet të bëhen shprehja e gjallë e të gjithë dokumentimit mbi kriminelët e jashtëm, italianë e gjermanë, të brendshëm, mbi vrasjet e dëmet e luftës.

Të tregohet një kujdes i fortë nga ana e organizatave të Partisë dhe të luftohet konfuzioni. Çdo gjë që flitet për njërin ose për tjetrin të dokumentohet. T'i vihet në të vërtetë gishti kriminelit dhe ai të dalë në shesh se në rast të kundërt do të dëmtohem politikisht në vend që të kemi përfundimet e parashikuara. Në komisione duhet të marrin pjesë njerëz të shkathët e të zot, njerëz që duan të punojnë dhe që dinë të punojnë, që kanë një të kaluar politike të mirë e që janë të ndërgjegjshëm. Populli t'i njohë si njerëz të drejtë, si njerëz që nuk gabohen në hetimet e tyre. Me një fjalë pjesëtarët e këtyre komisioneve duhet të jenë të vendosur në vendimet e tyre, larg ndonjë influence, miqësie e tarafilëku dhe të llogjikshëm.

Anëtarët e Partisë ta kuptojnë mirë rëndësinë e këtyre komisioneve dhe të mobilizojnë të gjitha energjitë e gjalla të popullit për t'u ardhur në ndihmë këtyre. Populli ta ndjejë krijimin e tyre dhe t'i shohë shpejt frutet e tyre, t'i ndihmojë këto me ndërgjegje dhe të ketë bindje se këto komisione krijohen vetëm për të mirën e popullit. KQ i quan sektorë pune me shumë rëndësi, prandaj barra ju bie juve ta kryeni si duhet e për çdo pengesë e mungesë ju jeni përgjegjës përpara Partisë.

2) Komisionet e asistencës sociale krijohen në çdo prefekturë dhe marrin përsipër të kryejnë një barrë shumë të rëndë dhe të domosdoshme në konditat që ndodhet sot populli ynë. Qëllimi

kryesor i këtyre është të normalizojnë gjendjen ekonomike të popullit, duke u munduar që të bëhet sa më e shpejtë zhdukja e mjerimit dhe e varfërisë që ka pushtuar popullin tonë. Do t'i mbërrihet këtij qëllimi me punë të pareshtur të organizatave të Partisë, të cilat duhet të mobilizojnë gjithë masat e popullit për t'u ardhur në ndihmë këtyre komisioneve, duhet t'i japim të kuptojë popullit me konferenca e mitingje të gjëra mbi rëndësinë e kësaj fushate të madhe e filantropike. Populli i gjithë duhet të shkundet mirë, ta ndjejë nevojën e fushatës dhe të kontribuojë me çdo mjet. Duhet të veprohet duke përdorur çdo mjet propagande: shkrime artikujsh, trakte, konferenca etj. dhe të arrihet që populli ta ndjejë vuajtjen dhe mjerimin e të dëmtuarve nga lufta, të zhvillohet në popull dhëmshuria, populli të heqë kafshatën e gojës për të ndihmuar vëllanë e tij që vuan prej urie. Me një fjalë të zhvillohet dhe të forcohet në popull solidariteti dhe dashuria për njëri-tjetrin dhe do t'i mbërrihet këtij qëllimi, kur populli të kuptojë rëndësinë e komisioneve të asistencës sociale, kur ai do të shohë përfundimin e tyre, kur do të shohë se këto komisione nuk janë ato të regjimeve të kaluara që bënin fushata ndihme për t'u pasuruar në kurriz të popullit, por janë komisione që do të krijohen me njerëz të ndershëm, të ndërgjegjshëm, njerëz që populli ka besim dhe i ka provuar.

Populli është i lodhur nga komisionet e regjimeve të kaluara, ai s'kënaqet me fjalë të bukura, por don vepra dhe prandaj pikërisht këtu duhet të insistohet që komisionet të dalin për një kohë të shkurtër përpara popullit me frutet e duhura. Anëtarët e Partisë duhet të bëhen flamurtarët e kësaj fushate, të mobilizojnë rreth këtyre gjithë energjitë dhe të bëhen mbështetje e fortë e komisioneve të asistencës sociale e në kryerjen e kësaj barre të rëndë filantropike. Fushata të ndihet mirë në popull. Të gjithë duhet ta ndiejnë si detyrë që duhet të ndihmojnë me para, me lesh, me grurë, misër, e me çfarëdo materiali të nevojshëm për të përmirësuar gjendjen e të mjeruarve nga lufta.

Të kuptohet mirë nga organizatat se ky është një problem ekonomik me shumë rëndësi që duhet zgjidhur dhe që do të zgjidhet vetëm në këtë mënyrë pasi burimet ekonomike e të ardhurat tona janë shumë të vogla e të pamundshme. Organizatat antifashiste e mbi të gjitha Gruaja Antifashiste, duhet të bëhet flamurtarja dhe mbështetja më e fortë për komisionet e asistencës sociale. Kështu dhe vetëm kështu do të mund të zhdukim mjerimin në popull. Prandaj organizatat e Partisë vihen përpara përgjegjësisë për kryerjen e këtij misioni me kaq rëndësi për Partinë tonë në këto momente dhe duhet që të kryhet pa asnjë shmangie dhe pa asnjë justifikim.

3) Komisionet mbi shqyrtimin e fitimeve të luftës duhet të krijohen sa më parë e pranë çdo prefekturë dhe do të marrin

përsipër një barrë me shumë rëndësi, e cila do të sjellë si përfundim grumbullimin e një shume të madhe të hollash që do të shkojë në ndihmë të arkës së shtetit dhe do të përdoret për nevojat e rindërtimit të Shqipërisë.

Shumë tregëtarë të mëdhenj e të mesëm dhe shumë pronarë gjatë luftës kanë bërë fitime kolosale, ndërsa pjesa më e madhe e popullit luftoi dhe u shkatërrua ekonomikisht. Komisionet do të jenë ato që do të shqyrtojnë këto fitime, që do të bëjnë në rregull kategorizimin e tregëtarëve dhe do t'i taksojnë ata në bazë të fitimeve që kanë bërë. Por duhet të kihet kujdes në këto shqyrtime që të bëhen në rregull e të mos bëhen gabime, prandaj personat që do të zgjidhen në këto komisione duhet të jenë të vendosur në mendimet e tyre, të aftë për kryerjen e misionit, të gatshëm për punë dhe të mos bien në pozita miqësie e tarafilëku, në mënyrë që përfundimi të jetë i tillë që komisionet të mos dalin nga ky veprim me disa shuma të vogla e qesharake, por me shuma të mëdha të hollash.

Sigurisht edhe për krijimin e këtyre komisioneve do të jenë organizatat e Partisë ato që do të luajnë rolin më me rëndësi, si në krijimin e shpejtë të tyre, ashtu edhe në mirëfunksionimin e tyre.

Duhet të sqarohen mirë të gjithë anëtarët e Partisë, të kuptojnë rëndësinë e madhe që u jep Partia këtyre tri komisioneve dhe ta marrin çështjen me gjithë seriozitetin e duhur në mënyrë që këto të krijohen sa më parë që të jetë e mundur dhe përfundimi i tyre të jetë i shpejtë dhe me frutet e parashikuara nga Partia. Asnjë justifikim nuk do të pranohet për mungesë e neglizhencë. KQ i quan si probleme me një rëndësi të jashtëzakonshme që duhet të shtrohen e të zgjidhen me urgjencë, prandaj të gjitha organizatat e Partisë, i gjithë populli duhet të mobilizohet e t'u vijë në ndihmë komisioneve të sipërpërmendura se vetëm kështu do t'i arrihet qëllimit.

#### KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

#### UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR FORCIMIN MË TEJ TË PUNËS POLITIKO-EDUKATIVE DHE ORGANIZATIVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

15 janar 1945

KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE  
KOMITETIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM  
KOMITETEVE TË SHTABEVE TË KORPUSEVE  
KOMITETEVE QARKORE  
KOMITETIT QENDROR TË RINISË  
KOMITETEVE QARKORE TË RINISË

Të dashur shokë,

Në Kongresin e Përmetit lëvizja jonë u paraqit e fortë si nga pikëpamja politike ashtu edhe nga ajo organizative. Doli me një ushtri të madhe dhe të fortë, që kishte mbledhur energji të reja dhe paraqiste të gjitha konditat për të shkuar edhe më përtej, për t'i dhënë Luftës nacional-çlirimtare karakterin nacional, për të zgjeruar kështu lëvizjen dhe për të çliruar zona të tëra, që ishin nën kontrollin e okupatorit dhe të yzmeqarëve të tij, «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti».

Bindja për ta zgjeruar luftën lindi nga prova që dhanë forcat tona, të cilat përbaluan me sukses ofensivën e madhe të dimrit, dhe konsoliduan pozitën politike dhe ushtarake. Ushtria jonë ishte e gatshme për të avancuar. Vendimi i Kongresit të Përmetit që u muar për kalimin e forcave tona për në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, i hapi rrugën Divizionit I Sulmues, që u formua në atë kohë, si reparti më i madh i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, për të avancuar, dhe, në marshim duke përbaluar ofensivën e dytë të qershorit, ai çliroi pjesë të mëdha të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, duke goditur qendra të rëndësishme të reaksionit.

Çlirimi i këtyre vendeve, që deri në atë kohë ishin nën kontrollin e okupatorit, bëri që të mbushen radhët, të zgjerohet dhe